

K u r a n i

Shqipëroi: Myfti Salih F. Hoxha

Përgatiti: Kudret S. Hoxha

Kopertina: Elvis Bejtja

Edicion elektronik. Rishikuar: 2015

Në shtyp: Botimi i parë: Shtëpia Botuese "Pegi".

Tirazhi 1000 kopje. Tiranë 2013

Botimi i dytë: Sh.B. "Logos-A" Për botuesin: Adnan
Ismaili. Shkup 2016

Published by K.S. Hoxha at Smashwords

© 2014 - 2016 kshoxha

ISBN: 9781310358791

Smashwords Edition, License Notes

All rights reserved. No part of this publication may be reproduced, stored in a retrieval system, or transmitted in any form or by any means, electronic, mechanical, photocopying, recording or otherwise, without the prior permission of the copyright owner.

القرآن الكريم

El Kur'ān El Kerím Kurani i Nderuar



Bismil-Lah' Er-Rahman Er-Rahim Me Emrin e Zotit, Bamirësit, Mëshirëplotit!

1. HYRJA (EL FATIHA)

Periudha e Mekës, 7 ajete

1. Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.
2. Lavdi Allahut, Zotit të botëve,
3. Bamirësit, Mëshirëplotit,
4. Sunduesit të Ditës së Gjykimit!
5. Ty të adhurojmë, Ty të kërkojmë ndihmë.
6. Drejtona në Rrugën e Drejtë,
7. në rrugën e atyre që ke bekuar, jo të atyre që urrehen, as t'atyre që janë të gabuar.

Periudha e Mekës: 610 - 622 e.r. Fillimet e shpalljes së Kuranit. Para shpërnguljes (në Medine).

Periudha e Medines: 622 - 632 e.r.Pas shpërnguljes.
Fillimi i Epokës Islame: 1h. (Hixhri), 622 e.r.

2. LOPA (EL BEKARE)

Periudha e Medines, 286 ajete
Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Elif, lam, mim. (a, l, m)
2. Ky libër, pa dyshim, është drejtim për të devotshmit,
3. që besojnë në të padukshmen, kryejnë të falurit dhe,
nga pjesa që u kemi dhënë, kontribuojnë.
4. që besojnë ç'është zbritur tek ty e ç'u zbrit para teje
dhe binden për të ardhmen.
5. Ata janë të drejtuar nga Zoti i tyre, ata janë të
suksesshmit.
6. Për mohuesit është njësoj: i paralajmëron ose jo, nuk
besojnë.
7. Zoti ua vulosi zemrat e veshët; në sytë e tyre ka
perde dhe i pret dënim i madh.
8. Ndër njerëzit, ka që thonë: "Besojmë Zotin dhe Ditën
e Fundit", - por nuk janë besimtarë.
9. Duan të mashtrojnë Zotin e besimtarët, mashtrojnë
veten dhe nuk e kuptojnë.
10. Lëngatë në zemrat e tyre; Zoti u shtoi lëngatë dhe
kanë dënim të hidhët pasi gënjen.
11. Kur u thuhet: "Mos sillni ngatërresa në tokë!" - thonë:
"Ne jemi vetëm paqësorë."
12. A nuk janë ata ngatërrestarët? Mirëpo s'e kuptojnë.
13. Kur u thuhet: "Besoni siç besuan njerëzit", - thonë:
"Të besojmë siç besuan budallenjtë?" A nuk janë ata
budallenjtë? Mirëpo nuk e dinë.

14. Kur takojnë besimtarët, thonë: “Besuam!”- dhe, kur veçohen te djajtë e tyre, thonë: “Ne jemi me ju. Ne vetëm se po tallemi.”
15. Zoti tallet me ta dhe u jep kohë të çoroditen në rebelimin e tyre.
16. Janë ata që blenë të shtrembtën me të drejtën, s'u pati fitim tregtia e tyre dhe nuk u udhëhoqën drejt.
17. Shembulli i tyre, si i dikujt që ndez zjarr; sapo bën dritë për rreth, Zoti ia merr dritën dhe e lë në errësirë. Nuk vështrojnë.
18. Të shurdhër, memecë, të verbër, ata nuk ndryshojnë.
19. Ose, si në një rrebesh nga qielli, me errësirë, gjënim e vetëtimë; zënë veshët me gishta nga rrufetë, të trembur për vdekje. Zoti i rrethon mohuesit.
20. Shkreptima gati ua verbon të parët; me t'u bërë dritë, ecin nëpër të; kur errësohet, shtangen. Të kishte dashur Zoti, ua merrte të dëgjuarit dhe të parët. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.
21. Njerëz, adhuron Zotin tuaj i Cili ju krijoi juve dhe paraardhësit tuaj që të mund të përmbaheni.
22. Bëri për ju tokën shtrat dhe qiellin ngrehinë, uli prej qiellit ujë dhe nxori me të fryte, ushqim për ju. Mos i bëni Zotit ortakë përderisa e dini.
23. Po të jeni në dyshim nga ç'i shpallëm robit Tonë, sillni një sure të ngjashme dhe ftoni, veç Zotit, dëshmitarët tuaj në thoni të vërtetën.
24. Po nuk e bëtë dhe nuk do ta bëni, ruajuni zjarrit me lëndë djegëse njerëzit e idhujt: u gatit për mohuesit.
25. Përgëzoji ata që besojnë e bëjnë të mira. Për ta ka kopshte ku rrjedhin lumenj. Sa herë ushqehen me frytet e tyre, thonë: “Me këto u ushqyem më parë.”

- Dhe u shëmbëllejné. Kanë atje bashkëshorte të pastra dhe janë në to përgjithmonë.
26. Zoti nuk druan të sjellë shembull rreth një insekti a më tej. Besimtarët e dinë se është e vërteta nga Zoti i tyre. Ndërsa mohuesit thonë: “Ç’ka dashur Zoti me këtë shembull?” Gabon me të shumë e drejton me të shumë, porse gabon të pabindurit,
27. që thyejnë besën e Zotit pasi e dhanë, këpusin çfarë Zoti ka urdhëruar të arrihet me të dhe shkaktojnë të këqia në tokë. Ata janë të humburit.
28. Si mohoni Zotin që, ndërsa ishit të pajetë, ju dha jetë, pastaj ju vdes e ju ngjall dhe te Ai ktheheni?
29. Është Ai që krijoi për ju krejt ç’janë në tokë, iu përqendrua qiellit dhe sistemoi shtatë qiej. Ai është për gjithçka dijeplotë.
30. Kur yt Zot u tha engjëjve: “Unë po vë mëkëmbës në tokë”, - thanë: “Vë kë sjell të këqia në të e derdh gjak ndërsa ne të thurim lavde e të shenjtërojmë?” Tha: “Unë di ç’ju nuk dini.”
31. Dhe ia mësoi Ademit gjithë emrat, pastaj ua parashtoi engjëjve e tha: “Më njoftoni për emrat në thoni të vërtetën!”
32. Thanë: “Madhëruar qofsh! Ne nuk dimë veç asaj që na ke mësuar. Ti je Dijeploti, i Urti.”
33. Tha: “O Adem, bëjua të njohur emrat!” Kur ai ua bëri të njohur emrat, tha: “A nuk ju thashë se Unë di të padukshmen e qiejve dhe të tokës, di çfarë shfaqni e fshihni?”
34. Kur u thamë engjëjve: “Përluni para Ademit!” - u përlulën përveç Iblisit (djallit). Refuzoi, u mburr dhe qe ndër mohuesit.

35. Thamë: "O Adem, banoni ti dhe gruaja jote në kopsht, hani aty lirisht, ku të dëshironi, por mos iu afroni kësaj peme e të jeni ndër dhunuesit."
36. I tundoi djalli te ajo dhe i nxori së andejmi. U thamë: "Zbritni, armiq të njëri-tjetrit! (njerëzit me dajtë) Keni në tokë vendqëndrim dhe jetesë të përkohshme."
37. Ademi mori fjalë nga Zoti i tij dhe Ai e fali. Ai është Falësi, Mëshirëploti.
38. Thamë: "Zbritni së andejmi të gjithë! Kur t'ju vijë drejtim nga Unë, cilët ndjekin drejtimin Tim, nuk frikësohen e dëshpërohen;
39. ata që mohojnë dhe përgënjeshtrojnë dëshmitë Tona janë banorët e zjarrit, përgjithmonë."
40. Bijtë e Izraelit, kujtoni të mirën që ju bëra, përmbushni besën me Mua, Unë përmbush besën me ju dhe Mua m'u frikësoni.
41. Besoni çfarë kam zbritur, që vërteton shkrimet tuaja dhe mos jini të parët mohues të tij. Mos blini me dëshmitë e Mia një çmim të ulët dhe Mua m'u përmbani!
42. Mos vishni të vërtetën me të rremen e të fshihni me dijeni të vërtetën.
43. Kryeni të falurit, jepni detyrimin (zekatin) dhe përkuluni (faluni) me ata që përkulen.
44. A u porositni njerëzve besimtarinë dhe harroni veten ndërsa ju recitoni Librin? Nuk kuptoni?
45. Kërkoni ndihmë me durim e lutje. Kjo është e vështirë, por jo për të përvuajturit,
46. që besojnë se janë në takim me Zotin e tyre dhe te Ai kthehen.
47. Bijtë e Izraelit, kujtoni të mirën që ju bëra: Unë ju dallova mbi popujt.

48. Kujdes ditën kur nuk paguan një frymë tjetrën, nuk pranohet ndërmjetësi, nuk merret shpërblim dhe ata nuk do të ndihmohen.
49. Kur ju shpëtuam nga njerëzit e faraonit që ju jepnin dënimin më të keq, thernin bijtë tuaj dhe linin gjallë gratë tuaja, ishte kjo për ju një provë e madhe nga Zoti juaj.
50. Kur ndamë detin e ju shpëtuam, i mbytëm njerëzit e faraonit nën vështirimin tuaj.
51. Kur i caktuam Musait dyzetë netët, morët vijën (idhull) pas tij si dhunues.
52. Pas kësaj, ju falëm që të mund të falënderoni.
53. I dhamë Musait Librin dhe Dalluesin që të mund të drejtoheni.
54. Kur Musai i tha kombit të tij: “Kombi im! Me vijën, dhunuat veten tuaj, pendohuni te Krijuesi juaj dhe vrisni veten! Kështu është më mirë për ju, pranë Krijuesit tuaj.” Dhe Ai ju fali. Ai është Falësi, Mëshirëploti.
55. Kur thatë: “O Musa, nuk të besojmë pa e parë Zotin hapur”, - ju mori rrufeja tek shihnit.
56. Pasi vdiqët, ju ngritëm përsëri që të mund të falënderoni.
57. Bëmë sipër jush hije me re dhe zbritëm nektar e thëllëza: “Hani nga të mirat që ju dhamë!” Nuk na dhunuan Ne, por dhunuan veten.
58. Kur thamë: “Hyni në këtë vendbanim dhe ushqehuni aty lirisht, ku të dëshironi; hyni në portë me përulje dhe thoni: “Falje!”- t’jua falim gabimet dhe mirëbërësve t’u shtojmë të mirat”, -

59. dhunuesit ndërruan fjalë, ndryshe nga ç'u qe thënë. Ulëm mbi dhunuesit ndëshkim nga qielli pasi rebeluan.
60. Kur Musai kërkoi ujë për kombin e tij, thamë: "Godite shkëmbin me shkopin tënd!" Gufuan dymbëdhjetë burime ku secili fis dinte burimin e vet. "Hani e pini nga ushqimi i Zotit dhe mos veproni keq në tokë si ngatërrestarë!"
61. Kur thatë: "O Musa, nuk do të durojmë me njëlloj ushqimi. Thirre tët Zot të na nxjerrë nga perimet që prodhon toka: tranguj, hudhra, thjerrëza e qepë", - ai tha: "Doni të këmbeni diçka më të mirë me të rëndomtë? Zbrisni në qytet ku ka për ju ç'të kërkoni." Ranë mbi ta poshtërimi e skamja dhe rikthyen zemërim nga Zoti. Sepse mohuan dëshmitë e Zotit dhe vranë pa të drejtë profetët. Sepse kundërshtuan dhe e tejkaluan.
62. Besimtarët, judenjtë, të krishterët, sabinët, cilët besojnë Zotin dhe Ditën e Fundit dhe bëjnë mirë, e kanë shpërblimin pranë Zotit të tyre. Nuk frikësohen e dëshpërohen.
63. Kur morëm besën tuaj dhe jua lartësua Malin (Sinai): "Mbani fort çfarë ju kemi dhënë dhe kujtoni ç'është në të që të mund të përmbaheni."
64. Më tej, u shmangët dhe, të mos qenë mirësia e Zotit ndaj jush dhe mëshira e Tij, do të ishit të humbur.
65. Tashmë i dini tuajt që dhunuan të Shtunën dhe u thamë: "Jini majmunë, të përçmuar!"
66. E bëmë ndëshkim shembullor për të pranishmit e të mëpasshmit dhe këshillë për të devotshmit.

67. Kur Musai i tha kombit të tij: “Zoti ju urdhëron të thorni një lopë”, - thanë: “Po tallesh me ne?” Tha: “Zoti më ruajttë të mos jem ndër të paditurit!”
68. Thanë: “Thirrë tët Zot të na sqarojë ç’është ajo.” Tha: “Thotë se është lopë mesatare, as e vjetër dhe e re. Bëni ç’jeni urdhëruar.”
69. Thanë: “Thirrë tët Zot të na sqarojë për ngjyrën e saj.” Tha: “Thotë se ka ngjyrë të verdhë, një ngjyrë të shndritshme që i kënaq shikuesit.”
70. Thanë: “Thirrë tët Zot të na sqarojë ç’është ajo pasi lopët na duken të ngjashme dhe, dashtë Zoti, udhëhiqemi drejt!”
71. Tha: “Thotë se është lopë e pambrehur në zgjedhë për të lëruar tokën e për të vaditur të mbjellat, pa të meta dhe nuk ka ndonjë njollë.” Thanë: “Tani na e solle të vërtetën.” Dhe e therën, por s’do ta kishin bërë.
72. Kur vratë një frymë, u grindët në të. Zoti nxjerr në dukje të fshehtat.
73. Thamë: “Goditeni me një copë të saj!” Kështu, Zoti sjell në jetë të vdekurin dhe ju tregon dëshmitë e Tij që të mund të kuptoni.
74. Edhe pas kësaj, u ngurtësuan zemrat tuaja, si gurët a më të ngurta, sepse ka gurë nga ku gufojnë lumenj ose që çahen e buron ujë ose që bien nga frika e Zotit. Zoti nuk është i shkujdesur ndaj veprave tuaja.
75. Lakmoni t’ju besojnë kur një kastë e tyre dëgjon Fjalën e Zotit dhe, pasi e ka kuptuar, e ndryshon me vetëdije?
76. Kur takojnë besimtarët, thonë: “Besuam”- dhe, kur veçohen te njëri-tjetri, thonë: “A u tregoni atyre çfarë

- ju zbuloi Zoti që t'ju kundërshtojnë me të te Zoti juaj?
Nuk kuptoni?"
77. Nuk e dinë se Zoti di çfarë mbajnë fshehur e thonë hapur?
78. Ndër ta, të paditurit nuk njohin Librin, por iluzionet dhe vetëm se pandehin.
79. Mjerë ata që shkruajnë librin me duart e tyre, pastaj thonë: "Është nga Zoti", - për të blerë me të një çmim të ulët. Mjerë ata se ç'shkruajnë duart e tyre, mjerë ata çfarë fitojnë!
80. Thonë: "Nuk do të na prekë zjarri përveç disa ditëve të numëruara." Thuaj: "Mos morët besë te Zoti? Sepse Zoti nuk e shkel besën e Tij. Apo thoni për Zotin çfarë nuk dini?"
81. Po, cilët fituan të keqen dhe i rrethuan gabimet e tyre, janë banorët e zjarrit, përgjithmonë.
82. Ata që besojnë e bëjnë të mira janë banorët e parajsës, përgjithmonë.
83. Kur morëm besën e bijve të Izraelit: "Të adhuroni vetëm Zotin dhe, me prindërit, të silleni mirë, edhe me të afërmit, me jetimët, me të varfrit; t'u flisni mirë njerëzve, të kryeni të falurit e të jepni detyrimin", - përjashtuar një pakice, u shmangët si kundërshtarë.
84. Kur morëm besën tuaj: "Të mos derdhni gjakun tuaj dhe mos nxirrni njëri-tjetrin nga shtëpitë tuaja", - e pranuat dhe e dëshmoni.
85. Pastaj, jeni ju që vrisni veten tuaj dhe nxirrni një pjesë tuajsh nga shtëpitë e tyre duke bashkëpunuar kundër tyre me mëkat e armiqësi. Po t'ju vijnë të robëruar, i paguani ndërsa nuk ju lejohej dëbimi i tyre. A besoni një pjesë të Librit dhe mohoni një pjesë? Cili është ndëshkimi i atyre që veprojnë kështu? Poshtërim në

këtë botë dhe Ditën e Ringjalljes i kthehen një dënimi më të rreptë. Zoti nuk është i shkujdesur ndaj veprave tua.

86. Janë ata që blenë këtë botë me të ardhmen, nuk u lehtësohet dënimi, as do të ndihmohen.
87. I dhamë Musait Librin dhe e pasuam me profetë. I dhamë Isait, birit të Merjemit, prova të qarta dhe e mbështetëm me Shpirtin e Shenjtë. Sa herë ju erdhi i dërguar me çka s'ju pëlqente, a u mburrët dhe dikë e përgënjeshtruat, dikë e vratë?
88. Thonë: "Zemrat tona janë të mbyllta." Porse i mallkoi Zoti për mohimin e tyre dhe pak besojnë.
89. Kur u erdhi libër nga ana e Zotit, që vërteton shkrimet e tyre, ndërsa më parë kërkonin fitoren mbi mohuesit, sapo u erdhi ai që njihnin, e mohuan. Mallkimi i Zotit qoftë mbi mohuesit!
90. Sa keq e shitën veten duke mohuar çfarë Zoti ka zbritur, nga keqdashja që Zoti, me Mirësinë e Tij, ia zbret atij që do ndër robtë e Vet. Dhe kthyen zemërim pas zemërimi. Mohuesit kanë dënim poshtërues.
91. Kur u thuhet: "Besoni çfarë Zoti ka zbritur,"- thonë: "Besojmë ç'u zbrit tek ne" - dhe mohojnë të vërtetën më pas që vërteton shkrimet e tyre. Thuaj: "Përse i vrisnit më parë profetët e Zotit në jeni besimtarë?"
92. Ju erdhi Musai me prova të qarta dhe morët pas tij viçin si dhunues.
93. Kur morëm besën tuaj dhe jua lartësuam Malin: "Mbani fort çfarë ju kemi dhënë dhe dëgjoni!"- thanë: "Dëgjuam e kundërshtuam." Dhe iu ngulit në zemra viçi me mohimin e tyre. Thuaj: "Sa keq ju porosit besimi juaj në jeni besimtarë!"

94. Thuaj: "Po të jetë banesa e së ardhmes pranë Zotit vetëm për ju, pa njerëzit e tjerë, dëshirojeni vdekjen në thoni të vërtetën."
95. Nuk do ta dëshironin kurrë me ç'përgatitën duart e tyre. Zoti i njeh dhunuesit.
96. Do t'i gjesh ata, njerëzit më lakmues në jetë, edhe se idhujtarët. Do t'i pëlqente ndonjërit prej tyre të jetonte një mijë vjet, por nuk do t'i largohet dënimit edhe sikur të jetojë. Zoti është largpamës i veprave të tyre.
97. Thuaj: "Kush është armik i Xhibrilit? Ai e zbriti atë, me lejen e Zotit, në zemrën tënde, duke vërtetuar shkrimet para tij, drejtim e sihariq për besimtarët."
98. Kush është armik i Zotit, i engjëjve të Tij, i të dërguarve të Tij, i Xhibrilit dhe Mekailit? Zoti është armik i mohuesve.
99. Ne të shpallëm dëshmi të qarta që nuk i mohojnë, por vetëm se të pabindurit.
100. Sa herë lidhën besë, mos e hodhi tej një pjesë e tyre? Të shumtët nuk besojnë.
101. Kur u erdhi i dërguar nga ana e Zotit që vërteton shkrimet e tyre, një kastë e atyre që u është dhënë Libri e hodhi pas shpine Librin e Zotit si të mos e dinte.
102. Dhe ndoqën ligjërimet e djajve gjatë sundimit të Sulejmanit. Nuk mohoi Sulejmani, por djajtë mohuan; u mësonin njerëzve magjinë dhe nga ç'u qe dhënë dy engjëjve në Babiloni, Harutit e Marutit. Këta nuk mësonin dikë pa thënë: "Ne jemi vetëm si provë, pra mos mohoni!" Mësonin prej tyre ndarjen e burrit me gruan. Ata nuk mund të dëmtonin dikë pa lejen e Zotit. Mësonin ç'i dëmtonte e që nuk u bënte dobi.

- Dhe e dinin se kush e bleu atë, s'ka pjesë në të ardhmen. Sa keq e shitën veten sikur ta dinin!
103. Po të besonin e të përmbaheshin, një shpërblim nga ana e Zotit do të ishte më i mirë sikur ta dinin.
104. Besimtarë, mos thoni: "Raina!"- por thoni: "Undhurna (vërena, vëzhгона)!"- dhe dëgjoni! Mohuesit kanë dënim të hidhët.
105. Nuk u pëlqen mohuesve ithtarë të Librit (ndër judenjtë e të krishterët) dhe idhujtarëve t'ju vijë e mirë nga Zoti juaj. Zoti veçon, me Mëshirën e Vet, atë që do. Zoti është i Mirësisë së Madhe.
106. Kur anulojmë ndonjë dëshmi ose e lëmë në harresë, sjellim një më me përparësi ose të ngjashme. A nuk e di se Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë?
107. Nuk e di se Zotit i takon sundimi i qiejve e i tokës dhe se, veç Zotit, nuk keni kujdestar e ndihmëtar?
108. Mos doni të pyesni profetin tuaj siç u pyet Musai më parë? Kush këmben besimin me mohim, ka gabuar rrugën e drejtë.
109. Shumë nga ithtarët e Librit do të dëshironin t'ju prapsin, pas besimit, në mohues, nga smira që kanë pasi u është sqaruar e vërteta. Falni e mos vini re derisa Zoti të sjellë urdhër. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.
110. Kryeni të falurit, jepni detyrimin! Ç'të mirë i përgatisni vetes, e gjeni pranë Zotit. Zoti është largpamës i veprave tuaja.
111. Thonë: "Nuk do të hyjë tjetër në parajsë përveç judenjve a të krishterëve." Këto janë iluzionet e tyre. Thuaj: "Sillni argumentin tuaj në thoni të vërtetën."

112. Po, kush i dorëzohet Zotit si mirëbërës, e ka shpërblimin pranë Zotit të tij. Nuk frikësohet e dëshpërohet.
113. Judenjtë thonë: “Të krishterët nuk kanë bazë.” Të krishterët thonë: “Judenjtë nuk kanë bazë.” Dhe ata recitojnë Librin. Kështu thonë edhe të paditurit (idhujtarët). Zoti do të gjykojë mes tyre Ditën e Ringjalljes se ku ranë në kundërshti.
114. A ka më të padrejtë se ata që ndalojnë në faltoret e Zotit të përmendet Emri i Tij dhe përpiqen për rrënimin e tyre? Ata nuk duhej të hynin në to, por se të ndrojtur. Për ta ka poshtërim në këtë botë dhe, në të ardhmen, një dënim të madh.
115. Lindja e Perëndimi janë Zotit. Ngado të ktheheni, është Fytyra e Zotit. Zoti është i paanë, dijeplotë.
116. Thanë: “Zoti ka bërë bir.” Madhëruar qoftë! Atij i takojnë ç’janë në qiej e në tokë, gjithçka Atij i është nënshtuar.
117. Zanafillësi i qiejve dhe i tokës, kur vendos diçka, thotë vetëm: “Ji!” – dhe ajo është.
118. Të paditurit thonë: “Sikur të na fliste Zoti a të na vinte ndonjë shenjë?” Kështu thanë ata më parë. U përngjanë zemrat. Ne i sqaruam dëshmitë për njerëzit që binden.
119. Të dërguam ty me të vërtetën, përgëzues e paralajmërues dhe nuk do të pyetesh për banorët e zjarrit.
120. Nuk do të kënaqen prej teje judenjtë e të krishterët pa ndjekur udhën e tyre. Thuaj: “Drejtimi i Zotit është drejtim.” Sikur të ndiqje pasionet e tyre pas dijes që të erdhi, nuk do të kishe prej Zotit kujdestar e ndihmëtar.

121. Ata që u kemi dhënë Librin e lexojnë atë siç duhet dhe e besojnë. Të humburit e mohojnë.
122. Bijtë e Izraelit, kujtoni të mirën që ju bëra: Unë ju dallova mbi popujt.
123. Kujdes ditën kur s'e paguan një frymë tjetrën, nuk pranohet shpërblim, nuk do të vlejë ndonjë ndërmjetësi dhe ata nuk ndihmohen.
124. Kur Zoti e provoi Ibrahimin me disa fjalë dhe ai i plotësoi, tha: "Unë po të bëj udhëheqës për njerëzit." Ai tha: "Dhe nga pasardhësit e mi?" Tha: "Besa Ime nuk zë dhunuesit."
125. Kur e bëmë Shtëpinë (Ka'ba, Qabe) strehim e siguri për njerëzit, pra, merrni vendndodhjen e Ibrahimit një vendfalje, ua besuam Ibrahimit dhe Ismailit ta pastronin Shtëpinë Time (nga idhujt) për ata që i sillen qark, që ngujohen (dhjetë ditët e fundit të ramazanit), që përkulen e përulen (duke u falur).
126. Kur Ibrahim tha: "Im Zot, bëje këtë qytet të sigurt dhe ushqej me fryte banorët e tij që besojnë Zotin dhe Ditën e Fundit!"- Ai tha: "Edhe ata që mohojnë do t'i bëj të shijojnë për pak, pastaj do t'i shtrëngoj me dënimin e zjarrit. Ç'fund i keq!"
127. Kur Ibrahim dhe Ismaili ngritën themelet e Shtëpisë: "Zoti ynë, na e prano! Ti je Dëgjuesi, Dijeploiti.
128. Zoti ynë, na bëj të dorëzuar te Ty, edhe ndër pasardhësit tanë, një popull të dorëzuar te Ty, tregona ritet dhe pranona pendimin! Ti je Falësi, Mëshirëploti.
129. Zoti ynë, dërgo te ata një profet prej tyre, t'u recitojë dëshmitë e Tua, t'u mësojë Librin e Urtësinë dhe t'i çlirojë! Ti je i Plotfuqishmi, i Urti."

130. Kush largohet nga feja e Ibrahimit përveç atij që shpërfill vetveten? E zgjidhëm në këtë botë, edhe në të ardhmen është ndër të mirët.
131. Kur Zoti i tha: "Dorëzohu!" - tha: "Iu dorëzova Zotit të botëve!"
132. Ibrahim i ua porositi atë të bijve, edhe Jakubi: "Bijtë e mi, Zoti jua zgjodhi fenë, pra, të vdisni vetëm si muslimanë!"
133. Mos ishit dëshmitarë kur Jakubit i erdhi vdekja dhe u tha të bijve: "Ç' do të adhuron pas meje?" Thanë: "Adhurojmë Zotin tënd, Zotin e etërve të tu, Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, një Zot. Ne Atij i jemi dorëzuar."
134. Ajo ishte një bashkësi që kaloi. Asaj i takon ç'fitoi dhe juve, ç'fituat. Ju nuk do të pyeteni për bëmat e saj.
135. Thanë: "Jini judenj a të krishterë të udhëhiqeni drejt." Thuaj: "Jo, por në fenë e vendosur të Ibrahimit. Ai nuk qe idhujtar."
136. Thoni: "Besojmë Zotin dhe ç'është zbritur te ne, ç'iu zbrit Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit e breznive, çfarë iu dha Musait e Isait dhe ç' u është dhënë profetëve nga Zoti i tyre; nuk ndajmë asnjërin nga ata. Ne Atij i jemi dorëzuar."
137. Po të besonin siç besuat ju, do të udhëhiqeshin drejt. Në u shmangën, janë në mospajtim. Zoti të mjafton ndaj tyre. Ai është Dëgjuesi, Dijeploji.
138. Pagëzimin e Zotit! Kush është më i mirë se Zoti në pagëzim? Ne Atë adhurojmë.
139. Thuaj: "A na kundërshtoni te Zoti ndërsa Ai është Zoti ynë e Zoti juaj? Për ne janë veprat tona dhe për ju, veprat tuaja. Ne Atij i jemi kushtuar.
140. Mos thoni se Ibrahim, Ismaili, Is'haku, Jakubi dhe breznitë ishin judenj a të krishterë?" Thuaj: "Ju dini

- më shumë apo Zoti? Kush është më i padrejtë se ai që fsheh dëshmi nga Zoti? Zoti nuk është i shkujdesur ndaj veprave tuaja.”
141. Ajo ishte një bashkësi që kaloi. Asaj i takon ç’fitoi dhe juve, ç’fituat. Ju nuk do të pyeteni për bëmat e saj.
 142. Njerëzit e pamend do të thonë: “Ç’i ktheu prej kibles (drejtimit) ku ishin?” Thuaj: “Lindja e Perëndimi janë të Zotit. Drejton me dashjen e Tij në udhë të drejtë.”
 143. Kështu, ju bëmë një bashkësi të drejtë, të jeni dëshmues ndaj njerëzve dhe Profeti të jetë dëshmues ndaj jush. Nuk e bëmë drejtimin nga ishe, por që ta dimë kush ndjek të Dërguarin dhe cili kthehet prapa. Në qe e vështirë, nuk ishte për ata që drejtoi Zoti. Zoti nuk është për humbjen e besimit tuaj. Zoti është me njerëzit i dhembshur, mëshirëplotë.
 144. Të vërejmë tek kthen fytyrën nga qielli. Ja, po të kthejmë drejt kibles së dëshiruar. Ktheje fytyrën nga Faltorja e Shenjtë! Kudo që të jeni, ktheni fytyrat nga ana e saj! Ta dinë ithtarët e Librit se është e vërteta nga Zoti i tyre. Zoti nuk është i shkujdesur ndaj veprave të tyre.
 145. Ithtarët e Librit nuk do të ndiqnin kiblen tënde edhe sikur t’u vije me çdo dëshmi. Edhe ti nuk po ndjek kiblen e tyre. Dhe një pjesë tyresh nuk ndjek kiblen e pjesës tjetër. Po të ndiqje pasionet e tyre pas dijes që të erdhi, do të ishe i padrejtë.
 146. Ithtarët e Librit e njohin atë siç njohin të bijtë edhe pse një kastë fsheh me dijeni të vërtetën.
 147. E vërteta është nga yt Zot, të mos jesh dyshues!
 148. Secili ka një drejtim nga është kthyer, pra, konkurroni në vepra të mira! Kudo që të jeni, Zoti do t’ju mbledhë së bashku. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.

149. Kudo që të kesh dalë, ktheje fytyrën nga Faltorja e Shenjtë! Ajo është e vërteta nga yt Zot. Zoti nuk është i shkujdesur ndaj veprave tuaja.
150. Kudo që të kesh dalë, ktheje fytyrën nga Faltorja e Shenjtë! Kudo që të jeni, ktheni fytyrat nga ana e saj! Të mos jetë për njerëzit argument kundër jush, përjashuar dhunuesve. Mos iu frikësoni atyre, Mua frikësomuni! Që ta plotësoj të mirën Time ndaj jush e të udhëhiqeni drejt.
151. Siç edhe ju dërguam një profet prej jush, t'ju recitojë dëshmitë Tona, t'ju çlirojë, t'ju mësojë Librin e Urtësinë, t'ju mësojë çfarë nuk dini.
152. Pra, më kujtoni, Unë ju kujtoj, më falënderoni dhe mos më mohoni!
153. Besimtarë, kërkoni ndihmë me durim e lutje. Zoti është me durimtarët.
154. Mos thoni se janë të vdekur ata që vriten në Rrugën e Zotit. Jo, janë të gjallë, por ju nuk e ndieni.
155. Ne ju provojmë me frikë, uri dhe mungesë pasurie, frymësh e prodhimesh. Dhe përgëzoji durimtarët!
156. Që, kur u ndodh fatkeqësi, thonë: "Ne jemi të Zotit dhe te Ai kthehemi."
157. Ata kanë bekime e mëshirë nga Zoti dhe janë ata të udhëhequrit drejt.
158. Safa e Merve janë simbole të Zotit. Kush shkon për haxh ose viziton Shtëpinë, s'bën mëkat t'i përshkojë. Në bëhet vullnetarisht diçka e mirë, Zoti është mirënjohës, dijeplotë.
159. Cilët fshehin provat e qarta dhe drejtimin që shpallëm, pasi i sqaruam në libër për njerëzit, i mallkon Zoti, i mallkojnë edhe mallkuesit (engjëjt).

160. Përveç atyre që pendohen, përmirësohen dhe sqarojnë. Këtyre ua pranoj pendimin. Unë jam Pranuesi i pendimit, Mëshirëploti.
161. Ata që mohojnë dhe vdesin mohues kanë mallkimin e Zotit, të engjëjve e njerëzve bashkë.
162. Përgjithmonë! Nuk u lehtësohet dënimi e rishikohen.
163. Zoti juaj është Një Zot. S'ka zot veç Tij, Bamirësit, Mëshirëplotit.
164. Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të tokës, ndryshimin e natës dhe të ditës, anijen që lundron në det në dobi të njerëzve, shiun që Zoti ka bërë të bjerë nga qielli duke i dhënë jetë tokës së vdekur ku ka përhapur lloj-lloj gjallesash, në qarkullimin e erërave dhe renë e varur mes qiellit e tokës, ka dëshmi për njerëzit që kuptojnë.
165. Nga njerëzit, cilët i bëjnë Zotit ortakë, i duan këta me dashurinë e Zotit ndërsa besimtarët kanë më të fuqishmen dashuri për Zotin. Po të vërenin dhunuesit kur të përballen me dënimin, tërë fuqia i takon Zotit. Zoti ka ndëshkim të rreptë.
166. Kur të pasuarit t'i kenë braktisur pasuesit, të përballen me dënimin dhe të jenë prerë motivet e tyre,
167. pasuesit do të thonë: "Sikur të na përsëritej e t'i braktisnim ata siç na braktisën neve!" Zoti ua shfaq kështu veprat e tyre, dëshpërim për ta. Dhe nuk do të dalin prej zjarrit.
168. Njerëz, ushqehuni me ç'janë në tokë, të lejuara, të mira dhe mos ndiqni gjurmët e djallit: ai është për ju armik i hapur.
169. Ju porosit të keqen dhe paudhësinë e të flisni për Zotin me padije.

170. Kur u thuhet: “Ndiqni shpalljen e Zotit”, - thonë: “Jo, por ndjekim traditën e etërve tanë”, - edhe pse etërit e tyre s’kuptonin gjë dhe s’qenë të udhëhequr drejt.
171. Shembulli i mohuesve, si i dikujt që bërtet tek s’dëgjon, veç një thirrje e apel. Të shurdhër, memecë, të verbër: ata nuk kuptojnë.
172. Besimtarë, ushqehuni me të mirat që ju kemi dhënë dhe falënderoni Zotin po qe se vetëm Atë adhuron.
173. Por, ju janë ndaluar ngordhësira, gjaku, mishi i derrit dhe ç’është therur jo për Zotin. Kush shtrëngohet (nga uria), pa dëshirë e tepri, s’bën mëkat. Zoti është falës, mëshirëplotë.
174. Cilët fshehin shpalljen e Zotit në Libër dhe blejnë me të një çmim të ulët, hanë në barqet e tyre vetëm zjarr. Ditën e Ringjalljes, Zoti nuk u flet, s’i çliron dhe kanë dënim të hidhët.
175. Janë ata që blenë të shtrembtën me të drejtën, ndëshkimin me faljen. Sa të durueshëm ndaj zjarrit!
176. Sepse Zoti zbriti Librin me të vërtetën ndërsa ata që ndërhyjnë në libër janë në mospajtim të thellë.
177. Nuk është besimtari të ktheni fytyrat nga lindja e perëndimi, por besimtaria është te ata që besojnë Zotin, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin, profetët; që japin nga pasuria e duhur të afërmeve, jetimëve, rrugëtarëve, lypësve dhe për lirin e të robëruarve; që kryejnë të falurit dhe japin detyrimin; që përmbushin besën kur lidhin besë; te durimtarët në mjerim e vështirësi dhe në kohë burrërie. Ata janë të vërtetët dhe janë ata të devotshmit.
178. Besimtarë! U caktua për ju hakmarrja në vrasje: i liri me të lirë, rob me rob dhe femra me femër. Po të ketë falje nga i vëllai, të përcillet me drejtësi dhe

- pagesa t'i bëhet me mirëdashje. Kjo është lehtësim nga Zoti juaj dhe mëshirë. Kush e tejkalon më pas, ka dënim të hidhët.
179. Në hakmarrje ka jetë për ju, o të mençur, që të mund të përmbaheni.
180. U caktua për ju: kur dikujt i vjen vdekja, po të ketë lënë pasuri, testamenti për prindërit dhe të afërmit, me drejtësi, është detyrë për të devotshmit.
181. Në qoftë se ndryshohet pasi të jetë dëgjuar, mëkati bie mbi ata që e ndryshojnë. Zoti është dëgjues, dijeplotë.
182. Kur nga trashëgimlënësi dyshohet të ketë anësi ose gabim, nuk është mëkat të rregullohet mes palëve. Zoti është falës, mëshirëplotë.
183. Besimtarë! U caktua për ju agjërimi, sikurse iu caktua atyre para jush, që të mund të përmbaheni.
184. Janë ditë të numëruara; kush është i sëmurë ose në udhëtim, disa ditë të tjera. Ata që s'mund ta mbajnë zëvendësojnë me ushqimin e një të varfri. Kush bën vullnetarisht një të mirë, gjen mirë. Të agjëroni është më mirë për ju sikur ta dinit.
185. Ramazan është muaji kur u zbrit Kurani, drejtim për njerëzit, platformë e drejtimit dhe Dalluesi. Kush e dëshmon muajin, të agjërojë; cili është i sëmurë ose në udhëtim, disa ditë të tjera. Zoti do për ju lehtësim, nuk do për ju vështirësim dhe që ta plotësoni afatin e të madhëroni Zotin sepse ju drejtoi dhe që të mund të falënderoni.
186. Në të pyesin robtë e mi për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem thirrjes së thirrësit kur më thërret. Le të më përgjigjen e të më besojnë që të mund të udhëhiqen drejt.

187. Ju lejohet, natën e agjërit, afrimi te gratë tuaja; ato janë petku juaj dhe ju, petku i tyre. Zoti e di se tradhtonit veten, jua pranoi pendimin dhe ju fali. Tashmë, bashkoni atyre dhe kërkoni çfarë Zoti ka caktuar për ju. Hani e pini derisa të dallohet filli i bardhë nga filli i zi në agim, pastaj, plotësoni agjërimin deri në mbrëmje. Mos iu bashkoni atyre duke qenë të ngjuar nëpër faltore. Këto janë kufijtë e Zotit, pra, mos i shkelni. Zoti i sqaron kështu dëshmitë e Tij për njerëzit që të mund të përmbahen.
188. Mos përvetësoni padrejtësisht pasuritë mes jush dhe mos korruptoni me to gjykatësit që të përvetësoni me mëkat e vetëdije pjesë nga pasuria e njerëzve.
189. Të pyesin rreth fazave të hënës, thuaju: “Ato janë për njerëzit periudha të kohës e të haxhit.” Nuk është besimtari të vini në shtëpi nga prapa; besimtari është të përmbaheni dhe të vini në shtëpi nga dyert e tyre. Përmbajuni Zotit që të mund të keni sukses.
190. Luftojini në Rrugën e Zotit ata që ju luftojnë, por mos e teproni. Zoti nuk i do agresorët.
191. Vritni ata ku t’i ndeshni (me armë); dëbojini prej ku ju dëbuan. Persekutimi është më i rëndë se vrasja. Mos i luftoni në Faltoren e Shenjtë pa ju luftuar në të; nëse ju luftojnë, vritini. Ky është ndëshkimi i mohuesve.
192. Po t’i japin fund, Zoti është falës, mëshirëplotë.
193. Luftojini ata derisa të mos ketë persekutim dhe feja të jetë për Zotin. Po t’i japin fund, s’ka armiqësi, përjashtuar dhunuesve.
194. Muaji i shenjtë, për muaj të shenjtë dhe tabutë kanë ndëshkim. Po t’ju sulmojnë, sulmójini siç ju sulmuan. Kini frikë Zotin dhe dijeni se Zoti është me ata që përmbahen.

195. Kontribuoni në Rugën e Zotit dhe mos bini me duart tuaja në shkatërrim. Bëni mirë! Zoti i do mirëbërësit.
196. Kryeni haxhin dhe umren (vizitën) për Zotin. Në pamundësi, një kurban ç'të jetë më lehtë. Mos e rruani kryet derisa kurban i të ketë arritur në vendflijim. Kush është i sëmurë ose me ndonjë shqetësim nga koka, zëvendëson me agjërim, lëmoshë a sakrificë. Kur të jeni të sigurt, kush e kalon kohën nga umreja deri në haxh, le të bëjë kurban ç'të jetë më lehtë. Po të mos gjejë, le të agjërojë tri ditë gjatë haxhit dhe shtatë në kthim, të tilla, dhjetë të plota. Kjo, për ata që nuk i kanë familjet pranë Faltores së Shenjtë. Përmbajuni Zotit dhe dijeni se Zoti ka ndëshkim të rreptë.
197. Haxhi është në muaj të njohur. Kush vendos në to haxhin, pa pasione, pa shthurje dhe pa mosmarrëveshje gjatë haxhit. Ç'të mirë bëni, Zoti e di. Përgatitni rezervat, por rezerva më e mirë është devotshmëria. Më kini frikë, ju, o të mençur!
198. Nuk është mëkat të kërkonti mirësi prej Zotit. Kur të keni dalë nga Arafati, përmendni Zotin pranë Monumentit të Shenjtë (në Muzdelife), përmendeni Atë tek ju drejtoi ndërsa ishit më parë të gabuar.
199. Pastaj, dilni bashkë me njerëzit e tjerë dhe kërkojini falje Zotit. Zoti është falës, mëshirëplotë.
200. Kur të keni mbaruar ritet, përmendni Zotin siç përmendnit etërit tuaj, edhe më thellë. Nga njerëzit, kush thotë: "Zoti ynë, na jep në këtë botë!" - nuk ka pjesë në të ardhmen.
201. Ata që thonë: "Zoti ynë, jepna të mira në këtë botë, edhe në të ardhmen të mira dhe ruajna nga dënimi i zjarrit!" -

202. kanë pjesë fitimi. Zoti bën vlerësim të shpejtë.
203. Përmendni Zotin ditëve të numëruara. Kush është i devotshëm, s'bën mëkat të nxitojë në dy ditë, s'bën mëkat të vonojë. Përmbajuni Zotit dhe dijeni se te Ai do të mblidheni.
204. Nga njerëzit, dikush të habit me fjalën e tij në jetën e kësaj bote dhe dëshmon Zotin se ç'ka në zemër ndërsa ai është kundërshtari më i rreptë.
205. Posa largohet, përpiket të çrregullojë në tokë, të prishë të mbjellat dhe gjënë e gjallë. Zoti nuk e do çrregullimin.
206. Kur i thuhet: "Ki frikë Zotin!" - e kap sedra mëkatore. I mjafton skëterra, sa shtrat i keq!
207. Nga njerëzit, dikush e sakrifikon veten në kërkim të kënaqësisë së Zotit. Zoti është i dhembshur me robtë.
208. Besimtarë, hyni në paqe plotësisht dhe mos ndiqni gjurmët e djallit. Ai është për ju armik i hapur.
209. Po të devijoni, pasi ju erdhën provat e qarta, dijeni se Zoti është i plotfuqishëm, i urtë.
210. Mos presin t'u vijë Zoti nën hijet e reve, edhe engjëjt dhe çështja të jetë vendosur? Zotit i kthehen çështjet.
211. Pyeti bijtë e Izraelit, sa prova të qarta u kemi dhënë! Kush këmben mirësinë e Zotit pasi t'i ketë ardhur, ka ndëshkimin e rreptë të Zotit.
212. Iu zbukurua mohuesve jeta e kësaj bote dhe tallen me besimtarët. Të devotshmit janë mbi ta Ditën e Ringjalljes. Zoti i jep kujt do, pa masë.
213. Njerëzit ishin një bashkësi. Zoti dërgoi profetët-përgëzues e paralajmërues dhe zbriti me ta librin me të vërtetën, për të gjykuar mes njerëzve ku ranë në kundërshti. Dhe ranë në kundërshti vetëm ata që iu dha ai, nga keqdashja mes tyre, pasi u erdhën provat

e qarta. Zoti i drejton besimtarët, me lejen e Tij, nga kundërshtia tek e vërteta. Zoti drejton atë që do në rrugë të drejtë.

214. Mos menduat të hyni në parajsë pa ju ndodhur siç u ndodhi atyre më parë? U ranë fatkeqësi e vështirësi dhe u tronditën aq sa profeti dhe besimtarët me të thanë: “Kur është ndihma e Zotit?” A nuk është afër ndihma e Zotit?
215. Të pyesin çfarë të kontribuojnë? Thuaj: “Ç’të kontribuoni nga pasuria, të jetë për prindërit, të afërmit, jetimët, të varfrit, rrugëtarët. Ç’të mirë bëni, Zoti e di.”
216. U caktua për ju lufta ndonëse e padëshiruar. Por, mund të mos dëshironi diçka e të jetë në të mirën tuaj, mund të doni diçka e të jetë në të keqen tuaj. Zoti di tek ju nuk dini.
217. Të pyesin për luftën në muajin e shenjtë, thuaj: “Lufta në të është e rëndë, por pengesa në Rrugën e Zotit dhe mohimi i Tij, pengesa në Faltoren e Shenjtë dhe dëbimi i njerëzve të saj janë më të rënda te Zoti. Persekutimi është më i rëndë se vrasja.” Nuk do të pushojnë së ju luftuari derisa t’ju prapsin nga feja po të mundnin. Cilët prapsen, ndër ju, nga feja e tyre (Islami) dhe vdesin mohues, u kanë dështuar veprat në këtë botë e në të ardhmen. Ata janë banorët e zjarrit, përgjithmonë.
218. Cilët besojnë, emigrojnë dhe luftojnë në Rrugën e Zotit, shpresojnë mëshirën e Zotit. Zoti është falës, mëshirëplotë.
219. Të pyesin për verën e bixhazin, thuaj: “Në to ka mëkat të madh dhe përfitim te njerëzit, por mëkati është më i madh se përfitimi.” Të pyesin çfarë të kontribuojnë?

- Thuaj: “Një falje.” Zoti jua shpjegon kështu dëshmitë që të mund të mendoheni.
220. Në këtë botë e në të ardhmen. Të pyesin për jetimët, thuaj: “Një përmirësim për ta është më mirë. Nëse bashkëpunoni, janë vëllezërit tuaj. Zoti dallon dashakeqin nga dashamiri. Po të deshte Zoti, ju hidhte në vështirësi. Zoti është i plotfuqishëm, i urtë.”
221. Mos u martoni me idhujtare derisa të besojnë; një skllave besimtare është më e mirë nga një idhujtare edhe sikur t’ju mahnisë. Mos u martoni me idhujtarë derisa të besojnë; një skllav besimtar është më i mirë nga një idhujtar edhe sikur t’ju mahnisë. Ata ftojnë në zjarr; Zoti fton, me lejen e Vet, në parajsë e falje. Dhe i sqaron dëshmitë e Tij për njerëzit që të mund të mendohen.
222. Të pyesin për të përmuajshmet, thuaj: “Ato janë papastërti, pra, veçohuni nga gratë gjatë të përmuajshmeve dhe mos iu afroni derisa të pastrohen. Kur të jenë pastruar, t’u vini siç ju urdhëron Zoti. Zoti i do ata që pendohen, i do ata që pastrohen.
223. Gratë tuaja janë ara juaj; ejajini arës suaj si të dëshironi dhe përgatitni për veten tuaj! Kini frikë Zotin dhe dijeni se jeni në takim me Të. Dhe përgëzoji besimtarët!
224. Mos e bëni Zotin pengesë në betimet tuaja për mirësi, drejtësi dhe pajtim mes njerëzve. Zoti është dëgjues, dijeplotë.
225. Zoti nuk ju fajëson te betimet tuaja padashur, por te qëllimet tuaja. Zoti është falës, i butë.

226. Cilët largohen prej grave të tyre duke u betuar, të presin katër muaj. Po të tërhiqen, Zoti është falës, mëshirëplotë.
227. Nëse vendosin ndarjen, Zoti është dëgjues, dijeplotë.
228. Të ndarat të presin tri të përmuajshme. Nuk u lejohet të fshehin çfarë Zoti ka krijuar në mitrat e tyre në besojnë Zotin dhe Ditën e Fundit. Burrave u takon t'i kthejnë, ndërkohë, po qe se duan pajtim. Për të drejtat dhe detyrimet e tyre, me mirëkuptim, por burrat kanë përparësi. Zoti është i plotfuqishëm, i urtë.
229. Ndarja është dy herësh: mbajtje me mirëkuptim ose lirim me të mirë. Nuk ju lejohet të merrni diçka që u keni dhënë, vetëm nëse ata të dy dyshojnë të mos ruajnë kufijtë e Zotit. Kur ju dyshoni se ata të dy nuk do t'i ruajnë kufijtë e Zotit, s'është mëkat që ajo japë shpërblesë. Këto janë kufijtë e Zotit, pra, mos i shkelni. Cilët shkelin kufijtë e Zotit, ata janë dhunuesit.
230. Nëse e ka ndarë, ajo nuk i lejohet më derisa të jetë martuar me një burrë tjetër dhe ai ta ketë ndarë; atëherë s'bëjnë mëkat të rikthehen po qe se besojnë t'i ruajnë kufijtë e Zotit. Këto janë kufijtë e Zotit; i sqaron për njerëzit që dinë.
231. Kur t'i keni ndarë gratë dhe arrijnë afatin, mbajini me mirëkuptim ose lirojini me mirëkuptim, por mos i mbani me forcë e të dhunoni. Kush vepron kështu, ka dhunuar vetveten. Mos i merrni me mospërfillje dëshmitë e Zotit! Kujtoni të mirën e Zotit dhe ç'ju zbriti nga Libri e Urtësia, këshillë për ju. Përmbajuni Zotit dhe dijeni se Zoti është për gjithçka dijeplotë.
232. Kur t'i keni ndarë gratë dhe arrijnë afatin, mos i pengoni të martohen me burrat e tyre po qe se

pranojnë së bashku me mirëkuptim. Kështu këshillohen ata që besojnë Zotin dhe Ditën e Fundit. Kjo është më e mençur për ju dhe më e pastër. Zoti di tek ju nuk dini.

233. Nënata u japin gjithë fëmijëve dy vjet të plota nëse duan ta plotësojnë gjidhënien. I ati ka për detyrë ushqimin dhe veshmbathjen e tyre, me mirëkuptim. Nuk ngarkohet një frymë përtej mundësisë. Nuk dëmtohet nëna për fëmijën e saj, as babai për fëmijën e tij. Po kështu edhe kujdestari. Po të duan ndërprerjen e gjirit, me pëlqimin dhe këshillimin e të dyve, nuk kanë mëkat. Në qoftë se kërkon gjidhënien e fëmijëve tuaj, s'është mëkat për ju kur të keni bërë siç duhet pagesën. Përmbajuni Zotit dhe dijeni se Zoti është largpamës i veprave tuaja.
234. Gratë e veja të presin katër muaj e dhjetë ditë. Kur arrijnë afatin, nuk është mëkat për ju se ç'bëjnë ato vetë me mirëkuptim. Zoti është në dijeni të veprave tuaja.
235. Nuk është mëkat të shprehni ose të keni për qëllim martesën me gratë (e veja). Zoti e di që do të flisni rreth tyre, por mos bëni premtime të fshehta; thoni fjalë të njohura. Mos e caktoni lidhjen martesore pa u arritur afati i caktuar. Dijeni se Zoti di ç'keni në vetvete, pra, kujdes prej Tij! Dijeni se Zoti është falës, i butë.
236. Nuk është mëkat t'i ndani gratë (e veja) pa bërë marrëdhënie me to ose pa vënë për to një detyrim. Por pajisini ato, i pasuri në masën e tij dhe i varfri në masën e tij, me një mjet jetese, me mirëkuptim, si detyrë për mirëbërësit.
237. Po t'i ndani para se të keni bërë marrëdhënie me to, por që keni vënë për to një detyrim, gjysmën e

- detyrim; vetëm nëse ato falin ose fal ndërmjetësi i lidhjes martesore. Të falni është më afër devotshmërisë. Mos harroni mirësinë mes jush. Zoti është largpamës i veprave tuaja.
238. Respektoni të falurit dhe faljen e mesme. Qëndroni para Zotit të bindur!
239. Në kohë rreziku, më këmbë ose kaluar. Kur të jeni të sigurt, përmendni Zotin, siç ju mësoi çfarë nuk dinit.
240. Për gratë e veja mes jush, si testament, jetesën deri në një vit, pa i larguar. Po të largohen, nuk është mëkat për ju se ç'bëjnë ato vetë, me mirëkuptim. Zoti është i plotfuqishëm, i urtë.
241. Për të ndarat, një mjet jetese, me mirëkuptim, është detyrë për të devotshmit.
242. Kështu jua sqaron Zoti dëshmitë e Tij që të mund të kuptoni.
243. Nuk ke parë te ata që dolën prej trojeve të tyre, me mijëra, të trembur për vdekje? Zoti u tha: "Vdisni!" - pastaj i ktheu në jetë. Zoti është i mirësisë ndaj njerëzve, por të shumtët e njerëzve nuk falënderojnë.
244. Luftoni në Rugën e Zotit dhe dijeni se Zoti është dëgjues, dijeplotë.
245. Kujt i huan Zotit një huadhënie fisnike, Ai ia shumëfishon. Zoti ngushton e zgjeron dhe te Ai ktheheni.
246. Nuk ke parë nga përfaqësuesit e bijve të Izraelit, pas Musait, kur i thanë profetit: "Dërgona një mbret të luftojmë në Rugën e Zotit", - ai u tha: "Ndoshta nuk do të luftoni po t'ju caktohet lufta?" Thanë: "Përse të mos luftojmë në Rugën e Zotit ndërsa u dëbuam nga trojet tona dhe fëmijët tanë?" Kur u caktua për ta lufta,

përveç një pakice, kthyen shpinën. Zoti i njeh mirë dhunuesit.

247. Profeti u tha: “Zoti ju dërgoi Talutin mbret.” Thanë: “Të na sundojë ai kur ne kemi më të drejtë sundimi dhe atij nuk i është dhënë ndonjë pasuri?” Tha: “Zoti e zgjodhi atë mbi ju dhe ia shtoi dijen dhe forcën fizike.” Zoti ia jep sundimin atij që do. Zoti është i paanë, dijeplotë.
248. U tha Profeti: “Shenjë e sundimit të tij, qetësim prej Zotit tuaj, është ardhja e arkës që e bartin engjëjt me reliktet e familjes së Musait dhe familjes së Harunit. Këtu ka dëshmi për ju në jeni besimtarë.”
249. Kur doli me trupat, Taluti tha: “Zoti ju vë në provë te një lumë. Kush pi në të, s’është prej meje; cili merr vetëm një grusht ujë dhe nuk ngopet me të, ai është prej meje.” Përrjashtuar një pakice, të gjithë pinë. Kur ai dhe besimtarët me të dolën matanë, thanë: “Sot nuk kemi fuqi për Xhalutin dhe trupat e tij.” Ata që besonin në takimin me Zotin, thanë: “Sa e sa grupe të vogla kanë mundur, me lejen e Zotit, grupe të mëdha! Zoti është me durimtarët.”
250. Kur u ballafaquan me Xhalutin dhe trupat e tij, thanë: “Zoti ynë, jepna durim, forcoi këmbët tona dhe ndihmona ndaj njerëzve të pabesë!”
251. I thyen, me lejen e Zotit dhe Davudi e vrau Xhalutin. Zoti i dha sundim e urtësi dhe ia mësoi çfarë deshi. Po të mos i zmbapste Zoti disa njerëz me të tjerë, do të prishej toka. Porse Zoti është i mirësisë ndaj njerëzve.
252. Këto janë dëshmitë e Zotit; t’i recitojmë me të vërtetën. Dhe ti je ndër të dërguarit.

253. Këta të dërguar i dalluam mes tyre. Ka që u foli Zoti dhe disa që i ngriti në pozitë. I dhamë Isait, birit të Merjemit, prova të qarta dhe e mbështetëm me Shpirtin e Shenjtë. Po të deshte Zoti, nuk do të luftonin njëri me tjetrin ndjekësit e tyre, pas provave të qarta që u erdhën, por ranë në kundërshti dhe disa besuan e disa mohuan. Po të deshte Zoti, nuk do të luftonin njëri me tjetrin, por Zoti bën atë që do.
254. Besimtarë, kontribuoni nga ç'ju kemi dhënë para se të vijë një ditë kur s'ka shitblerje, as miqësi, as ndërmjetësi. Mohuesit, ata janë dhunuesit.
255. Zoti, s'ka zot veç Tij, është i Gjalli, i Përjetshmi. Nuk e kap dremitje e gjumë. Atij i takojnë ç'janë në qiej e në tokë. Kush mund të ndërmjetësojë te Ai pa lejen e Tij? Di të tashmen dhe të ardhmen e tyre ndërsa ata nuk mund të nxënë nga dija e Tij, vetëm se me dashjen e Tij. Pushteti i Tij shtrihet në qiej e në tokë dhe nuk e rëndon ruajtja e tyre. Ai është i Larti, Madhështori.
256. Nuk ka shtrëngim në fe. U dallua e drejta nga e shtrembta. Kush mohon djajtë dhe beson Zotin, është kapur te një nyjë e fortë që s'këputet. Zoti është dëgjues, dijeplotë.
257. Zoti është Kujdestari i besimtarëve: i nxjerr nga errësira në dritë. Mohuesit kanë për kujdestarë djajtë: i nxjerrin nga drita në errësirë. Ata janë banorët e zjarrit, përgjithmonë.
258. Nuk ke parë nga ai që kundërshtoi Ibrahimin te Zoti i tij ndërsa Zoti i pati dhënë sundim? Kur Ibrahim i tha: "Im Zot është që ngjall e vdes", - tha: "Unë ngjall e vdes." Ibrahim i tha: "Zoti e sjell diellin nga lindja, sille ti nga perëndimi!" Dhe mbeti mohuesi i hutuar. Zoti nuk udhëzon tiranët.

259. Apo, sikundër ai që kaloi pranë një qyteze me çatitë e rrënuara. Dhe tha: “Si e ngjall Zoti këtë pas vdekjes?” Zoti e bëri të vdesë për njëqint vjet, pastaj e ngriti. Tha: “Sa qëndrove?” Tha: “Qëndrova një ditë ose një pjesë dite.” Tha: “Jo, ke qëndruar njëqint vjet. Vështro te ushqimi dhe pija jote si nuk janë prishur. Vështro te gomari yt! Që të të bëjmë dëshmi për njerëzit, pa shih te eshtrat si i përtërijmë dhe i veshim me mish!” Kur iu bë e qartë, tha: “Di që, vërtet, Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.”
260. Kur Ibrahim i tha: “Im Zot, tregomë si i ngjall të vdekurit?” - tha: “Nuk beson?” Tha: “Po, por le të qetësohet zemra ime!” Tha: “Merr katër shpendë dhe ndilli pas vetes. Pastaj vëre secilin në një mal dhe thirru, të të vijmë fluturimthi. Dije se Zoti është i plotfuqishëm, i urtë.”
261. Shembulli i atyre që shpenzojnë pasuritë e tyre në Rugën e Zotit, një kokërr gruri që jep shtatë kallinj; në çdo kalli, njëqint kokrra. Zoti ia shumëfishon atij që do. Zoti është i paanë, dijeplotë.
262. Cilët shpenzojnë pasuritë e tyre në Rugën e Zotit dhe nuk e përcjellin shpenzimin e bërë me të përmendura e mundim, e kanë shpërblimin pranë Zotit të tyre. Nuk frikësohen e dëshpërohen.
263. Një fjalë e mirë dhe ndjesë kanë më vlerë nga një lëmoshë e përcjellë me mundim. Zoti është i pasur, i butë.
264. Besimtarë, mos i zhvleftësoni lëmoshat tuaja me të përmendura e mundim si ata që shpenzojnë pasuritë e tyre për opinion të njerëzve dhe nuk besojnë Zotin dhe Ditën e Fundit. Shembulli i tyre: një shkëmb i mbuluar me dhe; e zë shi i madh dhe e lë të

zhveshur. Nuk zotërojnë gjë në fitimin e tyre. Zoti nuk i drejton njerëzit mohues.

265. Shembulli i atyre që, të vendosur në vetvete, shpenzojnë pasuritë e tyre në kërkim të kënaqësisë së Zotit, një kopsht në vend të lartë: e zë shi i dendur dhe jep frytet e tij dy herë më shumë; në mos shi i dendur edhe një vesë. Zoti është largpamës i veprave tuaja.
266. Do të dëshironte dikush nga ju të kishte një kopsht palmash e hardhish, me rrjedhë lumenjsh dhe lloj-lloj frytesh, ta zinte pleqëria me pasardhës të paaftë dhe një stuhi e zjarrtë t'ia përzhiste atë? Zoti jua sqaron kështu dëshmitë që të mund të mendoheni.
267. Besimtarë, kontribuoni nga të mirat që fituat dhe ç'kemi prodhuar prej tokës për ju, por mos veçoni kualitetin më të keq e të jepni diçka që vetë nuk do t'ia kishit hedhur sytë. Dhe dijeni: Zoti është i pasur, lavdiplotë.
268. Djalli ju kërcënon me varfëri dhe ju porosit paudhësinë; Zoti ju premtan falje e mirësi prej Tij. Zoti është i paanë, dijeplotë.
269. Ia jep urtësinë atij që do. Kujt i jepet urtësia, i është dhënë një pasuri e madhe. Të mençurit meditojnë.
270. Ç'kontribut keni bërë dhe ç'zotim keni marrë, Zoti e di. Dhunuesit nuk kanë ndihmëtarë.
271. T'i bëni bamirësitë hapur është mirë, por t'ua jepni të varfërve fshehtas, është më mirë për ju. Dhe jua shlyen disa nga të këqiat. Zoti është në dijeni të veprave tuaja.
272. Nuk të bie ty drejtimi i tyre, porse drejton Zoti atë që do. Ç'të kontribuoni nga pasuria, e keni për vete. Dhe

- kontribuoni vetëm për hir të Zotit! Ç'të mirë kontribuoni, ju përmbushet e nuk dëmtoheni.
273. Për të varfrit e kufizuar në Rrugën e Zotit, që s'kanë mundësi të përpiqen në tokë, – nga sedra e tyre, i padituri i pandeh të pasur; i njeh ata nga çehrja, nuk bezdisin njerëzit për lëmoshë, – ç'të mirë kontribuoni, Zoti e di.
274. Cilët kontribuojnë me pasuritë e tyre natën e ditën, fshehtas e haptas, e kanë shpërblimin pranë Zotit të tyre. Nuk frikësohen e dëshpërohen.
275. Ata që hanë kamatën do të ngrihen si t'i ketë zënë djalli në kllapi. Kjo, mbasi thonë: "Tregtia është si kamata." Zoti lejoi tregtinë dhe ndaloi kamatën. Kush merr këshillë nga Zoti dhe heq dorë, çështja e tij i përket së kaluarës dhe është te Zoti. Cilët e përsërisin, janë përgjithmonë banorët e zjarrit.
276. Zoti asgjëson kamatën dhe i shton bamirësitë. Zoti nuk do një mosmirënjohës mëkatar.
277. Ata që besojnë e bëjnë të mira, kryejnë të falurit dhe japin detyrimin, e kanë shpërblimin pranë Zotit të tyre. Nuk frikësohen e dëshpërohen.
278. Besimtarë! Kini frikë Zotin dhe hiqni dorë nga kamata e mbetur në keni besuar.
279. Po të mos e bëni, merrni lajmin e një lufte nga Zoti dhe i Dërguari i Tij. Nëse pendoheni, ju takon kryet e mallit tuaj: nuk dëmtoni, as dëmtoheni.
280. Po të jetë në gjendje të vështirë, të pritët deri në përmirësim; në qoftë se bëni bamirësi, është më mirë për ju sikur ta dinit.
281. Kujdes ditën që ktheheni te Zoti dhe i përmbushet secilit ajo që fitoi e nuk i bëhet padrejtësi.

282. Besimtarë! Kur huazoni në afat të caktuar, shkruajeni! Le ta shkruajë atë një shkruet mes jush, me paanësi dhe të mos refuzojë ta shkruajë siç e ka mësuar Zoti. Të shkruajë duke i diktuar huamarrësi dhe ky t'i frikësohet Zotit e të mos pakësojë gjë. Në qoftë se huamarrësi është i metë, i paafte ose nuk ka mundësi të diktojë, le të diktojë me paanësi kujdestari i tij. Kërkoni të dëshmojnë dy burra mes jush; po të mos jenë dy burra, një burrë e dy gra që i pranoni si dëshmitarë; në gabon njëra, ia kujton tjetra. Dëshmitarët të mos refuzojnë kur ftohen dhe mos nënvleftësoni ta shkruani atë, qoftë e vogël apo e madhe, në afatin e saj. Kjo është më e drejtë te Zoti, më e fortë si dëshmi dhe më afër mosdysimit. Vetëm në qoftë shitblerje e pranishme që bëni mes jush, nuk është mëkat të mos e shkruani. Por dëshmoni kur arrini një marrëveshje. Nuk mund të dëmtohen shkruet dhe dëshmitari. Kjo do të ishte shkelje e rëndë. Kini frikë Zotin! Zoti ju mëson. Zoti është për gjithçka dijeplotë.
283. Kur jeni në udhëtim e nuk gjeni shkruet, një peng si garanci. Në i besoni njëri-tjetrit, i besuari duhet ta përmbushë porosinë dhe të ketë frikë Allahun, Zotin e tij. Mos e fshihni dëshminë! Kush e fsheh atë, bën me zemër mëkat. Zoti është dijeplotë për ato që bëni.
284. Zotit i takojnë ç'janë në qiej e në tokë. E shfaqni veten apo e fshihni, Zoti ju merr në llogari. Fal me dashjen e Tij dhe dënon me dashjen e Tij. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.
285. I Dërguari besoi çfarë i zbrii nga Zoti i tij, edhe besimtarët. Të gjithë besojnë Zotin, engjëjt e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij: "Nuk ndajmë asnjërin nga të

dërguarit e Tij.” Dhe thonë: “Dëgjuam e u bindëm. Faljen Tënde, Zoti ynë! Fundi është tek Ty.”

286. Zoti nuk ngarkon dikë përtej mundësisë. I takon ajo që fitoi dhe bie mbi të ajo që fitoi. “Zoti ynë, mos na ndëshko në harrojmë a gabojmë! Zoti ynë, mos na ngarko barrë që u ngarkove paraardhësve tanë! Zoti ynë, mos na ngarko sa s’kemi fuqi! Ndjena, falna, mëshirona! Ti je Zotëria ynë, ndihmona ndaj njerëzve të pabesë!

3. FAMILJA E IMRANIT (ALI IMRAN)

Periudha e Medines, 200 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Elif, lam, mim.
2. Zoti, s’ka zot veç Tij, është i Gjalli, i Përjetshmi.
3. Të zbriti Librin me të vërtetën që pohon shkrimet para tij, zbriti Teuratin e Ungjillin,
4. më parë, drejtim për njerëzit. Dhe zbriti Dalluesin. Ata që mohojnë dëshmitë e Zotit kanë dënim të rreptë. Zoti është i plotfuqishëm, i zoti i hakmarrjes.
5. Zotit nuk i fshihet gjë në tokë e në qiell.
6. Është Ai që ju formon në mitra, siç do. S’ka zot veç Tij, të Plotfuqishmit, të Urtit.
7. Është Ai që të zbriti Librin ku ka dëshmi të qarta që janë baza e Librit dhe të tjera, të figurshme. Ata me zemër të lëkundur ndjekin të figurshmet, me qëllim tundimi dhe interpretimi. Por interpretimin e tyre e di

- vetëm Zoti. Ata me dije të thella, thonë: “E besojmë. I tëri është nga Zoti ynë.” Meditojnë të mençurit:
8. “Zoti ynë, mos i lëkund zemrat tona pasi na drejtove! Dhurona prej Teje mëshirë! Ti je Dhuruesi.
 9. Zoti ynë, Ti je Tubuesi i njerëzve një ditë ku s’ka dyshim! Zoti nuk e shkel premtimin.”
 10. Mohuesve nuk u vlen gjë ndaj Zotit, as malli dhe fëmijët e tyre. Ata janë urët e zjarrit.
 11. Siç ndodhi me njerëzit e faraonit dhe pararendësit: përgënjeshtroan dëshmitë Tona dhe i mori Zoti me mëkatet e tyre. Zoti ka ndëshkim të rreptë.
 12. Thuaju mohuesve: “Do të mundeni e të grumbulloheni në skëterrë. Sa shtrat i keq!”
 13. Pati dëshmi për ju në takimin e dy grupeve (në Bedër); njëri grup që luftonte në Rrugën e Zotit dhe tjetri, mohues. Me shikimin e syrit u dukej sa dyfishi i tyre. Zoti mbështet me ndihmën e Tij kë do. Këtu ka mësim për largpamësit.
 14. Njerëzve u është zbukuruar pasioni për gratë, për fëmijët, për grumbullim ari e argjendi, për kuaj race, për bagëti e tokë. Kjo është kënaqësi e jetës së kësaj bote. Te Zoti është vendkthimi më i këndshëm.
 15. Thuaj: “T’jua bëj të njohur ç’është më e mirë? Të devotshmit kanë pranë Zotit të tyre kopshte ku rrjedhin lumenj, të përhershëm në to, bashkëshorte të pastra dhe kënaqësinë e Zotit.” Zoti është largpamës për robtë,
 16. që thonë: “Zoti ynë, besuam, falna mëkatet tona dhe mbrona nga dënimi i zjarrit”,
 17. për durimtarët, të singërtët, të bindurit, bujarët dhe ata që kërkojnë falje në agim.

18. Zoti dëshmon mbi bazën e së drejtës: s'ka zot veç Tij. Edhe engjëjt e të diturit. S'ka zot veç Tij, të Plotfuqishmit, të Urtit.
19. Feja te Zoti është Islami. Ithtarët e Librit ranë në kundërshti pasi u erdhi dija, nga keqdashja mes tyre. Në mohojnë dëshmitë e Zotit, Zoti ka llogari të shpejtë.
20. Në të kundërshtojnë, thuaj: "Unë dhe ndjekësit e mi iu dorëzuam Zotit." Thuaju ithtarëve të Librit dhe të paditurve: "Po ju, a dorëzoheni (si muslimanë)?" Nëse dorëzohen, janë të udhëhequr drejt; në largohen, ty të takon fjala. Zoti është largpamës për robtë.
21. Atyre që mohojnë dëshmitë e Zotit, vrasin profetët me pa të drejtë dhe vrasin njerëzit që porosisin drejtësi, jepu lajmin e një ndëshkimi të hidhët.
22. Të tillë që u dështuan veprat në këtë botë e në të ardhmen dhe nuk ka për ta ndihmëtarë.
23. Nuk ke parë nga ata që u është dhënë pjesë në libër? Ftohen te Libri i Zotit për të gjykuar mes tyre, pastaj një kastë kthehet në opozitë.
24. Pasi thonë: "Nuk do të na prekë zjarri përveç disa ditëve të numëruara." I mashtruan trillimet në fe.
25. Por, si, kur t'i mbledhim një ditë ku s'ka dyshim dhe t'i përmbushet secilit ajo që fitoi e të mos i bëhet e padrejtë?
26. Thuaj: "O Zot, Zotëruesi i Sundimit, Ti ia jep sundimin atij që do dhe ia heq sundimin atij që do, nderon kë do dhe poshtëron kë do! E mira është në Dorën Tënde. Ti je mbi gjithçka pushtetplotë.
27. Fut natën në ditë dhe fut ditën në natë, nxjerr të gjallin nga i vdekuri dhe të vdekurin nga i gjalli, ushqen kë do, pa masë!"

28. Besimtarët të mos marrin në vend të besimtarëve mohuesit për kujdestarë. Kush e bën këtë, s'ka vlerë te Zoti. Vetëm nëse i ruheni rrezikut të tyre. Ju paralajmëron Zoti Vetë. Fundi është te Zoti.
29. Thuaj: "I fshihni zemrat tuaja apo i shfaqni, Zoti e di. Ai di ç'janë në qiej e në tokë. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë."
30. Ditën kur secili ballafaqohet me të mirat që ka bërë, si dhe me të këqiat që ka bërë, këto, do të dëshironte të kishin me të një cak të largët. Ju paralajmëron Zoti Vetë. Zoti është i dhembshur me robtë.
31. Thuaj: "Në doni Zotin, më pasoni, t'ju dojë Zoti dhe t'jua falë mëkatet. Zoti është falës, mëshirëplotë."
32. Thuaj: "Bindjuni Zotit dhe të Dërguarit!" Nëse largohen, Zoti nuk i do mohuesit.
33. Zoti zgjodhi në botë Ademin, Nuhin, familjen e Ibrahimit, familjen e Imranit (atit të Musait),
34. pasardhës të njëri-tjetrit. Zoti është dëgjues, dijeplotë.
35. Kur gruaja e Imranit (nga breznia) tha: "Im Zot, unë ta kushtova Ty atë që kam në bark. Pranoje prej meje! Ti je Dëgjuesi, Dijeploti", -
36. - tek lindi, tha: "Im Zot, unë linda femër. – Zoti e di se ç'lindi dhe se mashkulli nuk është si femra. – E quajta Merjem dhe kërkoj për të e gjeneratën e saj mbrojtjen Tënde prej djallit të mallkuar."
37. Zoti i saj ia pranoi më së miri, e rriti atë më së miri dhe ia besoi Zekerijas. Sa herë hynte Zekerija te ajo në altar, i gjente ushqim. Tha: "O Merjem, nga e ke këtë?" Tha: "Nga Zoti." Zoti ushqen kë do, pa masë.
38. Zekerija iu lut aty Zotit. Tha: "Im Zot, dhuromë nga ana Jote një trashëgimi të mirë. Ti je Dëgjuesi i lutjes."

39. I thirrën engjëjt tek falej në altar: “Zoti të përgëzon me Jahjanë, vërtetues i një fjale prej Zotit, prijës, i dëlirë, profet dhe ndër të mirët.”
40. Tha: “Im Zot, si mund të bëhem me djalë kur më ka zënë pleqëria dhe gruaja ime është shterpë? Tha: “Kështu, Zoti bën atë që do.”
41. Tha: “Im Zot, më bëj një shenjë!” Tha: “Si shenjë, nuk do t’u flasësh njerëzve tri ditë, por me gjeste. Përmende shumë tët Zot, madhëroje mbrëmje e mëngjes.”
42. Kur engjëjt thanë: “O Merjem, Zoti të zgjodhi ty e të dëliri, të zgjodhi ndër gratë e botës,
43. o Merjem, bindju Zotit tënd, përlu dhe përkulu me ata që përkulen!”
44. - këto janë lajme të panjohura që po t’i kumtojmë. Nuk ishte pranë tyre kur hidhnin short se kush do të kujdesej për Merjemin, nuk ishte pranë tyre kur diskutonin.
45. Kur engjëjt thanë: “O Merjem! Zoti të përgëzon me një fjalë prej Tij: quhet Mesih, Isa, biri i Merjemit, i shquar në këtë botë dhe ndër të afërmit në të ardhmen;
46. u flet njerëzve në djep e në moshë të pjekur dhe është ndër të mirët”,
47. - ajo tha: “Im Zot, si mund të kem djalë kur s’më ka prekur njeri?” Tha: “Kështu, Zoti krijon ç’të dojë. Kur vendos diçka, thotë vetëm: “Ji!” dhe ajo është.”
48. Ia mëson Librin e Urtësinë, Teuratin dhe Ungjillin.
49. Profet te bijtë e Izraelit: “Unë ju erdha me dëshmi prej Zotit tuaj. Krijoj për ju nga balta një model shpendi, i fryj e bëhet shpend, me lejen e Zotit. Shëroj të verbrin e lebrosin dhe ngjall të vdekurin, me lejen e Zotit. Unë

- ju njoftoj se çfarë hani e ç'rezervoni në shtëpitë tuaja. Këtu ka dëshmi për ju në jeni besimtarë.
50. Duke pohuar Teuratin para meje, t'jua lejoj disa nga ç' ju ndaluan. Erdha me dëshmi nga Zoti juaj, pra, përmbajuni Zotit dhe bindmuni!
 51. Zoti është im Zot dhe Zoti juaj. Adhuroni Atë! Kjo është rrugë e drejtë."
 52. Kur pa mohimin e tyre, Isai tha: "Cilët janë ndihmëtarët e mi te Zoti?" Apostujt thanë: "Ne jemi ndihmëtarët e Zotit. Besojmë Zotin, pra, dëshmo se jemi muslimanë!
 53. Zoti ynë, ne besuam shpalljen dhe pasuam të Dërguarin. Na shkruaj si dëshmues!"
 54. Ata bënë një plan. Edhe Zoti bëri një plan. Zoti i bën mirë planet.
 55. Kur Zoti tha: "O Isa, Unë po të vdes e të ngre pranë Meje, po të dëlir nga mohuesit. Do t'i vë pasuesit e tu mbi mohuesit deri Ditën e Ringjalljes. Pastaj, kthimi juaj është tek Unë dhe do të gjykoj mes jush se ku ratë në kundërshti.
 56. Sa për mohuesit, do t'i ndëshkoj me dënim të rreptë në këtë botë e në të ardhmen dhe nuk ka për ta ndihmëtarë.
 57. Atyre që besojnë e bëjnë të mira ua përmbush shpërblimet. Zoti nuk i do dhunuesit."
 58. Ç'po të recitojmë, është nga dëshmitë dhe Kujtesa e Urtë.
 59. Te Zoti, shembulli i Isait është si shembulli i Ademit: e krijoi nga dheu, pastaj i tha: "Jil!" dhe është.
 60. E vërteta është nga yt Zot, të mos jesh dyshues!
 61. Atyre që të kundërshtojnë për të, pas dijes që të erdhi, thuaju: "Ejani të ftojme bijtë tanë e bijtë tuaj,

- gratë tona e gratë tuaja, veten tonë e veten tuaj dhe të kërkojmë mallkimin e Zotit mbi gënjeshtarët.”
62. Kjo është e vërteta e ngjarjes. S’ka zot veç Zotit. Zoti është i Plotfuqishmi, i Urti.
63. Në u shmangën, Zoti i njeh ngatërrestarët.
64. Thuaj: “Ithtarë të Librit, ejani te një fjalë e përbashkët mes nesh e jush: të adhurojmë vetëm Zotin, të mos i shoqërojmë gjë Atij, të mos marrim në vend të Zotit njëri-tjetrin për zota.” Po të largohen, thoni: “Dëshmoni se ne jemi muslimanë!”
65. Ithtarë të Librit, përse kundërshtoni te Ibrahim kur Teurati e Ungjilli zbritën pas tij? A nuk kuptoni?
66. Ju kundërshtoni ku keni dijeni; përse kundërshtoni ku s’keni dijeni? Zoti di tek ju nuk dini.
67. Ibrahim nuk ishte jude e i krishterë, por qe monoteist, musliman dhe nuk ishte idhujtar.
68. Njerëzit më të afërm te Ibrahim janë ata që e pasojnë, ky profet dhe ata që besojnë. Zoti është i Afërmi i besimtarëve.
69. Do të dëshironte një kastë ithtarësh të Librit t’ju gabonte, por gabojnë veten dhe nuk e kuptojnë.
70. Ithtarë të Librit, përse mohoni dëshmitë e Zotit kur jeni dëshmitarë?
71. Ithtarë të Librit, përse e vishni të vërtetën me të rremen dhe fshihni me dijeni të vërtetën?
72. Një kastë ithtarësh të Librit thotë: “Ç’u zbritet besimtarëve, bëni sikur e besoni në mëngjes dhe mohojeni në mbrëmje me qëllim që të kthejnë.
73. Dhe besojuni vetëm atyre që ndjekin fenë tuaj.” Thuaj: “Drejtimi i Zotit është drejtim. I jepet dikujt siç ju është dhënë juve. Mos po ju kundërshtojnë te Zoti juaj?”

- Thuj: "Mirësia është në Dorën e Zotit. Ia jep atij që do." Zoti është i paanë, dijeplotë.
74. Veçon me Mëshirën e Vet atë që do. Zoti është i Mirësisë së Madhe.
75. Ndër ithtarët e Librit, ka që, po t'ia besosh një mijë florinj, t'i kthen; ka që, po t'ia besosh një dinar, nuk ta kthen pa këmbëngulur. Sepse thonë: "S'mbajmë përgjegjësi për të paditurit." Thonë me dijeni gënjeshtër ndaj Zotit.
76. Po, Zoti i do ata që janë të devotshëm, mbajnë besën e ruhen.
77. Cilët blejnë me Besën e Zotit dhe betimet e tyre një çmim të ulët, s'kanë pjesë në të ardhmen. Ditën e Ringjalljes, Zoti nuk u flet, as i rishikon e nuk i çliron. Dhe kanë dënim të hidhët.
78. Ndër ta, ka që përdredhin gjuhën te libri, ta besoni si prej Librit, por nuk është prej Librit dhe thonë se është prej Zotit, por nuk është prej Zotit. Thonë, me dijeni, gënjeshtër ndaj Zotit.
79. Nuk ka njeri që Zoti t'i ketë dhënë Librin, urtësinë dhe profetësinë e t'u thotë njerëzve: "Jini robtë e mi në vend të Zotit!" - porse: "Jini ithtarë të Zotit sepse ju e bëni të njohur Librin dhe mësoni."
80. Dhe nuk ju porosit t'i merrni engjëjt e profetët për zota. A ju porosit mohimin pasi u bëtë muslimanë?
81. Kur Zoti u mori besë profetëve: "Duke ju dhënë libër e urtësi, vjen pastaj një profet që vërteton shkrimet tuaja, ta besoni e ndihmoni atë!" - tha: "A e pranoni dhe merrni përsipër Detyrën Time?" Thanë: "E pranojmë." Tha: "Dëshmoni! Edhe Unë jam me ju dëshmues."
82. Ata që largohen më pas janë të pabindur.

83. Mos kërkojnë tjetër veç Fesë së Zotit kur Atij i nënshtrohen ç'janë në qiej e në tokë, dashur e pa dashur dhe te Ai kthehen?
84. Thuaj: "Besojmë Zotin dhe ç'është zbritur te ne, ç'iu zbrit Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit e breznive, çfarë iu dha Musait, Isait dhe profetëve nga Zoti i tyre. Nuk ndajmë asnjërin prej tyre. Ne Atij i jemi dorëzuar."
85. Kujt kërkon fe tjetër veç Islamit, nuk i pranohet dhe, në të ardhmen, është ndër të humburit.
86. Si i drejtoka Zoti njerëzit që mohuan pasi besuan, dëshmuan se profeti është i vërtetë dhe u erdhën provat e qarta? Zoti nuk i drejton njerëzit e padrejtë.
87. Ndëshkimi i tyre është mallkimi i Zotit, i engjëjve dhe njerëzve së bashku.
88. Përgjithmonë. Nuk u lehtësohet dënimi e rishikohen.
89. Përveç atyre që, pas kësaj, u penduan e përmirësuan. Zoti është falës, mëshirëplotë.
90. Atyre që mohuan pasi besuan dhe u thelluan në mohim, nuk u pranohet pendimi. Ata janë të humburit.
91. Cilët mohuan dhe vdiqën mohues, nuk u pranohet, pa përjashtim, edhe sikur të shpërblejnë me flori sa faqja e dheut. Ata kanë dënim të hidhët dhe nuk ka për ta ndihmëtarë.
92. Nuk do t'ia arrini besimtarisë pa dhënë çfarë dëshironi për vete. Ç'të kontribuoni, Zoti e di.
93. Të gjitha ushqimet ishin të lejuara për bijtë e Izraelit përveç atyre që ndaloi vetë Izraeli (Jakubi) para shpalljes së Teuratit. Thuaj: "Sillni Teuratin dhe lexojeni në thoni të vërtetën."
94. Ata që trillojnë, pas kësaj, gënjeshtër ndaj Zotit janë dhunues.

95. Thuaj: “Zoti thotë të vërtetën. Pra, ndiqni fenë monoteiste të Ibrahimit. Ai nuk ishte idhujtar.”
96. E para shtëpi e caktuar për njerëzit është ajo në Bekkeh, e bekuar dhe drejtim për botët.
97. Aty ka dëshmi të qarta: vendndodhja e Ibrahimit. Kush hyn në të është i sigurt. Për Zotin, njerëzve u është bërë detyrë pelegrinazhi i Shtëpisë, cilët kanë mundësi udhëtimi. Në mohojnë, Zoti s’ka nevojë nga krijesat.
98. Thuaj: “Ithtarë të Librit, përse mohoni dëshmitë e Zotit kur Zoti është dëshmues i veprave tuaja?”
99. Thuaj: “Ithtarë të Librit, përse pengoni nga Rrugja e Zotit kë beson duke dashur t’ia shtrembëroni atë ndërsa jeni dëshmitarë?” Zoti nuk është i shkujdesur ndaj veprave tuaja.
100. Besimtarë, po t’i bindeni një pjese të atyre që u është dhënë Libri, ju praps, pas besimit tuaj, në mohues.
101. Si mund të mohoni kur jeni ju që ju recitohen dëshmitë e Zotit dhe mes jush është i Dërguari i Tij? Kush mbahet te Zoti, është udhëhequr në rrugë të drejtë.
102. Besimtarë, përmbajuni Zotit me devotshmëri të vërtetë dhe mos vdisni, por vetëm si muslimanë.
103. Mbahuni së bashku në tërkuzën e Zotit dhe mos u përçani! Kujtoni të mirën e Zotit tek ishit armiq, jua bashkoi zemrat dhe u bëtë, me Mirësinë e Tij, vëllezër. Ishit buzë një gremine të zjarrtë dhe ju shpëtoi. Zoti jua sqaron kështu dëshmitë e Tij që të mund të drejtoheni.
104. Le të jetë prej jush një bashkësi që fton te e mira, porosit të mirën dhe ndalon nga e keqja. Këta janë të suksesshmit.

105. Dhe mos jini si ata që u përçanë e ranë në kundërshti pasi u erdhën provat e qarta. Për ta ka dënim të madh.
106. Ditën kur zbardhin fytyra dhe nxijnë fytyra, faqezinjtë: "A mohuat pasi besuat? Vuajeni dënimin sepse mohuat."
107. Faqebardhët janë përgjithmonë në mëshirën e Zotit.
108. Këto janë dëshmitë e Zotit. T'i recitojmë me të vërtetën. Zoti nuk do padrejtësi për botët.
109. Zotit i takojnë ç'janë në qiej e në tokë dhe te Zoti kthehen çështjet.
110. Ju jeni bashkësia më e mirë që doli për njerëzit, të porositni të mirën, të ndaloni të keqen dhe të besoni Zotin. Po të besonin ithtarët e Librit, do të ishte më mirë për ta. Prej tyre ka besimtarë, por të shumtët janë të pabindur.
111. Përveç ndonjë shqetësimi, nuk do të mund t'ju dëmtojnë. Në ju luftojnë, prapsen dhe nuk do të përkrahen.
112. Ra mbi ta poshtërimi kudo që u ndeshën, vetëm se në besë të Zotit e në besë të njerëzve. Kthyen zemërim nga Zoti dhe ra mbi ta skamja. Sepse mohuan dëshmitë e Zotit dhe vranë profetët me pa të drejtë. Sepse kundërshtuan dhe e tejkaluan.
113. Nuk janë njësoj. Ndër ithtarët e Librit ka njerëz të vendosur që recitojnë natën dëshmitë e Zotit dhe bien me krye në tokë.
114. Besojnë Zotin dhe Ditën e Fundit, porositin të mirën, ndalojnë të keqen dhe konkurrojnë në vepra të mira. Ata janë ndër të mirët.
115. Ç'të mirë bëjnë, nuk u mohohet. Zoti i njej të devotshmit.

116. Mohuesve nuk do t'u vlejë gjë prej Zotit, as malli dhe fëmijët e tyre. Ata janë përgjithmonë banorët e zjarrit.
117. Shembulli i atyre që shpenzojnë në jetën e kësaj bote, një erë me acar, godet dhe zhduk të mbjellat e njerëzve të dhunues të vetvetes. Nuk i dhunoi Zoti, por dhunuan veten.
118. Besimtarë, mos merrni si të brendshëm të tjerë veç tuajve. Nuk do t'i lënë intrigat derisa t'ju dërrmojnë. Urrejtja u shfaq në gojët e tyre, por ç'fshehin në zemra është më e madhe. Ne jua sqaruar dëshmitë po qe se kuptoni.
119. Ja, ju i doni ata dhe nuk ju duan; ju besoni gjithë librat. Kur ju takojnë, thonë: "Besuam!"- dhe, kur veçohen, kafshojnë majat e gishtërinjve nga urrejtja. Thuaj: "Vdisni me urrejtjen tuaj!" Zoti është dijeplotë për vetë kraharonët.
120. Në ju bie e mirë, dëshpërohen dhe, në ju godet një e keqe, gëzohen. Po të duroni e të ruheni, nuk ju dëmton dinakëria e tyre. Zoti ua rrethon veprimet.
121. Kur dole herët nga shtëpia për t'i vënë besimtarët në pozicionet e luftës, - Zoti është dëgjues, dijeplotë, -
122. dy grupe prej jush i la kuraja tek është Zoti Kujdestari i tyre. Vetëm Zotit t'i mbështeten besimtarët!
123. Zoti ju ndihmoi në Bedër ku ishit të pafuqishëm. Përmabajuni Zotit që të mund të falënderoni.
124. Kur u the besimtarëve: "Nuk mjafton t'ju përforcojë Zoti me tremijë engjëj të zbritur?"
125. Po, në qoftë se duroni e përmbaheni, edhe po t'ju vijnë papritur, Zoti ju përforcon me pesëmijë engjëj me shenja.

126. Zoti e bëri këtë sihariq për ju dhe t'i qetësojë zemrat tuaja. Ndihma është prej Zotit, të Plotfuqishmit, të Urtit.
127. Dhe ta ndajë nërin krah të mohuesve ose t'i demoralizojë e të tërhiqen të dështuar.
128. Nuk të takon ty çështja nëse Ai i fal apo i dënon sepse ata janë dhunues.
129. Zotit i takojnë ç'janë në qiej e në tokë. Fal dhe dënon me dashjen e Tij. Zoti është falës, mëshirëplotë.
130. Besimtarë, mos përdorni interesin e shtuar! Përmabajuni Zotit që të mund të shpëtoni.
131. Ruajuni zjarrit të gatitur për mohuesit.
132. Bindjuni Zotit dhe të Dërguarit që të mund të mëshiroheni.
133. Konkurrioni për falje nga Zoti dhe parajsë, e gjerë sa qiejt e toka; u gatit për të devotshmit,
134. që kontribuojnë në mirëqenie e vështirësi, përmabajnë zemërimin dhe falin njerëzit; - Zoti i do bamirësit; -
135. që, kur bëjnë ndonjë paudhësi ose i bëjnë keq vetvetes, përmendin Zotin dhe i kërkojnë falje për mëkatet e tyre - kush fal mëkatet veç Zotit? - dhe nuk vazhdojnë me dijeni në ato veprime.
136. Ata kanë si shpërblim falje nga Zoti i tyre dhe kopshte ku rrjedhin lumenj, të përhershëm në to. Sa i mirë shpërblimi i punëmirëve!
137. Kaluan para jush epoka. Udhëtoni në tokë të shihni si qe fundi i përgënjeshtresve.
138. Ky është sqarim për njerëzit, drejtim e këshillë për të devotshmit.
139. Mos u dobësoni e dëshpëroni! Ju jeni më lart në jeni besimtarë.

140. Në ju prek një dhimbje, edhe atë popull e preku dhimbje si kjo. Ditë të tilla i qarkullojmë mes njerëzve, t'i njohë Zoti besimtarët dhe të marrë prej jush dëshmorë. Zoti nuk i do dhunuesit.
141. Dhe t'i pastrojë Zoti besimtarët e t'i asgjësojë mohuesit.
142. Mos menduat të hyni në parajsë pa i ditur Zoti cilët luftuan e t'i njohë durimtarët?
143. Ju e dëshironit vdekjen para se ta ndeshnit. Ja tek e patë, ballë për ballë!
144. Muhammedi është vetëm një i dërguar. Kaluan para tij të dërguar. Po të vdiste a të vritej, ju do të dezertonit? Kush dezerton, nuk i bën dëm Zotit. Zoti i shpërblen mirënjohësit.
145. Nuk vdes një frymë, por me lejen e Zotit, në afat të caktuar. Kujt dëshiron shpërblimin e kësaj bote, ia japim atë; kujt dëshiron shpërblimin e së ardhmes, ia japim atë. Dhe do t'i shpërblejmë mirënjohësit.
146. Sa e sa profetë luftuan me ithtarë të shumtë dhe nuk e humbën kurajën nga vështirësitë në Rrugën e Zotit, as u dobësuan e u nënshtruan. Zoti i do durimtarët.
147. Thonin vetëm: "Zoti ynë, falna mëkatet tona, teprimet në punët tona, forcoi këmbët tona dhe ndihmona ndaj njerëzve të pabesë!"
148. Zoti ua dha shpërblimin e kësaj bote dhe më të mirin shpërblim të së ardhmes. Zoti i do mirëbërësit.
149. Besimtarë, po t'u bindeni mohuesve, ju bëjnë të dezertoni dhe ktheheni të humbur.
150. Por, jo! Zoti është Mbrojtësi juaj dhe Ndhimëtar i Mirë.
151. Do të hedhim panik në zemrat e mohuesve sepse i bënë Zotit shok dhe, për këtë, nuk u erdhi argument.

- Zjarri është streha e tyre. Sa i keq vendqëndrimi i dhunuesve!
152. Zoti e mbajti premtimin tek i thyet me lejen e Tij. Derisa humbët kurajën, diskutuat urdhrin dhe nuk u bindët kur ju nxori përpara çfarë dëshironit. – Ndër ju, ka që duan këtë botë, ka që duan të ardhmen. - Pastaj ju prapsi prej tyre për t'ju vënë në provë. Dhe ju fali. Zoti është i mirësisë ndaj besimtarëve.
153. Kur po ngjiteshit përpjetë, pa vënë re dikë, ndërsa Profeti ju ftonte pas, Ai jua shpërbleu me tronditje pas tronditjeje, që të mos brengoseshit se ç'ju iku e ju zuri. Zoti është në dijeni të veprave tuaja.
154. Pas tronditjes, zbriti te ju qetësi, përgjumje që mbuloi një pjesë tuajsh ndërsa disa shqetësoheshin në vetvete. Mendonin për Zotin jo drejt, por me mendimin e kohës së padijes. Thonin: “A na takon neve diçka në çështje?” Thuaj: “Çështja i takon krejt Zotit.” Fshehin në vetvete ç'nuk ta shprehin ty. Thonë: “Po të na takonte diçka në çështje, s'do të vriteshim këtu.” Thuaj: “Po të ishit në shtëpitë tuaja, vdekja do t'u vinte në shtrat atyre që e kanë të shkruar.” Zoti vë në provë kraharorët tuaj dhe pastron zemrat tuaja. Zoti është dijeplotë për vetë kraharorët.
155. Ndër ju, cilët u shmangën ditën e takimit të dy grupeve, i tundoi vetëm se djalli për ca fitim. Por Zoti i fali. Zoti është falës, i butë.
156. Besimtarë, mos jini si mohuesit që, kur vëllezërit e tyre merrnin udhë ose ishin duke luftuar, thonin: “Po të qenë pranë nesh, nuk do të vdisnin e të vriteshin.” Zoti ua bëri mjerim në zemrat e tyre. Zoti jep jetë e vdes. Zoti është largpamës i veprave tuaja.

157. Po të vriteni a të vdisni në Rrugën e Zotit, një falje e mëshirë prej Zotit kanë më dobi nga ç'grumbullojnë ata.
158. Vdiqët a u vratë, te Zoti do të mblidheni.
159. Si mëshirë prej Zotit, ishe i butë me ta. Po të ishe i vrazhdë e zemërashpër, do të shpërndareshin nga rrethi yt. Fali e kërko falje për ta, konsultohu me ta në çështje dhe, kur vendos, mbështetu te Zoti. Zoti i do ata që mbështeten.
160. Nëse ju ndihmon Zoti, s'ka mposhtje për ju; në ju braktis, kush ju ndihmon veç Tij? Vetëm Zotit t'i mbështeten besimtarët!
161. Një profet nuk mashtron. Kush mashtron, vjen me mashtrimin e vet Ditën e Ringjalljes, pastaj i përmbushet çdo fryme ajo që fitoi dhe nuk i bëhet e padrejtë.
162. Ata që ndjekin kënaqësinë e Zotit mos janë si dikush që kthen zemërim nga Zoti? Streha e tij është skëterra, ç'fund i keq!
163. Ata kanë përparësi te Zoti. Zoti është largpamës i veprave të tyre.
164. Zoti i favorizoi besimtarët kur dërgoi tek ta një profet prej tyresh, t'u recitojë dëshmitë e Tij, t'i çlirojë dhe t'ua mësojë Librin e Urtësinë tek ishin më parë në gabim të dukshëm.
165. Kur ju ra një fatkeqësi, ndërsa ju shkaktuat dyfishin e saj, thatë: "Po kjo?" Thuaj: "E keni nga vetja." Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.
166. Ç'ju ndodhi ditën e takimit të dy grupeve, ishte me lejen e Zotit dhe për t'i njohur besimtarët.
167. Për t'i njohur edhe hipokritët që, kur iu tha: "Ejani të luftoni në Rrugën e Zotit ose të mbroheni", - thanë:

- “Po të dinim të luftonim, do t’ju ndiqnim”, - duke qenë më afër mohimit se besimit. Thonin me gojë e jo me zemër. Zoti ua di të fshehtat.
168. Duke ndenjur, u thanë të vëllezërve: “Po të na bindeshin, nuk do të qenë vrrarë.” Thuaj: “Prapseni vdekjen në thoni të vërtetën.”
 169. Mos i pandehni të vdekur cilët vriten në Rrugën e Zotit. Jo, janë të gjallë, ushqehen pranë Zotit të tyre,
 170. të gëzuar me ç’u ka dhënë Zoti me Mirësinë e Vet dhe duan t’u japin sihariq atyre që nuk u janë bashkuar ende, të mos frikësohen e dëshpërohen.
 171. Duan të japin sihariq për mirësi dhe nder nga Zoti. Zoti nuk ua humb shpërblimin besimtarëve,
 172. që, kur u ra dhimbja, iu përgjigjën Zotit dhe të Dërguarit, një shpërblim të madh mirëbërësve e të devotshmëve,
 173. që, kur u thanë: “Kini frikë! Njerëzit janë mbledhur kundër jush”, - iu shtua besimi dhe thanë: “Na mjafton Zoti, Mbrojtësi Më i Mirë!”
 174. U kthyen me mirësi e nder prej Zotit dhe nuk i zuri ndonjë e keqe, porse ndoqën kënaqësinë e Zotit. Zoti është i Mirësisë së Madhe.
 175. Djalli ju frikëson me miqtë e tij. Mos iu frikësoni atyre, frikësomuni Mua në jeni besimtarë.
 176. Mos të të dëshpërojnë ata që konkurrojnë në mohim. Ata nuk do ta dëmtojnë gjë Zotin. Zoti dëshiron të mos u bëjë pjesë në të ardhmen dhe kanë dënim të madh.
 177. Cilët blejnë mohimin me besim, nuk do ta dëmtojnë gjë Zotin dhe kanë dënim të hidhët.

178. Të mos pandehin mohuesit se u japim afat në të mirën e tyre. U japim afat të thellohen në mëkat dhe kanë dënim poshtërues.
179. Zoti nuk do t'i lërë besimtarët aty ku jeni, pa dalluar të keqen nga e mira. Zoti nuk jua zbulon të padukshmen, porse Zoti zgjedh, me dashjen e Tij, të dërguar. Besoni Zotin dhe të dërguarit e Tij! Po të besoni e të përmbaheni, ka për ju shpërblim të madh.
180. Të mos pandehin dorështërënguarit se ç'u ka dhënë Zoti, me Mirësinë e Tij, është në të mirë të tyre; jo, ajo është në të keq të tyre. Kopracia do t'u mbështillet Ditën e Ringjalljes. Trashëgimia e qiejve dhe e tokës i takon Zotit. Zoti është në dijeni të veprave tuaja.
181. Zoti e dëgjoi fjalën e atyre që thanë: "Allahu është i varfër dhe ne të pasur." Do t'i shkruajmë çfarë thonë dhe që vranë me pa të drejtë profetët. U themi: "Shijoni dënimin e zjarrit!
182. Përgatitur me duart tuaja." Zoti nuk është tiran me robtë.
183. Atyre që thonë: "Zoti ka marrë besë te ne të mos besojmë të dërguar pa na sjellë një kurban që e ha zjarri", - thuaju: "Ju erdhën më parë të dërguar me prova të qarta, edhe siç thoni. Përse i vratë ata në thoni të vërtetën?
184. Në të përgënjeshtrojnë, u përgënjeshtroan profetë para teje që erdhën me prova të qarta, me Zeburin dhe Librin Dritëdhënës.
185. Çdo frymë e shijon vdekjen. Dhe do të përmbushen shpërblimet tuaja Ditën e Ringjalljes: kush i largohet zjarrit dhe hyn në parajsë, ka dalë fitimtar. Jeta e kësaj bote është vetëm një iluzion.

186. Do të provoheni në pasuritë dhe veten tuaj e do të dëgjoni nga ata që u është dhënë libri para jush dhe nga idhujtarët fyerje të shumta. Të duroni e të përmbaheni, kjo është ndër çështjet vendimtare.
187. Kur Zoti mori besën e atyre që u është dhënë Libri: “T’ua shpjegoni njerëzve dhe të mos e fshehni”, - e hodhën pas shpine dhe blenë me të një çmin të ulët. Ç’të keqe blenë!
188. Mos i pandeh ata që gëzohen me ç’kanë bërë dhe që duan të lavdërohen me ç’nuk kanë bërë, pra, mos i pandeh të shpëtuar nga dënimi. Ata kanë dënim të hidhët.
189. Zotit i takon sundimi i qiejve dhe i tokës. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.
190. Në krijimin e qiejve e të tokës dhe në ndryshimin e natës e të ditës ka dëshmi për të mençurit,
191. që përmendin Zotin më këmbë, ulur e mënjane dhe meditojnë në krijimin e qiejve e të tokës: “Zoti ynë, nuk i krijove këto më kot. Qofsh madhëruar! Mbrona prej dënimit të zjarrit!
192. Zoti ynë, kë fute në zjarr, e ke poshtëruar. Dhunuesit nuk kanë ndihmëtarë.
193. Zoti ynë, dëgjuam një thirrës që fton në besim: “Besoni Zotin tuaj!” - dhe besuam. Zoti ynë, falna mëkatet tona, na i shlyej të këqiat tona dhe vdisna me të mirët!
194. Zoti ynë, jepna ç’na premtove me të dërguarit e Tu dhe mos na poshtëro Ditën e Ringjalljes! Ti nuk e shkel premtimin.”
195. Dhe iu përgjigj Zoti i tyre: “Unë nuk ia humb punën punuesit ndër ju, mashkull apo femër, ju jeni prej njëri-tjetrit. Por, atyre që emigruan, u dëbuan nga

- trojet e tyre, u munduan në Rugën Time, luftuan e u vranë, do t'ua shlyej të këqiat dhe do t'i fus kopshteve ku rrjedhin lumenj, shpërblim nga ana e Zotit.” Zoti ka pranë Tij shpërblimin më të mirë.
196. Mos të të mashtrojë lëvizja e mohuesve nëpër vende.
 197. Një kënaqësi e vogël. Pastaj, streha e tyre është skëterra, ç'shtrat i keq!
 198. Përkundrazi, cilët i përmbahen Zotit, kanë kopshte ku rrjedhin lumenj, të përhershëm në to, pritje nga ana e Zotit. Pranë Zotit është më e mira për të devotshmit.
 199. Ndër ithtarët e Librit, ka që besojnë Zotin, shpalljen të ju dhe shpalljen tek ata, të përvuajtur ndaj Zotit. Nuk blejnë me dëshmitë e Zotit një çmim të ulët. Ata e kanë shpërblimin pranë Zotit të tyre. Zoti ka llogari të shpejtë.
 200. Besimtarë! Duroni, qëndroni, shtrëngoni radhët dhe përmbajuni Zotit që të mund të keni sukses.

4. GRATË (EN-NISA')

Periudha e Medines, 176 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Njerëz, përmbajuni Zotit tuaj që ju krijoi nga një frymë e vetme, krijoi prej saj palën dhe përhapi prej tyre meshkuj e femra të shumtë. Përmbajuni Zotit me të Cilin i drejtoheni njëri-tjetrit dhe kujdes gjininë! Zoti është ndaj jush vëzhgues.

2. Jepuni jetimëve pasuritë e tyre dhe mos këmbeni të mirën me të keqe; mos përvetësoni pasuritë e tyre në pasuritë tuaja. Ky është mëkat i madh.
3. Po të druani se nuk do të mbanit drejtësi te jetimet, martohuni me gra të mira për ju, me dy, tre dhe katër; po të druani se nuk do të ishit të drejtë, vetëm me një ose me ato që zotëroni (shih ajetet 24,25). Kjo është më afër që të mos gaboni.
4. Jepuni grave dhuratën e martesës. Në ju bëjnë vetë ndonjë të mirë prej saj, pranojeni me kënaqësi.
5. Mos u jepni të metëve mendore pasuritë që Zoti jua bëri jetesë, por ushqejini, vishini dhe thuajuni fjalë të mira.
6. Provoni jetimet sa të arrijnë moshën e martesës dhe, kur shihni se janë të aftë, dorëzojuani pasuritë e tyre. Mos i përdorni ato me teprim e ngut para se të rriten. I pasuri le të vetëpërmbahet dhe i varfri le të përdorë me masë. Kur t'ua dorëzoni pasuritë e tyre, merrni dëshmitarë. Mjafton Zoti në llogari.
7. Meshkujt kanë pjesë nga ç'lënë prindërit e të afërmit dhe femrat kanë pjesë nga ç'lënë prindërit e të afërmit, pak apo shumë, pjesë e caktuar.
8. Po të jenë të pranishëm në ndarje të afërm, jetimë e të varfër, jepuni prej saj dhe thuajuni fjalë të mira.
9. Le të kenë frikë ata që, sikur të linin pasardhës të dobët, do të frikësoheshin për ta; pra, le të kenë frikë Zotin e të thonë fjalë me vend.
10. Cilët përvetësojnë pa të drejtë pasuritë e jetimëve, hanë në barqet e tyre vetëm se zjarr dhe do të digjen në flakë.
11. Zoti ju porosit te fëmijët: mashkullit i takon pjesa e dy femrave; po të jenë femra, dy e më shumë, u takon dy

të tretat e trashëgimisë; në qoftë ajo vetëm një, i takon gjysma. Kur i vdekuri ka fëmijë, prindërve u takon secilit një e gjashta; po të mos ketë fëmijë dhe e trashëgojnë dy prindërit, nënës i takon një e treta; po të ketë vëllezër e motra, nënës i takon një e gjashta; këto, pas ndonjë testamenti që ai ka bërë ose borxhi. Prindërit dhe fëmijët, ju nuk e dini cilët janë më afër në përfitim. Detyrim nga Zoti. Zoti është dijeplotë, i urtë.

12. Juve ju takon gjysma e asaj që lënë gratë tuaja po të mos kenë fëmijë; në qoftë se kanë fëmijë, ju takon një e katërta e asaj që lënë, pas ndonjë testamenti që ato kanë bërë ose borxhi. Atyre u takon një e katërta e asaj që lini ju në qoftë se nuk keni fëmijë; po të keni fëmijë, u takon një e teta e asaj që lini ju, pas ndonjë testamenti që keni bërë ose borxhi. Po të jetë mashkull a femër pa trashëgimtar, por që ka një vëlla ose motër, secilit prej tyre i takon një e gjashta; në qofshin më shumë, janë pjesëtarë në një të tretën, pas ndonjë testamenti të bërë ose borxhi, pa të dëmtuar. Porosi nga Zoti. Zoti është dijeplotë, i butë.
13. Këto janë kufijtë e Zotit. Cilët u binden Zotit dhe të Dërguarit të Tij, Ai i fut kopshteve ku rrjedhin lumenj, të përhershëm në to. Ky është sukses i madh.
14. Kë s'u bindet Zotit e të Dërguarit të Tij dhe shkel kufijtë e Tij, Ai e fut përgjithmonë në zjarr dhe ka dënim poshtërues.
15. Ndër gratë tuaja, për ato që bëjnë imoralitet, kërkoni të dëshmojnë katër vetë; po të dëshmojnë, mbajini në shtëpi derisa t'u vijë vdekja ose të ketë bërë Zoti zgjidhje.

16. Ata të dy që e bëjnë atë, ndëshkojini; po të pendohen e përmirësohen, shmanguni prej tyre. Zoti është falës, mëshirëplotë.
17. Pendim te Zoti është vetëm i atyre që e bëjnë të keqen me padije dhe pendohen shpejt. Zoti ua pranon pendimin. Zoti është dijeplotë, i urtë.
18. Nuk është pendimi i atyre që bëjnë të këqia dhe, kur u vjen vdekja, thonë: "Tani u penduam", - as i atyre që vdesin mohues. Bëmë për ta gati një dënim të hidhët.
19. Besimtarë! Nuk ju lejohet t'i trashëgoni gratë me forcë dhe mos i pengoni të martohen për t'u marrë pjesë nga ç'u keni dhënë, vetëm në qoftë se bëjnë ndonjë imoralitet të qartë. Jetoni me to me mirëkuptim. Në s'i pëlqeni, ndodh të mos pëlqeni diçka dhe Zoti të bëjë në të dobi të shumta.
20. Në qoftë se doni të merrni një grua në vend të një tjetre dhe së parës i keni dhënë një mijë florinj, mos merrni gjë prej saj. A e merrni me shpifje dhe faj të dukshëm?
21. Si mund t'ia merrni kur i jeni hapur njëri-tjetrit dhe ato kanë marrë prej jush besë të fortë?
22. Mos u martoni me gratë e etërve tuaj, përjashtuar së kaluarës që ishte imoralitet, e urryer dhe traditë e keqe.
23. Nuk ju lejohen nënat tuaja, bijat tuaja, motrat tuaja, hallat tuaja, tezet tuaja, bijat e vëllait, bijat e motrës, nënat e qumështit, motrat e qumështit, nënat e grave tuaja, bijat e gjetura nën kujdestarinë tuaj nga gratë tuaja me të cilat keni bërë marrëdhënie; nëse nuk keni bërë marrëdhënie, nuk është mëkat; gratë e bijve tuaj të lindur, dy motra njëkohësisht, përjashtuar së kaluarës, - Zoti është falës, mëshirëplotë, -

24. gratë nën kurorë, përveç atyre që zotëroni. Caktim i Zotit për ju. Lejohen të tjerat, t'i kërkonti me pasuritë tuaja, si të ndershëm e jo të pandershëm. Në bashkëjetesë me to, jepuni shpërblimin e detyruar të kurorës, por nuk është mëkat të pranoni diçka së bashku pas detyrimit. Zoti është dijeplotë, i urtë.
25. Kush nuk ka mundësi materiale për gra të lira besimtare, le të martohet me vajza besimtare që keni nën zotërim. Zoti e di më së miri besimin tuaj. Ju jeni prej njëri-tjetrit. Pra, martohuni me to, me lejen e të zotëve dhe jepuni me drejtësi shpërblimin e kurorës, si të ndershme dhe jo të pandershme e dashnore. Kur janë të martuara, po të bëjnë imoralitet, kanë gjysmën e dënimit të grave të lira. Kjo, për këdo që i ruhet mëkatit. Të duroni, është më mirë për ju. Zoti është falës, mëshirëplotë.
26. Zoti dëshiron t'ju sqarojë, t'ju drejtojë udhëve të të parëve (profetëve) dhe t'ju falë. Zoti është dijeplotë, i urtë.
27. Zoti dëshiron t'ju falë ndërsa ata që ndjekin pasionet duan të bini në gabim të rëndë.
28. Zoti dëshiron t'ju lehtësojë sepse njeriu u krijua i dobët.
29. Besimtarë, mos përvetësoni pa të drejtë pasuritë mes jush, por të jetë një tregti e pranueshme dhe mos dëmtoni veten tuaj. Zoti është me ju mëshirëplotë.
30. Kë e bën atë, me armiqësi e dhunë, ia vëmë zjarrit. Kjo, për Zotin është e lehtë.
31. Në u shmangeni mëkateve të mëdha, jua mbulojmë të metat dhe ju pranojmë në një hyrje të nderuar.
32. Mos lakmoni që Zoti ka dalluar disa mbi të tjerë. Burrat kanë pjesë nga ç'fitojnë dhe gratë kanë pjesë

nga ç'fitorje. Kërkojini Zotit mirësitë e Tij. Zoti është për gjithçka dijeplotë.

33. Secilit i bëmë trashëgimtarë nga ç'lënë prindërit dhe të afërmit. Atyre që u keni dhënë besë, jepuni pjesën. Zoti është në çdo gjë dëshmues.
34. Burrat janë kujdestarët e grave sepse Zoti ka dalluar disa mbi të tjerë dhe se ata shpenzojnë nga pasuritë e tyre. Gratë e mira janë të bindura, ruajtëse të nderit që Zoti e ka ruajtur. Ato të cilave u frikësoheni për mosbindje, këshillojini, veçojini në shtrat dhe ndëshkojini. Po të binden, mos kërkonin mjet kundër tyre. Zoti është i lartë, i madh.
35. Kur ka mosmarrëveshje mes tyre, dërgoni gjykatës nga familja e tij dhe gjykatës nga familja e saj. Në duan pajtim, Zoti ua plotëson. Zoti është dijeplotë, i gjithëditur.
36. Adhuroni Zotin dhe mos i bëni shok. Silluni mirë me prindërit, me të afërmit, me jetimët, me të varfrit, me fqinjin e afërt, me fqinjin e largët, me shokun, me udhëtarin dhe me robërit. Zoti nuk do mburracakë e arrogantë,
37. që janë dorështrënguar, porositin njerëzit të jenë dorështrënguar dhe fshehin çfarë Zoti u ka dhënë me Mirësinë e Vet, - mohuesve u përgatitëm dënim poshtëruës, -
38. që shpenzojnë pasuritë e tyre për opinion të njerëzve e nuk besojnë Zotin dhe Ditën e Fundit. Kush ka djallin shok, ç'shok të keq ka!
39. Përse të mos besojnë Zotin dhe Ditën e Fundit e të japin nga pjesa që Zoti u ka dhënë? Zoti është për ta dijeplotë.

40. Zoti nuk bën aspak padrejtësi; në qoftë vepër e mirë, Ai e shumëfishon dhe jep nga ana e Vet shpërblim të madh.
41. Si, kur Ne të sjellim nga çdo bashkësi një dëshmues dhe ty të të sjellim për ta dëshmues?
42. Atë ditë, cilët mohuan dhe kundërshtuan Profetin, do të dëshironin të rrafshohej me ta toka. Por nuk mund t'i fshehin Zotit fjalë.
43. Besimtarë, mos iu afroni të falurit të dehur, pa ditur se ç'flisni, as të papastër, derisa të laheni, vetëm në jeni kalimtarë. Po të jeni të sëmurë, në udhëtim, pas kryerjes së nevojave të jashtëqitjes ose marrëdhënieve me gratë dhe nuk gjeni ujë, kthejuni truallit të pastër dhe fërkoni fytyrat e duart. Zoti është ndjesës, falës.
44. Nuk ke parë te ata që u është dhënë pjesë nga Libri si blejnë të gabuarën dhe duan të gaboni udhë?
45. Zoti i njeh armiqtë tuaj. Mjafton Zoti kujdestar, mjafton Zoti ndihmëtar.
46. Disa judenj i ndryshojnë fjalët në kuptimin e tyre dhe thonë: "Dëgjuam e kundërshtuam", "Dëgjo, mos dëgjofsh", "Raina!"- duke përdredhur gjuhën me tallje në fe. Sikur të thonin: "Dëgjuam e u bindëm", "Dëgjo e na vështro!"- do të qe më mirë e drejt për ta, porse i mallkoi Zoti me mohimin e tyre dhe pak besojnë.
47. Ju që ju është dhënë Libri, besoni në atë që kemi zbritur, që vërteton shkrimet tuaja, para se të shpërfytyrojmë disa fytyra e t'i kthejmë së prapthi ose t'i mallkojmë siç mallkuam pjesëtarët e së Shtunës. Urdhri i Zotit është i kryer.

48. Zoti nuk fal t'i bëhet shok, por fal, veç kësaj, me dashjen e Vet. Kush i bën Zotit shok, ka sajuar një mëkat të madh.
49. Nuk ke parë te ata që çlirojnë veten? Jo, Zoti çliron atë që do dhe nuk i bëhet aspak e padrejtë.
50. Shih si sajojnë ndaj Zotit gënjeshtër! Mjafton kjo, një mëkat i qartë.
51. Nuk ke parë te ata që u është dhënë pjesë nga Libri? Besojnë në idhuj e djaj dhe thonë për mohuesit: "Këta janë më drejt në udhë se besimtarët."
52. Janë ata që ka mallkuar Zoti. Kë mallkon Zoti, nuk mund t'i gjesh ndihmëtar.
53. Mos kanë pjesë në sundim? Atëherë nuk do t'u jepnin njerëzve qoftë një bërthamë hurme.
54. Apo kanë zili njerëzit nga ç'u ka dhënë Zoti me Mirësinë e Vet? Ne i dhamë familjes së Ibrahimit Librin e Urtësinë, i dhamë sundim të madh.
55. Ndër ta, ka që e besojnë dhe ka të larguar prej tij. Mjafton skëterra me zjarrin ndezur.
56. Ata që mohojnë dëshmitë Tona ia vëmë zjarrit. Sa herë u digjet lëkura, ua ndërrojmë që ta shijojnë dënimin. Zoti është i plotfuqishëm, i urtë.
57. Cilët besojnë e bëjnë të mira, i pranojmë kopshteve ku rrjedhin lumenj, të përhershëm në to, përgjithmonë. Kanë atje bashkëshorte të pastra dhe i fusim në hije të këndshme.
58. Zoti ju urdhëron t'ua dorëzoni amanetet të zotëve dhe, kur të gjykoni mes njerëzve, gjykoni me drejtësi. Sa mirë ju këshillon Zoti! Zoti është dëgjues, largpamës.
59. Besimtarë, bindjuni Zotit, bindjuni të Dërguarit dhe urdhërdhënësve mes jush. Kur nuk pajtoheni me

diçka, përcillen te Zoti dhe i Dërguari po qe se besoni Zotin dhe Ditën e Fundit. Kjo është zgjidhja më e mirë dhe e bukur.

60. A nuk ke parë te ata që pohojnë të kenë besuar shpalljen tek ty e shpalljen para teje dhe duan të gjykojnë te djalli ndërsa u urdhëruan ta mohonin? Djalli dëshiron t'i shpjerë në gabim të thellë.
61. Kur u thuhet: "Ejani te ajo që Zoti ka shpallur dhe te i Dërguari", - i vështrojnë hipokritët si largohen prej teje të shmangur?
62. Kur u bie fatkeqësi e bërë me duart e tyre, vijnë tek ty dhe betohen në Zotin se "duam vetëm mirëkuptim e marrëveshje."
63. Janë ata që Zoti ua njeh zemrat, pra, shmangu prej tyre, këshilloji dhe thuaju fjalë me vend.
64. Ne dërguam të dërguar për bindje, me lejen e Zotit. Sikur të të vinin kur i bënë padrejtësi vetes dhe t'i kërkonin falje Zotit, edhe i Dërguari të kërkonte falje për ta, do ta gjenin Zotin falës, mëshirëplotë.
65. Por, jo! Për tët Zot, nuk besojnë pa të bërë ty gjykatës në mosmarrëveshjet e tyre, pastaj të mos ngushtohen nga vendimi yt dhe të nënshtrohen plotësisht.
66. Sikur t'ua caktonim të vetësakrifikoheshin ose të dilnin nga trojet e tyre, përjashtuar një pakice, nuk do ta bënin. Po të veprojnë siç këshillohen, është më mirë për ta dhe më e qëndrueshme.
67. U japim, atëherë, nga ana Jonë, shpërblim të madh.
68. Dhe i udhëheqim në udhë të drejtë.
69. Cilët u binden Zotit dhe të Dërguarit, janë me ata që bekoi Zoti, me profetët, besnikët, dëshmorët, të drejtët, ç'shokë fisnikë!
70. Kjo është mirësia e Zotit. Mjafton Zoti dijeplotë!

71. Besimtarë, merrni masat dhe dilni me njësi ose dilni së bashku.
72. Dikush nga ju ngurron dhe, në ju bie e keqe, thotë: “Më bekoi Zoti që s’isha me ta.”
73. Në ju bie e mirë nga Zoti, si të mos kishte lidhje me ju, thotë: “Sikur të isha me ta, do të arrija fitore të madhe!”
74. Le të luftojnë në Rrugën e Zotit ata që japin jetën e kësaj bote për të ardhmen! Kujt lufton në Rrugën e Zotit, vritet a ngadhënjën, i japim shpërblim të madh.
75. Përse të mos luftoni në Rrugën e Zotit edhe për ata që janë të shtypur, burra, gra e fëmijë dhe që thonë: “Zoti ynë, nxirrna nga ky vendbanim me njerëz tiranë dhe bëna nga ana Jote kujdestar, bëna nga ana Jote ndihmëtar!”
76. Besimtarët luftojnë në Rrugën e Zotit ndërsa mohuesit luftojnë në rrugën e djallit. Luftoni aleatët e djallit! Strategjia e djallit është e dobët.
77. Nuk ke parë nga ata që u thuhet: “Mbani duart, kryeni të falurit, jepni detyrimin?” – dhe, sapo u caktua për ta lufta, ja, një kastë e tyre u frikësohet njerëzve si t’i frikësohej Zotit, edhe më fort. Thonë: “O Zot, përse na e caktove luftën dhe nuk na e shtyn për një kohë?” Thuaj: “Kënaqësia e kësaj bote është e pakët; e ardhmja është më e mirë për të devotshmit. Dhe nuk ju bëhet aspak e padrejtë.
78. Kudo që të jeni, ju arrin vdekja, qofshi në kulla të larta.” Në u bie e mira, thonë se është nga Zoti; në u bie e keqja, thonë se është prej teje. Thuaju: “E tëra është nga Zoti.” Përse këta njerëz gati nuk kuptojnë një fjalë?

79. Ç'e mirë të bie, është nga Zoti dhe, ç'e keqe të bie, e ke nga vetja. Ne të dërguam si të dërguar për njerëzit. Mjafton Zoti dëshmues.
80. Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Zotit. Në largohen, nuk të dërguam mbi ta rojë.
81. Dhe thonë: "Bindje!" Kur veçohen prej teje, një grup tyresh planifikon ndryshe nga fjalët tuaja. Zoti ua shkruan planet. Ti shmangu prej tyre dhe mbështetu te Zoti. Mjafton Zoti mbrojtës.
82. A nuk e shqyrtojnë Kuranin? Po të mos ishte nga ana e Zotit, do të gjenin në të kundërshti të shumta.
83. Me t'u ardhur ndonjë lajm qetësues apo shqetësues, e përhapin. Sikur t'ua përcillnin Profetit dhe autoriteteve mes tyre, ata do të dinin si ta trajtonin. Të mos qenë mirësia dhe mëshira e Zotit ndaj jush, përjashtuar një pakice, do të ndiqnit djallin.
84. Lufto në Rrugën e Zotit! Ti ngarkohesh vetëm për veten tënde. Dhe nxiti besimtarët! Zoti mund ta përmbajë fuqinë e mohuesve. Zoti ka fuqi më të rreptë dhe ndëshkim më të rreptë.
85. Kush ndërhyr për mirë, ka pjesë në të. Kush ndërhyr për keq, ka barrë në të. Zoti është i gjithëfuqishëm te çdo gjë.
86. Kur merrni përshëndetje, përshëndetni edhe më bukur ose kthejeni atë. Zoti vlerëson gjithçka.
87. Zoti, s'ka zot veç Tij, do t'ju mbledhë, pa dyshim, Ditën e Ringjalljes. Kush flet më drejt se Zoti?
88. Përse jeni dy grupesh te hipokritët? Zoti i ktheu, me ç'fituan, mbrapsht. Mos doni të drejtoni dikë që Zoti e ka lënë të humbur? Kë Zoti lë të humbur, s'mund t'i gjesh udhë.

89. Dëshirojnë të mohonit siç mohuan e të jeni njësoj.
Pra, mos i merrni për miq pa dalë në Rrugën e Zotit.
Po të dezertojnë, kapini e vritini ku t'i gjeni. Dhe mos bëni prej tyre mik e ndihmëtar.
90. Përveç atyre që i bashkohen një populli me të cilin keni marrëveshje ose që nuk kanë zemër t'ju luftojnë juve apo të luftojnë njerëzit e tyre. Të kishte dashur Zoti, u jepte fuqi dhe ju luftonin. Nëse tërhiqen, nuk ju luftojnë dhe ju propozojnë paqe, Zoti nuk ju bën udhë kundër tyre.
91. Do të gjeni të tjerë që duan të sigurohen prej jush e të sigurohen prej popullit të tyre dhe në çdo rast i kthehen pabesisë. Në qoftë se nuk tërhiqen, s'ju propozojnë paqe dhe nuk mbajnë duart, kapini e vritini ku t'i ndeshni. Ju kemi dhënë kundër tyre një mandat të qartë.
92. Besimtari nuk duhet të vrasë një besimtar në mos gabimisht. Kur vritet një besimtar gabimisht, të lirohet një rob besimtar dhe t'i paguhet gjaku familjes së tij, vetëm po qe se ajo dëshiron t'i bëjë një të mirë. Po të jetë besimtar nga një popull armik, të lirohet një rob besimtar. Po të jetë nga një popull me të cilin keni marrëveshje, t'i paguhet gjaku familjes së tij dhe të lirohet një rob besimtar. Kush nuk gjen, të agjërojë dy muaj në vazhdim, si pendim ndaj Zotit. Zoti është dijeplotë, i urtë.
93. Kush vret një besimtar me dashje, ka skëterrën shpërblim ku është i përhershëm. Zemërimi i Zotit ra mbi të; Ai e mallkoi dhe i bëri gati një dënim të madh.
94. Besimtarë, kur dilni në Rrugën e Zotit, sigurohuni dhe mos i thoni dikujt që ju jep paqe se "nuk je besimtar" duke lakmuar prenë e kësaj bote. Pranë Zotit ka trofe

- të shumta. Ishit kështu më parë, por Zoti ju bekoi, pra, sigurohuni! Zoti është në dijeni të veprave tuaja.
95. Ndër besimtarët, nuk barazohen mospjesëmarrësit që nuk janë të paaftë dhe luftëtarët në Rrugën e Zotit me pasuritë dhe veten e tyre. Zoti ka dalluar në pozitë luftëtarët me pasuritë dhe veten e tyre mbi mospjesëmarrësit. Zoti i ka premtuar secilit më të mirën. Por Zoti dallon luftëtarët mbi mospjesëmarrësit me shpërblim të madh,
 96. grada prej Tij dhe falje e mëshirë. Zoti është falës, mëshirëplotë.
 97. Atyre që engjëjt i vdesin si dhunues të vetvetes, u thonë: “Në ç’gjendje ishit?” Thonë: “Ishim të dobët në tokë.” Thonë: “A nuk qe e gjerë toka e Zotit e të shpërnguleshit në të?” Streha e tyre është skëterra, ç’fund i keq!
 98. Përrjashtuar të paaftët, burra, gra e fëmijë, që nuk mund të lëvizin e të gjejnë udhë.
 99. Këta, Zoti shpresohet t’i falë. Zoti është ndjesës, falës.
 100. Kush shpërngulet në Rrugën e Zotit, gjen në tokë mjaft vendstrehim e begati. Shpërblimi i atij që del nga shtëpia si i shpërngulur te Zoti dhe i Dërguari i Tij dhe e zë vdekja, bie te Zoti. Zoti është falës, mëshirëplotë.
 101. Kur marshoni në tokë, nuk është mëkat të shkurtoni të falurit nëse i frikësoheni provokacionit të mohuesve. Mohuesit janë armiq të tuaj të hapur.
 102. Kur je me ta dhe i drejton të falen, le të qëndrojnë një grup me ty e të marrë armët; pasi të keni kryer lutjet, le të tërhiqet pas jush e të vijë për t’u falur grupi tjetër, në gatishmëri dhe me armë. Do të dëshironin

mohuesit të ishit të pakujdesshëm te armët dhe mjetet tuaja e t'ju zinin në befasi. Nuk është mëkat t'i ulni armët kur keni vështirësi prej shiut ose jeni të sëmurë, por merrni masat! Zoti u ka bërë gati mohuesve një dënim poshtërues.

103. Kur të mbaroni së faluri, përmendni Zotin më këmbë, ulur e mënjandë dhe, me t'u siguruar, kryeni lutjet. Vërtet, të falurit është për besimtarët detyrim në kohë.
104. Mos u dobësoni në kërkim të armikut. Nëse vuani, edhe ata vuajnë. Ju shpresoni nga Zoti çfarë ata nuk shpresojnë. Zoti është dijeplotë, i urtë.
105. Ne të shpallëm Librin me të vërtetën, për të gjykuar mes njerëzve siç të ka treguar Zoti. Dhe mos ji ndërgjygjës për të pabesët.
106. Kërkoji falje Zotit. Zoti është falës, mëshirëplotë.
107. Mos kundërshtoj rreth atyre që tradhetojnë veten. Zoti nuk do të pabesë mëkatarë.
108. Kërkojnë të fshihen nga njerëzit, por nuk i fshihen Zotit. Ai është me ta kur sajojnë fjalë që nuk i miraton. Zoti ua rrethon veprimet.
109. Ja që kundërshtuat rreth tyre në këtë botë, por kush do t'i kundërshtojë Zotit për ta Ditën e Ringjalljes? Mos kanë dorëzanës?
110. Kush bën një të keqe ose i bën keq vetes, pastaj i kërkon falje Zotit, e gjen Zotin falës, mëshirëplotë.
111. Kush fiton mëkatin, e fitoi për vete. Zoti është dijeplotë, i urtë.
112. Kush bën gabim a mëkat dhe ia hedh një të pafajshmi, ngarkohet me shpifje e mëkat të hapur.
113. Të mos qenë mirësia e Zotit dhe mëshira e Tij, do t'ia arrinte një kastë e tyre të të gabonte, por gabojnë veten dhe nuk do të të dëmtojnë. Zoti të zbriti Librin e

- Urtësinë dhe të mësoi çfarë nuk dije. Mirësia e Zotit ndaj teje është e madhe.
114. Nuk ka ndonjë të mirë në më të shumtën e bisedave të tyre. Veç në porositin bamirësi, mirëkuptim dhe paqe mes njerëzve. Kujt vepron kështu, për kënaqësinë e Zotit, i japim shpërblim të madh.
115. Kë i kundërvihet Profetit, pasi i është sqaruar drejtimi dhe nuk ndjek rrugën e besimtarëve, e kthejmë nga është kthyer dhe ia vëmë skëterrës, ç'fund i keq!
116. Zoti nuk fal t'i bëhet shok; fal, veç kësaj, atë që do. Kush i bën Zotit shok, ka rënë në gabim të thellë.
117. Lusin në vend të Tij ca idhuj femra, lusin djallin rebel.
118. Zoti e mallkoi dhe ai tha: "Do të marr nga robtë e Tu një pjesë të caktuar,
119. t'i gaboja, mashtroj, t'i urdhëroj t'ua çajnë veshët bagëtive, t'i urdhëroj të shpërftyrojnë krijesën e Zotit." Kush merr, në vend të Zotit, djallin kujdestar, ka humbur me një humbje të dukshme.
120. U premton dhe i mban me shpresa, por djalli nuk u premton tjetër përveçse mashttrim.
121. Streha e tyre është skëterra dhe nuk gjejnë prej tij shteg.
122. Cilët besojnë e bëjnë të mira, i fusim kopshteve ku rrjedhin lumenj, të përhershëm në to, përgjithmonë. Premtim i vërtetë i Zotit. Kush flet më drejt se Zoti?
123. Jo me iluzionet tuaja dhe me iluzionet e ithtarëve të Librit. Kush bën keq, shpërblehet me të dhe nuk i gjendet, në vend të Zotit, kujdestar e ndihmëtar.
124. Ata që bëjnë të mira, meshkuj e femra, si besimtarë, hyjnë në parajsë dhe nuk u bëhet aspak e padrejtë.

125. Kush është më i mirë në fe se ai që ia dorëzon veten Zotit si mirëbërës dhe ndjek besimin monoteist të Ibrahimit? Zoti e mori Ibrahimin për mik.
126. Zotit i përkasin ç'janë në qiej e në tokë. Zoti ka rrethuar çdo gjë.
127. Të kërkojnë vendim te gratë, thuaj: "Zoti jep vendim për to atje ku ju është lexuar në libër për gratë jetime të cilave nuk u jepni të drejtën e tyre dhe doni të martoheni me to. Edhe për fëmijët pa mbështetje. Që të mbani drejtësi me jetimët. Ç'të mirë bëni, Zoti e di."
128. Kur një grua i frikësohet urrejtjes apo largimit të së shoqit, s'është mëkat të bëjnë paqe. Paqja është më e mirë, por njerëzit janë shpirtngushtë. Në bëni mirë e përmbaheni, Zoti është në dijeni se ç'bëni.
129. Nuk do të mund të mbanit drejtësi mes grave edhe po ta lakmonit. Por mos anoni plotësisht nga njëra anë e të lini dikë në pritje. Në bëni pajtim dhe përmbaheni, Zoti është falës, mëshirëplotë.
130. Po të ndahen, Zoti i mjafton secilit me bujarinë e Vet. Zoti është i paanë, i urtë.
131. Të Zotit janë ç'ka në qiej e në tokë. Atyre që u është dhënë Libri para jush, si edhe juve, ju kemi dhënë porosi t'i përmbaheni Zotit. Në mohoni, Zotit i përkasin ç'janë në qiej e në tokë. Zoti është i pasur, lavdiplotë.
132. Të Zotit janë ç'ka në qiej e në tokë. Mjafton Zoti dorëzanës.
133. Po të dojë, ju merr juve, o njerëz dhe sjell të tjerë. Zoti është për këtë i pushtetshëm.
134. Kush dëshiron shpërblimin e kësaj bote, te Zoti janë shpërblimi i kësaj bote dhe i së ardhmes. Zoti është dëgjues, largpamës.

135. Besimtarë, jini të qëndrueshëm në drejtësi, si dëshmues për Zotin, edhe kundër vetes, prindërve a të afërmve, të pasur ose të varfër; Zoti është më pranë tyre. Mos ndiqni pasionin te e drejta. Në qoftë se dredhoni e shmangeni, Zoti është në dijeni të veprave tuaja.
136. Besimtarë! Besoni Zotin, të Dërguarin e Tij, Librin që Ai ia zbriti të Dërguarit të Tij dhe Librin që Ai ka zbritur më parë. Kush mohon Zotin, engjëjt e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij dhe Ditën e Fundit, ka rënë në gabim të thellë.
137. Ata që besojnë, pastaj mohojnë, përsëri besojnë, pastaj mohojnë dhe thellohen në mohim, Zoti nuk i fal e drejton në udhë.
138. Jepu hipokritëve lajmin e një dënimi të hidhët.
139. Janë ata që bëjnë, në vend të besimtarëve, mohuesit miq. Kërkojnë me ta nder? Nderi i takon krejt Zotit.
140. Ju shpallëm në libër që, kur dëgjoni të mohohen dhe shpërfillen dëshmitë e Zotit, mos rrini me ta pa ndërruar bisedë. Do të ishit atëherë si ata. Zoti i mbledh të gjithë në skëterrë, hipokritët dhe mohuesit,
141. që rrinë në pritje: nëse Zoti ju jep fitore, thonë: “A nuk ishim bashkë me ju?” Nëse u takon pjesë mohuesve, thonë: “A nuk po ngadhënjëm mbi ju dhe ju mbrojtëm nga besimtarët?” Zoti gjykon mes jush Ditën e Ringjalljes. Zoti nuk do t’u bëjë mohuesve udhë kundër besimtarëve.
142. Hipokritët duan të mashtrojnë Zotin, por Ai i zhgënjën. Kur bëjnë të falen, ngrihen me përtesë, sa për t’u dukur para njerëzve dhe e përmendin Zotin pak.
143. Lëkunden andej-këtej. Kë humb Zoti, s’mund t’i gjesh udhë.

144. Besimtarë, mos bëni, në vend të besimtarëve, mohuesit miq. A doni t'i jepni Zotit një argument të qartë kundër jush?
145. Hipokritët janë në vatër të zjarrit dhe nuk do të gjesh për ta ndihmëtar.
146. Përveç atyre që pendohen, përmirësohen, mbahen fort te Zoti dhe që ia kushtojnë besimin e tyre Zotit. Këta janë me besimtarët. Zoti u jep besimtarëve shpërblim të madh.
147. Ç'do të bënte Zoti me dënimin tuaj në qoftë se falënderoni e besoni? Zoti është mirënjohës, dijeplotë.
148. Zoti nuk dëshiron të publikohet e keqja, vetëm nëse dikujt i shkelen të drejtat. Zoti është dëgjues, dijeplotë.
149. E shfaqni apo e fshihni një të mirë ose falni një të keqe, Zoti është falës, pushtetplotë.
150. Ata që mohojnë Zotin dhe të dërguarit e Tij dhe duan të bëjnë ndarje mes Zotit dhe të dërguarve të Tij duke thënë: "Besojmë disa e mohojmë disa", - për të gjetur shteg ndërmjet,
151. janë me të vërtetë mohues. U përgatitëm mohuesve dënim poshtërues.
152. Cilët besojnë Zotin dhe të dërguarit e Tij dhe nuk ndajnë asnjërin nga ata, Ai ua jep shpërblimet. Zoti është falës, mëshirëplotë.
153. Ithtarët e Librit kërkojnë t'u zbresësh një libër nga qielli. I kërkuan Musait diçka më të rëndë dhe thanë: "Na e trego Zotin haptas!" I zuri rrufeja me dhunimin e tyre. Pastaj, kur u erdhën provat e qarta, morën vëllim. Ne i falëm dhe i dhamë Musait autoritet të qartë.
154. Lartësuam mbi ta Malin, me besën e tyre dhe u thamë: "Hyni në portë me përulje!" U thamë: "Mos

- dhunoni të Shtunën!” Dhe morëm prej tyre zotim të fortë.
155. Me thyerjen e besës, mohimin e dëshmimeve të Zotit, vrasjen pa të drejtë të profetëve, me fjalën e tyre: “Zemrat tona janë të mbyllta”; - jo, ua vulosi Zoti me mohimin e tyre dhe pak besojnë; -
156. me mohimin dhe fjalën e tyre për Merjemin si një shpifje e madhe,
157. me fjalën e tyre: “Ne e vramë Mesihun”, Isanë, birin e Merjemit, të Dërguarin e Zotit; - nuk e vranë dhe kryqëzuan, porse u përngjau; cilët nuk pajtohen rreth tij, janë në dyshim, s’kanë dijeni dhe shkojnë me hamendje; sigurisht nuk e vranë,
158. por Zoti e ngriti pranë Tij; Zoti është i plotfuqishëm, i urtë;
159. nga ithtarët e Librit ai duhej të besohej para vdekjes dhe Ditën e Ringjalljes është për ta dëshmuar; -
160. për tiraninë e judenjve, ua ndalua të mira që u ishin lejuar dhe, me pengesat e shumta në Rugën e Zotit,
161. me marrjen e kamatës, të ndaluar prej saj, me përvetësimin pa të drejtë të pasurive të njerëzve, u përgatitëm mohuesve ndër ta dënim të hidhët.
162. Përkundrazi, atyre me dije të thella ndër ta, besimtarëve që besojnë shpalljen tek ty dhe shpalljen para teje, që kryejnë të falurit dhe japin detyrimin, që besojnë te Zoti dhe Dita e Fundit, do t’u japim shpërblim të madh.
163. Ne të kumtuam ty sikurse u kumtuam Nuhit dhe profetëve pas tij, u kumtuam Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, Jakubit dhe breznive, Isait, Ejubit, Junusit, Harunit e Sulejmanit, ndërsa Davudit i dhamë Zeburin;

164. të dërguar që t'i përmendëm më parë dhe të dërguar që nuk t'i kemi përmendur; Zoti i foli Musait me fjalë;
165. të dërguar, përgëzues e paralajmërues, që njerëzit të mos kenë pas të dërguarve argument kundër Zotit. Zoti është i plotfuqishëm, i urtë.
166. Zoti dëshmon se ç'të zbriti ty, e zbriti me Dijen e Vet. Edhe engjëjt dëshmojnë. Mjafton Zoti dëshmues.
167. Ata që mohojnë dhe pengojnë nga Rruga e Zotit janë në gabim të thellë.
168. Cilët mohojnë dhe ushtrojnë dhunë, Zoti nuk i fal e drejton në udhë.
169. Por në udhën e skëterrës ku janë të përhershëm, përgjithmonë. Për Zotin, kjo është e lehtë.
170. Njerëz, ju erdhi i Dërguari me të vërtetën nga Zoti juaj; të besoni është më mirë për ju. Në mohoni, të Zotit janë gjithçka në qiej e në tokë. Zoti është dijeplotë, i urtë.
171. Ithtarë të Librit, mos e kaloni masën në fenë tuaj dhe mos thoni për Zotin tjetër veç së vërtetës. Mesihu – Isai, biri i Merjemit, ishte i Dërguari i Zotit, fjala e Tij drejtuar Merjemit dhe frymë prej Tij. Besoni Zotin dhe të dërguarit e Tij dhe mos thoni: “Trini!” Hiqni dorë në të mirën tuaj. Zoti është një Zot, shumë i madhëruar për t'iu bërë bir. Atij i takojnë ç'janë në qiej e në tokë. Mjafton Zoti dorëzanës.
172. Mesihu nuk e mohon të qenët rob i Zotit, as edhe engjëjt pranë. Kush mohon adhurimin e Tij dhe mburret? Ai do t'i tubojë të gjithë në Praninë e Tij.
173. Atyre që besojnë e bëjnë të mira ua përmbush shpërblimet dhe do t'u japë më shumë me Mirësinë e Vet. Cilët mohojnë e mburren, i dënon me dënim të

- hidhët dhe nuk do të gjejnë, në vend të Zotit, kujdestar e ndihmëtar.
174. Njerëz, ju erdhi provë nga Zoti juaj dhe zbritëm tek ju një dritë të qartë.
 175. Cilët besojnë Zotin dhe i mbështeten Atij, i fut në Mëshirën dhe Mirësinë e Vet dhe i udhëheq drejt Tij në udhë të drejtë.
 176. Kërkojnë prej teje vendim (fetva), thuaj: “Zoti jep vendim në trashëgiminë jo të drejtpërdrejtë. Kur një person vdes e nuk ka fëmijë, por një motër, asaj i takon gjysma nga ç'ka lënë ai. Dhe ai e trashëgon atë në qoftë se ajo s'ka fëmijë. Po të jenë ato dy, u takon dy të tretat e asaj që ai ka lënë. Po të jenë vëllezër e motra, mashkullit i takon pjesa e dy femrave.” Zoti ju sqaron që të mos gaboni. Zoti është për gjithçka dijeplotë.

5. TRYEZA (EL MAIDE)

Periudha e Medines, 120 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Besimtarë, përmbushni marrëveshjet! Ju lejohet mishi i bagëtive përveç atyre që do të përmenden. Nuk lejohet gjahu kur jeni me ihram. Zoti vendos me Vullnetin e Tij.
2. Besimtarë, mos dhunoni simbolet e Zotit, muajin e shenjtë, kurbanet, gjerdanët dhe vizitorët e Shtëpisë së Shenjtë në kërkim të mirësisë dhe kënaqësisë së Zotit. Kur të liroheni, gjuani. Të mos ju shtyjë urrejtja e një populli që ju pengoi nga Faltorja e Shenjtë t'i kaloni kufijtë. Bashkëpunoni në besimtari e

devotshmëri dhe mos bashkëpunoni në mëkat e armiqësi. Ndëshkimi i Zotit është i rreptë.

3. Ndalohen ngordhësira, gjaku, mishi i derrit, çfarë i kushtohet jo Zotit, ç'është mbytur, goditur, rrëzuar, shqyer me brirë, që e ka ngrënë egërsira, vetëm nëse e keni therur, ç'është therur mbi altar si dhe hedhja e shigjetave të fatit; kjo është për ju herezi. Sot mohuesit janë të pashpresë nga feja juaj, por mos iu frikësoni atyre, frikësomuni Mua! Sot jua përsosa fenë, plotësova Mirësinë Time ndaj jush, pëlqeva për ju Islamin fe. Kur dikush shtrëngohet nga uria, pa rënë në mëkat, Zoti është për të falës, mëshirëplotë.
4. Të pyesin ç'u lejohet, thuaj: "Ju lejohen ushqimet e mira. Hani çfarë zënë kafshët e gjahut që i stërvitni siç ju ka mësuar Zoti dhe përmendni në të Emrin e Zotit. Përmabajuni Zotit! Zoti ka llogari të shpejtë.
5. Sot, lejohen për ju ushqimet e mira; ushqimi i ithtarëve të Librit është i lejueshëm për ju dhe ushqimi juaj, i lejueshëm për ta; gratë e ndershme besimtare dhe gratë e ndershme prej atyre që u është dhënë më parë Libri, që t'u jepni dhuratën e kurorës si të ndershëm dhe jo të pandershëm e dashnorë. Kujt mohon besimin, i kanë dështuar veprat dhe, në të ardhmen, është ndër të humburit.
6. Besimtarë, kur ngriheni për t'u falur, lani fytyrën e duart deri në bërryla dhe pastroni kryet e këmbët deri në nyja. Po të jeni të ndotur, pastrohuni. Kur jeni të sëmurë, në udhëtim, pas kryerjes së nevojave të jashtëqitjes ose marrëdhënieve me gratë e nuk gjeni ujë, kthejuni truallit të pastër dhe fërkoni me të fytyrën e duart. Zoti nuk dëshiron t'ju sjellë vështirësi, porse

- dëshiron t'ju pastrojë dhe ta plotësojë të mirën e Tij ndaj jush që të mund të falënderoni.
7. Kujtoni të mirën e Zotit dhe besën e dhënë kur thatë: "Dëgjuam e u bindëm." Përmbajuni Zotit! Zoti është dijeplotë për vetë kraharorët.
 8. Besimtarë, jini të vendosur për Zotin, si dëshmues me drejtësi dhe të mos ju shtyjë urrejtja ndaj një populli e të jeni të padrejtë. Drejtësia është më afër devotshmërisë. Përmbajuni Zotit! Zoti është në dijeni të veprave tuaja.
 9. Zoti u ka premtuar atyre që besojnë e bëjnë të mira falje dhe shpërblim të madh.
 10. Cilët mohojnë dhe përgënjeshtrojnë dëshmitë Tona, janë banorët e skëterrës.
 11. Besimtarë, kujtoni të mirën e Zotit kur një popull zgjati duart drejt jush dhe Ai ia ndali duart. Përmbajuni Zotit! Zotit t'i mbështeten besimtarët!
 12. Zoti u mori besë bijve të Izraelit dhe përfaqësuam ndër ta dymbëdhjetë prijës. Zoti tha: "Unë jam me ju. Po të kryeni të falurit, të jepni detyrimin (zekatin), t'u besoni të dërguarve të Mi, t'i ndihmoni ata dhe t'i huazoni Zotit një hua të mirë, jua shlyej të këqijat dhe ju pranoj kopshteve ku rrjedhin lumenj. Kush mohon më pas është larguar nga Rruga e Drejtë."
 13. Me thyerjen e besës, i mallkuam dhe ua ashpërsuam zemrat. E shtrembërojnë fjalën në kuptimin e saj dhe harrojnë ç'u është përmendur. Përveç një pakice, vazhdimisht do të zbulosh prej tyre tradhti. Por, fali e mos vë re. Zoti i do mirëbërësit.
 14. Morëm edhe besën e atyre që thonë se "jemi të krishterë", por që harrojnë ç'u është përmendur.

- Mbollëm mes tyre armiqësi e urrejtje deri Ditën e Ringjalljes. Zoti do t'i njoftojë se çfarë sajonin.
15. Ithtarë të Librit! Ju erdhi i Dërguari Ynë dhe sqaron shumë nga ç'fshihnit prej Librit e fal shumë. Ju erdhi dritë nga Zoti dhe një libër i qartë.
 16. Zoti drejton me të udhëve të shpëtimit ata që ndjekin kënaqësinë e Tij, i nxjerr, me lejen e Vet, nga errësirat në dritë dhe i udhëheq në udhë të drejtë.
 17. Mohuan ata që thanë: “Zot është Mesihu, biri i Merjemit.” Thuaj: “Kush ka fuqi ndaj Zotit nëse Ai dëshiron të zhdukë Mesihun, birin e Merjemit, nënën e tij dhe krejt ç’janë në tokë?” Zotit i takon sundimi i qiejve dhe i tokës e ç’janë mes tyre. Krijon me Vullnetin e Tij. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.
 18. Judenjtë e të krishterët thonë: “Ne jemi bijtë e Zotit dhe të dashurit e Tij.” Thuaj: “Përse ju dënon për mëkatet tuaja? Jo, ju jeni ndër njerëzit që Ai ka krijuar. Fal e dënon me dashjen e Tij. Zotit i takon sundimi i qiejve dhe i tokës e ç’janë mes tyre. Fundi është tek Ai.”
 19. Ithtarë të Librit, ju erdhi i Dërguari Ynë dhe ju sqaron në vazhden e të dërguarve, të mos thoni: “S’na erdhi përgëzues e paralajmërues.” Ju erdhi një përgëzues e paralajmërues. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.
 20. Kur Musai i tha kombit të tij: “Kombi im, kujtoni të mirën e Zotit tek bëri ndër ju profetë, ju bëri sundues dhe ju dha ç’nuk i ka dhënë kujt në botë;
 21. kombi im, hyni në tokën e shenjtë që ju caktoi Zoti (urdhëroi pas eksodit nga Egjipti), mos u tërhiqni e të ktheheni të humbur”, -

22. ata thanë: “O Musa, aty është një komb i fuqishëm dhe ne nuk do të hyjmë pa dalë ata. Po të dalin ata, hyjmë ne.”
23. Dy burra të devotshëm që Zoti i kishte bekuar, thanë: “Hyni përballë tyre nga porta. Me t’u hyrë, jeni ngadhënjimtarë. Mbështetjuni Zotit në jeni besimtarë!”
24. Thanë: “O Musa, ne s’do të hyjmë atje përderisa janë ata. Shkoni ti e yt Zot dhe luftoni. Ne po presim këtu.”
25. Tha: “Im Zot, unë s’kam gjë në dorë veç vetes sime e tim vëllai. Bëj ndarje mes nesh dhe kombit të pabindur.”
26. Tha: “Të mohuar dyzetë vjet, do të enden në tokë, pra, mos u brengos për njerëzit e pabindur!”
27. Recitoju me të vërtetën rrëfenjën e dy bijve të Ademit kur bënë kurban dhe iu pranua njërit e s’iu pranua tjetrit. Ky i tha: “Unë po të vras.” Tha: “Zoti ua pranon vetëm të devotshmëve.
28. Në zgjat dorën të më vrasësh, unë nuk zgjas dorën të të vras sepse i frikësohem Allahut, Zotit të botëve.
29. Le të bartësh mëkatin tim e mëkatin tënd dhe të jesh ndër banorët e zjarrit! Ky është shpërblimi i dhunuesve.”
30. E mposhti uni për të vrarë të vëllanë dhe e vrau. Dhe mbeti i humbur.
31. Zoti dërgoi një korb që rrëmihte në tokë e t’i tregonte atij se si ta mbulonte kufomën e të vëllait. Tha: “I mjeri unë! Kaq i paafte sa të mos jem si ky korb dhe ta mbuloj trupin e tim vëllai?” Dhe mbeti i penduar.
32. Prandaj ua parashkruam bijve të Izraelit që, kush vret një frymë jo për frymë a krime në tokë, është si të ketë vrarë njerëzit mbarë; kush shpëton, si të ketë shpëtuar njerëzit mbarë. U erdhën të dërguarit Tanë

me prova të qarta, por shumë prej tyre, edhe pas kësaj, shpërdorjnë në tokë.

33. Ndëshkimi i atyre që luftojnë Zotin dhe të Dërguarin e Tij dhe bëjnë të këqia në tokë është të vriten, të kryqëzohen, t'u priten duart e këmbët në anë të ndryshme ose të dëbohen nga vendi. Ky është, për ta, poshtërim në këtë botë dhe, në të ardhmen, kanë dënim të madh.
34. Përrjashtuar atyre që pendohen para se të ushtroni pushtetin mbi ta. Dhe dijeni: Zoti është falës, mëshirëplotë.
35. Besimtarë, përmbajuni Zotit dhe kërkoni mjet afrimi tek Ai, përpikuni në Rrugën e Tij që të mund të keni sukses.
36. Vërtet, sikur mohuesit të kishin krejt ç'ka në tokë, edhe po aq, për të paguar dënimin e Ditës së Ringjalljes, nuk u pranohet. Dhe kanë dënim të hidhët.
37. Duan të dalin prej zjarrit, por nuk mund të dalin. Dhe kanë dënim të pafund.
38. Vjedhësit dhe vjedhëses prejuani duart si ndëshkim i merituar. Masë shembullore nga Zoti. Zoti është i plotfuqishëm, i urtë. (Sipas traditës profetike dhe juristëve islamë, ky vendim zbatohet kur dikush vjedh pronën e tjetrit në një vlerë të caktuar, jo sende për t'u ushqyer dhe jo në pronë të përbashkët, vakëf. Në këto raste merren masa të tjera.)
39. Kush pendohet, pasi dhunoi dhe përmirësohet, atij Zoti ia pranon pendimin. Zoti është falës, mëshirëplotë.
40. A nuk e di që Zotit i takon sundimi i qiejve dhe i tokës? Dënon e fal me dashjen e Tij. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.

41. O i dërguar, mos të të dëshpërojnë ata që konkurrojnë në mohim, që thonë me gojë: “Besuam” – e nuk besojnë me zemër, që janë judenj e bëjnë të dëgjohet gënjeshtria, të dëgjoen njerëz që nuk kanë ardhur tek ty. I ndryshojnë fjalët në kuptimin e tyre dhe thonë: “Në ju jepet kjo, merreni; në mos ju jepet, kujdes!” Kë Zoti vë në provë, ti nuk zotëron gjë për të ndaj Zotit. Janë ata që Zoti nuk dëshiron t’ua pastrojë zemrat. Për ta ka poshtërim në këtë botë dhe një dënim të madh në të ardhmen.
42. Bëjnë të dëgjohet gënjeshtria dhe të përdoret e paligjshmja. Po të të vijnë, gjyko mes tyre ose shmangu. Në u shmangesh, nuk mund të të dëmtojnë. Po të gjykosh, gjyko mes tyre me drejtësi. Zoti i do ata që janë të drejtë.
43. Si të bëjnë të gjykosh kur kanë Teuratin ku është gjykimi i Zotit dhe që përsëri largohen? Ata nuk janë besimtarë.
44. Ne e zbritëm Teuratin me drejtim e dritë. Gjykuan me të për judenjtë profetët që iu dorëzuan Zotit, mësimdhënësit dhe juristët, ruajtës të Librit të Zotit dhe dëshmues të tij. Pra, mos iu frikësoni njerëzve, frikësomuni Mua! Mos blini me dëshmitë e Mia një çmim të ulët. Cilët nuk gjykojnë me shpalljen e Zotit, ata janë mohuesit.
45. Ua parashkruam në të frymën për frymë, syrin për sy, hundën për hundë, veshin për vesh, dhëmbin për dhëmb, edhe te plagët, dëmshpërblim. Kush fal, është i falur. Cilët nuk gjykojnë me shpalljen e Zotit, ata janë dhunuesit.
46. Pasuam në gjurmët e tyre Isanë, birin e Merjemit, që vërteton Teuratin para tij dhe i dhamë Ungjillin me

drejtim e dritë, që vërteton Teuratin para tij, drejtim e këshillë për të devotshmit.

47. Le të gjykojnë ithtarët e Ungjillit me çfarë Zoti ka shpallur në të. Cilët nuk gjykojnë me shpalljen e Zotit, ata janë të pabindurit.
48. Ty të zbritëm Librin me të vërtetën, që vërteton librin para tij dhe garanci për të. Gjyko mes tyre me çfarë Zoti ka zbritur dhe mos ndiq pasionet e tyre rreth së vërtetës që të erdhi. Secilit i bëme ligj e udhë. Po të deshte Zoti, ju kishte bërë një bashkësi, mirëpo ju provon me ç'ju ka dhënë. Pra, konkurroni në vepra të mira! Te Zoti është kthimi juaj, të gjithëve dhe ju njofton se ku ishit në kundërshti.
49. Të gjykosësh ndër ta me shpalljen e Zotit dhe mos ndiq pasionet e tyre, por ruaju mos të tundojnë rreth një pjese të asaj që Zoti të ka zbritur. Në largohen, dije se Zoti dëshiron t'i zërë me gabimet e tyre. Shumë njerëz janë të pabindur.
50. Mos kërkojnë gjykimin e kohës së padijes? Kush gjykon më mirë se Zoti për njerëzit që binden?
51. Besimtarë! Mos merrni judenjtë e të krishterët për aleatë. Ata janë aleatë të njëri-tjetrit. Kush bën aleatë ndër ta është prej tyresh. Zoti nuk i drejton njerëzit dhunues.
52. I sheh zemërsëmurët të nxitojnë tek ata duke thënë: "Kemi frikë mos na bie ndonjë e keqe!" Ndoshta Zoti sjell fitore ose urdhër prej Tij dhe ata mbesin të penduar me të fshehtat e tyre?
53. Besimtarët i thonë njëri-tjetrit: "Këta u betuan me be të fortë te Zoti se qenkan me ju?" Dështuan veprat e tyre dhe u kthyen të humbur.

54. Besimtarë! Në prapësoheni nga feja juaj, Zoti sjell njerëz që i do dhe e duan, të thjeshtë me besimtarët dhe krenarë me mohuesit, që luftojnë në Rrugën e Zotit dhe nuk i tremben akuzës së akuzuesit. Kjo është mirësia e Zotit; ia jep atij që do. Zoti është i paanë, dijeplotë.
55. Zoti është aleati juaj, edhe i Dërguari i Tij dhe besimtarët, ata që kryejnë të falurit, japin detyrimin dhe përgjigjen me adhurim.
56. Në bëni aleatë Zotin, të Dërguarin e Tij dhe besimtarët, Partia e Zotit është fitimtarja.
57. Besimtarë! Mos bëni aleatë ithtarët e Librit dhe mohuesit që e marrin fenë tuaj me mospërfillje e lojë. Përmbajuni Zotit në jeni besimtarë.
58. Edhe kur thirrni për t'u falur, tallen e zbavitën me të. Sepse janë njerëz që nuk kuptojnë.
59. Thuaj: "Ithtarë të Librit, hakmerreni pse besojmë Zotin, ç'është zbritur tek ne dhe ç'u zbrit më parë? Të shumtët tuaj janë të pabindur."
60. Thuaj: "T'jua bëj të ditur më të keqen nga kjo, si shpërblim të Zotit? Ata që mallkoi Zoti dhe u zemërua me ta, që bëri prej tyre majmunë e derra dhe adhurojnë djajtë janë në vendin më të keq dhe më larg udhës së drejtë."
61. Kur vijnë te ju, thonë: "Besojmë", - por hyjnë e dalin me mohim. Zoti e di mirë çfarë fshehin.
62. I sheh shumë prej tyre të konkurrojnë në mëkat e armiqësi dhe të përvetësojnë të paligjshmen. Sa keq veprojnë!
63. Sikur mësimdhënësit dhe dijetarët të mos i kenë ndaluar nga fjalët e këqia dhe përvetësimi i së paligjshmes! Ç'të keqe bëjnë!

64. Judenjtë thonë: “Dora e Zotit është nën pranga. Nën pranga janë duart e tyre. U mallkuan me ç’thonë. Jo, duart e Tij janë të lira; shpenzon si të dojë. Shpallja tek ty nga yt Zot ua shton tiraninë dhe mohimin. Hodhëm mes tyre armiqësi e urrejtje deri Ditën e Ringjalljes. Sa herë ndezën zjarrin e luftës, Zoti ua shuajti. Nxitojnë për mosmarrëveshje në tokë. Zoti nuk i do ngatërrestarët.
65. Sikur ithtarët e Librit të besonin e të përmbaheshin, ua shlyenim të këqiat dhe i pranonim kopshteve të begata.
66. Po të zbatonin Teuratin, Ungjillin dhe ç’u është shpallur prej Zotit të tyre, do të ushqeheshin nga lart e poshtë. Ndër ta ka njerëz të matur, por, të shumtët, sa keq veprojnë!
67. O i Dërguar! Komunikojë shpalljen nga yt Zot! Po të mos e bësh, nuk e ke komunikuar mesazhin e Tij. Zoti të mbron nga njerëzit. Zoti nuk e drejton popullin mohues.
68. Thuaj: “Ithtarë të Librit, ju nuk keni bazë pa zbatuar Teuratin, Ungjillin dhe ç’ju është shpallur nga Zoti juaj.” Porse, shpallja nga yt Zot, ua shton shumicës së tyre tiraninë dhe mohimin. Pra, mos u brengos për njerëzit mohues.
69. Besimtarët, judenjtë, sabinët, të krishterët, cilët besojnë Zotin dhe Ditën e Fundit e bëjnë mirë, nuk frikësohen e dëshpërohen.
70. Morëm besën e bijve të Izraelit dhe dërguam te ata profetë. Sa herë u erdhi i dërguar me ç’nuk u pëlqente, dikë e përgënjeshtroan, dikë e vranë.

71. Pandehën të mos jetë provë dhe u verbuan e u shurdhuan. Pastaj Zoti i fali. Përsëri, shumë prej tyre u verbuan dhe u shurdhuan. Zoti i sheh se ç'bëjnë.
72. Mohuan ata që thanë: "Zot është Mesihu, biri i Merjemit." Ndërsa Mesihu tha: "Bijtë e Izraelit! Adhuroni Zotin, tim Zot e Zotin tuaj." Kujt i bën Zotit shok, Zoti ia ka ndaluar parajsën dhe streha e tij është zjarri. Dhunuesit nuk kanë ndihmëtarë.
73. Mohuan ata që thanë: "Zot është trinia." Nuk ka zot veç një Zoti. Po të mos tërhiqen nga këto fjalë, mohuesit ndër ta do t'i zërë dënim i hidhët.
74. Nuk pendohen te Zoti e t'i kërkojnë falje? Zoti është falës, mëshirëplotë.
75. Mesihu, biri i Merjemit, qe vetëm i dërguar. Kaluan para tij të dërguar. Nëna e tij ishte e drejtë. Që të dy hanin ushqim. Shih si ua sqarojmë dëshmitë, shih pastaj si ikin!
76. Thuaj: "Adhuroni në vend të Zotit ç'nuk ju zotëron dëm e dobi?" Zoti, Ai është Dëgjuesi, Dijeploti.
77. Thuaj: "Ithtarë të Librit, mos e kapërceni të vërtetën në fenë tuaj dhe mos ndiqni pasionet e njerëzve që gabuan më parë, gabuan shumë të tjerë dhe devijuan nga Rrugja e Drejtë.
78. U mallkuan mohuesit ndër bijtë e Izraelit në gjuhën e Davudit dhe të Isait, birit të Merjemit. Sepse kundërshtuan dhe e tejkaluan.
79. Nuk ndalojnë njëri-tjetrin nga të këqiat. Ç'të keqe bëjnë!
80. I sheh shumë prej tyre t'i bëjnë mohuesit aleatë. Ç'të keqe i përgatitën vetes, aq sa Zoti u zemërua me ta dhe janë në dënim të përhershëm.

81. Po të besonin Zotin, Profetin dhe shpalljen tek ai, nuk do t'i bënin aleatë, mirëpo shumë prej tyre janë të pabindur.
82. Do t'i gjesh judenjtë dhe idhujtarët njerëzit më të rreptë në armiqësi me besimtarët. Do t'i gjesh më të afërt në dashuri me besimtarët ata që thonë: "Ne jemi të krishterë." Sepse ndër ta ka priftërinj e murgj që nuk krenohen.
83. Kur dëgjojnë çfarë iu zbrit të Dërguarit, i sheh sytë e tyre të përlohen me njohjen e së vërtetës. Dhe thonë: "Zoti ynë, besuam, pra, na shkruaj me dëshmuesit!
84. Përse të mos besojmë Zotin dhe të vërtetën që na erdhi e të lakmojmë të na pranojë Zoti ynë me të mirët?"
85. Zoti ua shpërbleu fjalët me kopshte ku rrjedhin lumenj, të përhershëm në to. Ky është shpërblimi i mirëbërësve.
86. Cilët mohuan dhe përgënjeshtruan dëshmitë Tona, janë banorët e zjarrit.
87. Besimtarë, mos i bëni të ndaluara të mirat që lejoi Zoti dhe mos e kaloni masën. Zoti nuk i do ata që e tejkalojnë.
88. Ushqehuni me ç'ju ka dhënë Zoti, të lejuara, të mira dhe përmbajuni Zotit të Cilit i besoni.
89. Zoti nuk ju fajëson për betimet padashur, porse ju fajëson për betimet me qëllim. Si shlyerje është ushqimi i dhjetë të varfërve me ushqimin mesatar të familjes suaj ose veshmbathja e tyre ose lirimi i një robi. Kush nuk gjen, të agjërojë tri ditë. Kjo është shlyerja e betimeve tuaja kur bëni be. Mbani betimet! Kështu jua sqaron Zoti dëshmitë e Tij që të mund të falënderoni.

90. Besimtarë! Vera, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fatit janë njollë e punës së djallit. Shmangiuni atij që të mund të shpëtoni.
91. Me verën e bixhוזin, djalli dëshiron të hedhë armiqësi e urrejtje mes jush dhe t'ju pengojë në përmendjen e Zotit dhe kryerjen e të falurit. A po ndaloni?
92. Bindjuni Zotit, bindjuni të Dërguarit dhe kini kujdes! Në ktheni krahët, dijeni se për të Dërguarin Tonë është komunikimi i qartë.
93. Nuk bie mëkat te ata që besojnë e bëjnë të mira për ushqimin që përdorën më parë, ndërsa përmbahen dhe besojnë e bëjnë të mira, pastaj përmbahen e besojnë, pastaj përmbahen e bëjnë mirë. Zoti i do mirëbërësit.
94. Besimtarë! Zoti ju provon me gjahun që arrijnë duart dhe shigjetat tuaja. Ta dijë Zoti se kush i frikësohet Atij në të padukshmen. Cili e tejkalon më pas, ka dënim të hidhët.
95. Besimtarë, mos vrisni gjah kur jeni në pelegrinazh. Kush vret me dashje, si shpërblim që e gjykojnë dy vetë të drejtë mes jush, bën kurban pranë Qabes një bagëti si ajo që vrau. Ose, si shlyerje faji, me ushqimin e të varfërve ose duke zëvendësuar me agjërim. Që ai ta provojë pasojën e vet. Zoti fal të shkuarën, por, kush e përsërit, Zoti hakmerret prej tij. Zoti është i plotfuqishëm, i zoti i hakmarrjes.
96. Lejohet gjuetia e detit dhe ushqimi i tij, furnizim për ju dhe për udhëtarët. Ndalohet gjuetia e tokës gjatë rriteve të haxhit. Përmbajuni Zotit tek i Cili do të mbledheni.
97. Zoti e bëri Qaben, Shtëpinë e Shenjtë, simbol për njerëzit, edhe muajin e shenjtë, kurbanin e gjerdanët.

- Kjo, që ta dini se Zoti di ç'ka në qiej e në tokë. Zoti është për gjithçka dijeplotë.
98. Dijeni se Zoti ka ndëshkim të rreptë dhe se Zoti është falës, mëshirëplotë.
99. Detyrë për të Dërguarin është të komunikuarit ndërsa Zoti e di çfarë shfaqni e fshihni.
100. Thuaj: "Nuk barazohen e keqja dhe e mira edhe sikur të të mahnisë shtimi i së keqes." Përmbajuni Zotit, ju, o të mençur, që të mund të keni sukses.
101. Besimtarë, mos pyesni për gjëra që, po t'ju zbulohen, ju shqetësojnë. Por, nëse pyesni rreth tyre kur shpallet Kurani, ju sqarohen. Zoti e fal këtë. Zoti është falës, i butë.
102. Pyetën njerëz para jush, pastaj u bënë mohues.
103. Zoti nuk ka bërë Behire, Saibe, Vesile dhe Ham (deve e bagëti të shenjtë), porse mohuesit sajojnë gënjeshtër ndaj Zotit. Të shumtët e tyre nuk kuptojnë.
104. Kur u thuhet: "Ejani te ajo që Zoti ka zbritur dhe te i Dërguari!" - thonë: "Na mjafton tradita e të parëve tanë" - edhe pse të parët e tyre nuk dinin gjë, as qenë të udhëhequr drejt.
105. Besimtarë, kini kujdes! Nuk do t'ju dëmtojë një i gabuar në qoftë se udhëhiqeni drejt. Kthimi i ju të gjithëve është te Zoti. Dhe do t'ju njoftojë për veprat.
106. Besimtarë! Kur dikujt nga ju i vjen vdekja dhe lë porosi, të dëshmojnë dy të drejtë mes jush ose të tjerë, nëse ju bie vdekja në udhëtim e sipër. Po të dyshoni, mbajini pas faljes dhe le të betohen për Zotin se: "Nuk blejmë me të ndonjë çmim edhe sikur të jetë i afërm dhe nuk fshehim dëshminë e Zotit sepse do të ishim mëkatarë."

107. Po të dalë se kanë bërë mëkat, le të dalin në vend të tyre dy të tjerë të afërm dhe të betohen në Zotin se: "Dëshmia jonë është më e vërtetë nga dëshmia e tyre dhe ne nuk po veprojmë me të padrejtë sepse do të ishim dhunues."
108. Kështu është më e përshtatshme që të dëshmojnë siç duhet ose të kenë frikë se mos përsëriten betime pas betimeve të tyre. Përmbajuni Zotit dhe dëgjoni. Zoti nuk i drejton njerëzit e pabindur.
109. Ditën që Zoti mbledh të dërguarit dhe u thotë: "Ç'përgjigje morët?" - do të thonë: "Ne nuk kemi dije. Ti je Njohësi i të fshehtave."
110. Kur Zoti tha: "O Isa, biri i Merjemit, kujto të mirën Time ndaj teje dhe nënës tënde kur të mbështeta me Shpirtin e Shenjtë, t'u flasësh njerëzve në djep e në moshë të rritur, kur të mësova Librin e Urtësinë, Teuratin e Ungjillin, kur krijove, me lejen Time, një model shpendi nga balta, i fryve dhe, me lejen Time, u bë shpend; shërove, me lejen Time, të verbrin e lebrosin; ngjalle, me lejen Time, të vdekurin dhe kur i mbajta prej teje bijtë e Izraelit tek u erdhe me prova ndërsa mohuesit ndër ta thanë: "Kjo është magji e qartë!"
111. Kur u kumtova apostujve që: "Besomëni Mua dhe të Dërguarin Tim", - thanë: "Besojmë dhe dëshmojmë se jemi muslimanë."
112. Kur apostujt thanë: "O Isa, biri i Merjemit! A ka mundësi yt Zot të na zbresë nga qielli një tryezë?" - tha: "Kini frikë Zotin në jeni besimtarë!"
113. Thanë: "Duam të ushqehemi prej saj e të qetësohen zemrat tona, ta dimë se na the të vërtetën e të jemi për të dëshmuar."

114. Isai, biri i Merjemit, tha: “Im Zot, Zoti ynë! Na zbrit nga qielli një tryezë, të jetë gosti për të parin e të fundin tonë dhe një dëshmi prej Teje. Ushqena! Ti je Ushqyesi Më i Mirë!”
115. Zoti tha: “Vërtet, Unë po e zbres, por, kë mohon më pas, e dënoj me një dënim që s’kam dënuar dikë në botë.”
116. Kur Zoti tha: “O Isa, biri i Merjemit, ti u ke thënë njerëzve: “Na merrni mua e nënën time për zota në vend të Zotit?””- ai tha: “Madhëruar qofsh! Nuk më takon të them diçka që s’kam të drejtë. Po ta kisha thënë, Ti e dije. Ti di ç’është në veten time ndërsa unë nuk di ç’është në Vetën Tënde. Ti je Njohësi i të fshehtave.
117. U kam thënë atyre vetëm çfarë më ke urdhëruar: “Adhuroni Zotin, tim Zot e Zotin tuaj”- dhe isha ndaj tyre dëshmues për sa qesh te ata. Kur më vdiqe, Ti ishe ndaj tyre vëzhgues. Ti je mbi gjithçka dëshmues.
118. Në i dënon, janë robtë e Tu; në i fal, Ti je i Plotfuqishmi, i Urti.”
119. Zoti tha: “Kjo është dita kur besnikëve u vlerësohet besnikëria e tyre. Ata kanë kopshte ku rrjedhin lumenj, të përherëshëm në to, përgjithmonë. Zoti është i kënaqur prej tyre dhe ata janë të kënaqur prej Tij. Ky është suksemi i madh.
120. Zotit i takon sundimi i qiejve dhe i tokës e ç’janë në to. Ai është mbi gjithçka pushtetplotë.

6. BAGËTITË (EL EN'AM)

Periudha e Mekës, 165 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Lavdi Zotit që krijoi qiejt e tokën dhe bëri errësitat e dritën! Ndërsa mohuesit i bëjnë të barabartë Zotit të tyre.
2. Është Ai që ju krijoi nga balta, pastaj vuri afat dhe një afat i caktuar është pranë Tij. Pastaj, ju dyshoni.
3. Ai është Zoti në qiej e në tokë. Di të fshehtën e të haptën tuaj, di edhe çfarë fitoni.
4. Nuk u erdhi dëshmi, ndër dëshmitë e Zotit që të mos i shmangeshin.
5. Përgënjeshtroan të vërtetën kur u erdhi. Por do t'u vijjnë lajmet që shpërfillën.
6. Nuk shohin sa e sa brezni zhdukëm para tyre? I fuqizua në tokë siç nuk ju fuqizua juve, u dërgua qiellin me rreshje dhe bëmë lumenjtë të rrjedhin ndër ta, pastaj i asgjësua për mëkatet e tyre dhe ngritëm më pas gjenerata të tjera.
7. Edhe sikur të të zbrisnim një libër në fletë e ta preknin me duart e tyre, mohuesit do të thonin: “Kjo është magji e hapur.”
8. Dhe thonë: “Përse nuk i zbriti një engjëll?” Po të zbritnim engjëll, do të vendosej çështja e nuk u jepej kohë.
9. Edhe sikur ta bënim atë engjëll, do ta krijonim si njeri dhe t'i hutonim më keq.
10. U shpërfillën të dërguar para teje, por i zuri shpërfillësit shpërfillja e tyre.
11. Thuaj: “Udhëtoni në tokë të shihni si qe fundi i përgënjeshtresve.”

12. Thuaj: "Kujt i takojnë ç'janë në qiej e në tokë?" Thuaj: "Zotit." Ai ia caktoi Vetes mëshirën. Do t'ju mbledhë patjetër Ditën e Ringjalljes ku s'ka dyshim. Nuk besojnë ata që humbën vetveten.
13. Atij i takon çdo gjë që e jeton natën dhe ditën. Ai është Dëgjuesi, Dijeploiti.
14. Thuaj: "Të marr mbrojtës në vend të Zotit, Krijuesit të qiejve e të tokës, ndërsa Ai ushqen e nuk ushqehet?" Thuaj: "Unë u urdhërova të jem i pari musliman. E të mos jem idhujtar. "
15. Thuaj: "Po të mos i bindem tim Zoti, i frikësohem dënimit të një dite të madhe."
16. Kë i shpëton asaj dite, Ai e ka mëshiruar. Kjo është fitorja e qartë.
17. Nëse Zoti të prek me një të keqe, përveç Tij, s'ka kush ta heq; në të prek me një të mirë, Ai është mbi gjithçka pushtetplotë.
18. Ai është i Gjithëfuqishmi mbi robtë e Vet; Ai është i Urti, i Gjithëdituri.
19. Thuaj: "Ç'është më e madhe si dëshmi?" Thuaj: "Zoti është dëshmuar mes nesh. M'u kumtua ky Kuran t'ju tërheq vëmendjen juve dhe kujtdo që arrin. Dëshmoni se me Zotin ka zota të tjerë?" Thuaj: "Unë nuk dëshmoj." Thuaj: "Ai është një Zot. Unë jam i çliruar nga ç'i shoqëroni."
20. Ithtarët e Librit e njohin atë siç njohin të bijtë, por, nuk besojnë ata që humbën vetveten.
21. Kush është më i padrejtë se ai që trillon ndaj Zotit gënjeshtër ose përgënjeshton dëshmitë e Tij? Dhunuesit nuk kanë sukses.
22. Ditën që i tubojmë të gjithë dhe u themi idhujtarëve: "Ku i keni shoqëruesit që besonit?"-

23. nuk kanë dredhi tjetër, por të thonë: “Për Zotin, Zoti ynë, nuk ishim idhujtarë!”
24. Pa shih si gënjejnë vetveten! Dhe u shkuan më kot trillimet.
25. Ka nga ata që të dëgjojnë, por u bëmë në zemër mbulesë dhe nuk e kuptojnë, ndërsa në veshët e tyre, rëndesë. Edhe sikur të shohin çdo dëshmi, nuk e besojnë, aq sa, kur vijnë për të diskutuar me ty, mohuesit thonë: “Kjo është rrëfenjë e të parëve.”
26. Ndalojnë të tjerët prej saj dhe qëndrojnë vetë larg, porse prishin veten dhe nuk e ndiejnë.
27. Po të shihje kur t'i përballen zjarrit, do të thonë: “Ah, sikur të qemë kthyer! Nuk do të përgënjeshtrojmë dëshmitë e Zotit dhe do të ishim besimtarë.”
28. Por, jo! U del e fshehta në shesh. Edhe sikur të ktheheshin, do të përsëritnin po ato nga të cilat u ndaluan. Sepse janë gënjeshtarë.
29. Thonë: “Është vetëm jeta jonë e kësaj bote dhe nuk ringjallemi.”
30. Po të shihje kur të qëndrojnë para Zotit dhe Ai t'u thotë: “A nuk është kjo e vërteta?”- do të thonë: “Po, për Zotin tonë!” Thotë: “Shijoni dënimin pasi mohuat!”
31. Kanë humbur ata që përgënjeshtrojnë takimin me Zotin, derisa, kur t'u vijë papritmas ora, do të thonë: “Mjerë ne ç'lamë pas dore!” Dhe do të bartin në shpinë barrët e tyre. Ç'barrë të këqia bartin!
32. Jeta e kësaj bote është vetëm shfaqje dhe kalim kohe ndërsa banesa e së ardhmes është më e mira për të devotshmit. A nuk kuptoni?
33. Ne e dimë se të dëshpërojnë fjalët e tyre, porse nuk të përgënjeshtrojnë ty. Dhunuesit refuzojnë dëshmitë e Zotit.

34. U përgënjeshtruan profetë para teje, i duruan përgënjeshttrimet dhe u munduan derisa erdhi ndihma Jonë. Fjalët e Zotit janë të patjetërsueshme. Tashmë të kanë ardhur disa nga ngjarjet e profetëve.
35. Në të rëndon largimi i tyre, hyr në tokë a ngjitu në qiell dhe sillu, po të mundje, një dëshmi. Të kishte dashur Zoti, i bashkonte në udhë, pra, mos u bëj ndër të paditurit.
36. Përgjigjen ata që dëgjojnë. Sa për të vdekurit, Zoti do t'i ngrejë dhe i kthehen Atij.
37. Thonë: "Sikur nuk i zbriti ndonjë shenjë nga Zoti i tij!" Thuaj: "Zoti është i pushtetshëm të zbresë një shenjë." Por të shumtët e tyre nuk dinë.
38. Nuk ka gjallesë në tokë dhe shpend që fluturon me flatra, të mos jetë si ju në bashkësi. Nuk kemi lënë gjë pas dore në libër. Pastaj, te Zoti i tyre mblidhen.
39. Ata që përgënjeshtrojnë dëshmitë Tona janë shurdhmemecë në errësirë. Kë do Zoti, lë të gabojë dhe, atë që do, e vë në udhë të drejtë.
40. Thuaj: "Po të shihnit se ju erdhi dënimi i Zotit ose ju erdhi ora, a do të thirrnit dikë, veç Zotit, në thoni të vërtetën?"
41. Jo, Atij do t'i thirrnit dhe, në dashtë, jua largon atë për të cilën i thirrnit dhe të harroni çfarë i shoqëronit.
42. Dërguam të dërguar te popujt e tjerë para teje dhe i zumë me mjerim e vështirësi që të mund të nënshtroheshin.
43. Kur u erdhi Fuqia Jonë, nuk u nënshtruan, përkundrazi, u ashpërsuan zemrat e tyre dhe djalli ua zbukuroi veprat.

44. Sapo harruan kujtesën, u hapëm portat e çdo gjëje, derisa, kur u vetëkënaqën me ç'u qe dhënë, i zumë papritmas dhe, ja, tek u zhgënjyen.
45. U këputën rrënjët e popullit dhunues, falënderuar qoftë Allahu, Zoti i botëve!
46. Thuaj: "Po të shihnit se Zoti ju mori të dëgjuarit e të parët dhe jua shtangu zemrat, cili zot, veç Zotit, jua sjell?" Shih si i shtjellojmë dëshmitë, pastaj bëjnë mënjane.
47. Thuaj: "Po të shihnit se ju vjen dënimi i Zotit, befas apo haptas, kush zhduket veç popullit dhunues?"
48. Ne dërguam të dërguarit si përgëzues e paralajmërues. Cili besoi dhe u përmirësua, nuk frikësohet e dëshpërohet.
49. Ata që përgënjeshtrojnë dëshmitë Tona i zë dënimi pasi nuk u bindën.
50. Thuaj: "Unë nuk them se kam thesaret e Zotit, as se di të panjohurën, as po ju them se jam engjëll. Unë ndjek çfarë më kumtohet." Thuaj: "A janë njësoj i verbri me kë sheh? Nuk mendoheni?"
51. Paralajmëro me të ata që i frikësohen tubimit të Zotit i tyre që të mund të përmbahen sepse nuk kanë veç Tij kujdestar e ndërmjetës.
52. Dhe mos përzë cilët lusin Zotin mëngjes e mbrëmje për hir të Tij. Nuk të takon ty gjë nga llogaria e tyre, as atyre nga llogaria jote. Po t'i përzësh, do të ishe i padrejtë.
53. Kështu, i bëjmë disa provë për të tjerë që mund të thonë: "Këta i paska bekuar mes nesh Zoti?" Nuk i di Zoti më së miri falënderuesit?
54. Kur të të vijnë ata që besojnë dëshmitë Tona, thuaj: "Paqja qoftë me ju!" Zoti ia caktoi Vetes mëshirën, që,

- me të vërtetë, nëse ndonjëri nga ju bën një të keqe me padije, pastaj pendohet e përmirësohet, Ai është falës, mëshirëplotë.
55. Kështu i shtjellojmë dëshmitë dhe të bëhet e qartë udha e mëkatarëve.
56. Thuaj: “Unë jam ndaluar të adhuroj ç’adhuroni ju në vend të Zotit.” Thuaj: “Unë nuk ndjek dëshirat tuaja. Përndryshe do të gaboja dhe s’do të isha udhëzuar drejt.”
57. Thuaj: “Unë jam me provë të qartë nga im Zot ndërsa ju e përgënjeshtruat. Nuk më takon mua çfarë kërkonti ju me ngut. Vendimi i takon Zotit. Ai thotë të vërtetën dhe është Gjykatësi Më i Mirë.”
58. Thuaj: “Po të më takonte mua çfarë kërkonti ju me ngut, do të kishte marrë fund çështja mes nesh. Zoti i njeh mirë dhunuesit.”
59. Pranë Tij janë çelësat e së panjohurës; askush s’i di ato veç Tij. Ai di ç’është në tokë e në det. Nuk bie gjethe pa dijen e Tij. S’ka farë në errësirat e tokës, të njomë e të thatë, pa qenë në libër të qartë.
60. Është Ai që ju vdes natën dhe di ç’lëvruar ditën, pastaj ju ngre në të derisa të jetë kryer një afat i caktuar, pastaj i ktheheni Atij dhe ju njofton se ç’keni bërë.
61. Ai është i Gjithëfuqishmi mbi robtë e Vet. Dërgon te ju përgjues, derisa, kur ndonjërit prej jush i vjen vdekja, lajmësit Tanë e vdesin pa bërë lëshim.
62. Pastaj i kthehen Zotit, zotërisë së tyre të vërtetë. A nuk i takon Atij vendimi tek është llogarimarrësi më i shpejtë?

63. Thuaj: "Kush ju shpëton nga errësirat e tokës e të detit kur i luteni me përlulje e në fshehtësi që "po na shpëtoi nga këto, do të jemi falënderues?"
64. Thuaj: "Zoti ju shpëton prej tyre dhe nga çdo ankth, pastaj i vini shok."
65. Thuaj: "Ai është i pushtetshëm t'ju dërgojë ndëshkim nga lart ose poshtë këmbëve tuaja ose t'ju ndajë në sekte dhe të provoni ndëshkimin e njëri-tjetrit." Shih si i shtjellojmë dëshmitë që të mund të kuptojnë.
66. Edhe populli yt përgënjeshtroi ndërsa ajo është e vërteta. Thuaj: "Unë nuk jam për ju dorëzanës."
67. Çdo mesazh është i përcaktuar në kohë dhe do ta mësoni.
68. Kur i sheh të përflasin dëshmitë Tona, largohu sa të ndërrojnë bisedë. Në të bën djalli të harrosh, me t'u kujtuar, mos rri me njerëzit dhunues.
69. Të devotshmit nuk kanë gjë nga llogaria e tyre, porse është një kujtesë që të mund të përmbahen.
70. Lëri ata që e marrin fenë si lojë dhe kalim kohe ndërsa i mashtroi jeta e kësaj bote. Bëj me të kujtesë para se një frymë të vuajë pasojën e vet. Nuk ka për të, veç Zotit, kujdestar e ndërmjetës dhe nuk i pranohet sikur të shpërblejë me çdo shpërblesë. Janë ata që do të vuajnë pasojën e veprës së tyre. Ata kanë pije uji të valë dhe dënim të hidhur ngaqë mohuan.
71. Thuaj: "Të lusim veç Zotit çfarë s'na bën dobi e dëm dhe të kthehemi mbrapsht pasi Zoti na drejtoi? Si dikush që djalli ka lënë të hutuar në tokë ndërsa shokët e ftojnë në udhë të drejtë: "Eja te ne!" Thuaj: "Drejtimi i Zotit është drejtim. U urdhëruam t'i dorëzohemi Zotit të botëve."

72. Dhe të kryeni të falurit e t'i përmbaheni Atij tek i Cili do të mblidheni.
73. Është Ai që krijoi qiejt e tokën me të vërtetën. Ditën që thotë: "Jil!" - ajo do të jetë (ringjallja). Fjala e Tij është e vërteta. Atij i takon sundimi ditën që i fryhet bririt. Njohësi i së padukshmes dhe i të dukshmes, Ai është i Urti, në dijeni për gjithçka.
74. Kur Ibrahim i tha të atit, Azerit: "A po merrni idhujt për zota? Unë të shoh ty dhe popullin tënd në gabim të hapur", -
75. ia treguam kështu Ibrahimit pushtetin e qiejve dhe të tokës për t'u bindur.
76. Kur ra nata, pa një yll e tha: "Ky është Zoti im!" Me të perënduar, tha: "Unë nuk i dua ata që perëndojnë."
77. Kur pa hënën të ngrihej, tha: "Ky është Zoti im!" Me të perënduar, tha: "Të mos më drejtonte im Zot, do të isha ndër njerëzit e gabuar."
78. Kur pa diellin të ngrihej, tha: "Ky është Zoti im! Ky është më i madhi." Me të perënduar, tha: "Kombi im, unë jam i çliruar nga adhurimi juaj.
79. Ia ktheva fytyrën Atij që krijoi qiejt e tokën, i vendosur dhe nuk jam idhujtar."
80. Kombi i tij e kundërshtoi. Ai tha: "Më kundërshtoni te Zoti që më drejtoi? Unë nuk u frikësohem idhujve që ia shoqëroni Atij, porse në dashtë im Zot diçka. Zoti im ka përfshirë çdo gjë me dije. A nuk mendoheni?"
81. Si t'u frikësohem idhujve që shoqëroni kur ju s'keni frikë t'i bëni Zotit shok ndërsa Ai nuk ju ka zbritur për këtë argument? Cila palë ka të drejtë të jetë e sigurt nëse e dini?
82. Ata që besojnë dhe nuk e veshin besimin me dhunë janë të sigurt e të udhëhequr drejt."

83. Ky është argumenti Ynë që i dhamë Ibrahimit ndaj kombit të tij. Ne ngrejmë në pozitë me dashjen Tonë. Yt Zot është i urtë, dijeplotë.
84. I dhuruam atij Is'hakun dhe Jakubin. Secilin e udhëzuam drejt. Edhe Nuhin e drejtuam më parë. Ndër pasardhësit e tij: Davudin, Sulejmanin, Ejjubin, Jusufin, Musanë dhe Harunin. Kështu i shpërblejmë mirëbërësit.
85. Edhe Zekerijan, Jahjanë, Isain dhe Iljasin. Secili ishte ndër të mirët.
86. Edhe Ismailin, Eljesanë, Junusin dhe Lutin. Secilin e nderuam në botë.
87. Edhe ndër etërit, pasardhësit, vëllezërit e tyre, zgjodhëm dhe i drejtuam në rrugë të drejtë.
88. Ky është drejtimi i Zotit; drejton me të atë që do ndër robtë e Vet. Në bëjnë idhujtari, ka dështuar ajo që bëjnë.
89. U dhamë Librin, autoritetin dhe profetësinë. Nëse këta mohojnë, Ne përfaqësuam me njerëz që nuk mohojnë,
90. ata që Zoti ka drejtuar, pra, ndiq drejtimin e tyre. Thuaj: "Unë nuk ju kërkoj shpërblim. Kjo është kujtesë për botët."
91. Nuk çmojnë drejt Zotin kur thonë: "Zoti nuk i zbriti gjë njeriut." Thuaj: "Kush e zbriti Librin që solli Musai, dritë e drejtim për njerëzit? E shkruani atë në fletë që i bëni të njohura ndërsa shumë mbani fshehur. Dhe mësuat ç'nuk keni ditur ju dhe etërit tuaj." Thuaj: "Zoti." Pastaj, le të zhyten në diskutime të kota!
92. Edhe ky është një libër të cilin e zbritëm, i bekuar, vërtetues i atij që ka pranë, për të tërhequr vëmendjen e Nënës së Vendbanimeve (Mekës) dhe

rrethinave të saj. Cilët besojnë në të ardhmen, e besojnë atë dhe zbatojnë me përpikmëri ritet e adhurimit.

93. Kush është më i padrejtë se ai që trillon gënjeshtër ndaj Zotit ose thotë: “M’u kumtua mua”, - kur nuk i është kumtuar gjë dhe se ai që thotë: “Unë do të shpall siç ka shpallur Zoti?” Po t’i shihje dhunuesit në agoninë e vdekjes, u zgjasin duart engjëjt dhe u thonë: “Jepni shpirt! Sot do të shpërbleheni me dënim poshtërues sepse flisnit jo drejt për Zotin dhe se ishit mendjemëdhenj ndaj dëshmive të Tij.”
94. “Ja ku na erdhët fillikat, siç ju krijuam për herë të parë, latë pas ç’ju patëm dhënë dhe nuk po shohim me ju ndërmjetësit që besonit të jenë shoqërues. U këput lidhja mes jush dhe u zhdukën çfarë besonit.”
95. Zoti shpërthen farën dhe bërthamën, nxjerr të gjallin nga i vdekuri dhe nxjerr të vdekurin nga i gjalli. Ja, ky është Zoti. Ku shkoni?
96. Ai shpërthen agimin ndërsa natën e bëri prehje dhe diellin e hënën për njësim. Ky është përcaktimi i të Plotfuqishmit, Dijeploitit.
97. Është Ai që bëri yjet të orientoheni në errësirat e tokës e të detit. I shtjelluam dëshmitë për njerëzit që dinë.
98. Është Ai që ju ngriti nga një frymë e vetme, me një vendqëndrim dhe vendkalim. I shtjelluam dëshmitë për njerëzit që kuptojnë.
99. Është Ai që uli ujë nga qielli. Nxorëm me të vegjetacionin e çdo gjëje; prej tij nxjerrim gjelbërim dhe prodhojmë prej tij kallinj të dendur; nga hurma, prej gonxhes së saj, vile të varura; vreshta rrushi, ullinj e shegë, të ngjashme e të llojllojshme. Vështroni

- te frytet e tyre si formohen e piquen. Këtu ka dëshmi për njerëzit që besojnë.
100. I bëjnë Zotit shoqërues xhinët që Ai ka krijuar. Dhe sajojnë për të me padije bij e bija. Madhëruar qoftë, i lartë nga ç'i cilësojnë!
 101. Zanafillësi i qiejve dhe i tokës. Si mund të ketë bir kur nuk ka bashkëshorte? Ai krijoi çdo gjë dhe për çdo gjë është dijeplotë.
 102. Ky është Allahu, Zoti juaj – s'ka zot veç Tij – krijuesi i gjithçkaje. Adhuroni Atë! Ai është dorëzanës për çdo gjë.
 103. Të parët nuk e arrin Atë, ndërsa Ai e kap të parët. Ai është i Ndjeshmi, i Gjithëdituri.
 104. Ju erdhi dritë nga Zoti juaj, pra, kush vështron, e ka për vete; kush verbohët, ia bën vetes. Unë nuk jam tutor mbi ju.
 105. Kështu i shtjellojmë dëshmitë dhe ata mund të thonë se ti i ke mësuar, porse Ne i sqarojmë ato për njerëzit që dinë.
 106. Ndiq çfarë të kumtohet nga yt Zot, – s'ka zot veç Tij, – dhe largohu nga idhujtarët.
 107. Po të deshte Zoti, nuk do të adhuronin idhuj dhe ty nuk të bëjnë mbi ta rojë, as je ndaj tyre dorëzanës.
 108. Mos i fyeri ata që lusin të tjerë në vend të Zotit dhe të fyejnë nga inati e me padije Zotin. Kështu, ia zbukuruam çdo populli bëmat e tij. Pastaj te Zoti është kthimi i tyre dhe i njofton se ç'kanë bërë.
 109. Betohen te Zoti me be të fortë se, po t'u vijë një shenjë, patjetër do të besojnë. Thuaj: "Shenjat janë pranë Zotit." Çfarë do t'ju bënte të kuptonit që, edhe po t'u vijë, nuk besojnë?

110. Ua tjetërsuam zemrat dhe të parët. Sikundër nuk besuan herën e parë, i lëmë të enden të verbuar në rebelimin e tyre.
111. Edhe sikur t'u zbrisnim engjëjt, t'u flisnin të vdekurit dhe t'i ballafaqonim me çdo gjë, nuk besojnë, vetëm në dashtë Zoti. Të shumtët e tyre janë të paditur.
112. Kështu, i bëmë çdo profeti armik djajtë, njerëz e xhinë që frymëzojnë njëri-tjetrin me fjalë të bukura, mashtruese. Po të deshte yt Zot, nuk do ta bënin. Pra, lëri ata me ç'rillojnë.
113. Dhe të anojnë andej zemrat e atyre që nuk besojnë në të ardhmen, të kënaqen me to dhe të fitojnë çfarë fitojnë.
114. "Të kërkoj, veç Zotit, gjykatës ndërsa Ai ju zbriti Librin me shpjegime?" Ata që u kemi dhënë Librin e dinë se është shpallur nga yt Zot me të vërtetën. Pra, mos ji dyshues.
115. Fjala e tët Zoti është e plotë në vërtetësi e drejtësi. Askush nuk mund të ndryshojë fjalët e Tij. Ai është Dëgjuesi, Dijepoti.
116. Po t'u bindesh shumë prej atyre që janë në tokë, të largojnë nga Rruga e Zotit. Ata shkojnë me hamendje dhe vetëm se trillojnë.
117. Yt Zot i di mirë cilët largohen nga Rruga e Tij dhe Ai i di mirë ata që janë të udhëhequr drejt.
118. Hani aty ku përmendet Emri i Zotit nëse besoni dëshmitë e Tij.
119. Përse të mos hani ku përmendet Emri i Zotit ndërsa Ai jua shpjegoi se çfarë ndalohej, vetëm në jeni të shtrënguar? Shumë gabojnë të tjerët me pasionet e tyre dhe me padije. Yt Zot i njeh mirë dhunuesit.

120. Largohuni nga mëkati i hapur dhe i fshehtë. Cilët fitojnë mëkatin, shpërblehen me ç'fituan.
121. Mos hani ku nuk përmendet Emri i Zotit. Kjo është herezi. Janë djajtë që frymëzojnë miqtë e tyre për t'ju kundërshtuar. Nëse u bindeni atyre, jeni idhujtarë.
122. A është një i vdekur që e kthym në jetë dhe i bëmë dritë të ecë me të mes njerëzve si dikush në errësirë pa dalje? Kështu iu zbukuruan veprat mohuesve.
123. Po kështu, bëmë në çdo vendbanim krerët tiranë të thurin plane, por i thurin plane vetes dhe nuk e kuptojnë.
124. Kur u vjen dëshmi, thonë: "Nuk besojmë derisa të na jepet neve siç u është dhënë profetëve të Zotit." Zoti e di mirë ku e përcjell mesazhin e Vet. Fajtorët do t'i zërë, me intrigat e tyre, poshtërim të Zoti dhe një dënim i rreptë.
125. Kë do Zoti të drejtojë, ia hap zemrën për Islam; kë do të gabojë, ia bën zemrën të ngushtë e të shtrënguar si të ngjitej në qiell (nga shtypja e gravitetit). Zoti u vë kështu njollë atyre që nuk besojnë.
126. Kjo është Rruga e Drejtë e tët Zoti. I shpjeguar dëshmitë për njerëzit që mendojnë.
127. Për ta, banesa e paqes është pranë Zotit. Ai është kujdestari i veprave të tyre.
128. Ditën kur i tubon të gjithë: "Ju, grupi i xhinëve, keni bërë shumë njerëz." Miqtë e tyre ndër njerëzit do të thonë: "Zoti ynë, ne përfituam nga njëri-tjetri dhe arritëm afatin që na caktove." Thotë: "Zjarri është përgjithmonë banesa juaj." Vetëm në dashtë Zoti. Yt Zot është i urtë, dijeplotë.
129. I bëmë dhunuesit, me ç'fituan, miq të njëri-tjetrit.

130. “Ju, grupi i xhinëve dhe i njerëzve! A nuk ju erdhën të dërguar mes jush, t’ju tregonin dëshmitë e Mia dhe t’ju tërhiqnin vëmendjen për takimin e kësaj dite?”
Thonë: “Dëshmojmë kundër vetes sonë.” I mashtroi jeta e kësaj bote dhe dëshmuan kundër vetes se ishin mohues.
131. Kjo, sepse yt Zot nuk është për zhdukjen e vendbanimeve me dhunë kur banorët e tyre janë të pavetëdijshëm.
132. Secili ka një vend me veprat e tij dhe yt Zot nuk është për to i shkujdesur.
133. Yt Zot është i vetëmjaftueshëm, i zoti i mëshirës. Po të dojë, ju heq dhe sjell të tjerë që Ai do, siç edhe ju ngriti juve nga gjenerata e një populli tjetër.
134. Ç’ju është parathënë, do të vijë dhe s’mund ta pengoni.
135. Thuaj: “Populli im! Ju veproni nga pozitat tuaja. Edhe unë po veproj. Dhe do ta mësoni kujt i takon fundi. Dhunuesit nuk kanë sukses.”
136. I bëjnë Zotit pjesë nga të lashtat dhe bagëtitë që Ai ka krijuar dhe thonë: “Kjo është për Zotin - sipas tyre - dhe kjo për idhujt tanë.” Ç’është e idhujve, nuk shkon te Zoti dhe ç’është e Zotit, shkon te idhujt e tyre. Sa keq gjykojnë!
137. Po kështu, idhujt (bestytinitë) ua zbukuruan shumë prej idhujtarëve vrasjen e fëmijëve të tyre, për t’i shuar dhe që t’ua ngatërrojnë fenë. Po të deshte Zoti, nuk do ta bënin, pra, lëri ata me ç’trillojnë.
138. Dhe thonë: “Këto bagëti e të lashta janë tabu. Askush nuk mund t’i përdorë përveç atyre që duam ne.” Sipas tyre. Dhe disa kafshë ku ndalohet barra, të tjera ku

- nuk përmendet Emri i Zotit. Duke trilluar ndaj Tij. Do t'i ndëshkojë me ç'trilluan.
139. Thonë: “Ç’është në barqet e këtyre bagëtive, u takon meshkujve tanë, ndalohet për femrat. Në qoftë e vdekur, janë bashkëpjesëtarë.” Do t'ua shpërblejë vlerësimet që bëjnë. Ai është i urtë, dijeplotë.
140. Kanë humbur ata që vrasin fëmijët e tyre me marrëzi e padije dhe ndalojnë ushqimin që Zoti u bëri pjesë duke trilluar ndaj Zotit. Ata janë të çoroditur, jo të udhëzuar drejt.
141. Është Ai që nxori kopshtet e varura dhe jo të varura, palmat dhe drithërat, me shije të ndryshme, ullinj të shëgët, të ngjashme e jo të ngjashme. Ushqehuni me frytet e tyre kur prodhojnë, jepni detyrimin ditën e vjeljes dhe mos shpërdoroni. Ai nuk i do shpërdoruesit.
142. Ndër bagëtitë, ka për ngarkesë e për shtrojë. Ushqehuni me ç’ju ka dhënë Zoti dhe mos ndiqni gjurmët e djallit. Ai është për ju armik i hapur.
143. Tetë në çifte: dy nga dhentë e dy nga dhitë. Thuaj: “Kë ndaloj, dy meshkujt a dy femrat apo ç’janë në barqet e dy femrave? Më thoni me dije në thoni të vërtetën.”
144. Dhe dy nga devetë e dy nga lopët. Thuaj: “Kë ndaloj, dy meshkujt a dy femrat apo ç’janë në barqet e dy femrave? Mos ishit dëshmitarë kur Zoti jua porositi këtë?” Kush është më i padrejtë se ai që sajon gënjeshtër ndaj Zotit, për të gabuar me padije njerëzit? Zoti nuk i drejton dhunuesit.
145. Thuaj: “Unë nuk gjej të më jetë komunikuar ndonjë ushqim që ndalohet përveç së ngordhurës, gjakut të derdhur, mishit të derit, si papastërti ose ç’i kushtohet

- jo Zotit, si një herezi.” Nëse dikush shtrëngohet, pa e lakmuar dhe pa e tepruar, yt Zot është falës, mëshirëplotë.
146. Ua ndaluam judenjve kafshët me kthetra; prej lopës dhe deles ndaluam dhjamin, përveç atij të shpinës, të zorrëve ose që është ngjitur me kockat. Ua shpërblyem me lakminë e tyre. Ne e vërtetojmë.
147. Në të përgënjeshtrojnë, thuaj: “Zoti juaj ka mëshirë të gjerë, por nuk mund të prapset Fuqia e Tij nga njerëzit mëkatarë.”
148. Idhujtarët do të thonë: “Po të deshte Zoti, nuk do të kishim besuar idhuj, as ne e etërit tanë dhe nuk do të bënim gjë tabu.” Kështu përgënjeshtrojnë para tyre derisa provuan fuqinë Tonë. Thuaj: “Mos keni ndonjë dije të na e nxirrni? Ju ndiqni hamendjet dhe vetëm se trilloni.
149. Thuaj: “Zotit i takon argumenti më i plotë. Po të deshte, ju kishte drejtuar të gjithëve.”
150. Thuaj: “Sillni dëshmitarët tuaj të dëshmojnë se Zoti e ka ndaluar këtë.” Po të dëshmojnë, mos dëshmo me ta dhe mos ndiq dëshirat e atyre që përgënjeshtrojnë dëshmitë Tona, nuk besojnë në të ardhmen dhe i bëjnë të barabartë Zotit të tyre.
151. Thuaj: “Ejani të recitoj çfarë ju ka ndaluar Zoti: të mos i shoqëroni gjë Atij, të silleni mirë me prindërit, të mos vrisni fëmijët tuaj nga varfëria, - Ne ju ushqejmë juve dhe ata, - të mos i afroheni imoralitetit të hapur e të fshehtë, të mos vrisni pa të drejtë një frymë që Zoti e ka ndaluar. Ju porosit kështu që të mund të kuptoni.
152. Të mos i afroheni pasurisë së jetimit, por në mënyrën më të mirë, derisa ai të rritet. Të plotësoni me drejtësi masën e peshojën. – Nuk ngarkojmë një frymë përtej

- mundësisë. – Kur të flisni, të jeni të paanshëm, qoftë edhe për një të afërm. Dhe të përmbushni Besën e Zotit. Ju porosit kështu që të mund të mendoheni.”
153. Kjo është Rruga Ime e Drejtë, pra, ndiqni atë! Mos ndiqni udhë që ju ndajnë nga Rruga e Tij. Ju porosit kështu që të mund të përmbaheni.
 154. Musait i dhamë librin, të plotë për mirëbërësit, shpjegim i çdo gjëje, drejtim e mëshirë që ata të mund të besonin në takimin me Zotin e tyre.
 155. Edhe ky është një libër që Ne e shpallëm, i bekuar, pra, ndiqni atë dhe përmbahuni që të mund të mëshiroheni.
 156. Të mos thoni se libri iu shpall dy palëve para nesh dhe ne qemë në padijeni të mësimëve të tyre.
 157. Të mos thoni edhe se, po të na shpallej libri, do të ishim më të udhëzuar drejt se ata. Ja ku ju erdhi dëshmi e qartë nga Zoti juaj, drejtim e mëshirë. Kush është më i padrejtë se ai që përgënjeshtroi dëshmitë e Zotit dhe shmanget prej tyre? Do t'ua shpërblejmë atyre që shmangen nga dëshmitë Tona me dënim të keq pasi u shmangën.
 158. Mos presin t'u vijnë engjëjt ose të vijë yt Zot apo të vijnë shenja të tët Zoti? Ditën që vijnë shenja të tët Zoti, nuk i vlen besimi një fryme që s'besoi më parë ose që s'fitoi një të mirë me besimin e vet. Thuaj: “Prisni! Ne po presim.”
 159. Ti nuk ke të bësh aspak me ata që e përçanë fenë e tyre, të ndarë në sekte. Çështja e tyre është te Zoti dhe do t'i njoftojë se ç'kanë bërë.
 160. Kush vjen me të mirën, ka dhjetëfishin e saj; kush vjen me të keqen, do të shpërblehet me të dhe nuk i bëhet e padrejtë.

161. Thuaj: "Im Zot më drejtoi në rrugë të drejtë, fe e qëndrueshme, në besimin monoteist të Ibrahimit. Ai nuk ishte idhujtar."
162. Thuaj: "Adhurimi im, sakrifica ime, jeta dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e botëve."
163. Ai nuk ka shoqërues. Për këtë u urdhërova dhe jam i pari musliman."
164. Thuaj: "Të kërkoj tjetër zot, në vend të Zotit, ndërsa Ai është Zoti i gjithçkaje?" Çdo frymë fiton të sajën dhe nuk do të mbajë një bartës barrën e tjetrit. Pastaj, kthimi juaj është te Zoti dhe ju njofton se ku ishit në kundërshti."
165. Është Ai që ju bëri mëkëmbës në tokë dhe ngriti në pozitë disa mbi të tjerë për t'ju provuar me ç'ju ka dhënë. Yt Zot ka ndëshkim të shpejtë dhe, vërtet, Ai është falës, mëshirëplotë."

7. PURGATORI (EL A'RAF)

Periudha e Mekës, 206 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Elif, lam, mim, sad.
2. Libër që u shpall tek ty - mos të të ndrydhet zemra të tërheqësh me të vëmendjen - dhe kujtesë për besimtarët.
3. Ndiqni shpalljen tek ju, nga Zoti juaj dhe mos ndiqni zota në vend të Tij. Ju pak mendoheni.
4. Sa e sa vendbanime kemi zhdukur! U erdhi Fuqia Jonë natën a në pikë të ditës.
5. Kur u erdhi Fuqia Jonë, e humbën davanë dhe thanë: "Ishim të padrejtë!"

6. Do marrim në pyetje ata ku u dërguan të dërguar, do marrim në pyetje edhe të dërguarit.
7. Ua tregojmë me fakte dhe nuk mungojmë.
8. Peshojë atë ditë është e vërteta: kujt i peshon balanca, ka shpëtuar;
9. kujt nuk i peshon balanca, ka humbur veten pasi keqpërdori dëshmitë Tona.
10. Ju vendosëm në tokë dhe bëmë për ju mjete jetese. Ju pak falënderoni.
11. Ne ju krijuam, ju dhamë formë dhe u thamë engjëjve: “Përluni para Ademit!” U përlën përveç Iblisit. Ai nuk ishte me të përlurit.
12. Tha: “Ç’të pengoi të përlesh kur të urdhërova?” Tha: “Unë jam më i mirë prej tij. Mua më krijove nga zjarri dhe e krijove atë nga balta.”
13. Tha: “Zbrit së andejmi! Nuk të takon ty të krenohesh atje. Dil! Je i përçmuar.”
14. Tha: “Më jep afat deri Ditën e Ringjalljes!”
15. Tha: “Ti je nga ata me afat.”
16. Tha: “Meqenëse më prapësove, do t’u zë pritë në Rrugën Tënde të Drejtë.
17. Pastaj u vij para e pas, djathtas e majtas dhe të shumtët e tyre nuk i gjen falënderues.”
18. Tha: “Dil së andejmi, i fajësuar, i përzënë! Në të ndjekin ty, do ta mbush skëterrën me ju bashkë.”
19. “O Adem, banoni ti dhe gruaja jote në kopsht, hani ku të dëshironi, por mos iu afroni kësaj peme e të jeni dhunues.”
20. I cyti djalli për t’u nxjerrë në dukje pjesët e turpshme, të fshehta prej tyre (të ndienin epsh) dhe tha: “Zoti ju ndaloi nga kjo pemë, të mos bëheni engjëj a të përjetshëm.”

21. Dhe u betua: "Vërtetë, unë jam për ju një këshillues i mirë!"
22. I shoqëroi me mashtrim dhe, kur ata e shijuan pemën, u dolën në dukje pjesët e turpshme që filluan t'i mbulonin me gjethet e kopshtit. U thirri Zoti: "A s'ju ndalova prej asaj peme dhe ju thashë se djalli është për ju armik i hapur?"
23. Thanë: "Zoti ynë! Ne dhunuam vetveten. Po s'na fale e mëshirove, jemi të humbur."
24. Tha: "Zbritni, armiq të njëri-tjetrit (njëriut me djallin)! Keni në tokë vendqëndrim dhe jetesë të përkohshme. -
25. Tha: Në të jetoni, në të vdisni dhe prej saj do të dilni."
26. Bijtë e Ademit! Ju zbritëm një petk-stoli që mbulon trupin tuaj dhe petkun e devotshmërisë; ky është më i mirë. Këto ishin dëshmitë e Zotit që të mund të mendoheshin.
27. Bijtë e Ademit! Të mos ju mashtrojë djalli sikurse nxori nga kopshti prindërit tuaj duke u hequr petkun për t'u nxjerrë në dukje pjesët e turpshme. Ai dhe sëra e tij ju shohin nga nuk i shihni. I bëmë djajtë kujdestarë të atyre që nuk besojnë.
28. Kur bëjnë paudhësi, thonë: "Kështu i gjetëm etërit tanë dhe na e urdhëroi Zoti." Thuaj: "Zoti nuk urdhëron paudhësitë. A thoni për Zotin çfarë nuk dini?"
29. Thuaj: "Zoti më urdhëroi të drejtën. Ktheni fytyrën nga faltoret dhe lutjuni Atij me besim thjesht për Të. Siç ju zuri fill, ktheheni."
30. Një pjesë Ai e drejtoi dhe një pjesë meritoi humbjen; morën, në vend të Zotit, djajtë për kujdestarë dhe pandehin se janë drejt.

31. Bijtë e Ademit! Merrni stolitë tuaja (veshmbathjet) nëpër faltore, hani e pini dhe mos shpërdoroni. Ai nuk i do shpërdoruesit.
32. Thuaj: “Kush ndaloi stolitë e Zotit që Ai nxori për robtë e Vet dhe të mirat për jetesë?” Thuaj: “Ato janë për besimtarët në jetën e kësaj bote, posaçërisht, Ditën e Ringjalljes.” Kështu i shpjegojmë dëshmitë për njerëzit që dinë.
33. Thuaj: “Im Zot ka ndaluar punët e këqia, të hapura e të fshehta, mëkatin, armiqësinë pa të drejtë, t’i bëni Zotit shok, sepse nuk ka zbritur për këtë ndonjë argument dhe të flisni për Zotin me padije.”
34. Çdo popull ka një afat dhe, kur i vjen afati, nuk mund ta vonojë e ta shpejtojë.
35. Bijtë e Ademit! Në ju vijnë të dërguar t’ju tregojnë dëshmitë e Mia, kush ruhet e përmirësohet, nuk frikësohet e dëshpërohet.
36. Cilët përgënjeshtrojnë dëshmitë Tona dhe tregohen ndaj tyre kryeneçë, janë banorët e përhershëm të zjarrit.
37. A ka më të padrejtë se ata që shpifin ndaj Zotit gënjeshtër ose përgënjeshtrojnë dëshmitë e Tij? Atyre u arrin pjesa që u takon nga Libri dhe, kur t’u vijnë lajmësit Tanë e t’i vdesin, u thonë: “Ku janë çfarë lusnit në vend të Zotit?” Do të thonë: “Na humbën.” Dëshmojnë kundër vetes se ishin mohues.”
38. Thotë: “Hyni në zjarr me turmat e xhinëve e të njerëzve që kaluan para jush.” Sa herë hyn një turmë, mallkon simotrën dhe, kur arrijnë të gjithë, të fundit thonë për të parët: “Zoti ynë, ja, këta na gabuan! Jepu dënim të dyfishtë zjarri.” Thotë: “Secili e ka të dyfishtë. Por ju nuk dini.”

39. Dhe u thonë të parët të fundit: “Ju nuk keni dallim prej nesh. Shijoni dënimin që fituat.”
40. Cilët përgënjeshtroan dëshmitë Tona dhe u treguan kryeneçë, nuk u hapen portat e qiellit dhe, më sa hyn deveja në vrimë të gjilpërës, mund të hyjnë ata në parajsë. Kështu ua shpërblejmë fajtorëve.
41. Për ta, skëterra është shtrat e mbulesë. Kështu ua shpërblejmë dhunuesve.
42. Ata që besojnë e bëjnë të mira, - nuk ngarkojmë një frymë përtej mundësisë, - janë banorët e parajsës, përgjithmonë.
43. Heqim nga zemrat e tyre çdo mëri, rrjedhin ndër ta lumenj dhe thonë: “Lavdi Zotit që na drejtoi këtu! Po të mos na drejtonte Zoti, nuk do të drejtoheshim. Na erdhën të dërguarit e Zotit tonë me të vërtetën.” U thirret: “Ja, kjo është parajsa që trashëguat me veprat tuaja!”
44. Banorët e parajsës u thërrasin banorëve të zjarrit: “Ne e gjetëm të vërtetë premtimin e Zotit tonë. Po ju, a e gjetët të vërtetë premtimin e Zotit tuaj?” Thonë: “Po.” Një thirrës mes tyre thotë: “Mallkimi i Zotit qoftë mbi dhunuesit,
45. që penguan nga Rruga e Zotit, donin ta shtrembëronin atë dhe ishin mohues të së ardhmes!”
46. Mes tyre është një perde. Në lartësitë e Purgatorit ka njerëz që e njohin secilin nga çehrrja. U thërrasin banorëve të parajsës: “Paqja qoftë me ju!” Nuk kanë hyrë atje, por lakmojnë.
47. Kur shikimi i tyre shkon te banorët e zjarrit, thonë: “Zoti ynë, mos na bëj me dhunuesit!”

48. Banorët e Purgatorit u thërrasin disa njerëzve që i njohin në fytyrë dhe u thonë: “Ç’ju vlejti që grumbulluat e u mburrët?”
49. A janë këta për të cilët bënit be se Zoti nuk i arrin me mëshirë: “Hyni në parajsë, s’ka frikë për ju dhe nuk dëshpëroheni?””
50. Banorët e zjarrit u thërrasin banorëve të parajsës: “Na lëshoni pak ujë a ç’ju ka dhënë Zoti!” Thonë: “Zoti i ka ndaluar këto për mohuesit.”
51. Ata që morën fenë si kalim kohe e lojë dhe i joshi jeta e kësaj bote, sot Ne i harrojmë siç harruan takimin e kësaj dite dhe refuzuan dëshmitë Tona.
52. Ne u sollëm një libër që e shpjeguam me dije, drejtim e mëshirë për njerëzit që besojnë.
53. Mos presin domethënien e tij? Ditën që i realizohet domethënia, ata që e harruan më parë do të thonë: “Na erdhën të dërguarit e Zotit me të vërtetën. A ka për ne ndërmjetës të na ndërmjetësojnë ose të kthehemi e të bëjmë ndryshe nga ç’kemi bërë?” Humbën veten dhe u zhdukën ç’trilluan.
54. Zoti juaj është Allahu, Ai që krijoi qiejt e tokën në gjashtë ditë, pastaj përqendroi pushtetin. Mbulon pandërprerë ditën me natë; dielli, hëna dhe yjet i janë nënshtruar Urdhrit të Tij. A nuk i takojnë Atij krijimi dhe urdhri? Bekuar qoftë Allahu, Zoti i botëve!
55. Lusni Zotin tuaj me përlulje e mënjanë. Ai nuk i do ata që e tejkalojnë.
56. Mos sillni, pas paqes, mosmarrëveshje në tokë. Luteni Atë me drojë e shpresë. Mëshira e Zotit është pranë mirëbërësve.
57. Është Ai që dërgon erërat - sihariq të mëshirës së Vet. Derisa, kur bartin re të rënduar, ia çojmë tokës së

- vdekur, zbresim ujë dhe nxjerrim me të lloj-lloj frytesh. Kështu i nxjerrim të vdekurit. Që ju të mund të mendoheni.
58. Toka e mirë jep, me lejen e Zotit, bimësinë e vet; toka e varfër vështirë të nxjerrë gjë. Kështu i shtjellojmë dëshmitë për njerëzit që falënderojnë.
59. Dërguam Nuhin te kombi i tij dhe tha: “Kombi im, adhuroni Zotin! S’keni zot veç Tij. Unë i trembem për ju dënimit të një dite të madhe.”
60. Krerët e kombit thanë: “Ne të shohim në gabim të hapur.”
61. Tha: “Kombi im, nuk jam në gabim, porse i dërguar nga Zoti i botëve.
62. Unë po ju komunikoj mesazhet e tim Zoti dhe ju këshilloj. Unë di nga Zoti ç’ju nuk dini.
63. Mos u çuditët që ju erdhi kujtesë nga Zoti juaj, te një burrë prej jush, t’ju tërheqë vëmendjen, të përmbaheni e të mund të mëshiroheni?”
64. E përgënjeshtruan dhe Ne shpëtuam atë e ç’qenë me të në anije dhe i mbytëm ata që përgënjeshtruan dëshmitë Tona. Ishte popull i verbër.
65. Te Adi, të vëllanë, Hudin. Tha: “Kombi im, adhuroni Zotin! S’keni zot veç Tij. A nuk përmbaheni?”
66. Krerët mohues të kombit të tij thanë: “Ne të shohim ty të pamend dhe besojmë se je gënjeshtar.”
67. Tha: “Kombi im, unë nuk jam i pamend, porse i dërguar nga Zoti i botëve.
68. Unë po ju komunikoj mesazhet e tim Zoti dhe jam për ju këshillues besnik.
69. Mos u çuditët që ju erdhi kujtesë nga Zoti juaj, te një burrë prej jush, t’ju tërheqë vëmendjen? Kujtoni tek ju bëri mëkëmbës pas kombit të Nuhit, ju shtoi e zgjeroi

- në botë. Kujtoni të mirat e Zotit që të mund të keni sukses.”
70. Thanë: “Na erdhe të adhurojmë Zotin një të vetëm e t’i lëmë ç’adhuronin etërit tanë? Sillna paralajmërimin tënd në thua të vërtetën.”
 71. Tha: “Ra mbi ju, nga Zoti juaj, dënim e urrejtje. Po më kundërshtoni me ca emra që i keni vënë ju dhe etërit tuaj? Zoti nuk ka zbritur për to ndonjë argument. Pritni, edhe unë po pres me ju.”
 72. Shpëtuan atë e ç’qenë me të, me mëshirën Tonë dhe ua këputëm rrënjët atyre që përgënjeshtuan dëshmitë Tona. Ata nuk ishin besimtarë.
 73. Te Themudi, të vëllanë, Salihun. Tha: “Kombi im, adhuroni Zotin! S’keni zot veç Tij. Ju erdhi provë e qartë nga Zoti juaj. Kjo është deveja e Zotit, shenjë për ju. Lëreni të ushqehet në tokën e Zotit dhe mos e prekni me të keq e t’ju zërë dënim i hidhët.
 74. Kujtoni tek ju bëri mëkëmbës pas Adit, ju vendosi në tokë ku zini rrafshinat me pallate dhe gdhendni malet për banesa. Kujtoni të mirat e Zotit dhe mos veproni keq në tokë si ngatërrestarë.”
 75. Krerët kryelartë të kombit të tij u thanë të pafuqishëmve që besonin: “E dini me të vërtetë se Salihu është i dërguar nga Zoti?” Thanë: “Ne e besojmë misionin e tij.”
 76. Thanë kryelartët: “Ne e mohojmë besimin tuaj.”
 77. E gjymtuan devenë dhe ngritën krye ndaj urdhrit të Zotit e thanë: “O Salih, sillna paralajmërimin tënd në je i dërguar.”
 78. I zuri tronditja dhe mbetën përmbys nëpër shtëpitë e tyre.

79. U largua nga ata e tha: "Kombi im, unë jua komunikova mesazhin e tim Zoti dhe ju këshillova, mirëpo ju nuk i doni këshilluesit."
80. Edhe Luti kur i tha kombit të tij: "A po bëni paudhësi që s'e ka bërë kush më parë në botë?"
81. U vini burrave me epsh në vend të grave. Sigurisht, ju jeni një komb i shthurur."
82. Përgjigjja e kombit të tij ishte: "Dëbojini nga vedbanimi juaj meqë janë të panjollësor!"
83. Shpëtua atë dhe njerëzit e tij përveç së shoqes që ishte me të prapambeturit.
84. Lëshuam mbi ta një shi dhe vështro si qe fundi i fajtorëve!
85. Te Medjeni, të vëllanë Shuajbin. Tha: "Kombi im, adhuroni Zotin! S'keni zot veç Tij. Ju erdhi provë e qartë nga Zoti juaj. Plotësoni masën e peshojën dhe mos mangësoni mallrat e njerëzve. Mos shkaktoni, pas paqes, mosmarrëveshje në tokë. Kështu është më mirë për ju në jeni besimtarë.
86. Mos zini shtigjet duke kërcënuar e penguar nga Rruga e Zotit kë beson me qëllim që t'ia shtrembëroni. Kujtoni tek ishit të pakët dhe Ai ju shtoi. Dhe shihni si qe fundi i ngatërrestarëve!
87. Nëse një pjesë tuajsh beson në misionin tim dhe një pjesë nuk beson, duroni derisa Zoti të gjykojë mes nesh. Ai është Gjykatësi Më i Mirë."
88. Krerët kryelartë të kombit të tij thanë: "Do t'ju dëbojmë nga vendbanimi ynë, o Shuajb, ty dhe ata që besojnë me ty ose kthehuni në besimin tonë." Tha: "Me pahir?"
89. Po të kthehemi në besimin tuaj pasi Zoti na shpëtoi prej tij, do të sajnim ndaj Zotit gënjeshtër. Nuk na takon neve të kthehemi në të pa dashjen e Allahut,

- Zotit tonë. Zoti ynë përfshin me dije çdo gjë. Te Zoti mbështetemi. Zoti ynë, vendos me drejtësi mes nesh dhe kombit tonë! Ti je Vendosësi Më i Mirë.”
90. Krerët mohues të kombit të tij thanë: “Po të ndiqni Shuajbin, jeni të humbur.”
 91. I zuri tronditja dhe mbetën përmbys nëpër shtëpitë e tyre.
 92. Cilët përgënjeshtuan Shuajbin, u bënë si të mos kishin banuar në to. Të humbur ishin ata që përgënjeshtuan Shuajbin.
 93. U largua prej tyre dhe tha: “Kombi im, unë jua komunikova mesazhet e tim Zoti dhe ju këshillova. Si të brengosem për njerëzit mohues?”
 94. Në çdo vendbanim që dërguam profet, i morëm banorët e tij me fatkeqësi e vështirësi që të mund të nënshtroheshin.
 95. Pastaj ua këmbuem të keqen me të mirë derisa e morëm veten dhe thanë: “Edhe të parët tanë kaluan vështirësi e ditë të mira.” I morëm në befasi dhe nuk e kuptuan.
 96. Sikur banorët e vendbanimeve të besonin e të përmbaheshin, ua hapnim bekimet nga qielli e toka, mirëpo përgënjeshtuan dhe i morëm me ç’fituan.
 97. Mos u siguruan banorët e vendbanimeve se nuk u vjen Fuqia Jonë natën, në gjumë?
 98. Apo u siguruan banorët e vendbanimeve se nuk u vjen Fuqia Jonë ditën duke u zbavitur?
 99. Dhe iu siguruan kurthit të Zotit. Vetëm njerëzit e humbur i sigurohen kurthit të Zotit.
 100. A nuk është mësim për ata që trashëguan tokën, pas banorëve të saj, se, po të duam, i godasim me

- mëkatet e tyre? Ne vëmë vulë në zemrat e tyre dhe nuk ndiejnë.
101. Këto janë vendbanimet që po të tregojmë disa nga ndodhitë e tyre. U erdhën të dërguarit me prova të qarta, por nuk qenë që të besonin ç'kishin përgënjeshtuar më parë. Kështu, Zoti ua vulos zemrat mohuesve.
 102. Nuk gjetëm te të shumtët e tyre besë ndërsa i gjetëm të shumtët e tyre të pabindur.
 103. Pas tyre, dërguam Musanë me dëshmitë Tona te faraoni dhe krerët e tij. I dhunuan ato dhe shih si qe fundi i keqbërësve!
 104. Musai tha: "O faraon! Unë jam i dërguar nga Zoti i botëve.
 105. Është e vërtetë që them për Zotin vetëm të vërtetën. Ju erdha me dëshmi nga Zoti juaj, pra nisi me mua bijtë e Izraelit!"
 106. Tha: "Po të kesh ardhur me ndonjë dëshmi, sille në thua të vërtetën."
 107. E hodhi shkopin, kur, ja, një gjarpër që dukej!
 108. Nxori dorën, kur, ja, e bardhë për shikuesit!
 109. Krerët e kombit të faraonit thanë: "Ky qenka magjistar i ditur."
 110. "Kërkon t'ju nxjerrë nga vendi juaj. Ç'urdhëroni?"
 111. Thanë: "Mbaje në pritje me të vëllanë dhe dërgo nëpër qytete korrierë,
 112. të të sjellin çdo magjistar të ditur."
 113. Erdhën magjistarët te faraoni dhe thanë: "Sigurisht, do të shpërblehemi po të fitojmë."
 114. Tha: "Po. Dhe do të jeni ndër të afërmit."
 115. Thanë: "O Musa, hidh ose të hedhim."

116. Tha: "Hidhni!" Sapo hodhën, i magjepsën sytë e njerëzve dhe i tmerruan. Sollën një magji të madhe.
117. E frymëzuam Musanë të hidhte shkopin e vet, kur, ja, i përpiu ç'kishin sajuar.
118. U realizua e vërteta dhe shkoi më kot bëma e tyre.
119. U mundën atje dhe mbetën të poshtëruar.
120. Magjistarët ranë me krye në tokë.
121. Thanë: "Besojmë Zotin e botëve,
122. Zotin e Musait e të Harunit."
123. Faraoni tha: "Besoni para se t'ju lejoj unë? Ky është komplot që kurdisët në qytet për të dëbuar banorët e tij. Por, ta dini!
124. Do t'ju pres duar e këmbë tërthor dhe t'ju kryqëzoj të gjithëve."
125. Thanë: "I kthehemi Zotit tonë.
126. Po hakmerresh vetëm e vetëm pse besuam dëshmitë e Zotit tonë që sapo na erdhën. Zoti ynë, mbushna me durim dhe vdisna si muslimanë!"
127. Krerët e kombit të faraonit thanë: "A po lë Musanë dhe kombin e tij të sjellin ngatërresa në tokë e t'ju braktisin ty dhe zotat tuaj?" Tha: "T'i vrasim bijtë e tyre dhe lëmë gjallë gratë e tyre. Ne jemi mbi ta të plotfuqishëm."
128. Musai i tha popullit të tij: "Kërkoni ndihmë prej Zotit dhe duroni! Toka është e Zotit. Ia trashëgon atij që do ndër robtë e Vet. Fundi u takon të devotshmëve."
129. Thanë: "Ne u shtypëm para se të vije ti dhe pasi na erdhe ti." Tha: "Ndoshta Zoti i shkatërron armiqtë tuaj, ju bën mëkëmbës në tokë dhe të shohë si veproni."
130. I morëm njerëzit e faraonit me thatësi dhe mungesë prodhimesh që të mund të mendoheshin.

131. Kur u vinte e mira, thonin: “Kjo është për ne.” Po t’u binte e keqja, ia hidhnin Musait me të tijët. A nuk qe oguri i keq i tyre te Zoti? Mirëpo të shumtët nuk dinin.
132. Dhe thonin: “Çfarëdo shenje të sjellësh për të na bërë magji, nuk të besojmë.”
133. U lëshuam përmbytje, karkaleca, parazitë, bretkoca e gjak, shenja në detaje, por mbetën kokëfortë dhe qenë fajtorë.
134. Kur u ndodhte e keqja, thonin: “O Musa, lute për ne tët Zot sipas besës me ty. Po na e hoqe të keqen, patjetër do të besojmë dhe t’i nisim me ty bijtë e Izraelit.”
135. Kur ua hoqëm të keqen, me një afat që ata duhej ta arrinin, ja tek e thyen!
136. U hakmorëm me ta dhe i mbytëm në det. Sepse përgënjeshtuan dëshmitë Tona dhe ishin ndaj tyre të shkujdesur.
137. Ua trashëguam njerëzve të shtypur tokën që bekuam, në lindje dhe perëndim të saj. U plotësua fjala e bukur e tët Zoti për bijtë e Izraelit sepse duruan. Dhe i asgjësuam planet që thurën faraoni me kombin e tij.
138. I kapërcyem në det bijtë e Izraelit dhe arritën pranë një kombi të dhënë pas idhujve. Thanë: “O Musa, na bëj një zot si zotat e tyre!” Tha: “Ju jeni popull i paditur.
139. Gjendja në të cilën janë ata është shkatërrim dhe puna që bëjnë, e kotë.”
140. Tha: “A të kërkoj për ju, në vend të Zotit, zota të tjerë ndërsa Ai ju dalloi në botë?”
141. Kur ju shpëtuam nga njerëzit e faraonit që ju jepnin dënimin më të keq, vrisnin bijtë tuaj dhe linin gjallë

- gratë tuaja, ishte kjo për ju një provë e madhe nga Zoti juaj.
142. I caktuam Musait tridhjetë netë, i plotësuam me dhjetë dhe u mbush koha e caktuar e Zotit prej dyzetë netësh. Musai i tha të vëllait, Harunit: “Më zëvendëso te kombi im, ji i drejtë dhe mos ndiq udhën e ngatërrestarëve.”
143. Kur erdhi Musai në takim dhe i foli Zoti, tha: “Im Zot, m’u shfaq, të të shoh!” Tha: “Ti nuk mund të më shohësh, por shih te mali: po të qëndrojë, do të më shohësh.” Posa Zoti i rrezatoi malit, u dërmua dhe Musai ra pa ndjenja. Kur u përmend, tha: “Madhëruar qofsh! Unë të pendohem dhe jam i pari besimtar.”
144. Tha: “O Musa! Unë të zgjodha ndaj njerëzve me mesazhet dhe fjalët e Mia, pra, merr çfarë të kam dhënë dhe ji falënderues.”
145. Shkruam për të në pllaka gjithçka si këshillë e sqarim: “Mbaji fort dhe urdhëro kombin tënd t’i përvetësojë më së miri. Do t’jua tregoj vendin e të pabindurve.
146. Cilët mburren me pa të drejtë në tokë, do t’i largoj nga dëshmitë e Mia. Edhe sikur të shohin çdo dëshmi, nuk e besojnë. Po të shohin Rugën e Drejtë, nuk e marrin për udhë. Po të shohin rrugën e shtrembër, atë marrin për udhë. Sepse përgënjeshtrojnë dëshmitë Tona dhe ishin ndaj tyre të shkujdesur.
147. Atyre që përgënjeshtrojnë dëshmitë Tona dhe takimin e së ardhmes u kanë dështuar veprat. Mos shpërblehen ndryshe nga ç’vepruan?
148. Pas tij, kombi i Musait bëri nga stolitë një model viçi që pëlliste. Nuk e shihnin që s’u fliste e t’i drejtonte në udhë? E morën atë si dhunues.

149. Kur u ngeli në dorë dhe e panë se kishin gabuar, thanë: “Nëse Zoti ynë nuk na mëshiron e fal, jemi të humbur.”
150. Kur Musai u kthye te kombi i tij, shumë i zemëruar dhe i brengosur, tha: “Sa keq më zëvendësuar pas meje! Nxituat urdhrin e Zotit tuaj?” I la pllakat dhe zuri të vëllanë nga koka duke e tërhequr drejt vetes. Ai i tha: “O biri i nënës sime! Populli më mundi dhe gati sa s’më mbyti. Mos më bëj mua lojë për armiqtë dhe mos më vërë me njerëzit dhunues.”
151. Tha: “Im Zot, falna mua e tim vëlla dhe na prano në mëshirën Tëndel! Ti je Mëshiruesi i mëshiruesve.
152. Cilët bënë idhull viçin, i zë zemërimi i Zotit dhe poshtërimi në jetën e kësaj bote. Kështu i shpërblejmë ata që sajojnë të paqena.
153. Porse, cilët bënë të këqia, pastaj u penduan e besuan, yt Zot është për ta falës, mëshirëplotë.
154. Kur i ra inati, Musai mori pllakat me shkrimet, udhëzim e mëshirë për ata që i frikësohen Zotit.
155. Musai zgjodhi shtatëdhjetë burra nga kombi i tij në takimin Tonë dhe, tek i zuri një tërmet, tha: “Im Zot, po të deshe, i kishe zhdukur ata që më parë, edhe mua. Do të na zhdukësh për bëmën e budallenjve mes nesh? Ajo ishte prova Jote: gabon me të atë që do dhe drejton atë që do. Ti je Kujdestari ynë. Falna e mëshirona! Ti je Falësi Më i Mirë.
156. Na shkruaj të mira në këtë botë e në të ardhmen! Ne u drejtuam nga Ty.” Tha: “Me ndëshkimin Tim godas kë dua, ndërsa mëshira lme përfshin gjithçka. Ua shkruaj atyre që përmbahen, bëjnë bamirësi dhe besojnë në dëshmitë Tona;

157. që ndjekin të Dërguarin, profetin e pamësuar të cilin e gjejnë të përshkruar në Teurat e Ungjill. Ai porositi të pranueshmen dhe ndalon nga e papranueshmja, ua lejon të mirat dhe ndalon të këqiat, heq barrën e rëndë dhe prangat që u rëndojnë. Cilët e besojnë atë, e ndihmojnë, e përkrahin dhe ndjekin dritën e ardhur me të. Ata janë të suksesshmit.”
158. Thuaj: “O njerëz! Unë jam te ju të gjithë i Dërguari i Zotit, Atij që i takon sundimi i qiejve dhe i tokës. S’ka zot veç Tij. Ai ngjall e vdes. Besoni Zotin dhe të Dërguarin e Tij, Profetin e pamësuar që beson Zotin dhe fjalët e Tij. Ndiqni atë që të mund të udhëhiqeni drejt.”
159. Nga kombi i Musait ka njerëz që udhëzojnë me të vërtetën dhe me të mbajnë drejtësi.
160. I ndamë ata në dymbëdhjetë brezn si bashkësi. Kur kombi i tij kërkoi ujë, i kumtuam Musait: “Bjeri shkëmbit me shkopin tënd!” Dhe rrodhën prej tij dymbëdhjetë burime ku çdo fis dinte burimin e vet. U bëmë hije me re dhe zbritëm pranë tyre nektar e shkurtëza: “Hani nga të mirat që ju kemi dhënë!” Nuk na dhunuan Ne, por dhunuan veten.
161. Kur iu tha: “Banoni në këtë vendbanim, ushqehuni aty ku të dëshironi dhe thoni: “Ndjesë!” Hyni në portë me përlulje, t’ju falim gabimet dhe mirëbërësve t’ua shtojmë të mirat”, -
162. dhunuesit ndërruan fjalë, ndryshe nga ç’u qe thënë. Dërguam mbi ta ndëshkim nga qielli pasi dhunuan.
163. Pyeti ata rreth vendbanimit në breg të detit që dhunoi të Shtunën. U vinin balenat afër ditën e së shtunës së tyre dhe nuk u vinin ditën që s’kremtonin. I vumë në provë sepse ishin të pabindur.

164. Kur një grup mes tyre tha: “Përse këshilloni njerëz që Zoti dëshiron t’i shkatërrojë a t’i dënojë rreptë?”-
thanë: “Si ndjesë te Zoti dhe që të mund të përmbahen.”
165. Me të harruar ç’u qe bërë kujtesë, shpëtuam ata që iu shmangën së keqes dhe i morëm dhunuesit me dënim të rreptë sepse rebeluan.
166. Tek i kaluan caqet e ndaluara, u thamë: “Jini majmunë, të përçmuar!”
167. Kur yt Zot shpalli se do të dërgonte kundër tyre, deri Ditën e Ringjalljes, dikë për t’u dhënë dënimin më të keq, vërtet, Zoti yt ka ndëshkim të shpejtë, por Ai është falës, mëshirëplotë.
168. I ndamë si popuj në tokë. Prej tyresh, ka të drejtë e jo të tillë. Dhe i provuam me të mira e të këqia që të mund të ndryshonin.
169. Vazhduan pas tyre mëkëmbës që trashëguan Librin dhe marrin përfitimet e ulta të kësaj bote duke thënë: “Do të na falet!” Nëse u vjen një përfitim si ato, e marrin. Nuk u mor prej tyre Besa e Librit se do të thonë vetëm të vërtetën për Zotin ndërsa mësojnë ç’është në të? Dhe se banesa e së ardhmes është më e mirë për të devotshmit? A nuk kuptoni?
170. Ne nuk ua humbim shpërblimin të drejtëve, atyre që kapen fort te Libri dhe kryejnë të falurit.
171. Kur shkundëm malin si tendë, pandehën se po binte mbi ta. “Mbani fort çfarë ju kemi dhënë dhe kujtoni ç’është në të që të mund të përmbaheni.”
172. Kur yt Zot mori nga gjeneza e bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri të dëshmonin: “A s’jam Unë Zoti juaj?”, - thanë: “Po, me të vërtetë,

- dëshmojmë!” “Të mos thoni Ditën e Ringjalljes se ishim të pavetëdijsëm!”
173. Ose të thoni: “Bënë idhujtari etërit tanë më parë dhe ne jemi pasardhësit e tyre. A do të na zhdukësh për bëmat e njerëzve të gabuar?”
174. Kështu i shpjegojmë dëshmitë dhe që të mund të ndryshojnë.
175. Tregoju si i ndodhi dikujt që i dhamë dëshmitë Tona e u zhvesh prej tyre, ndoqi djallin dhe mori udhën e shtrembër.
176. Po të donim, e ngrenim me to, mirëpo mbeti poshtë dhe ndoqi pasionin. Si shembull për të, një qen; tek e ndërson, nxjerr gjuhën; tek e lë, nxjerr gjuhën. Ky është shembulli i njerëzve që përgënjeshtrojnë dëshmitë Tona. Tregoju shembuj që të mund të mendohen.
177. Sa i keq shembulli i njerëzve që përgënjeshtrojnë dëshmitë Tona dhe dhunuan vetveten!
178. Kë drejton Zoti, është i udhëhequr drejt; cilët lë të gabojnë, janë të humburit.
179. Shumë xhinë e njerëz ia bëmë skëterrës. Ata kanë zemra që nuk ndiejnë, sy që nuk shohin, veshë që nuk dëgjojnë. Janë si bagëtitë, edhe më të humbur. Ata janë të pavetëdijsëm.
180. Të Zotit janë emrat më të bukur, pra, thirreni me to! Lërin ata që përdhosin emrat e Tij. Do të shpërblehen me ç'bënë.
181. Nga ç'krijuam, ka njerëz që drejtojnë me të vërtetën dhe me të mbajnë drejtësi.
182. Ata që përgënjeshtrojnë dëshmitë Tona i shpiem ca nga ca ku nuk e dinë.
183. Ua shtyjme, por plani Im është i sigurt.

184. Nuk mendojnë që shoku i tyre s'është i marrë, por një paralajmërues i qartë?
185. Nuk shohin në mbretërinë e qiejve e të tokës dhe objektet që Zoti ka krijuar? Se ndoshta u afrua afati i tyre? Ç'fakt pas këtij besojnë?
186. Kë Zoti lë të gabojë, s'ka drejtues për të. Dhe i lë të çoroditen në rebelimin e tyre.
187. Të pyesin për Orën, kur arrin? Thuaj: "Dija e saj është te im Zot. Veç Tij, askush nuk mund ta zbulojë kohën e saj. Ajo rëndon në qiej e në tokë dhe ju vjen befas." Të pyesin sikur je në brendësi të saj. Thuaj: "Dija e saj është te Zoti, mirëpo të shumtët e njerëzve nuk dinë."
188. Thuaj: "Unë nuk i zotëroj vetes sime dobi a dëm, por në dashtë Zoti. Po ta dija të fshehtë, do t'i shtoja të mirat e nuk do të më prekte e keqja. Unë jam paralajmërues dhe përgëzues për njerëzit që besojnë."
189. Është Ai që ju krijoi nga një frymë e vetme, bëri prej saj palën të prehet në të. Kur e mbulon, bart një barrë të lehtë dhe ngjizet me të. Ndërsa rëndohet, i luten Allahut, Zotit të tyre: "Na dhënjë një të mirë, të jemi mirënjohës!"
190. Kur u jep një të mirë, i bëjnë shokë në çfarë u ka dhënë. I lartë është Zoti nga ç'i shoqërojnë!
191. A i shoqërojnë ç'nuk krijojnë gjë ndërsa janë të krijuar?
192. Që s'mund t'u vijnë në ndihmë, as veten të ndihmojnë?
193. Në i ftoni në udhë të drejtë, nuk ju ndjekin. Njësoj, u thirrni ose heshtni.

194. Ç'thirmni veç Zotit, janë robër si ju. Thirruni dhe le t'ju përgjigjen në thoni të vërtetën.
195. Mos kanë këmbë të ecin, duar të kapin, sy të shohin a veshë të dëgjojnë? Thuaj: "Thirruni idhujve tuaj dhe më bëni pritë e mos prisni.
196. Mbrojtësi im është Allahu, Ai që zbriti Librin. Ai i merr të mirët në mbrojtje.
197. Ç'thirmni në vend të Tij, nuk mund t'ju ndihmojnë, as veten të ndihmojnë.
198. Në i ftoni në udhë të drejtë, nuk dëgjojnë. I sheh të të vështrojnë e nuk shohin."
199. Merr faljen, porosit të mirën dhe largohu nga të paditurit!
200. Në të nxit djalli, kërko mbrojtjen e Zotit. Ai është dëgjues, dijeplotë.
201. Kur u vjen djalli rrotull, të devotshmit përmenden dhe, ja, tek vështrojnë!
202. Ndërsa "vëllamët" e tyre i fusin thellë e më thellë në gabim dhe nuk pushojnë.
203. Po s'u solle ndonjë dëshmi, thonë: "Përse nuk e sajoni?" Thuaj: "Unë ndjek çfarë më kumtohet nga im Zot. Kjo është dritë nga Zoti juaj, drejtim e mëshirë për njerëzit që besojnë."
204. Kur lexohet Kuran, dëgjojeni e vini mendjen që të mund të mëshiroheni.
205. Përmende të Zot në vetvete, mëngjeseve e mbrëmjeve, me përgjërime e drojë, jo për t'u dukur dhe mos ji i pavëmendshëm!
206. Ata pranë Zotit tënd nuk janë kryeneçë në adhurimin e Tij, i thurin lavde dhe bien për Të me krye në tokë.

8. PLAÇKA E LUFTËS (EI ENFAL)

Periudha e Medines, 75 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Të pyesin për plaçkën e luftës, thuaj: “Plaça e luftës i takon Zotit dhe të Dërguarit.” Përmbajuni Zotit dhe rregulloni marrëdhëniet mes jush. Bindjuni Zotit dhe të Dërguarit të Tij në jeni besimtarë.
2. Besimtarë janë ata që, kur përmendet Zoti, u dridhet zemra dhe, kur recitohen dëshmitë e Tij, u shtohet besimi dhe te Zoti i tyre mbështeten,
3. që kryejnë të falurit dhe kontribuojnë nga pjesa që u kemi dhënë.
4. Ata janë në të vërtetë besimtarë. Kanë pranë Zotit të tyre përparësi, falje dhe një pjesë bujare.
5. Siç edhe të nxori yt Zot nga shtëpia me të vërtetën ndërsa një pjesë besimtarësh nuk dëshironte.
6. Të kundërshtonin në të vërtetën e bërë të qartë, thuajse po shtyheshin drejt vdekjes së sigurt.
7. Kur Zoti ju premtoi njërin prej dy grupeve, dëshironit të qe juaji ai i paarmatosuri, por Zoti dëshiron të vërtetë të vërtetën me fjalët e Tij dhe t’u këpusë rrënjët mohuesve.
8. Të vërtetë të vërtetën e të zhvleftësojë të pavërtetën edhe pse e urrejnë mëkatarët.
9. Kur i thirrët Zotit tuaj në ndihmë, Ai ju përgjigj: “Unë ju përforcoj me një mijë engjëj radhë-radhë.”

10. Zoti e bëri atë sihariq dhe t'i qetësojë zemrat tuaja. Fitorja vjen prej Zotit. Zoti është i plotfuqishëm, i urtë.
11. Kur ju mbuloi me prehje e siguri prej Tij dhe zbriti nga qielli ujë, për t'ju pastruar me të e të largojë prej jush papastërtinë e djallit, jua shtrëngoi zemrat dhe forcoi këmbët.
12. Kur yt Zot u kumtoi engjëjve: "Unë jam me ju. Përforconi besimtarët! Do të lëshoj panik në zemrat e mohuesve. Qëllojuni në qafë dhe nyjëve!" -
13. kështu, sepse iu kundërvunë Zotit dhe të Dërguarit të Tij. Kush i kundërvihet Zotit dhe të Dërguarit të Tij ka ndëshkimin e rreptë të Zotit.
14. Shijojeni, pra! Mohuesit kanë dënimin e zjarrit.
15. Besimtarë, kur takoni mohuesit në marshim, mos ua ktheni shpinën.
16. Kush ua kthen shpinën atë ditë, jo si lëvizje luftimi ose për t'iu bashkuar një grupi, kthen zemërim nga Zoti dhe streha e tij është skëterra, ç'fund i keq!
17. Nuk i vratë ju, por i vrau Zoti. Kur gjuajte, nuk gjuajte ti, por gjuajti Zoti. Për t'u dhënë besimtarëve një përvojë të mirë. Zoti është dëgjues, dijeplotë.
18. Kështu, Zoti e bën të paefektshëm planin e mohuesve:
19. "Në kërkonit fitoren, ja tek ju erdhi "fitorja." "Nëse tërhiqeni, është më mirë për ju. Në ktheheni, kthehemi dhe nuk do t'i vlejë grupit tuaj edhe sikur të jetë më shumë. Zoti është me besimtarët."
20. Besimtarë! Bindjuni Zotit dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u largoni prej tij ndërsa ju dëgjoni.
21. Mos jini si ata që thonë: "Dëgjuam"- e nuk dëgjojnë.
22. Gjallesat më të këqia të Zoti janë të paveshët e të pagojët, ata që nuk kuptojnë (mohuesit).

23. Po të shihte Zoti diçka të mirë te ata, i bënë të dëgjonin. Edhe sikur t'i bënë të dëgjonin, do të ktheheshin kundërshtarë.
24. Besimtarë! Përgjigjuni Zotit dhe të Dërguarit kur ju bën thirrje që ju jep jetë. Dijeni se Zoti është mes njeriut dhe zemrës së tij dhe se te Ai do të mblidheni.
25. Ruajuni së keqes që nuk prek vetëm të këqijtë. Dhe dijeni: Zoti ka ndëshkim të rreptë.
26. Kujtoni tek ishit një pakicë e dobët në tokë, të frikësuar se mos ju shfarosnin njerëzit ndërsa Ai ju dha strehë e ju mbështeti me ndihmën e Vet, ju ushqeui me të mira që të mund të falënderoni.
27. Besimtarë! Mos tradhtoni Zotin dhe të Dërguarin e të tradhtoni me dijeni amanetet tuaja.
28. Dijeni se pasuria juaj dhe fëmijët tuaj janë provë. Zoti ka pranë Tij shpërblim të madh.
29. Besimtarë! Në qoftë se i përmbaheni Zotit, bën për ju dallim dhe jua shlyen të këqiat e ju fal. Zoti është i Mirësisë së Madhe.
30. Kur mohuesit bënë plan të të izolonin, të të vrisnin a të të dëbonin, edhe Zoti bëri një plan. Zoti planifikon më së miri.
31. Kur u recitohen dëshmitë Tona, thonë: "I kemi dëgjuar. Po të duam, themi edhe ne të tilla. Rrëfenja të të parëve."
32. Edhe kur thanë: "O Zot, në qoftë kjo e vërteta prej Teje, lëshona nga qielli shi me gurë ose sillna një dënim të hidhët!"
33. Zoti nuk i dënon duke qenë ti me ta. Zoti nuk është për dënimin e tyre kur ata mund të kërkojnë falje.
34. Përse të mos i dënojë Zoti kur pengojnë nga Faltorja e Shenjtë ndërsa s'janë kujdestarët e saj? Kujdestarë

- të saj janë vetëm ata që kanë frikë Zotin. Mirëpo të shumtët e tyre nuk dinë.
35. Falen pranë Shtëpisë me fishkëllima e përplasje duarsh. Shijoni dënimin si mohues!
 36. Mohuesit shpenzojnë pasuritë e tyre për të larguar nga Rruga e Zotit. Shpenzojnë dhe u bëhet mjerim, pastaj do të munden dhe në skëterrë mohuesit mbliidhen.
 37. Që Zoti të veçojë të keqin nga i miri, t'i vërë të këqijtë njëri mbi tjetrin, t'i grumbullojë të gjithë e t'i fusë në skëterrë. Ata janë të humburit.
 38. Thuaju mohuesve: po t'i japin fund, u falet e shkuara; në i kthehen, kaloi përvoja e të parëve.
 39. Luftojini derisa të mos ketë provokim dhe feja të jetë krejt për Zotin. Po t'i japin fund, Zoti është largpamës i veprave të tyre.
 40. Në shmangen, dijeni se Zoti është Mbrojtësi juaj. Ç'mbrojtës i mirë, ç'përkrahës i mirë!
 41. Dijeni edhe që, fituat diçka (pre lufte), një e pesta është për Zotin e të Dërguarin, për të afërmit, jetimët, të varfrit dhe rrugëtarët, në besoni Zotin dhe çfarë i shpallëm rob të Tonë Ditën e Dallimit, ditën e takimit të dy grupeve. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.
 42. Kur ju ishit në bregun e afërm, ata në bregun e largët dhe karvani poshtë jush, edhe po të kishit lënë pikëpjekje, do të mungonit. Mirëpo, që Zoti të ekzekutonte një vendim, ata që do të vdisnin, të vdisnin pas një prove të qartë; ata që do të jetonin, të jetonin pas një prove të qartë. Zoti është dëgjues, dijeplotë.
 43. Kur Zoti t'i tregoi në vizionin tënd të paktë, po t'i tregonte të shumë, do të humbisnit kurajën e të

- kundërshtonit urdhrin, mirëpo Zoti paqësoi. Ai është dijeplotë për vetë kraharorët.
44. Ndërsa jua tregoi ata, kur u takuat, të paktë në sytë tuaj dhe ju pakësoi juve në sytë e tyre, qe që Zoti të kryente një vendim. Zotit i kthehen çështjet.
 45. Besimtarë! Kur ndeshni një grup, qëndroni fort dhe përmendni Zotin shumë që të mund të fitoni.
 46. Bindjuni Zotit dhe të Dërguarit të Tij e mos u grindni, të humbisni kurajën e t'ju lërë shpirti. Dhe duroni! Zoti është me durimtarët.
 47. Mos jini si ata që dolën nga shtëpitë e tyre me bujë, për opinion të njerëzve dhe pengonin nga Rrugat e Zotit. Zoti ua rrethon veprimet.
 48. Kur djalli ua zbukuroi veprat dhe u tha: "Sot nuk ka mposhtje për ju nga njerëzit, unë jam fqinji juaj", - me t'u përballë dy grupet, u kthye nga thembrat e tha: "Jam i paangazhuar me ju. Unë shoh ç'ju nuk shihni. Unë i trembem Zotit." Zoti ka ndëshkim të rreptë.
 49. Kur hipokritët dhe zemërsëmurët thanë: "Këta i mashtroi feja e tyre", - por, në i mbështeten Zotit, Zoti është i plotfuqishëm, i urtë.
 50. Po të shihje kur engjëjt t'i vdesin mohuesit, u bien para e pas: "Shijoni dënimin në zjarrin e këndellur!
 51. Kjo, e bërë me duart tuaja. Zoti nuk është i padrejtë për robtë."
 52. Siç ndodhi me njerëzit e faraonit dhe paraardhësit: mohuan dëshmitë e Zotit dhe Zoti i mori me mëkatet e tyre. Zoti është i fuqishëm, ka ndëshkim të rreptë.
 53. Sepse Zoti nuk e ndryshon të mirën e dhënë në populli pa ndryshuar ai vetë. Zoti është dëgjues, dijeplotë.

54. Siç ndodhi me njerëzit e faraonit dhe paraardhësit: përgënjeshtroan dëshmitë e Zotit dhe Ne i zhdukëm me mëkatet e tyre dhe i mbytëm njerëzit e faraonit. Të gjithë ishin tiranë.
55. Gjallesat më të këqia te Zoti janë ata që mohuan e nuk besojnë.
56. Janë ata prej të cilëve u mor besë, thyen besën çdo herë dhe s'kanë frikë Zotin.
57. Në qoftë se i ndesh në luftë, shparatalloji ata dhe ndjekësit e tyre që të mund të përmenden.
58. Në i frikësohesh tradhtisë së njerëzve, tërhiq, gjithashtu, prej tyre. Zoti nuk i do tradhtarët.
59. Të mos kujtojnë mohuesit se kanë epërsi. Ata nuk mund të shpëtojnë.
60. Përgatitjuni atyre me forcë e kavaleri që ta tmerroni armikun e Zotit dhe armikun tuaj e të tjerë të cilët nuk i dini; Zoti i di. Ç'të kontribuoni në Rrugën e Zotit, ju plotësohet e nuk dëmtoheni.
61. Po të anojnë nga paqja, anoni edhe ju dhe mbështetuni te Zoti. Ai është Dëgjuesi, Dijeploji.
62. Në duan të të mashtrojnë, të mjafton Zoti. Ai të përforcoi me ndihmën e Vet dhe besimtarët.
63. Ai i bashkoi zemrat e tyre. Edhe sikur të kishe shpenzuar krejt çka në tokë, nuk do t'jua bashkoje zemrat, mirëpo Zoti i bashkon. Zoti është i plotfuqishëm, i urtë.
64. O Profet! Ju mjafton Zoti ty dhe besimtarëve që të pasojnë.
65. O Profet! Nxiti besimtarët për luftë. Nëse janë njëzetë të vendosur prej jush, mundin dyqint dhe, nëse janë njëqint, mundin një mijë mohues sepse ata janë njerëz që nuk kuptojnë.

66. Tashmë Zoti jua lehtësoi dhe e di se te ju ka dobësi, pra, po të jenë prej jush njëqint të vendosur, mundin dyqint dhe, po të jenë një mijë, mundin, me lejen e Zotit, dymijë. Zoti është me durimtarët.
67. Nuk është për një profet të mbajë robër pa gjakderdhje në tokë (luftë frontale). Ju dëshironi përfitimin e kësaj bote, Zoti dëshiron të ardhmen. Zoti është i plotfuqishëm, i urtë.
68. Të mos qe parathënë nga Zoti, do t'ju kishte zënë te preja që morët një dënim i madh.
69. Pra, përdorni çfarë fituat, të lejueshme e të mirë dhe kini frikë Zotin! Zoti është falës, mëshirëplotë.
70. O Profet! Thuaju robërve në dorën tuaj: "Në sheh Zoti të mirën në zemrat tuaja, ju jep më të mirë nga ç'ju është marrë dhe ju fal. Zoti është falës, mëshirëplotë."
71. Në qoftë se duan të të tradhtojnë, kanë tradhtuar Zotin më parë, prandaj Ai i mposhti. Zoti është dijeplotë, i urtë.
72. Cilët besuan, emigruan, luftuan me pasuritë dhe veten e tyre në Rrugën e Zotit dhe ata që dhanë strehë e ndihmuan janë kujdestarë të njëri-tjetrit. Ata që besojnë por s'janë shpërngulur, nuk i keni ju nën kujdestari derisa të shpërngulen. Po t'ju kërkojnë ndihmë në fe, duhet t'i ndihmoni, përjashtuar një populli me të cilin keni marrëveshje. Zoti është largpamës i veprave tuaja.
73. Edhe mohuesit janë kujdestarë të njëri-tjetrit. Nëse ju nuk do ta bënit, do të kishte në tokë persekutim dhe mosmarrëveshje të madhe.
74. Ata që besuan, emigruan, luftuan në Rrugën e Zotit dhe ata që dhanë strehë e ndihmuan janë në të vërtetë besimtarë. Për ta ka falje dhe një pjesë bujare.

75. Edhe ata që besuan më pas dhe emigruan e luftuan me ju janë prej jush. Por të gjinisë janë më afër njërit-tjetrit në Librin e Zotit (në trashëgimi). Zoti është dijeplotë për gjithçka.

9. PENDIMI (ET-TEUBE)

Periudha e Medines, 129 ajete

1. Mosangazhim i Zotit dhe i të Dërguarit të Tij nga pakti me idhujtarët:
2. “Jeni të lirë të lëvizni në tokë për katër muaj dhe dijeni se nuk mund t’i shpëtoni Zotit. Zoti i poshtëron mohuesit.”
3. Njoftim i Zotit dhe i të Dërguarit të Tij njerëzve, ditën e Haxhit të Madh: “Zoti dhe i Dërguari i Tij janë të mosangazhuar me idhujtarët: “Po të pendoheni, është më mirë për ju. Në shmangeni, dijeni se nuk mund t’i shpëtoni Zotit.” Jepu mohuesve lajmin e një dënimi të hidhët.
4. Përfjashtuar idhujtarët me të cilët keni marrëveshje dhe që nuk jua kanë mangësuar e ndihmuar dikë kundër jush. Përbushni marrëveshjen me ta, në afatin e caktuar. Zoti i do ata që përmbahen.
5. Me të mbaruar muajt e shenjtë, vritni idhujtarët ku t’i gjeni; kapini, rrethojini dhe bëjuni pritë në çdo shteg. Në qoftë se pendohen, kryejnë të falurit dhe japin detyrimin, lëshojuni udhë. Zoti është falës, mëshirëplotë.

6. Nëse ndonjëri nga idhujtarët kërkon strehim, strehoje derisa të dëgjojë Fjalën e Zotit, pastaj përcille në vend të sigurt. Sepse ata janë njerëz që nuk dinë.
7. Si mund të ketë besë për idhujtarët te Zoti dhe te i Dërguari i Tij përjashtuar atyre që u dhatë besë në Faltoren e Shenjtë? Përderisa ju qëndrojnë, qëndrojnë. Zoti i do ata që përmbahen.
8. Si, që, po të dilnin mbi ju, nuk do të respektonin gjini e marrëveshje? Ju miratojnë me gojë e refuzojnë me zemër. Të shumtët e tyre janë të pabindur.
9. Blejnë me dëshmitë e Zotit një çmim të ulët dhe pengojnë nga Rruga e Tij. Ç'të keqe bëjnë!
10. Nuk respektojnë te një besimtar gjini e marrëveshje. Ata i kalojnë kufijtë.
11. Nëse pendohen, kryejnë të falurit dhe japin detyrimin, janë vëllezërit tuaj në fe. I shpjeguar dëshmitë për njerëzit që dinë.
12. Po të thyejnë zotimet pas besës së dhënë dhe ju sulmojnë në fe, luftoni krerët e mohimit që të mund të ndalen sepse ata nuk kanë besë.
13. Nuk do të luftoni njerëz që shkelën zotimet dhe u përpoqën të dëbonin Profetin ndërsa ata ia filluan të parët me ju? U frikësoheni atyre? Zotit duhet t'i frikësoheni në jeni besimtarë.
14. Luftojini ata! Zoti do t'i ndëshkojë me duart tuaja dhe t'i poshtërojë. Ju ndihmon kundër tyre dhe shëron zemrat e besimtarëve.
15. Ai do ta largojë urrejtjen në zemrat e tyre. Zoti fal atë që do. Zoti është dijeplotë, i urtë.
16. Mos pandehët të liheni pa i ditur Zoti cilët luftuan ndër ju dhe që nuk morën të besuar veç Zotit, të Dërguarit

- të Tij dhe besimtarëve? Zoti është në dijeni të veprave tuaja.
17. Nuk u takon idhujtarëve të mirëmbajnë faltoret e Zotit, dëshmues kundër vetvetes në mohim. Janë ata që u kanë dështuar veprat, të përhershëm në zjarr.
 18. I mirëmbajnë faltoret e Zotit vetëm ata që besojnë Zotin dhe Ditën e Fundit, kryejnë të falurit, japin detyrimin dhe i frikësohen Zotit. Këta shpresohet të jenë të udhëhequr drejt.
 19. A bëni dhënien ujë haxhinjve dhe mirëmbajtjen e Faltoreve së Shenjtë si besimin te Zoti dhe Dita e Fundit dhe përpjekjen në Rrugën e Zotit? Pranë Zotit nuk janë njësoj. Zoti nuk i drejton dhunuesit.
 20. Cilët besojnë, emigrojnë dhe luftojnë në Rrugën e Zotit, me pasuritë dhe veten e tyre, janë në pozitën më të lartë pranë Zotit. Ata janë fitimtarët.
 21. Zoti i përgëzon me mëshirën dhe kënaqësinë e Vet, me kopshte ku ka për ta mirëqenie të pasosur;
 22. të përhershëm në to, përgjithmonë. Zoti ka pranë Tij shpërblim të madh.
 23. Besimtarë, mos merrni etërit dhe vëllezërit tuaj për mbrojtës nëse ata parapëlqejnë mohimin ndaj besimit. Cilët nga ju u kthehen atyre janë dhunues.
 24. Thuaj: "Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, farefisi juaj, pasuria e fituar, tregtia të cilës i frikësoheni në humbje dhe trojet që ju pëlqeni, janë më të dashura se Zoti, i Dërguari i Tij dhe përpjekja në Rrugën e Tij, prisni sa Zoti të bëjë urdhër. Zoti nuk drejton njerëzit e pabindur.
 25. Zoti ju ndihmoi në shumë fushëbeteja edhe Ditën e Hunejnit kur ju mahniti epërsia juaj e nuk ju vlejti gjë,

u ngushtua para jush toka me gjithë gjerësinë e saj dhe u kthyet në ikje.

26. Pastaj, Zoti zbriti qetësinë e Vet mbi të Dërguarin e Tij dhe besimtarët, dërgoi ushtri që nuk i shihnit dhe dënoi mohuesit. Ky është shpërblimi i mohuesve.
27. Pas kësaj, Zoti fal atë që do. Zoti është falës, mëshirëplotë.
28. Besimtarë! Idhujtarët janë të papastër, pra të mos i afrohen Faltores së Shenjtë pas këtij viti. Në i frikësoheni varfërisë, do t'ju pasurojë Zoti, në dashtë, me Mirësinë e Vet. Zoti është dijeplotë, i urtë.
29. Luftoni ithtarët e Librit që nuk besojnë Zotin dhe Ditën e Fundit, nuk ndalojnë çfarë Zoti dhe i Dërguari i Tij kanë bërë të ndaluar dhe nuk respektojnë Fenë e Vërtetë, derisa të paguajnë haraçin si të nënshtruar.
30. Judenjtë thonë: "Uzejri është biri i Zotit." Edhe të krishterët thonë: "Mesihu është biri i Zotit." Këto janë fjalë nga gojët e tyre. Përsërisin fjalët e mohuesve më parë. I vraftë Zoti si gënjehen!
31. Marrin, në vend të Zotit, rabijtë dhe murgjit për zota, edhe Mesihun, birin e Merjemit. Ndërsa u urdhëruan të adhuronin vetëm një Zot. S'ka zot veç Tij. I madhëruar është nga ç'i shoqërojnë.
32. Duan të shuajnë me gojën e tyre Dritën e Zotit, por Zoti i prapson dhe plotëson Dritën e Tij edhe pse e urrejnë mohuesit.
33. Është Ai që dërgoi të Dërguarin e Vet me drejtimin dhe Fenë e Vërtetë për të triumfuar mbi çdo fe edhe pse e urrejnë idhujtarët.
34. Besimtarë! Shumë nga rabijtë e murgjit përvetësojnë pa të drejtë pasuritë e njerëzve dhe pengojnë nga Rruga e Zotit. Cilët grumbullojnë ar e argjend dhe nuk

- e shpenzojnë në Rugën e Zotit, jepu atyre lajmin e një dënimi të hidhët.
35. Ditën kur u bie vala në zjarrin e skëterrës, damkosen me to në ballë, ijë e shpinë: “Ja, thesari juaj! Shijoni thesarin që grumbulluat!”
36. Te Zoti, numri i muajve në Librin e Zotit është dymbëdhjetë muaj, ditën që Ai krijoi qiejt e tokën. Prej tyre, katër janë të shenjtë. Kjo është feja e drejtë. Pra, mos dhunoni vetveten në to. Luftoni idhujtarët në tërësi sikurse ju luftojnë në tërësi. Dhe dijeni se Zoti është me ata që përmbahen.
37. Mosrespektimi është thellim në mohim. Gabohen me të mohuesit duke e lejuar një vit dhe ndaluar vitin tjetër, për të plotësuar numrin që Zoti bëri të shenjtë. Lejojnë çfarë Zoti ka ndaluar. U është zbukuruar e keqja në veprat e tyre. Zoti nuk i drejton mohuesit.
38. Besimtarë, ç’është me ju që, kur ju thuhet: “Dilni në Rugën e Zotit”, sikur i rëndoni tokës? Parapëlqeni jetën e kësaj bote ndaj së ardhmes? Kënaqësia e kësaj jete në të ardhmen është e vogël.
39. Po të mos dilni, ju dënon me dënim të hidhët dhe ju zëvendëson me njerëz të tjerë ndërsa ju nuk i sillni dëm Atij. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.
40. Në qoftë se nuk e ndihmoni atë, e ndihmoi Zoti kur mohuesit e nxorën jashtë vetë të dytin dhe ai i tha shokut në shpellë: “Mos u dëshpëro, Zoti është me ne!” Zoti zbriti mbi të qetësinë e Vet dhe e mbështeti me ushtri që ju nuk mund t’i shihnit. E bëri fjalën e mohuesve më të ultën. Fjala e Zotit, ajo është e larta. Zoti është i plotfuqishëm, i urtë.

41. Dilni lehtë e rëndë dhe luftoni me pasuritë dhe veten tuaj në Rugën e Zotit. Kjo është më mirë për ju sikur ta dinit.
42. Po të qe një përfitim i afërt dhe udhëtim i lehtë, do të ndiqnin, mirëpo u duket edhe më i vështirë dhe bëjnë be te Zoti se “po të mundnim, do të dilnim me ju.” Prishin veten. Zoti e di se janë gënjeshtarë.
43. Zoti të faltë! Përse u jep leje pa sqaruar se cilët thonë të vërtetën e t'i njohësh gënjeshtarët?
44. Ata që besojnë te Zoti dhe Dita e Fundit nuk të kërkojnë leje nga lufta me pasuritë dhe veten e tyre. Zoti i njeh të devotshmit.
45. Të kërkojnë leje ata që nuk besojnë te Zoti dhe Dita e Fundit, që u dyshojnë zemrat dhe luhaten në dyshim.
46. Po të donin të dilnin, do të përgatiteshin, mirëpo Zoti e urren qëndrimin e tyre, i mban dhe u thuhet: “Rrini me ata që rrinë!”
47. Po të dilnin te ju, do të shtonin mosmarrëveshje e do të hynin në radhët tuaja duke provokuar. Mes jush ka që i dëgjojnë. Zoti i njeh dhunuesit.
48. Edhe më parë kërkonin provokim dhe të t'i përmbysnin punët, derisa erdhi e vërteta dhe u manifestua urdhri i Zotit ndërsa ata e urrejnë.
49. Dikush prej tyre thotë: “Më jep leje e mos më provoko!” A nuk kanë rënë ata në provokim? Skëterra i ka qarkuar mohuesit.
50. Në të bie një e mirë, i shqetëson; në të bie një e keqe, thonë: “Ne i morëm më parë masat” - dhe kthehen të gëzuar.
51. Thuj: “Nuk na ndodh gjë pa e shkruar Zoti. Ai është Mbrotësi ynë. Zotit t'i mbështeten besimtarët!”

52. Thuaj: “Mos prisni për ne ndryshe nga dy të mirat (fitoren ose të rënë të dëshmor)? Ne presim t’ju zërë Zoti me dënim nga ana e Tij ose me duart tona. Prisni e po presim.”
53. Thuaj: “Kontribuoni me dashje a pa dashje, nuk ju pranohet. Vërtet, ju jeni njerëz të pabindur.”
54. S’i pengon tjetër t’u pranohet kontributi i tyre sepse ata mohuan Zotin dhe të Dërguarin e Tij, falen me përtesë dhe kontribuojnë të pakënaqur.
55. Mos të të habisin pasuria dhe fëmijët e tyre. Zoti do që t’i dënojë me to në jetën e kësaj bote dhe të vdesin mohues.
56. Betohen në Zotin se janë prej jush, nuk janë prej jush, por janë njerëz të trembur.
57. Sikur të gjenin strehë, ndonjë zgavër a vrimë, do të nxitonin andej.
58. Prej tyre, ka që të përgojnë në bamirësi; po u dhe, kënaqen; po s’u dhe, zemërohen.
59. Sikur të kënaqeshin me ç’u kanë dhënë Zoti dhe i Dërguari i Tij e të thonin: “Na mjafton Zoti! Zoti do të na japë me Mirësinë e Vet. Edhe i Dërguari i Tij. Te Zoti ne shpresojmë!”
60. Bamirësia (zekati) është për të varfrit, nevojtarët, mbledhësit e saj, për të fituar zemrat, për lirim të robërve, për ata në borxh, në Rrugën e Zotit dhe për udhëtarët. Urdhëresë nga Zoti. Zoti është dijeplotë, i urtë.
61. Ka prej tyre që lëndojnë Profetin duke thënë: “Ai mban vesh.” Thuaj: “Mban vesh në të mirën tuaj, beson Zotin dhe u beson besimtarëve, është mëshirë për ata që besojnë ndër ju.” Cilët lëndojnë të Dërguarin e Zotit, kanë dënim të hidhët.”

62. Ju betohen në Zotin për t'ju bërë qejfin, por Zotit dhe të Dërguarit të Tij duhet t'u bëjnë qejfin në janë besimtarë.
63. A nuk e dinë se kush u kundërvihet Zotit dhe të Dërguarit të Tij ka përgjithmonë zjarrin e skëterrës? Ky është poshtërim i madh.
64. Hipokritët ruhen se mos shpallet për ta ndonjë kapitull dhe ua zbulon zemrat. Thuaj: "Talluni! Zoti nxjerr në dukje atë që i frikësoheni."
65. Në i pyet, thonë: "Bëjmë shaka." Thuaj: "Me Zotin, me dëshmitë e Tij dhe me të Dërguarin e Tij bëni shaka?"
66. Mos u shfajësoni! Ju mohuat pasi besuat. Edhe po të falim një pjesë tuajsh, do të dënojmë një pjesë. Sepse ata janë fajtorë.
67. Hipokritët dhe hipokritet janë të njëri-tjetrit, porosisin të keqen, ndalojnë të mirën dhe mbledhin duart. Ata harruan Zotin dhe Ai i harron ata. Hipokritët, ata janë të pabindurit.
68. Zoti u ka paralajmëruar hipokritëve, hipokriteve dhe mohuesve zjarrin e skëterrës, të përhershëm në të. Mjafton për ta. I mallkoi Zoti dhe kanë dënim të vazhdueshëm.
69. Si dhe paraardhësit. Ishin më të fuqishëm, me më shumë mall e fëmijë dhe përjetuan pjesën e tyre. Edhe ju përjetoni pjesën tuaj siç përjetuan para jush pjesën e tyre dhe u morët me fjalë të kota siç u morën ata me fjalë të kota. Dështuan veprat e tyre në këtë botë e në të ardhmen. Ata janë të humburit.
70. A nuk u erdhën lajmet e pararendësve, kombit të Nuhit, Adit, Themudit, kombit të Ibrahimit, banorëve të Medjenit dhe vendbanimeve të përmbysura? U

erdhën të dërguarit me prova të qarta. Nuk i dhunoi Zoti, por dhunuan vetveten.

71. Besimtarët e besimtareve janë kujdestarë të njëri-tjetrit, këshillojnë të mirën dhe ndalojnë të keqen, kryejnë të falurit dhe japin detyrimin, u binden Zotit dhe të Dërguarit të Tij. Këta Zoti do t'i mëshirojë. Zoti është i plotfuqishëm, i urtë.
72. Zoti u premtoi besimtarëve e besimtareve kopshte ku rrjedhin lumenj, të përhershëm në to, vendbanime të këndshme në kopshtet e Edenit dhe, mbi të gjitha, kënaqësinë e Zotit. Ky është suksesi i madh.
73. O Profet! Luftoji mohuesit e hipokritët dhe ji i rreptë me ta. Streha e tyre është skëterra, ç'fund i keq!
74. Bëjnë be te Zoti se nuk kanë thënë, porse thanë fjalë mohimi dhe mohuan pasi pranuan Islamin. Dëshën t'ia arrinin ç'nuk ia arritën dhe duan të hakmerren sepse Zoti, me Mirësinë e Vet dhe i Dërguari i Tij i kanë pasuruar. Po të pendohen, është më mirë për ta; nëse kthejnë shpinën, Zoti do t'i dënojë me dënim të hidhur, në këtë botë e në të ardhmen dhe nuk kanë në tokë kujdestar e ndihmëtar.
75. Ka prej tyre që i dhanë besë Zotit se "po të na japë, me Mirësinë e Vet, do të bëjmë bamirësi e të jemi ndër të mirët."
76. Kur u dha, me Mirësinë e Vet, u ngushtuan dhe u kthyen në opozitë.
77. Ua pasoi me hipokrizi në zemrat e tyre deri Ditën e Takimit me Të sepse thyen besën e dhënë Zotit dhe ishin gënjeshtarë.
78. Nuk e dinë se Zoti njih sekretet dhe bisedat e tyre kokë më kokë? Që Zoti di gjithë të fshehtat?

79. Cilët përgojnë besimtarët vullnetarë në bamirësi dhe ata që nuk gjejnë tjetër veç mundit të tyre e tallen me ta, i shpërfill Zoti dhe kanë dënim të hidhur.
80. Kërkon apo nuk kërkon falje për ta, edhe sikur të kërkoje falje për ta shtatëdhjetë herë, Zoti nuk do t'i falë, sepse mohuan Zotin dhe të Dërguarin e Tij. Zoti nuk drejton njerëzit e pabindur.
81. Të prapambeturit u gëzuan që mbetën prapa të Dërguarit të Zotit, nuk u pëlqente të luftonin me pasuritë dhe veten e tyre në Rugën e Zotit dhe thanë: "Mos dilni në të nxehtë!" Thuaj: "Zjarri i skëterrës është më i nxehtë", - nëse mund ta kuptojnë.
82. Le të qeshin pak e të qajnë shumë si shpërblim që fituan.
83. Në qoftë se Zoti të kthen te një kastë e tyre dhe të lypin leje për të dalë, thuaj: "Nuk do të dilni kurrë me mua dhe nuk do të luftoni armik me mua. Ju pëlqeu të rrinit herën e parë, rrini pra me të prapambeturit."
84. Dhe kurrë mos u lut në funeralin e ndonjërit prej tyre dhe mos qëndro pranë varrit të tij. Ata mohuan Zotin dhe të Dërguarin e Tij dhe vdiqën të pabindur.
85. Mos të të mashtrojnë pasuria dhe fëmijët e tyre. Zoti do që t'i dënojë me to në këtë botë dhe t'u dalë shpirti si mohues.
86. Kur shpallet ndonjë kapitull që të besoni Zotin dhe të luftoni bashkë me të Dërguarin e Tij, të kamurit ndër ta të kërkojnë leje dhe thonë: "Lërna me ata që do të rrinë!"
87. U pëlqen të jenë me shtëpiakët. Iu vulosën zemrat dhe nuk kuptojnë.

88. Por i Dërguari dhe besimtarët me të luftojnë me pasuritë dhe veten e tyre. Të mirat janë për ta. Ata janë të suksesshmit.
89. Zoti u përgatiti kopshte ku rrjedhin lumenj, të përhershëm në to. Ky është suksesi i madh.
90. Erdhën disa beduinë duke u shfajësuar për leje dhe qëndruan ata që gënjyen Zotin dhe të Dërguarin e Tij. Mohuesit ndër ta do t'i zërë një dënim i hidhët.
91. Nuk detyrohen të paaftët, të sëmurët dhe ata që s'kanë me se të kontribuojnë, të sinqertë ndaj Zotit dhe të Dërguarit të Tij. Nuk ka udhë ndaj të ndershmëve. Zoti është falës, mëshirëplotë.
92. Edhe ndaj atyre që erdhën t'i bartje dhe u the se nuk gjeje me se t'i bartje dhe u që u kthyen me sy të përlotur e të dëshpëruar sepse nuk kishin si të kontribuonin.
93. Ka udhë ndaj atyre që të kërkuan leje duke qenë të pasur. Sepse u pëlqen të jenë me shtëpiakët. Zoti ua vulosi zemrat dhe nuk kuptojnë.
94. Kur të ktheheni te ata, ju shfajësohen. Thuaj: "Mos u shfajësoni se s'ju besojmë. Zoti na njoftoi për ju. Zoti dhe i Dërguari i Tij do ta shohin punën tuaj. Pastaj i ktheheni Njohësit të së padukshmes e të dukshmes dhe ju njofton se ç'keni bërë.
95. Kur u riktheheni, ju bëjnë be te Zoti t'i lini mënjanë. Lini, pra, mënjanë! Sepse ata janë njollë dhe streha e tyre është ferri, shpërblimi që fituan.
96. Ju bëjnë be që të kënaqeni prej tyre. Por, nëse kënaqeni prej tyre, Zoti nuk kënaqet nga njerëzit e pabindur.

97. Beduinët janë më të rreptët në mohim e hipokrizi dhe më të dhënë në mosnjohjen normave që Zoti ia zbriti të Dërguarit të Vet. Zoti është dijeplotë, i urtë.
98. Ka beduinë që e marrin kontributin si gjobë dhe presin për ju radhën. Radha e së keqes është te ata. Zoti është dëgjues, dijeplotë.
99. Ndër beduinët, ka që besojnë Zotin dhe Ditën e Fundit dhe e marrin kontributin e tyre si afrim te Zoti dhe bekimin e Profetit. A nuk është afrim për ta? Zoti do t'i pranojë në Mëshirën e Vet. Zoti është falës, mëshirëplotë.
100. Zoti është i kënaqur me pararendësit e emigrantëve dhe ndihmëtarëve dhe me pasuesit e tyre në vepra të mira. Edhe ata janë të kënaqur prej Tij. Ai u ka përgatitur kopshte ku rrjedhin lumenj, të përhershëm në to, përgjithmonë. Ky është sukses i madh.
101. Edhe rreth jush ka beduinë dhe bashkëqytetarë hipokritë, të regjur në hipokrizi. Ti nuk i njeh, Ne i njohim. Do t'i dënojmë dy herë, pastaj i kthehen një dënimi të madh.
102. Të tjerë që i kanë pranuar mëkatet, përziejnë punët e mira me të këqiat. Ndoshta Zoti i fal. Zoti është falës, mëshirëplotë.
103. Merr nga pasuritë e tyre bamirësi, t'i pastrosh e t'i çlirosh me të dhe lutu për ta. Lutja jote është qetësim për ta. Zoti është dëgjues, dijeplotë.
104. Nuk e dinë se Zoti është Ai që pranon pendimin e robërve të Vet dhe merr bamirësitë? Zoti është Pranuesi i pendimit, Mëshirëploti.
105. Thuaj: "Punoni dhe Zoti do t'i shohë punët tuaja, edhe i Dërguari i Tij dhe besimtarët. Dhe do t'i ktheheni

- Njohësit të së padukshmes e të dukshmes dhe t'ju njoftojë për veprat.”
106. Të tjerë, në pritje të urdhrit të Zotit: i dënon apo i fal. Zoti është dijeplotë, i urtë.
 107. Edhe të tjerë që bënë xhami sherri, mohimi e ndasie mes besimtarëve, një pusi e atij që luftoi më parë Zotin dhe të Dërguarin e Tij. Betohen se kanë qëllim të mirë. Zoti dëshmon se ata janë gënjeshtarë.
 108. Mos qëndro kurrë aty! Meriton të qëndrosh në të, faltorja e themeluar të parën ditë mbi devocion (Mesxhid'ul takva në Kuba). Aty ka burra që dëshirojnë të dëliren. Zoti i do të dëlirët.
 109. Kush është më i mirë, ai që themelon ngrehinën e vet mbi devocion dhe kënaqësi nga Zoti apo që ngre ngrehinën buzë një shpati të shembur dhe shembet bashkë me të në zjarrin e skëterrës? Zoti nuk i drejton dhunuesit.
 110. Ngrehina që ata ngritën nuk do të pushojë së qeni ankth në zemrat e tyre derisa t'u bëhen zemrat copë. Zoti është dijeplotë, i urtë.
 111. Zoti ka blerë nga besimtarët veten e tyre dhe pasuritë e tyre me parajsë. Luftojnë në Rrugën e Zotit, vrasin e vriten. Premtim i vërtetë i Tij në Teurat, Ungjill e Kuran. Kush e përmbush besën veç Zotit? Përgëzohuni me shitblerjen që keni bërë! Ky është suksesi i madh.
 112. Përgëzoji besimtarët: të penduarit, adhuresit, falënderuesit, agjëruarit, ata që përkulen dhe bien me krye në tokë, që porositin të mirën dhe ndalojnë të keqen, që ruajnë kufijtë e Zotit.

113. Nuk u takon Profetit dhe besimtarëve të kërkojnë falje për idhujtarët, qofshin të afërm, pasi u është bërë e qartë se ata janë banorët e ferrit.
114. Nuk i takonte Ibrahimit të kërkonte falje për të atin, por ishte një premtim që ai pati bërë. Kur iu sqarua se ishte armik i Zotit, u çlirua prej tij. Ibrahim i qe i përvuajtur, i butë.
115. Zoti nuk është për ta lënë të humbur një popull pasi e drejtoi, derisa t'ia ketë bërë të qartë ku të përmbahet. Zoti është dijeplotë për çdo gjë.
116. Zotit i takon sundimi i qiejve dhe i tokës; Ai ngjall e vdes dhe nuk keni, veç Zotit, kujdestar e përkrahës.
117. Zoti ua fali Profetit, emigrantëve, ndihmëtarëve dhe atyre që e ndoqën atë në orë të vështirë kur gati u luhatën zemrat e një pjese prej tyre. Dhe ua pranoi pendimin. Ai është për ta i dhembshur, mëshirëplotë.
118. Sa për ata të tre, të mbetur pas (Ka'ab bin Malik, Hilal bin Umejje, Murereh bin Rubai), kur iu ngushtua toka me gjithë gjerësinë e saj dhe u ndrydhën shpirtrat e tyre, besuan se nuk ka strehë ndaj Zotit, por vetëm tek Ai. Pastaj Ai i fali që ata të mund të pendoheshin. Zoti është Falësi, Mëshirëploti.
119. Besimtarë, përmbajuni Zotit dhe jini me ata që thonë të vërtetën.
120. Nuk është për banorët e Medines dhe beduinët fqinj të mbesin prapa të Dërguarit të Zotit e të parapëlqejnë veten e tyre nga ajo e tij. Sepse ata nuk i zë etje, lodhje e uri në Rrugën e Zotit, nuk bëjnë ndonjë hap që i tërbon mohuesit dhe nuk u ndodh gjë nga armiku pa u shkruar për ta si vepër e mirë. Zoti nuk ua humb shpërblimin mirëbërësve.

121. As nuk japin kontribut të vogël a të madh dhe nuk kalojnë ndonjë shpat pa ua shpërblyer Zoti më së miri për veprën e tyre.
122. Nuk duhet të dalin të gjithë besimtarët. Le të dalin nga çdo njësi disa që të marrin njohuri në fe dhe, kur të kthehen, të instruktojnë njerëzit e tyre që ata të mund të ruhen.
123. Besimtarë! Luftoni mohuesit afër jush dhe le të gjejnë te ju rreptësi. Dijeni se Zoti është me të devotshmit.
124. Kur zbret një sure, ka nga ata që thonë: “Cilit prej jush ia shtoi besimin?” Sa për besimtarët, ua shton besimin dhe përgëzohen.
125. Sa për zemërsëmurët, u shton njollë në njollën e tyre dhe vdesin mohues.
126. Nuk shohin se po vihen në provë çdo vit, një herë, dy herë dhe përsëri s'pendohen, as nxjerrin mësim?
127. Kur shpallet një sure, vështrojnë njëri-tjetrin: “Mos ju ka parë kush?” Pastaj lakojnë. Zoti ua lakoi zemrat sepse janë njerëz që nuk kuptojnë.
128. Ju erdhi i dërguar mes jush, i vuajtur me vuajtjet tuaja, lakmues për ju, i dhembshur, mëshirëplotë me besimtarët.
129. Në qoftë se largohen, thuaj: “Më mjafton Zoti - s'ka zot veç Tij - Atij iu mbështeta. Ai është Zoti i Fronit Madhështor.

10. JUNUSI (JUNUS)

Periudha e Mekës, 109 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Elif, lam, ra. Këto janë dëshmitë e Librit të Urtë.

2. Mos është çudi për njerëzit t'i kumtojmë një burri mes tyre që të paralajmërojë njerëzimin dhe t'i përgëzojë besimtarët se kanë perspektivë të vërtetë pranë Zotit të tyre? Mohuesit thonë: “Ky është magjibërës i qartë.”
3. Zoti juaj është Allahu i cili krijoi qiejt e tokën në gjashtë ditë, pastaj përqendroi pushtetin dhe vuri rendin. Nuk ka ndërmjetës pa lejen e Tij. Ky është Allahu, Zoti juaj. Adhuroni atë! A nuk mendoheni?
4. Kthimi i ju të gjithëve është tek Ai, premtim i vërtetë i Zotit. Ai zë fill krijimin, pastaj e rikthen, për t'i shpërblyer me drejtësi ata që besuan e bënë të mira. Ndërsa mohuesit kanë pije uji të valë dhe dënim të hidhët pasi mohuan.
5. Është Ai që bëri diellin-rrezatues dhe hënën-dritë, e ndau atë në faza që të njihni numërimin vjetor dhe përlllogaritjen. Zoti i krijoi këto me të vërtetën. I shpjegon dëshmitë për njerëzit që dinë.
6. Në ndërrimin e natës e të ditës dhe krijimin e Zotit në qiej e tokë, ka dëshmi për njerëzit që përmbahen.
7. Ata që nuk e presin takimin Tonë dhe pëlqejnë e kënaqen me jetën e kësaj bote, të shkujdesur ndaj dëshmimeve Tona,
8. kanë si fitim zjarrin-strehë.
9. Cilët besojnë e bëjnë të mira, Zoti i udhëheq me besimin e tyre. Rrjedhin ndër ta lumenj në kopshtet e begata.
10. Thirrja e tyre atje është: “Madhëruar qofsh, o Zot”, përshëndetja e tyre: “Paqe” dhe, në fund, thirrja: “Lavdi Allahut, Zotit të botëve!”
11. Sikur Zoti t'ua nxitonte njerëzve të keqen siç kërkojnë me ngut të mirën, ishte kryer afati i tyre. Ata që nuk e

presin takimin Tonë i lëmë të enden të verbuar në rebelimin e tyre.

12. Kur njeriun e zë e keqja, na lutet mënjane, ulur ose më këmbë; sapo ia largojmë të keqen, kalon sikur nuk na u lut për ndonjë hall. Kështu iu zbukuruan shpërdoruesve punët e tyre.
13. Zhdukëm brezni para jush kur dhunuan dhe u erdhën të dërguarit me prova të qarta e nuk besuan. Kështu ua shpërblejmë mëkatarëve.
14. Ju bëmë, pas tyre, mëkëmbës në tokë që të shohim si veproni.
15. Kur u lexohen dëshmitë Tona të qarta, cilët nuk presin takimin Tonë, thonë: “Sillna një këndim tjetër ose ndryshoj!” Thuaj: “Nuk më takon mua ta ndryshoj. Unë ndjek ç’më kumtohet. Në i kundërshtoj tim Zoti, i trembem dënimit të një dite të madhe.”
16. Thuaj: “Po të deshte Zoti, nuk do t’jua recitoja dhe Ai nuk do t’jua kishte bërë të njohur. Qëndrova pranë jush një jetë të tërë më parë. A nuk kuptoni?”
17. Kush është më dhunues se ai që trillon gënjeshtër ndaj Zotit ose përgënjeshton dëshmitë e Tij? Mëkatarët nuk kanë sukses.
18. Adhurojnë në vend të Zotit çfarë s’u bën dëm e dobi dhe thonë: “Këta janë ndërmjetësit tanë pranë Zotit.” Thuaj: “Ia bëni Zotit të njohur të panjohurat në qiej e në tokë?” I madhëruar dhe i lartë nga ç’i shoqërojnë!
19. Njerëzit ishin një bashkësi dhe ranë në mospajtim. Të mos qe parathënë nga yt Zot, do të merrte fund mospajtimi i tyre.
20. Thonë: “Përse nuk i zbriti një shenjë nga Zoti i tij?” Thuaj: “E fshehta i takon Zotit. Prisni! Edhe unë po pres me ju.”

21. Kur njerëzit i bëjmë të shijojnë mëshirë, pasi ranë në vështirësi, ja tek sajojnë plane në dëshmitë Tona!
Thuaj: “Zoti planifikon më shpejt.” Lajmësit Tanë i shkruajnë çfarë sajojnë.
22. Është Ai që ju bëri të udhëtoni në tokë e në det.
Derisa, kur jeni në anije dhe lundrojnë në erë të mbarë, i gëzohen; vjen një uragan me dallgë anëmbanë dhe mendojnë se s'kanë shpëtim. I luten Zotit me besim për Të: “Po na shpëtove nga kjo, të jemi falënderues!”
23. Kur i shpëton, rebelojnë me pa të drejtë në tokë. O njerëz, rebelimi është kundër jush, një dukuri e jetës së kësaj bote. Pastaj, kthimi juaj është te Ne dhe ju vëmë në dijeni se çfarë keni bërë.
24. Shembulli i jetës së kësaj bote, si ujët që zbresim nga qielli dhe plekset me të bimësia e tokës prej ku ushqehen njerëzit e kafshët. Dhe, kur toka të ketë marrë stolinë e saj e të jetë zbukuruar dhe njerëzit e saj të mendojnë se janë të pushtetshëm mbi të, vjen Urdhri Ynë natën a ditën dhe e bëjmë të kositur, si të mos kishte lulëzuar një ditë më parë. Kështu i shpjegojmë dëshmitë për njerëzit që mendojnë.
25. Zoti fton në Banesën e Paqes dhe udhëheq me dashjen e Tij në udhë të drejtë.
26. Cilët bëjnë mirë, kanë më të mirën, edhe më shumë. Nuk ua zënë fytyrën çehrja e zezë dhe poshtërimi. Ata janë banorët e parajsës, të përhershëm në të.
27. Cilët fitojnë të këqiat, - shpërblimi i së keqes është me të, - i zë poshtërimi. Nuk kanë nga Zoti mbrojtës. Fytyrat e tyre janë si t'i kenë mbuluar copëza të errëta nate. Ata janë banorët e zjarrit, të përhershëm në të.

28. Ditën që i tubojmë të gjithë, u themi idhujtarëve: “Ja vendi juaj dhe i idhujve tuaj!” Bëjmë mes tyre ndarje. U thonë idhujt: “Nuk na adhurovat ne!”
29. Mjafton Zoti dëshmuës mes nesh e jush se ishim të pavetëdijshëm në adhurimin tuaj.”
30. Atje, çdo frymë do të përjetojë të kaluarën. I kthehen Zotit, zotërisë së tyre të vërtetë dhe u zhduken ç'trilluan.
31. Thuaj: “Kush ju ushqen prej qiellit e tokës, kush zotëron të dëgjuarit e të parët, kush nxjerr të gjallin nga i vdekuri dhe nxjerr të vdekurin nga i gjalli, kush rregullon çështjet?” Do të thonë: “Zoti.” Thuaj: “A nuk përmbaheni?”
32. Ky është Allahu, Zoti juaj i vërtetë. Ç’është pas së vërtetës veç të rremes? Si largoheni?
33. Vërtetohet kështu fjala e tët Zoti për mëkatarët se ata nuk besojnë.
34. Thuaj: “Cili nga idhujt tuaj zë fill krijimin, pastaj e përsërit?” Thuaj: “Zoti zë fill krijimin, pastaj e përsërit. Si largoheni?”
35. Thuaj: “A ka ndër idhujt tuaj që udhëheq te e vërteta?” Thuaj: “Zoti udhëheq te e vërteta. Kush meriton të ndiqet, ai që udhëheq te e vërteta apo ç’nuk udhëheq veç në udhëhiqet? Përse gjykoni kështu?”
36. Të shumtët e tyre shkojnë me hamendje. Por hamendja nuk vlen te e vërteta. Zoti e di se ç'bëjnë.
37. Ky Kuran nuk është që mund të sajohet prej dikujt, veç Zotit, porse është vërtetim i shkrimeve të tjera, shpjegues i Librit, pa dyshim nga Zoti i botëve.
38. Thonë se e sajoi ai? Thuaj: “Sillni një sure si të tij dhe ftoni kë të mundni, veç Zotit, në thoni të vërtetën.”

39. Përgënjeshtrojnë çka nuk e përfshijnë me dije dhe pa u ardhur ende domethënia e saj. Kështu përgënjeshtrojnë më parë dhe shih si që fundi i dhunuesve.
40. Prej tyre, ka që e besojnë dhe, prej tyre, ka që nuk e besojnë. Zoti i njeh më mirë keqbërësit.
41. Në të përgënjeshtrojnë, thuaj: “Për mua është vepra ime dhe për ju, vepra juaj. Ju jeni të çliruar nga vepra ime dhe unë, i çliruar nga vepra juaj.”
42. Prej tyre, ka që bëjnë sikur të dëgjojnë. A ti i bën të paveshët të dëgjojnë nëse nuk kuptojnë?
43. Prej tyre, ka që shohin nga ty. Ti u prin të verbërve nëse nuk vështrojnë?
44. Zoti nuk u bën njerëzve padrejtësi, porse njerëzit i bëjnë padrejtësi vetvetes.
45. Ditën që i tubojmë, si të mos kishin qëndruar më se një orë dite, njohin njëri-tjetrin. Kanë humbur ata që përgënjeshtrojnë takimin e Zotit dhe nuk u udhëhoqën drejt.
46. Edhe sikur të të bëjmë të shohësh ç’u paralajmëruam ose të të vdesim, te Ne është kthimi i tyre. Zoti është dëshmuar i veprave të tyre.
47. Çdo popull ka një lajmës. Kur u vjen lajmësi, vendoset mes tyre me paanësi dhe nuk u bëhet e padrejtë.
48. Dhe thonë: “Kur është ky paralajmërim në thoni të vërtetën?”
49. Thuaj: “Unë nuk i zotëroj vetes sime dëm a dobi, por atë që do Zoti. Çdo bashkësi ka një afat. Kur vjen afati, s’mund ta vonojnë një orë e ta nxitojnë.”
50. Thuaj: “E kuptoni që, po t’ju vijë dënimi i Tij natën a ditën, ç’do të nxitojnë mëkatarët?”

51. Në ndodhtë, a do ta besoni? Ndërsa e kërkuat me ngut?
52. Pastaj, u thuhet dhunuesve: “Shijoni dënimin e pafund! A nuk u shpërblyet me ç’fituat?”
53. Duan ta dinë prej teje në është e vërtetë?” Thuaj: “Po, për tim Zot, është e vërtetë! Dhe nuk mund t’i shpëtoni.”
54. Edhe sikur të ketë gjithçka në tokë, një frymë që dhunoi s’mund të shpërblejë me të. Përpiqen të fshehin pendimin kur shohin dënimin, por do të vendoset mes tyre me drejtësi dhe nuk u bëhet e padrejtë.
55. Nuk i takojnë Zotit ç’janë në qiej e në tokë? A s’është i vërtetë premtimi i Zotit? Mirëpo të shumtët e tyre nuk dinë.
56. Ai jep jetë e vdes dhe i ktheheni Atij.
57. O njerëz! Ju erdhi këshillë nga Zoti juaj, shërim i zemrave, drejtim e mëshirë për besimtarët.
58. Thuaj: “Mirësisë dhe mëshirës së Zotit le t’u gëzohen! Kjo është më e mirë nga ç’grumbullojnë.”
59. Thuaj: “E shihni çfarë Zoti ka zbritur ushqim për ju dhe e bëni atë të ndaluar e të lejuar?” Thuaj: “Zoti jua lejoi apo trilloni ndaj Zotit?”
60. Ç’mendojnë ata që trillojnë gënjeshtër ndaj Zotit për Ditën e Ringjalljes? Zoti është i mirësisë ndaj njerëzve, por të shumtët nuk falënderojnë.
61. Kudo qofshi, duke recituar Kuran a kryer ndonjë aktivitet, Ne jemi të pranishëm në aktivitetin tuaj. Tët Zoti nuk i shpëton edhe një grimë në tokë e në qiell, as më e vogël e më e madhe, pa qenë në libër të qartë.

62. A nuk, vërtet, miqtë e Zotit s'kanë frikë e dëshpërohen?
63. Që besojnë e përmbahen?
64. Ata kanë sihariq në këtë jetë e në të ardhmen. Fjalët e Zotit nuk tjetërsohen. Ky është sukses i madh.
65. Mos të të dëshpërojë fjala e tyre. Fuqia është krejt e Zotit. Ai është Dëgjuesi, Dijeploiti.
66. A nuk i takojnë Zotit ç'janë në qiej e në tokë? Cilët lusin në vend të Zotit idhuj, shkojnë me hamendje dhe vetëm se gënjejnë.
67. Është Ai që bëri për ju natën prehje dhe ditën dritë. Këtu ka dëshmi për njerëzit që dëgjojnë.
68. Thonë: "Zoti ka bërë bir." Madhëruar qoftë! Ai është i Vetëmjaftueshmi. Atij i takojnë ç'janë në qiej e në tokë. Ju nuk keni argument për këtë. A thoni për Zotin çfarë nuk dini?
69. Thuaj: "Cilët trillojnë gënjeshtër ndaj Zotit, s'kanë sukses."
70. Një dukuri kalimtare në këtë botë. Pastaj, te Ne është kthimi i tyre dhe i bëjmë të shijojnë dënimin e rreptë sepse mohuan.
71. Recitoju ngjarjen e Nuhit kur i tha kombit të tij: "Kombi im! Po të jenë të rënda për ju qëndrimi im dhe kujtesa e dëshmive të Zotit, unë iu mbështeta Zotit, ndërsa ju bëni një plan të përbashkët me idhujt tuaj dhe të mos jetë plani juaj brengë për ju, pastaj zbatojeni te unë e mos prisni.
72. Në u shmangët, unë nuk ju kërkova shpërblim. Shpërblimi im është te Zoti dhe u urdhërova të jem musliman.
73. E përgënjeshtroan, por Ne shpëtuam atë dhe ç'qenë me të në anije, i bëmë mëkëmbës dhe i mbytëm ata

- që përgënjeshtroan dëshmitë Tona. Shih si qe fundi i atyre që u paralajmëruan!
74. Dërguam, pas tij, të dërguar te kombet e tyre, që u erdhën me prova të qarta, por ata nuk deshën të besonin ç'kishin përgënjeshtroar më parë. Ua vulosëm, kështu, zemrat atyre që e tejkaluan.
75. Pas tyre, dërguam Musanë dhe Harunin me dëshmitë Tona te faraoni dhe krerët e tij, por ata u treguan kryeneçë dhe ishin komb mëkatar.
76. Kur u erdhi e vërteta nga ana Jonë, thanë: "Kjo është magji e qartë."
77. Musai tha: "A thoni për të vërtetën që ju erdhi? Magji është kjo? Magjistarët nuk kanë sukses."
78. Thanë: "Erdhe të na largosh nga tradita e të parëve tanë dhe t'ju mbesë ju të dyve madhështia në tokë? Ne nuk ju besojmë."
79. Faraoni tha: "Më sillni çdo magjistar të ditur!"
80. Kur erdhën magjistarët, Musai u tha: "Hidhni ç'keni për të hedhur!"
81. Kur hodhën, Musai tha: "Kjo është magji dhe Zoti e bën atë të pavlefshme. Zoti nuk mbarëson punën e keqbërësve.
82. Me fjalët e Tij, Zoti vë në jetë të vërtetën edhe pse e urrejnë mëkatarët."
83. I besoi Musait vetëm brezi i ri i kombit të vet nga frika e persekutimit të faraonit dhe krerëve të tij. Faraoni qe tiran në tokë, shpërdorues.
84. Musai tha: "Kombi im! Po t'i keni besuar Zotit, Atij mbështetjuni në jeni muslimanë."
85. Thanë: "Iu mbështetëm Zotit. Zoti ynë, mos na bëj provë për popullin dhunues.
86. Shpëtona me mëshirën Tënde nga populli mohues!"

87. U kumtuam Musait e të vëllait: “Bëni shtëpi për njerëzit tuaj në Egjipt, shtëpitë tuaja bëjini drejtim, kryeni të falurit dhe përgëzoji besimtarët!”
88. Musai tha: “Zoti ynë, Ti u ke dhënë faraonit dhe krerëve të tij stoli e pasuri në këtë botë, Zoti ynë, që të largojnë të tjerët nga Rruga Jote. Zoti ynë, zhduke pasurinë e tyre dhe bëji të ashpra zemrat e tyre, të mos besojnë derisa të ballafaqohen me dënimin e hidhët!”
89. Tha: “Lutja juaj ka marrë përgjigje. Jini të vendosur dhe mos ndiqni udhën e të paditurve!”
90. I kaluam në det bijtë e Izraelit ndërsa faraoni dhe trupat e tij i ndiqnin me urrejtje e armiqësi. Kur po mbytej, tha: “Besoj se s’ka zot tjetër veç Atij që besojnë bijtë e Izraelit. Edhe unë jam i dorëzuar te Zoti!”
91. Tani, që kundërshtove më parë dhe ishe keqbërës?
92. Sot po shpëtojmë kufomën tënde, të jesh për pasardhësit një dëshmi. Shumë njerëz janë të shkujdesur ndaj dëshmimeve Tona.
93. U bëmë bijve të Izraelit vendbanim të vërtetë, i ushqyem me të mira, por ranë në kundërshti kur u erdhi dija. Yt Zot do të vendosë mes tyre Ditën e Ringjalljes se ku ranë në kundërshti.
94. Po të jesh në dyshim rreth shpalljes, pyeti ata që lexojnë Librin para teje. Të erdhi e vërteta nga yt Zot dhe mos ji dyshues!
95. Mos ji prej atyre që përgënjeshtroan dëshmitë e Zotit e të jesh i humbur.
96. Ata që u është përligjur fjala e tët Zoti nuk besojnë,
97. edhe po t’u vijë çdo dëshmi, derisa të ballafaqohen me dënimin e hidhur.

98. Sikur të mos kishte veç kombit të Junusit ndonjë vendbanim tjetër që besoi dhe i vlejti besimi! Kur besuan, ua hoqëm dënimin poshtërues në këtë botë dhe i bëmë të jetonin deri në një kohë.
99. Po të deshte yt Zot, do të besonin të gjithë në tokë. Ti do t'i detyrosh njerëzit të besojnë?
100. Nuk mund të besojë një frymë pa lejen e Zotit. Ai u vë njollë atyre që s'kuptojnë.
101. Thuaj: "Pa shihni nga qiejt e toka! Dëshmitë dhe vërejtjet nuk i vlejné një populli që s'beson."
102. Mos presin ditët e atyre që kaluan më parë? Thuaj: "Prisni! Edhe unë jam me ju në pritje."
103. Pastaj i shpëtojmë të dërguarit Tanë dhe besimtarët. Kështu, na takon Neve t'i shpëtojmë besimtarët.
104. Thuaj: "O njerëz! Po të jeni në dyshim rreth fesë sime, unë nuk adhuroj çfarë adhuron ju në vend të Zotit. Porse adhuroj Zotin i cili ju vdes. Dhe u urdhërova të jem ndër besimtarët.
105. Pra, drejto fytyrën tënde te feja, i vendosur dhe mos ji ndër idhujtarët!
106. Mos lut, në vend të Zotit, ç'nuk të sjell dobi e dëm. Përndryshe do të ishe ndër të padrejtët (idhujtarët)
107. Nëse Zoti të prek me dhimbje, askush veç Tij s'mund ta largojë. Në ta do të mirën, nuk kthehet pas Mirësia e Tij. Ia arrin atij që do ndër robtë e Vet. Ai është Falësi, Mëshirëploti."
108. Thuaj: "O njerëz! Ju erdhi e vërteta nga Zoti juaj. Kush drejtohet, u drejtua për vete; kush shmanget, iu shmang vetes. Unë nuk jam ndaj jush dorëzanës."
109. Ndiq çfarë të kumtohet dhe duro sa të vendosë Zoti. Ai është Më i Miri Gjykatës.

11. HUDI (HUD)

Periudha e Mekës, 123 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Elif, lam, ra. Libër, dëshmitë e të cilit u gjykuan dhe u shtjelluan nga një i Urtë, i Gjithëditur.
2. “Të adhuron vetëm Zotin! Unë jam për ju, nga ana e Tij, paralajmërues dhe përgëzues.
3. T’i kërkoni falje Zotit e t’i pendoheni Atij. Ai ju bën të jetoni jetë të dobishme, në afat të caktuar dhe ia jep të mirit Mirësinë e Vet. Nëse largoheni, i frikësohem për ju dënimit të një dite të madhe.
4. Te Zoti është kthimi juaj. Ai është mbi gjithçka pushtetplotë.” (Fjalët e Zotit vënë në gojën e të dërguarit të Tij)
5. Bëhen më dysh t’i fshihen Atij. Edhe kur hedhin petkun, a nuk e di Ai çfarë fshehin e zbulojnë? Ai është dijeplotë për vetë kraharorët.
6. Nuk ka gjallesë në tokë të mos ketë ushqimin te Zoti. Ai di vendqëndrimin dhe vendkalimin e saj. Gjithçka është në libër të qartë.
7. Është Ai që krijoi qiejt e tokën në gjashtë ditë ndërsa pushteti i Tij ishte mbi ujë. Për t’ju provuar në vepra të mira. Kur thua: “Me të vërtetë, ju do të ringjallen pas vdekjes”, - mohuesit thonë: “Kjo është magji e qartë.”
8. Nëse ua vonojmë dënimin për një kohë, do të thonë: “Ç’e mban?” A nuk u vjen një ditë e pashmangshme dhe t’i zërë shpërfillja e tyre?

9. Në e bëjmë njeriun të shijojë mëshirën Tonë dhe pastaj ia largojmë, ja tek është i dëshpëruar, mosmirënjohës!
10. Në e bëjmë të shijojë, pas vështirësisë, mirëqenie, patjetër do të thotë: "Ikën të këqiat prej meje!" Ai është entuziast, i vetëkënaqur.
11. Por jo ata që durojnë e bëjnë të mira. Për ta ka falje e shpërblim të madh.
12. Ndoshta do të hiqje diçka nga ç't'u kumtua ndërsa të ngushtohet zemra kur thonë: "Përse nuk i zbriti ndonjë thesar a të vinte me të një engjëll?" Ti je vetëm një paralajmërues. Zoti është në çdo gjë dorëzanës.
13. Ose kur thonë: "Ai e sajoi." Thuaj: "Sillni dhjetë sure të sajua si ato dhe ftoni kë të mundni, veç Zotit, në thoni të vërtetën."
14. Po të mos ju përgjigjen, dijeni se është shpallur me dijen e Zotit. Nuk ka zot veç Tij. A jeni të dorëzuar?
15. Cilët dëshirojnë jetën e kësaj bote dhe stolinë e saj, atyre ua shpërblejmë veprat në të e nuk mangësohen.
16. Janë ata që në të ardhmen kanë vetëm se zjarr. U dështuan planet dhe u shkuan më kot bëmat.
17. Mos janë ata që mbështeten në dëshmi të qartë nga Zoti dhe që ua reciton një dëshmues prej Tij ndërsa më parë ishte libri i Musait drejtim e mëshirë? Këta e besojnë. Nga palët, cilët e mohojnë, kanë zjarrin pikëtakimi. Mos ji në dyshim për të! Është e vërteta nga yt Zot, por të shumtët e njerëzve nuk besojnë.
18. Kush është më i padrejtë se ata që trillojnë gënjeshtër ndaj Zotit? Do të sillen para Zotit dhe dëshmitarët thonë: "Ja këta që gënjen për Zotin e tyre!" A nuk është mallkimi i Zotit mbi dhunuesit,

19. që pengojnë nga Rruga e Zotit, duan ta shtrembërojnë atë dhe janë mohues të së ardhmes?
20. Këta nuk mund të shpëtojnë në tokë dhe s'kanë mbrojtës veç Zotit, porse një dënim të dyfishtë. Ata nuk arritën të dëgjonin e të shikonin.
21. Janë ata që humbën veten dhe iu zhdukën trillimet.
22. Pa dyshim, në të ardhmen, janë të humburit.
23. Cilët besojnë e bëjnë të mira dhe përulen para Zotit, janë banorët e përhershëm të parajsës.
24. Shembulli i dy grupeve, si i verbri e shurdhi me kë sheh e dëgjon. A janë njësoj? Nuk mendoni?
25. Dërguam Nuhin te kombi i tij: "Unë jam për ju një paralajmërues i qartë.
26. Të adhuron vetëm Zotin! Unë i frikësohem për ju dënimit të një dite të hidhët."
27. Krerët mohues të kombit të tij thanë: "Ty të shohim njeri si ne dhe shohim që të ndjek shtresa më e ulët, pa mend. Nuk shohim të keni ndonjë meritë ndaj nesh, përkundrazi, ju quajmë gënjeshtarë."
28. Tha: "Kombi im! E kuptoni se, duke qenë me provë të qartë nga im Zot që më dha prej Tij mëshirë dhe ajo është për ju e errët, a mund t'jua detyrojmë me pahir tek e urreni?
29. Kombi im! Unë nuk ju kërkoj për të pasuri. Shpërblimi im është te Zoti. Dhe nuk i përzë besimtarët. Vërtet, ata janë në takim me Zotin e tyre. Porse, ju shoh juve një popull të paditur.
30. Kombi im! Kush do të më mbronte prej Zotit në i përzë ata? A nuk mendoni?
31. Dhe nuk po ju them se kam thesaret e Zotit e di të padukshmen, nuk them se jam engjëll dhe nuk them

- për ata që përçmojnë sytë tuaj se Zoti s'u jep të mira. Zoti ua njeh zemrat. Atëherë do të isha i padrejtë.”
32. Thanë: “O Nuh! Mjaft na bëre debat! Sillna dënimin në thua të vërtetën.”
33. Tha: “Vetëm Zoti e sjell, në dashtë dhe ju nuk mund t'i shpëtoni.
34. Edhe pse dua t'ju këshilloj, këshilla ime nuk ju bën dobi nëse Zoti do që të gaboni udhë. Ai është Zoti juaj dhe i ktheheni Atij.”
35. Mos thonë: “E sajoi ai?” Thuaj: “Në e sajova, faji im bie mbi mua dhe unë jam i çliruar nga fajet tuaja.”
36. Iu kumtua Nuhit: “Nuk do të besojnë të tjerë nga kombi yt përveç atyre që tashmë kanë besuar. Pra, mos u brengos për veprat e tyre.
37. Ndërtoje anijen nën vëzhgimin e frymëzimin Tonë dhe mos m'u drejto për dhunuesit. Ata janë të mbytur.”
38. Po ndërtonte anijen dhe, sa herë kalonin andej krerët e kombit të tij, talleshin me të. Tha: “Në talleni me ne, ne do të tallemi me ju sikurse talleni.
39. Dhe do ta mësoni kujt i vjen dënim poshtërues dhe një dënim që vazhdon bie mbi të.”
40. Kur erdhi Urdhri Ynë dhe gufoi toka, thamë: “Bart në të nga një çift prej çdo lloji, familjen tënde, përjashtuar atij që i është marrë vendimi dhe besimtarët.” Porse pak kishin besuar me të.
41. Tha: “Hipni! Qofshin me Emrin e Zotit lundrimi dhe ankorimi i saj! Im Zot është falës, mëshirëplotë.”
42. Filloi të rrëshqiste me ta në valët si male ndërsa Nuhi i thirri të birin që kishte mbetur matanë: “Biri im, ngjitu me ne dhe mos ji me mohuesit!”
43. Tha: “Do të tërhiqem në mal të më mbrojë nga uji.”
- Tha: “Sot nuk ka kush të të mbrojë nga urdhri i Zotit,

veç kë mëshiron Ai.” Hynë mes tyre valët dhe ai qe ndër të mbyturit.

44. U tha: “O tokë, përpije ujin dhe shtero o qiell!” U pakësua ujët, u përmbush urdhri dhe ajo zuri vend në Xhudi. U tha: “Larg kombit të pabesë!”
45. Nuh iu lut Zotit dhe tha: “Im Zot, biri im është familja ime. Premtimi Yt është i vërtetë. Ti je Më i Urti i të urtëve!”
46. Tha: “O Nuh! Ai s’është familja jote sepse vepra e tij nuk është e mirë. Mos më kërko diçka për të cilën s’ke dijeni. Unë të këshilloj të mos jesh i paditur.”
47. Tha: “Im Zot! Unë lyp mbrojtjen Tënde nga të kërkuarit diçka ku s’kam dijeni. Nëse nuk më fal e mëshiron, do të jem ndër të humburit.”
48. Iu tha: “O Nuh! Zbrit me paqe prej Nesh dhe bekim për ty e për popuj që janë me ty. Ka popuj që i bëjmë të jetojnë dhe i zë prej Nesh dënim i hidhët.”
49. Këto janë lajme të panjohura që po t’i kumtojmë. Nuk i dinit as ti e kombi yt më parë. Duro, sepse fundi është për të devotshmit.
50. Te adët, vëllanë e tyre, Hudin. Tha: “Kombi im, adhuron Zotin! S’keni zot veç Tij. Ju vetëm se trilloni.
51. Kombi im! Unë nuk ju kërkoj për këtë shpërblim. Shpërblimi im është te Ai që më krijoi. A nuk kuptoni?
52. Kombi im! Kërkoni Zotit tuaj falje dhe kthejuni të penduar. Ai ju dërgon nga qielli reshje të bollshme dhe ju shton fuqi në fuqinë tuaj. Mos u largoni si mëkatarë!”
53. Thanë: “O Hud! Ti s’na solle ndonjë provë dhe ne nuk i lëmë zotat tanë me fjalën tënde e nuk të besojmë.

54. Por ne themi se të kanë zënë zotat tanë me të keq.”
Ai tha: “Unë dëshmoj Zotin. Ju, dëshmoni se jam i
çliruar nga idhujt që shoqëroni
55. në vend të Tij. Pra, bëmani planin së bashku dhe mos
prisni.
56. Unë mbështetem te Allahu, Zoti im e Zoti juaj. Nuk ka
gjallesë që Ai të mos e ketë nën kontroll. Im Zot është
mbi udhën e drejtë.
57. Nëse largoheni, unë jua komunikova mesazhin. Im
Zot ju zëvendëson me njerëz të tjerë ndërsa ju nuk
mund ta dëmtoni Atë. Im Zot është mbikëqyrës në
çdo gjë.”
58. Kur erdhi urdhri Ynë, shpëtuam me mëshirën Tonë
Hudin dhe besimtarët me të, i shpëtuam nga një
dënim i rreptë.
59. Këta ishin adët: refuzuan dëshmitë e Zotit dhe nuk iu
bindën të Dërguarit të Tij, por ndoqën urdhrin e
tiranëve rebelë.
60. U përcollën me mallkim në këtë botë dhe Ditën e
Ringjalljes. A nuk mohuan adët Zotin e tyre? Larg
Adit, kombit të Hudit!
61. Te Themudi, të vëllanë, Salihun. Tha: “Kombi im,
adhuroni Zotin! S’keni zot veç Tij. Ai ju solli nga toka
dhe ju vendosi në të. Kërkojini falje dhe kthejuni të
penduar. Im Zot është afër, përgjigjet.”
62. Thanë: “O Salih! Ti ishe më parë shpresë te ne. Po na
ndalon të adhurojmë ç’adhuronin etërit tanë? Ne jemi
në dyshim, të pabindur ku na fton.”
63. Tha: “Kombi im! A e kuptoni se, duke qenë me provë
të qartë nga im Zot dhe Ai më dha prej Tij mëshirë,
kush më përkrah ndaj Zotit po të mos i bindem? Ju
nuk do të më shtonit tjetër veç humbjes.

64. Kombi im! Kjo është deveja e Zotit, shenjë për ju. Lëreni të ushqehet në tokën e Zotit dhe mos e zini me të keq, t'ju marrë një dënim i afërt."
65. E gjymtuan dhe ai u tha: "Qëndroni edhe tri ditë në shtëpitë tuaja! Ky është një paralajmërim që s'mund të përgënjeshtrohet.
66. Kur erdhi urdhri Ynë, shpëtuam me mëshirën Tonë Salihun dhe besimtarët me të nga mjerimi i asaj dite. Vërtet yt Zot është i Forti, i Plotfuqishmi.
67. I zuri dhunuesit krisma dhe mbetën në shtëpitë e tyre kufoma.
68. Si të mos kishin bërë prokopi në to. A nuk mohuan themudët Zotin e tyre? Larg Themudit!
69. I erdhën lajmësit Tanë Ibrahimit me sihariq. Thanë: "Paqe!" Tha: "Paqe!" Dhe nuk vonoi të sillte një viç të pjekur.
70. Kur i pa të mos zgjatnin duart, u zhgënjye e u tut. Thanë: "Mos ki frikë! Ne jemi dërguar te kombi i Lutit."
71. Gruaja e tij ishte më këmbë dhe buzëqeshi. E përgëzuam me Is'hakun dhe, pas Is'hakut, me Jakubin.
72. Tha: "E mjera unë! A do të lind plakë dhe ky, im shoq, i moshuar? Diçka e çuditshme."
73. Thanë: "Çuditësh me urdhrin e Zotit? Mëshira e Zotit dhe bekimet e Tij qofshin me ju, o njerëzit e shtëpisë! Ai është i lëvduar, lavdiplotë."
74. Sapo i kaloi Ibrahimit paniku dhe mori lajmin e gëzuar, na bëri debat për kombin e Lutit.
75. Ibrahim i qe i butë, i dhembshur dhe pendimtar.
76. "O Ibrahim, largoju kësaj! Urdhri i tët Zoti ka ardhur dhe atyre po u vjen një dënim i pakthyesëm."

77. Kur i erdhën Lutit lajmësit Tanë, u pikëllua dhe u zu ngushtë. Tha: “Kjo është ditë e vështirë.”
78. I erdhi me ngut populli i tij, ca që bënë punë të liga. Tha: “O bashkëkombas, ja bijat e mia! Ato janë për ju të pastra. Kini frikë Zotin dhe mos më dëshpëroni te miqtë! A nuk ka mes jush ndonjë burrë të matur?”
79. Thanë: “Ti e di që ne s’i meritojmë bijat tuaja dhe e di çfarë duam.”
80. Tha: “Sikur të kisha fuqi a të kapesha te një mbështetje të fortë!”
81. Thanë: “O Lut! Ne jemi lajmësit e tët Zoti. Ata nuk do të të arrijnë. Dil natën me familjen tënde dhe asnjëri të mos kthejë kokën pas. Përveç gruas tënde. Atë do ta zërë ç’i zë ata. Mëngjesi është afati i tyre. A nuk është afër mëngjesi?”
82. Me të ardhur urdhri Ynë, e kthyem vendin përmbys dhe derdhëm në të reshje gurësh, argjili të pjekur,
83. me damkë nga yt Zot. Nuk është larg nga të pabesët.
84. Te Medjeni, të vëllanë, Shuajbin. Tha: “Kombi im, adhuron Zotin! Nuk keni zot veç Tij. Mos mangësoni masën dhe peshën! Unë ju shoh në kamje dhe i trembem për ju dënimit të një dite pa rrugëdalje.
85. Kombi im! Plotësoni masën dhe peshën me drejtësi, mos mangësoni mallrat e njerëzve dhe mos veproni në tokë si keqbërës.
86. Ç’mбетet prej Zotit është më e mirë për ju në jeni besimtarë. Unë nuk jam mbi ju rojë.”
87. Thanë: “O Shuajb! Adhurimi yt të porositi t’i lëmë ç’adhuronin etërit tanë e të mos bëjmë ç’të duam me mallin tonë? Ti na qenke i butë, i matur!”
88. Tha: “Kombi im! E kuptoni se, duke qenë me provë të qartë nga im Zot dhe Ai më ushqeu me ushqim të

mirë, unë nuk dua të dal kundër jush aty ku ju ndaloj, por dua vetëm të mirën me sa kam mundësi? Suksesi im është te Zoti. Atij iu mbështeta dhe kthehem te Ai i penduar.

89. Kombi im! Të mos ju shtyjë mospajtimi me mua e t'ju ndodhë siç u ndodhi kombit të Nuhit, kombit të Hudit a kombit të Salihut. Kombi i Lutit nuk është larg jush.
90. Kërkoni falje Zotit dhe kthejuni të penduar! Im Zot është mëshirëplotë, i dhembshur.”
91. Thanë: “O Shuajb! Nuk kuptojmë shumë nga ato që thua, por të shohim të dobët mes nesh. Të mos qe klani yt, do të të gjuanim me gurë. Ti nuk ke fuqi mbi ne.”
92. Tha: “Kombi im! Mos është për ju klani im më i fuqishëm se Zoti që e lini pas? Im Zot jua ka rrethuar bëmat.
93. Kombi im! Ju veproni nga pozita juaj edhe unë po veproj. Dhe do ta mësoni kujt i vjen dënim poshtërues dhe është gënjeshtar. Përgjoni! Edhe unë jam me ju përgjues.”
94. Kur erdhi urdhri Ynë, shpëtuam me mëshirën Tonë Shuajbin dhe besimtarët me të. I zuri dhunuesit krisma dhe mbetën nëpër shtëpitë e tyre kufoma.
95. Si të mos kishin bërë prokopi në to. Larg Medjenit si edhe larg Themudit!
96. Dërguam Musanë me dëshmitë Tona dhe autoritet të qartë.
97. Te faraoni dhe krerët e tij. Por ata ndoqën urdhrin e faraonit. Urdhri i faraonit nuk ishte i drejtë.
98. U paraprin njerëzve të tij Ditën e Ringjalljes dhe i shoqëron në zjarr. Sa i keq lugu ku u prinë!

99. U ndoqën me mallkim këtu dhe Ditën e Ringjalljes. Sa e keqe dhurata që u shpërblyen!
100. Këto janë disa nga ndodhitë e vendbanimeve që po t'i tregojmë. Prej tyre, ka më këmbë e rrënoja.
101. Nuk i dhunuam Ne, por dhunuan veten. Kur u erdhi urdhri i tët Zoti, nuk u bënë dobi zotat që lusnin në vend të Zotit. Dhe u shtuan vetëm se rrënim.
102. Kështu dënon yt Zot kur i zë venbanimet e dhunshme. Ndëshkimi i Tij është i hidhur, i rreptë.
103. Këtu ka shenjë për këdo që i trembet dënimit të së ardhmes. Ajo është dita e mbledhjes së njerëzve, ditë dëshmie.
104. Nuk e vonojmë, por në afatin e caktuar.
105. Kur vjen, nuk flet një frymë pa lejen e Tij. Mes tyre, të mjerë e të lumtur.
106. Të mjerët janë në zjarr, me grahma e ofshama,
107. përgjithmonë, sa të jenë qiejt e toka, vetëm në dashtë yt Zot. Yt Zot e bën të kryer atë që do
108. Të lumturit janë në parajsë, përgjithmonë, sa të jenë qiejt e toka, me dashjen e tët Zoti. Një dhuratë e pashtershme.
109. Mos ji në mëdyshje për adhurimin e tyre. Adhurojnë ç'adhuronin etërit e tyre më parë. Dhe do t'ua plotësojmë çfarë u takon, pa mungesë.
110. I dhamë Musait Librin dhe ranë në kundërshti. Të mos qe parathënë nga yt Zot, do të vendosej mes tyre. Ata janë në dyshim, skeptikë rreth tij.
111. Yt Zot ia plotëson secilit veprat. Ai është në dijeni se ç'bëjnë.
112. Ti qëndro siç je urdhëruar. Edhe ata që kthehen të penduar bashkë me ty. Pra, mos i kaloni kufijtë. Vërtet, Ai është largpamës i veprave tuaja.

113. Mos anoni nga dhunuesit e t'ju zërë zjarri. Nuk do të ketë, veç Zotit, mbrojtës për ju, pastaj, nuk do të ndihmoheni.
114. Kryeni të falurit skajeve të ditës dhe orëve të para të natës. Të mirat i largojnë të këqiat. Kjo është kujtesë për ata që kujtojnë.
115. Bëj durim, sepse Zoti nuk ua humb shpërblimin të mirëve.
116. Përveç një pakice që shpëtuam, si të mos kishte nga breznitë para jush njerëz të matur që të ndalonin nga të këqiat në botë! Dhunuesit ndoqën teprimet në jetë dhe ishin keqbërës.
117. Yt Zot nuk është për zhdukjen padrejtësisht të vendbanimeve kur banorët e tyre janë paqësorë.
118. Po të deshte yt Zot, i bënte njerëzit një bashkësi. Pra, nuk do të pushojnë së qeni në mospajtim.
119. Përveç atyre që mëshiron yt Zot. Dhe, për këtë, Ai i ka krijuar. Plotësohet fjala e tët Zoti se “do ta mbush skëterrën me xhinë e njerëz bashkë.”
120. Gjithë çka të rrëfejmë nga ndodhitë e profetëve është që ta forcojmë me to zemrën tënde. Të erdhi në to e vërteta, këshillë dhe kujtesë për besimtarët.
121. Mosbesimtarëve thuaju: “Veproni nga pozitat tuaja dhe ne po veprojmë.
122. Prisni e po presim.”
123. Zotit i takon e fshehta e qiejve dhe e tokës. Tek Ai kthehen çështjet, të gjitha. Adhuronit Atë dhe mbështetjuni Atij! Zoti nuk është i shkujdesur ndaj veprave tuaja.

12. JUSUFI (JUSUF)

Periudha e Mekës, 111 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Elif, lam, ra. Këto janë dëshmitë e Librit të Qartë.
2. E shpallëm atë një këndim në arabisht që të mund të kuptoni.
3. Po të rrëfejme episodin më të bukur me të cilin ta kumtuam këtë Kuran ndërsa ishte më parë i pavetëdijshëm.
4. Kur Jusufi i tha të atit: “O baba, pashë njëmbëdhjetë yje, diellin dhe hënën të më përuleshin”, -
5. tha: “Biri im, mos ua kallëzo ëndrrën tënde vëllezërve të tu, të të ngrej në ndonjë kurth. Djalli është për njeriun armik i hapur.
6. Kështu, yt Zot të zgjedh e të mëson kuptimin e ndodhive, plotëson të mirën e Tij ndaj teje dhe ndaj familjes së Jakubit, siç e plotësoi ndaj etërve të tu më parë, Ibrahimit dhe Is’hakut. Yt Zot është dijeplotë, i urtë.”
7. Te Jusufi dhe të vëllezërit ka dëshmi për kërkuesit.
8. Thanë: “Jusufi dhe i vëllai janë më të dashur prej nesh se ati ynë megjithëse ne jemi shumicë. Ati ynë është në gabim të qartë.”
9. “Vrisni Jusufin ose hidheni diku që babai të kthehet nga ju dhe, pas tij, të bëheni njerëz të shquar.”
10. Dikush ndër ta tha: “Mos e vrisni Jusufin, por, në doni të bëni diçka, hidheni në fund të një pusi ta nxjerrin karvanet.”

11. Thanë: “Ati ynë, përse nuk na e beson Jusufin? Ne ia duam të mirën.
12. Dërgoje nesër me ne, të kënaqet e të luajë. Ne e ruajmë.”
13. Tha: “Unë shqetësohem po ta merrni me vete. Kam frikë se e ha ujku duke qenë ndaj tij të shkujdesur.”
14. Thanë: “Po ta hante ujku ndërsa jemi një grup i madh, do të ishim vërtet të humbur.”
15. Kur u larguan me të dhe vendosën ta linin në fund të pusit, Ne i kumtuam se “ti do t’ua përmendësh këtë veprim të tyre dhe ata s’do ta kuptojnë.”
16. I erdhën të atit në mbrëmje me të qarë.
17. Thanë: “Ati ynë! Ne po bënim gara, e lamë Jusufin pranë teshave tona dhe e hëngri ujku. Ti nuk ke për të na besuar megjithëse jemi të sinqertë.”
18. Dhe e sollën këmishën me gjak të rremë. Tha: “Jo! Ju ka mashtruar shpirti juaj. Bukur durim dhe qoftë ndihma e Zotit për fjalët që thoni!”
19. Erdhi një karvan dhe dërguan ujëmbartësin. Me të lëshuar kovën, ai tha: “Hej, sihariq! Një djalë!” Dhe e fshehën si mall tregu. Zoti ishte në dijeni se ç’bënin.
20. Donin ta hiqnin qafe dhe e shitën lirë, për ca dërhëmë.
21. Blerësi nga Misiri i tha së shoqes: “Mbaje mirë! Ndoshta do të na bëjë dobi a e birësojmë.” I bëmë Jusufit mundësi në tokë, t’i mësonim atij kuptimin e ndodhive. Zoti sundon urdhrin, por të shumtët e njerëzve nuk dinë.
22. Kur arriti pjekurinë, i dhamë gjykim e dituri. Kështu i shpërblejmë të mirët.

23. E joshi zonja e shtëpisë, mbylli portat dhe i tha: “Eja!” Tha: “Zoti më ruajtë! Zotëria më bëri vend të mirë. Dhunuesit nuk kanë sukses.”
24. Ajo iu dha dhe ai iu dha po të mos i qe treguar prova e Zotit. Këtë, që t’ia largonim të keqen dhe paudhësinë. Ishte ndër robtë Tanë të dëlirë.
25. Vrapuan drejt portës dhe ajo ia shqeu këmishën nga pas. Te dera gjetën të shoqin. Ajo tha: “Ç’ndëshkim ka ai që ia do të keqen familjes tënde përveç burgut a ndonjë dënimi të hidhur?”
26. Tha: “Ajo më provokoi.” Një dëshmues nga njerëzit e saj tha: “Po t’i jetë çarë këmisha përpara, ajo thotë të vërtetën ndërsa ai është gënjeshtar.
27. Po t’i jetë çarë këmisha nga pas, ajo gënjen ndërsa ai thotë të vërtetën.”
28. Kur pa këmishën të shqyer prapa, i tha asaj: “Ky është ndër kurthet tuaja. Kurthi juaj është i rëndë.
29. Jusuf, harroje këtë! Dhe ti, kërko falje për mëkatin tënd sepse je fajtorë.”
30. Gratë e qytetit thonin: “Gruaja e guvernatorit josh skillavin e saj. Ai ia mori mendjen. Ne e shohim në gabim të qartë.”
31. Kur dëgjoi pëshpëritjet, ajo i ftoi dhe u përgatiti një pritje. Secilës i dha një thikë dhe i tha atij: “Dilu përpara!” Me ta parë, e admiruan dhe prenë duart. Thanë: “Zoti na ruajtë! Ky s’është njeri, por një engjell fisnik.”
32. Ajo tha: “Ja, për këtë më qortuat. Unë e joshja dhe ai u mbrojt. Po nuk bëri siç e urdhëroj, do të burgoset e të jetë i poshtëruar.”

33. Ai tha: “Im Zot! Më mirë burgun nga ku më ftojnë ato. Po s’ma largove kurthin e tyre, mund të anoj e të jem ndër të paditurit.”
34. Zoti iu përgjigj dhe e largoi prej tij kurthin e tyre. Ai është Dëgjuesi, Dijeploiti.
35. Edhe pse i panë dëshmitë, vendosën ta fusnin një kohë në burg.
36. Hynë me të në burg dy të rinj. Njëri prej tyre tha: “Unë pashë sikur po shtypja bërsi vere.” Tjetri tha: “Unë pashë sikur po bartja në kokë bukë që e hanin zogjtë. Na shpjego kuptimin e tyre sepse të shohim njeri të mirë.”
37. Tha: “Nuk ju vjen ushqim me të cilin ushqeheni që unë të mos jua them domethënien e tij para se t’ju vijë. Siç më mësoi im Zot. Unë braktisa udhën e njerëzve që s’besojnë Zotin dhe mohojnë të ardhmen.
38. Dhe ndoqa udhën e etërve të mi, Ibrahimit, Is’hakut e Jakubit. Ne nuk i bëjmë Zotit shok. Kjo është mirësia e Zotit ndaj nesh dhe ndaj njerëzve, por të shumtët e njerëzve nuk falënderojnë.
39. O shokët e mi të burgut! Më mirë zota të ndryshëm apo Zoti Një, i Gjithëfuqishmi?
40. Po adhuron i në vend të Tij ca emra që i keni vënë vetë, ju dhe etërit tuaj. Zoti nuk zbriti për to ndonjë argument. Urdhri është i Zotit. Urdhëron të adhuron i vetëm Atë. Kjo është feja e drejtë, por të shumtët e njerëzve nuk dinë.
41. O shokët e mi të burgut! Njëri nga ju do t’i shërbejë të zotit pije ndërsa tjetri do të kryqëzohet dhe do t’ia çukisin kryet zogjtë. Çështja për të cilën më kërkuat shpjegim është vendosur.”

42. Atij që mendoi se do të shpëtonte, i tha: “Më kujto te zotëria yt!” Por djalli e bëri të harronte për t’ia kujtuar të zotit dhe ai mbeti disa vjet në burg.
43. Mbreti tha: “Kam parë shtatë lopë të majme që i hanin shtatë të dobëta dhe shtatë kallinj të gjelbër, të tjerët të tharë. O fisnikë! Në mund të shpjegoni ëndrrat, më jepni një argument në ëndrrën time.”
44. Thanë: “Ëndrra të ngatërruara. Ne nuk jemi të ditur në shpjegimin e ëndrrave.”
45. Kur u kujtua mbas një kohe, ai që shpëtoi ndër ata të dy, tha: “Unë jua bëj të njohur shpjegimin e tyre po të më dërgoni me detyrë.”
46. “Jusuf, o njeri i drejtë! Na jep mendim te shtatë lopë të majme që i hanin shtatë lopë të dobëta dhe shtatë kallinj të gjelbër, të tjerët të tharë, të kthehem te njerëzit dhe ata të mund ta mësojnë.”
47. Tha: “Mbillni shtatë vjet me radhë dhe, përveç një pakice për të ngrënë, lini të korrat në kallinj.
48. Pastaj vijnë shtatë të vështira që do të konsumojnë rezervat duke lënë diçka mënjane.
49. Pastaj vjen viti kur njerëzit do të kenë bollëk e të bëjnë zahire.”
50. Mbreti tha: “Sillmani mua!” Kur i erdhi lajmëtari, tha: “Kthehu te zotëria yt dhe pyete: “Si qëndron çështja e grave që prenë duart? Im Zot e di kurthin e tyre.”
51. Tha: “Përse e joshët Jusufin?” Thanë: “Zoti na ruajtë! Nuk dimë për të ndonjë të keqe.” Gruaja e guvernatorit tha: “Le të dalë e vërteta! Unë e joshja ndërsa ai është i singertë.”
52. “Kjo, që ta dijë se unë nuk e tradhtova në mungesë. Zoti nuk mbarëson kurthin e tradhtarëve. (Fjalët e Jusufit...)

53. Unë nuk shfajësoj veten sepse nefsi prin te e keqja. Por, me mëshirën e tim Zoti. Im Zot është falës, mëshirëplotë.”
54. Mbreti tha: “Sillmani ta mbaj në shërbimin tim.” Pasi foli me të, tha: “Sot, ti je pranë nesh me pozitë, i besuar.”
55. Ai tha: “Më cakto te rezervat e vendit. Unë jam kujdestar i ditur.”
56. Kështu, e mundësuam Jusufin në tokë, të vendosej aty ku deshte. Zëmë me mëshirën Tonë kë duam dhe të mirëve nuk ua humbim shpërblimin.
57. Por shpërblimi i së ardhmes është më i mirë për ata që besojnë dhe përmbahen.
58. Erdhën vëllezërit e Jusufit, hynë në prani të tij dhe ai i njohu, ata nuk e njohën.
59. Pasi i furnizoi me drithë, tha: “Ma sillni vëllanë tuaj nga babai. Siç e shihni, unë jua plotësova barrën dhe jam mikpritës i mirë.
60. Po të mos vini me të, s’keni barrë këtu, as që mund të më afroheni.”
61. Thanë: “Do t’i lutemi babait dhe patjetër do ta bëjmë.”
62. U tha shërbëtorëve: “Vëruani monedhat e tyre në bagazh, t’i shohin kur të arrijnë pranë familjes dhe të kthehen përsëri.”
63. Kur arritën te i ati, thanë: “O baba! Nuk na dhanë barrë të plotë, pra, nise me ne vëllanë tonë, të marrim barrë. Ne e ruajmë atë.”
64. Tha: “T’jua besoj siç jua besova të vëllanë më parë? Zoti është Ruajtësi Më i Mirë. Ai është Mëshiruesi i mëshiruesve.”
65. Kur hapën thasët, gjetën monedhat e tyre të kthyera dhe thanë: “O baba! Ç’mund të kërkojmë më? Ja

- paratë tona! Na u kthyen që të furnizojmë familjen tonë, të kujdesemi për vëllanë dhe të shtojmë një barrë deveje. Kjo, një barrë e kollajtë.”
66. Tha: “Nuk e nis atë me ju pa më dhënë besë te Zoti se do të ma sillni përsëri. Veç në rënçi në pritë.” Kur i dhanë besë, tha: “Zoti qoftë dorëzanës në fjalët tona!”
67. Tha edhe: “Bijtë e mi, mos hyni nga një portë, por hyni nga porta të ndryshme. Unë nuk ju bëj dobi ndaj Zotit. Vendimi i takon Zotit. Atij i mbështetem dhe te Ai le të mbështeten ata që kërkojnë mbështetje!”
68. Duke hyrë nga i porositi i ati, nuk u bënte ndonjë dobi ndaj Zotit, porse ishte një kërkesë e Jakubit për ta kryer. Ai zotëronte dije që Ne ia mësuam. Mirëpo të shumtët e njerëzve nuk dinë.
69. Kur hynë në prani të Jusufit, ai e tërhoqi mënjanë të vëllanë dhe tha: “Unë jam yt vëlla, mos u shqetëso për punët e tyre!”
70. Sapo i furnizoi me drithë, e vuri kupën në barrën e të vëllait. Pastaj dikush thirri: “Hej, ju të karvanit qenkeni vjedhës!”
71. U kthyen dhe thanë: “Ç’keni humbur?”
72. Tha: “Kemi humbur masën e mbretit. Kush e sjell, ka një barrë deveje. Unë përgjigjem.”
73. Thanë: “Për Zotin, ju e dini, nuk erdhëm të bëjmë keq në tokë dhe nuk jemi vjedhës.”
74. Thanë: “Ç’ndëshkim në gënjeni?”
75. Thanë: “Ndëshkimi është i atij në barrën e të cilit gjendet. Kështu i ndëshkojmë dhunuesit.”
76. Filloi me thasët e tyre para thesit të vëllait, pastaj e nxori atë nga barra e të vëllait. Kështu bëmë për Jusufin një plan. Sipas ligjit të mbretit, ai nuk mund ta mbante të vëllanë. Por, me dashjen e Zotit. Ngrejmë

- në pozitë atë që duam dhe mbi çdo të ditur është një Dijeplohtë.
77. Thanë: “Nëse ky vjedh, edhe i vëllai ka vjedhur më parë.” Jusufi e mbajti atë në vetvete dhe nuk e shfaqti. Tha: “Ju jeni në pozitë më të keqe. Zoti e di mirë se ku e keni fjalën.”
78. Thanë: “O i nderuar! Ky ka një baba shumë të vjetër. Merr njërin prej nesh në vend të tij meqë të shohim fisnik.”
79. Tha: “Zoti na ruajtë! Mbajmë vetëm atë ku u gjet malli ynë. Përndryshe, do të ishim të padrejtë.”
80. Kur i humbën shpresat për të, u tërhoqën duke u konsultuar. Më i madhi tha: “A nuk e dini se ati juaj ju mori besë te Zoti dhe që, më parë, e shpërdoruat në Jusufin? Unë nuk e lë këtë vend pa më dhënë leje im atë ose derisa Zoti të ketë vendosur për mua. Ai është Gjykatësi Më i Mirë.
81. Kthehuni te babai dhe thojini: “Ati ynë, biri yt ka vjedhur. Po dëshmojmë çfarë dimë pasi nuk e pamë me sytë tanë.
82. Pyet qytetin ku ishim ose karvanin me të cilin u kthyem. Ne jemi të sinqertë.”
83. Tha: “Jo! Ju ka mashtruar shpirti juaj. Bukur durim. Ndoshta Zoti m’i sjell së bashku. Ai është Dijeplohti, i Urti.”
84. U kthye mënjane dhe tha: “Vaj medet për Jusufin!” Dhe iu zbardhën sytë nga brenga e dëshpërimit.
85. Thanë: “Për Zotin, s’pushove së kujtuari Jusufin derisa të tretesh e të vdesësh.”
86. Tha: “Unë e qaj brengën dhe dëshpërimin vetëm te Zoti. Unë di nga Zoti ç’ju nuk dini.

87. Bijtë e mi! Shkoni e pyesni për Jusufin e të vëllanë dhe mos humbisni shpresën te mëshira e Zotit. Nuk e humb kush shpresën te mëshira e Zotit përveç mohuesve.”
88. Kur hynë para tij, thanë: “O i nderuar! Na zuri ne e familjen tonë vështirësia dhe erdhëm me një shumë të vogël. Plotësona ngarkesën si bamirësi. Zoti i shpërblen bamirësit.”
89. Tha: “A e dini ç’bëtë me Jusufin e të vëllanë si njerëz të paditur?”
90. Thanë: “Ti je Jusufi? Tha: “Unë jam Jusufi dhe ky, im vëlla. Zoti na bekoi. Zoti nuk ua humb shpërblimin të mirëve, atyre që përmbahen e durojnë.”
91. Thanë: “Për Zotin! Zoti të zgjodhi ndaj nesh dhe ne ishim të gabuar.”
92. Tha: “Sot s’ka qortim për ju. Zoti ju faltë! Ai është Mëshiruesi i mëshiruesve.
93. Merrni këmishën time dhe hidhjani tim ati në fytyrë, t’i vijnë sytë. Ejani këtu bashkë me familjen tuaj.”
94. Kur karvani u nis, ati i tyre tha: “Në s’më bëni të lënë, po ndiej erën e Jusufit.”
95. Thanë: “Për Zotin, ti ke lajthitur qëmoti.”
96. Me të ardhur lajmëtari, ia hodhi atë në fytyrë dhe atij iu kthye shikimi. Tha: “A nuk ju kam thënë që di nga Zoti ç’ju nuk dini?”
97. Thanë: “Ati ynë, falna mëkatet se ishim fajtorë.”
98. Tha: “Do t’i kërkoj falje për ju tim Zoti. Ai është Falësi, Mëshirëploti.”
99. Pasi hynë te Jusufi, ai i mori prindërit pranë vetes dhe tha: “Hyni në Misir, në dashtë Zoti, me paqe e siguri!”
100. I ngriti prindërit në fron dhe të gjithë i ranë në gjunjë. Tha: “Im atë! Ja kuptimi i ëndrrës sime të dikurshme.

Im Zot e bëri atë të vërtetë. Ai më bëri mirë kur më nxori nga burgu dhe ju solli juve nga shkretëtira pasi djalli pati futur të keqen mes meje dhe vëllezërve të mi. Im Zot është, me Dashjen e Tij, i butë. Ai është Dijeploiti, i Urti.

101. Im Zot! Ti më dhe pushtet dhe më mësove kuptimin e ndodhive. Krijues i qiejve dhe i tokës, Ti je Kujdestari im në këtë botë e në të ardhmen. Më vdis si musliman dhe bashkomë me të mirët!”
102. Këto janë ndër lajmet e panjohura që t’i kumtojmë. Nuk ishe me ta kur u mbledhën për qëllimin e tyre duke bërë një plan.
103. Edhe sikur të lakmoje, të shumtët e njerëzve nuk janë besimtarë.
104. Ti nuk po u kërkon shpërblim. Kjo është kujtesë për botët.
105. Sa e sa dëshmi ka në qiej e në tokë që ata u kalojnë pranë të larguar!
106. Të shumtët e tyre besojnë Zotin duke i bërë shok.
107. Mos janë të sigurt se nuk u vjen e keqja nga dënimi Zotit e t’u vijë papritmas e pa kujtuar Ora?
108. Thuaj: “Kjo është rruga ime. Ftojme te Zoti me vetëdije, unë dhe ndjekësit e mi. Madhëruar qoftë Zoti! Unë nuk jam idhujtar.”
109. Dërguam para teje, te banorët e vendbanimeve, burra që u kumtuam. Nuk udhëtojnë në tokë të shohin si qe fundi i pararendësve? A nuk e kuptoni se banesa e së ardhmes është më e mirë për të devotshmit?
110. Kur të dërguarit humbën shpresë dhe kujtuan se qenë mohuar, u erdhi ndihma Jonë dhe shpëtuan ata që deshëm Ne. Nuk prapset fuqia Jonë nga mëkatarët.

111. Në ndodhitë e tyre ka mësim për të mençurit. Nuk është rrëfenjë e trilluar, porse vërtetim i shkrimeve para tij, shpjegim i gjithçkaje, drejtim e mëshirë për besimtarët.

13. USHTIMA (ER-RA'D)

Periodha e Mekës, 43 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Elif, lam, mim, ra. Këto janë dëshmitë e Librit. Ç'të zbriti nga yt Zot, është e vërteta, por të shumtët e njerëzve nuk besojnë.
2. Zoti është Ai që ngriti qiejt pa mbështetëse të dukshme, pastaj përqendroi pushtetin dhe nënshtroi diellin e hënën; secili sillet në afat të caktuar. Ai mban rendin. I shpjegon dëshmitë që të bindeni në takimin me Zotin tuaj.
3. Është Ai që shtriu tokën dhe bëri në të vargmale e lumenj. Nga çdo lloj fruti, bëri në të palë, dy nga dy. Ai ka bërë natën të mbulojë ditën. Këtu ka shenja për njerëzit që mendojnë.
4. Në tokë, parcela pranë e pranë, kopshte hardhish, ara e palma, binjake e jobinjake, vaditen me të njëjtin ujë dhe Ne i bëmë disa më të pëlqyeshme se të tjerat në fryte. Këtu ka shenja për njerëzit që kuptojnë.
5. Në çuditësh, e çuditshme është fjala e tyre: "Kur të bëhemi dhé, jemi në krijim të ri?" Janë ata që mohuan

- Zotin e tyre. Ata kanë në qafë pranga dhe janë banorët e zjarrit, të përhershëm në të.
6. Duan të të nxitojnë në të keqen para së mirës ndërsa u kaluan më parë shembujt. Yt Zot është për faljen e njerëzve ndaj dhunës së tyre dhe, vërtet, yt Zot ka ndëshkim të rreptë.
 7. Mohuesit thonë: "Përse nuk i zbriti ndonjë shenjë nga Zoti i tij?" Ti je vetëm një paralajmërues dhe çdo komb ka udhërrëfyes.
 8. Zoti di ç'mban një femër dhe çfarë mangësojnë e teprojnë mitrat. Te Ai, çdo gjë është me masë.
 9. Njohësi i së padukshmes e të dukshmes, Ai është i Madhi, i Larti.
 10. Njësoj, nëse dikush nga ju e mban sekret fjalën apo e shpreh hapur, në fshihet natën dhe endet ditën,
 11. ndjekës para e pas e ruajnë me Urdhrin e Zotit. Zoti nuk ndryshon një popull pa ndryshuar ai veten dhe, kur Zoti ia do të keqen një populli, s'ka kthim për të, as mik veç Tij.
 12. Është Ai që ju tregon vetëtimën, frikë e shpresë dhe ngre re të ngarkuara.
 13. E madhëron ushtima me lavde për Të, edhe engjëjt, nga droja e Tij. Dërgon rrufetë dhe godet me të atë që do. Ndërsa ata bëjnë debat te Zoti, por Ai ka fuqi të rreptë.
 14. Atij i drejtohet thirrja e vërtetë. Ç'lusin në vend të Tij, nuk u përgjigjen. Si dikush që zgjat duart nga uji, t'i arrijë në gojë dhe s'i arrin. Thirrja e mohuesve është në humbje.
 15. Zotit i përulen ç'janë në qiej e në tokë, me dashje e pa dashje, edhe hijet e tyre, mëngjes e mbrëmje.

16. Thuaj: “Cili është Zoti i qiejve dhe i tokës?” Thuaj: “Allahu.” Thuaj: “Po merrni në vend të Tij mbrojtës që nuk i zotërojnë vetes dobi e dëm?” Thuaj: “A barazohet i verbri me kë sheh? Ose, a barazohen errësirat me dritën?” I bëjnë Zotit ortakë që krijojnë si krijimin e Tij dhe u shembëllen krijimi? Thuaj: “Zoti është Krijuesi i çdo gjëje; Ai është Një i Vetmi, Nënshtruesi.”
17. Zbret nga qielli ujë dhe vërshojnë përrenjtë e mbushur plot. Bart rrëkeja shkumë që grafullon si shkuma e metalit të shkrirë në zjarr për stoli e pajisje. Zoti sjell kështu të vërtetën e të rremen: shkuma shkon më kot dhe mbetet në tokë ajo nga ç’përfitojnë njerëzit. Kështu, Zoti sjell shembujt.
18. Ata që i përgjigjen Zotit kanë Më Të Bukurën. Cilët s’i përgjigjen, sikur të kenë krejt ç’ka në tokë, edhe po aq, s’mund të shpërblejnë. Llogaria e tyre është e rëndë dhe streha e tyre, skëterra, ç’shtrat i keq!
19. Ai që e di se shpallja nga yt Zot është e vërteta, a mund të jetë si një i verbër? Të mençurit meditojnë;
20. që përmbushin besën e Zotit dhe nuk thyejnë zotimin;
21. që ia arrijnë çfarë Zoti ka urdhëruar të arrihet, i frikësohen Zotit dhe i tremben llogarisë së keqe;
22. që durojnë për hir të Zotit, falen dhe kontribuojnë fshehtas e haptas nga ç’u kemi dhënë dhe largojnë të keqen me të mirë. Për ta është banesa e fundit,
23. kopshtet e Edenit ku do të hyjnë me etërit e tyre, bashkëshortet e tyre dhe pasardhësit e tyre të meritueshëm. U hyjnë engjëjt nga çdo portë:
24. “Paqja qoftë me ju sepse duruat! Sa e mirë, banesa e fundit!”

25. Cilët thyejnë besën e Zotit pasi e lidhën, këpusin çfarë Zoti ka urdhëruar të arrihet me të dhe sjellin të këqia në tokë, kanë mallkimin dhe banesën më të keqe.
26. Zoti ia zgjeron mjetet e jetesës atij që do ose ia kufizon ndërsa ata kënaqen me jetën e kësaj bote. Por jeta e kësaj bote në të ardhmen është vetëm një mbresë.
27. Mohuesit thonë: “Përse nuk i zbriti ndonjë shenjë nga Zoti i tij?” Thuaj: “Zoti lë të gabojë atë që do dhe drejton nga Ai kë kthehet i penduar.”
28. Ata që besojnë dhe u qetësohen zemrat me përmendjen e Zotit – a nuk qetësohen zemrat me përmendjen e Zotit?
29. -- që besojnë e bëjnë të mira, sihariq për ta dhe një vendkthim të mirë!
30. Kështu, të dërguam ty te një popull, – kaluan para tij popuj, – t’u recitosh çfarë të kumtuam ndërsa ata mohojnë Bamirësin. Thuaj: “Ai është im Zot, s’ka zot veç Tij, Atij iu mbështeta dhe kthehem te Ai i penduar.”
31. Edhe sikur të qe një këndim me të cilin të lëvizeshin malet a të çahet toka ose të flisnin të vdekurit, urdhri i takon krejt Zotit. Nuk e kuptojnë besimtarët se po të deshte Zoti, i drejtonte gjithë njerëzit? Mohuesve nuk u ndahen së rëni fatkeqësitë me ç’ kanë bërë ose u rrinë në prag të derës derisa të realizohet premtimi i Zotit. Zoti nuk e shkel afatin.
32. U shpërfillën të dërguar para teje, por, mohuesve ua zgjata, pastaj i mora. Dhe si qe ndëshkimi Im?
33. Nuk është Ai që vëzhgon çdo frymë se çfarë fitoi? Ndërsa ata i bëjnë Zotit shokë. Thuaj: “Vëruni emra! Apo doni t’ia bëni Atij të njohur të panjohurat në tokë?

Ose, thjesht fjalë goje?” lu zbukurua mohuesve plani i tyre dhe largohen nga rruga. Kë humb Zoti, nuk ka për të drejtues.

34. Ata kanë dënim në jetën e kësaj bote, porse dënimi i së ardhmes është më i vështirë. Dhe nuk kanë ndaj Zotit mbrojtës.
35. Shembulli i kopshtit premtuar të devotshmëve: rrjedhë lumenjsh, fryte dhe hije pa mbarim. Ky është përfundimi i të devotshmëve dhe zjarri, fundi i mohuesve.
36. Ata që u kemi dhënë librin gëzohen me shpalljen tek ty, porse, nga grupet, ka që nuk pëlqejnë pjesë të tij. Thuaj: “Unë jam urdhëruar të adhuroj Zotin dhe të mos i bëj shok. Ftoj te Ai dhe i kthehem Atij.”
37. Pra, e shpallëm atë një program në arabisht. Nëse ndjek dëshirat e tyre pasi të erdhi dija, nuk ke ndaj Zotit kujdestar e mbrojtës.
38. Dërguam të dërguar para teje dhe i bëmë me gra e fëmijë. Nuk u takonte të dërguarve të sillnin mrekulli, porse me lejen e Zotit. Çdo periudhë është e parashkuar.
39. Zoti e bën diçka që do, të paqenë ose e përforcon. Te Ai është Baza e Librit.
40. Edhe sikur të të bënim të shihje të realizuara paralajmërimet ose të të vdisnim, ty të takon fjala, Neve, llogaria.
41. A nuk shohin se Ne i vijmë përqark tokës duke i marrë anët? Zoti merr vendim. Askush nuk e rishikon Vendimin e Tij. Ai ka llogari të shpejtë.
42. Bënë plane para tyre, por plani i përket krejt Zotit. Ai di çfarë fitoi çdo frymë ndërsa mohuesit do ta mësojnë kujt i takon banesa e fundit.

43. Mohuesit thonë se nuk je i dërguar. Thuaj: “Mjafton Zoti dëshmues mes nesh. Edhe ata që kanë dije nga Libri.”

14. IBRAHIMI (IBRAHIM)

Periodha e Mekës, 52 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Elif, lam, ra. Libër që e zbritëm tek ty, të nxjerrësh njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësirat në dritë, udhës së të Plotfuqishmit, Lavdiplotit;
2. Zotit të Cilit i përkasin ç’janë në qiej e në tokë. Mjerë mohuesit nga një dënim i rreptë;
3. që parapëlqejnë jetën e kësaj bote ndaj së ardhmes, pengojnë nga Rruga e Zotit dhe duan ta shtrembërojnë atë! Ata janë në humbje të thellë.
4. Çdo profet e dërguam në gjuhën e kombit të vet për ta sqaruar. Zoti lë të gabojë dhe drejton me dashjen e Tij. Ai është i Plotfuqishmi, i Urti.
5. Dërguam Musanë me dëshmitë Tona: “Të nxjerrësh kombin tënd nga errësirat në dritë dhe t’ia kujtosh ditët e Zotit!” Këtu ka dëshmi për çdo durimtar e mirënjohës.
6. Kur Musai i tha kombit të vet: “Kujtoni të mirën e Zotit tek ju shpëtoi nga njerëzit e faraonit që ju jepnin dënimin më të keq: thernin bijtë tuaj dhe linin gjallë gratë tuaja. Ishte kjo për ju një provë e rëndë nga Zoti juaj.

7. Dhe kur Zoti shpalli: “Po të falënderoni, ju jap më shumë; nëse mohoni, dënimi Im është i rreptë.”
8. - Musai tha: “Sikur të mohoni ju e gjithë ç’janë në tokë, Zoti s’ka nevojë, është lavdiplotë.”
9. A nuk ju erdhën lajmet e pararendësve tuaj, kombit të Nuhit, Adit, Themudit e më pas? Nuk i di kush veç Zotit. U erdhën të dërguarit me prova të qarta, por ata rrinin me duar në gojë dhe thonin: “Ne e mohojmë misionin tuaj dhe jemi të pabindur, në mëdyshe të thirrjes suaj.”
10. Të dërguarit thanë: “Jeni në mëdyshe të Zotit, Krijuesit të qiejve e të tokës? Ai ju fton në falje të mëkateve tuaja dhe ju jep kohë deri në një afat të caktuar.” Thanë: “Ju jeni njerëz si ne që doni të na largoni nga kulti i etërve tanë. Na sillni një argument të qartë!”
11. Të dërguarit u thanë: “Ne jemi njerëz si ju, por Zoti i jep dhunti atij që do ndër robtë e Vet. Nuk na takon neve t’ju sjellim argument, porse me lejen e Zotit. Zotit t’i mbështeten besimtarët!
12. Përse të mos i mbështetemi Zotit që na drejtoi udhëve tona? Ne do t’i durojmë mundimet tuaja dhe le t’i mbështeten Zotit ata që mbështeten!”
13. Mohuesit u thanë të dërguarve: “Kthehuni në traditën tonë ose t’ju dëbojmë nga vendi.” Atëherë Zoti u kumtoi: “Do t’i rrënojmë dhunuesit.
14. Dhe t’ju vendosim pas tyre në tokë. Kjo, për këdo që i frikësohet pranisë Sime dhe i frikësohet paralajmërimit Tim.”
15. Kërkuar vendim dhe dështoi çdo tiran rebel,
16. me skëterrën pas ku i jepet të pijë rrjedhë plagësh.

17. Merr një gllënjë e nuk e gëlltit dot. I vjen vdekja nga çdo anë e nuk jep shpirt. Më pas, një dënim të rreptë.
18. Shembulli i atyre që mohojnë Zotin janë veprat e tyre si hiri që fryn me furi era në ditë stuhie. Nuk zotërojnë gjë nga fitimi. Kjo është humbja e thellë.
19. Nuk sheh që Zoti krijoi qiejt e tokën me të vërtetën? Po të dojë, ju heq dhe sjell një krijim të ri.
20. Për Zotin, kjo nuk është e vështirë.
21. Dhe dalin para Zotit të gjithë. Të pafuqishmit u thonë të fuqishmëve: “Ne ju ndoqëm pas. A mund të na bëni dobi ndaj dënimit të Zotit?” Thonë: “Po të na kishte drejtuar Zoti, ju drejtonim juve. Njësoj për ne: s’qëndrojmë a qëndrojmë, nuk ka rrugëdalje.”
22. Kur çështja të jetë vendosur, djalli u thotë: “Zoti ju premtoi premtim të vërtetë. Unë ju premtova e tradhtova. Unë s’pata fuqi ndaj jush, vetëm se ju ftova dhe m’u përgjigjët. Pra, mos më qortoni mua, qortoni veten tuaj. Unë nuk jam shpëtimtari juaj, as ju shpëtimtarët e mi. Unë e mohoj kultin që më bënit më parë.” Dhunuesit kanë dënim të hidhët.
23. Cilët besojnë e bëjnë të mira, hyjnë, me lejen e Zotit, në kopshte ku rrjedhin lumenj, të përherëshëm në to. Përsëritja e tyre atje është: “Paqe!”
24. Nuk sheh se si Zoti sjell shembull fjalën e mirë, si një pemë e mirë, me rrënjët thellë dhe degët në qiell?
25. Jep, me lejen e Zotit, frytin e vet në çdo kohë. Zoti sjell shembuj për njerëzit që të mund të mendohen.
26. Shembulli i fjalës së keqe, një pemë e keqe: i dalin rrënjët mbi dhë e nuk zë vend.
27. Zoti i përforcon besimtarët me fjalën e qëndrueshme në jetën e kësaj bote e në të ardhmen. Dhunuesit, Zoti i lë në humbje. Zoti ushtron Vullnetin e Tij.

28. Nuk ke parë nga ata që këmbejnë të mirën e Zotit me mohim dhe i hapin popullit portat e humbjes,
29. në skëterrë, përballë zjarrit? Ç'vendqëndrim të keq!
30. I bënë Zotit ortakë për të larguar nga Rruga e Tij.
Thuaj: "Jetoni! Fundi juaj është në zjarr."
31. Thuaju robërve të Mi besimtarë të kryejnë të falurit dhe të kontribuojnë fshehtas e haptas nga ç'u kemi dhënë para se të vijë një ditë kur s'ka ujdi e miqësi.
32. Zoti është Ai që krijoi qiejt e tokën, zbriti nga qielli ujë dhe nxori me të fryte, ushqim për ju. Vuri në shërbimin tuaj anijen për të lundruar me urdhrin e Tij në det, vuri në shërbimin tuaj lumenjtë.
33. Nënshtroni për ju diellin e hënën të sillen pandërprerë, nënshtroni për ju natën e ditën.
34. Ju dha gjithçka që ju nevojitet. Po t'i numëronit të mirat e Zotit, nuk mund t'i llogaritnit. Njeriu është i padrejtë, mosmirënjohës.
35. Kujto kur Ibrahim tha: "Im Zot, bëje këtë vend të sigurt dhe mbana mua e bijtë e mi nga adhurimi i idhujve!
36. Im Zot, ata kanë bërë të gabojnë shumë njerëz. Kush më ndjek mua, është ndër të mitë; në më kundërshton, Ti je falës, mëshirëplotë.
37. Zoti ynë! Unë vendosa disa nga pasardhësit e mi në një luginë të pakultivuar, pranë Shtëpisë Tënde të Shenjtë, që, o Zot, të kryejnë adhurimin, pra, bëji zemrat e njerëzve të anojnë drejt tyre dhe ushqeji me fryte që ata të mund të falënderojnë.
38. Zoti ynë! Ti e di se ç'fshehim e çfarë zbulojmë; Zotit s'mund t'i fshihet gjë në tokë e në qiell.
39. Falënderuar qoftë Zoti që më dhuroi në pleqëri Ismailin dhe Is'hakun! Vërtet, im Zot e dëgjon lutjen.

40. Zoti im, na bëj mua dhe pasardhësit e mi të kryejmë të falurit! Zoti ynë, pranoje lutjen time!
41. Zoti ynë, falna mua, prindërit e mi dhe besimtarët ditën e llogarisë!”
42. Mos e pandeh Zotin të shkujdesur nga veprat e dhunuesve. I vonon deri ditën kur shtangen shikimet.
43. Shkojnë të dalldisur, kryet përpjetë, shikimin ngulur, zemrat zbrazur.
44. Paralajmëroji njerëzit për ditën kur u vjen dënimi dhe dhunuesit thonë: “Zoti ynë, na e shty në një afat të afërt, t’i përgjigjemi thirrjes Tënde e të ndjekim të dërguarit.” “A nuk u betuat më parë se s’ka fund për ju?”
45. U ngulët në trojet e atyre që dhunuan vetveten dhe u bë e qartë për ju si vepruam me ta. Ju sollëm shembujt.”
46. Bënë plane, por planet e tyre janë te Zoti edhe sikur të lëviznin me to malet.
47. Mos e pandeh Zotin të shkelë premtimin me të dërguarit e Tij. Zoti është i plotfuqishëm, i zoti i hakmarrjes,
48. ditën që toka bëhet tjetër tokë, edhe qiejt dhe dalin para Zotit, Një të Vetmit, Nënshtruesit.
49. I sheh atë ditë fajtorët pranë e pranë në pranga.
50. Petku i tyre është prej katrani dhe ua mbulon fytyrën zjarri.
51. Që Zoti t’ia shpërblejë secilit atë që fitoi. Zoti ka llogari të shpejtë.
52. Ky është komunikim për njerëzit, të paralajmërohen me të, ta dinë se Ai është Një Zot dhe të meditojnë të mençurit.

15. LUGINA E GURTË (EL HIXHR)

Periudha e Mekës, 99 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Elif, lam, ra. Këto janë dëshmitë e Librit dhe të një këndimi të qartë.
2. Do të dëshironin mohuesit të ishin muslimanë.
3. Le të hanë, të përfitojnë, të mbahen me shpresa dhe do ta mësojnë.
4. Nuk shkatërruam vendbanim pa një dekret të njohur.
5. Një popull s'mund ta shpejtojë afatin, as ta vonojë.
6. Thonë: "Ti që t'u shpall Kujtesa je i marrë.
7. Përse s'na erdhe me engjëj në je i vërtetë?"
8. I zbresim engjëjt me të vërtetën dhe, atëherë, nuk u jepet kohë.
9. Ne e zbritëm Kujtesën dhe Ne e ruajmë atë.
10. Dërguam para teje në bashkësitë e para.
11. Nuk u erdhi i dërguar të mos e tallnin.
12. Kështu e futëm në zemrat e mëkatarëve.
13. Nuk besojnë megjithëse u kaloi përvoja e të parëve.
14. Edhe sikur t'u hapnim portat e qiellit e të ngjiteshin,
15. "Na u errën sytë a na bënë magji", - do të thonin.
16. Bëmë në qiell yjësi dhe i stolisëm për vëzhguesit.
17. E ruajtëm atë nga çdo djall i mallkuar.
18. Kë përgjon, e ndjek një flakërimë e dukur.
19. Tokën e shtrimë dhe vendosëm në të vargmale; rritëm në të çdo gjë në përshtatje.

20. Bëmë në të mjete jetese, për ju dhe çfarë ju nuk ushqeni.
21. Nuk ka gjë të mos ketë rezervat e saj pranë Nesh. I zbresim ato me masë.
22. Dërgojmë erërat pjellore dhe zbresim nga qielli ujë e ju japim të pini. Nuk jeni ju që mbani rezervat.
23. Ne japim jetë e vdesim dhe Ne jemi trashëguesit.
24. Ne i dimë pararendësit tuaj, dimë edhe pasrendësit.
25. Yt Zot është Ai që do t'i tubojë. Ai është i urtë, dijeplotë.
26. E krijuam njeriun prej bote, balte të mbrujtur.
27. Xhinin e krijuam më parë prej zjarrit të ndezur.
28. Kur yt Zot u tha engjëjve: "Unë po krijoj njeriun prej bote, balte të mbrujtur;
29. pasi ta kem formuar e fryrë nga Fryma Ime, bini para tij të përulur",
30. - u përulën engjëjt të gjithë bashkë.
31. Përrjashtuar Iblisit; refuzoi të jetë i përulur.
32. Tha: "O Iblis, përse nuk përulesh?"
33. Tha: "Nuk më takon t'i përulem njeriut që e krijove prej bote, balte të mbrujtur."
34. Tha: "Dil së andejmi! Je i mallkuar.
35. Mbi ty është mallkimi deri Ditën e Gjykimit."
36. Tha: "Im Zot, më prit deri ditën që ngrihen!"
37. Tha: "Ti je nga ata që priten,
38. deri ditën e kohës së caktuar."
39. Tha: "Im Zot! Meqë më prapësive, do t'i josh në tokë e t'i prapësoj të gjithë,
40. përveç robërve Tuaj të singertë."
41. Tha: "Kjo është udhë ndaj Meje e drejtë:
42. Ti s'ke mbi robtë e Mi autoritet, por te ata që të ndjekin ty dhe janë të gabuar.

43. Skëterra është pikëpjekja e tyre, bashkë.
44. Me shtatë porta; për çdo portë, një pjesë e ndarë."
45. Të devotshmit janë në kopshte e burime.
46. "Hyni, me paqe dhe të sigurt!"
47. Hoqëm nga gjokset e tyre çdo mëri. Si vëllezër, në frona përkarshi.
48. Nuk i zë dhembje e s'janë të përzënë.
49. Thuaju robërve të Mi: "Vërtet, Unë jam Falësi, Mëshirëploti.
50. Por ndëshkimi Im është i hidhët."
51. Njoftoji për miqtë e Ibrahimit.
52. Kur hynë te Ai dhe thanë: "Paqe!" – tha: "Jemi nga ju të frikësuar."
53. Thanë: "Mos ki frikë! Ne të përgëzojmë me një djalë të zgjuar."
54. Tha: "Më përgëzoni tek më ka zënë pleqëria? Si përgëzoni?"
55. Thanë: "Të përgëzojmë me të vërtetën, pra, mos ji i pashpresë."
56. Tha: "Kush e humb shpresën te mëshira e Zotit përveç atyre që janë të humbur?" -
57. - tha: "Ç'qëllim keni, o të dërguar?"
58. Thanë: "U dërguam te një komb i fajësuar.
59. Jo njerëzit e Lutit: do t'i shpëtojmë ata bashkë.
60. Përveç gruas së tij: e caktuam të jetë me të prapambeturit."
61. Kur erdhën të dërguarit te shtëpia e Lutit,
62. tha: "Ju jeni njerëz të panjohur."
63. Thanë: "Të erdhëm për çka janë të lëkundur.
64. Të erdhëm me të vërtetën dhe jemi të besuar.

65. Nisu natën me njerëzit e tu dhe ec pas gjurmëve të tyre. Asnjëri të mos kthejë kokën, por shkoni ku jeni urdhëruar.”
66. Ia dhamë atij vendimin: rrënjët e tyre do të shkulen në të aguar.
67. Erdhën banorët e qytetit të gëzuar.
68. Tha: “Këta janë miqtë e mi, mos më turpëroni!
69. Kini frikë Zotin, mos më poshtëroni!”
70. Thanë: “Nga punët e botës a s’ të ndaluan?”
71. Tha: “Ja bijat e mia në qoftë se i doni.”
72. Për jetën tënde! Në dehjen e tyre shkonin të verbuar.
73. I mori krisma në të aguar.
74. I përmbysëm dhe u derdhëm shi me gurë balte të pjekur.
75. Në të ka dëshmi për gjurmuesit.
76. Është në një rrugë të njohur.
77. Këtu ka dëshmi për besimtarët.
78. Edhe banorët e Ejkes dhunuan.
79. Prandaj me ta u hakmorëm. Të dyja janë në një udhë të hapur.
80. I përgënjeshtruan të dërguarit banorët e Hixhrit (Luginës së Gurtë)
81. U dhamë dëshmitë Tona, por u larguan.
82. Gdhendnin shtëpi në mal, të siguruar.
83. I mori krisma në të aguar.
84. Dhe nuk u bëri dobi ç’kishin fituar.
85. Qiejt, tokën e gjithçka mes tyre i krijuam me të vërtetën dhe Ora po vjen. Pra, kalo me durim e vetëpërmbytje.
86. Yt Zot, Ai është Krijuesi i Gjithëditur.
87. Të dhamë shtatë të përsëriturat (suren Fatiha) dhe Kuranin e Madhëruar.

88. Mos i hidh sytë te kënaqësitë që u dhamë disa palëve, as mos u brengos për ta dhe ji i butë me besimtarët.
89. Thuaj: “Unë jam paralajmërues i qartë.”
90. Sikurse shpallëm edhe te sektarët (judenjtë e të krishterët),
91. të cilët e trajtojnë Kuranin pjesërisht.
92. Për tët Zot, do t'i marrim të gjithë në pyetje
93. për veprat që kanë bërë.
94. Shpalle haptas ç'je urdhëruar dhe largohu nga idhujtarët.
95. Ne të mjaftojmë për mospërfillësit,
96. që bëjnë me Zotin zota të tjerë. Por do ta mësojnë.
97. Ne e dimë se të ngushtohet gjoksi nga fjalët që thonë.
98. Thuri lavde tët Zoti dhe ji me ata që i bien të përulur në sexhde.
99. Adhuro Zotin tënd deri në vdekje.

16. BLETA (EN-NAHL)

Periudha e Mekës, 128 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Urdhri i Zotit vjen, mos e nxitoni! Madhëruar qoftë, i lartë nga ç'i shoqërojnë!
2. Zbret engjëjt me frymën e Urdhrit të Tij, atje ku dëshiron ndër robtë e Vet, për të tërhequr vëmendjen se: “Nuk ka zot veç Meje, pra, Mua frikësomuni!”
3. Krijoi qiejt dhe tokën me të vërtetën, i lartë nga ç'i shoqërojnë!
4. Krijoi njeriun nga një pikëz dhe, ja, ai është kundërshtar i hapur.

5. Edhe bagëtitë Ai i krijoi. Keni në to ngrohje, përfitim dhe ushqeheni prej tyre.
6. Është bukur kur i vathoni dhe i lëshoni për kullotë.
7. Bartin barrët tuaja atje ku nuk do t'ia arrinit, por me mundim të madh. Vërtet, Zoti juaj është i dhembshur, mëshirëplotë.
8. Edhe kuajt, mushkat e gomerët, për t'u hipur dhe si stoli. Krijon çfarë nuk dini.
9. Te Zoti është drejtimi i udhës dhe, prej saj, ka shmangie. Po të deshte, ju drejtonte të gjithëve.
10. Është Ai që zbret nga qielli ujë; prej tij keni ujë të pijshëm dhe bimësi për kullotë.
11. Rrit me të, për ju, drithërat, ullinjtë, hurmat, hardhitë dhe lloj-lloj frytësh. Këtu ka dëshmi për njerëzit që mendojnë.
12. Nënshtroni për ju natën e ditën, diellin e hënën. Edhe yjet i janë nënshtruar Urdhrit të Tij. Këtu ka dëshmi për njerëzit që kuptojnë.
13. Dhe gjithë ç'ka përhapur për ju në tokë, me ngjyra të ndryshme, janë dëshmi për njerëzit që meditojnë.
14. Është Ai që nënshtroni detin ku ushqeheni me mish të freskët dhe nxirrni stoli që mbani. Sheh anijen tek çan në të, të kërkonti mirësitë e Tij dhe që të mund të falënderoni.
15. Vuri në tokë formacione të qëndrueshme që ajo të mos lëkundet bashkë me ju, lumenj e shtigje ku mund të orientoheni.
16. Edhe shenja dhe orientimin me yjet.
17. Ai që krijon, mos është si diçka që s'krijon? Nuk mendoni?
18. Po t'i numëronit të mirat e Zotit, s'mund t'i llogaritnit. Zoti është falës, mëshirëplotë.

19. Zoti di çfarë fshihni e zbuloni.
20. Ç'u luten në vend të Zotit, nuk krijojnë gjë por janë të krijuar.
21. Të vdekur, pa jetë, nuk e kuptojnë kur ringjallen.
22. Zoti juaj është Një Zot. Zemrat e atyre që s'besojnë në të ardhmen janë mohuese dhe ata, kryeneçë.
23. Pa dyshim, Zoti di çfarë fshehin e zbulojnë. Ai nuk i do kryeneçët.
24. Kur u thuhet: "Çfarë zbriti Zoti juaj?" – thonë: "Rrëfenja të të parëve."
25. Për të bartur Ditën e Ringjalljes barrën e tyre të plotë dhe barrë të atyre që i gabuan me padije. Ç'të keqe bartin!
26. Edhe më parë thurën të paqena, por Zoti ua shembi në themel ngrehinën dhe u ra çatia mbi kokë. U erdhi dënimi pa e kuptuar.
27. Ditën e Ringjalljes i poshtëron dhe u thotë: "Ku janë shoqëruesit e Mi për të cilët u armiqësuat?" Të diturit thonë: "Sot poshtërimi dhe e keqja janë mbi mohuesit."
28. Që i vdesin engjëjt si dhunues të vetvetes. Dhe pranojnë dorëzimin: "Nuk bëmë ndonjë të keqe!" Zoti e di mirë se ç'bënit.
29. Hyni përgjithmonë në portat e skëterrës! Sa i keq vendbanimi i kryeneçëve!
30. U thuhet të devotshmëve: "Çfarë zbriti Zoti juaj? – thonë: "Të mirën." Cilët bëjnë mirë në këtë botë, gjejnë mirë dhe parajsa është më e mira. Sa i mirë vendbanimi i të devotshmëve!
31. Kopshtet e Edenit ku ata hyjnë. Rrjedhin në to lumenj dhe kanë atje ç'të dëshirojnë. Kështu i shpërblen Zoti të devotshmit.

32. I vdesin engjëjt si të mirë dhe u thonë: “Paqja qoftë me ju! Hyni në parajsë me ç’keni bërë.”
33. Mos presin t’u vijnë engjëjt ose t’u vijë urdhri i tët Zoti? Kështu vepruan më parë. Nuk i dhunoi Zoti, por dhunuan veten.
34. U ranë të këqiat që bënë dhe i zuri ajo me të cilën u tallën.
35. Idhujtarët thonë: “Po të deshte Zoti, nuk do të adhuronim gjë veç Tij, ne dhe etërit tanë e nuk do të shenjtëronim gjë veç Tij.” Kështu vepruan më parë. A kanë të dërguarit detyrë tjetër përveç komunikimit të qartë?
36. Dërguam te çdo popull të dërguar: “Adhuroni Zotin dhe largojuni djajve!” Prej tyre, ka që i drejtoi Zoti dhe, prej tyre, që merituan humbjen. Udhëtoni në tokë të shihni si qe fundi i përgënjeshtresve.
37. Në lakmon të vijnë në udhë të drejtë, Zoti nuk drejton kë lë të humbur dhe nuk ka për ta ndihmëtarë.
38. Bëjnë be në Zotin, të sigurt se Zoti nuk ringjall të vdekurit. Po, një premtim i vërtetë që Ai ka marrë, por të shumtët e njerëzve nuk dinë.
39. T’u bëhet e qartë atyre që janë në kundërshti dhe ta mësojnë mohuesit se ishin gënjeshtarë.
40. Kur Ne duam diçka, themi vetëm: “Ji!” – dhe ajo është.
41. Ata që u shpërngulën për Zotin pasi u shtypën do t’i vendosim në këtë botë me të mira ndërsa shpërblimi i së ardhmes është më i madh sikur ta dinin.
42. Janë ata që duruan dhe te Zoti i tyre mbështeten.
43. Nuk dërguam para teje të tjerë, por burra që u kumtuam, - pyesni njerëzit e mesazhit po të mos e dini,

44. - me prova të qarta dhe shkrimet e shenjta. Ty të zbritëm Kujtesën për t'ua sqaruar njerëzve ç'u është shpallur dhe që të mund të mendohen.
45. Mos u siguruan ata që thurin të këqiat se Zoti nuk i fundos në tokë apo s'u vjen pa e kuptuar dënimi?
46. Se nuk i zë në udhë e sipër e të mos i shpëtojnë?
47. Apo t'i zërë në panik? Vërtet, Zoti juaj është i dhembshur, mëshirëplotë.
48. Nuk shohin në krijimin e Zotit si anojnë hijet e tyre djathtas e majtas, me përulje për Zotin, të nënshtruara?
49. Zotit i përulen ç'janë në qiej e në tokë, gjallesa e engjëj dhe nuk mburren.
50. I frikësohen Zotit të tyre sipër dhe bëjnë siç urdhërohen.
51. Zoti ka thënë të mos bëni dy zota. Ai është Një Zot. "Pra, Mua m'u frikësoni!"
52. Atij i përkasin ç'janë në qiej e në tokë dhe feja është gjithmonë për Të. I frikësoheni dikujt tjetër në vend të Zotit?
53. Çdo të mirë e keni prej Zotit, madje, edhe kur ju bie e keqja, Atij i qaheni.
54. Kur jua largon të keqen, ja, disa prej jush i shoqërojnë Zotit idhuj!
55. Për të mohuar çfarë u kemi dhënë. Jetoni dhe do ta mësoni.
56. Bëjnë ndarje me padije nga pjesa që u kemi dhënë. Për Zotin, do të merreni në pyetje se çfarë trilluat!
57. I bëjnë Zotit bija, madhëruar qoftë! Dhe, për vete, ç'të dëshirojnë.
58. Kur dikush përgëzohet me vajzë, i nxihet fytyra e dëshpërohet.

59. U fshihet njerëzve nga lajmi i keq. Ta mbajë atë me turp apo ta fusë në dhé? Sa keq gjykojnë!
60. Shembulli i keq është i atyre që nuk besojnë në të ardhmen. Për Zotin është shembulli më i lartë. Ai është i Plotfuqishmi, i Urti.
61. Sikur Zoti t'i merrte njerëzit me padrejtësitë dhe dhunën e tyre, s'do të linte gjallesë mbi tokë, por i shtyn në afat të caktuar dhe, kur u vjen afati, nuk mund ta vonojnë një orë e ta shpejtojnë.
62. I bëjnë Zotit ç'nuk pëlqejnë vetë dhe thonë me gojë gënjeshtër se u takon parajsa. Pa dyshim, u takon zjarri ku do të futen me ngut.
63. Për Zotin, dërguam të dërguar te popujt para teje, por djalli ua zbukuroi punët! (Zoti betohet në Vetën e Tij) Sot ai është kujdestari i tyre dhe kanë dënim të hidhët.
64. Nuk ta zbritëm Librin për tjetër, por që t'i sqarosh ata që ranë në kundërshti rreth tij dhe drejtim e mëshirë për njerëzit që besojnë.
65. Zoti zbret nga qielli ujë dhe i jep me të jetë tokës së vdekur. Këtu ka dëshmi për njerëzit që dëgjojnë.
66. Keni shembull te bagëtisë: ju japim të pini ç'është në barqet e tyre mes nënproduktit dhe gjakut, qumësht të pastër e të shijshëm për ata që e pijnë.
67. Edhe nga frytet e palmave e të hardhive nxirrni pije dehëse dhe ushqim të mirë. Këtu ka dëshmi për njerëzit që kuptojnë.
68. I kumtoi yt Zot bletës: "Bëj banesë nëpër male, pemë e koshere,
69. ushqehu me fryte dhe ndiq udhët e shkelura të tët Zotit!" Del nga barqet e tyre një lëng me nuanca të ndryshme, shërim për njerëzit. Këtu ka dëshmi për njerëzit që mendojnë.

70. Zoti ju krijoi, pastaj ju vdes; prej jush, disa rëndohen në moshë dhe i lë dija. Zoti është dijeplotë, i plotpushtetshëm.
71. Zoti dalloi në mjetet e jetesës disa mbi të tjerë. Ata që kanë nuk ua japin pjesën e tyre robërve e të jenë në të të barabartë. Të refuzojnë të mirën e Zotit?
72. Zoti bëri për ju, nga ju vetë, bashkëshorte; prej bashkëshorteve, fëmijë e pasardhës dhe ju ushqen me të mira. Besojnë në kotësi dhe mohojnë të mirën e Zotit?
73. Adhurojnë në vend të Zotit ç'nuk zotërojnë gjë për vete në ushqimin nga qiejt e toka dhe as që munden.
74. Pra, mos i bëni shembull Zotit! Zoti di dhe ju nuk dini.
75. Zoti bie shembull një rob nën zotërim, të paaftë për diçka dhe një tjetër që i kemi dhënë pjesë të mirë dhe kontribuon prej saj fshehtas e haptas. Këta, a janë të barabartë? Lavdi Zotit! Por të shumtët nuk dinë.
76. Zoti bie shembull dy burra: njëri i pagojë dhe i paaftë, barrë e të zotit; ngado që ta drejtojë, nuk i sjell dobi. Ky a barazohet me atë që porosit drejtësi dhe është vetë në udhë të drejtë?
77. Zotit i përket e fshehta e qiejve dhe e tokës. Çështja e Orës është sa hap e mbyll sytë, edhe më afër. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.
78. Zoti ju nxori nga barqet e nënave të paditur. Ju bëri të dëgjuarit, të parët dhe zemrat që të mund të jeni mirënjohës.
79. A nuk shohin te shpendët si i janë përshtatur mjedisit të qiellit? Vetëm Zoti i mban. Këtu ka dëshmi për njerëzit që besojnë.
80. Zoti ju bëri shtëpitë tuaja banim dhe, nga lëkurat e kafshëve, shtëpi të lehta për t'u bartur në udhëtim e

vendqëndrim; nga leshi, gëzofi dhe qimet e tyre, tesha e mjete për një kohë.

81. Zoti bëri për ju, nga ç'krijoi, hije; nga malet, strehë; ju bëri veshje për t'u mbrojtur nga të nxehtit dhe veshje për t'u mbrojtur në luftë. E plotëson të mirën e Vet ndaj jush që të jeni muslimanë.
82. Në largohen, ty të takon komunikimi i qartë.
83. E njohin të mirën e Zotit, pastaj e mohojnë. Të shumtët janë mohues.
84. Ditën që ngrejmë nga çdo bashkësi dëshmues, mohuesve nuk u jepet leje, as u pranohet lutje.
85. Kur dhunuesit të përballen me dënimin, nuk u lehtësohet, as rishikohen.
86. Kur idhujtarët të ballafaqohen me idhujt e tyre, do të thonë: "Zoti ynë, këta janë idhujt tanë që iu lutëm në vendin Tënd." Ata ua kthejnë fjalën: "Vërtet, ju jeni gënjeshtarë."
87. I dorëzohen atë ditë Zotit dhe u zhduken trillimet.
88. Atyre që mohojnë dhe pengojnë nga Rrugja e Zotit u shtojmë dënim pas dënimi për të këqiat që bënë.
89. Ditën që ngrejmë nga çdo bashkësi një dëshmitar për të, nga ata vetë, të sjellim ty dëshmues për këta. Të zbritëm Librin, sqarim i gjithçkaje, drejtim, mëshirë dhe sihariq për muslimanët.
90. Zoti porosit drejtësinë, dashamirësinë, dhënien të afërmeve dhe ndalon paudhësinë, të papëlqyeshmen e dhunën. Ju këshillon që të mund të mendoheni.
91. Përmbushni besën e dhënë Zotit dhe mos i thyeni betimet që keni bërë me Zotin dorëzanës. Zoti jua di veprat.
92. Mos jini si ajo që prishi tjerren e vet pasi e endi fort dhe t'i merrni betimet tuaja mashtrim mes jush duke

- qenë njëra bashkësi më e madhe se tjetra. Zoti ju vë në provë me to dhe Ditën e Ringjalljes do t'ju sqarojë se ku ishit në kundërshti.
93. Po të deshte Zoti, ju bënte një bashkësi, por Ai lë të gabojë atë që do dhe drejton atë që do dhe ju, sigurisht, do të pyeteni për veprat tuaja.
94. Mos i merrni betimet tuaja mashtrim mes jush, të rrëshqitni nga pozitat e shëndosha, të shijoni të keqen sepse penguat nga Rruga e Zotit dhe t'ju zërë dënim i madh.
95. Mos blini me Besën e Zotit një çmim të ulët. Ç'është pranë Zotit, është më e mirë për ju sikur ta dinit.
96. Ç'është te ju, shteron dhe, ç'është pranë Zotit, mbetet. Durimtarët do t'i shpërblejmë me më të mirën e veprave të tyre.
97. Cilët bëjnë mirë, meshkuj e femra, si besimtarë, i bëjmë të jetojnë një jetë të mirë dhe do t'i shpërblejmë me më të mirën e veprave të tyre.
98. Kur lexon Kuran, kërko mbrojtjen e Zotit nga djalli i mallkuar.
99. Ai nuk ka fuqi tek ata që besojnë dhe te Zoti i tyre mbështeten.
100. Ka fuqi tek ata që e ndjekin dhe janë idhujtarë të tij.
101. Kur zëvendësojmë një ajet me ajet - Zoti e di se çfarë zbret - thonë: "Ti e ke sajuar." Të shumtët e tyre nuk dinë.
102. Thuaj: "E zbriti Shpirti i Shenjtë nga yt Zot me të vërtetën, t'i përforcojë besimtarët, drejtim dhe sihariq për muslimanët."
103. E dimë se thonë: "E ka mësuar një njeri!" - gjuha e të cilit lënë të kuptohet është e huaj ndërsa kjo, gjuhë e pastër arabe.

104. Ata që nuk besojnë në dëshmitë e Zotit, Zoti s'i drejton dhe kanë dënim të hidhët.
105. Sajojnë gënjeshtër vetëm ata që nuk besojnë në dëshmitë e Zotit. Këta janë gënjeshtarët.
106. Cilët mohojnë pasi besuan - vetëm në detyrohen me forcë, me zemrën plot besim - dhe ia hapin gjoksin mohimit, kanë mbi vete zemërimin e Zotit dhe një dënim të madh.
107. Sepse parapëlqejnë jetën e kësaj bote ndaj së ardhmes. Zoti nuk drejton popullin mohues.
108. Janë ata që Zoti ua vulosi zemrat, të dëgjuarit dhe të parët. Ata janë të shkujdesurit.
109. Pa dyshim, në të ardhmen, janë të humburit.
110. Vërtet, yt Zot, për ata që emigruan pasi u persekutuan dhe luftuan e duruan, yt Zot, pas kësaj, është falës, mëshirëplotë,
111. ditën që çdo frymë vjen të ballafaqohet me vetveten dhe secilit i përmbushet vepra e tij e nuk i bëhet padrejtësi.
112. Zoti sjell shembull një vendbanim në paqe e siguri; i vinte furnizimi me bollëk nga çdo anë dhe mohoi të mirat e Zotit. Zoti e bëri të vishte, me ç'bënë, petkun e urisë e të frikës.
113. U erdhi mes tyre i dërguar, por e përgënjeshtroan dhe i zuri dënimi si dhunues.
114. Ushqehuni me ç'ju ka dhënë Zoti, të lejueshme, të mira dhe falënderoni për të mirën e Zotit nëse vetëm Atë adhuron.
115. Por jua ndaloi ngordhësin, gjakun, mishin e derrit dhe ç'i kushtohet jo Zotit. Nëse dikush shtrëngohet, pa e lakmuar e tepruar, Zoti është falës, mëshirëplotë.

116. Mos thoni të pavërtetat që sajón gjuha juaj se kjo është e lejuar dhe kjo e ndaluar dhe të trilloni ndaj Zotit gënjeshtër. Cilët trillojnë ndaj Zotit gënjeshtër, nuk kanë sukses.
117. Një përfitim i vogël dhe dënim i madh.
118. Edhe judenjve ua ndalua ç' të kemi treguar më parë. Nuk i dhunua Ne, por dhunuan veten.
119. Vërtet, yt Zot, për ata që vepruan keq me padije, pastaj u penduan dhe përmirësuan, yt Zot, pas kësaj, është falës, mëshirëplotë.
120. Ibrahim i qe model, i bindur ndaj Zotit, monoteist dhe nuk ishte idhujtar.
121. Falënderues për të mirat e Tij. Ai e zgjodhi dhe e udhëhoqi në Udhë të Drejtë.
122. I dhamë në botë të mira, edhe në të ardhmen është ndër të mirët.
123. Të kumtuam ty të ndjekësh besimin monoteist të Ibrahimit. Ai nuk ishte idhujtar.
124. E Shtuna iu caktua atyre që ranë në kundërshti për të. Yt Zot do të gjykojë mes tyre, Ditën e Ringjalljes, se ku ranë në kundërshti.
125. Fto në Rrugën e tët Zoti me urtësi e këshillë të mirë dhe diskuto me ta në mënyrën më të mirë. Yt Zot e di cili largohet nga Rrugja e Tij; Ai i di, gjithashtu, ata që janë drejtuar.
126. Në qoftë se kundërpërgjigjeni, përgjigjuni ashtu siç u detyruat të përgjigjeni. Po të duroni, kjo është më e mira për durimtarët.
127. Duro, se durimi yt është vetëm me Zotin. Mos u dëshpëro për ta dhe mos u ngushto prej intrigave të tyre.
128. Zoti është me të devotshmit e mirëbërësit.

17. UDHËTIMI I NATËS (EL ISRA')

Periudha e Mekës, 111 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Madhëruar qoftë Ai që barti robin e Vet, natën, nga Faltorja e Shenjtë te Faltorja e Largët (në Jeruzalem), mjedisin e së cilës e bekuam, për t'i treguar dëshmitë Tona. Ai është Dëgjuesi, Largpamësi.
2. I dhamë Musait Librin dhe e bëmë drejtim te bijtë e Izraelit: “Mos merrni të besuar të tjerë në vendin Tim!”
3. Pasardhës të atyre që bartëm me Nuhin. Ai ishte rob mirënjohës.
4. Ua parashkruam bijve të Izraelit në libër se: “Do të shkaktoni dy herë mosmarrëveshje në tokë dhe do të ushtroni tirani të madhe.”
5. Kur u realizua paralajmërimi i parë, dërguam kundër jush robtë Tanë me fuqi të rreptë që shkelën shtëpi më shtëpi. Ishte paralajmërim i kryer.
6. Pastaj jua kthyem radhën kundër tyre dhe ju përforcuam me pasuri, djem e trupa të shumtë.
7. Në bëni mirë, i bëni mirë vetes suaj; në bëni keq, ia bëni vetes. Kur të realizohej paralajmërimi i dytë, do t'jua prishnin fytyrat dhe do t'i hynin faltores siç i hynë herën e parë duke rrënuar gjithçka që arrinin.
8. Ndoshta Zoti ju mëshiron, por, nëse e përsëritni, e përsërisim. E bëmë skëterrën qelinë e mohuesve.

9. Ky Kuran drejton te më e qëndrueshmja dhe përgëzon besimtarët, ata që bëjnë të mira, se kanë shpërblim të madh.
10. Atyre që nuk besojnë në të ardhmen u përgatitëm dënim të hidhët.
11. Njeriu kërkon të keqen në vend të së mirës. Njeriu është i nxituar.
12. I bëmë natën dhe ditën dy dukuri: errësua dukurinë e natës dhe e bëmë të dukshme dukurinë e ditës që ju të mund të kërkon mirësi nga Zoti juaj e të njihni numërimin vjetor dhe përlllogaritjen. Gjithçka e shtjellua me hollësi.
13. Çdo njeriu i varëm etiketën e tij në qafë dhe Ditën e Ringjalljes ia nxjerrim libër të hapur:
14. "Lexoje librin tënd! Mjafton, sot, ti, vetë, në llogarinë tënde."
15. Kush merr rrugën e drejtë, është drejtuar për vete; kush shkon në rrugë të gabuar, ka gabuar ndaj vetes. Askush nuk mban barrën e tjetrit. Ne nuk dënojmë pa dërguar një të dërguar.
16. Kur duam ta prishim një vend, urdhërojmë të kamurit e tij; ata rebelojnë dhe përlligjet fjala. E rrënojmë atë në themel.
17. Sa a sa brezni zhdukëm pas Nuhit! Mjafton yt Zot, i gjithëditur dhe largpamës për mëkatet e robërve të Vet.
18. Kujt dëshiron të përkohshmen, ia shpejtojmë aty ku duam, atij që duam. Pastaj ia bëjmë skëterrën ku hyn i fajësuar, i përzënë.
19. Kush dëshiron të ardhmen dhe përpiket për të si besimtar, përpjekjen e tij e ka të mirënjohur.

20. Ne i furnizojmë të gjithë, ata e këta, me dhuratën e tët Zoti. Dhurata e tët Zoti nuk është e kufizuar.
21. Shih si dallojmë disa mbi të tjerë, por e ardhmja është shkalla më e lartë dhe mirësia më e madhe.
22. Mos bëj me Zotin tjetër zot e të mbetesh i fajësuar, i braktisur.
23. Yt Zot ka urdhëruar të adhuroni vetëm Atë dhe, me prindërit, të silleni mirë. Kur njërin prej tyre apo të dy i zë pleqëria pranë teje, mos u thuaj: “Uf!” dhe mos i qorto, por folu me respekt.
24. Ji me ta i përlur, si mëshirë dhe thuaj: “Im Zot, mëshiroji ata siç më rritën të mitur.”
25. Zoti juaj e di më së miri se ç'keni në vetvete. Në jeni të drejtë, Ai i fal ata që kthehen të penduar.
26. Jepu të afërmve, të varfërve dhe rrugëtarëve të drejtën e tyre dhe mos shpërdoro!
27. Shpërdoruesit janë vëllezërit e djajve dhe djalli është mosmirënjohës i Zotit të tij.
28. Në qoftë se u largohesh, me shpresë në mëshirën e tët Zoti, thuaju fjalë lehtësuese.
29. Mos e mbaj dorën lidhur pas qafe dhe mos e shtrij jashtë mase e të mbetesh fajtor, i mjerë.
30. Yt Zot ia zgjeron të mirat atij që do dhe ia kufizon. Ai është i gjithëditur, largpamës për robtë e Vet.
31. Mos i mbytni fëmijët nga frika e varfërisë. Ne i ushqejmë ata dhe juve. Mbytja e tyre është faj i madh.
32. Mos iu afroni imoralitetit që është paudhësi dhe rrugë shumë e keqe.
33. Mos vrisni një frymë që Zoti e ka ndaluar, porse vetëm me të drejtë. Në vritet padrejtësisht, i japim autoritet kujdestarit të tij dhe ky të mos shpërdorojë në vrasje duke qenë i mbështetur.

34. Mos iu afroni pasurisë së jetimit, por në mënyrën më të mirë, derisa të arrijë pjekurinë. Përmbushni marrëveshjen sepse marrëveshja është përgjegjësi.
35. Plotësoni masën kur matni dhe peshoni me peshojë të saktë. Kjo është më e mirë dhe më e ndershme në përfundim.
36. Mos ndiq diçka ku nuk ke dije. Të dëgjuarit, të parët dhe zemra kanë secila përgjegjësi.
37. Mos ec në tokë me mburrje. Vërtet, ti nuk mund të çash tokën, as i arrin malet në lartësi.
38. E gjitha kjo, me të keqen e saj, është e urryer te yt Zot.
39. Kështu, me urtësinë që të frymëzoi yt Zot. Dhe mos i bëj Zotit tjetër zot e të hidhesh në skëterrë i fajësuar, i përzënë.
40. Mos ju zgjodhi Zoti me djem dhe mori për vete prej engjëjve bija? Ju po thoni fjalë të rënda.
41. E shtjelluam këtë Kuran që ata të mund të mendohen, porse u shtoi ikjen.
42. Thuaj: “Po të qenë me Të zota të tjerë, siç thonë, do të kërkonin rrugë për pushtet.”
43. Madhëruar qoftë, i lartë nga ç’thonë, madhështor!
44. E madhërojnë shtatë qiejt, toka dhe ç’janë në to. S’ka gjë që të mos i thurë lavde, por ju nuk ua kuptoni lavdet. Ai është i butë, falës.
45. Kur reciton Kuran, bëjmë perde mes teje dhe atyre që nuk besojnë në të ardhmen.
46. Në zemrat e tyre vëmë shtresa që të mos e ndiejnë dhe, në veshët e tyre, shurdhim. Kur përmend tët Zot në Kuran, Një të Vetëm, prapësohen në ikje.

47. Ne e dimë si dëgjojnë kur të dëgjojnë dhe kur të pabesët pëshpërisin e thonë: “Po ndiqni një njeri të magjepsur!”
48. Shih si të bëjnë shembull, çoroditen dhe s’mund të gjejnë udhë.
49. Thonë: “Kur të bëhemi kocka e thërri me, ngrihemi në krijim të ri?”
50. Thuaj: “Qofshi gurë ose hekur.
51. A një krijesë e stërmadhe në ndërgjegjen tuaj.” Do të thonë: “Kush na rikthen?” Thuaj: “Kush ju krijoi për herë të parë.” Tundin kryet dhe thonë: “Kur?” Thuaj: “Ndoshta së afërmi.”
52. Ditën kur Ai ju thërret dhe i përgjigjeni me lavde, do ta besoni se qëndruat fare pak.
53. Thuaju robërve të Mi të thonë të mirën sepse djalli i provokon. Djalli është për njeriun armik i hapur.
54. Zoti ju njeh. Po të dojë, ju mëshiron; po të dojë, ju dënon. Ty nuk të dërguam për ta dorëzues.
55. Zoti di ç’janë në qiej e në tokë. Dalluam disa profetë mbi të tjerë dhe Davudit i dhamë Zeburin.
56. Thuaj: “Thirrni atyre që pretendoni në vend të Tij! S’kanë fuqi t’jua largojnë të keqen, as ta ndryshojnë.
57. Ata që u luten kërkojnë mjet afrimi te Zoti, shpresojnë mëshirën e Tij dhe i tremben dënimit të Tij. Vërtet, dënimit të tët Zoti duhet t’i ruhesh.
58. S’ka vendbanim që të mos e kemi shkatërruar para Ditës së Ringjalljes ose të mos e kemi ndëshkuar rreptë. Kjo është e shkruar në libër.
59. Nuk na pengoi gjë të dërgonim shenja, porse të parët i përgënjeshtroan. U dhamë themudëve devenë në mënyrë të qartë dhe ata e dhunuan. I dërguam shenjat si paralajmërim.

60. Edhe kur të themi se yt Zot i rrethon njerëzit. Vegimin që të shfaqëm dhe pemën e mallkuar, në Kuran, i bëmë provë për njerëzit. Ne i frikësojmë ndërsa atyre ua shton më tepër mosbindjen.
61. Kur u thamë engjëjve: "Përlujuni Ademit!" – u përlën, përveç Iblisit. Tha: "T'i përulem atij që krijove nga balta?"-
62. - tha: "Ja kë nderove mbi mua! Në qoftë se ma shtyn deri Ditën e Ringjalljes, përjashtuar një pakice, do t'i zë pasardhësit e tij te freri."
63. Tha: "Shko! Në të ndjekin ty, skëterra është shpërblimi juaj, një shpërblim më se i mjaftueshëm.
64. Dhe nxit kë të mundësh me zërin tënd, vëri para me kalorësit dhe këmbësorët e tu, bëhu me ta pjesëtar në mall e fëmijë dhe premtu. Djalli u premtonte mashtrim.
65. Vërtet, ti nuk ke fuqi mbi robtë e Mi!" Mjafton yt Zot dorëzanës.
66. Zoti juaj është Ai që shtyn anijet në det në kërkim të mirësive të Tij. Ai është me ju mëshirëplotë.
67. Kur ju zë e keqja në det, zhduken çfarë lusnit në vend të Tij. Sapo ju shpëton në tokë, largoheni. Njeriu është mosmirënjohës.
68. Mos jeni të sigurt se nuk fundos bashkë me ju një pjesë toke a të dërgojë ndonjë uragan e të mos gjeni mbrojtës?
69. Mos jeni të sigurt se nuk ju kthen në të tjetër herë, t'ju dërgojë një stuhi me erë të fortë dhe t'ju fundosë sepse mohuat? Pastaj, nuk do të gjeni ndaj Nesh përkrahës.
70. I nderuam bijtë e Ademit, i bartëm në tokë e në det, i ushqyem me të mira dhe i dalluam në përparësi mbi shumicën e krijesave.

71. Ditën që thërrasim çdo popull me udhëheqësit e tyre, kujt i jepet libri në të djathtë, e lexon librin e vet dhe nuk i bëhet aspak e padrejtë.
72. Kush është këtu i verbër, i verbër mbetet në të ardhmen dhe i humbur nga rruga.
73. Gati të tunduan të sajoje për Ne ndryshe nga ç'të kumtuam dhe të të bënin, atëherë, mik.
74. Po të të mos forconim, do të anojë diçka nga ata.
75. Dhe do të të bënim ta pësoje dyfish në jetë e dyfish në vdekje e nuk do të gjeje ndaj Nesh përkrahës.
76. Gati do të të shkulinin nga vendi e të dëbonin; atëherë, pak kohë do të qëndronin pas teje.
77. Udhë e profetëve që dërguam para teje. Nuk do të gjesh ndryshim në Udhën Tonë.
78. Kryej të falurit, me rënien e diellit, deri në errësimin e natës dhe këndimin e mëngjesit. Vërtet, Kurani i mëngjesit është i dëshmuar.
79. Kalo një pjesë nate me të, si shtesë, që yt Zot të të ngrejë në pozitë të lëvduar.
80. Thuaj: "Im Zot, bëmë të hyj në një hyrje të vërtetë dhe të dal në një dalje të vërtetë; bëj për mua, nga ana Jote, autoritet mbrojtës."
81. Thuaj: "Erdhi e vërteta dhe u zhduk e pavërteta. E pavërteta është në zhdukje."
82. Dhe të shpallim nga Kurani, shërim e mëshirë për besimtarët ndërsa të pabesëve u shton humbje.
83. Kur i japim njeriut të mira, shmangjet e rri mënjanë; kur e zë e keqja, është i pashpresë.
84. Thuaj: "Secili vepron sipas mënyrës së vet. Zoti juaj e di se kush është në rrugë të drejtë."
85. Të pyesin rreth shpirtit, thuaj: "Shpirti është çështje e tim Zoti dhe ju keni pak dijeni."

86. Po të donim, ta hiqim komunikimin dhe ti nuk do të gjeje për të, ndaj Nesh, mbrojtës.
87. Vetëm si mëshirë nga yt Zot. Mirësia e Tij ndaj teje është e madhe.
88. Thuaj: "Sikur të mblidheshin njerëzit e xhinët, të sillnin një Kuran si ky, nuk do t'ia dilnin edhe po të bashkëpunonin."
89. U shtjelluam njerëzve në këtë Kuran gjithfarë shembujsh, por të shumtët e tyre refuzojnë me mohim.
90. Thonë: "S'të besojmë pa na nxjerrë nga toka një burim.
91. A të kesh një kopsht hurmash e rrushi e të nxjerrësh përmes rrjedhë lumenjsh.
92. Ose të bësh të na bien copa qielli, siç thua, a të sjellësh Zotin dhe engjëjt përballë.
93. Edhe sikur të kesh një shtëpi të artë ose të ngjitesh në qiell, nuk do ta besojmë ngjitjen tënde pa na zbritur një libër që ta lexojmë." Thuaj: "Lëvduar qoftë im Zot! A nuk jam unë vetëm njeri, një i dërguar?"
94. Nuk i pengoi gjë njerëzit të besonin kur u erdhi drejtimi, por vetëm ngaqë thanë: "Paska dërguar Zoti një njeri si të dërguar?"
95. Thuaj: "Po të ishin në tokë engjëj, të ecnin rëndom, do t'u zbritnim nga qielli një engjëll si të dërguar."
96. Thuaj: "Mjafton Zoti dëshmues mes meje e jush. Ai është për robtë e Vet i gjithëditur, largpamës."
97. Kë drejton Zoti, është i udhëhequr drejt; cilët lë të gabojnë, s'mund t'u gjesh, në vend të Tij, kujdestarë. I tubojmë Ditën e Ringjalljes si turmë: të verbër, memecë, të shurdhër. Streha e tyre është skëterra. Sa herë shuhet, u shtojmë zjarr.

98. Ky është shpërblimi i tyre pasi mohuan dëshmitë Tona dhe thanë: “Kur të bëhemi kocka e thërrime, ngrihemi në krijim të ri?”
99. A nuk vërejnë se Zoti që krijoi qiejt e tokën është i pushtetshëm të krijojë si ato? Dhe bëri për ta një afat ku s’ka dyshim. Mirëpo të pabesët refuzojnë me mohim.
100. Thuaj: “Edhe sikur të zotëronit thesaret e mëshirës së tim Zoti, do t’i mbanit vetë nga frika se mos ju shterojnë.” Njeriu është tepër i ngushtë.
101. I dhamë Musait nëntë dëshmi të qarta. Pyeti bijtë e Izraelit kur u erdhi ai dhe faraoni i tha: “Unë të shoh, o Musa, të magjepsur.”
102. Tha: “Tashmë ti e di se këto i ka zbritur Zoti i qiejve dhe i tokës si ndriçim, por unë të shoh ty, o faraon, të humbur.”
103. Deshi t’i shkulte nga vendi dhe Ne mbytëm atë e ç’qenë me të, bashkë.
104. U thamë, pas tij, bijve të Izraelit: “Banoni në tokë dhe, kur të ketë ardhur afati i së ardhmes, ju sjellim të gjithë.”
105. Ne e zbritëm atë me të vërtetën dhe me të vërtetën zbriti; të dërguam ty përgëzues e paralajmërues.
106. Një Kuran që e ndamë në pjesë, t’ua lexosh njerëzve me ndalesa dhe e zbritëm me faza.
107. Thuaj: “E besoni apo nuk e besoni, ata që u është dhënë më parë dija, kur u recitohet, bien me mjekër në tokë.
108. Dhe thonë: “Madhëruar qoftë Zoti ynë! Premtimi i Zotit tonë është i kryer.”
109. Bien me mjekër duke qarë dhe u shtohet përulja.

110. Thuaj: “Thërrisni “All-llah” apo thërrisni “Rahman”, sido që të thërrisni, Atij i takojnë emrat fisnikë.”” Dhe mos e ngre zërin kur falesh, as mos e ul, por kërko një mënyrë të mesme.
111. Thuaj: “Lavdi Zotit i Cili nuk ka marrë bir e pjesëmarrës në sundim, as mbrojtës në pamundësi!” Dhe madhëroje Atë me lavde.

18. SHPELLA (EL KEHF)

Periudha e Mekës, 110 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Lavdi Zotit që i zbriti robit të Vet librin pa shtrembërime!
2. Drejt, të tërheqë vëmendjen për një ndëshkim të rreptë nga ana e Tij dhe t'i përgëzojë besimtarët që bëjnë të mira se kanë shpërblim bujar,
3. ku do të jenë përgjithmonë.
4. T'u tërheqë vëmendjen edhe atyre që thonë: “Zoti ka bërë bir.”
5. Ata nuk kanë dije për të, as etërit e tyre. Fjalë e rëndë u del nga goja. Thonë vetëm se gënjeshtër.
6. Ndoshta vret veten nga brenga se nuk besojnë në këtë fjalë.
7. Ne bëmë gjithçka mbi tokë stoli të saj për t'i provuar ata se cili është më i mirë në vepra.
8. Dhe Ne e bëjmë gjithçka mbi të, tokë të tharë.
9. Mos mendon se njerëzit e shpellës dhe mbishkrimi qenë ndër shenjat Tona një çudi?

10. Kur të rinjtë gjetën strehë te shpella dhe thanë: “Zoti ynë, jepna prej Teje mëshirë dhe mbarësna në çështjen tonë,”
11. - ua zumë veshët në shpellë për vite me radhë.
12. Pastaj i ngritëm, ta dimë cila nga dy palët e llogariti më mirë kohëqëndrimin.
13. Po të rrëfejmë ndodhinë e tyre me të vërtetën. Ishin të rinj që besonin Zotin dhe Ne ua përforcuam drejtimin.
14. Dhe i forcuam zemrat e tyre kur u ngritën e thanë: “Zoti ynë është Zoti i qiejve e i tokës dhe ne nuk lusim zot veç Tij. Do të thonim, atëherë, diçka jo të drejtë.
15. Bashkëkombësit tanë morën, në vend të Tij, zota, pa sjellë për ta ndonjë argument të qartë. Kush është më i padrejtë se ai që trillon ndaj Zotit gënjeshtër?”
16. Kur u tërhoqët prej tyre dhe adhurimit në vend të Zotit: “Bëni strehë në shpellë! Zoti juaj do hapë për ju Mëshirën e Vet dhe do t’ju bëjë lehtësi të çështjes suaj.”
17. E shihje diellin tek lindte, t’i vinte shpellës nga e djathta; kur perëndonte, t’u përvdij nga e majta dhe ata rrinin në një guvë të saj. Qe ndër dëshmitë e Zotit. Kë drejton Zoti, është i udhëhequr drejt; kë lë të gabojë, nuk mund t’i gjesh kujdestar udhërrëfyes.
18. I mendoje zgjuar tek qenë në gjumë. I kthenim djathtas e majtas ndërsa qeni i tyre kishte zgjatur këmbët te hyrja. Po të ndeshje në ta, ikje i frikësuar.
19. Kështu, i ngritëm të pyesnin njëri-tjetrin. Njëri tha: “Sa qëndruat?” Thanë: “Qëndruam një ditë a një pjesë dite.” Thanë: “Zoti e di më mirë sa qëndruat. Dërgoni njërin prej jush me këtë monedhë në qytet të gjejë ushqim të pastër dhe le të sjellë furnizim prej tij e të jetë i kujdesshëm të mos bëjë fjalë për ju.

20. Po t'ju zbulojnë, ju gjuajnë me gurë ose ju kthejnë në kultin e tyre dhe nuk do t'ia dilni kurrë mbarë.”
21. I bëmë kështu të njohur, ta dinë se premtimi i Zotit është i vërtetë, pa dyshim, edhe Ora. Kur diskutonin për ta, thanë: “Ngrejuni një monument!” Zoti i njeh më mirë. Ata që e fituan çështjen, thanë: “Le të bëjmë pranë një faltore!”
22. Do të thonë: “Tre, i katërti, qeni i tyre.” Dhe thonë: “Pesë, i gjashti, qeni i tyre.” Hamendje për të panjohurën. Thonë: “Shtatë, i teti, qeni i tyre.” Thuaj: “Im Zot e di numrin e tyre.” Pak dinë për ta. Diskuto rreth tyre në dukje dhe mos kërko te ata ndonjë vendim.
23. Mos thuaj për diçka: “Do ta bëj nesër!”
24. Por: “Në dashtë Zoti!” Përmende tët Zot kur harron dhe thuaj: “Ndoshta im Zot më orienton drejt, më afër nga kjo.”
25. Se qëndruan në shpellë treqint vjet. I shtuan edhe nëntë.
26. Thuaj: “Zoti e di sa qëndruan. Atij i takon e panjohura e qiejve dhe e tokës. Ai sheh e dëgjon më së miri. Nuk kanë veç Tij kujdestar. Ai nuk bën pjesëtar në sundim.”
27. Ti recito çfarë të kumtohet nga Libri i tët Zoti. Askush nuk mund të zëvendësojë fjalët e Tij dhe nuk do të gjeje, në vend të Tij, nga të anosh.
28. Mbahu me ata që lusin Zotin mëngjes e mbrëmje, për hir të Tij dhe mos i kthe sytë prej tyre duke kërkuar stolinë e jetës së kësaj bote. Mos iu bind dikujt zemrën e të cilit e bëmë të shkujdesur në përmendjen Tonë, që ndjek pasionin ndërsa çështja e tij i ka kaluar kufijtë.

29. Thuaj: “E vërteta është nga Zoti. Kush të dojë, të besojë; kush të dojë, të mohojë!” U përgatitëm dhunuesve një zjarr muret e të cilit i kanë rrethuar. Në kërkojnë ndihmë, u jepet ujë - katran që ua përzhit fytyrën. Ç’pije e keqe, ç’vendpushimi i keq!
30. Cilët besojnë e bëjnë të mira, - Ne nuk ia humbim shpërblimin atij që vepron mirë,-
31. kanë kopshtet e Edenit ku rrjedhin lumenj. Stolisur, atje, me byzylykë floriri dhe veshur me petka të gjelbra mëndafshi, qëndisur në ar, mbështeten në frona të lartë. Ç’shpërblim i mirë, ç’vendpushimi i mirë!
32. Sillu atyre si shembull dy njerëz: njërit i bëmë dy kopshte me vreshta rrushi, përqark, palma hurmash dhe një arë në mes.
33. Secili nga kopshtet jepte frytet e tij dhe nuk mungonte gjë. Bëmë të gufonte nëpër to një lumë.
34. Ai kishte prodhim dhe i tha shokut në bisedë e sipër: “Unë kam më shumë se ty mall dhe jam më i fuqishëm në frymë.”
35. Hyri në kopsht si i dhunues i vetvetes dhe tha: “Nuk besoj të zhduket kjo ndonjëherë.
36. Dhe nuk besoj se Ora po vjen. Por edhe sikur t’i kthehem tim zoti, do të gjej në fund të fundit diçka më të mirë.”
37. I tha shoku në bisedë e sipër: “Po mohon kë të krijoi nga dheu, pastaj nga një pikë lëngu e të bëri njeri?
38. Për mua, Allahu është im zot dhe nuk i shoqëroj Zotit dikë tjetër.
39. Kur hyre në kopsht, përse nuk the: “Me dashjen e Zotit, s’ka fuqi veç Zotit?” Në më sheh që kam më pak mall e fëmijë,

40. ndoshta im Zot më jep diçka më të mirë nga kopshti yt, dërgon mbi të një breshër nga qielli dhe bëhet tokë e lëmuar?
41. Ose i shteron ujët dhe nuk mund ta nxjerrësh?”
42. Iu prish prodhimi dhe zuri të përdridhte duart për shpenzimin e bërë kur çdo gjë kishte rënë në tokë. Tha: “I mjeri unë, të mos i bëja Zotit shok!”
43. Dhe nuk iu bë, në vend të Zotit, ndonjë palë që ta ndihmonte, as mund të ndihmonte vetveten.
44. Kujdestaria i përket vetëm Zotit, të Vërtetit. Ai është më i miri në shpërblim, më i miri në përfundim.
45. Jepu shembullin e jetës së kësaj bote, si uji që zbresim prej qiellit, harliset me të bimësia e tokës, pastaj bëhet byk dhe e shpërndajnë erërat. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.
46. Malli dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj bote, por veprat e mira dhe të vazhdueshme kanë më vlerë të yt Zot në shpërblime, më vlerë në shpresë.
47. Ditën kur zhvendosim malet dhe sheh tokën të zhveshur, i tubojmë pa mungesë.
48. Dalin para tët Zoti në radhë: “Ja tek Na erdhët siç ju krijuam herën e parë! Mendonit se nuk do t’ju linim pikëpjekje.”
49. Vihet Libri dhe i sheh fajtorët të shqetësuar. Thonë: “Mjerë ne! Ç’është ky libër që nuk lë të vogël a të madhe pa numëruar?” I gjejnë të pranishme veprat e tyre. Zoti nuk i bën kujt padrejtësi.
50. Kur u thamë engjëjve: “Përlujuni Ademit!” – u përlën, përveç Iblisit. Ishte ndër xhinët dhe nuk iu bind urdhrit të Zotit. A merrni, në vendin Tim, atë dhe pasardhësit e tij për kujdestarë tek janë armiqtë tuaj? Këmbim i keq i dhunuesve.

51. Nuk i bëra ata dëshmues në krijimin e qiejve e të tokës, as në krijimin e tyre dhe nuk i mora të humburit në ndihmë.
52. Ditën kur Ai do të thotë: "Thirruni shoqëruesve të Mi që pretendonit!" – u thërrasin e s'u përgjigjen. Bëjmë mes tyre një humnerë.
53. Mëkatarët shohin zjarrin dhe e besojnë se po bien në të. Nuk gjejnë prej tij dalje.
54. Shtjelluam në këtë Kuran shembuj të ndryshëm për njerëzit, por njeriu është, mbi të gjitha, kundërshtues.
55. S'i pengoi gjë njerëzit të besonin dhe t'i kërkonin falje Zotit kur u erdhi drejtimi, porse që t'u vinte përvoja e të parëve a t'u vinte ballë për ballë dënimi.
56. Dërguam të dërguarit si përgëzues e paralajmërues ndërsa mohuesit kundërshtojnë me të pavërtetën për të hedhur poshtë të vërtetën. I marrin dëshmitë dhe paralajmërimet e Mia me mospërfillje.
57. A ka më të padrejtë se ata që u përmenden dëshmitë e Zotit dhe shmangen e harrojnë ç'u përgatitën duart? Në zemrat e tyre bëmë perde e nuk kuptojnë dhe në veshët e tyre, shurdhim. Në i thërret te drejtimi, nuk do të drejtohen, pra, kurrë.
58. Yt Zot është Falësi, Zotëruesi i Mëshirës. Sikur t'i merrte me ç'fituan, do t'ua shpejtonte dënimin, por ka për ta një afat nga s'mund të shpëtojnë.
59. Këto vendbanime i shkatërruam pasi dhunuan dhe bëmë për shkatërrimin e tyre një kohë të caktuar.
60. Kur Musai i tha shërbyesit: "Edhe sikur të vazhdoj me shekuj, nuk ndalem pa arritur atje ku bashkohen dy detet", -
61. sapo arritën vendin ku puqen, harruan peshkun dhe ai mori udhën e humbi në det.

62. Kur kapërcyen matanë, i tha shërbyesit: “Sillna mëngjesin! Ky udhëtim na lodhi shumë.”
63. Tha: “Pa shih! Kur pushuam te shkëmbi, harrova peshkun - djalli më bëri ta harroj e të mos e sjell ndërmend – dhe ai, papritur, paska marrë rrugën e tij në det.”
64. Tha: “Ja, këtë deshim!” Dhe u kthyen pas gjurmëve të tyre.
65. Gjetën një rob ndër robtë Tanë të cilit i patëm dhënë prej Nesh mëshirë dhe i mësuam nga ana Jonë dije.
66. Musai i tha: “A të të ndjek të më mësosh nga urtësia që ke marrë?”
67. Tha: “Ti s'mund të bësh me mua durim.
68. Si të durosh ku s'ta nxë dija?”
69. Tha: “Do të më gjesh, dashtë Zoti, durimtar dhe nuk do të të kundërshtoj.”
70. Tha: “Në më ndjek, mos më pyet pa të bërë për të një kujtesë.”
71. Morën udhë derisa, kur hipën në një anije, ai e shqeu atë. I tha: “E shqeve që të mbytësh njerëzit e saj? Bëre diçka të rëndë.”
72. Tha: “A nuk të thashë që s'mund të bësh me mua durim?”
73. Tha: “Mos më qorto sepse harrova dhe mos ma vështirëso çështjen.”
74. Morën udhë derisa, kur takuan një djalë, ai e vrau. I tha: “Vrave një frymë të pafajshme jo për frymë? Bëre diçka të urryer.”
75. Tha: “A nuk të thashë që s'mund të bësh me mua durim?”
76. Tha: “Në të pyes përsëri, mos më mbaj pranë. Tani ke prej meje një shkak.”

77. Morën udhë derisa, kur arritën te banorët e një fshati, u kërkuan njerëzve bukë dhe ata nuk u treguan mikpritës. Gjetën atje një mur duke rënë dhe ai e ngriti. Tha: “Po të doje, merrje për të shpërblim.”
78. Tha: “Kjo është ndarja jonë. Do të të shpjegoj kuptimin e atyre ku s'munde të bësh durim.
79. Sa për anijen, qe pronë e disa të varfërve që punonin në det. Desha ta dëmtoja pasi një mbret po merr me forcë çdo anije.
80. Sa për të riun, prindërit e tij ishin besimtarë dhe druanim se ai do t'i shtypte me tirani e mohim.
81. Dëshëm që Zoti t'ua këmbejë me një më të mirë në bamirësi dhe më pranë në mëshirë.
82. Sa për murin, ishte pronë e dy djemve jetimë në qytet babai i të cilëve qe njeri i drejtë. Aty poshtë kanë një thesar. Yt Zot dëshiron të arrijnë pjekurinë dhe ta nxjerrin thesarin si mëshirë prej tët Zoti. Unë nuk veprova me autoritetin tim. Ja, pra, kuptimi i atyre ku s'munde të bësh durim.”
83. Të pyesin për Dybrirëshin, thuaj: “Do t'ju recitoj rreth tij një kujtesë.”
84. E bëmë atë të fuqishëm në tokë dhe ia hapëm udhët në çdo drejtim.
85. Ndoqi një udhë.
86. Derisa, kur arriti në perëndim të diellit, e gjeti të perëndonte në një burim me baltë. Gjeti aty pranë një komb. I thamë: “O i zoti i Dy Brirëve! Mund t'i dënosh ose t'i marrësh me të mirë.”
87. Tha: “Kë dhunon, do ta dënojmë; pastaj kthehet te Zoti i tij dhe Ai e dënon me dënim të keq.
88. Kush beson e bën të mira, ka si shpërblim parajsën dhe i japim nga ana jonë lehtësi.”

89. Pastaj ndoqi një udhë.
90. Derisa, kur arriti lindjen e diellit, pa të lindte pranë një kombi që nuk i patëm bërë prej tij mbrojtë.
91. Kështu, Ne qemë për të në dijeni.
92. Pastaj ndoqi një udhë.
93. Derisa, kur arriti mes dy shpatesh, gjeti pas tyre një komb që gati nuk kuptonte ndonjë fjalë.
94. Thanë: "O i zoti i Dy Brirëve! Jexhuxhët dhe mexhuxhët bëjnë të këqia në tokë. A të të paguajmë haraç të na bësh në mes një barrierë?"
95. Tha: "Ç'më ka dhënë Zoti është më e mirë, por ju ndihmomëni me krah pune të bëj në mes një pritë.
96. Më sillni blloqe hekuri!" Derisa, kur i rrafshoi dy shpatet, tha: "Fryjini!" Derisa, kur e bëri zjarr, tha: "Më sillni bakër të shkrirë t'ia derdh sipër!"
97. Dhe nuk do të mund ta kalonin, as ta çanin.
98. Tha: "Kjo është mëshirë prej tim Zoti. Dhe, kur të vijë paralajmërimi i tim Zoti, e bën atë copë e thërriime. Paralajmërimi i tim Zoti është i vërtetë."
99. Atë ditë i lëmë disa të vërshojnë mbi të tjerë, i fryhet bririt dhe i mbledhim të gjithë.
100. E hapim atë ditë skëterrën hapur për mohuesit,
101. që ishin rreth Kujtesës Sime symbyllur, as mund të dëgjonin.
102. Pandehin mohuesit të marrin në vendin Tim robtë e Mi për mbrojtës? U përgatitëm mohuesve skëterrën - pritje.
103. Thuaj: "Doni t'jua bëjmë të ditur cilët janë më të humburit në vepra?
104. Janë ata që u shkuan më kot përpjekjet në jetën e kësaj bote dhe pandehin se bëjnë punë të mirë;

105. që mohuan dëshmitë e Zotit dhe takimin me Të.”
Dështuan veprat e tyre dhe, Ditën e Ringjalljes, nuk do të vëmë për ta peshojë.
106. Shpërblimi i tyre është skëterra sepse mohuan dhe i morën me mospërfillje dëshmitë e Mia dhe të dërguarit e Mi.
107. Cilët besojnë e bëjnë të mira, kanë kopshtet Firdeus - pritje.
108. Të përhershëm në to, nuk duan prej tyre shpërngulje.
109. Thuaj: “Po të qe deti bojë për fjalët e tim Zoti, do të shteronte deti para se të shteronin fjalët e tim Zoti edhe sikur të sillnim po aq.”
110. Thuaj: “Unë jam njeri si ju. M’u kumtua se Zoti juaj është një Zot. Kush shpreson takimin e Zotit, le të bëjë një vepër të mirë dhe të mos i shoqërojë dikë adhurimit të Zotit.

19. MERJEMI (MERJEM)

Periudha e Mekës, 98 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Qef, he, je, ajn, sad. (Shkronjat: q, h, j, a, s)
2. Kujtesë e mëshirës së tët Zoti për robin e Vet, Zekerija.
3. Kur i thirri Zotit me një thirrje të thellë,
4. tha: “Im Zot, mua m’u dobësuan eshtrat dhe m’u zbardh kryet, por nuk jam i mjerë në lutjen time për Ty, o Zot.

5. Unë u frikësohem trashëgimtarëve pas meje dhe ime shoqe është shterpë. Më jep nga ana Jote një kujdestar,
6. të më trashëgojë mua, të trashëgojë familjen e Jakubit dhe bëje atë, Zoti im, të pëlqyeshëm!”
7. “O Zekerija! Ne të përgëzojmë me një djalë. Emri i tij është Jahja. Nuk i kemi bërë më parë njëemërsh.”
8. Tha: “Im Zot, si mund të kem djalë kur gruaja ime është shterpë ndërsa unë arrita pleqëri të shtyrë?”
9. Tha: “Ja, kështu. Yt Zot thotë: “Për mua, kjo është e lehtë. Unë të krijova më parë kur ti s’ishe gjë.””
10. Tha: “Im Zot, më jep një shenjë!” Tha: “Shenja jote: nuk do t’u flasësh njerëzve tri ditë e netë me radhë.”
11. Doli nga altari, pranë njerëzve të tij dhe u kumtoi: “Madhëroni Zotin mëngjes e mbrëmje!”
12. “O Jahja, mbaje Librin fort!” I dhamë gjykim që fëmijë.
13. Mëshirë nga ana Jonë e dëlirësi. Ishte i devotshëm,
14. i sjellshëm me prindërit, nuk qe kryelartë e i pabindur.
15. Paqja qoftë me të ditën që u lind, ditën që vdes dhe ditën që ringjallet!
16. Përmende në libër Merjemin kur u veçua prej njerëzve të saj në një vend nga lindja;
17. u nda prej tyre me perde dhe i dërguam engjëllin Tonë që i shëmbëlleu si njeri i pashëm.
18. Ajo tha: “Mbrohem prej teje me Bamirësin në i frikësohesh Zotit!”
19. Tha: “Unë jam i dërguar nga yt Zot të të dhuroj një djalë të dëlirë.”
20. Tha: “Si të kem djalë kur s’më ka prekur njeri, as jam e pandershme?”

21. Tha: "Ja, kështu. Yt Zot ka thënë: "Për mua, kjo është e lehtë. Që ta bëjmë atë dëshmi për njerëzit dhe mëshirë prej Nesh. Është urdhër i kryer.""
22. E barti dhe u tërhoq me të diku larg.
23. I erdhën dhimbjet e lindjes pranë një trupi hurme. Tha: "Ah, sikur të kisha vdekur më parë e të qesh harruar!"
24. I thirri nga poshtë: "Mos u brengos! Yt Zot ka bërë ndër teje një rrëke.
25. Shkunde trupin e hurmës, të të bien fruta të freskëta!
26. Ha, pi e qetësohu! Po pe dikë, thuaji: "Unë i kushtova Bamirësit një agjërime dhe nuk do t'i flas sot njeriu.""
27. Me atë në krah, erdhi pranë njerëzve të saj. Thanë: "O Merjem, na paske bërë diçka të padëgjuar!
28. O motër e Harunit! (nga breznia) Yt atë nuk qe burrë i keq, as nëna jote, e pandershme."
29. U bëri shenjë nga ai. Thanë: "Si mund t'i flasim një fëmije në djep?"
30. Tha: "Unë jam rob i Zotit. Ai më dha libër e më bëri profet.
31. Më bëri të bekuar kudo që të jem dhe më urdhëroi të falem e të jap bamirësi sa të jem gjallë.
32. Të sjellshëm me nënën time, nuk më bëri kryelartë e të prapë.
33. Paqja është me mua ditën që u lindi, ditën që vdes dhe ditën që ringjallet."
34. Ai qe Isai, biri i Merjemit, fjalë e së vërtetës ku janë në mëdyshe.
35. Nuk është për Zotin të bëjë bir, lëvduar qoftë! Kur merr vendim, thotë: "Ji!"- dhe është.
36. "Allahu është im Zot dhe Zoti juaj. Adhuronit Atë! Kjo është rrugë e drejtë."

37. Por palët ranë në kundërshti. Mjerë mohuesit nga prania në një ditë të madhe!
38. Sa mirë dëgjojnë e shohin ditën që na vijnë! Porse dhunuesit janë sot në humbje të qartë.
39. Tërhiq vëmendjen për ditën e mjerimit kur merret vendimi ndërsa ata janë të shkujdesur e nuk besojnë.
40. Ne e trashëgojmë tokën e ç'janë mbi të dhe tek Ne kthehen.
41. Përmende në libër Ibrahimin. Qe besnik, një profet.
42. Kur i tha të atit: "Ati im, përse adhuron diçka që nuk dëgjon e sheh dhe as që të vlen?"
43. Ati im, mua më erdhi një dije që ty s'të ka ardhur, pra, ndiqmë, të të prij në udhë të drejtë.
44. Im atë, mos adhuro djallin! Djalli është për Bamirësin - Rahman i pabindur.
45. Ati im! Unë kam frikë mos të të zërë dënim nga Bamirësi - Rahman e të bëhesh mik i djallit." -
46. Ai tha: "Hoqe dorë nga zotat e mi, o Ibrahim? Po vazhdove kështu, do të të gjuaj me gurë. Largohu prej meje një kohë!"
47. Tha: "Paqja qoftë me ty! Do t'i lyp tim Zoti falje për ty. Ai është i dashur me mua.
48. Po veçohem prej jush dhe çfarë lusni në vend të Zotit. Do t'i lutem tim Zoti me shpresë të mos jem i mjerë në lutjen e Zotit tim."
49. Pasi u veçua prej tyre dhe çfarë adhuronin në vend të Zotit, i dhuruam Is'hakun e Jakubin. I bëmë që të dy profetë.
50. U dhuruam mëshirën Tonë dhe i bëmë gjuhë të një të vërtete të lartë.
51. Përmende në libër Musanë. Ai ishte i zgjedhur, i dërguar, një profet.

52. I thirrëm nga ana e Malit, në të djathtë dhe e afruam pranë në fjalë.
53. I dhuruam, me mëshirën Tonë, të vëllanë, Harunin profet.
54. Përmende në libër Ismailin. Ai e mbante premtimin dhe ishte i dërguar, një profet.
55. I porosiste njerëzit e tij të falen dhe të japin zekatin. Ishte pranë Zotit i pëlqyeshëm.
56. Përmende në libër Idrisin. Ai qe besnik, një profet.
57. Dhe e ngritëm në vend të lartë.
58. Janë ata që bekoi Zoti, profetët nga pasardhësit e Ademit, nga ata që bartëm me Nuhin, nga pasardhësit e Ibrahimit dhe Israilit dhe nga ata që drejtua e zgjodhëm. Kur u recitohen dëshmitë e Bamirësit – Rahman, bien në tokë me sy të përlotur.
59. Erdhën pas tyre të mëpasshëm që lanë lutjen e ndoqën pasionet. Dhe do të ndeshin humbjen.
60. Përveç atyre që pendohen, besojnë dhe bëjnë të mira. Këta do të hyjnë në parajsë dhe nuk u bëhet e padrejtë.
61. Kopshtet e Edenit që Bamirësi – Rahman u premtoi robërve të Vet në të padukshmen. Me të vërtetë, premtimi i Tij realizohet.
62. Nuk dëgjojnë aty fjalë të kotë, por: "Paqe!" Ata kanë në të ushqimin e tyre mëngjes e mbrëmje.
63. Kjo është parajsa që ua trashëgojmë robërve Tanë të devotshëm.
64. "Ne (engjëjt) zbresim me urdhrin e tët Zoti. Atij i përket e tashmja dhe e ardhmja jonë e ç'është ndërmjet. Yt Zot nuk harron."

65. Zoti i qiejve dhe i tokës e gjithçkaje mes tyre. Pra, adhuroje Atë! Dhe ji i vendosur në adhurimin e Tij. Mos i di Atij të barabartë?
66. Njeriu thotë: “Si të kem vdekur, do të dal në jetë?”
67. A nuk mendon njeriu se Ne e krijuam më parë kur ai s’ishte gjë?
68. Për të Zot, do t’i tubojmë ata dhe djajtë e t’i sjellim të gjunjësuar rreth e qark skëterrës!
69. Pastaj nxjerrim nga çdo grupim më të pabindurit ndaj Bamirësit.
70. Ne e dimë më së miri cilët i jepen zjarrit.
71. Çdonjëri prej jush ia arrin atje. Te yt Zot është vendim i kryer.
72. I shpëtojmë ata që kanë frikë Zotin dhe lëmë dhunuesit të gjunjësuar.
73. Kur u lexohen dëshmitë Tona të qarta, mohuesit u thonë besimtarëve: “Cila nga dy palët është më mirë në pozitë dhe në rreth më të mirë?”
74. Sa brezni zhdukëm para tyre? Ishin më mirë në mall e salltanet.
75. Thuaj: “Atyre që janë në udhë pa krye Bamirësi – Rahman u jep kohë, derisa, kur të shohin ç’u paralajmëruan, qoftë dënimin apo Orën, do ta kuptojnë kush ishte në pozitë më të keqe dhe më dobët në fuqi.”
76. Zoti ua përforcon drejtimin atyre që janë drejt. Veprat e mira, të vazhdueshme janë më të mira tek yt Zot në shpërbtim, më të mira në kthim.
77. Ke parë kë mohon dëshmitë Tona dhe thotë: “Do të kem mall e fëmijë?”
78. Mos sheh të padukshmen apo mori besë te Bamirësi?
79. Ne ia shkruajmë fjalët dhe i japim kohë për dënimin.

80. Ne i trashëgojmë çfarë thotë ndërsa ai na vjen i vetëm.
81. Marrin, në vend të Zotit, zota, të jenë për ta nder e fuqi.
82. Por, jo! Do t'ua mohojnë adhurimin dhe janë me ta në opozitë.
83. Nuk e kupton që u dërgojmë mohuesve djajtë për t'i nxitur?
84. Pra, mos u ngut për ta. Ne ua numërojmë.
85. Ditën që i tubojmë të devotshmit te Bamirësi si të ftuar
86. dhe i shtyjmë mëkatarët në skëterrë si kope e etur,
87. veç besës me Bamirësin – Rahman, nuk kanë fuqi të ndërhyjnë.
88. Thonë: “Bamirësi – Rahman ka bërë bir.”
89. Sollët diçka shumë të keqe.
90. Gati s'u çanë qiejt prej saj, s'u copëtua toka dhe nuk u shembën malet.
91. Që i thirrën Bamirësit – Rahman një bir.
92. Nuk i shkon Bamirësit – Rahman të marrë bir.
93. Ç'janë në qiej e në tokë, i vijnë Bamirësit si robër.
94. Ai i ka regjistruar e numëruar me saktësi.
95. Të gjithë i vijnë Atij Ditën e Ringjalljes si individë.
96. Cilët besojnë e bëjnë të mira, Bamirësi – Rahman bën për ta dhimbsuri e dashuri.
97. E lehtësuam atë në gjuhën tënde, të përgëzosh me të të devotshmit dhe të paralajmërosh me të të pabindurit.
98. Sa e sa brezni zhdukëm para tyre! Mos ke parë dikë a dëgjuar ndonjë zë?

20. TA - HA (TA - HA)

Periudha e Mekës, 135 ajete
Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Ta, ha. (t, h)
2. Nuk ta zbritëm Kuranin për të të munduar.
3. Porse një kujtesë kujt druan i frikësuar.
4. Shpallje e Atij që tokën dhe qiejt e lartë ka krijuar,
5. Bamirësit – Rahman, mbi fronin – pushtet përqendruar.
6. Të Tijat janë gjithçka në qiej e në tokë, mes tyre dhe ndër tokë mbuluar.
7. Në e thua me zë, Ai di të fshehtën dhe ç'është më e fshehtë.
8. Zotit, s'ka zot veç Tij, i takojnë emrat më të bukur.
9. Të erdhi ngjarja e Musait?
10. Kur pa një zjarr, u tha njerëzve të tij: "Qëndroni! Unë po shquaj një zjarr. Ndoshta ju sjell prej tij një pishtar a gjej pranë zjarrit drejtim."
11. Me të arritur: "O Musa! - u thirr. -
12. Unë jam yt Zot. Hiqi sandalet e tua! Këtu je në Luginën e Shenjtë Tuva.
13. Unë të zgjodha, dëgjo ç'të kumtohet!
14. Unë jam Zoti, s'ka zot veç Meje, pra, adhuromë Mua! Dhe falu, të më përmendësh Mua."
15. Ora po vjen, - nuk është e fshehtë, - që të shpërblehet çdo frymë me ç'është përpjekur.
16. Mos të të largojë kush s'beson e ndjek pasionin dhe të mbetesh i rrënuar."
17. "Ç'është në të djathtën tënde, o Musa?"

18. Tha: "Shkopi im, mbështetem në të, u shkund gjethe deleve të mia dhe për nevoja të tjera."
19. Tha: "Hidhe atë, o Musa!"
20. E hodhi, kur, ja, një gjarpër që lëvrinte.
21. Tha: "Merre, mos ki frikë! E bëjmë siç ishte.
22. Fute dorën nën sqetull, të dalë e bardhë, pa njollë, një shenjë tjetër.
23. Të të tregojmë ndër shenjat Tona të mëdha.
24. Shko te faraoni! Ai e ka tepruar."
25. Tha: "Im Zot, zgjeroma zemrën time
26. dhe lehtësoma detyrën time.
27. Zgjdhma nyjën e gjuhës
28. që ta kuptojnë fjalën time.
29. Bëmë një mëkëmbës nga familja ime,
30. Harunin, tim vëlla.
31. Forcoma me të fuqinë
32. dhe ma bëj shok në detyrën time,
33. të të thurim lavde shumë
34. dhe të të përmendim shumë.
35. Vërtet, Ti na ke largvështuar."
36. Tha: "T'u plotësua lutja, o Musa.
37. Të bekuam edhe më parë,
38. kur i kumtuam nënës tënde:
39. "Fute atë në një arkë dhe hidhe në lumë. Lumi do ta hedhë në breg dhe do ta marrë armiku Im e armiku i tij." Hodha mbi ty dashuri prej Meje që të rriteshe nën syrin Tim.
40. Kur jot motër shkoi e tha: "T'ju tregoj kush mund ta mbajë?" – të kthym te nëna jote, t'i gëzohej syri e të mos dëshpërohej. Ti vrave një njeri, por të shpëtuam nga halli e të vumë në provë. Qëndrove për vite te

banorët e Medjenit, pastaj erdhe në vendmbërritje, o Musa.

41. Dhe të bëra gati për Mua.”
42. “Nisuni ti e yt vëlla me dëshmitë e Mia dhe mos u ndani nga përmendja Ime.
43. Shkoni te faraoni. Ai e ka tepruar.
44. Thojini fjalë të buta që të kujtohet a frikësohet.”
45. Thanë: “Zoti ynë! Kemi frikë se nuk përmbahet dhe e tepron.”
46. Tha: “Mos kini frikë! Unë jam me ju: dëgjoj e shoh.
47. Ejani e thojini: “Ne jemi të dërguar nga yt Zot. Nisi me ne bijtë e Izraelit dhe mos i mundo. Të erdhëm me dëshmi nga Zoti yt. Paqja qoftë me atë që ndjek drejtimin!
48. Na u kumtua se, vërtet, dënimi është mbi këdo që përgënjeshtrohet e largohet.”
49. Tha: “Kush është Zoti juaj, o Musa?”
50. Tha: “Zoti ynë është Ai që i dha çdo gjëje krijimin, pastaj e drejton.”
51. Tha: “Po popujt e hershëm?”
52. Tha: “Dija për ta është te im Zot, në libër. Im Zot nuk gabon e harron.”
53. Është Ai që bëri për ju tokën djep, hapi në të shtigje dhe zbriti nga qielli ujë. Nxjerrim me të bimë të ndryshme.
54. Ushqehuni dhe kullotni kafshët tuaja! Këtu ka dëshmi për njerëzit e mençur.
55. Prej saj ju krijuam, në të ju kthejmë dhe ju nxjerrim prej saj tjetër herë.
56. Ia treguam shenjat Tona, të gjitha, por ai përgënjeshtroi dhe nuk pranoi.

57. Tha: "Erdhe të na nxjerrësh me magjinë tënde nga toka jonë, o Musa?"
58. Le të sjellim edhe ne një magji si ajo, lëmë takim në një vend të përbashkët e të mos mungojmë as ne, as ti."
59. Tha: "Takimi të jetë ditën e panairit dhe le të grumbullohen njerëzit në mëngjes."
60. Faraoni u largua, përpiloi planin e tij, pastaj erdhi.
61. Musai u tha: "Kujdes, mos sajoni ndaj Zotit gënjeshtër dhe t'ju zhdukë me dënim. Ka dështuar cilido që sajon të pagënë."
62. Ata e rrahën çështjen mes tyre dhe e mbajtën të fshehtë.
63. Thanë: "Këta të dy janë magjistarë që duan t'ju nxjerrin me magjinë e tyre nga toka juaj dhe t'ju largojnë nga tradita juaj e mirë."
64. Prandaj, bëni planin tuaj dhe ejani në radhë. Sot ka sukses kush ia del në krye."
65. Thanë: "O Musa! Do të hedhësh a të hedhim ne të parët?"
66. Tha: "Hidhni ju!" Kur, ja! Nga magjia e tyre, iu duk se litarët e shkopinjtë po lëvrinin shpejt.
67. Musai ndjeu në vetvete frikë.
68. Thamë: "Mos u frikëso se ti je më lart."
69. Hidhe ç'ke në të djathtën tënde, t'i përpijë sajimet e tyre. Ç'sajuan ata, është dredhi magjistari. Magjistari nuk fiton sido që të vijë."
70. Magjistarët ranë me krye në tokë dhe thanë: "Ne besojmë Zotin e Harunit e të Musait."
71. Tha: "Besoni pa lejen time? Po, ai është i madhi juaj që jua mësoi magjinë. Do t'ju pres duar e këmbë

- tërthor dhe t'ju kryqëzoj në trungjet e palmave, ta dini se kush ka dënim më të rreptë e të përhershëm.”
72. Thanë: “Ne nuk të vëmë ty para dëshmime të qarta që na erdhën dhe Atij që na krijoi. Pra, kryej vendimin. Çfarëdo të vendosësh, ti vendos vetëm në jetën e kësaj bote.
73. Ne besojmë Zotin tonë, të na falë gabimet dhe magjinë që na detyrove. Zoti është Më i Miri dhe i Përhershmi.”
74. Kush i vjen Zotit si fajtor, ka skëterrën ku as vdes e jeton.
75. Cilët i vijnë si besimtarë, me vepra të mira, kanë pozita të larta,
76. përgjithmonë, në kopshtet e Edenit ku rrjedhin lumenj. Ky është shpërblimi i atyre që çlirohen.
77. I kumtuam Musait: “Udhëto natën me robtë e Mi, hapu udhë të terur në det, mos ki frikë se të zënë dhe mos u tremb!”
78. I ndoqi faraoni me trupat e tij, por i mbuloi vala e detit.
79. Faraoni e udhëhoqi gabim kombin e vet dhe nuk e udhëzoi drejt.
80. Bijtë e Izraelit! Ne ju shpëtuam nga armiku juaj, bëmë besë me ju në anën e djathtë të Malit dhe ju dërguam nektar e shkurtëza.
81. Ushqehuni me të mirat që ju dhamë dhe mos rebeloni e t'ju bjerë zemërimi Im. Kujt i bie zemërimi Im, ka marrë fund.
82. Unë jam Falës i Madh për këdo që pendohet, beson, bën të mira dhe udhëhiqet drejt.
83. Ç'të nxitoi para kombit tënd, o Musa?
84. Tha: “Ata janë pas gjurmëve të mia. Nxitova drejt Teje, im Zot, të jesh i kënaqur.”

85. Tha: “Ne e vumë në provë kombin tënd, pas teje, por e gabo i samiriu.”
86. Musai u kthye te kombi i tij i zemëruar dhe i brengosur. Tha: “Kombi im! A nuk ju premtoi Zoti juaj një premtim të mirë? Mos ju duk kohë e gjatë apo deshët t’ju zbriste zemërim nga Zoti dhe e thyet besën me mua?”
87. Thanë: “Nuk e thyem besën me dashjen tonë, por ishim ngarkuar me barrën e stolive të popullit dhe i derdhëm ato siç i derdhi samiriu.”
88. Ai nxori për ta një trupore viçi që pëlliste. Thanë: “Ja, ky është zoti juaj dhe zoti i Musait, por ai e la në harresë.”
89. Nuk shihnin që s’u kthente ndonjë fjalë dhe s’mund t’u bënte dëm a dobi?
90. Vërtet, Haruni u tha që më parë: “Kombi im! Me të jeni vënë në provë. Zoti juaj është Bamirësi – Rahman. Pra, ndiqmëni mua dhe bindjuni urdhrin tim.”
91. Thanë: “Nuk tërhiqemi prej tij pa u kthyer Musai.”
92. Tha: “O Harun! Kur i pe ata gabim, ç’të pengoi të mos më ndiqje mua? A kundërshtove urdhrin tim?”
93. Tha: “O bir i nënës sime, mos më zër nga mjekra e koka! Kisha frikë se do të thojë: “I përçave bijtë e Izraelit dhe nuk e mbajte fjalën time.””
94. Tha: “Si është puna, o samirij?”
95. Tha: “Unë pashë ç’nuk panë ata, mora një dorë nga gjurma e lajmësit dhe e hodha. Kështu ma tha mendja.”
96. Tha: “Largohu! Sa të jesh gjallë, do të thuash: “Larg meje!” dhe ke një afat që s’mund ta shkelësh. Shihe idhullin tënd që i je dhënë! Do ta djegim e shkapërderdhim në det.”

98. Zoti juaj është Zoti veç të cilit s'ka zot tjetër. Ai përfshin çdo gjë me dije.
99. Kështu, po të rrëfejmë disa nga ndodhitë e së kaluarës. Ty të dhamë nga ana Jonë një kujtesë.
100. Kush largohet prej saj, bart Ditën e Ringjalljes një barrë.
101. Përgjithmonë! Ç' barrë e keqe Ditën e Ringjalljes!
102. Ditën që i fryhet bririt, mbledhim fajtorët, atëherë të zbehtë.
103. Pëshpërisin mes tyre se paskan ndenjur vetëm dhjetë.
104. Ne e dimë çdo të thonë kur udhërrëfyeni i tyre thotë: "Qëndruat vetëm një ditë."
105. Të pyesin për malet, thuaju: "Im Zot i shpërndan ato si thërrime.
106. Dhe i lë rrafsh me tokën.
107. Nuk sheh në të rrudhë e palë."
108. Atë ditë ndjekin thirrësin; ai nuk devijon. Ulen zërat para Bamirësit – Rahman dhe dëgjon vetëm murmurimë.
109. Atë ditë s'ka ndërmjetësi përveç atij që lejon Bamirësi – Rahman dhe është me fjalën e tij i kënaqur.
110. Ai di të tashmen dhe të ardhmen e tyre ndërsa ata nuk e përfshijnë Atë me dije.
111. Të përulura janë fytyrat para të Gjallit, të Përjetshmit dhe dështon çdo bartës dhune.
112. Kush bën vepra të mira, si besimtar, nuk i trembet ndonjë padrejtësie e mosvlerësimi.
113. Kështu, e shpallëm atë një këndim në arabisht dhe shtjelluam në të premtime e paralajmërime që ata të mund të përmbahen a të jetë për ta kujtesë.

114. I lartë është Zoti, Sundimtari i Vërtetë! Mos u nxito në Kuran para se të jetë plotësuar kumtimi i tij. Dhe thuaj: “O Zot, shtoma diturinë!”
115. Edhe Ademin e porositëm më parë, por harroi dhe nuk qe i vendosur.
116. Kur u thamë engjëjve: “Përlujuni Ademit”, - u përlën përveç Iblisit. Refuzoi.
117. Thamë: “O Adem! Ky është armik për ty e për tët shoqe, pra, të mos ju nxjerrë nga kopshti e të mjerohesh.
118. Nuk je i uritur aty, as i zhveshur.
119. Nuk je i etur aty, as ke vapë.”
120. I pëshpëriti djalli dhe i tha: “O Adem! Eja të të çoj te pema e përjetësisë dhe sundimit pa rënie.”
121. Hëngrën prej saj që të dy dhe u dolën në dukje pjesët e turpshme. Filluan t'i mbulonin me gjethet e kopshtit. Ademi nuk iu bind Zotit të tij dhe gaboi.
122. Zoti e zgjodhi atë, e fali dhe drejtoi.
123. Tha: “Zbritni së andejmi të gjithë, disa armiq për të tjerë. Kur t'ju vijë drejtim nga Unë, kush ndjek drejtimin Tim, nuk gabon e dëshpërohet.
124. Kujt largohet nga Kujtesa Ime, i bëhet jeta e vështirë dhe e tubojmë Ditën e Ringjalljes të verbër.”
125. Do të thotë: “Im Zot, përse më tubove të verbër tek isha me sy?”
126. Thotë: “Ja, të erdhën dëshmitë Tona dhe i harrove. Sot u harrove ti.”
127. Kështu ia shpërblejmë kujt shpërdoron e s'beson në dëshmitë e Zotit. Ndërsa dënimi i së ardhmes është më i ashpër dhe afatgjatë.

128. Nuk marrin mësim që zhdukëm para tyre sa e sa brezni në trojet e të cilave kalojnë? Këtu ka dëshmi për njerëzit që kuptojnë.
129. Të mos qe një fjalë e parathënë nga yt Zot dhe afat i caktuar, do të ishte e pashmangshme.
130. Pra, bëj durim për çka thonë dhe thuri lavde të Zotit, para lindjes së diellit dhe para perëndimit, lëvdoje natën dhe skajeve të ditës që të mund të jesh i kënaqur.
131. Dhe mos i zgjat sytë nga stolitë e jetës me të cilat kemi pajisur një palë tyresh për t'i vënë në provë. Pjesa që të ka dhënë yt Zot është më e mirë dhe afatgjatë.
132. Porosit familjen tënde të falet dhe ji i durueshëm në të. Ne nuk ta kërkojmë ty ushqimin. Ne të ushqejmë. Fundi është i devotshmërisë.
133. Thonë: "Përse nuk na solli shenjë nga Zoti i tij?" A nuk u erdhi prova e qartë e shkrimeve të mëparshme?
134. Sikur t'i kishim rrënuar me dënim para tij, do të thonin: "Zoti ynë, përse nuk na dërgove një profet, të ndiqnim dëshmitë e Tua para se të ishim poshtëruar e mjeruar?"
135. Thuaj: "Secili po pret. Prisni edhe ju. Dhe do ta mësoni cilët janë shokët e udhës së mbarë e që udhëhiqen drejt."

21. PROFETËT (EI ENBIJA')

Periudha e Mekës, 112 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Iu afrua njerëzve llogaria tek janë në shkujdesje, të larguar.
2. Nuk u vjen kujtesë e re nga Zoti i tyre që të mos e dëgjojnë sikur luajnë.
3. Zemrat e tyre janë të trazuara. Thonë dhunuesit gojë më gojë: “A nuk është ky njeri si ju? Dhe i vini magjisë me sy hapur?”
4. Tha: “Im Zot di ç’thuhet në qiell e në tokë. Ai është dëgjues, dijeplotë.”
5. Jo, por thonë: “Ëndrra të ngatërruara. Jo, ai i ka trilluar. Jo, është poet. Le të na sjellë një shenjë siç iu dërgua të parëve.”
6. Nuk besoi para tyre ndonjë vendbanim që zhdukëm. Të besojnë ata?
7. Dërguam para teje burra që u kumtuam. Pyesni njerëzit e shkrimeve nëse nuk e dini.
8. S’i bë më krijesa që s’hanin ushqim, as qenë të pavdekshëm.
9. Pastaj, ua mbajtëm premtimin: shpëtuam ata e të tjerë, me dashjen Tonë dhe zhdukëm shpërdoruesit.
10. Ju zbritëm një libër ku keni kujtesë. Nuk kuptoni?
11. Zhdukëm sa e sa vendbanime dhune dhe ngritëm pas tyre kombe të tjerë.
12. Kur e panë Fuqinë Tonë, ikën kush e kush më parë.
13. Mos ikni! Kthehuni në pasurinë dhe banesat tuaja që të mund të pyeteni.
14. Thonë: “Mjerë ne, ishim të padrejtë!”
15. Dhe vazhdoi davaja e tyre derisa i lamë të shkretë.

16. Nuk krijuam qiellin, tokën dhe ç'ka mes tyre për lojë.
17. Po të deshim ta merrnim si kalim kohe, nëse do ta bënim, e kishim marrë nga ana Jonë.
18. Mirëpo Ne ia përplasim të vërtetën të rremes dhe e zhduk atë. Ndërsa ajo shuhet, mjerë ju ç'përshkruanit!
19. Atij i takon gjithçka në qiej e në tokë. Ata pranë nuk tregohen mendjemëdhenj në adhurimin e Tij dhe nuk lodhen.
20. Thurin lavde natë e ditë e nuk mënojnë.
21. Mos marrin nga toka zota që japin jetë?
22. Po të kishte në to zota veç Zotit, do të prisheshin. Madhëruar qoftë Allahu, Zoti i Fronit nga ç'i cilësojnë!
23. Ai nuk pyetet se ç'bën ndërsa ata do të pyeten.
24. Marrin zota në vend të Tij? Thuaj: "Sillni argumentin tuaj! Kjo është kujtesë e atyre që janë me mua dhe kujtesë e atyre para meje." Porse të shumtët nuk e dinë të vërtetën dhe janë të larguar.
25. Nuk dërguam profet para teje pa i kumtuar se s'ka zot veç Meje, pra, Mua të më adhuronit!
26. Thonë: "Bamirësi – Rahman ka marrë bir." Madhëruar qoftë! Jo, por janë robër të nderuar.
27. Nuk ia marrin fjalën dhe, me urdhrin e Tij, veprojnë.
28. Ai di të tashmen dhe të ardhmen e tyre ndërsa ata nuk ndërhyjnë pa pëlqimin e Tij, por janë, nga droja për Të, të ndrojtur.
29. Po të thotë dikush ndër ta: "Unë jam zot në vend të Tij", - ia paguajmë me skëterrën. Kështu i shpërblejmë dhunuesit.
30. Nuk vërejnë mohuesit se qiejt e toka ishin ngjitur dhe Ne i shkëputëm e bëmë nga uji çdo gjë të gjallë? A nuk besojnë?

31. Bëmë në tokë formacione të qëndrueshme që ajo të mos lëkundet bashkë me ta dhe hapëm në to shtigje e rrugë për t'u orientuar.
32. Qiellin e bëmë çati të mbrojtur ndërsa ata janë, ndaj dëshmimeve Tona, të larguar.
33. Është Ai që krijoi natën e ditën, diellin dhe hënën. Secili noton në sferën qiellore.
34. Nuk bëmë para teje njerëz të përjetshëm dhe, nëse ti vdes, të jenë ata të përherëshëm.
35. Çdo frymë e shijon vdekjen. Ju provojmë me të keqen e të mirën, si përvojë dhe ktheheni tek Ne.
36. Kur mohuesit të shohin, të marrin me tallje: "Ky është ai që zë në gojë zotat tuaj?" - dhe nuk besojnë në përmendjen e Bamirësit.
37. Njeriu u krijua i nxituar. Do t'jua tregoj dëshmitë e Mia, pra, mos më nxitoni!
38. Dhe thonë: "Kur është ky premtim në thoni të vërtetën?"
39. Sikur ta dinin mohuesit kohën kur s'do të mund ta mbajnë zjarrin nga fytyra e shpina dhe nuk do të ndihmohen!
40. U vjen papritmas, i huton dhe s'mund ta prapsin, as që vonohen.
41. U tallën profetë para teje, por i zuri tallësit ajo me të cilën u tallën.
42. Thuaj: "Kush ju ruan natën e ditën prej Bamirësit - Rahman?" Mirëpo ata janë të larguar nga përmendja e Zotit të tyre.
43. Mos kanë, veç Nesh, zota të tjerë që i mbrojnë? S'do të mund të ndihmonin vetveten, as merren prej Nesh në mbrojtje.

44. I bëmë këta dhe etërit e tyre të jetojnë jetën, sa t'u zgjasë jeta. Nuk shohin që i vijmë tokës duke i marrë anët? Ata janë triumfuesit?
45. Thuaj: "Unë vetëm po ju tërheq vëmendjen me anë të komunikimit." Por shurdhët nuk e dëgjojnë thirrjen kur u tërhiqet vëmendja.
46. Në i prek edhe një frymë e dënimit të tët Zoti, do të thonë: "Të mjerët ne, ishim të padrejtë!"
47. Ditën e Ringjalljes vëmë peshojat e drejtësisë dhe nuk i bëhet kujt e padrejtë. Edhe sikur të jetë me peshë sa një farë mustarde, Ne e sjellim atë. Mjaftojmë Ne në llogari.
48. U dhamë Musait dhe Harunit Dalluesin, dritë e kujtesë për të devotshmit,
49. që i frikësohen Zotit në të padukshmen dhe i ruhen Orës.
50. Edhe kjo është kujtesë e bekuar që Ne e zbritëm. Ju e mohoni?
51. I dhamë më parë Ibrahimit gjykimin e drejtë dhe qemë për të në dijeni;
52. kur i tha të atit dhe kombit të tij: "Ç'janë këto shëmbëlltyra që u jeni dhënë?"
53. Thanë: "I gjetëm etërit tanë t'i adhuronin."
54. Tha: "Ju dhe etërit tuaj jeni në gabim të hapur."
55. Thanë: "Thua të vërtetën apo tallesh?"
56. Tha: "Zoti juaj është Zoti i qiejve dhe i tokës, Ai që i krijoi ato, ndërsa unë jam për këtë dëshmues.
57. Për Zotin, do t'ua punoj idhujve tuaj me të kthyer shpinën!"
58. Dhe i bëri copë-copë, përveç më të madhit, që atij t'i ktheheshin.

59. Thanë: “Kush e bëri këtë me zotat tanë është keqbërës.”
60. Thanë: “Dëgjuam një të ri t'i përmendte. Thirret Ibrahim.”
61. Thanë: “Silleni në sytë e njerëzve të dëshmojnë.”
62. Thanë: “Ti e bërë këtë me zotat tanë, o Ibrahim?”
63. Tha: “Jo! E bëri i madhi i tyre. Pyetini po qe se flasin.”
64. U kthyen në vetvete dhe thanë: “Jeni gabim!”
65. Pastaj ulën kryet: “Ti e dije se ata nuk flasin.”
66. Tha: “Adhuroni në vend të Zotit çfarë s'ju bën dobi e dëm?”
67. Mjerë ju ç'adhuroni në vend të Zotit! A nuk kuptoni?”
68. Thanë: “Digjeni! Dhe ejani në ndihmë të zotave tuaj në jeni gati!”
69. Thamë: “O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!”
70. Ata i bënë kurth dhe Ne i bëmë të humbur.
71. Shpëtuam atë dhe Lutin në një tokë që e bekuam për njerëzit.
72. I dhuruam Is'hakun dhe, më tej, Jakubin. Secilin e bëmë ndër të mirët.
73. I bëmë prijës që drejtonin me urdhrin Tonë dhe ua kumtuam të bënë vepra të mira, të kryenin të falurit, të jepnin zekatin. Ishin adhuresit Tanë.
74. I dhamë Lutit gjykim e dituri dhe e shpëtuam nga vendbanimi ku bënë punë të ndyra. Ishte komb i keq, i shthurur.
75. E futëm atë në mëshirën Tonë dhe qe ndër të mirët.
76. Edhe Nuhit, kur thirri më parë, iu përgjigjëm dhe shpëtuam atë dhe njerëzit e tij nga një ankth i madh.
77. E ndihmuam ndaj kombit që përgënjeshtroi dëshmitë Tona. Ishte popull i keq dhe i mbytëm të gjithë.

78. Edhe Davudit e Sulejmanit kur gjykuan në çështjen e të mbjellave që shkelën natën dhentë e dikujt. Ishim në gjykimin e tyre dëshmitarë.
79. E bëmë Sulejmanin ta kuptonte atë. Të dyve u dhamë gjykim e dituri. I nënshtroam malet dhe shpendët të thurnin lavde bashkë me Davudin. Ne i bëmë.
80. Ia mësuam atij artin e veshjes për t'u mbrojtur në luftë. Pra, a jeni mirënjohës?
81. Edhe Sulejmanit erën e fortë duke lëvizur me urdhrin e tij drejt tokës që bekuam. Ne jemi për çdo gjë dijeplotë.
82. Prej djajve, disa zhyteshin për të dhe bënin punë të tjera. Ne i ruanim ata.
83. Edhe Ejubit kur i thirri Zotit: "Unë jam në vështirësi dhe Ti je Mëshiruesi i mëshiruesve!"
84. Iu përgjigjëm dhe ia larguam vështirësinë, i dhamë familjen, edhe po aq, mëshirë nga ana Jonë dhe kujtesë për ata që adhurojnë.
85. Edhe Ismailit, Idrisit, Dhul Kiflit. Secili ishte durimtar.
86. I futëm në mëshirën Tonë dhe qenë ndër të mirët.
87. Edhe atë të peshkut, kur iku i zemëruar dhe pandehur se s'kishim mbi të fuqi. Thirri në errësirë: "S'ka zot veç Teje, madhëruar qofsh! Unë isha i padrejtë."
88. Iu përgjigjëm dhe e shpëtuam nga ankthi. Kështu i shpëtojmë besimtarët.
89. Edhe Zekerijas, kur thirri Zotin: "Im Zot, mos më lë të vetëm sepse Ti je Më i Miri Trashëgues!"
90. Iu përgjigjëm, i dhuruam Jahjanë dhe ia përmirësuam të shogën. Ata ishin të tillë që konkurronin në vepra të mira, Na luteshin me shpresë e drojë dhe qenë të përvuajtur.

91. Edhe asaj që ruajti nderin, i frymë nga fryma Jonë dhe bëmë atë e të birin dëshmi për botët.
92. Kjo është bashkësia juaj, një bashkësi, ndërsa Unë jam Zoti juaj. Pra, adhuromëni Mua!
93. E përçanë çështjen e tyre. Të gjithë te Ne do të kthehen.
94. Kujt bën të mira si besimtar, nuk i mohohet përpyekja dhe Ne e regjistrojmë.
95. I mohohet një vendbanimi që shkatërruam. Nuk ka kthim për të.
96. Derisa të lëshohen jexhuxhët e mexhuxhët duke rënë nga çdo bregore.
97. Dhe të jetë afruar premtimi i vërtetë dhe të shtangen shikimet e mohuesve: "Të mjerët ne! Qemë për këtë të shkujdesur. Ishim të padrejtë."
98. "Ju dhe ç'adhuronit në vend të Zotit jeni lënda djegëse e xhehenemit që po ia arrini."
99. Sikur të ishin zota, nuk do të arrinin atje. Të gjithë janë përgjithmonë në të.
100. Rënkojnë aty e nuk dëgjojnë.
101. Ata që u paraprin nga ana Jonë parajsa janë larg tij.
102. Nuk ia dëgjojnë murmurimën, por janë, përgjithmonë, atje ku dëshirojnë.
103. Nuk i brengos frika e madhe dhe i takojnë engjëjt: "Kjo është Dita juaj e Premtuar!"
104. Dita kur palosim qiellin si fletë librash. Siç zumë fill krijimin e parë, e përsëritim. Një premtim mbi Ne. Dhe Ne e kryejmë.
105. E shkruam në fletët e shenjta (Zebur), pas Mesazhit (Teuratit), se tokën do ta trashëgojnë robtë e Mi të drejtë.
106. Këtu ka komunikim për njerëzit që adhurojnë.

107. Të dërguam ty, mëshirë për botët.
108. Thuaj: "M'u kumtua se Zoti juaj është Një Zot. Pra, a jeni të nënshtuar?"
109. Po të kthejnë, thuaj: "Jua shpalla njësoj. Unë nuk di a është paralajmërimi afër apo larg.
110. Ai di fjalën e hapur, di edhe ç'fshihni.
111. Nuk di në është provë për ju dhe shtyerje në kohë."
112. Tha: "Im Zot, gjyko me të vërtetën! Zoti ynë është Bamirësi-Rahman të Cilit i lypet ndihmë për ato që i cilësoni."

22. HAXHI (EL HAXHXH)

Periudha e Medines, 78 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. O njerëz, përmbajuni Zotit tuaj! Me të vërtetë, tronditja e Orës është e madhe.
2. Ditën kur nëna të lërë foshnjën e saj dhe shtatzëna të dështojë barrën e saj, i sheh njerëzit të dehur e s'janë të dehur, porse dënimi i Zotit është i rreptë.
3. Ndër njerëzit, dikush kundërshton te Zoti me padije dhe ndjek çdo djall rebel.
4. Është shkruar për të që, kë e bën mik, e gabon dhe e shpie drejt dënimit në zjarrin e përflaktë.
5. O njerëz! Po të keni dyshim rreth ringjalljes, Ne ju krijuam nga dheu, pastaj nga një pikëz, pastaj nga një gjak i trashë, pastaj nga një copë mishi të formuar e të paformuar. Që t'jua bëjmë të qartë. Vëmë në mitra, me dashjen Tonë, në afat të caktuar, pastaj ju nxjerrim foshnjë dhe arrini pjekurinë. Prej jush, disa vdesin dhe, prej jush, disa kthehen në moshën më të

- lënë e nuk njohin gjë prej gjëje. E sheh tokën të shkretë, zbresim ujë dhe ajo gjallërohet, harliset e nxjerr lloj-lloj bimësh të hareshme.
6. Kështu, sepse Zoti është e Vërteta, Ai ngjall të vdekurin dhe është mbi gjithçka pushtetplotë.
 7. Ora po vjen, s'ka dyshim dhe Zoti do t'i ngrejë ata në varre.
 8. Ndër njerëzit, dikush kundërshton te Zoti me padije, pa drejtim e libër dritëdhënës.
 9. I prirë për të larguar nga Rruga e Zotit, ai ka poshtërim në këtë botë dhe, Ditën e Ringjalljes, e bëjmë të shijojë dënimin në zjarrin e këndellur:
 10. "Kjo, me ç'përgatitën duart tuaja. Zoti nuk është i padrejtë me robtë."
 11. Ndër njerëzit, dikush adhuron Zotin në dukje dhe, në i bie e mira, qetësohet; në bie në provë, kthehet mënjane duke humbur këtë botë e të ardhmen. Kjo është humbja e qartë.
 12. Lut, në vend të Zotit, ç'nuk i bën dëm e dobi. Kjo është humbja e thellë.
 13. Lut dikë, dëmi i të cilit është më afër dobisë. Ç'mbrojtës të keq, ç'shok të keq!
 14. Cilët besojnë e bëjnë të mira, Zoti i fut në kopshte ku rrjedhin lumenj. Zoti bën atë që do.
 15. Kush mendon se Zoti nuk do ta ndihmojë atë (të Dërguarin a.s.) në këtë botë e në të ardhmen, le të arrijë me një mjet në qiell e ta këpusë, të shohë nëse plani i tij ia largon urrejtjen.
 16. Zbritëm, kështu, dëshmi të qarta. Zoti drejton me dashjen e Tij.

17. Ditën e Ringjalljes, Zoti bën ndarje mes besimtarëve, judenjve, sabinëve, të krishterëve, mexhusëve e idhujtarëve. Zoti është dëshmues për çdo gjë.
18. Nuk sheh që Zotit i përulen ç'janë në qiej e në tokë, edhe dielli, hëna, yjet, malet, pemët, kafshët dhe shumë ndër njerëzit ndërsa shumë meritojnë dënimin? Kë poshtëron Zoti, nuk e nderon kush. Zoti bën ç'të dëshirojë.
19. Këto dy palë kundërshtarësh janë në konflikt te Zoti i tyre. Mohuesve u janë prerë petka zjarri. Derdhet mbi kryet e tyre ujë i valë.
20. U treten të brendshmet e lëkura.
21. Për ta janë topuzat prej hekuri.
22. Sa herë duan të dalin nga agonja, kthehen në të: "Vuajeni dënimin në zjarrin e këndellur!"
23. Zoti i pranon ata që besojnë e bëjnë të mira në kopshte ku rrjedhin lumenj. Stolisen në to me byzylykë ari e margaritarë ndërsa veshjet e tyre atje janë prej mëndafshi.
24. U prinë te fjala më e mirë, u prinë Udhës së të Lavdishmit.
25. Ata që mohojnë dhe pengojnë nga Rruga e Zotit dhe Faltorja e Shenjtë të cilën e bëmë njësoj si për të brendshmit e vizitorët dhe që duan në të herezi e dhunë, i bëjmë të vuajnë dënim të hidhët.
26. Kur ia caktuam Ibrahimit vendin e Shtëpisë: "Të mos shoqërosh asgjë me Mua! Pastroje Shtëpinë Time për ata që i sillen qark, që rrinë më këmbë, përkulen dhe bien me krye në tokë.
27. Shpalle te njerëzit haxhin, të të vijnë nga luginat e thella, më këmbë e mbi deve gërmuqe.

28. Të shohin dobi dhe të përmendin Emrin e Zotit ditëve të caktuara për bagëtitë me të cilat i ka pajisur. Hani prej tyre dhe ushqeni të varfrin nevojtar!
29. Pastaj, le të kryejnë ritet, të përmbushin zotimet dhe t'i sillen qark Shtëpisë së Lashtë.”
30. Kush respekton simbolet e shenjta të Zotit, ka të mira pranë Zotit të tij. U lejuan për ju bagëtitë përveç atyre që janë përmendur. Shmanguni nga papastërtia e idhujve, shmanguni edhe nga fjalët e rreme.
31. Me besim të vendosur për Zotin, jo idhujtarë. Kush i bën Zotit shok, është si të ketë rënë nga qielli, ta kenë zënë shpendët ose ta hedhë era diku larg.
32. Ja, kështu. Kush respekton shenjat e Zotit, e ka nga devotshmëria e zemrës.
33. Ju keni në to përfitim, deri në afat të caktuar, pastaj vendmbërritja e tyre është Shtëpia e Lashtë.
34. Çdo popull i kemi bërë ritual ku përmend Emrin e Zotit në bagëtitë me të cilat e ka pajisur. Zoti juaj është një Zot, pra, Atij dorëzohuni! Dhe përgëzoji të nënshtruarit,
35. ata që, kur përmendet Zoti, u drithërohen zemrat, durimtarët në fatkeqësi, ata që kryejnë të falurit dhe kontribuojnë nga pjesa që u kemi dhënë.
36. Edhe devetë i bëmë për ju shenja të Zotit. Në to keni dobi. Përmendni Emrin e Zotit tek janë vënë në radhë dhe, kur të jenë shtrirë, hani prej tyre dhe ushqeni jolypsin e lypsin. I vumë ato në shërbimin tuaj që të mund të falënderoni.
37. Zotit nuk i shkojnë mishi e gjaku i tyre, porse i shkon devotshmëria juaj. Ai i ka vënë ato në shërbimin tuaj që të madhëroni Zotin sepse ju drejtoi. Dhe përgëzoji mirëbërësit!

38. Zoti i mbron besimtarët; Zoti nuk do të pabesët dhe mohuesit.
39. U është dhënë leje atyre që janë luftuar, sepse, me të vërtetë, ata u shtypën. Zoti është i plotpushtetshëm t'i ndihmojë ata,
40. që u nxorën nga shtëpitë e tyre me të padrejtë, vetëm e vetëm pse thonë: "Zoti ynë është Allahu." Sikur Zoti të mos i zmbrapste disa me të tjerë, do të rrënoheshin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë ku përmendet shumë Emri i Zotit. Zoti do t'i ndihmojë ata që e ndihmojnë Atë, - Zoti është i fortë, i plotfuqishëm, -
41. ata që i vendosëm në tokë (në Medinë), që kryejnë të falurit dhe japin detyrimin, porositin të mirën dhe ndalojnë të keqen. Zotit i takon fundi i çështjeve.
42. Në të përgënjeshtrojnë, përgënjeshtruan para tyre kombi i Nuhit, Adit e Themudit,
43. kombi i Ibrahimit dhe kombi i Lutit,
44. banorët e Medjenit. Dhe u përgënjeshtrua Musai. Mohuesve ua zgjata, pastaj i mora dhe si qe mospëlqimi Im?
45. Sa e sa vendbanime dhune i shkatërroam, me ngrehinat e shembura, pusët e lëna shkretë dhe kullat e larta!
46. Nuk udhëtojnë në tokë e ta ndiejnë me zemër apo ta dëgjojnë me veshë? Nuk janë sytë të verbra, por, të verbra, zemrat në kraharore.
47. Duan të të nxitojnë për dënimin, por Zoti nuk e shkel fjalën. Një ditë pranë tët Zoti është sa një mijë vjet që numëroni ju.
48. Sa e sa vendbanimeve dhune ua zgjata, pastaj i mora dhe fundi është tek Unë.

49. Thuaj: “O njerëz, unë jam për ju një paralajmërues i qartë.”
50. Cilët besojnë e bëjnë të mira, kanë falje dhe një pjesë bujare.
51. Ata që përpiqen të zhvleftësojnë dëshmitë Tona janë banorët e skëterrës.
52. Nuk dërguam para teje të dërguar e profet që djalli të mos i ndërhynte në dëshirat e tij. Porse Zoti shfuqizon ndërhyrjen e djallit dhe i fuqizon Zoti dëshmitë e Tij. Zoti është dijeplotë, i urtë.
53. Që ta bëjë ndërhyrjen e djallit provë për zemërsëmurët dhe zemërgurët. Dhunuesit janë në mospajtim të thellë.
54. Dhe ta dinë ata me dije se është e vërteta nga yt Zot, ta besojnë dhe t'i nënshtrohen zemrat e tyre. Zoti i udhëheq besimtarët në udhë të drejtë.
55. Mohuesit nuk do të pushojnë së qeni në dyshim derisa t'u vijë papritmas ora ose t'u vijë dënimi një ditë pa shpëtim.
56. Sundimi atë ditë i takon Zotit. Ai gjykon mes tyre. Cilët besojnë e bëjnë të mira janë në kopshtet e begata.
57. Ata që mohojnë dhe përgënjeshtrojnë dëshmitë Tona kanë dënim poshtërues.
58. Ndërsa, atyre që emigruan në Rrugën e Zotit dhe u vranë a vdiqën, Zoti do t'u japë një pjesë bujare. Zoti është Dhënësi Më i Mirë.
59. Ai i pranon në një hyrje ku janë të kënaqur. Zoti është dijeplotë, i butë.
60. Ja, pra. Zoti do t'i ndihmojë ata që ndëshkojnë siç u ndëshkuan dhe u shtypën. Zoti është ndjesës, falës.
61. Kështu, sepse Zoti fut natën në ditë dhe fut ditën në natë. Zoti është dëgjues, largpamës.

62. Sepse Zoti është e Vërteta dhe, ç'lusin në vend të Tij, janë e pavërteta. Zoti është i Larti, i Madhi.
63. Nuk sheh që Zoti zbret nga qielli ujë dhe gjelbërohet toka? Zoti është i ndjeshëm, i gjithëditur.
64. Atij i takojnë ç'janë në qiej e në tokë. Zoti është i Vetëmjaftueshmi, i Lëvduari.
65. Nuk sheh që Zoti ka vënë në shërbimin tuaj ç'janë në tokë, edhe anijen që lundron në det me urdhrin e Tij? Ai mban, me lejen e Vet, qiellin të mos bjerë në tokë. Zoti është i dhembshur me njerëzit, mëshirëplotë.
66. Është Ai që ju jep jetë, pastaj ju vdes e ngjall. Me të vërtetë, njeriu është mosmirënjohës.
67. Çdo populli i bëmë një ritual që mban. Le të mos diskutojnë me ty në këtë çështje. Fto te yt Zot sepse ti je në drejtimin e duhur.
68. Po të të kundërshtojnë, thuaj: "Zoti i di mirë veprat tuaja."
69. Zoti do të gjykojë mes jush Ditën e Ringjalljes se ku ishit në kundërshti.
70. Nuk e di që Zoti di ç'janë në qiell e në tokë? Kjo është në libër dhe për Zotin është e lehtë.
71. Adhurojnë në vend të Zotit ç' Ai nuk shpalli për të ndonjë argument dhe që s'kanë dije. Dhunuesit nuk kanë përkrahës.
72. Kur u recitohen dëshmitë Tona të qarta, vëren në fytyrat e mohuesve mospëlqim. Sa s'u hidhen sipër atyre që u recitojnë dëshmitë Tona. Thuaj: "T'jua bëj të njohur ç'është më e keqe? Zjarri që Zoti u paralajmëroi mohuesve. Ç'fund i keq!"
73. O njerëz! Jepet një shembull, pra, dëgjoheni! Çfarë lusni në vend të Zotit s'do të mund të krijonin qoftë një mizë edhe po të bashkëpunojnë. Nëse miza u

- rrëmben diçka, nuk mund ta shpëtojnë. Të dobët janë si kërkuesi edhe i kërkuari.
74. Nuk e vlerësojnë Zotin me vlerësimin e duhur. Zoti është i fortë, i plotfuqishëm.
75. Zoti zgjedh, ndër engjëjt dhe njerëzit, të dërguar. Zoti është dëgjues, largpamës.
76. Ai di të tashmen dhe të ardhmen e tyre. Te Zoti kthehen çështjet.
77. Besimtarë! Përkuluni, përuluni, adhuron Zotin tuaj dhe bëni të mira që të mund të keni sukses.
78. Përpiquni te Zoti me përpjekjen e vërtetë për Të. Ai ju zgjodhi juve në besimin e atit tuaj, Ibrahimit dhe nuk ju bëri vështirësi në fe. Ju quajti muslimanë, më parë edhe këtu, që i Dërguari të jetë dëshmues për ju dhe ju të jeni dëshmues për njerëzit. Kryeni të falurit, jepni detyrimin dhe mbahuni te Zoti! Ai është Mbrojtësi juaj, ç'mbrojtës i mirë dhe përkrahës i mirë!

23.BESIMTARËT (EL MU'MINUN)

Periudha e Mekës, 118 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Kanë sukses besimtarët,
2. të përkushtuar në adhurimin e tyre,
3. larg fjalëve të kota,
4. zbatues të zekatit,
5. ruajtës të nderit;

6. - nuk qortohen për bashkëshortet dhe robinjat e tyre;
(Shih 4:3, 25)
7. bëjnë shkelje nëse lakmojnë më tej; -
8. mbajtës të porosisë dhe besës së dhënë,
9. respektues në adhurimin e tyre.
10. Ata janë trashëgimtarët,
11. që trashëgojnë kopshtet e parajsës ku do të jenë të përhershëm.
12. E krijuam njeriun nga një prejardhje balte.
13. Pastaj e bëmë pikë lëngu në vend të sigurt.
14. Pikën e lëngut e krijuam, pastaj, gjak të trashë; gjakun e krijuam copë mishi; copën e mishit e krijuam eshtra; eshtrat i veshëm me mish; pastaj e nxorëm atë tjetër krijesë. Bekuar qoftë Zoti, Më i Miri Krijues!
15. Vërtet, ju, pas kësaj, do të vdisni.
16. Pastaj, Ditën e Ringjalljes, ngriheni.
17. Krijuam mbi ju shtatë rrugë (qiej) dhe nuk jemi rreth krijimit të pavëmendshëm.
18. Zbresim nga qielli ujë me masë dhe e depozitojmë në tokë, por Ne mund edhe ta shterojmë.
19. Nxjerrim me të, për ju, kopshte palmash e rrushi, me fryte të shumta dhe hani prej tyre.
20. Dhe një pemë që del nga Mali Sinai dhe jep vaj e bërsi për ushqim.
21. Ka për ju, te kafshët, mësim: ju japim të pini nga barqet e tyre, keni në to dobi të shumta dhe ushqeheni prej tyre.
22. Barteni mbi to dhe në anije.
23. Dërguam Nuhin te kombi i tij dhe tha: "Kombi im, adhuroni Zotin! S'keni zot veç Tij. A nuk përmbaheni?"

24. Krerët mohues të kombit të tij thanë: “Ky është njeri si ju që kërkon të dallohet. Po të deshte Zoti, kishte zbritur engjëj. S’e dëgjuam këtë te etërit tanë të parë.
25. Ai është njeri i marrë. Prisni për të një kohë!”
26. Tha: “Im Zot, ndihmomë se më përgënjeshtruan!”
27. I kumtuam: “Ndërto anijen nën sytë dhe frymëzimin Tonë! Kur të vijë urdhri Ynë e të gufojë toka, merr në të nga dy për çift dhe familjen tënde, përveç atyre që u ka kaluar fjala. Dhe mos m’u drejto për dhunuesit. Ata janë të mbytur.
28. Kur të hipni në anije, ti dhe ç’janë me ty, thuaj: “Lavdi Zotit që na shpëtoi nga kombi dhunues!”
29. Dhe thuaj: “Im Zot, zbarkomë në një vend të bekuar! Ti je më i miri zbarkues!”
30. Këtu ka dëshmi dhe Ne vëmë në provë.
31. Ngritëm pas tyre brezni të tjera.
32. Dhe dërguam të dërguar prej tyre: “Adhuroni Zotin! S’keni zot veç Tij. A nuk përmbaheni?”
33. Krerët e kombit, që mohuan dhe përgënjeshtruan takimin e së ardhmes, ndërsa i patëm bërë të kamur në këtë botë, thanë: “Ky është njeri si ju, ha çfarë hani ju dhe pi çfarë pini ju.
34. Në qoftë se i bindeni një njeriu si ju, jeni të humbur.
35. A ju premtan, pasi të vdisni dhe të bëheni pluhur e kocka, të dilni përsëri?
36. Një premtim larg së vërtetës.
37. Është vetëm jeta jonë në këtë botë: vdesim, jetojmë dhe nuk ringjallemi.
38. Ai është njeri që sajton gënjeshhtë ndaj Zotit dhe ne nuk e besojmë.”
39. Tha: “Im Zot, ndihmomë se më përgënjeshtruan!”
40. Tha: “Së shpejti do të pendohen.”

41. I zuri krisma me të vërtetën dhe i bëmë mbeturina.
Larg njerëzve të padrejtë!
42. Ngritëm pas tyre brezni të tjera.
43. Nuk mund ta parakalojë një popull afatin e vet, as ta vonojë.
44. Dërguam në vazhdim të dërguarit Tanë. Sa herë i erdhi një populli i dërguari, e përgënjeshtroi dhe Ne i përcollëm njërin pas tjetrit dhe i bëmë histori. Larg njerëzve që nuk besojnë!
45. Pastaj dërguam Musanë e të vëllanë, Harunin, me dëshmitë Tona dhe autoritet të qartë.
46. Te faraoni dhe krerët e tij, por ata u mburrën dhe ishin tiranë.
47. Thanë: "A t'u besojmë dy njerëzve si ne kur bashkëkombësit e tyre janë në shërbimin tonë?"
48. I përgënjeshtruan dhe u bënë të paqenë.
49. I dhamë Musait Librin që të mund të drejtoheshin.
50. Bëmë birin e Merjemit dhe nënën e tij dëshmi dhe i strehuam në një kodrinë të qetë e një burim.
51. "O të dërguar, ushqehuni me të mirat dhe bëni të mira! Unë jam, për bëmat tuaja, dijeplotë.
52. Kjo është bashkësia juaj, një bashkësi dhe Unë jam Zoti juaj, pra, përmbamuni Mua!"
53. E përçanë çështjen e tyre në fraksione dhe secila palë qe e kënaqur me të sajën.
54. Lëri ata një kohë në çoroditjen e tyre.
55. Besojnë se po i mbështesim me mall e fëmijë?
56. Se po nxitojmë për ta në të mira? Jo, nuk e kuptojnë.
57. Me të vërtetë, ata që nga frika për Zotin e tyre shqetësohen
58. dhe në dëshmitë e Zotit besojnë,
59. që Zotit të tyre shok nuk i bëjnë,

60. që japin ç'mund të japin dhe u dridhen zemrat se te Zoti i tyre do të kthehen,
61. ata nxitojnë në të mira dhe për to janë pararojë.
62. Nuk ngarkojmë një frymë përtej mundësisë. Pranë Nesh është një libër që flet të vërtetën dhe nuk i bëhet kujt e padrejtë.
63. Por zemrat e tyre janë në çoroditje rreth kësaj dhe veprat që ata kryejnë, ndryshe nga kjo.
64. Derisa, kur t'i zëmë të kamurit e tyre me dënim, ja tek qahen.
65. "Sot mos u qani se nuk do të gjeni ndaj Nesh ndihmë.
66. Ju lexuan dëshmitë e Mia dhe u kthyet mbrapsht.
67. Kryeneçë për to, përcillnit natën fjalë të këqia."
68. Nuk e shqyrtojnë fjalën apo u vjen si diçka që s'u pati ardhur etërve të tyre të parë?
69. Apo nuk e njohin të Dërguarin dhe e mohojnë?
70. Apo thonë se e kanë zënë xhinët? Jo, ai u erdhi me të vërtetën, por të shumtët e tyre janë mohues të së vërtetës.
71. Sikur e vërteta të ndiqte dëshirat e tyre, do të prisheshin qiejt dhe toka e ç'janë në to. Ne u sollëm kujtesë, por ata i largohen kujtesës.
72. Mos po u kërkon haraç? Haraçi i tët Zoti është më i mirë dhe Ai është Dhënësi Më i Mirë.
73. Ti po i fton në udhë të drejtë.
74. Por, ata që nuk e besojnë të ardhmen janë larg udhës.
75. Edhe sikur t'i mëshironim dhe t'ua largonim të keqen me ta, do të këmbëngulnin të çoroditur në rebelimin e tyre.
76. I zumë me vuajtje dhe nuk iu nënshtuan Zotit, as u përulën.

77. Derisa t'u hapim portën e dënimit të rreptë dhe, ja, ku janë në të të dëshpëruar.
78. Është Ai që krijoi për ju të dëgjuarit, të parët dhe zemrat. Ju pak falënderoni.
79. Është Ai që ju përhapi në tokë dhe drejt Tij do të mbliidheni.
80. Është Ai që ngjall e vdes dhe ndryshon natën me ditën. A nuk kuptoni?
81. Jo, ata flasin siç flisnin të parët.
82. Thonë: "Kur të vdesim e të jemi bërë pluhur e kocka, do të ngrihemi?"
83. Kjo na u premtua neve dhe etërve tanë më parë, porse është rrëfenjë e të parëve."
84. Thuaj: "E kujt është toka e ç'janë në të nëse e dini?"
85. Do të thonë: "E Zotit." Thuaj: "A nuk mendoheni?"
86. Thuaj: "Kush është Zoti i shtatë qiejve, Zoti i Fronit të Madh?"
87. Do të thonë: "Zoti." Thuaj: "A nuk përmbaheni?"
88. Thuaj: "Në dorën e kujt është sundimi i çdo gjëje, ndërsa Ai merr në mbrojtje dhe nuk ka mbrojtje ndaj Tij, nëse e dini?"
89. Do të thonë: "E Zotit." Thuaj: "Si mashtroheni?"
90. Porse, Ne u erdhëm me të vërtetën dhe ata janë gënjeshtarët.
91. Zoti nuk ka bërë bir dhe s'ka me të zota të tjerë. Atëherë, çdo zot do të merrte krijimin e vet dhe do të ngriheshin disa mbi të tjerë. Madhëruar qoftë Zoti nga ç'i cilësojnë!
92. Ai di të padukshmen e të dukshmen, i lartë nga ç'i shoqërojnë.
93. Thuaj: "Im Zot! Edhe në më bën të shoh ç'u është paralajmëruar,

94. mos më lë, Zoti im, te njerëzit e pabesë!”
95. Vërtet, Ne jemi të pushtetshëm të të bëjmë të shohësh ç’u është paralajmëruar.
96. Ti ktheje të keqen me të mirë! Ne e dimë çfarë cilësojnë.
97. Dhe thuaj: “Zoti im! Kërkoj mbrojtjen Tënde nga tundimet e djajve!”
98. Dhe: “Mbrohemi me Ty, im Zot, nga prania e tyre!”
99. Vetëm kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, thotë: “Im Zot, më kthe!”
100. Të mund të bëj të mirat që kam lënë!” Jo, thotë fjalë goje. Pas tyre, një humnerë deri ditën që do të ngrihen.
101. Kur t’i fryhet bririt, atë ditë s’ka mes tyre lidhje dhe nuk pyesin njëri-tjetrin.
102. Ata që u peshon balanca janë të suksesshmit.
103. Cilët nuk u peshon balanca, humbën veten, në skëterrë, ku do të jenë të përhershëm.
104. Ua përzhit fytyrën zjarri dhe janë në të të dëshpëruar.
105. “A nuk ju lexuan dëshmitë e Mia dhe i përgënjeshtruat?”
106. Thonë: “Zoti ynë, na munda e keqja jonë dhe ishim të gabuar.
107. Zoti ynë, nxirrna nga kjo! Në e përsëritshim, vërtet jemi të paudhë.”
108. Thotë: “Të përçmuar, mos më drejtoni fjalë.
109. Ishte një grup ndër robtë e Mi që thonin: “Zoti ynë, ne besojmë, pra, falna e mëshirona! Ti je Më i Miri Mëshirues!”
110. Por ju i morët me tallje, aq sa ju bënë të harronit Kujtesën Time e të qeshnit me ta.

111. Sot i shpërbleva për durimin e tyre dhe ata janë fitimtarët.”
112. Thotë: “Sa vite qëndruat në tokë?”
113. Thonë: “Qëndruam një ditë a një pjesë dite. Pyet llogaritësit!”
114. Thotë: “Sikur ta dinit, qëndruat vetëm pak.
115. Mos pandehët se ju krijuam më kot dhe nuk do të ktheheshit te Ne?”
116. I Lartë është Zoti, Sundimtari i Vërtetë! S’ka zot, veç Tij, Zotit të Fronit të Nderuar.
117. Kush lut me Zotin tjetër zot, pa argument për këtë, e ka llogarinë pranë Zotit të tij. Mohuesit nuk kanë sukses.
118. Thuaj: “Im Zot, fal e mëshiro! Ti je Më i Miri Mëshirues.”

24. DRITA (EN NUR)

Periudha e Medines, 64 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Kapitull të cilin e zbritëm dhe e bëmë detyrim. Shpallëm në të dëshmi të qarta që të mund të mendoheni.
2. Të përdalën e të përdalin (të pamartuar. Për të martuarit, shih 4:15,16,25) fshikullojini me nga njëqint kamxhikë dhe të mos ju dhimbsen në fenë e Zotit në besoni Zotin dhe Ditën e Fundit. Le të dëshmojë ndëshkimin e tyre një grup besimtarësh.

3. I përdali të martohet me të përdalë ose me idhujtare dhe e përdala të martohet me të përdalë ose me idhujtar. Nuk lejohen për besimtarët.
4. Ata që akuzojnë gratë e ndershme pa sjellë katër dëshmitarë, fshikullojini me tetëdhjetë kamxhikë dhe mos e pranoni kurrë dëshminë e tyre. Këta janë të shthurur.
5. Përrjashtuar atyre që, më pas, pendohen e përmirësohen. Zoti është falës, mëshirëplotë.
6. Cilët akuzojnë gratë e tyre dhe nuk kanë dëshmitarë veç vetes, të dëshmojnë katër herë për Zotin se thonë të vërtetën.
7. Dhe, të pestën, që mallkimi i Zotit rëntë mbi ta po që se gënjejnë.
8. Në qoftë se ajo dëshmon katër herë për Zotin se ai është gënjeshtar, i hiqet dënimi.
9. Dhe, të pestën, që zemërimi i Zotit rëntë mbi të nëse ai thotë të vërtetën.
10. Të mos qenë mirësia e Zotit ndaj jush dhe mëshira e Tij! Zoti është falës, i urtë.
11. Shpifësit janë një grup tuajsh. Mos e mendoni në të keqen tuaj; jo, është në të mirën tuaj. Secili prej tyre ka mëkatin e vet, por atij që mori përgjegjësinë i takon dënim tepër i rëndë.
12. Kur e dëgjuat, përse besimtarët dhe besimtare nuk menduan mirë në vetvete e të thonin: “Kjo është shpifje e qartë?”
13. Përse nuk sollën katër dëshmitarë? Meqë nuk sollën dëshmitarët, te Zoti ata janë gënjeshtarë.
14. Të mos qenë mirësia e Zotit ndaj jush dhe mëshira e Tij në këtë botë e në të ardhmen, do t’ju kishte zënë te thashethemet një dënim tepër i rëndë.

15. Kur e përcollët me gjuhët tuaja dhe thatë me gojë diçka për të cilën nuk kishit dijeni, e menduat të lehtë, por te Zoti qe e rëndë.
16. Kur e dëgjuat, përse nuk thatë: "S'na takon neve të flasim për këtë, madhëruar qofsh, kjo është shpifje e madhe?"
17. Zoti ju këshillon të mos e përsëritni më në jeni besimtarë.
18. Zoti jua sqaron dëshmitë. Zoti është dijeplotë, i urtë.
19. Cilët dëshirojnë të përhapet e keqja te besimtarët, kanë dënim të hidhët në këtë botë e në të ardhmen. Zoti di tek ju nuk dini.
20. Të mos qenë mirësia e Zotit ndaj jush dhe mëshira e Tij! Zoti është i dhembshur, mëshirëplotë.
21. Besimtarë, mos ndiqni gjurmët e djallit! Kë ndjek gjurmët e djallit, ai i porosit paudhësinë dhe të urryerën. Të mos qenë mirësia e Zotit ndaj jush dhe mëshira e Tij, nuk do të çlirohej ndonjëri nga ju, kurrë. Porse Zoti çliron me dashjen e Tij. Zoti është dëgjues, dijeplotë.
22. Bujarët dhe njerëzit e begatë ndër ju të mos betohen se nuk do t'u japin të afërmve, të varfërve dhe të shpërngulurve në Rrugën e Zotit. Le të falin e të mos vënë re. Mos nuk doni t'ju falë Zoti? Zoti është falës, mëshirëplotë.
23. Ata që akuzojnë besimtarët e ndershme e të pafajshme u mallkuan në këtë botë e në të ardhmen dhe kanë dënim të madh,
24. ditën që u dëshmojnë gjuhët, duart dhe këmbët për veprat e tyre.
25. Atë ditë, Zoti ua plotëson shpërblimin e merituar. Ta dinë se Zoti është e Vërteta e Qartë.

26. Të këqijat janë për të këqijtë dhe të këqijtë janë për të këqijat; të mirat janë për të mirët dhe të mirët janë për të mirat. Ata janë të pafajshëm për fjalët e të tjerëve. Kanë falje dhe një pjesë bujare.
27. Besimtarë! Mos hyni në shtëpitë që s'janë shtëpitë tuaja pa kërkuar leje dhe përshëndetur njerëzit e tyre. Kështu është më mirë për ju që të jeni të vëmendshëm.
28. Edhe sikur të mos gjeni dikë në to, mos hyni pa leje. Po t'ju thuhet të ktheheni, kthehuni. Kjo është më e dëlirë për ju. Zoti është dijeplotë për veprat tuaja.
29. S'është mëkat të hyni për strehim në shtëpitë e pabanuara. Zoti e di çfarë shfaqni e ç'fshihni.
30. Thuaju besimtarëve të ulin shikimet dhe të ruajnë nderin. Kjo është më e pastër për ta. Zoti është në dijeni se ç'planifikojnë.
31. Thuaju besimtareve të ulin shikimet, të ruajnë nderin dhe të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç asaj që duket. Le t'i hedhin perçet mbi kraharor e të mos zbulojnë bukurinë e tyre, përjashtuar burrave të tyre ose etërve të tyre ose etërve të burrave të tyre ose bijve të tyre ose bijve të burrave të tyre ose vëllezërve të tyre ose bijve të vëllezërve të tyre ose bijve të motrave të tyre ose shoqeve të tyre ose shërbyeseve të tyre ose burrave nën shërbim që nuk kanë nevojë ose fëmijëve që nuk u bien në sy pjesët e turpshme të grave. Të mos përplasnin këmbët për t'u dukur stolitë që fshehin. Pendohuni te Zoti, të gjithë o besimtarë, që të jeni faqebardhë.
32. Martoni të pamartuarit ndër ju dhe skllëvërit e skllavet e ndershme. Në janë të varfër, i begaton Zoti me Mirësinë e Vet. Zoti është i paanë, dijeplotë.

33. Le të ruajnë nderin ata që nuk gjejnë martesë derisa Zoti t'i begatojë me Mirësinë e Vet. Skllevërve që kërkojnë dokument, nënshkruajuni nëse ua dini të mirën dhe jepuni nga pasuria e Zotit që Ai jua ka dhënë. Mos i detyroni shërbëtoret tuaja në prostitucion kur ato duan të mbeten të ndershme dhe të kërkonin një fitim kalimtar të jetës së kësaj bote. Nëse detyrohen, Zoti është, pasi janë detyruar, falës, mëshirëplotë.
34. Ne ju shpallëm dëshmi të qarta, shembullin e pararendësve tuaj dhe këshillë për të devotshmit.
35. Allahu është Drita e qiejve dhe e tokës. Shembull i Dritës së Tij, një fole me kandil; kandili është në një llambë të kristaltë; llamba e kristaltë, si një yll shndritës, ndizet nga një pemë e bekuar ulliri, pa lindje e perëndim, vaji i të cilit bën dritë thuajse nuk e ka prekur ndonjë zjarr. Dritë mbi dritë. Zoti drejton te Drita e Tij atë që do. Zoti u sjell shembuj njerëzve. Zoti është për çdo gjë dijeplotë.
36. Nëpër shtëpi që Zoti lejoi të ngrihen dhe të përmendet Emri i Tij, i thurin lavde, mëngjes e mbrëmje,
37. njerëz të cilët tregtia e shitblerja nuk i largojnë nga të përmendurit e Zotit, që kryejnë të falurit dhe japin detyrimin, që i frikësohen një dite kur tronditen zemrat dhe vështrimet.
38. Që Zoti t'i shpërblejë me më të mirën e veprave të tyre dhe t'u japë më shumë me Mirësinë e Vet. Zoti i jep atij që do, pa masë.
39. Veprat e mohuesve janë si një mirazh në shkretëtirë që i eturi e pandeh për ujë dhe, kur afrohet, s'gjen gjë. Gjen aty Zotin që ia bën llogarinë. Zoti ka llogari të shpejtë.

40. Ose si errësirat në një oqean të thellë: e mbulojnë dallgë mbi dallgë dhe, përsipër, retë; errësirë mbi errësirë; nxjerr dorën dhe zor se e sheh. Kujt s'i bën Zoti dritë, nuk ka për të dritë.
41. Nuk vë re që Zotit i thurin lavde ç'janë në qiej e në tokë edhe shpendët me flatrat hapur? Secili di adhurimin dhe himnet për Të. Zoti është dijeplotë për veprat e tyre.
42. Zotit i takon sundimi i qiejve dhe i tokës. Fundi është te Zoti.
43. Nuk vë re që Zoti lëviz retë, pastaj i bashkon, pastaj i bën pìrg dhe sheh shiun të dalë nga mesi i tyre? Zbret nga qielli male breshëri dhe godet me to atë që do ose i lakon prej atij që do. Shkëlqimi i vetëtimës gati merr të parët.
44. Zoti rrotullon natën e ditën. Këtu ka mësim për vëzhguesit.
45. Zoti krijoi çdo gjallesë nga uji. Ndër to, ka që ecin barkas, që ecin me dy këmbë, që ecin me katër. Zoti krijon ç'të dojë. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.
46. Ne të shpallëm dëshmi të qarta. Zoti drejton atë që do në udhë të drejtë.
47. Thonë: "Besojmë Zotin dhe të Dërguarin e bindemi." Pastaj, një kastë e tyre tërhiqet. Ata nuk janë besimtarë.
48. Kur ftohen te Zoti dhe i Dërguari i Tij për të gjykuar mes tyre, ja, një kastë e tyre largohet.
49. Po të jetë me ta e drejta, i vijnë të nënshtruar.
50. Mos ka në zemrat e tyre sëmundje apo dyshojnë a frikësohen se Zoti dhe i Dërguari i Tij do të gjykojnë padrejtësisht? Jo, ata janë të padrejtët.

51. Kur besimtarët ftohen te Zoti dhe i Dërguari i Tij për të gjykuar mes tyre, thonë: “Dëgjuam e u bindëm.” Këta janë faqebardhët.
52. Cilët u binden Zotit e të Dërguarit të Tij dhe i frikësohen e i përmbahen Zotit, ata janë të suksesshmit.
53. Betohen në Zotin me be të fortë se, po t’i urdhërosh, patjetër do të dalin. Thuaj: “Mos u betoni. Një bindje e njohur. Zoti është në dijeni të veprave tuaja.”
54. Thuaj: “Bindjuni Zotit dhe bindjuni të Dërguarit!” Në qoftë se shmangeni, mbi të është barra e tij dhe, mbi ju, barra juaj. Në qoftë se bindeni, udhëhiqeni drejt. Për të Dërguarin është fjala e qartë.
55. Zoti u premtoi atyre që besojnë prej jush e bëjnë të mira t’i bëjë mëkëmbës në tokë siç i bëri mëkëmbës pararendësit e tyre, t’u vendosë fenë që Ai ka pëlqyer për ta dhe t’ua kthejë frikën në siguri. Ata do të më adhurojnë Mua dhe nuk do të më shoqërojnë gjë. Cilët mohojnë, pas kësaj, ata janë të pabindurit.
56. Kryeni të falurit, jepni detyrimin dhe bindjuni të Dërguarit që të mund të mëshiroheni.
57. Mos i pandehni mohuesit çudibërës në tokë. Streha e tyre është zjarri, ç’fund i keq!
58. Besimtarë! Le të kërkojnë lejen tuaj shërbyesit dhe ata që nuk kanë arritur pjekurinë tri herë: para faljes së mëngjesit, gjatë pushimit të drekës dhe pas faljes së natës, tri kohë mëvetësie për ju. S’bëni mëkat ju ose ata t’i shkoni njëri-tjetrit më pas. Zoti jua sqaron kështu dëshmitë. Zoti është dijeplotë, i urtë.
59. Kur fëmijët tuaj të kenë arritur pjekurinë, le të kërkojnë leje siç kërkojnë leje më të mëdhenjtë. Zoti jua sqaron kështu dëshmitë e Tij. Zoti është dijeplotë, i urtë.

60. Nuk është mëkat për gratë e shkuara në moshë dhe që s'presin martesë, t'i heqin rrobat, pa zbuluar stolinë, por, nëse kufizohen, është më mirë për to. Zoti është dëgjues, dijeplotë.
61. Nuk është e ndaluar për të verbrin, të gjymtuarin, të sëmurin, as për ju vetë të ushqeheni nga shtëpitë tuaja, shtëpitë e etërve tuaj, shtëpitë e nënave tuaja, shtëpitë e vëllezërve tuaj, shtëpitë e motrave tuaja, shtëpitë e xhaxhallarëve tuaj, shtëpitë e hallave tuaja, shtëpitë e dajave tuaj, shtëpitë e tezeve tuaja ose ku keni çelësat në dorëzim a te një miku juaj. Nuk është mëkat të hani së bashku ose veç e veç. Kur të hyni në shtëpi, përshëndetuni me urim prej Zotit, të bekuar e të mirë. Kështu jua sqaron Zoti dëshmitë që të mund të kuptoni.
62. Besimtarë janë ata që besojnë Zotin dhe të Dërguarin e Tij dhe, kur janë bashkë me të për diçka të përbashkët, nuk ikin pa i marrë leje. Ata që të lypin leje janë që besojnë Zotin dhe të Dërguarin e Tij, prandaj, kur të kërkojnë leje për ndonjë punë të tyre, jepu leje, me dashjen tënde dhe lypj Zotit falje për ta. Zoti është falës, mëshirëplotë.
63. Mos e merrni thirrjen e të Dërguarit mes jush si thirrje të njëri-tjetrit. Zoti e di se cilët ikin tinëz. Le të kenë kujdes ata që shkelin urdhrin e tij se mund të bien në provë a t'i zërë ndonjë dënim i hidhët.
64. A s'i takojnë Zotit ç'janë në qiej e në tokë? Ai e di gjendjen tuaj. Ditën që i kthehen Atij, i njofton për veprat. Zoti është për gjithçka dijeplotë.

25. DALLUESI (EL FURKAN)

Periudha e Mekës, 77 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Bekuar qoftë Ai që zbriti mbi robin e Vet Dalluesin, të jetë për botët paralajmërues!
2. Ai, të Cilit i përket sundimi i qiejve dhe i tokës, që nuk ka bërë bir, nuk ka pjesëmarrës në sundim, që krijoi çdo gjë dhe e përcaktoi me masë.
3. Marrin, në vend të Tij, zota që nuk krijojnë, por janë të krijuar, që nuk zotërojnë për vete dëm e dobi dhe nuk zotërojnë vdekje, jetë e ringjallje.
4. Mohuesit thonë: "Kjo është gënjeshtër që e trilloi ai me ndihmën e të tjerëve." Bëjnë padrejtësi dhe shtrëmbërim të madh.
5. Thonë edhe: "Rrëfenja të të parëve që bëri t'i shkruhen dhe recitohen mëngjes e mbrëmje."
6. Thuj: "E zbriti Ai që di të fshehtë në qiej e në tokë. Ai është falës, mëshirëplotë."
7. Thonë: "Ç'qenka ky i dërguar që ha ushqim dhe ecën rrugës? Përse nuk i zbriti një engjëll të jetë bashkë me të paralajmërues?"
8. Ose t'i jepej një thesar dhe t'i bëhej një kopsht-parajsë ku të ushqehet?" Dhunuesit thonë: "Po ndiqni një njeri të magjepsur."
9. Shih ç'krahassime të bëjnë! Gabojnë dhe s'mund të gjejnë udhë.
10. Bekuar qoftë Ai që, në dashtë, bën për ty më të mira nga këto, kopshte ku rrjedhin lumenj dhe bën për ty pallate.

11. Jo, ata përgënjeshtrojnë Orën. Atyre që përgënjeshtrojnë Orën u bëjnë gati skëterrën.
12. Kur t'u shfaqet nga larg, do t'ia dëgjojnë tërbimin dhe ulërimën.
13. Kur të jenë hedhur grumbull në një qeli të saj, do të lypin vdekjen.
14. "Mos e lypni, sot, vdekjen një herë, lypeni shumë herë!"
15. Thuaj: "Kjo, më mirë apo kopshti i përjetshëm, premtuar të devotshmëve? Për ta, një shpërblim dhe vendarritje.
16. Të përhershëm, kanë në të ç'të dëshirojnë. Për të Zot, premtim i përgjegjshëm.
17. Ditën që i tubon ata dhe ç'adhurorin në vend të Zotit, thotë: "Ju i gabuat këta robtë e Mi apo gabuan rrugë?"
18. Thonë: "Madhëruar qofsh! Nuk na përshtatet neve të marrim kujdestarë në vendin Tënd, porse i bëre ata dhe etërit e tyre ta gëzonin jetën derisa harruan Kujtesën dhe mbetën të humbur."
19. "Ja ku jua përgënjeshtroan fjalët! Dhe nuk mund të lakoni e të kërkoni ndihmë. Dhunuesit i bëjnë të shijojnë dënim të madh."
20. Nuk dërguam para teje të dërguar që të mos hanin ushqim e të ecnin rrugës. I bëjnë disa prej jush provë për të tjerët. A po duroni? Yt Zot është largpamës.
21. Ata që nuk e presin takimin Tonë, thonë: "Përse nuk na zbritën engjëjt a të shihnim Zotin tonë?" U mburrën në vetvete dhe i kaluan kufijtë.
22. Ditën që shohin engjëjt, nuk ka shtatë për mëkatarët. Dhe thonë: "Ndalohej!"
23. U kthehemi veprave të tyre dhe i bëjmë pluhur që derdhet.

24. Banorët e parajsës janë atë ditë në vendbanimin më të mirë dhe vendpushimin më të këndshëm.
25. Ditën që çahet qielli me re dhe zbresin engjëjt,
26. sundimi i vërtetë, atë ditë, i takon Bamirësit. Për mohuesit është ditë e vështirë,
27. dita kur dhunuesi kafshon dorën e vet e thotë: “Sikur të merrja me të dërguarin udhë!
28. I mjeri unë, filanin mik të mos e kisha bërë!
29. Ai më largoi nga kujtesa pasi më erdhi. Djalli është për njeriun një tradhtar.”
30. I Dërguari do të thotë: “Im Zot, populli im e mori këtë Kuran si të harruar.”
31. Çdo profeti i bëmë kështu armiq ndër mëkatarët. Mjafton yt Zot, udhëheqës e ndihmëtar!
32. Mohuesit thonë: “Përse nuk i zbriti Kurani i tëri njëherësh?” Kështu, që ta forcojmë me të zemrën tënde dhe e renditëm sipas një rendi.”
33. Shembujve të tyre Ne u sjellim të vërtetën dhe shpjegimin më të mirë.
34. Ata që tubohen me fytyrë nga skëterra janë në pozicionin më të keq dhe të humbur në udhë.
35. I dhamë Musait Librin dhe bëmë me të të vëllanë, Harunin, mëkëmbës.
36. Thamë: “Shkoni te njerëzit që përgënjeshtroan dëshmitë Tona!” Dhe, ata, i rrënuam.
37. Edhe kombin e Nuhit, kur përgënjeshtroi të dërguarit, e mbytëm dhe e bëmë dëshmi për njerëzit. Dhunuesve u bëmë gati dënim të hidhët.
38. Adit, Themudit, banorëve të Resit dhe shumë breznive mes tyre.
39. Secilit i sollëm shembuj. Dhe i bëmë të rrënuar.

40. Kanë kaluar në vendbanimin ku ra shiu i së keqes. A nuk shohin? Jo, por s'presin ringjallje.
41. Kur të shohin ty, të marrin me tallje: "Ky është që Zoti e dërgoi si të dërguar?"
42. Gati na largoi nga zotat tanë po të mos qemë të vendosur." Kur të shohin dënimin, do ta mësojnë kush ishte nga rruga i larguar.
43. E sheh kë merr për zot pasionin? Ti je për të i besuar?
44. Pandeh se të shumtët e tyre dëgjojnë a kuptojnë? Jo, ata janë si kafshët, madje, nga rruga edhe më të shmangur.
45. Nuk sheh tek yt Zot si shtrin hijen? Po të deshte, e bënte të palëvizshme. E bëmë diellin mbi të një tregues.
46. Pastaj e tërheqim lehtë nga Ne.
47. Është Ai që bëri për ju natën mbulesë, gjumin pushim dhe ditën ringjallje.
48. Është Ai që dërgon erërat, sihariq të mëshirës së Tij. Zbresim nga qielli ujë të pastër,
49. që të përtërijmë me të një tokë të vdekur dhe t'u japim të pijnë kafshëve dhe njerëzve të shumtë që krijuam.
50. E shpërndamë mes tyre që të mund të përmenden, por të shumtët e njerëzve refuzojnë duke mohuar.
51. Po të donim, kishim dërguar në çdo vendbanim paralajmërues.
52. Ti mos iu bind mohuesve, por bëju me të një përpjekje të madhe.
53. Është Ai që la të lirë dy dete: të ëmbël e të shijshëm dhe të kripur e të hidhur dhe bëri mes tyre barrierë, një ndarje të pakalueshme.

54. Është Ai që krijoi nga uji njeriun; e bëri atë në gjini e afri. Yt Zot është i plotpushtetshëm.
55. Adhurojnë në vend të Zotit ç'nuk u bën dobi e dëm ndërsa mohuesi del kundër Zotit të tij.
56. Të dërguam ty si përgëzues e paralajmërues.
57. Thuaj: "Nuk ju kërkoj për të shpërblim, por, kush të dojë, te Zoti i tij të marrë udhë."
58. Mbështetu te i Gjalli pa vdekje dhe madhëroje me lavdet për Të. Mjafton Ai, në dijeni për mëkatet e robërve të Tij.
59. Ai që krijoi qiejt dhe tokën e ç'janë mes tyre në gjashtë ditë, pastaj përqendroi pushtetin, Bamirësi-Rahman. Pyet Atë që është i gjithëditur!
60. Kur u thuhet: "Bini me krye në tokë për Bamirësin," – thonë: "Ç'është Bamirësi? T'i përulemi dikujt që na urdhëron ti?" Dhe u shton ikjen.
61. Bekuar qoftë Ai që bëri në qiell yjësi dhe, në to, një llambë të zjarrtë e hënë të shndritshme!
62. Është Ai që bëri natën dhe ditën të njëpasnjëshme, për këdo që dëshiron të meditojë a dëshiron të falënderojë.
63. Robtë e Bamirësit-Rahman janë ata që ecin në tokë me modesti dhe kur u drejtohen të paditurit, thonë: "Paqe!"
64. Ata që kalojnë natën për Zotin, përmbys e më këmbë.
65. Ata që thonë: "Zoti ynë, largona dënimin e skëterrës sepse dënimi i saj është vuajtje e madhe!
66. Një vendqëndrim dhe pozitë e keqe."
67. Ata që, kur shpenzojnë, nuk shpërdorojnë, as janë dorështrënguar, por të matur.

68. Ata që nuk lusin me Zotin zot tjetër, nuk vrasin pa të drejtë një frymë që Zoti e ka ndaluar dhe nuk bëjnë imoralitet. - Kush e bën atë, do të shohë dënimin.
69. Ditën e Ringjalljes i dyfishohet dënimi dhe është në të përjetë i poshtëruar.
70. Përveç atyre që pendohen, besojnë e bëjnë të mira. Zoti ua këmben të këqiat me të mira. Zoti është falës, mëshirëplotë.
71. Kush pendohet dhe bën mirë, kthehet te Zoti i penduar. -
72. Ata që nuk bëjnë dëshmi të rreme dhe, kur ndodhen në biseda të kota, kalojnë me nder.
73. Ata që, kur u përmenden dëshmitë e Zotit, nuk mbesin shurdhë e të verbër.
74. Ata që thonë: "Zoti ynë, jepna kënaqësi nga bashkëshortet dhe pasardhësit tanë, bëna shembull te të devotshmit!"
75. Këta do të shpërblehen me vendet më të larta të parajsës pasi duruan dhe do të gjejnë atje mirëseardhje e paqe.
76. Përgjithmonë. Ç'vëndqëndrim dhe pozitë e mirë!
77. Thuaj: "Im Zot nuk do të shqetësohej për ju të mos qe lutja juaj, porse përgënjeshtruat dhe u bë e domosdoshme."

26. POETËT (ESH-SHU'ARA')

Periudha e Mekës, 227 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Ta, sin, mim.
2. Këto janë dëshmitë e Librit të Qartë.
3. Ndoshta vret veten pse nuk besojnë.
4. Po të duam, u zbresim nga qielli një shenjë dhe të mbesin para saj qafëpërkulur.
5. Nuk u vjen kujtesë e re prej Bamirësit të mos i jenë shmangur.
6. Përgënjeshtroan dhe do t'u vijnë lajmet që shpërfillën.
7. Nuk shohin në tokë sa lloje të këndshme bëmë të rriten?
8. Këtu ka dëshmi, por të shumtët nuk janë besimtarë.
9. Yt Zot, Ai është i Plotfuqishëm, Mëshirëplotë.
10. Kur i thirri yt Zot Musait: “Eja te kombi dhunues,
11. kombi i faraonit! A nuk përmbahen?”
12. – tha: “Im Zot, kam frikë se do të më përgënjeshtrojnë.
13. Më ndrydhet zemra e nuk më zgjidhet gjuha. Dërgoje, pra, Harunin.
14. Më ngarkuan me faj dhe kam frikë se do të më vrasin.”
15. Tha: “Jo! Shkoni të dy me dëshmitë Tona. Ne jemi me ju, dëgjojmë.
16. Ejani te faraoni dhe thojni: “Jemi të dërguarit e Zotit të botëve.
17. Nisi me ne bijtë e Izraelit!”
18. Tha: “A nuk të rritëm mes nesh fëmijë dhe qëndrove te ne gjatë jetës tënde me vite?
19. Bëre ç'bëre dhe mohove.”
20. Tha: “E bëra kur isha i gabuar.
21. Ika prej jush nga frika dhe im Zot më dhuroi urtësi e më bëri të dërguar.

22. E mira që më bëre ti: skllavërove bijtë e Izraelit.”
23. Faraoni tha: “Ç’është Zoti i botëve?”
24. Tha: “Zoti i qiejve e i tokës dhe gjithçkaje mes tyre në bindeni.”
25. U tha atyre përreth: “A s’dëgjoni?”
26. Tha: “Zoti juaj dhe Zoti i etërve tuaj të parë.”
27. Tha: “Ky profet, i dërguar te ju, qenka i marrë!”
28. Tha: “Zoti i Lindjes e i Perëndimit dhe gjithçkaje mes tyre në kuptoni.”
29. Tha: “Po more zot tjetër veç meje, do të të bëj të burgosur.”
30. Tha: “Edhe në të sjell një provë të hapur?”
31. Tha: “Sille, në thua të vërtetën.”
32. Hodhi shkopin, kur, ja, një gjarpër që dukej.
33. Nxori dorën, kur, ja, e bardhë për shikuesit.
34. U tha krerëve përreth: “Ky qenka magjistar i ditur!
35. Me magjinë e vet, kërkon t’ju nxjerrë nga toka juaj. Ç’këshilloni?”
36. Thanë: “Ktheje me të vëllanë dhe dërgo tubues nëpër qytete.
37. Të të sjellin gjithë magjistarët e ditur.”
38. U mbloodhën magjistarët në takimin e ditës së caktuar.
39. Iu tha njerëzve: “Mblidhuni,
40. t’i ndjekim magjistarët nëse do të jenë ata fitimtarët.”
41. Me të ardhur magjistarët, i thanë faraonit: “Shpërblehemi po të jemi ne fitimtarët?”
42. Tha: “Po. Dhe do të jeni, atëherë, ndër të afërmit.”
43. Musai u tha: “Hidhni, ç’keni për të hedhur!”
44. Hodhën litarë e shkopin dhe thanë: “Për lavdinë e faraonit, ne jemi fitimtarët!”
45. Musai hodhi shkopin, kur, ja, i përpiu ç’kishin sajuar.
46. Ranë magjistarët në sexhde të përulur.

47. Thanë: "Besojmë Zotin e botëve,
48. Zotin e Musait e të Harunit."
49. Tha: "Besoni pa ju lejuar? Vërtet, ai është i madhi juaj që ju mësoi magjinë. Por, ta dini! Do t'ju pres tërthor duar e këmbë dhe t'ju kryqëzoj të gjithëve."
50. Thanë: "S'ka gjë. I kthehemi Zotit tonë.
51. Shpresojmë që Zoti ynë të na falë gabimet si të parët besimtarë."
52. I kumtuam Musait: "Nisu natën me robtë e Mi! Jeni në ndjekje."
53. Faraoni dërgoi tubues nëpër qytete:
54. "Këta janë një grup i vogël
55. që na provokuan.
56. Ndërsa ne, një shumicë e gatshme."
57. I nxorëm, pra, nga kopshtet e burimet,
58. thesaret dhe vendet e begata.
59. Ua trashëguam, kështu, bijve të Izraelit.
60. I ndoqën me të lindur të diellit.
61. Kur dy grupet panë njëri-tjetrin, shokët e Musait thanë: "Na arritën!"
62. Tha: "Jo! Me mua është im Zot që më prin."
63. I kumtuam Musait: "Bjeri me shkopin tënd detit!" U ça dhe u bë çdo anë një mal i lartë.
64. I afruam pranë të tjerët.
65. Shpëtuam Musanë dhe ç'qenë me të bashkë.
66. Pastaj i mbytëm të tjerët.
67. Këtu ka dëshmi, por të shumtët nuk janë besimtarë.
68. Yt Zot, Ai është i Plotfuqishëm, Mëshirëplotë.
69. Recitoju ndodhinë e Ibrahimit.
70. Kur i tha të atit dhe kombit të tij: "Ç'adhuroni?"
71. - thanë: "Adhurojmë idhuj që u jemi kushtuar."
72. Tha: "Kur thirrni, a ju dëgjojnë?"

73. Ju bëjnë dobi apo ju dëmtojnë?”
74. Thanë: “Jo. I gjetëm etërit tanë kështu të bënin.”
75. Tha: “E shihni çfarë po adhuronit?
76. Ju dhe etërit tuaj të vjetër?
77. Te unë, janë të urryer. Përveç Zotit të botëve,
78. Atij që më krijoi; Ai më drejton.
79. Atij që më ushqen e më jep të pi.
80. Dhe, kur sëmurem, Ai më shëron.
81. Atij që më vdes e më ngjall
82. dhe që, shpresoj, Ditën e Gjykimit, gabimet të më
falë.
83. Im Zot, më jep urtësi dhe bashkomë me të mirët;
84. bëj për mua, te pasardhësit, gjuhë të së vërtetës;
85. më bëj ndër trashëgimtarët e kopshtit të parajsës;
86. fale tim atë se është i gabuar
87. dhe mos më dëshpëro Ditën e Ringjalljes,
88. ditën kur s' bëjnë dobi malli e fëmijët,
89. vetëm në i vjen Zotit me zemër të pastër!”
90. U afrohet parajsa të devotshmëve
91. dhe skëterra u shfaqet të mashtruarve.
92. U thuhet: “Ku janë ç'adhuruat
93. në vend të Zotit? Mund t'ju vijnë në ndihmë apo veten
të ndihmojnë?”
94. Bien në të ata dhe të mashtruarit,
95. tërë ushtria e djallit.
96. Bëjnë debat e thonë:
97. “Për Zotin, ishim në gabim të hapur,
98. kur ju krahasuam me Zotin e botëve!
99. Na gabuan mëkatarët
100. dhe nuk ka për ne nga ndërmjetësuesit,
101. as ndonjë mik të afërt.
102. Po të na përsëritej, do të ishim ndër besimtarët.”

103. Këtu ka dëshmi, por të shumtët nuk janë besimtarë.
104. Yt Zot, Ai është i Plotfuqishëm, Mëshirëplotë.
105. Përgënjeshtroi kombi i Nuhit të dërguarit,
106. kur vëllai i tij, Nuhi, tha: “A nuk përmbaheni?
107. Unë jam për ju një i dërguar besnik.
108. Përmbajuni Zotit e bindmuni!
109. Nuk po ju kërkoj për këtë shpërblim. Shpërblimi im është te Zoti i botëve.
110. Përmbajuni Zotit e bindmuni!”
111. Thanë: “Të të besojmë ty kur të ndjekin më të ultit?”
112. Tha: “Ku t'ua di unë punët?
113. Llogaria e tyre është te im Zot nëse kuptoni.
114. Unë nuk jam për t'i përzënë besimtarët.
115. Por jam vetëm një paralajmërues i qartë.”
116. Thanë: “O Nuh! Po s'hoqe dorë, do të të gjuajmë me gurë.”
117. Tha: “Im Zot, bashkëkombësit e mi më përgënjeshtroan.
118. Bëj ndarje mes meje e tyre dhe shpëtona mua e besimtarët.”
119. Shpëtuam atë dhe ç'qenë me të në anijen e ngarkuar.
120. Pastaj i mbytëm të tjerët.
121. Këtu ka dëshmi, por të shumtët nuk janë besimtarë.
122. Yt Zot, Ai është i Plotfuqishëm, Mëshirëplotë.
123. Përgënjeshtroi Adi të dërguarit
124. kur vëllai i tyre, Hudi, tha: “A nuk përmbaheni?
125. Unë jam për ju një i dërguar besnik.
126. Përmbajuni Zotit e bindmuni!
127. Nuk po ju kërkoj për këtë shpërblim. Shpërblimi im është te Zoti i botëve.
128. Ngreni më kot në çdo kodër nga një shenjë
129. dhe i merrni ndërtimet si të ishit përjetë?

130. Kur mësyni, mësyni si tiranë?
131. Përmbajuni Zotit e bindmuni!
132. Përmbajuni Atij që ju mbështeti siç e dini.
133. Ju mbështeti me kafshë e fëmijë,
134. kopshte e burime.
135. Unë i frikësohem për ju dënimit të një dite të madhe.”
136. Thanë: “Njësoj për ne, na këshillove apo s'na këshillove,
137. kjo është udha e të parëve.
138. Dhe nuk do të dënohemi.”
139. E përgënjeshtroan dhe i rrënuam. Këtu ka dëshmi, por të shumtët nuk janë besimtarë.
140. Yt Zot, Ai është i Plotfuqishëm, Mëshirëplotë.
141. Përgënjeshtroi Themudi të dërguarit,
142. kur vëllai i tyre, Salihu, u tha: “A nuk përmbaheni?
143. Unë jam për ju një i dërguar besnik.
144. Përmbajuni Zotit e bindmuni!
145. Nuk po ju kërkoj për këtë shpërblim. Shpërblimi im është te Zoti i botëve.
146. A do të liheni siç jeni, të qetë e të sigurt,
147. në kopshte e burime,
148. ara e palmore, me gonxhet e varura?
149. Të gdhendni si mjeshtër shtëpi nëpër male?
150. Përmbajuni Zotit e bindmuni!
151. Mos iu bindni urdhrit të shpërdoruesve,
152. që sjellin të këqia në tokë dhe nuk bëjnë të mira.”
153. Thanë: “Qenke i magjepsur!
154. Ti je njeri si ne. Sill një shenjë në je i besuar.”
155. Tha: “Kjo është një deve. Ajo ka radhën e saj të ujit dhe ju, radhën tuaj të ujit, në ditë të caktuar.
156. Mos e prekni me të keq, t’ju zërë dënimi i një dite të madhe.”

157. Por ata e gjymtuan dhe u bënë të penduar.
158. I zuri dënimi. Këtu ka dëshmi, por të shumtët nuk janë besimtarë.
159. Yt Zot, Ai është i Plotfuqishëm, Mëshirëplotë.
160. Përgënjeshtroi kombi i Lutit të dërguarit,
161. kur vëllai i tyre, Luti, tha: “A nuk përmbaheni?
162. Unë jam për ju një i dërguar besnik.
163. Përmbajuni Zotit e bindmuni!
164. Nuk po ju kërkoj për këtë shpërblim. Shpërblimi im është te Zoti i botëve.
165. U vini meshkujve të botës
166. dhe lini gratë që Zoti jua ka krijuar? Ju jeni popull i shthurur.”
167. Thanë: “O Lut! Po s'hoqe dorë, je i dëbuar.”
168. Tha: “Unë e urrej punën tuaj.
169. Im Zot, shpëtona mua dhe familjen time nga punët e tyre!”
170. Shpëtuam atë dhe familjen e tij, bashkë.
171. Përveç një plake me të prapambeturit.
172. Pastaj zhdukëm të tjerët.
173. U derdhëm një shi, ç'shi i keq për të paralajmëruarit!
174. Këtu ka dëshmi, por të shumtët nuk janë besimtarë.
175. Yt Zot, Ai është i Plotfuqishëm, Mëshirëplotë.
176. Përgënjeshtroan të dërguarit banorët e Ejkes,
177. kur Shuajbi u tha: “A nuk përmbaheni?
178. Unë jam për ju një i dërguar besnik.
179. Përmbajuni Zotit e bindmuni!
180. Nuk po ju kërkoj për këtë shpërblim. Shpërblimi im është te Zoti i botëve.
181. Plotësoni masën e mos mangësoni.
182. Dhe peshoni me peshojë të drejtë.

183. Mos ua pakësoni mallrat njerëzve dhe mos veproni keq në tokë si ngatërrestarë.
184. Përmbajuni Atij që ju krijoi, juve dhe brezat e parë.”
185. Thanë: “Ti qenke vërtet i magjepsur!
186. Ti je njeri si ne dhe besojmë se je gënjeshtar.
187. Na lësho një copë qielli në je i besuar.”
188. Tha: “Im Zot e di mirë se ç’po bëni.”
189. E përgënjeshtroan dhe i zuri dënimi i një dite të zyrtë. Ishte dënimi i një dite të rëndë.
190. Këtu ka dëshmi, por të shumtët nuk janë besimtarë.
191. Yt Zot, Ai është i Plotfuqishëm, Mëshirëplotë.
192. Është shpallja e Zotit të botëve.
193. E zbret atë Shpirti Besnik,
194. në zemrën tënde që të jesh paralajmërues,
195. në gjuhë arabe të qartë.
196. Dhe gjendet në shkrimet e para.
197. Nuk është për ta shenjë që e njohin dijetarët e bijve të Izraelit?
198. Edhe sikur t’ia zbrisnim një të huaji
199. dhe t’ua recitonte, nuk do ta besonin.
200. Kështu e përcollëm në zemrat e mëkatarëve.
201. Nuk e besojnë derisa të shohin dënimin e hidhur.
202. U vjen befaz dhe nuk e parandjejnë.
203. Do të thonë: “A na jepet kohë?”
204. Dënimin Tonë duan të nxitojnë?
205. E sheh që i bëmë të gëzonin vite me radhë,
206. pastaj u vjen ç’u është paralajmëruar
207. dhe nuk u vlen që gëzuan?
208. Nuk zhdukim një vendbanim pa paralajmërues.
209. Si kujtesë, Ne nuk jemi dhunues.
210. Nuk e zbritën djajtë,
211. s’u përshtatet, as që kanë mundësi;

212. ata nuk arrijnë ta dëgjojnë.
213. Prandaj, mos lut me Zotin zot tjetër e të jesh i dënuar.
214. Tërhiq vëmendjen e farefisit të afërm.
215. Dhe ule dorën me besimtarët që të ndjekin.
216. Thuaju atyre që të kundërshtojnë: “Nga veprat tuaja jam i çliruar.”
217. Dhe mbështetju të Plotfuqishmit, Mëshirëplotit.
218. Që të sheh kur ngrihesh
219. dhe kur bashkë me ta falesh.
220. Ai është Dëgjues, Dijeplohtë.
221. T’ju tregoj ku zbresin djajtë?
222. Zbresin te çdo shpifës, mëkatar.
223. Mbajnë vesh dhe të shumtët janë gënjeshhtarë.
224. Poetët, shkojnë pas tyre të mashtruarit.
225. Nuk i sheh të enden nëpër lugina?
226. Ndryshe thonë e ndryshe bëjnë.
227. Jo ata që besojnë, bëjnë të mira dhe përmendin Zotin shumë, që vetëmbrohen pasi u sulmuan. Dhunuesit do ta mësojnë se ku po bien.

27. MILINGONAT (EN-NEML)

Periudha e Mekës, 93 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Ta, sin. Këto janë dëshmitë e Kuranit dhe të një libri të qartë.
2. Drejtim e sihariq për besimtarët,

3. që kryejnë të falurit, japin detyrimin dhe binden për të ardhmen.
4. Atyre që nuk besojnë në të ardhmen ua zbukuruam veprat dhe enden të verbër.
5. Për ta është dënimi më i keq dhe, në të ardhmen, ata janë të humburit.
6. Ti po merr Kuranin nga Një i Urtë, i Plotëditur.
7. Kur Musai u tha njerëzve të tij: “Unë pashë një zjarr. Do t’ju sjell prej tij ndonjë lajm a një urë për t’u ngrohur”, -
8. sapo arriti atje, u thirr: “Bekuar qoftë kush është në zjarr (në Dritën e Zotit) e përreth tij! Madhëruar qoftë Allahu, Zoti i botëve!
9. O Musa, Unë jam Zoti, i Plotfuqishmi, i Urti.
10. Hidhe shkopin tënd!” Kur e pa të lëvrinte si gjarpër, u praps e bëri mënjane. “O Musa, mos u tremb! Nuk tremben profetët në Praninë Time.
11. Përveç dikujt që ka dhunuar dhe, pastaj, e ka kthyer të keqen në të mirë. Vërtet, Unë jam falës, mëshirëplotë.
12. Fute dorën në gjoksin tënd, të dalë e bardhë, pa njollë. Njëra nga nëntë dëshmitë të faraoni dhe kombi i tij. Ata janë njerëz të pabesë.”
13. Kur u erdhën dëshmitë Tona të dukshme, thanë: “Kjo është magji e qartë.”
14. Edhe pse vetë të bindur, i refuzuan me dhunë e kryelartësi. Shih, pra, si qe fundi i keqbërësve!
15. U dhamë Davudit e Sulejmanit dije dhe thanë: “Lavdi Zotit që na dalloi mbi shumë nga robtë e tij besimtarë!”

16. Sulejmani trashëgoi Davudin e tha: "O njerëz, neve na u mësua gjuha e shpendëve dhe na është dhënë nga çdo gjë. Kjo është mirësi e qartë."
17. U rreshtua në formacion luftimi ushtria e Sulejmanit, e përbërë prej xhinëve, njerëzve dhe shpendëve.
18. Kur arritën te lugina e milingonave, një milingonë tha: "O milingona, futuni nëpër foletë tuaja të mos ju shkelin padashur Sulejmani me trupat e tij."
19. Ai buzëqeshi nga fjala e saj dhe tha: "Im Zot, frymëzomë të të falënderoj për mirësinë që na dhurove mua e tim ati dhe të bëj të mira për kënaqësinë Tënde! Pranomë, me mëshirën Tënde, te robtë e Tu të mirë!"
20. Inspektori shpendët e tha: "Përse nuk po e shoh pupëzën? Mos mungon?"
21. Do ta ndëshkoj rëndë a ta ther. Përndryshe, le të më sjellë një argument të qartë!"
22. Ajo nuk vonoi e tha: "Unë mësova ç'nuk ke mësuar ti. Po vij nga Seba me një lajm të sigurt."
23. Gjeta të sundonte atje një grua me salltanet dhe fron madhështor.
24. E gjeta atë dhe kombin e saj t'i përulëshin diellit në vend të Zotit dhe djalli ua kishte zbukuruar punët duke i larguar nga rruga. Pra, nuk qenë të udhëzuar drejt."
25. Dhe t'i përulëshin Zotit i cili nxjerr të fshehtën në qiej e në tokë dhe di se ç'fshihni e çfarë bëni të njohur.
26. Allahu, s'ka zot veç Tij, është Zoti i Fronit Madhështor.
27. Tha: "Të shohim në thua të vërtetën apo gënjen."
28. Shko me këtë letër, hidhja atyre, pastaj bëj mënjanë dhe shih çfarë do të kthejnë."
29. Tha: "O fisnikë, më erdhi një letër e çmuar:

30. “Prej Sulejmanit. Me Emrin e Zotit, Bamirësit, Mëshirëplotit!
31. Mos dilni kundër meje, por ejani të bindur si muslimanë!”
32. Dhe tha: “O krerë! Më jepni mendim në këtë çështje! Unë nuk vendos pa dëshmuar ju.”
33. Thanë: “Ne kemi forcë e fuqi të rreptë, por urdhri është tek ty. Shih çfarë do të urdhërosh.”
34. Tha: “Kur sundimtarët hyjnë në një vend, e rrënojnë atë dhe fisnikët i poshtërojnë. Ja, kështu bëjnë.
35. Unë po u nis një dhuratë, të shohim me se do të kthehen lajmëtarët.”
36. Kur i erdhën Sulejmanit, ai tha: “Po më ofroni mall? Ç’më ka dhënë Zoti është më e mirë nga ajo që ju ka dhënë juve. Por ju kënaqeni me dhuratën tuaj.
37. Kthehuni te ata! Do t’u vijmë me trupa që s’mund t’u bëjnë ballë dhe do t’i nxjerrim së andejmi të mundur e të poshtëruar.”
38. Tha: “O krerë, cili nga ju më sjell fronin e saj para se të më vijnë të dorëzuar?”
39. Një xhin vigan tha: “Unë ta sjell para se të ngrihesh nga vendi. Për këtë jam i fuqishëm, i sigurt.”
40. Ai që kishte dije libri, tha: “Unë ta sjell sa çel e mbyll sytë.” Kur e pa të qëndronte aty pranë, tha: “Kjo është mirësia e tim Zoti për të më provuar nëse falënderoj a mohoj. Kush falënderon, falënderon për vete; në mohon, im Zot është i pasur, bujar.”
41. Tha: “Maskojani fronin, të shohim a udhëhiqet drejt apo është nga ata që nuk udhëhiqen.”
42. Kur ajo erdhi, iu tha: “Mos është kështu froni yt?”
Tha: “Si të qe ai! Na u bë e ditur më parë dhe jemi muslimanë.”

43. E penguan idhujt që adhuronte në vend të Zotit dhe ishte prej një populli mohues.
44. Iu tha: "Hyr në pallat!" Kur e pa, iu duk si pellg uji dhe zbuloi këmbët. Ai tha: "Ky pallat është i shtruar me kristale." Ajo tha: "Im Zot, i paskam bërë padrejtësi vetvetes! Iu dorëzova me Sulejmanin Allahut, Zotit të botëve."
45. Dërguam te Themudi të vëllanë, Salihun: "Adhuroni Zotin!" – por ata u përçanë në dy grupe kundërshtarë.
46. Tha: "Kombi im! Përse nxitoni në të keqen para së mirës dhe nuk i kërkonit falje Zotit që të mund të mëshiroheni?"
47. Thanë: "Me ty dhe ç'janë me ty kemi ogur të keq." Tha: "Oguri juaj është te Zoti, porse jeni të mashtruar."
48. Ishin në qytet nëntë vetë për të këqia e jo të mira.
49. Thanë: "Le të betohemi me zot se do t'i sulmojmë natën atë dhe familjen e tij. Pastaj t'i themi kujdestarit se nuk ishim dëshmitarë në vrasjen e familjes së tij. Dhe themi të vërtetën."
50. Ata bënë një plan dhe Ne bëmë një plan. Ata nuk e kuptonin.
51. Dhe shih si qe fundi i kurthit të tyre: i zhdukëm ata dhe kombin e tyre bashkë.
52. Ja shtëpitë e tyre të rrënuara pasi dhunuan! Këtu ka dëshmi për njerëzit që dinë.
53. I shpëtua ata që besuan dhe u përmbajtën.
54. Edhe Lutin, kur i tha kombit të tij: "Bëni me vetëdije imoralitet?"
55. U afroheni burrave me pasion në vend të grave? Ju jeni një popull barbar.

56. Populli i tij s'pati përgjigje tjetër, por tha: "Nxirrni nga qyteti familjen e Lutit se janë njerëz të panjollë."
57. Shpëtuam atë dhe familjen e tij, përjashtuar së shoqes të cilën e caktuam të jetë me të prapambeturit.
58. Derdhëm mbi ta një shi; ç'shi i keq për të paralajmëruarit!
59. Thuaj: "Lavdi Zotit dhe paqe mbi robtë e Tij të zgjedhur!" Më mirë Zoti apo idhujt që shoqërojnë?
60. A nuk është Ai që krijoi qiejt e tokën dhe zbriti për ju nga qielli ujë? Rrisim me të kopshte të hareshme. Nuk i rrisni ju pemët e tyre. A ka zot me Zotin? Por ata i bëjnë të barabartë.
61. Që bëri tokën të banueshme, terrenin e saj me lumenj dhe i bëri asaj vargmale e mes dy detesh një ndarje? A ka zot me Zotin? Të shumtët e tyre nuk dinë.
62. Që i përgjigjet fatkeqit kur e thërret dhe ia largon të keqen e ju bën juve trashëgues në tokë? A ka zot me Zotin? Ju pak mendoni.
63. Që ju orienton në errësirat e tokës e të detit dhe dërgon retë - sihariq të mëshirës së Tij? A ka zot me Zotin? I lartë është Zoti nga ç'i shoqërojnë.
64. Që zë fill krijimin, pastaj e përsërit dhe ju ushqen nga qielli e toka? A ka zot me Zotin? Thuaj: "Sillni argumentin tuaj në thoni të vërtetën."
65. Thuaj: "Veç Zotit, askush në qiej e në tokë nuk di të fshehtë. Dhe nuk e dinë se kur do të ngrihen."
66. A arrin dija e tyre te e ardhmja? Jo, ata janë në dyshim rreth saj. Janë ndaj saj të verbër.
67. Mohuesit thonë: "Kur të jemi bërë dhé, ne dhe etërit tanë, do të dalim përsëri?"

68. Edhe më parë na u premtua kjo, neve dhe etërve tanë, por s'është tjetër veçse rrëfenjë e të parëve.”
69. Thuj: “Udhëtoni në tokë, të shihni si qe fundi i mëkatarëve.”
70. Mos u dëshpëro për ta dhe mos u ngushto nga kurthet e tyre.
71. Thonë edhe: “Kur është ky paralajmërim në thoni të vërtetën?”
72. Thuj: “Ndoshta është pas jush ajo që kërkoni me ngut.”
73. Yt Zot është i mirësisë ndaj njerëzve, por të shumtët nuk falënderojnë.
74. Yt Zot e di se ç'fshehin kraharorët dhe çfarë zbulojnë.
75. Nuk ka të fshehtë në qiej e në tokë të mos jetë në libër të qartë.
76. Ky Kuran u rrëfen bijve të Izraelit të shumtën ku ata janë në kundërshti.
77. Është drejtim e mëshirë për besimtarët.
78. Yt Zot vendos mes tyre me autoritetin e Tij. Ai është i Plotfuqishmi, Dijepoti.
79. Prandaj, mbështetu te Zoti! Ti je në të vërtetën e qartë.
80. Ti s'mund ta bësh të vdekurin të dëgjojë, as shurdhin të dëgjojë thirrjen kur ata kthejnë shpinën.
81. Ti nuk je për t'i orientuar të verbrit në udhën e tyre pa krye, as të bësh dikë të dëgjojë, por vetëm ata që besojnë në dëshmitë Tona si muslimanë.
82. Kur të realizohet fjala ndaj tyre, nxjerrim për ta një gjallesë nga toka që u flet se, me të vërtetë, njerëzit nuk janë të bindur në dëshmitë Tona.
83. Ditën kur tubojmë nga çdo popull, turmat e atyre që përgënjeshtuan dëshmitë Tona vihen në radhë.

84. Sapo vijnë, u thotë: "Përgënjeshtroat dëshmitë Tona pa i zënë ato me dije? Apo ç'keni bërë?"
85. Realizohet ndaj tyre fjala pasi dhunuan. Dhe nuk do të flasin.
86. Nuk shohin se bëmë natën prehje dhe ditën dritë? Këtu ka dëshmi për njerëzit që besojnë.
87. Ditën kur i fryhet bririt, përveç atij që do Zoti, shtangen ç'janë në qiej e në tokë. Të gjithë i vijnë të përlur.
88. Sheh malet dhe i pandeh se nuk lëvizin, por kalojnë si retë. Është arti i Zotit, i përsosur në çdo gjë. Vërtet, Ai është në dijeni të veprave tuaja.
89. Cilët vijnë me të mirën, gjejnë më mirë se ajo dhe janë, nga tmerri i asaj dite, të siguruar.
90. Kush vjen me të keqen, bie me fytyrë në zjarr. Mos shpërbleheni ndryshe nga ç'keni bërë?
91. "Unë u urdhërova të adhuroj Zotin e këtij qyteti që e bëri të shenjtë dhe se Atij i takon çdo gjë. U urdhërova të jem musliman.
92. Dhe të recitoj Kuranin." Kush drejtohet, është drejtuar për vete. Kujt shkon në rrugë të gabuar, thuaj: "Unë jam vetëm një paralajmërues."
93. Dhe thuaj: "Lavdi Zotit! Ai do t'jua tregojë dëshmitë e Tij dhe ju do t'i njihni." Yt Zot nuk është i shkujdesur për ato që bëni.

28. EPISODI (EL KASAS)

Periodha e Mekës, 88 ajete
Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Ta, sin, mim.
2. Këto janë dëshmitë e Librit të Qartë.
3. Po të recitojmë me të vërtetën, për njerëzit që besojnë, lajme të Musait dhe faraonit.
4. Faraoni ngriti krye në tokë dhe i ndau banorët e saj në palë duke shtypur njërën palë prej tyresh: therte bijtë e tyre dhe linte gjallë gratë e tyre. Ai ishte keqbërës.
5. Ne deshëm t'i mbështetnim të shtypurit në tokë, t'i bënim prijësa e trashëgimtarë.
6. T'i fuqizonim në tokë e t'u tregonim faraonit, Hamanit dhe trupave të tyre atë që ia kishin frikën. (Hamani ishte ministër i thesarit. Sipas një ëndrrë, një fëmijë mashkull i lindur atë kohë të izraelitët do ta përmbyste faraonin.)
7. I kumtuam të ëmës së Musait: "Jepi të pijë dhe, kur ta ndiesh rrezikun, hidhe në lumë. Mos u frikëso e mos u dëshpëro! Ne do të ta kthejmë dhe ta bëjmë lajmëtar."
8. E nxori familja e faraonit, t'i bëhej armik e brengë. Sepse faraoni, Hamani dhe trupat e tyre ishin mëkatarë.
9. Gruaja e faraonit tha: "Një gëzim për mua e për ty. Mos e vrit! Ndoshta kemi dobi a e birësojmë." Por ata nuk e kuptonin.
10. Mbeti e zbrazur zemra e nënës së Musait dhe gati do të shfaqej po të mos ia forconim zemrën me besim.
11. I tha motrës së tij që ta gjurmonte dhe ajo e vëzhgonte nga larg, pa u vënë re.

12. E bëmë të mos merrte gjë dhe ajo u tha: “T’ju tregoj një familje që ta ketë në ngarkim e të kujdeset për të?”
13. E kthyem te e ëma, t’i gëzohej syri e të mos dëshpërohej, ta dinte se premtimi i Zotit është i vërtetë. Mirëpo të shumtët e tyre nuk dinë.
14. Kur arriti pjekurinë dhe u formua, i dhamë gjykim e dije. Kështu i shpërblejmë mirëbërësit.
15. Hyri në qytet pa rënë në sy nga njerëzit dhe gjeti atje dy burra që po ziheshin, njëri prej sërës së vet dhe tjetri ndër armiqtë. Ai i sërës së vet i kërkoi ndihmë kundër armikut. Musai e qëllloi me grusht dhe e la në vend. Tha: “Punë djalli! Ai është armik, një gabues i hapur.”
16. Tha: “Im Zot, unë i bëra keq vetes. Më fal!” - dhe e fali. Ai është Falësi, Mëshirëploti.
17. Tha: “Im Zot! Ti më bërë të mira dhe unë nuk do të jem në ndihmë të fajtorëve.”
18. U gdhi në qytet duke përgjuar i trembur, kur, ja, personi që i kërkoi ndihmë dje, e thirri përsëri. Musai i tha: “Ti qenke i paudhë!”
19. Ndërsa po matej ta mbante armikun e tyre, ai i tha: “O Musa! Kërkon të më vrasësh siç vrave dje dikë? Dashke të bëhesh tiran në tokë, nuk dashke të jesh paqësor.”
20. Erdhi me nxitim një njeri nga ana e qytetit dhe tha: “O Musa! Krerët janë mbledhur të urdhërojnë vrasjen tënde, prandaj ik! Unë po të këshilloj.”
21. Iku duke parë me frikë dhe tha: “Im Zot, shpëtomë prej njerëzve të padrejtë!”
22. Kur u drejtua nga Medjeni, tha: “Zoti më pastë prirë në udhë të mbarë!”

23. Me të arritur te pusi i Medjenit, gjeti disa njerëz duke dhënë ujë (bagëtime), veç tyre, dy gra diku në pritje. Tha: “Ç’hall keni?” Ato thanë: “Ne s’mund të japim ujë pa u larguar barinjtë. Babai ynë është burrë i moshuar.”
24. Ai u dha ujë, pastaj shkoi në një hije e tha: “Im Zot, unë jam nevojtar për çdo të mirë që më dërgon.”
25. Njëra nga ato iu afrua e ndrojtur. Tha: “Im atë të fton të të shpërblejë për shërbimin.” Kur shkoi dhe ia tregoi ngjarjen, ai i tha: “Mos u frikëso! Shpëtove nga kombi dhunues.”
26. Njëra nga ato të dyja tha: “Baba, merre me mëditje. Punëtori më i mirë është i fuqishmi dhe besniku.”
27. Tha: “Unë dua të të martoj me njërën nga bijat e mia dhe të më shërbesh për tetë vjet. Po bëre dhjetë, është prej teje. Unë nuk dua të të mendoj. Dashtë Zoti, të më gjesh njeri të drejtë.”
28. Tha: “Kjo, mes meje e teje. Çfarëdo afati të plotësoj, pa armiqësi ndaj meje. Zoti qoftë dorëzanës në bisedën tonë!”
29. Kur Musai kreu afatin dhe po udhëtonte me njerëzit e tij, dalloi nga ana e Malit një zjarr. U tha njerëzve: “Ju qëndroni këtu! Unë pashë një zjarr. Mbase ju sjell lajm prej tij ose ndonjë urë për t’u ngrohur.”
30. Me të arritur atje, u thirr nga ana e djathtë e bregut, prej pemës në truallin e bekuar: “O Musa! Unë jam Allahu, Zoti i botëve.”
31. Hidhe shkopin tënd!” Kur e pa të lëvrinte si gjarpër, u praps e bëri mënjanë. “O Musa, afrohu, mos ki frikë! Je i sigurt.

32. Fute dorën në gjoks, të të dalë e bardhë, pa njollë. Dhe mblidhe veten nga frika. Ja dy prova prej tēt Zoti te faraoni dhe krerët e tij! Ata janë popull rebel.”
33. Tha: “Im Zot, unë vrava një njeri prej tyre dhe kam frikë se do të më vrasin.
34. Im vëlla, Haruni, është më i shprehur se unë në gjuhë. Dërgoje me mua si mbështetje e të më vërtetojë. Kam frikë se do të më përgënjeshtrojnë.”
35. Tha: “Do ta forcojmë krahun tënd me tēt vëlla, ju japim autoritet dhe nuk do t’ju arrijnë. Me dëshmitë Tona, ju të dy dhe ata që ju pasojnë jeni fitimtarë.”
36. Kur u erdhi Musai me dëshmitë Tona të qarta, thanë: “Kjo është magji e trilluar. S’e kemi dëgjuar këtë te etërit tanë të parë.”
37. Musai tha: “Im Zot e di se kush vjen me drejtim prej Tij dhe që i takon e ardhmja. Dhunuesit nuk kanë sukses.”
38. Tha faraoni: “O krerë! Unë nuk di të keni zot tjetër veç meje, pra, ndizi furrat, o Haman dhe ndërto për mua një kullë të ngjitem te zoti i Musait. Unë e quaj atë gënjeshtar.”
39. Ngritën, me pa të drejtë, krye në tokë, ai dhe trupat e tij dhe menduan se nuk do të ktheheshin te Ne.
40. I zumë atë dhe trupat e tij dhe i hodhëm në det. Shih si qe fundi i dhunuesve!
41. I bëmë drejtues që ftojnë në zjarr ndërsa Ditën e Ringjalljes nuk do të përkrahen.
42. I përcolem me mallkim në këtë botë dhe Ditën e Ringjalljes janë të urryer.
43. I dhamë Musait Librin, pasi patëm zhdukur breznitë e kaluara, ndriçim për njerëzit, drejtim e mëshirë që ata të mund të mendoheshin.

44. Ti nuk ishe në anën perëndimore kur i dhamë Musait detyrën. Nuk ishe dëshmues.
45. Por, Ne sollëm brezni dhe zgjati me ta jeta. Ti nuk ishe banor te medjenasit t'u recitoje dëshmitë Tona, porse Ne dërgojmë të dërguar.
46. Nuk ishe nga ana e malit kur thirrëm, por, si mëshirë nga yt Zot, je për t'u tërhequr vëmendjen njerëzve të cilëve nuk u erdhi paralajmërues para teje që ata të mund të mendohen.
47. Të mos u vijë ndonjë fatkeqësi e përgatitur me duart e tyre dhe të thonë: "Zoti ynë, përse nuk na dërgove të dërguar, të ndiqnim dëshmitë Tuaja e të besonim?"
48. Kur u erdhi e vërteta nga ana Jonë, thanë: "Përse nuk iu dha si Musait?" A nuk mohuan më parë ato që iu dhanë Musait? Thonë: "Dy magji që mbështesin njëra-tjetrën." Thonë: "Nuk besojmë asnjërën."
49. Thuaj: "Sillni një libër nga Zoti, të udhëzojë më drejt nga këto dhe unë ta ndjek, në thoni të vërtetën."
50. Po nuk t'u përgjigjën, dije se ndjekin pasionet. Kush është më i gabuar se ai që ndjek pasionin pa ndonjë drejtim nga Zoti? Zoti nuk drejton njerëzit e padrejtë.
51. Ne bëmë t'u arrijë fjala që të mund të mendohen.
52. Ata që u kemi dhënë librin para tij e besojnë.
53. Kur u recitohet, thonë: "E besuam. Është e vërteta nga Zoti ynë. Ne ishim edhe më parë muslimanë.
54. Atyre u jepet dy herë shpërblim sepse duruan dhe e larguan të keqen me të mirë dhe se kontribuojnë nga ç'u kemi dhënë.
55. Kur dëgjojnë fjalë të kota, shmangen e thonë: "Ne kemi veprat tona dhe ju, veprat tuaja. Paqja qoftë me ju! Ne nuk lakmojmë të paditurit."

56. Nuk drejton ti, me dashjen tënde, porse drejton Zoti atë që do. Ai i di mirë ata që udhëhiqen drejt.
57. Thonë: “Po të ndjekim drejtimin tënd, dëbohemi nga toka jonë.” A nuk vendosëm për ta një shenjtorë të sigurt ku mbliidhen frytet e çdo gjëje, ushqim nga ana Jonë? Por të shumtët e tyre nuk dinë.
58. Zhdukëm sa e sa vendbanime që përçmuan të mirat e jetës. Ato vendbanime u banuan pas tyre vetëm për pak kohë dhe Ne jemi trashëguesit.
59. Yt Zot nuk ishte për shkatërrimin e vendbanimeve pa dërguar në mesin e tyre të dërguar që t’u komunikonte dëshmitë Tona. Ne nuk jemi për shkatërrimin e vendbanimeve pa qenë banorët e tyre dhunues.
60. Çdo gjë që ju është dhënë, është mjet jetese e jetës së kësaj bote dhe stoli e saj, por, ç’është pranë Zotit, është më e mirë dhe e qëndrueshme. Nuk kuptoni?
61. Ai që i kemi premtuar një premtim të mirë dhe ia arrin, mos është si dikush që e bëmë të jetojë jetën e kësaj bote dhe Ditën e Ringjalljes vjen i fajësuar?
62. Ditën kur u thërret dhe thotë: “Ku janë shoqëruesit e Mi që besonit?”
63. -- ata që u është përligjur fjala do të thonë: “Zoti ynë! Këta që i gabuam ne, i gabuam siç gabuam vetë. Shfajësohemi para Teje. Nuk ishim ne që adhuruan.”
64. U thuhet: “Thirruni idhujve tuaj!” U thërrasin, por s’u përgjigjen dhe përballen me dënimin. Sikur të qenë drejtuar!
65. Ditën kur u thërret dhe thotë: “Ç’përgjigje u dhatë të dërguarve?”
66. U errësohet kujtesa dhe nuk do të mund të pyesin njëri-tjetrin.

67. Cilët u penduan, besuan dhe bënë të mira, kanë shpresë të shpëtojnë.
68. Yt Zot krijon me dashjen e Tij dhe zgjedh. Nuk u takon të zgjedhurit atyre. Madhëruar qoftë Zoti, i lartë nga ç'i shoqërojnë!
69. Yt Zot di se ç'fshehin zemrat e tyre dhe çfarë zbulojnë.
70. Ai është Zoti; s'ka zot veç Tij. Atij i takojnë lavdet, këtu e në të ardhmen. Vendimi i takon Atij dhe te Ai ktheheni.
71. Thuaj: "E kuptoni se, sikur Zoti t'jua bënte natën pandërprerje, deri Ditën e Ringjalljes, cili zot veç Zotit do t'ju sillte dritë? A nuk dëgjoni?"
72. Thuaj: "E kuptoni se, sikur Zoti t'jua bënte ditën pandërprerje, deri Ditën e Ringjalljes, cili zot veç Zotit do t'ju sillte natë të pushonit? A nuk vështroni?"
73. Bëri për ju, me Mëshirën e Vet, natën e ditën, të pushoni dhe të kërkonit mirësitë e Tij dhe që të mund të falënderoni.
74. Ditën kur u thërret dhe thotë: "Ku janë shoqëruesit e Mi që besonit?"
75. - nxjerrim dëshmuës nga çdo bashkësi dhe themi: "Sillni argumentin tuaj!" Ta dinë se e vërteta i takon Zotit. Dhe u përvdiren trillimet.
76. Karuni ishte nga kombi i Musait, por doli kundër tyre. I dhamë aq thesare sa që çelësat e tyre i bartte një trupë e fuqishme. I tha kombi i tij: "Mos u vetëkënaq! Zoti nuk i do të vetëkënaqurit.
77. Lakmo, në ç'të ka dhënë Zoti, banesën e së ardhmes, mos harro pjesën tënde nga bota, bëj mirë, siç të ka bërë mirë Zoti dhe mos kërko të keqen në tokë. Zoti nuk i do keqbërësit."

78. Tha: "M'u dha me dijen time." Nuk e di se Zoti zhduku para tij brezni më të fuqishme dhe me më shumë pasuri? Fajtorët nuk do të pyeten për mëkatet e tyre.
79. Doli me salltanet para kombit të tij. Ata që dëshironin jetën e kësaj bote, thanë: "Sikur të ishim si Karuni! Paska qenë me fat të madh."
80. Dhe thanë ata me dije: "Mjerë ju! Shpërblimi i Zotit është më i mirë për këdo që beson e bën të mira. Dhe ia arrijnë vetëm durimtarët."
81. E fundosëm tokën bashkë me të dhe banesën e tij. Dhe nuk pati ndonjë grup që ta ndihmonte ndaj Zotit, as mund të ndihmonte vetveten.
82. Cilët e lakmuan dje, thanë: "Vërtet, Zoti ia zgjeron të mirat atij që do ndër robtë e Vet dhe ia kufizon. Të mos qe mirësia e Zotit ndaj nesh, do të na kishte fundosur. Mohuesit nuk kanë sukses."
83. Ja, pra, e bëmë banesën e së ardhmes për ata që nuk duan tirani dhe të këqia në tokë. Fundi është i të devotshmëve.
84. Kush vjen me vepër të mirë, gjen më të mirë se ajo; kush vjen me vepër të keqe, nuk do të shpërblehet ndryshe përveç të keqes që ka bërë.
85. Ai që të ngarkoi Kuranin, do të të kthejë në shtëpi (Mekë). Thuaj: "Im Zot e di më së miri kush vjen me drejtim dhe cili është në rrugë të gabuar."
86. Ti nuk prisje të të vinte Libri, por si mëshirë nga yt Zot. Pra, të mos jesh në mbështetje të mohuesve!
87. Dhe mos të të largojnë nga dëshmitë e Zotit pasi të zbritën. Fto te yt Zot dhe mos ji ndër idhujtarët!
88. Mos lut me Zotin zot tjetër. S'ka zot veç Tij. Gjithçka zhduket veç Fytyrës së Tij. Vendimi i takon Atij dhe te Ai ktheheni.

29. MERIMANGA (EL ANKEBUT)

Periudha e Mekës, 69 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Elif, lam mim.
2. Pandehin njerëzit të lihen duke thënë: "Besojmë," pa u vënë në provë?
3. I vumë në provë para tyre, ta dijë Zoti cilët thonë të vërtetën e t'i njohë gënjeshtarët.
4. Pandehin keqbërësit të Na parakalojnë? Sa keq gjykojnë!
5. Në pret takimin me Zotin, koha e caktuar nga Zoti vjen. Ai është Dëgjuesi, Dijeploiti.
6. Kush përpiket, përpiket për vete. Zoti s'ka nevojë nga krijesat.
7. Atyre që besojnë e bëjnë të mira ua shlyejmë të këqiat dhe i shpërblejmë me më të mirën e veprave.
8. I porositëm njeriut mirësjelljen me prindërit. Nëse përpiqen, me padijen tënde, të më bësh shok, mos iu bind. Te Unë është kthimi juaj dhe ju njoftoj për veprat.
9. Cilët besojnë e bëjnë të mira, i pranojmë tek të mirët.
10. Ka njerëz që thonë: "Besojmë Zotin", - por, kur mundohen te Zoti, e bëjnë provën e njerëzve si dënim nga Zoti. Nëse vjen ndihmë nga yt Zot, thonë: "Ne ishim me ju." A nuk e di Zoti ç'ka në zemrat e njerëzve?
11. Zoti i njeh besimtarët, njeh edhe hipokritët.

12. Mohuesit u thonë besimtarëve: “Ndiqni rrugën tonë, t’i bartim ne mëkatet tuaja!” Nuk bartin gjë nga mëkatet e tyre, porse janë gënjeshtarë.
13. Ata bartin barrët e tyre dhe barrë me barrët e tyre. Ditën e Ringjalljes do të pyeten për trillimet.
14. Dërguam Nuhin te kombi i tij dhe qëndroi me ta një mijë pa pesëdhjetë vjet. I zuri përmbytja si dhunues.
15. Shpëtuaam atë dhe pjesëtarët e anijes të cilën e bëmë dëshmi për botët.
16. Edhe Ibrahimin kur i tha kombit të tij: “Adhuroni Zotin dhe frikësojuni Atij! Kështu është më mirë për ju sikur ta dinit.
17. Ju po adhuroni, në vend të Zotit, idhuj dhe sajoni të paqena. Ata që adhuroni në vend të Zotit nuk zotërojnë ushqimin tuaj, pra, kërkoni ushqimin pranë Zotit, adhuroni Atë dhe falënderojeni. Tek Ai do të ktheheni.”
18. Në përgënjeshtroi, përgënjeshtruan popuj para jush. Detyra e të Dërguarit është komunikimi i qartë.
19. Nuk shohin si Zoti zë fill krijimin, pastaj e përsërit? Për Zotin kjo është e lehtë.
20. Thuaj: “Udhëtoni në tokë të shihni si e zuri fill krijimin!” Zoti krijon pastaj të ardhmen. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.
21. Dënon me dashjen e Tij dhe mëshiron me dashjen e Tij. Tek Ai do të ktheheni.
22. Ju nuk jeni çudibërës në tokë e në qiell dhe nuk keni, veç Zotit, kujdestar e ndihmëtar.
23. Ata që mohojnë dëshmitë e Zotit dhe takimin me Të i kanë prerë shpresat nga mëshira lme. Për ta ka dënim të hidhët.

24. S'pati përgjigje tjetër nga kombi i tij, por thanë: "Vriteni a digjeni!" Zoti e shpëtoi nga zjarri. Këtu ka dëshmi për besimtarët.
25. Tha: "Ju keni marrë, në vend të Zotit, idhuj, si dashuri me ta në jetën e kësaj bote, pastaj, Ditën e Ringjalljes, mohoni dhe mallkoni njëri-tjetrin. Streha juaj është zjarri dhe nuk keni ndihmëtarë."
26. E besoi Luti dhe ai tha: "Unë po emigroj te im Zot. Ai është i Plotfuqishmi, i Urti."
27. I dhurua Is'hakun e Jakubin, bëmë te pasardhësit e tij profetësinë e librin dhe i dhamë shpërblimin në këtë botë. Edhe në të ardhmen është ndër të mirët.
28. Edhe Lutin, kur i tha kombit të tij: "Po bëni paudhësi që s'e ka bërë kush në botë."
29. A u afroheni meshkujve, prisni rrugën dhe bëni në shoqërinë tuaj punë të neveritshme?" S'pati përgjigje tjetër nga kombi, por thanë: "Sille dënimin e Zotit në thua të vërtetën."
30. Tha: "Im Zot, më ndihmo ndaj kombit keqbërës!"
31. Kur i erdhën Ibrahimit lajmësit Tanë me sihariq, thanë: "Ne do t'i rrënojmë njerëzit e atij vendbanimi sepse banorët e tij janë dhunues."
32. Ai tha: "Aty është Luti." Thanë: "E dimë kush është aty. Do shpëtojmë atë dhe familjen e tij përveç së shoqes. Ajo është me të prapambeturit."
33. Posa i erdhën Lutit lajmësit Tanë, u shqetësua për ta dhe ra ngushtë. Thanë: "Mos u frikëso e mos u dëshpëro! Ne do t'ju shpëtojmë ty dhe familjen tënde përveç gruas tënde. Ajo është me të prapambeturit."
34. Do të zbresim mbi banorët e këtij vendbanimi ndëshkim nga qielli pasi rebeluan."
35. Lamë prej tij dëshmi të qartë për njerëzit që kuptojnë.

36. Në Medjen, vëllanë e tyre, Shuajbin. Ai tha: “Kombi im! Adhuroni Zotin, prisni Ditën e Fundit dhe mos veproni në tokë si ngatërrestarë.”
37. E përgënjeshtroan, i zuri tronditja dhe mbetën përmbys në shtëpitë e tyre.
38. Edhe Adin e Themudin. Ju është bërë e qartë për vendbanimet e tyre. Ua zbukuroi veprat djalli dhe i largoi nga rruga tek shihnin.
39. Karunit, Faraonit dhe Hamanit u erdhi Musai me prova të qarta, por ngritën krye në tokë e nuk shpëtuan.
40. Secilin e morëm me mëkatet e veta: dikujt i dërguam uragan, dikë e zuri krisma, dikë e kredhëm në tokë dhe dikë e përmbytëm. Nuk qe Zoti për dhunimin e tyre, porse dhunuan vetveten.
41. Shembulli i atyre që marrin zota në vend të Zotit është merimanga që bën shtëpinë e saj. Sikur ta dinin, shtëpia më e dobët është ajo e merimangës.
42. Zoti e di se ç'lusin në vend të Tij. Ai është i Plotfuqishmi, i Urti.
43. I sjellim këta shembuj për njerëzit, por i kuptojnë vetëm të diturit.
44. Zoti krijoi qiejt e tokën me të vërtetën. Këtu ka dëshmi për besimtarët.
45. Ti recito ç'të kumtohet nga Libri dhe kryej të falurit. Vërtet të falurit ndalon paudhësitë dhe të urryerën. Përmendja e Zotit është më e madhja. Zoti e di çfarë përgatisni.
46. Diskutoni me ithtarët e Librit në mënyrën më të mirë. Përfunduar dhunuesve ndër ta. Dhe thoni: “Besojmë ç'është zbritur te ne dhe ç'u zbrit te ju. Zoti ynë e Zoti juaj janë një dhe ne Atij i jemi dorëzuar.”

47. Kështu, zbritëm tek ty Librin. Ata që u kemi dhënë Librin e besojnë. Edhe nga këta, ka që e besojnë. Vetëm mohuesit refuzojnë dëshmitë Tona.
48. Ti s'ke lexuar më parë ndonjë libër dhe nuk ke shkruar me të djathtën tënde. Atëherë, njerëzit jo të vërtetë do të dyshonin.
49. Përkundrazi, është dëshmi e qartë në zemrat e atyre me dije. Dëshmitë Tona i refuzojnë vetëm dhunuesit.
50. Thonë: "Përse nuk i zbritën shenja nga Zoti i tij?" Thuaj: "Shenjat janë pranë Zotit dhe unë jam paralajmërues i qartë."
51. Nuk u mjafton që Ne të zbritëm librin i cili u recitohet? Në të ka mëshirë dhe kujtesë për besimtarët.
52. Thuaj: "Mjafton Zoti dëshmues mes nesh. Ai di ç'janë në qiej e në tokë. Cilët besojnë të pavërtetën dhe mohojnë Zotin, janë të humburit.
53. Të kërkojnë me ngut dënimin. Po të mos qe një afat i caktuar, do t'u vinte dënimi. U vjen papritmas dhe nuk e ndiejnë.
54. Të kërkojnë me ngut dënimin ndërsa skëterra ka rrethuar mohuesit.
55. Ditën që i mbulon dënimi, nga lart e ndër këmbë, Ai u thotë: "Shijoni veprën tuaj!"
56. Robtë e Mi besimtarë! Toka Ime është e gjerë, pra, vetëm Mua të më adhuron!
57. Çdo frymë e shijon vdekjen, pastaj ktheheni te Ne.
58. Ata që besojnë e bëjnë të mira i vëmë në dhoma të larta të parajsës ku rrjedhin lumenj, të përhershëm në to. Sa i mirë shpërblimi i veprimtarëve,
59. që durojnë dhe te Zoti i tyre mbështeten!
60. Sa e sa gjallesa nuk bartin ushqimin e tyre! Zoti i ushqen ato dhe juve. Ai është Dëgjuesi, Dijeploti.

61. Në i pyet: “Kush krijoi qiejt e tokën dhe nënshtroi diellin e hënën?” – do të thonë: “Zoti.” Pra, si mashtrohen?
62. Zoti ia zgjeron të mirat atij që do ndër robtë e Vet dhe ia kufizon. Zoti është për gjithçka dijeplotë.
63. Në i pyet: “Kush zbret ujin nga qielli dhe përtërin me të tokën e vdekur?” – do të thonë: “Zoti.” Thuaj: “Lavdi Zotit!” Por të shumtët e tyre nuk kuptojnë.
64. Jeta e kësaj bote është kalim kohe dhe lojë; banesa e së ardhmes, sikur ta dinin, është jeta.
65. Kur hypin në anije, lusin Zotin me besim thjesht për Të. Me t’i nxjerrë në tokë, ja tek i bëjnë shok!
66. Për të mohuar çfarë u kemi dhënë e të përfitojnë. Por do ta mësojnë.
67. Nuk shohin që Ne bëmë një vend të shenjtë e të sigurt ndërsa njerëzit në rrethina janë të pasigurt? Besojnë kotësinë dhe mohojnë të mirën e Zotit?
68. Kush është më i padrejtë se ai që sajon gënjeshtër ndaj Zotit ose përgënjeshton të vërtetën që i erdhi? A nuk ka në skëterrë strehë për mohuesit?
69. Cilët përpiqen tek Ne, i drejtojmë udhëve Tona. Zoti është me mirëbërësit.

30. ROMAKËT (ER-RUM)

Periudha e Mekës, 60 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Elif, lam, mim.

2. Romakët u mundën.
3. Diku afër. Pas humbjes, ata do të fitojnë.
4. Në pak vite - urdhri i takon fillim e mbarim Zotit - dhe, atëherë, besimtarët do të gëzohen.
5. Me ndihmën e Zotit. Ndiemon atë që do. Ai është i Plotfuqishmi, Mëshirëploti.
6. Premtim i Zotit. Zoti nuk e shkel premtimin, por të shumtët e njerëzve nuk dinë.
7. Dinë anën e jashtme të jetës së kësaj bote, të shkujdesur rreth së ardhmes.
8. Nuk mendojnë në vetvete se Zoti krijoi qiejt dhe tokën e ç'janë mes tyre me të vërtetën dhe afat të caktuar? Mirëpo, shumë njerëz mohojnë takimin me Zotin.
9. Nuk udhëtojnë në tokë të shohin si qe fundi i pararendësve? Ishin akoma më të fuqishëm, punuan tokën, e populluan atë më tepër nga ç'e kanë populluar këta dhe u erdhën të dërguarit me prova të qarta. Nuk i dhunoi Zoti, porse dhunuan vetveten.
10. Pastaj, fundi i keqbërësve është edhe më i keq, sepse përgënjeshtroan dëshmitë e Zotit dhe u tallën me to.
11. Zoti zë fill krijimin, pastaj e përsërit dhe ktheheni te Ai.
12. Ditën që vjen Ora, mëkatarët zhgënjehen.
13. Nuk u ndërmjetësojnë idhujt e tyre, por i mohojnë.
14. Ditën që vjen Ora, ndahen.
15. Cilët besuan e bënë të mira, janë në kopshte, të kënaqur.
16. Ata që mohuan dhe përgënjeshtroan dëshmitë Tona si dhe takimin e së ardhmes do të sillen të pranishëm në dënim.
17. Madhëroni Zotin kur ngryseni e gdhiheni!
18. Atij i takon falënderimi në qiej e në tokë, kur bie nata e vjen dita.

19. Nxjerr të gjallin prej të vdekurit, nxjerr të vdekurin prej të gjallit dhe gjallëron tokën e vdekur. Edhe ju, kështu do të nxirreni.
20. Ndër dëshmitë e Tij është krijimi juaj nga toka, pastaj, ja tek jeni njerëz të shpërndarë!
21. Ndër dëshmitë e Tij është krijimi i bashkëshorteve tuaja nga ju vetë, të preheni në to dhe krijoi mes jush dashuri e mëshirë. Këtu ka dëshmi për njerëzit që mendojnë.
22. Ndër dëshmitë e Tij janë krijimi i qiejve dhe i tokës, ndryshimi i gjuhëve dhe i ngjyrave. Këtu ka dëshmi për të diturit.
23. Ndër dëshmitë e Tij janë gjumi i natës e i ditës dhe kërkimi i mirësisë së Zotit. Këtu ka dëshmi për njerëzit që dëgjojnë.
24. Ndër dëshmitë e Tij, ju shfaq vetëtimën, frikë e shpresë, zbret nga qielli ujë dhe gjallëron me të tokën e vdekur. Këtu ka dëshmi për njerëzit që kuptojnë.
25. Ndër dëshmitë e Tij është të qëndruarit e qiellit dhe tokës me urdhrin e Tij. Pastaj, kur ju bën thirrje prej tokës, ja tek dilni!
26. Atij i takojnë ç'janë në qiej e në tokë. Gjithçka i bindet Atij.
27. Zë fill krijimin dhe e përsërit. Kjo është për Të e lehtë. Shembulli më i lartë në qiej e në tokë i takon Atij. Ai është i Plotfuqishmi, i Urti.
28. Ju jep shembull nga vetja juaj: robërit që zotëroni, a janë pjesëtarë të barabartë në pjesën që ju kemi dhënë që t'u druheni atyre siç i druheni njëri-tjetrit? Kështu i shpjegojmë dëshmitë për njerëzit që kuptojnë.

29. Mirëpo dhunuesit ndjekin me padije pasionet. Kush vë në udhë ata që Zoti i ka lënë të gabojnë? Për ta nuk ka ndihmëtarë.
30. Drejto fytyrën nga feja e vërtetë, natyra në të cilën Zoti krijoi njerëzit. Nuk ka zëvendësim në krijimin e Zotit. Kjo është feja e drejtë, por të shumtët e njerëzve janë të paditur.
31. Përmbajuni Atij, të penduar, kryeni të falurit dhe mos jini me idhujtarët,
32. nga ata që e përçanë fenë në sekte ku çdo palë është e kënaqur me të sajën.
33. Kur bien në vështirësi, njerëzit i luten Zotit të penduar; pastaj, kur i bën të shijojnë prej Tij mëshirë, ja ku, një pjesë tyresh, i bën Zotit shok!
34. Për të mohuar çfarë u kemi dhënë. Përfitoni, pa do ta dini!
35. Mos u zbritëm ndonjë argument në favor të idhujve që shoqërojnë?
36. Kur njerëzit i bëjmë të shijojnë mëshirë, vetëkënaqen; në u bie e keqja që përgatitën duart e tyre, ja tek dëshpërohen!
37. Nuk shohin se Zoti ia zgjeron të mirat atij që do ose ia kufizon? Këtu ka dëshmi për njerëzit që besojnë.
38. Pra, jepi të afërmit, të varfrit dhe udhëtarit të drejtën e tij. Kjo është më e mirë për ata që kërkojnë pëlqimin e Zotit. Këta janë të suksesshmit.
39. Ç'jepni me kamatë, për ta shtuar nga pasuria e njerëzve, nuk shtohet pranë Zotit; ç'keni dhënë për bamirësi duke kërkuar pëlqimin e Zotit, shumëfishohet.

40. Zoti është Ai që ju krijoi dhe ju ushqen, pastaj ju vdes e ju ngjall. Ndër idhujt tuaj, a ka ndonjë që bën diçka të tillë? I madhëruar dhe i lartë nga ç'i shoqërojnë!
41. U shfaq e keqja në tokë e në det me duart e njerëzve. Që Ai t'i bëjë të shijojnë një pjesë të veprës së tyre dhe të mund të ndryshojnë.
42. Thuaj: "Udhëtoni në tokë të shihni si qe fundi i pararendësve. Të shumtët ishin idhujtarë."
43. Drejto fytyrën nga feja e drejtë para se të vijë prej Zotit një ditë pa kthim. Dita kur do të ndahen.
44. Kush mohoi, ka mbi vete mohimin; cilët bënë të mira, i bënë vend vetes.
45. Që t'i shpërblejë ata që besuan e bënë të mira me Mirësinë e Vet. Vërtet, Ai nuk i do mohuesit.
46. Ndër dëshmitë e Tij, dërgon erërat - sihariq që të shijoni mëshirën e Tij, të lundrojë anija me urdhrin e Tij në kërkim të mirësive të Tij dhe që të mund të falënderoni.
47. Dërguam para teje të dërguar te kombet e tyre dhe u erdhën me prova të qarta. Ndëshkuam fajtorët dhe qe detyrë për Ne t'i ndihmonim besimtarët.
48. Zoti dërgon erërat dhe shpërndajnë retë; i shtrin ato me dashjen e Tij në qiell dhe i shpërbën; sheh shiun të dalë nga mesi i tyre dhe, kur bën të bjerë mbi robtë e Tij që dëshiron, ja tek gëzohen!
49. Edhe pse ishin më parë të pashpresë.
50. Shih, pra, në gjurmët e mëshirës së Zotit, si përtërin token e vdekur! Kështu ngjall të vdekurin. Ai është mbi gjithçka pushtetplotë.
51. Sikur të dërgonim një erë dhe ta shihnin atë të zverdhur, do të mbeteshin, pas saj, mohues.

52. Ti nuk bën të vdekurin të dëgjojë, as shurdhët të dëgjojnë thirrjen ndërsa ikin të prapsur.
53. Ti nuk je që të drejtosh të verbrit në udhën e tyre pa krye, porse bën të dëgjojnë vetëm ata që besojnë në dëshmitë Tona si muslimanë.
54. Zoti ju krijoi të pafuqishëm; pastaj, nga të pafuqishëm, ju jep fuqi; pastaj, nga të fuqishëm, ju lë të dobët e të moshuar. Krijon me dashjen e Tij. Ai është Dijeploji, i Plotpushtetshmi.
55. Ditën që vjen Ora, mëkatarët betohen se nuk qëndruan më se një orë. Kështu u mashtruan.
56. Ata me dije e besim, thonë: "Qëndruat, sipas librit të Zotit, deri Ditën e Ringjalljes. Ja, kjo është Dita e Ringjalljes, mirëpo ju nuk dinit."
57. Atë ditë, dhunuesve nuk u bën dobi shfajësimi, as që lejohen të luten.
58. Sollëm në këtë Kuran, për njerëzit, gjithfarë shembujsh, por, në u sjell dëshmi, mohuesit do të thonë: "Ju ndiqni të kotën."
59. Kështu, Zoti ua vulosi zemrat atyre që nuk dinë.
60. Ti duro sepse premtimi i Zotit është i vërtetë. Dhe, mos të të lëkundin ata që nuk binden.

31. LUKMANI (LUKMAN)

Periudha e Mekës, 34 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Elif, lam, mim.

2. Këto janë dëshmitë e Librit të Urtë.
3. Drejtim e mëshirë për mirëbërësit,
4. që kryejnë të falurit, japin detyrimin dhe binden për të ardhmen.
5. Ata janë të udhëhequr nga Zoti i tyre, ata janë të suksesshmit.
6. Ndër njerëzit, ka që shkëmbejnë biseda të kota për të larguar nga Rruga e Zotit me padije dhe e marrin atë me tallje. Ata kanë dënim poshtërues.
7. Kur u recitohen dëshmitë Tona, largohen me mendjemadhësi si të mos i kenë dëgjuar a t'u jenë rënduar veshët. Jepu lajmin e një dënimi të hidhët.
8. Cilët besojnë dhe bëjnë të mira, kanë kopshtet e begata,
9. të përhershëm në to. Premtim i vërtetë i Zotit. Ai është i Plotfuqishmi, i Urti.
10. Krijoi qiejt pa mbështetje të dukshme, vuri në tokë formacione të qëndrueshme, që ajo të mos lëkundet bashkë me ju dhe përhapë në të lloj-lloj gjallesash. Zbritëm nga qielli ujë dhe rritëm në të gjithfarë llojesh të dobishme.
11. Ky është krijimi i Zotit. Më tregoni, çfarë krijuan të tjerët në vend të Tij? Porse dhunuesit janë në gabim të qartë.
12. I dhamë Lukmanit urtësinë: "Falëndero Zotin!" Kush falënderon, falënderon për vete; në mohon, Zoti është i vetëmjaftueshëm, i lëvdur.
13. Kur Lukmani këshillonte të birin, i thoshte: "Biri im, mos i bëj Zotit shok! Idhujtaria është dhunim tepër i rëndë."
14. E porositëm njeriun për prindërit. Nëna e bart në gjendje të brishtë dhe e ndan nga gjiri në dy vjet. Pra,

falënderona Mua dhe prindërit e tu! Tek Unë është fundi.

15. Në përpiqen me padijen tënde të më bësh shok, mos iu bind, por shoqëroji në këtë botë me respekt. Dhe ndiq rrugën e atyre që kthehen nga Unë të penduar. Kthimi juaj është tek Unë dhe ju njoftoj se ç'keni bërë.
16. "Biri im! Qoftë ajo me peshën e një fare sinapi dhe të jetë në shkëmb, në qiej a në tokë, Zoti e sjell. Zoti është i butë, i gjithëditur.
17. Biri im! Kryej të falurit, porosit të mirën, ndalo nga e keqja dhe duro në vështirësi. Këto janë ndër çështjet kryesore.
18. Mos i përçmo njerëzit dhe mos ec në tokë me mburrje. Zoti nuk i do mburravecët dhe arrogantët.
19. Mate hapin dhe ule zërin. Zëri më i papëlqyer është ai i gomarit."
20. Nuk shihni që Zoti nënshtroi për ju ç'janë në qiej e në tokë dhe derdhi mbi ju të mirat e Tij në mënyrë të dukshme e të padukshme? Ka njerëz që kundërshtojnë te Zoti me padije, pa drejtim e libër dritëdhënës.
21. Kur u thuhet: "Ndiqni çfarë Zoti ka zbritur", - thonë: "Ndjekim traditën e etërve tanë." Edhe pse djalli i fton te dënimi në zjarrin e përflakur.
22. Kush i dorëzohet Zotit si mirëbërës, është kapur te një nyjë e fortë. Te Zoti është fundi i çështjeve.
23. Në mohojnë, mos të të dëshpërojnë mohimi i tyre. Te Ne është kthimi i tyre dhe i njoftojmë se ç'kanë bërë. Zoti është dijeplotë për vetë krahavorët.
24. I bëjmë të gëzojnë për pak, pastaj i detyrojmë me dënim të rreptë.

25. Në i pyet: “Kush krijoi qiejt e tokën?” – do të thonë: “Zoti.” Thuaj: “Lavdi Zotit!” Por të shumtët nuk dinë.
26. Zotit i takojnë ç’janë në qiej e në tokë. Zoti është i Vetëmjaftueshmi, i Lëvduari.
27. Sikur të ishin gjithë pemët në tokë penda dhe detit t’i shtoheshin shtatë dete, nuk do të shteronin fjalët e Zotit. Zoti është i plotfuqishëm, i urtë.
28. Krijimi dhe ringjallja juaj janë si i një fryme të vetme. Zoti është dëgjues, largpamës.
29. A nuk sheh që Zoti fut natën në ditë dhe fut ditën në natë, nënshtrori diellin e hënën dhe secili lëviz në afat të caktuar? Që Zoti është në dijeni të veprave tuaja?
30. Sepse Zoti është e Vërteta dhe, ç’lusin veç Tij, janë e pavërteta. Zoti është i Larti, Madhështori.
31. A nuk sheh që anija lundron në det me mirësinë e Zotit për t’ju treguar shenjat e Tij? Këtu ka dëshmi për çdo durimtar e falënderues.
32. Kur i mbulon ndonjë dallgë si re, lusin Zotin me besim thjesht për Të. Sapo i nxjerr në tokë, disa bëjnë kompromis. Dëshmitë Tona i kundërshton vetëm një i pabesë, mosmirënjohës.
33. Njerëz, përmbajuni Zotit tuaj dhe kini frikë një ditë kur nuk paguan i ati të birin, as i biri të paguajë të atin. Paralajmërimi i Zotit është i vërtetë. Të mos ju mashtrojë jeta e kësaj bote, të mos ju mashtrojë për Zotin mashtrulesi!
34. Vërtet, Allahu, pranë Tij është Dija e Orës, zbret shiun dhe di ç’mbajnë mitrat. Një frymë nuk e di çfarë i sjell e nesërmja dhe nuk di një frymë në ç’tokë do të vdesë. Zoti është Dijeplotë, i Plotëditor.

32. PËRULJA (ES-SEXHDE)

Periodha e Mekës, 30 ajete
Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Elif, lam, mim.
2. Shpallja e Librit është, pa dyshim, nga Zoti i botëve.
3. Thonë se e sajoi ai? Jo. Është e vërteta nga yt Zot, për t'i tërhequr vëmendjen një populli të cilit nuk i erdhi profet para teje, që të mund të drejtohet.
4. Zoti është Ai që krijoi qiejt e tokën dhe ç'janë mes tyre në gjashtë ditë, pastaj përqendroi pushtetin. Nuk keni, veç Tij, kujdestar e ndërmjetës. A nuk mendoheni?
5. Drejton urdhrin nga qielli në tokë, pastaj ngjitet te Ai në një ditë sa një mijë vjet që numëroni ju.
6. Ai është Njohësi i së padukshmes e të dukshmes, i Plotfuqishmi, Mëshirëploti.
7. Është Ai që krijoi çdo gjë më së miri dhe e nisi krijimin e njeriut nga balta.
8. Pastaj bëri gjeneratën e tij prej një prejardhje uji të lënë.
9. Pastaj e formoi dhe i fryu nga Shpirti i Tij. Bëri për ju të dëgjuarit, të parët dhe zemrat. Ju pak falënderoni.
10. Thonë: "Kur të kemi humbur në tokë, do të krijohemi sërish?" Jo, ata mohojnë takimin me Zotin e tyre.
11. Thuaj: "Ju vdes engjëlli i vdekjes, i ngarkuar për ju, pastaj, te Zoti juaj ktheheni."
12. Sikur t'i shihje mëkatarët kokulur para Zotit: "Zoti ynë, ne shohim e dëgjojmë. Na kthe të bëjmë të mira! Me të vërtetë, jemi të bindur."
13. Po të deshim, i kishim dhënë çdo fryme drejtimin, por përligjet fjala prej Meje se "do ta mbush skëterrën me xhinë e njerëz bashkë."

14. Shijojeni, pra, pasi harruat takimin e kësaj dite! Edhe Ne ju harruam. Shijoni dënimin e pafund për veprat tuaja!
15. Besojnë në dëshmitë Tona vetëm ata që, kur u përmenden, bien me krye në tokë, i thurin lavde Zotit e nuk mburren.
16. Lënë shtretërit e i luten Zotit me frikë e shpresë dhe kontribuojnë nga ç'u kemi dhënë.
17. Njeriu nuk di se ç'kënaqësi është rezervuar për të si shpërblim i veprës së tij.
18. A mund të jetë besimtari si një mëkatar i pabindur? Nuk barazohen.
19. Cilët besojnë e bëjnë të mira, kanë kopshtet-strehë, pritje me ç'kanë bërë.
20. Keqbërësit kanë zjarrin për strehë. Sa herë duan të dalin, kthehen në të. U thuhet: "Shijoni dënimin e zjarrit që përgënjeshtroat!"
21. Do t'i bëjmë të shijojnë dënimin e afërt para dënimit të madh që të mund të ndryshojnë.
22. Kush është më i padrejtë se ai që i përmenden dëshmitë e Zotit dhe largohet prej tyre? Me fajtorët hakmerremi.
23. Musait i dhamë Librin – mos ji në dyshim rreth takimit të tij – dhe e bëmë drejtim për bijtë e Izraelit.
24. Derisa ishin të vendosur e të bindur në dëshmitë Tona, bëmë prej tyre udhëheqës që drejtuan me Urdhrin Tonë.
25. Yt Zot do të gjykojë mes tyre Ditën e Ringjalljes se ku ranë në kundërshti.
26. Nuk është për ta mësim që kemi zhdukur para tyre sa e sa brezni në vendbanimet e të cilëve ata ecin? Këtu ka dëshmi, pra, a nuk dëgjojnë?

27. Nuk shohin se Ne shpiem ujë në tokën djerr dhe nxjerrim me të bimësi ku ushqehen kafshët e tyre edhe ata vetë? Nuk vështrojnë?
28. Thonë: “Kur është ky vendim në thoni të vërtetën?”
29. Thuaj: “Ditën e Vendimit, nuk u vlen mohuesve besimi i tyre, as rishikohen.”
30. Shmangu prej tyre dhe prit! Ata janë në pritje.

33. KLANET (EL AHZAB)

Periudha e Medines, 73 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. O profet! Përmbaju Zotit dhe mos iu bind mohuesve e hipokritëve. Zoti është dijeplotë, i urtë.
2. Ndiq ç'të kumtohet nga yt Zot. Zoti është në dijeni të veprave tuaja.
3. Mbështetu te Zoti. Mjafton Zoti dorëzanës.
4. Zoti s'i ka bërë njeriut dy zemra në trup, as gratë tuaja të cilave u ktheni shpinën, nënat tuaja dhe nuk jua bëri bijtë e birësuar, bijtë tuaj. Këto janë fjalë që thoni me gojën tuaj. Zoti thotë të vërtetën dhe Ai drejton udhën.
5. Thirrni ata me etërit e tyre. Kjo është më e drejtë pranë Zotit. Në qoftë se nuk ua dini etërit, ata janë vëllezërit tuaj në fe dhe të afërmit tuaj. Nuk është mëkat kur gaboni, porse në qëllimin e zemrave tuaja. Zoti është falës, mëshirëplotë.

6. Profeti është më afër besimtarëve nga ç'janë ata vetë dhe gratë e tij janë nënat e tyre. Në Librin e Zotit, njerëzit e një gjinie janë më të afërt me njëri -tjetrin se me besimtarët dhe emigrantët. Vetëm po qe se u bëni një të mirë miqve tuaj (Arab. ma'rufen, një të mirë të njohur ligjërisht). Kjo është e shkruar në libër.
7. Kur morëm besë nga profetët, edhe prej teje, prej Nuhit, Ibrahimit, Musait, Isait, birit të Merjemit, morëm një zotim të fortë.
8. Që Ai t'i pyesë besnikët për besën e tyre ndërsa mohuesve u bëri gati dënim të hidhët.
9. Besimtarë! Kujtoni të mirën e Zotit kur ju erdhën ushtri dhe dërguam kundër tyre një erë të fortë dhe trupa që nuk i shihnit. Zoti është largpamës i veprave tuaja.
10. Kur ju erdhën nga lart e poshtë (ana lindore Medines, e mbrojtur nga shkëmbinjtë dhe ultësira ku u gërmua një hendek i gjatë) dhe u errën shikimet e u ngushtuan zemrat, menduat ndryshe për Zotin.
11. Atje, besimtarët u vunë në provë dhe u tronditën thellë.
12. Ndërkohë, hipokritët dhe zemërsëmurët thanë: “Zoti dhe i Dërguari i Tij na paskan mashtruar!”
13. Dhe një grup prej tyre tha: “Banorë të Jethribit (Medines), s'ka qëndresë për ju, tërhiquni!” Një kastë nga ata i kërkoi leje Profetit duke thënë: “Shtëpitë tona janë të pambrojtura.” Nuk ishin të pambrojtura, por donin të iknin.
14. Sikur t'u merrnin krahët e t'u lypej tradhtia, do ta bënë pa ngurrim.
15. I dhanë më parë besë Zotit se nuk do të dezertonin. Besa e Zotit është me përgjegjësi.

16. Thuaj: “Ikni nga vdekja apo nga vrasja, ikja nuk ju bën dobi. Atëherë, pak do ta gëzonit.”
17. Thuaj: “Kush ju mban nga Zoti nëse Ai jua do të keqen ose do për ju mëshirë? Nuk do të gjejnë, veç Zotit, kujdestar e ndihmëtar.
18. Zoti i njeh pengimtarët mes jush dhe ata që u thonë të vëllezërve: “Ejani me ne!” – dhe zor se gjenden në vështirësi.
19. Të ngurtë ndaj jush, kur i zë frika, i sheh të të vështrojnë duke i kthyer sytë si t’u ketë rënë vdekja. Me t’u ikur frika, ju sulmojnë me gjuhë të mprehtë. Të ngurtë ndaj së mirës, ata nuk besojnë. Zoti ka bërë t’u dështojnë veprat dhe kjo për Zotin është e lehtë.
20. Mendojnë se klanet nuk kanë ikur. Në se klanet vijnë, do të dëshironin të ishin me beduinët në shkretëtirë e të merrnin lajme rreth jush. Edhe po të qenë me ju, zor se luftonin.
21. Te i Dërguari i Zotit keni një model të mirë për këdo që shpreson Zotin dhe Ditën e Fundit dhe që përmend Zotin shumë.
22. Kur i panë klanet, besimtarët thanë: “Ja premtimi i Zotit dhe i të Dërguarit të Tij! Zoti ka thënë të vërtetën, edhe i Dërguari i Tij. Dhe iu shtua besimi e bindja.
23. Te besimtarët ka burra që mbajnë besën e dhënë Zotit. Prej tyre, ka që përmbushën betimin dhe, prej tyre, ka që presin e nuk bëjnë këmbim.
24. Që Zoti, në dashtë, t’i shpërblejë besëtarët për besën e tyre dhe t’i dënojë hipokritët ose t’ua pranojë pendimin. Zoti është falës, mëshirëplotë.
25. Zoti i prapësoi mohuesit në tërbimin e tyre, pa arritur gjë. Zoti u mjafton besimtarëve në luftë. Zoti është i fortë, i plotfuqishëm.

26. I zbriti nga fortifikatat e tyre ithtarët e Librit që i mbështetën ata dhe u futi panik në zemër. Një pjesë e vratë dhe një pjesë e robëruat.
27. Dhe jua trashëgoi juve tokën e tyre, shtëpitë e tyre, mallin e tyre, një vend që nuk e patët shkelur. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.
28. O profet! Thuaju grave tuaja: "Në dëshironi jetën e kësaj bote dhe stolinë e saj, ejani e shijojini, t'ju liroj me të mirë.
29. Në doni Zotin, të Dërguarin e Tij dhe banesën e së ardhmes, Zoti u ka përgatitur mirëbërëseve ndër ju shpërblim të madh."
30. Gratë e Profetit! Cila nga ju bën paudhësi të qartë, i dyfishohet dënimi. Kjo, për Zotin është e lehtë.
31. Asaj që u bindet Zotit dhe të Dërguarit të Tij e bën mirë, ia japim shpërblimin dy herë. Dhe i kemi bërë gati një pjesë bujare.
32. Gratë e Profetit! Ju nuk jeni si gratë e tjera. Të devotshme, mos joshni me fjalë që një i pandërgjegjshëm të lakmojë, por thoni fjalë të matura.
33. Qëndroni në shtëpitë tuaja dhe mos e zbuloni veten si më parë, në kohën e padijes. Kryeni të falurit, jepni detyrimin dhe bindjuni Zotit e të Dërguarit të Tij. Zoti dëshiron të largojë prej jush, familjes profetike, njollën e idhujtarisë dhe t'ju pastrojë më së miri.
34. Përmendni ajetet e Zotit që lexohen në shtëpitë tuaja dhe urtësinë. Zoti është i butë, i gjithëditur.
35. Muslimanëve e muslimaneve, besimtarëve e besimtareve, të bindurve e të bindurave, të singertëve e të singertave, durimtarëve e durimtareve, të përulurve e të përulurave, bamirësve e bamirëseve, agjëruesve dhe agjërueseve, të ndershmëve e të

ndershmeve, përmendësve shumë të Zotit dhe përmendëseve, Zoti u ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh.

36. Kur Zoti dhe i Dërguari i Tij vendosin një çështje, besimtarit e besimtares nuk u takon të zgjedhin çështje të tyre. Kush nuk u bindet Zotit dhe të Dërguarit të Tij, ka rënë në gabim të qartë.
37. Kur i the atij që bekoj Zoti dhe e bekove ti me të mira: “Mbaje tët shoqe dhe ki frikë Zotin!” - fshihje në vetvete diçka që Zoti e shfaq dhe u druheshe njerëzve ndërsa duhej t’i druheshe Zotit. Kur Zejdi vendosi të ndahej prej saj, ta kurorëzuam ty, për të mos qenë pengesë te besimtarët në gratë e bijve të birësuar pasi të jenë ndarë. Urdhri i Zotit është i kryer.
38. Nuk ka pengesë për Profetin ku Zoti vendos për të. Rregull i Zotit te ata që kaluan më parë, - urdhri i Zotit është vendim i përcaktuar, -
39. që përcjellin mesazhet e Zotit dhe i frikësohen Atij e nuk i frikësohen dikujt tjetër veç Zotit. Mjafton Zoti llogarimarrës.
40. Muhammedi nuk është babai i dikujt prej burrave tuaj, porse i Dërguari i Zotit dhe vula e profetëve. Zoti është për çdo gjë dijeplotë.
41. Besimtarë, përmendni Zotin shumë!
42. Dhe lëvdojeni mëngjes e mbrëmje.
43. Është Ai që ju bekon, edhe engjëjt e Tij, për t’ju nxjerrë nga errësirat në dritë. Ai është me besimtarët mëshirëplotë.
44. Ditën që e takojnë, përshëndeten me: “Paqe!” Ai u përgatiti shpërblim bujar.
45. O profet! Ne të dërguam dëshmues, përgëzues e paralajmërues,

46. ftues te Zoti, me lejen e Tij dhe pishtar ndriçues.
47. Përgëzoji besimtarët se ka për ta nga Zoti nder të madh.
48. Mos iu bind mohuesve e hipokritëve dhe lëri fyerjet e tyre. Mbështetju Zotit! Mjafton Zoti dorëzanës.
49. Besimtarë! Kur të keni vënë kurorë me besimtarët dhe i ndani para se të bëni marrëdhënie me to, mos llogaritni kohë pritjeje, por pajisini dhe lirojini në mënyrë të hijshme.
50. O profet! Ne lejuam për ty gratë që u ke dhënë shpërblimin e kurorës, ato që Zoti t'i ka dhënë nën zotërim dhe bijat e xhaxhait, bijat e hallave, bijat e dajës, bijat e tezeve, të cilat janë shpërngulur me ty, si dhe një grua besimtare që ia dhuron veten Profetit dhe që Profeti dëshiron të martohet me të; vetëm për ty, jo për besimtarët. Ne e dimë ç'urdhëruam për ta te gratë dhe skllavet e tyre, pra, të mos jetë për ty pengesë. Zoti është falës, mëshirëplotë.
51. Ti lë në pritje dhe merr pranë cilën do prej tyre; të kërkoksh kë ke lënë mënjanë, nuk është mëkat. Kështu është më mirë që të qetësohen e të mos brengosen dhe të kënaqen me ç'u jep të gjithave. Zoti ua di zemrat. Zoti është dijeplotë, i butë.
52. Nuk të lejohen gratë më pas, që t'i zëvendësosh me gra të tjera, edhe sikur të të mahnisë bukuria e tyre, përveç atyre që zotëron. Zoti është mbikëqyrës në çdo gjë.
53. Besimtarë, mos hyni në shtëpitë e Profetit, vetëm në se ju jepet leje për ndonjë ushqim, pa qenë në pritje të përgatitjes së tij; por hyni kur të jeni ftuar, shpërndahuni pas ngrënies dhe mos kërkonit të familjarizoheni në bisedë e sipër. Kjo do ta

shqetësonte Profetin, por ai druhet prej jush ndërsa Zoti nuk druan nga e vërteta. Kur t'i pyesni ato për diçka, pyetini pas ndonjë perdeje. Kjo është më e pastër për zemrat tuaja dhe zemrat e tyre. Nuk ju takon ta shqetësoni të Dërguarin e Zotit apo të martoheni, pas tij, me gratë e tij, kurrë. Kjo, te Zoti është e rëndë.

54. E shfaqni apo fshihni diçka, Zoti e di.
55. Ato nuk bëjnë mëkat te etërit e tyre, bijtë e tyre, vëllezërit e tyre, bijtë e vëllezërve të tyre, bijtë e motrave të tyre, gratë dhe skllavet e tyre. Kini frikë Zotin! Zoti është dëshmues në çdo gjë.
56. Zoti dhe engjëjt e Tij e bekojnë Profetin. Besimtarë, bekojeni atë dhe përshëndeteni të nënshtuar!
57. Cilët shqetësojnë Zotin dhe të Dërguarin e Tij, i ka mallkuar Zoti në këtë botë e në të ardhmen dhe u përgatiti dënim poshtërues.
58. Ata që shqetësojnë, pa shkak, besimtarët e besimtarët ngarkohen me shpifje dhe mëkat të hapur.
59. O profet, thuaju grave tuaja, bijave tuaja dhe grave të besimtarëve të hedhin sipër mbulesë. Kështu është më mirë që ato të dallohen e të mos shqetësohen. Zoti është falës, mëshirëplotë.
60. Në qoftë se hipokritët, zemërsëmurët dhe përgojuesit në qytet nuk pushojnë, do të të ngrejme kundër tyre e nuk do të bashkëjetojnë aty gjatë.
61. Të mallkuar, do të kapen e të vriten kudo që ndeshen.
62. Ligj i Zotit te pararendësit. Nuk do të gjesh ndryshim në ligjin e Zotit.
63. Të pyesin njerëzit për Orën. Thuaj: "Dija e saj është pranë Zotit." Ku ta dish, ndoshta ora është afër?
64. Zoti i mallkoi mohuesit dhe u bëri gati zjarr të ndezur.

65. Të përhershëm në të, përgjithmonë. Nuk do të gjejnë kujdestar e përkrahës.
66. Ditën që bien me fytyrë në zjarr, thonë: "Të mjerët ne, sikur t'i bindeshim Zotit dhe t'i bindeshim të Dërguarit!"
67. Dhe thonë: "Zoti ynë, ne iu bindëm zotërinjve tanë e të mëdhenjve tanë dhe ata na larguan nga rruga.
68. Zoti ynë, shtoj atyre dënim dhe mallkoji me nëmë të madhe!"
69. Besimtarë! Mos jini si ata që shqetësuan Musanë! Zoti e dëliri nga fjalët e tyre dhe ai ishte te Zoti i dalluar.
70. Besimtarë! Kini frikë Zotin dhe thoni fjalë me vend.
71. Ai jua përmirëson veprat dhe ju fal mëkatet. Kush u bindet Zotit dhe të Dërguarit të Tij, ka arritur fitore të madhe.
72. Ua dhamë përgjegjësinë qiejve, tokës e maleve dhe ato s'e mbajtën, u tutën prej saj. Dhe e mbajti njeriu. Ai është i padrejtë, barbar.
73. Që Zoti t'i dënojë hipokritët dhe hipokritet, idhujtarët e idhujtare dhe t'i falë Zoti besimtarët e besimtare. Zoti është falës, mëshirëplotë.

34. SEBA (SEBE')

Periudha e Mekës, 54 ajete
Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Lavdi Zotit të Cilit i përket gjithçka në qiej e në tokë! Atij i takojnë lavdet edhe në të ardhmen. Ai është i Urti, i Gjithëdituri.
2. Di çfarë hyn në tokë e ç'del prej saj, çfarë zbret nga qielli e ç'ngjitet në të. Ai është Mëshirëploti, Falësi.
3. Mohuesit thonë: "Nuk do të na vijë ora." Thuaj: "Po, për Zotin, Njohësin e së padukshmes, patjetër do t'ju vijë. Atij nuk i shpëton një grimë në qiej e në tokë, as më e vogël dhe më e madhe, pa qenë në libër të qartë.
4. Që t'i shpërblejë ata që besojnë e bëjnë të mira. Ata kanë falje dhe një pjesë bujare.
5. Cilët përpiqen të pengojnë dëshmitë Tona, kanë si dënim një ndëshkim të hidhët.
6. Ata me dije nga Libri e shohin se shpallja tek ty nga yt Zot është e vërteta që drejton rrugës së të Plotfuqishmit, Lavdiplotit.
7. Mohuesit thonë: "T'ju rrëfejme njeriun që ju njofton se pasi të bëheni copë e thërrime jeni në krijim të ri?"
8. Sajon gënjeshtër ndaj Zotit apo e kanë zënë xhinët?" Jo, porse ata që nuk besojnë në të ardhmen janë në vuajtje dhe humbje të thellë.
9. Nuk shohin para e pas, nga qielli e toka? Po të deshim, fundosim me ta tokën ose bënim t'u binin copa qielli. Këtu ka dëshmi për çdo rob që kthehet i penduar.
10. I dhamë Davudit dhunti nga ana Jonë: "O male e shpendë, bëmëni bashkë me të jehonë!" Dhe zbutëm për të hekurin:
11. "Punoni takëme e parzmore! Dhe bëni vepra të mira! Unë jam largpamës i veprave tuaja."

12. Edhe Sulejmanit erën: mëngjesi i saj, sa një muaj dhe kthimi i saj, sa një muaj (udhëtimi me deve). Bëmë të rridhte për të bakër i shkrirë dhe, nga xhinët, disa punonin në prani të tij, me lejen e Zotit. Kë i shmangej urdhrit Tonë, e bënim të vuante dënimin në zjarrin me flakë.
13. Bënin për të ç'të dëshironte: altare, skulptura, depozita dhe kazanë të palëvizshëm. "Bëni falënderim, o pasardhës të Davudit!" Të paktë janë robtë e Mi që falënderojnë.
14. Kur e vdiqëm atë, nuk u tregoi kush. Vetëm kur brejtësi i tokës ia hëngri mbështetësen dhe ai ra, xhinët e kuptuan. Sikur ta dinin të fshehtë, nuk do të qëndronin nën mundimin përulës. (Me brejtësin e tokës kuptohet rënia e sundimit të Sulejmanit, pas vdekjes së tij. Xhinët nuk zotërojnë ndonjë aftësi të mbinatyrshe siç besonin njerëzit.)
15. Dy kopshte-parajsë, më të djathtë e të majtë, qenë dëshmi për banorët e Sebas në vendbanimin e tyre: "Ushqehuni me ushqimin e Zotit dhe falënderoni Atë!" Vend i mirë dhe Zot falës.
16. U shmangën dhe u dërguam rrëkenë e digës. I kthyem kopshtet-parajsë në kopshte me fryte të hidhta, shkurre e gjembaçe.
17. Kështu ua shpërblyem pasi mohuan. Mos dënojmë dikë veç mosmirënjohësve?
18. Bëmë mes tyre dhe vendbanimeve që bekuam, qyteza të njohura dhe i lidhëm me rrugë: "Udhëtoni në to, natë e ditë, të sigurt!"
19. Por thanë: "Na i zgjat, o Zot, udhëtimet tona!" Ia bënë të keqen vetes dhe i lamë në histori, të shpërndarë andej-këtej. Këtu ka dëshmi për çdo durimtar, falënderues.

20. Djalli ua tha hamendjen dhe, përveç një grupi besimtarësh, ata e ndoqën.
21. Ai s'kishte autoritet mbi ta, por që ta dinim kush besonte në të ardhmen dhe cili mbeti në mëdyshje. Yt Zot është në çdo gjë mbikëqyrës.
22. Thuaj: "Thirruni atyre që besoni në vend të Zotit! Nuk zotërojnë qoftë një grimë në qiej e në tokë, s'kanë pjesëmarrje në to dhe Ai nuk ka ndër ta bashkëpunëtor."
23. Nuk ia arrijnë të ndërhyjnë pa lejen e Tij. Dhe, kur çlirohen nga ankthi, thonë: "Ç'ka thënë Zoti?" Thonë: "Të vërtetën." Ai është i Larti, Madhështori.
24. Thuaj: "Kush ju ushqen nga qiejt e toka?" Thuaj: "Zoti. Pra, ne ose ju jemi drejt a në gabim të hapur."
25. Thuaj: "Ju nuk do të pyeteni për fajet tona dhe ne s'do të pyetemi për veprat tuaja."
26. Thuaj: "Zoti ynë do të na mbledhë e të vendosë mes nesh me të vërtetën. Ai është Vendosi, Dijeploji."
27. Thuaj: "M'i tregoni çfarë i bashkoni Atij si shoqërues. Jo, kurrë! Është Zoti, i Plotfuqishmi, i Urti."
28. Të dërguam ty përgëzues e paralajmërues për njerëzit mbarë, por të shumtët e njerëzve nuk dinë.
29. Thonë: "Kur është ky paralajmërim në thoni të vërtetën?"
30. Thuaj: "Ju keni takimin e një dite që s'mund ta vononi një orë apo ta sillni më parë."
31. Mohuesit thonë: "Ne nuk do të besojmë në këtë Kuran e ç'janë para tij." Sikur t'i shihje dhunuesit para Zotit se si ia kthejnë fjalën njëri-tjetrit! U thonë të shtypurit të mëdhenjve: "Po të mos ishit ju, do të qemë besimtarë."

32. Të mëdhenjtë u thonë të shtypurve: “Ne ju penguam kur ju erdhi drejtimi? Ju jeni fajtorë.”
33. U thonë të shtypurit të mëdhenjve: “Jo, por ishin planet tuaja natë e ditë kur na urdhëronit të mohonim Zotin e t’i bënim shokë.” Përpiqen të fshehin pendimin kur shohin dënimin. Mohuesve u vumë në qafë pranga. A nuk shpërblehen me ç’kanë bërë?
34. S’dërguam paralajmërues në një vendbanim pa u thënë të kamurit: “Nuk e besojmë misionin tuaj.”
35. Thonë: “Ne kemi shumë mall e fëmijë dhe nuk do të vuajmë dënimin.”
36. Thuaj: “Im Zot ia zgjeron të mirat atij që do ose i kufizon, por të shumtët e njerëzve nuk dinë.”
37. Nuk janë malli e fëmijët tuaj që ju afrojnë pranë Nesh. Por, ata që besojnë e bëjnë të mira. Këta kanë shpërblim të shumëfishtë të veprës së tyre, të qetë e të sigurt në vendet e larta të parajsës.
38. Cilët përpiqen të pengojnë dëshmitë Tona, janë të pranishëm në dënim.
39. Thuaj: “Im Zot ia zgjeron të mirat atij që do ndër robtë e Vet dhe ia kufizon. Ç’të kontribuoni, Ai e zëvendëson. Ai është Dhënësi Më i Mirë.”
40. Ditën që i mbledh të gjithë, u thotë engjëjve: “Këta ju adhuronin?”
41. Thonë: “Lëvduar qofsh! Ti je Kujdestari ynë, jo ata. Porse adhuronin xhinët. Të shumtët e tyre besonin ata.”
42. Sot nuk i zotëron një palë prej tyre tjetrës dobi e dëm. U themi dhunuesve: “Shijoni dënimin e zjarrit që përgënjeshtrojnë!”
43. Kur u recitohen ajetet Tona të qarta, thonë: “Ky është njeri që kërkon t’ju largojë nga adhurimi i etërve tuaj.”

Dhe thonë: “Kjo është gënjeshtër e sajuar.” Kur u erdhi e vërteta, mohuesit thanë: “Kjo është magji e hapur.”

44. Atyre nuk u patëm dhënë libra që t'i studionin, as u dërguam para teje ndonjë paralajmërues.
45. Përgënjeshtruan ata më parë ndërsa këta nuk kanë arritur qoftë të dhjetën e asaj që u dhamë atyre. Përgënjeshtruan të dërguarit e Mi dhe si qe mospëlqimi Im?”
46. Thuaj: “Unë ju këshilloj diçka: ngrehuni për Zotin, dy nga dy ose veç e veç dhe mendohuni. Shoku juaj nuk është i marrë, porse paralajmërues para një dënimi të rreptë.”
47. Thuaj: “Nuk ju kërkova shpërblim. Shpërblimi im është te Zoti. Ai është dëshmuar për gjithçka.”
48. Thuaj: “Im Zot nxjerr në shesh të vërtetën. Njohësi i të fshehtave.”
49. Thuaj: “Erdhi e vërteta. Ndërsa e pavërteta nuk zë fill e përsërit.”
50. Thuaj: “Në gabo, gabo nga vetja. Në jam në udhë të drejtë, kjo, sepse më frymëzoi im Zot. Ai dëgjon, është afër.”
51. Po t'i shihje kur t'u kallet frika, pa shpëtim e të zihen nga afër,
52. thonë: “E besojmë!” Por, si mund t'ia arrijnë nga larg?
53. Mohuan më parë dhe e hodhën të padukshmen larg.
54. Vihet një barrierë me dëshirat e tyre siç u bë me llojin e tyre më parë. Ata janë në mëdyshje të plotë, skeptikë.

35. KRIJUESI (FATIR)

Periodha e Mekës, 45 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëpotë.

1. Lavdi Zotit, Zanafillësit të qiejve e të tokës, Krijuesit të engjëjve-lajmëtarë, me nga dy, tri e katër flatra. Shton në krijim me Dashjen e Tij. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.
2. Kur Zoti hap mëshirën për njerëzit, askush nuk mund ta mbajë; nëse Ai e mban, askush pas Tij s'mund ta lëshojë. Ai është i Plotfuqishmi, i Urti.
3. O njerëz, përmendni të mirën e Zotit ndaj jush! Mos ka krijues, veç Zotit, që ju ushqen nga qielli e toka? S'ka zot veç Tij. Ku shkoni?
4. Në të përgënjeshtrojnë, u përgënjeshtruan të dërguar para teje. Te Zoti kthehen çështjet.
5. O njerëz! Premtimi i Zotit është i vërtetë; të mos ju mashtrojë jeta e kësaj bote, të mos ju mashtrojë për Zotin mashtguesi.
6. Djalli është armiku juaj, pra, merreni si armik! Fton klanin e tij, pjesëtar në zjarr.
7. Mohuesit kanë dënim të rreptë. Cilët besojnë dhe bëjnë të mira, kanë falje e shpërblim të madh.
8. Mos janë ata që u është zbukuruar e keqja e veprës së tyre dhe e shohin të mirë? Zoti lë të gabojë e drejton me dashjen e Tij. Të mos humbasë shpirti yt nga brenga për ta! Zoti e di se çfarë sajojnë.
9. Zoti është Ai që dërgon erërat dhe lëvizin retë. I shpiem në një vend pa jetë dhe përtërijmë me to tokën e vdekur. Ja, kjo është ringjallja.
10. Kush kërkon madhështinë, madhështia i takon e tëra Zotit. Te Ai ngjitet fjala e mirë dhe vepra e mirë e

- lartëson atë. Cilët sajojnë të këqiat, kanë dënim të rreptë dhe plani i tyre shkon më kot.
11. Zoti ju krijoi nga toka, pastaj nga një pikëz, pastaj ju bëri çift. Nuk bart e lind një femër pa dijen e Tij dhe nuk i zgjatet jeta jetëgjatit, as i mangësohet, pa qenë në libër. Kjo, për Zotin është e lehtë.
 12. Nuk janë njësoj dy dete, njëri i këndshëm, i ëmbël, i shijshëm për t'u pirë, tjetri i kripur dhe i hidhët. Prej secilit ushqeheni me mish të freskët dhe nxirrni stoli për veshje. Sheh anijen të çajë në to duke kërkuar mirësitë e Tij dhe që të mund të falënderoni.
 13. Ai fut natën në ditë dhe fut ditën në natë, nënshtroi diellin e hënën dhe secili lëviz në afat të caktuar. Ky është Allahu, Zoti juaj. Atij i përket sundimi. Ç'lusni në vend të Tij, nuk zotërojnë një membranë të bërthamës së hurmës.
 14. Në u thirrni, nuk e dëgjojnë thirrjen; nëse dëgjojnë, nuk ju përgjigjen dhe, Ditën e Ringjalljes, e mohojnë kultin tuaj. Askush nuk të vë në dijeni si Një i Gjithëditur.
 15. O njerëz! Ju jeni nevojtarë te Zoti. Zoti, Ai është i Pasuri, Lavdiploti.
 16. Po të dojë, ju heq dhe sjell një krijim të ri.
 17. Për Zotin kjo nuk është e vështirë.
 18. Nuk do të bartë një bartës barrën e tjetrit. Edhe sikur një i tejnarkuar të thërrasë te barra e vet, nuk i bartet gjë, qoftë i afërm. Ti u tërheq vëmendjen vetëm atyre që i frikësohen Zotit në të padukshmen dhe kryejnë të falurit. Kush çlirohet, çlirohet për vete. Fundi është te Zoti.
 19. Nuk janë njësoj i verbri me kë sheh,
 20. as errësirat me dritën,

21. as hija me rrezatimin e diellit.
22. Nuk janë njësoj i gjalli me të vdekurin. Zoti bën të dëgjojë atë që do ndërsa ti s'mund të bësh të dëgjojnë ata në varre.
23. Ti je vetëm një paralajmërues.
24. Ne të dërguam me të vërtetën, përgëzues e paralajmërues. S'ka popull pa i kaluar një paralajmërues.
25. Në të përgënjeshtrojnë, përgënjeshtruan para tyre. U erdhën të dërguar me prova të qarta, me shkrimet dhe Librin Dritëdhënës.
26. Pastaj, i mora mohuesit dhe si qe mospëlqimi Im?
27. Nuk sheh që Zoti ka bërë të zbresë nga qielli ujë? Nxjerrim me të fryte shumëngjyrëshe. Edhe te malet ka damarë të bardhë, të kuq, shumëngjyrësh dhe të zinj të errët.
28. Ndër njerëzit, kafshët e bagëtisë, po kështu, ka me ngjyra të ndryshme. Nga robtë e Tij, i frikësohen Zotit vetëm ata me dije. Zoti është i plotfuqishëm, falës.
29. Cilët lexojnë Librin e Zotit, falen dhe kontribuojnë fshehtas e haptas nga pjesa që u kemi dhënë, shpresojnë një shitblerje që nuk humbet.
30. Që Ai t'ua plotësojë shpërblimet dhe t'u japë akoma më shumë, me mirësinë e Tij. Ai është falës, mirënjohës.
31. Ç'të kumtuam nga Libri, është e vërteta që pohon shkrimet para tij. Zoti është për robtë e Vet i gjithëditur, largpamës.
32. Pastaj ua trashëgojmë Librin robve Tanë që zgjedhim. Ndër ta, ka të padrejtë të vetvetes, ka që ndjekin udhë të mesme dhe, me lejen e Zotit, që paraprijnë në vepra të mira. Kjo është mirësia e madhe.

33. Janë kopshtet e Edenit ku do të hyjnë të stolisur me byzylykë ari e margaritarë dhe të veshur në mëndafsh.
34. Dhe thonë: "Lavdi Zotit i Cili na largoi brengat! Zoti ynë është falës, mirënjohës.
35. Që, me mirësinë e Vet, na vendosi në banesën e përhershme ku s'na zë mundim e lodhje."
36. Mohuesit kanë zjarrin e skëterrës ku nuk u ekzekutohet vdekja, as u lehtësohet vuajtja. Kështu i shpërblejmë të pabesët.
37. Dhe thërrasin në ndihmë: "Zoti ynë, na nxirr të bëjmë të mira, jo siç kemi bërë!" A nuk ju dhamë jetë, të merrte në të mësim kush merr mësim? Dhe ju erdhi paralajmëruesi. Shijojeni, pra! Dhunuesit nuk kanë ndihmëtarë.
38. Zoti di të fshehtën e qiejve dhe të tokës. Ai është dijeplotë për vetë kraharorët.
39. Është Ai që ju bëri mëkëmbës në tokë. Kush mohon, e ka mohimin mbi vete. Nuk u shton mohuesve te Zoti mohimi i tyre, vetëm se urrejtje; nuk u shton mohuesve mohimi i tyre, vetëm se humbje.
40. Thuaj: "I shihni idhujt që lusni në vend të Zotit? Më tregoni, çfarë krijuan nga toka? Mos kanë pjesë në qiej? Apo u dhamë ndonjë libër dhe kanë provë? Ajo që i premtojnë dhunuesit njëri-tjetrit është vetëm se mashtrim.
41. Zoti mban qiejt e tokën të mos devijojnë; po të devijojnë, askush pas Tij s'mund t'i mbajë. Ai është i butë, falës.
42. U betuan në Zotin me be të fortë se, po t'u vinte profet, do të qenë më drejt nga çdo popull tjetër. Kur u erdhi profet, ua shtoi ikjen.

43. Me mendjemadhësi në tokë dhe plane të këqia. Por planet e këqia i zënë njerëzit që i bëjnë. Mos presin udhën e të parëve? Nuk do të gjesh këmbim në udhën e Zotit, nuk do të gjesh në udhën e Zotit ndryshim.
44. Nuk udhëtojnë në tokë të shohin si qe fundi i pararendësve? Ishin më të fuqishëm se ata. Zotin s'e pengon gjë në qiej e në tokë. Ai është dijeplotë, i plotpushtetshëm.
45. Po t'i merrte Zoti njerëzit me ç'fituan, s'do të linte gjallesë në sipërfaqen e saj, mirëpo i vonon deri në një afat të caktuar. Kur u vjen afati, Zoti është për robtë e Vet largpamës.

36. JA - SIN (JA-SÍN)

Periodha e Mekës, 83 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Ja, sin. (j, s)
2. Për Kuranin e Urtë,
3. ti je ndër të dërguarit
4. në udhë të drejtë!
5. Mesazh i të Plotfuqishmit, Mëshirëplotit.
6. Të paralajmërosh njerëz etërit e të cilëve nuk qenë paralajmëruar dhe janë të shkujdesur.
7. Është përligjur për të shumtët e tyre fjala, pra nuk besojnë.

8. U kemi vënë në qafë hallka që arrijnë deri në mjekër dhe janë kryepërpjetë.
9. Bëmë para tyre pengesë, edhe prapa pengesë, i mbuluam e nuk shohin.
10. Njësoj, i paralajmëron apo s'i paralajmëron, nuk besojnë.
11. Ti paralajmëron vetëm kë ndjek Kujtesën dhe i frikësohet Bamirësit-Rahman në të padukshmen. Përgëzoje me falje dhe shpërblim bujar.
12. Ne ngjallim të vdekurit dhe shkruajmë çfarë përgatitën, edhe gjurmët e tyre. Gjithçka e numërojmë në evidencë të qartë.
13. Jepu shembull banorët e qytezës kur u erdhën të dërguarit.
14. Dërguam tek ata dy dhe i përgënjeshtroan. I mbështetëm me një të tretë dhe thanë: "Ne jemi te ju të dërguar."
15. Thanë: "Ju jeni njerëz si ne. Bamirësi nuk ka zbritur gjë, porse jeni gënjeshtarë."
16. Thanë: "Zoti ynë e di që jemi të dërguar te ju.
17. Detyra jonë është fjala e qartë."
18. Thanë: "Me ju kemi ogur të keq. Po nuk ndaluat, do t'ju gjuajmë me gurë e t'ju zërë nga ne një dënim i hidhët."
19. Thanë: "Oguri i keq është me ju. Sepse u këshilluat? Ju jeni njerëz shpërdorues."
20. Erdhi nga anët e qytetit një burrë duke nxituar dhe tha: "Bashkëkombësit e mi, pasoni të dërguarit!"
21. Pasoni ata që s'po ju kërkojnë shpërblim dhe janë të udhëzuar.
22. Përse të mos adhuroj kë më krijoi dhe që tek Ai do të ktheheni?

23. Të marr në vend të Tij zota që, nëse Bamirësi-Rahman ma do të keqen, nuk do të më bënte dobi ndërhyrja e tyre, as më shpëtojnë?
24. Do të isha, pra, në gabim të hapur.
25. Unë besoj Zotin tuaj, më dëgjoni!”
26. Iu tha: “Hyr në parajsë!” Tha: “Sikur kombi im ta dinte
27. se im Zot më fali e më nderoi!”
28. Nuk zbritëm, pas tij, mbi kombin e vet ushtri nga qielli, as që do të zbrisnim.
29. Një krismë dhe u shuan.
30. Mjerë robtë! S’u erdhi i dërguar që të mos e tallnin.
31. Nuk shohin sa e sa brezni zhdukëm para tyre që nuk do t’u kthehen?
32. Të gjithë, së bashku, në Praninë Tonë do të dalin.
33. Dëshmi për ta është toka e vdekur: e përtërijmë, nxjerrim prej saj drithë dhe me të ushqehen.
34. Bëmë në të kopshte palmash e vreshtash dhe hapëm burime.
35. Për t’u ushqyer me frytet e tyre. S’i bënë ato duart e tyre. Nuk falënderojnë?
36. Madhëruar qoftë Ai që krijoi llojet, të gjitha, çfarë prodhon toka, ata vetë dhe të tjera që nuk i dinë!
37. Dëshmi për ta është nata; tërheqim prej saj ditën dhe, ja, ku mbesin në errësirë.
38. Edhe dielli lëviz në ciklin e vet. Ky është përcaktimi i të Plotfuqishmit, Dijeploitit.
39. Hënës i caktuam faza derisa kthehet e bëhet si degë e vjetër palme.
40. Dielli s’ia arrin hënës, as nata parakalon ditën. Secili noton në orbitë.
41. Dëshmi për ta është që bartëm gjeneratën e tyre në anijen e ngarkuar.

42. Në shembullin e saj, krijuam për ta mjete ku hypin.
43. Po të duam, i fundosim; nuk kanë kujt t'i thërrasin dhe nuk shpëtohen.
44. Vetëm si mëshirë prej Nesh dhe jetesë deri një kohë.
45. Kur u thuhet: "Kujdes të tashmen dhe të ardhmen që të mund të mëshiroheni", -
46. nuk u vjen dëshmi nga dëshmitë e Zotit pa qenë ndaj saj të shmangur.
47. Kur u thuhet: "Kontribuoni me ç'ju ka dhënë Zoti", - mohuesit u thonë besimtarëve: "Të ushqejmë dikë që, po të deshte Zoti, e kishte ushqyer? Ju jeni në gabim të hapur."
48. Dhe thonë: "Kur është ky premtim në thoni të vërtetën?"
49. Presin një krismë, t'i marrë duke kundërshtuar.
50. Pa lënë testament, as te njerëzit e tyre të kthehen.
51. I fryhet bririt dhe, nga varret, te Zoti i tyre derdhen.
52. Thonë: "Të mjerët ne! Nga shtretërit kush na ngriti?" "Ky është premtimi i Bamirësit që profetët pohuan."
53. Një krismë dhe, ja, të gjithë në Praninë Tonë dalin.
54. Sot nuk i bëhet kujt padrejtësi; me veprat tuaja shpërbleheni.
55. Banorët e parajsës, sot, në gjallëri gëzojnë.
56. Ata dhe bashkëshortet e tyre, hijeve, në frona të lartë mbështetur,
57. kanë fryte e ç'të kërkojnë.
58. "Paqe!" – fjalë nga Një Zot i Plotmëshirshëm.
59. "Veçohuni, sot, ju mëkatarë!
60. Nuk ju porosit, o bijtë e Ademit, djallin të mos adhuronit? Se ai është për ju armik i hapur?
61. Mua të më adhuronit, kjo është rrugë e drejtë?
62. Se ai gaboi prej jush shumë krijesa, a nuk e kuptoni?

63. Kjo është skëterra që u paralajmëruat.
64. Hyni sot në të sepse mohuat.”
65. Sot ua zëmë gojën; na flasin duart e tyre dhe u dëshmojnë këmbët për çka fituan.
66. Po të deshim, ua shuanim dritën e syve dhe do të nxitonin udhëve, por si mund të vështrojnë?
67. Po të deshim, i tjetërsonim në vendet e tyre dhe s’do të mund para e pas të shkonin.
68. Kujt i japim jetë, e kthejmë në krijim. A nuk kuptojnë?
69. S’ia mësuam atij poezinë dhe nuk i shkon. Kjo është kujtesë dhe një këndim i qartë,
70. të paralajmërojë kë është i gjallë. Mohuesve u është përligjur fjala.
71. Nuk shohin që krijuam për ta, me Dorën Tonë, kafshët që zotërojnë?
72. I nënshtroam për ta dhe barten e ushqehen prej tyre.
73. Kanë në to dobi dhe një burim ku pijnë. A nuk falënderojnë?
74. Marrin, veç Zotit, zota që t’i ndihmojnë.
75. Nuk i kanë për ndihmë ndërsa ata trupojë u rrinë.
76. Mos të të dëshpërojnë fjalët e tyre! Ne e dimë se ç’fshehin dhe çfarë zbulojnë.
77. Nuk sheh njeriu që e krijuam nga një pikë? Kur, ja, ai del kundërshtar i hapur.
78. Na bën krahasim dhe harron krijimin e tij. Thotë: “Kush i ngjall eshtrat kur të jenë kalbur?”
79. Thuaj: “I ngjall Ai që i ngriti herën e parë. Për çdo krijim Ai është i plotëditur.
80. Që bëri për ju nga druri i gjelbër zjarr dhe, ja, prej tij digjini.
81. Ai që krijoi qiejt e tokën, nuk ka fuqi si ato të krijojë? Po, Ai është Krijuesi i Madh, Dijeploti.

82. Kur do diçka, urdhëron e i thotë: “Ji!” – dhe ajo është.
83. Madhëruar qoftë Ai në Dorën e të Cilit është sundimi i çdo gjëje dhe që tek Ai ktheheni!

37. ATA QË NË RRESHTA JANË (ES-SAFFAT)

Periudha e Mekës, 182 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Për ata që në rreshta janë
2. dhe që me forcë tej shtyjnë;
3. për ata që një kujtesë lexojnë,
4. Zoti juaj Një i Vetëm është,
5. Zoti i qiejve e i tokës dhe mes tyre ç'është, Zoti i lindjeve!
6. E stolisëm qiellin e tokës me stolinë e yjeve
7. dhe mbrojtje nga çdo djall i prapë.
8. Nuk mund të përgjojnë në sferën e lartë dhe gjuhen nga çdo anë,
9. të përzënë, me dënim përjetë;
10. kë kap diçka, e ndjek një flakërimë e mprehtë.
11. Pyeti ata, mos janë më të vështirë në krijim nga ç'krijua? I krijua ata prej balte të mbrujtur.
12. Çuditësh që tallen
13. dhe, kur u bëhet kujtesë, nuk përmenden?
14. Në shohin një shenjë, kërkojnë të tallen.
15. Dhe thonë: “Kjo është magji e hapur.
16. Kur të vdesim e bëhemi pluhur e kocka, kemi për t'u ngritur?
17. Ne dhe etërit tanë të vjetër?”

18. Thuaj: "Po dhe të përulur."
19. Një thirrje dhe, ja, tek vështrojnë!
20. Dhe thonë: "Të mjerët ne, kjo është Dita e Gjykimit!"
21. "Kjo është Dita e Vendimit që përgënjeshtrojnë."
22. "Grumbulloni dhunuesit, palën e tyre e ç'adhuroni
23. në vend të Zotit. Drejtojini në udhën e ferrit!
24. Mbajini të pyeten."
25. "Ç'është me ju që s'po ndihmoni njëri-tjetrin?"
26. Jo, sot, ata janë plotësisht të nënshtruar.
27. Kthehen nga njëri-tjetri duke akuzuar.
28. Thonë: "Ju na zinit rrugën!"
29. Thonë: "Jo, por ju nuk besoni."
30. Ne s'patëm mbi ju pushtet, porse ishit njerëz të pabindur.
31. U përligj fjala e Zotit tonë dhe tani po e provojmë.
32. Ju gabuam dhe qemë të gabuar."
33. Atë ditë, në dënim janë bashkëpjesëtarë.
34. Kështu veprojmë me fajtorët.
35. Kur u thuhej: "S'ka zot veç Zotit", - ishin kryelartë.
36. Thonin: "T'i lëmë zotat tanë për një poet të marrë?"
37. Jo, ai erdhi me të vërtetën dhe vërtetoi profetët.
38. Ndërsa ju do të shijoni dënimin e hidhët.
39. Shpërbleheni me ç'punuat.
40. Përveç robërve të singertë të Zotit.
41. Ata kanë pjesë të njohur,
42. fryte dhe janë të nderuar,
43. në kopshtet e begata;
44. në frona, përkarshi,
45. u shkon qark një gotë burimi,
46. e pastër, për ata që e pijnë, me shije,
47. pa marramendje dhe nuk dehen;
48. pranë tyre, hyritë symëdha,

49. si inxhi të fshehtë.
50. Kthehen përballë njëri-tjetrit, bisedojnë.
51. Një folës thotë: "Kisha një mik
52. që thoshte: "Vërtet je nga ata që pohojnë
53. se, kur të vdesim e bëhemi pluhur e kocka, do të shpërblehemi?"
54. Thotë: "A vështroni?"
55. Vështroi dhe e pa atë në mes të ferrit.
56. Tha: "Për Zotin, gati më prishe edhe mua!
57. Të mos qe mirësia e tim Zoti, do të vija i fajësuar."
58. "Po ne, a s'do të vdesim?"
59. Veç vdekjes sonë të parë, s'do të dënohemi?"
60. Ja, kjo është fitorja e madhe.
61. Për këtë le të punojnë veprimtarët!
62. Kjo është gosti e mirë apo pema e Zekumit?
63. E bëmë atë provë për dhunuesit.
64. Një pemë që del nga fundi i ferrit,
65. sythet e saj si koka e djallit.
66. Hanë prej saj dhe mbushin barqet.
67. Më tej, pije uji të valët.
68. Fundi i tyre, në gropën e zjarrit.
69. I gjetën etërit të gabuar
70. dhe në gjurmët e tyre me nxitim shkuan.
71. Gabuan para tyre shumë nga të parët.
72. Dërguam te ata paralajmëruesit
73. dhe, shih si qe fundi i të paralajmëruarve!
74. Përveç robërve të sinqertë të Zotit.
75. Na thirri Nuhi, sa mirë iu përgjigjëm!
76. Atë dhe njerëzit e tij nga ankthi i madh i shpëtuan.
77. Pasardhësit e tij i bëmë vazhduesit.
78. Lamë për të te të mëvonshmit:
79. "Paqe në botë Nuhit!"

80. Kështu i shpërblejmë mirëbërësit.
81. Ishte ndër robtë Tanë, besimtarët.
82. Pastaj i mbytëm të tjerët.
83. Në vazhdën e tij, Ibrahim,
84. i erdhi Zotit me zemër të pastër.
85. Kur i tha të atit dhe kombit të tij: “Ç’po adhuroni?
86. Në vend të Zotit, zota të remë kërkoni?
87. Zotin e botëve si e mendoni?”
88. Hodhi një vështrim nga yjet
89. dhe tha: “Jam i pamundur.”
90. I kthyen shpinën e u larguan.
91. Shkoi te zotat e tyre dhe tha: “Nuk po hani?
92. Ç’është me ju që nuk flisni?”
93. Dhe me të djathtën i goditi.
94. Erdhën përballë tij duke nxituar.
95. Tha: “Po adhuroni diçka që gdhendni?
96. Zoti ju krijoi juve dhe çfarë bëni.”
97. Thanë: “Ngrini për të një stivë me dru, në zjarr hidheni!”
98. Ata ia bënë kurthin dhe Ne i poshtëruam.
99. Tha: “Unë po shkoj te im Zot, Ai të më drejtojë.
100. Zoti im, dhuromë një nga të mirët!”
101. Dhe Ne e përgëzuam me një djalë të urtë.
102. Kur arriti të ecte me të, i tha: “Biri im! Pashë në ëndërr se po të flijoja. Ti, ç’ke për të thënë?” Tha: “Baba, bëj siç je urdhëruar. Do të më gjes, dashtë Zoti, të duruar.”
103. Kur u falën dhe ai e shtriu përmbys,
104. i thirrëm: “O Ibrahim!
105. Ti e vërtetove ëndrrën. Kështu i shpërblejmë të drejtët.
106. Ja, pra, kjo është prova që duket!”

107. Dhe ia zëvendësuam me kurbanet.
108. Lamë për të te të mëvonshmit:
109. "Paqe Ibrahimit!"
110. Kështu i shpërblejmë mirëbërësit.
111. Ishte ndër robtë Tanë, besimtarët.
112. E gëzuam me Is'hakun, profet, ndër të mirët.
113. I bekuam atë dhe Is'hakun. Nga pasardhësit e tyre ka të mirë dhe të këqinj të vetvetes, hapur.
114. U bëmë nder Musait e Harunit.
115. Shpëtuam ata dhe kombin e tyre nga një brengë e madhe.
116. I ndihmuam dhe fituan.
117. U dhamë librin me sqarime.
118. Dhe i drejtuam në Udhë të Drejtë.
119. Lamë për ta te të mëvonshmit:
120. "Paqe Musait e Harunit!"
121. Kështu i shpërblejmë mirëbërësit.
122. Ishin ndër robtë Tanë, besimtarët.
123. Edhe Iljasi qe ndër të dërguarit,
124. kur i tha kombit të tij: "A nuk përmbaheni?
125. I luteni Baalit dhe lini Më të Mirin Krijues,
126. Allahun, Zotin tuaj dhe Zotin e etërve tuaj të vjetër?"
127. E përgënjeshtroan dhe janë të pranishëm.
128. Përveç robërve të singertë të Zotit.
129. Lamë për të te të mëvonshmit:
130. "Paqe Iljasit!"
131. Kështu i shpërblejmë mirëbërësit.
132. Ishte ndër robtë Tanë, besimtarët.
133. Edhe Luti qe ndër të dërguarit,
134. kur e shpëtuam bashkë me të tijët,
135. përveç një plake me të prapambeturit.
136. I rrënuam të tjerët.

137. Kaloni pranë tyre në mëngjes herët.
138. Dhe gjatë natës. Nuk e kuptonit?
139. Edhe Junusi qe ndër të dërguarit,
140. kur u arratis te anija e ngarkuar.
141. Hodhën short dhe doli i humbur.
142. E gëlltiti peshku të fajësuar.
143. Zotin të mos kishte madhëruar,
144. do të mbetej në barkun e tij deri ditën që ngrihen.
145. E hodhëm pa ndjenja në një vend të zbuluar
146. dhe bëmë ta mbulonte një bimë prej kungullit.
147. E dërguam te njëqint mijë a më shumë.
148. Besuan dhe u dhamë për një kohë jetë.
149. Pyeti, mos janë për tët Zot bijat e për ta bijtë?
150. Apo i krijuam engjëjt femra dhe ata e dëshmuan?
151. Nuk është trillim kur thonë:
152. "Zoti ka bërë djalë?" Vërtet, ata janë gënjeshtarë.
153. Zgjodhi bijat mbi bijtë?
154. Përse kështu gjykoni?
155. A nuk mendoni?
156. Mos keni ndonjë argument të qartë?
157. Sillni, pra, librin tuaj, të vërtetën në thoni.
158. Bëjnë lidhje mes Tij e xhinëve. Xhinët e dinë se do të jenë të pranishëm.
159. Madhëruar qoftë Zoti nga ç'i kanë cilësuar!
160. Por jo robtë e sinqertë të Zotit:
161. "Ju e ç'adhuroni,
162. nuk mund të tundoni,
163. veç atij që i përballet zjarrit.
164. Secili prej nesh ka një vend të njohur,
165. radhë-radhë të rreshtuar,
166. Zotin duke madhëruar."
167. Edhe pse thonin:

168. "Të kishim një kujtesë nga të parët,
169. do të qemë robtë e singertë të Zotit",
170. - e mohuan, por do ta mësojnë.
171. Fjala Jonë u parapriu robërve Tanë të dërguar.
172. Ata janë fitimtarët.
173. Ushtarët Tanë janë ngadhnjimarët.
174. Largohu prej tyre një kohë!
175. Shihi e ta shohin.
176. Për dënimin Tonë nxitojnë?
177. Kur u zbret te pragu, sa i keq mëngjesi i të
paralajmëruarve!
178. Largohu prej tyre një kohë!
179. Shihi e ta shohin.
180. Madhëruar qoftë yt Zot, Zoti i madhështisë nga ç'i
cilësojnë!
181. Paqe të dërguarve!
182. Lavdi Allahut, Zotit të botëve!

38. SAD (SAD)

Periudha e Mekës, 88 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Sad ("s"). Për Kuranin plot kujtesë!
2. Mohuesit janë kryelartë e në mospajtim.
3. Sa e sa brezni zhdukëm para tyre! Thirrën, por qe
vonë për shpëtim.
4. Bënë çudi që u erdhi paralajmërues mes tyre dhe
mohuesit thonë: "Ky qenka magjistari, një gënjeshtar.

5. I bëri zotat vetëm një zot? Diçka e paparë.”
6. Krerët deklaruan: “Vazhdoni të mbaheni te zotat tuaj! E bërë me qëllim.
7. Nuk e dëgjuam këtë në fenë e fundit. Është e krijuar.
8. I erdhi mes nesh atij mesazhi?” Jo, ata janë në mëdyshje rreth Mesazhit Tim. Akoma s’e kanë shijuar dënimin Tim.
9. Mos kanë thesaret e mëshirës së tët Zoti, të Plotfuqishmit, Dhuruesit të Madh?
10. Apo zotërojnë sundimin e qiejve dhe të tokës e ç’janë mes tyre? Le t’ia arrijnë, pra, qëllimit!
11. Një bandë klanesh atje e shpartalluar.
12. Përgënjeshtroan para tyre kombi i Nuhit, Adit dhe faraoni i kulmeve,
13. Themudi, kombi i Lutit dhe banorët e Ejkes. Ata qenë klanet.
14. Të gjithë përgënjeshtroan të dërguarit dhe u përligj ndëshkimi Im.
15. Edhe këta presin një krismë, pa u dhënë kohë.
16. Thonë: “O Zot, shpejtona fatin tonë para Ditës së Llogarisë!”
17. Duroji fjalët e tyre dhe kujto robin Tonë, Davudin e fuqishëm. Vërtet, ai qe pendimtar.
18. Nënshtruam malet të thurnin me të lavde mbrëmje e mëngjes.
19. Edhe shpendët, në tufë, i ktheheshin atij.
20. Ia forcuam sundimin, i dhamë urtësinë dhe gjykimin e drejtë.
21. A ke dijeni për paditësit kur erdhën papritur në altar?
22. Kur hynë përballë Davudit dhe ai u tut? Thanë: “Mos ki frikë! Ne jemi paditës të njëri - tjetrit. Gjyko mes

nesh me të vërtetën, mos u shmang, por udhëzونا drejt.

23. Ky vëllai ka nëntëdhjetë e nëntë dele, unë, vetëm një dele. Tha: “Ma ngarko mua!” Dhe më mundi në fjalë.”
24. Tha: “Ai nuk veproi drejt duke të kërkuar delen tënde te delet e tij. Shumë ortakë i bëjnë padrejtësi njëritjetrit. Përveç atyre që besojnë e bëjnë të mira, por ata janë të paktë.” Davudi e kuptoi që e vumë në provë, i kërkoi falje Zotit, ra me përulje dhe u pendua.
25. Ne ia falëm dhe ai ka pranë Nesh afërsi e një vendkthim të mirë.
26. “O Davud! Ne të bëmë mëkëmbës në tokë, pra gjyko mes njerëzve me të vërtetën dhe mos ndiq pasionin, të të largojë nga Rruga e Zotit. Cilët i largohen Rrugës së Zotit, kanë dënim të rreptë pasi harruan Ditën e Llogarisë.”
27. Nuk i krijuam më kot qiellin e tokën dhe ç’janë mes tyre. Ashtu mendojnë mohuesit. Mjerë mohuesit prej zjarrit!
28. Apo t’i trajtojmë ata që besojnë e bëjnë të mira si keqbërësit në tokë dhe të devotshmit si mëkatarët?
29. Është një libër i bekuar që e zbritëm tek ty të shqyrtojnë dëshmitë e tij dhe të meditojnë të mençurit.
30. Davudit i dhuruam Sulejmanin. Ç’rob i mirë! Vërtet ai qe pendimtar.
31. Në mbrëmje, kur i dolën përpara kuajt e garës,
32. tha: “Pëlqeva pasionin e së mirës para se t’i falem tim Zotit!” Derisa ra nata.
33. “Kthejini te unë!” Dhe zuri t’i prekte nga këmbët e qafa.
34. E vumë Sulejmanin në provë dhe e lamë në fron si trup. Pastaj u pendua.

35. Tha: "Im Zot, më fal! Dhuromë një sundim të paarritshëm pas meje! Ti je Dhuruesi."
36. Ia nënshtruam erën, të lëvizte me urdhrin e tij, lehtë, atje ku deshte.
37. Edhe djajtë, si ndërtues e zhytës,
38. të tjerët, lidhur në pranga.
39. Ja dhurata Jonë, të japësh e të mbash pa masë.
40. Ka për të, pranë Nesh, afërsi dhe një vendkthim të mirë.
41. Përmende robin Tonë Ejubin kur i thirri Zotit: "Më ka zënë djalli me vuajtje e mundim!"
42. "Rrihe tokën me këmbë! Ja një burim i ftohtë, për t'u larë e për të pirë."
43. Ia kthjem si dhuratë familjen, po aq me të, mëshirë prej Nesh dhe kujtesë për të mençurit.
44. "Merr një dorë bar, qëllo dhe mos e thyej betimin." E gjetëm atë durimtar. Ç'rob i mirë! Vërtet ai pendohej.
45. Përmendi robtë Tanë, Ibrahimin, Is'hakun dhe Jakubin, me fuqi e largpamje.
46. I veçuam në përkushtimin e së ardhmes.
47. Ata janë pranë Nesh ndër të zgjedhurit dhe më të mirët.
48. Përmendi Ismailin, Eljesanë e Dhul Kiflin. Secili ishte ndër më të mirët.
49. Kjo është kujtesë. Të devotshmit kanë vendkthim të mirë.
50. Kopshtet e Edenit me portat hapur.
51. Të mbështetur, kërkojnë shumë fryte e pije.
52. Pranë tyre, virgjëreshat moshatare.
53. "Ja ç'u premtuat për Ditën e Llogarisë!
54. Të mirat Tona janë të pashtera."
55. Ja, pra. Ndërsa tiranët kanë vendkthimin më të keq.

56. Skëterrën ku do të digjen, ç'shtrat i keq!
57. Këtë. Dhe le ta shijojnë! Ujë të valë e rrjedhë plagësh.
58. Dhe të tjera si ato.
59. "Ja një turmë që po kridhet bashkë me ju! Pa mirëseardhje. Në zjarr do të digjet."
60. Thonë: "Nuk jeni të mirëpritur. Këtë, ju na i përgatitët. Ç'vend i keq!"
61. Thonë: "O Zot, kujt na i bëri këtë, dyfishoja dënimin në zjarr!"
62. Thonë: "Përse nuk po shohim ca burra që i quanim të këqij?"
63. I morëm me tallje apo syri jonë s'arrin t'i shohë?"
64. Kjo është e vërtetë: banorët e zjarrit debatojnë.
65. Thuaj: "Unë jam vetëm paralajmërues. S'ka zot veç Zotit, Një të Vetmit, Nënshtruesit,
66. Zotit të qiejve dhe të tokës e ç'janë mes tyre, të Plotfuqishmit, Falësit."
67. Thuaj: "Ky është një lajm i madh.
68. Ju jeni larg tij.
69. Unë nuk jam në dijeni të Këshillit të Lartë kur diskuton.
70. M'u kumtua se jam vetëm një paralajmërues i qartë."
71. Kur yt Zot u tha engjëjve: "Unë po krijoj njeriun prej balte;
72. kur ta kem formuar e t'i fryj nga Shpirti Im, bini për të në tokë me përlulje,"
73. - u përlulën engjëjt të gjithë bashkë.
74. Përrjashtuar Iblisit; u mburr dhe që ndër mohuesit.
75. Tha: "O Iblis! Ç'të pengoi t'i përulësh atij që krijova me Duart e Mia? Deshe të mburresh apo je ndër të lartët?"

76. Tha: "Unë jam më i mirë prej tij. Mua më krijove nga zjarri dhe e krijove atë prej balte."
77. Tha: "Dil së andejmi, je i mallkuar.
78. Mallkimi Im bie mbi ty deri Ditën e Gjykimit."
79. Tha: "Im Zot, më jep afat deri Ditën e Ringjalljes."
80. Tha: "Ti je nga ata me afat,
81. deri ditën e kohës së caktuar."
82. Tha: "Për Nderin Tënd! Do t'i mashtroj të gjithë.
83. Përveç robërve Tuaj të sinqertë."
84. Tha: "E vërteta është dhe Unë them të vërtetën
85. se do ta mbush skëterrën me ty dhe ndjekësit e tu bashkë."
86. Thuaj: "Nuk po ju kërkoj për këtë shpërblim, as ju detyroj.
87. Kjo është për botët kujtesë.
88. Dhe do ta mësoni lajmin e saj një kohë.

39. GRUPET (EZ-ZUMER)

Periudha e Mekës, 75 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Shpallja e Librit është nga Zoti, i Plotfuqishmi, i Urti.
2. Ne të kemi zbritur Librin me të vërtetën, pra, adhuro Zotin, me besim thjesht për Të.
3. A nuk është besimi thjesht për Zotin? Cilët marrin zota në vend të Tij, thonë: "I adhurojmë që të na afrojnë pranë Zotit." Zoti do të gjykojë mes tyre se ku janë në kundërshti. Zoti nuk drejton gënjeshtarë e mosmirënjohës.

4. Po të deshte Zoti të merrte bir, do të zgjidhte kë dëshiron ndër krijesat e Tij. Madhëruar qoftë! Zoti është Një i Vetmi, Nënshtruesi.
5. Krijoi qiejt e tokën me të vërtetën, mbështjell ditën me natën dhe mbështjell natën me ditën, nënshtroi diellin dhe hënën: secili lëviz në afat të caktuar. A nuk është Ai i Plotfuqishmi, Falësi?
6. Ju krijoi nga një frymë e vetme dhe bëri prej saj palën; solli për ju, ndër bagëtitë, tetë, në çifte (devetë, lopët, delet e dhitë); ju krijoi në barqet e nënave, krijim pas krijimi, në tri shtresa. Ky është Allahu, Zoti juaj të Cilit i përket sundimi. S'ka zot veç Tij. Ku shkoni?
7. Nëse mohoni, Zoti s'ka nevojë për ju, por nuk i pëlqen mohimi i robërve të Tij. Në falënderoni, është i kënaqur me ju. Nuk bart një bartës barrën e tjetrit. Pastaj i ktheheni Zotit tuaj dhe ju njofton për veprat. Ai është dijeplotë për vetë kraharorët.
8. Kur njeriu bie në vështirësi, i lutet Zotit i penduar; sapo i jep një të mirë, harron kë luti më parë dhe i bën Zotit të barabartë për të larguar nga Rruga e Tij. Thuaj: "Jeto pak me mohimin tënd. Vërtet, ti je ndër banorët e zjarrit."
9. Mos është dikush që, me bindje të plotë, lutet gjatë natës, përmbys e më këmbë, i druhet së ardhmes dhe shpreson mëshirën e Zotit? Thuaj: "A barazohen të diturit me të paditurit?" Të mençurit meditojnë.
10. Thuaj: "Robtë e Mi besimtarë, kini frikë Zotin! Kush bën mirë në këtë botë, gjen mirë. Toka e Zotit është e gjerë. Durimtarëve u plotësohet shpërblimi pa masë.
11. Thuaj: "Unë u urdhërova të adhuroj Zotin me besim thjesht për Të.
12. U urdhërova të jem i pari musliman."

13. Thuaj: "Në i kundërshtoj tim Zoti, i frikësohem dënimit të një dite të madhe."
14. Thuaj: "Unë adhuroj Zotin me besim thjesht për Të."
15. "Ju adhuroni, pra, ç'të dëshironi në vend të Tij!" Thuaj: "Të humbur janë ata që humbin veten dhe familjet e tyre Ditën e Ringjalljes. A nuk është kjo humbja e dukshme?"
16. Ata kanë nga lart e poshtë shtresa zjarri. Zoti frikëson me to robtë e Vet: "Robtë e Mi, frikësomuni Mua!"
17. Sihariq për ata që i largohen adhurimit të djallit dhe kthehen te Zoti të penduar. Përgëzoji, pra, robtë e Mi,
18. që dëgjojnë fjalën dhe ndjekin më të mirën e saj. Janë ata që drejtoi Zoti. Ata janë të mençurit.
19. Ti do të shpëtosh nga zjarri kë meriton fjalën e dënimit?
20. Përkundrazi, cilët i frikësohen Zotit, kanë dhoma të ngritura njëra mbi tjetrën ku rrjedhin, ndër to, lumenj. Premtim i Zotit. Zoti nuk e shkel premtimin.
21. Nuk vështron se si Zoti zbret nga qielli ujë dhe e përcjell burimeve në tokë? Nxjerr me të bimësi shumëngjyrëshe, pastaj ajo thahet dhe e sheh të zverdhur, pastaj e bën byk. Këtu ka kujtesë për të mençurit.
22. Mos është dikush që Zoti ia hapi zemrën për Islam, në dritë nga Zoti i tij? Mjerë ata zemrat e të cilëve janë të ngurta në të përmendurit e Zotit! Këta janë në gabim të qartë.
23. Zoti zbriti fjalën më të bukur, një libër me krahasime e përsëritje. U drithërohet trupi atyre që i frikësohen Zotit, pastaj u qetësohen trupi e zemra në të përmendurit e Zotit. Ky është drejtimi i Zotit. Drejton atë që do. Kë humb Zoti, s'ka kush ta drejtojë.

24. Mos është dikush që ruan fytyrën e vet nga e keqja e dënimit Ditën e Ringjalljes? Dhunuesve u thuhet: “Shijoni çfarë fituat!”
25. Përgënjeshtroan para tyre dhe u erdhi dënimi nga s’e kuptuan.
26. Zoti i bëri të shijonin poshtërim në këtë botë ndërsa dënimi i së ardhmes është më i madh sikur ta dinin.
27. Sollëm në këtë Kuran për njerëzit lloj-lloj shembujsh që të mund të mendohen.
28. Një këndim në arabisht, pa shtrembërime, që ata të mund të përmbahen.
29. Zoti sjell shembull një njeri ku ka pjesëtarë në mosmarrëveshje dhe një njeri në paqe me një njeri; a janë njësoj? Falënderimi i takon Zotit, por të shumtët nuk dinë.
30. Ti je i vdekshëm, edhe ata, të vdekshëm.
31. Pastaj, Ditën e Ringjalljes, bëni debat në prani të Zotit tuaj.
32. Kush është më i padrejtë se ai që gënjen për Zotin dhe përgënjeshtroi të vërtetën kur i erdhi? A nuk ka në skëterrë vend për mohuesit?
33. Cilët vijnë me të vërtetën dhe e pohojnë atë, ata janë të devotshmit.
34. Kanë pranë Zotit të tyre ç’të dëshirojnë. Ky është shpërblimi i mirëbërësve.
35. Që Zoti t’ua mbulojë të këqiat që kanë bërë dhe t’i shpërblejë me më të mirën e veprës së tyre.
36. Nuk i mjafton Zoti robit të Vet? Duan të të frikësojnë me të tjerë në vend të Tij. Kë lë Zoti të gabojë, s’ ka kush ta drejtojë.
37. Kë drejton Zoti, s’ka kush ta gabojë. Nuk është Zoti i plotfuqishëm, i zoti i hakmarrjes?

38. Në i pyet: “Kush krijoi qiejt e tokën?” – do të thonë: “Zoti.” Thuaj: “E kuptoni që, çfarë lusni në vend të Zotit, nëse Zoti ma do të keqen, a mund të ma largojnë të keqen e Tij? Në më do mëshirë, a mund ta mbajnë mëshirën e Tij?” Thuaj: “Mua më mjafton Zoti. Atij le t'i mbështeten ata që mbështeten!”
39. Thuaj: “Kombi im! Ju veproni nga pozitat tuaja. Unë po veproj. Dhe do ta mësoni,
40. se kujt i vjen një dënim që e poshtëron dhe i zbret dënim që vazhdon.”
41. Ne të shpallëm Librin për njerëzit me të vërtetën. Kush udhëhiqet drejt, e ka për vete; kush shkon në rrugë të gabuar, ka gabuar për vete. Ti nuk je për ta dorëzanës.
42. Zoti merr shpirtat kur vdesin dhe që nuk kanë vdekur e janë në gjumë. Mban kë ka vendosur të vdesë dhe lë të tjerët deri në afat të caktuar. Këtu ka dëshmi për njerëzit që mendojnë.
43. Apo marrin ndërmjetës në vend të Zotit? Thuaj: “Edhe pse nuk zotërojnë gjë e s'kuptojnë?”
44. Thuaj: “Zotit i përket plotësisht ndërmjetësimi. Atij i takon sundimi i qiejve e i tokës dhe ktheheni tek Ai.”
45. Kur përmendet Zoti Një, atyre që nuk besojnë në të ardhmen u prishet zemra dhe, kur përmenden të tjerë në vend të Tij, ja tek gëzohen!
46. Thuaj: “O Zot, Krijuesi i qiejve dhe i tokës, Njohësi i së padukshmes e të dukshmes! Ti gjykon mes robërve të Tu se ku janë në kundërshti.”
47. Sikur dhunuesit të kishin krejt ç'ka në tokë, edhe po aq, s'do të mund të shpërblenin të keqen e dënimit Ditën e Ringjalljes. U del nga Zoti ç'nuk e mendojnë.

48. U dalin të këqiat që fituan dhe i zë ajo me të cilën u tallën.
49. Kur njeriu bie në vështirësi, Na thërret; kur i dhurojmë një të mirë nga ana Jonë, thotë: "M'u dha me dijen time." Jo, është provë, por të shumtët nuk dinë.
50. Kështu thanë edhe më parë, por s'u vlejti çfarë fituan.
51. I zunë të këqiat që fituan. Edhe dhunuesve ndër këta do t'u bien të këqiat që fituan dhe s'mund të shpëtojnë.
52. Nuk e dinë se Zoti ia zgjeron të mirat atij që do ose ia kufizon? Këtu ka dëshmi për njerëzit që besojnë.
53. Thuj: "Robtë e Mi (robtë e Zotit), shpërdorues të vetvetes! Mos i prisni shpresat nga mëshira e Zotit! Zoti i fal mëkatet, të gjitha. Ai është Falësi, Mëshirëploti.
54. Kthejuni Zotit të penduar dhe dorëzojuni Atij para se t'ju vijë dënimi e të mos ndihmoheni.
55. Ndiqni shembullin e mirë që erdhi nga Zoti juaj para se t'ju vijë dënimi papritmas e pakuptuar
56. dhe të thotë dikush: "Mjerë unë që nënvleftësova detyrën ndaj Zotit dhe u talla!"
57. Ose të thotë: "Po të më drejtonte Zoti, do të isha i devotshëm."
58. Ose, kur të shohë dënimin, të thotë: "Sikur të më përsëritej, do të isha bamirës."
59. Po! Të erdhën dëshmitë e Mia dhe i përgënjeshtrova, u mburre dhe u bërë mohues.
60. Ditën e Ringjalljes, i sheh ata që gënjejnë ndaj Zotit me fytyra të nxira. A nuk ka në skëterrë vend për mendjemëdhenjtë?
61. Zoti i nxjerr faqebardhë ata që përmbahen. Nuk i prek e keqja, as dëshpërohen.

62. Zoti është krijuesi i çdo gjëje, Ai është në çdo gjë dorëzanës.
63. Atij i takojnë çelësat e qiejve dhe të tokës. Cilët mohojnë dëshmitë e Zotit, ata janë të humburit.
64. Thuaj: “O të paditur, po më urdhëroni të adhuroj dikë tjetër në vend të Zotit?”
65. U kumtua tek ty dhe tek ata para teje se, po i bëre Zotit shok, ka dështuar vepra jote dhe je i humbur.
66. Përkundrazi, adhuro Zotin dhe ji mirënjohës.
67. Nuk e vlerësojnë drejt Zotin. Ditën e Ringjalljes, toka është e tëra në grusht të Tij dhe qiejt mbështjellë në Dorën e Tij. I madhëruar dhe i lartë nga ç'i shoqërojnë!
68. I fryhet bririt dhe, përveç atij që do Zoti, bien vdekur ç'janë në qiej e në tokë. I fryhet edhe një herë dhe, ja, tek ngrihen e presin.
69. Ndriçon toka me Dritën e Zotit të saj, hapet Libri, vijnë profetët e dëshmitarët dhe vendoset mes tyre me të vërtetën e nuk u bëhet padrejtësi.
70. Secilit i plotësohet puna e tij. Ai ua di mirë veprat.
71. Përcillen mohuesit grupe-grupe në skëterrë. Kur arrijnë, hapen portat dhe u thonë rojat: “A nuk ju erdhën mes jush të dërguar, t'ju recitojnë dëshmitë e Zotit dhe t'ju paralajmërojnë për takimin e kësaj dite?” Thonë: “Po.” Mirëpo mohuesit merituan fjalën e dënimit.
72. Thuhet: “Hyni përgjithmonë në portat e ferrit! Sa i keq vendbanimi i mendjemëdhenjve!
73. Ata që iu frikësuan Zotit përcillen grupe-grupe në parajsë. Kur arrijnë, hapen portat dhe u thonë rojat: “Paqja qoftë me ju! E bëtë mirë. Hyni përgjithmonë në të!”

74. Thonë: "Lavdi Zotit që e mbajti premtimin dhe na i trashëgoi tokën, të banojmë ku të duam në parajsë!"
Sa i mirë shpërblimi i veprimtarëve!
75. I sheh engjëjt t'i shkojnë Fronit për rreth duke i thurë lavde Zotit. Vendoset mes tyre me të vërtetën dhe thuhet: "Lavdi Allahut, Zotit të botëve!"

40. FALËSI (GAFIR)

Periudha e Mekës, 85 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Ha, mim.
2. Shpallja e Librit është nga Zoti, i Plotfuqishmi, Dijeploti,
3. Falësi i mëkatit dhe Pranuesi i pendimit, i ashpër në dënim, Zoti i Bujarisë. S'ka zot veç Tij. Fundi është tek Ai.
4. Vetëm mohuesit kundërshtojnë dëshmitë e Zotit. Mos të të mashtrorjë lëvizja e tyre nëpër vende!
5. Përgënjeshtroan më parë kombi i Nuhit dhe grupimet më pas. Çdo popull u përpoq ta pengonte profetin e vet; kundërshtuan me të pavërtetën për të hedhur poshtë të vërtetën. I mora dhe si qe ndëshkimi Im?
6. U përligj kështu fjala e tët Zoti për mohuesit se ata janë banorët e zjarrit.
7. Bartësit e Fronit dhe përreth i thurin lavde Zotit, e besojnë dhe kërkojnë falje për besimtarët: "Zoti ynë që përfshin çdo gjë me mëshirë e dije, fali ata që janë

- penduar dhe ndjekin Rrugën Tënde, ruaji nga dënimi i zjarrit!
8. Zoti ynë, futi kopshteve të Edenit të cilat ua premtove atyre dhe etërve, bashkëshorteve e pasardhësve të tyre të mirë. Ti je i Plotfuqishmi, i Urti.
 9. Ruaji nga të këqiat! Kë ruajte nga të këqiat e asaj dite, e ke mëshiruar. Ky është sukcesi i madh."
 10. U thirrret mohuesve: "Mëria e Zotit qe më e madhe nga mëria juaj ndaj vetes kur u ftuat në besim dhe mohuat."
 11. Do të thonë: "Zoti ynë! Na bëre të vdesim dy herë e na dhe jetë dy herë. I pranojmë mëkatet tona. A ka rrugëdalje?"
 12. "Ja, kështu. Kur u thirr Zoti Një, mohuat; në i bëhej shok, besonit. Vendimi i takon Zotit, të Lartit, Madhështorit."
 13. Është Ai që jua tregon dëshmitë e Tij dhe zbret për ju ushqim nga qielli. Meditojnë vetëm pendimtarët.
 14. Pra, thirrni Zotin me besim thjesht për Të edhe pse e urrejnë mohuesit.
 15. Zoti i Pushtetit Më të Lartë nis Shpirtin me urdhrin e Tij mbi atë që do ndër robtë e Vet, për të paralajmëruar Ditën e Takimit,
 16. ditën kur dalin në shesh dhe nuk mund t'i fshihet gjë Zotit. Kujt i takon sot sundimi? Zotit, Një të Vetmit, Nënshtruesit.
 17. Sot, secili shpërblehet me ç'fitoi. Nuk ka, sot, padrejtësi. Zoti bën vlerësim të shpejtë.
 18. Paralajmëroju ditën e afërt kur zemrat e tronditura vijnë në fyt. Dhunuesit nuk kanë mik e ndërmjetës që të dëgjohet.
 19. Ai di ç'tradhtojnë sytë e çfarë fshehin zemrat.

20. Zoti vendos me të vërtetën; ç'lusin në vend të Tij, nuk vendosin gjë. Zoti është Dëgjuesi, Largpamësi.
21. Nuk udhëtojnë në tokë të shohin si qe fundi i pararendësve? Ishin më të fuqishëm dhe me gjurmë në tokë; Zoti i mori me mëkatet e tyre dhe s'patën ndaj Zotit mbrojtës.
22. Sepse u erdhën të dërguarit me prova të qarta, mohuan dhe Zoti i dënoi. Ai është i fuqishëm, ka ndëshkim të rreptë.
23. Dërguam Musanë me dëshmitë Tona dhe argument të qartë,
24. te faraoni, Hamani e Karuni. Thanë: "Një magjibërës, gënjeshtar!"
25. Ndërsa ai u erdhi me të vërtetën prej Nesh, ata thanë: "Vritni bijtë e besimtarëve me të dhe lini gjallë gratë e tyre!" Por plani i mohuesve shkoi më kot.
26. Faraoni tha: "Më lini ta vras Musanë dhe le të thërrasë Zotin e tij! Druaj se mos ndryshon fenë tuaj a sjell mosmarrëveshje në tokë."
27. Musai tha: "Mbrohem me tim Zot dhe Zotin tuaj nga çdo tiran që nuk beson Ditën e Llogarisë!"
28. Një burrë besimtar nga njerëzit e faraonit, që e pati mbajtur fshehur besimin e vet, tha: "Të vrisni një njeri pse thotë: "Im zot është Zoti", - ndërsa ju erdhi me prova të qarta nga Zoti juaj? Në është gënjeshtar, gënjeshtër i rëndon atij; në është i singertë, ju zë paralajmërimi i tij. Zoti nuk drejton një shpërdorues e gënjeshtar.
29. Kombi im! Sot ju keni sundimin, triumfues në tokë, por kush do të na ndihmojë nëse vjen fuqia e Zotit?" Faraoni tha: "Unë po ju tregoj opinionin tim. Dhe ju udhëheq në rrugën e arsyes."

30. Besimtari tha: "Kombi im! Unë i frikësohem për ju shembullit të ditës së grupimeve,
31. sikurse ndodhi me kombin e Nuhit, Adit, Themudit e më pas. Zoti nuk do padrejtësi për robtë.
32. Kombi im! I frikësohem për ju Ditës së Thirrjes,
33. kur ktheheni në ikje dhe nuk gjeni dikë që t'i bëjë ballë Zotit. Kë humb Zoti, nuk ka kush ta drejtojë.
34. Ju erdhi më parë Jusufi me prova të qarta, por mbetët në dyshim rreth misionit të tij dhe, vetëm kur ai vdiq, thatë: "Zoti nuk do të na dërgojë profet pas tij." Kështu, Zoti bën të humbur shpërdoruesit dhe të pabindurit.
35. E madhe është urrejtja te Zoti dhe besimtarët për ata që kundërshtojnë dëshmitë e Zotit pa u ardhur ndonjë argument. Zoti vë, kështu, vulë në zemrat kryeneçëve dhe tiranëve."
36. Faraoni tha: "O Haman! Ndërtomë një kullë të arrij rrugët,
37. udhët e qiejve dhe të vështroj te Zoti i Musait. Unë e quaj atë gënjeshtar." Iu zbukurua faraonit e keqja e veprës së tij dhe nuk gjeti udhë. Plani i faraonit shpinte në humbje.
38. Besimtari tha: "Kombi im! Ndiqmëni, t'ju udhëheq rrugës së arsyes.
39. Kombi im! Jeta e kësaj bote është kalimtare; e ardhmja është banesa e përhershme.
40. Kush bën keq, shpërblehet me të; cilët bëjnë mirë, mashkull a femër, si besimtarë, hyjnë në parajsë ku u jepen të mira të pallogaritshme.
41. Kombi im! Unë po ju ftoj në shpëtim, përse më ftoni në zjarr?

42. Më ftoni të mohoj Zotin dhe t'i bëj shok me padije ndërsa unë ju ftoj te i Plotfuqishmi, Falësi i Madh.
43. Më ftoni, pa dyshim, atje ku s'ka ftesë në këtë botë dhe në të ardhmen. Kthimi ynë është te Zoti. Shpërdoruesit, ata janë banorët e zjarrit.
44. Do ta kujtoni ç'po ju them. Çështjen time ia besoj Zotit. Zoti është largpamës për robtë."
45. Zoti e ruajti nga të këqiat që i përgatitën ndërsa familjen e faraonit e zuri dënimi më i keq.
46. Zjarri që i përballen mëngjes e mbrëmje. Ditën kur vjen ora: "Futeni familjen e faraonit në dënimin më të rreptë!"
47. Kur bëjnë debat në zjarr, të pafuqishmit u thonë tiranëve: "Ne erdhëm pas jush. A mund të na mbani një pjesë zjarri?"
48. Tiranët do të thonë: "Ne të gjithë jemi në të. Zoti ka vendosur mes robërve."
49. Ata të zjarrit u thonë rojave të skëterrës: "Luteni Zotin të na lehtësojë një ditë nga dënimi."
50. Thonë: "A s'ju erdhën të dërguarit me prova të qarta?" Thonë: "Po." Thonë: "Lutuni, pra!" Lutja e mohuesve shkon në humbje.
51. Ne do t'i ndihmojmë të dërguarit Tanë e besimtarët në këtë botë dhe ditën kur dalin dëshmitarët.
52. Ditën kur dhunuesve nuk u bën dobi shfajësimi. Ata kanë mallkim dhe vendin më të keq.
53. I dhamë Musait drejtimin dhe ua trashëguam bijve të Izraelit librin,
54. udhëzim e kujtesë për të mençurit.
55. Ti duro! Sepse premtimi i Zotit është i vërtetë. Kërko falje për mëkatin tënd dhe thuri lavde tët Zoti mbrëmje e mëngjes.

56. Cilët kundërshtojnë dëshmitë e Zotit, pa u ardhur ndonjë argument, kanë në gjokset e tyre madhështi që s'ia arrijnë. Pra, kërko mbrojtje te Zoti sepse Ai është Dëgjuesi, Largpamësi.
57. Krijimi i qiejve dhe i tokës është më i madh nga krijimi i njeriut, por të shumtët e njerëzve nuk dinë.
58. Nuk barazohen i verbri me kë sheh, as ata që besojnë e bëjnë të mira me një keqbërës. Ju pak mendoheni.
59. Ora, pa dyshim, po vjen, mirëpo të shumtët e njerëzve nuk besojnë.
60. Zoti juaj thotë: "Thirr mëni, t'ju përgjigjem. Cilët tregohen mendjemëdhenj në adhurimin Tim, do të hyjnë në skëterrë, të poshtëruar."
61. Zoti është Ai që jua bëri natën të pushoni në të dhe ditën për të parë. Zoti është i mirësisë ndaj njerëzve, por të shumtët e njerëzve nuk falënderojnë.
62. Ky është Allahu, Zoti juaj, Krijuesi i çdo gjëje. S'ka zot veç Tij. Ku ikni?
63. Ikin ata që refuzojnë dëshmitë e Zotit.
64. Zoti është Ai që jua bëri tokën banim dhe qiellin ngrehinë, ju dha formën më të bukur dhe ju ushqen me të mira. Ky është Allahu, Zoti juaj. Bekuar qoftë Allahu, Zoti i botëve!
65. Ai është i Gjalli, s'ka zot veç Tij, pra thirreni me besim thjesht për Të. Lavdi Allahut, Zotit të botëve!
66. Thuaj: "Unë u ndalova të adhuroj çfarë lusni në vend të Zotit përderisa më erdhën prova të qarta nga im Zot. U urdhërova t'i dorëzohem Zotit të botëve."
67. Është Ai që ju krijoi nga toka, pastaj nga një pikëz, pastaj nga një gjak i trashë; ju nxjerr foshnjë, arrini pastaj pjekurinë dhe bëheni të moshuar. Ka prej jush

- që Ai i bën të vdesin më parë dhe arrini një afat të caktuar. Ndoshta e kuptoni.
68. Është Ai që jep jetë e vdes. Kur merr vendim, thotë vetëm: "Ji!" dhe është.
69. Nuk ke parë nga ata që kundërshtojnë dëshmitë e Zotit se si shpërndahen?
70. Që përgënjeshtrojnë Librin dhe të dërguarit Tanë me të? Por do ta dinë.
71. Kur në qafat e tyre të kenë pranga e zinxhirë, hiqen zvarrë,
72. në ujë të valë, pastaj digjen në zjarr.
73. U thuhet: "Ku janë çfarë shoqëronit
74. në vend të Zotit? Thonë: "U përvdirën prej nesh. Jo, nuk kemi lutur gjë më parë." Kështu, Zoti i lë të humbur mohuesit.
75. "Sepse u vetëkënaqët dhe u mburrët me pa të drejtë në tokë.
76. Hyni, përgjithmonë, në portat e skëterrës! Sa i keq vendbanimi i kryeneçëve!"
77. Ti duro sepse premtimi i Zotit është i vërtetë. Edhe në të bëjmë të shohësh ç'u kemi paralajmëruar a të vdesim, te Ne do të kthehen.
78. Dërguam të dërguar para teje. Për disa të rrëfyem dhe për disa nuk të kemi rrëfyer. Nuk i takon një profeti të sjellë dëshmi pa lejen e Zotit. Kur vjen urdhri i Zotit, vendoset me të vërtetën dhe humbasin të rremët.
79. Zoti jua bëri kafshët shtëpiake për ngarkesë dhe ushqim.
80. Keni në to dobi: arrini nëpërmjet tyre një qëllim dhe barteni mbi to e në anije.

81. Dhe ju tregon dëshmitë e Tij. Pra, cilën dëshmi të Zotit mohoni?
82. S'kanë udhëtuar në tokë të shohin si qe fundi i pararendësve? Ishin më shumë se ata, më të fuqishëm dhe me gjurmë në tokë, por nuk u vlejti ç'fituan.
83. Kur u erdhën të dërguarit me prova të qarta, u vetëkënaqën me dijen e tyre dhe i zuri ajo me të cilën u tallën.
84. Kur panë Fuqinë Tonë, thanë: "Besojmë Zotin Një dhe mohojmë çfarë i shoqëronim."
85. Por nuk u vlejti besimi përballë Fuqisë Sonë. Është Udhë e Zotit kaluar te robtë e Tij. Dhe humbën atje mohuesit.

41. DËSHMITË E SHTJELLUARA (FUSSILET)

Periudha e Mekës, 54 ajete
Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Ha, mim.
2. Shpallje e Bamirësit, Mëshirëplotit.
3. Libër, dëshmitë e të cilit u shtjelluan, një këndim në arabisht për njerëzit që kuptojnë.
4. Përgëzues dhe paralajmërues, por të shumtët e tyre shmangen e nuk dëgjojnë.
5. Thonë: "Zemrat tona janë të mbyllta atje ku na fton, veshët tona të shurdhta dhe mes nesh ka perde, pra, ti vepro dhe ne veprojmë."

6. Thuaj: “Unë jam njeri si ju; m’u kumtua se Zoti juaj është Një Zot, pra, drejtojuni Atij dhe kërkojini falje.” Mjerë idhujtarët,
7. që nuk bëjnë bamirësi dhe mohojnë të ardhmen!
8. Ata që besojnë e bëjnë të mira kanë shpërblim të pandërprerë.
9. Thuaj: “Mohoni kë krijoi tokën në dy ditë dhe i bëni të barabartë? Ai është Zoti i botëve.”
10. Krijoi në sipërfaqen e saj formacione të qëndrueshme, e begatoi dhe shpërndau në të, sipas nevojave, mjetet e jetesës, në katër ditë.
11. Pastaj iu përqendrua qiellit që ishte tym dhe u tha atij e tokës: “Ejani me dashje a pa dashje!” Thanë: “Vijmë me dashje.”
12. I bëri ato, në dy ditë, shtatë qiej dhe kumtoi te secili qiell rendin e vet. E stolisëm qiellin më të afërt me kandilë dhe si mbrojtje. Ky është përcaktimi i të Plotfuqishmit, Dijeploitit.
13. Në shmangen, thuaj: “Ju paralajmëroj me një rrufe si rrufeja te adët e themudët.
14. Kur u erdhën të dërguarit, para e pas, që të adhuronin vetëm Zotin, thanë: “Po të deshte Zoti, do të na kishte zbritur engjëj. Ne e mohojmë misionin tuaj.”
15. Adët u bënë pa të drejtë kryelartë në tokë dhe thanë: “Kush është më i fuqishëm se ne?” Nuk shohin se Zoti që i krijoi ata është më i fuqishëm? Dhe refuzuan dëshmitë Tona.
16. U dërguam një erë të vrullshme, ditëve ogurzeza, për t’i bërë të shijonin dënimin poshtërues në këtë botë ndërsa dënimi i së ardhmes është më i mjerueshëm dhe nuk do të përkrahen.

17. Sa për themudët, i udhëzuam, por ata pëlqyen verbimin para udhëzimit. I mori, si rrjedhojë, rrufeja e një dënimi poshtërues.
18. I shpëtua ata që besuan dhe u ruajtën.
19. Ditën kur armiqtë e Zotit tubohen drejt zjarrit, janë në radhë.
20. Me të arritur, u dëshmojnë veshët, sytë e lëkura se ç'kanë bërë.
21. I thonë lëkurës: “Përse dëshmon kundër nesh?”
Thotë: “Zoti më bëri të flas, Ai që bën të flasë çdo gjë. Ai ju krijoi së pari dhe i ktheheni Atij.
22. Nuk e mbulonit dot veten nga dëshmia kundër jush e veshëve, syve dhe lëkurës, por menduat se Zoti nuk di shumë nga punët tuaja.
23. Ky mendim për Zotin ju prishi dhe dolët të humbur.”
24. Në durojnë, zjarri është vendbanimi i tyre; në duan t'u bëhet lëshim, nuk u pranohet.
25. I lamë me ca shokë që ua hijeshonin të tashmen e të ardhmen dhe merituan fjalën të bashkësitë e kaluara të xhinëve e njerëzve se ata janë të humbur.
26. Mohuesit thonë: “Mos ia vini veshin Kuranit, por bëni zhurmë që ta mbytni.”
27. Do t'i bëjmë mohuesit të shijojnë dënim të rreptë dhe t'i shpërblejmë me më të keqen e asaj që bënë.
28. Ja shpërblimi i armiqve të Zotit, zjarri! Aty kanë banesën e përjetësisë si shpërblim që refuzuan dëshmitë Tona.
29. Mohuesit do të thonë: “Zoti ynë, na i trego xhinët e njerëzit që na gabuan, t'i vëmë ndër këmbë e t'i poshtërojmë!”
30. Atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu” dhe janë të vendosur, u zbresin engjëjt: “Mos u frikësoni e

dëshpëroni! Merrni lajmin e gëzuar të parajsës së premtuar!

31. Ne jemi kujdestarët tuaj në jetën e kësaj bote dhe në të ardhmen. Keni në të ç'të dëshironi e të kërkoni.
32. Pritje nga një Falës, Mëshirëplotë.”
33. Kush është më i mirë në fjalë se ai që fton te Zoti, bën vepra të mira dhe thotë: “Unë jam musliman?”
34. Nuk barazohen e mira me të keqen. Mbrohu me të mirën dhe armiku yt të bëhet mik.
35. Ia arrijnë kësaj durimtarët, ia arrijnë ata me fat të madh.
36. Në të nxit djalli, mbrohu me Zotin. Ai është Dëgjuesi, Dijeploti.
37. Ndër dëshmitë e Tij janë nata e dita, dielli dhe hëna. Mos iu përujti diellit dhe hënës, por përujuni Zotit që i krijoi po qe se vetëm Atë adhuron.
38. Në tregohen mendjemëdhenj, ata pranë tët Zoti e lëvdojnë Atë natë e ditë dhe nuk mërzhiten.
39. Ndër dëshmitë e Tij, sheh tokën shterp dhe, kur zbresim në të ujë, gjallërohet e bëhet pjellore. Kush i jep asaj jetë, ngjall edhe të vdekurin. Ai është mbi gjithçka pushtetplotë.
40. Cilët bëjnë shtrembërime në dëshmitë Tona, nuk mund të na fshihen. Dikush që hidhet në zjarr, më mirë apo që vjen i sigurt Ditën e Ringjalljes? Ju veproni si të doni. Ai ju sheh se ç'bëni.
41. Në mohojnë kujtesën që u erdhi, është një libër i nderuar.
42. Nuk i shkon e pavërteta, sot e në të ardhmen. Shpallje nga një i Urtë, i Lëvdur.
43. Çfarë të thuhet ty, u është thënë të dërguarve para teje. Yt Zot ka falje dhe ndëshkim të hidhur.

44. Po ta bënim atë një këndim në gjuhë të huaj, do të thonin: “Përse nuk na u shpjeguan dëshmitë e tij? I huaj dhe një arab?” Thuaj: “Për besimtarët është drejtim e shërim. Mosbesimtarët kanë në veshë shurdhim; për ta, ai është verbim. Ata janë larg thirrjes.”
45. I dhamë Musait Librin, por pati në të mosmarrëveshje. Të mos qe një fjalë e parathënë nga yt Zot, do të vendosej mes tyre. Ata janë në mëdyshje rreth tij, skeptikë.
46. Kush bën mirë, e ka për vete; kush bën keq, ia bën vetes. Yt Zot nuk është i padrejtë me robtë.
47. Te Ai kthehet dija e Orës. Nuk del fryt nga membrana e vet, as bart e lind një femër pa dijen e Tij. Ditën që u thërret: “Ku janë shoqëruesit e Mi? – do të thonë: “Të deklarojmë se nuk ka ndër ne që të dëshmojë.”
48. Humbasin prej tyre çfarë lusnin më parë dhe e besojnë se s’kanë shteg.
49. Njeriu nuk mërzhitet së kërkuari të mira. Në e zë e keqja, dëshpërohet e shkurajohet.
50. Kur e bëjmë të shijojë nga ana Jonë mëshirë, pasi ra në vështirësi, do të thotë: “Më takon. Nuk besoj se do të vijë ora. Por, edhe sikur të kthehem te im zot, kam pranë tij më të mirën.” Sigurisht, do t’i njoftojmë mohuesit për veprat e tyre dhe do t’i bëjmë të shijojnë dënim të rreptë.
51. Kur i japim njeriut të mira, shmanget e rri mënjanë; kur e zë e keqja, bën lutje të gjatë.
52. Thuaj: “E kuptoni që, duke qenë nga Zoti dhe ju e mohoni, kush është më i gabuar se ai në mospajtim të thellë?”

53. Ne do t'ua tregojmë dëshmitë Tona në horizonte dhe veten e tyre derisa t'u bëhet e qartë e vërteta. Nuk mjafton yt Zot, dëshmuës mbi çdo gjë?
54. Mos janë në dyshim rreth takimit me Zotin? A nuk ka përfshirë Ai gjithçka?

42. KËSHILLIMI (ESH-SHURA)

Periudha e Mekës, 53 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Ha, mim.
2. Ajn, sin, kaf. (h,m; a,s,k)
3. Ja, kështu. Të kumton ty dhe atyre para teje, Zoti, i Plotfuqishmi, i Urti.
4. Atij i takojnë ç'janë në qiej e në tokë. Ai është i Larti, Madhështori.
5. Gati sa s'çahen mbi ta qiejt ndërsa engjëjt i thurin lavde Zotit dhe lypin falje për ata në tokë. A nuk është Zoti Falësi, Mëshirëploti?
6. Zoti i vëzhgon ata që marrin në vend të Tij mbrojtës dhe ti nuk je mbi ta rojë.
7. Kështu, të kumtuam një këndim në arabisht, të paralajmërosh Mëmën e Vendbanimeve dhe rrethinat e saj dhe të paralajmërosh Ditën e Tubimit ku s'ka dyshim: një palë në parajsë, një palë në zjarr.
8. Po të deshte Zoti, i bënte një bashkësi, por fut në Mëshirën e Vet atë që do. Dhunuesit nuk kanë mbrojtës e përkrahës.

9. Marrin në vend të Tij mbrojtës? Zoti është Mbrojtësi. Ai ngjall të vdekurin dhe është mbi gjithçka pushtetplotë.
10. Ku jeni në kundërshti, gjykimi është te Allahu: “Ja, ky është Allahu, im zot. Atij i mbështetem dhe kthehem tek Ai i penduar.”
11. Krijuesi i qiejve dhe i tokës. Bëri për ju, nga ju vetë, çifte, edhe te kafshët, çifte. Në to ju shton. Nuk ka në shembullin e Tij gjë. Ai është Dëgjuesi, Largpamësi.
12. Atij i përkasin çelësat e qiejve dhe të tokës. I shtrin të mirat me dashjen e Vet dhe i kufizon. Ai është për gjithçka dijeplotë.
13. Parashtroi për ju fenë që ia porositi Nuhit dhe ta kumtuam ty, që ua porositëm Ibrahimit, Musait dhe Isait: “Zbatoni fenë e mos u përçani!” E rëndë është për idhujtarët ftesa juaj. Zoti zgjedh te Ai atë që do dhe drejton tek Ai kë kthehet i penduar.
14. U përçanë vetëm pasi u erdhi dija, nga keqdashja mes tyre. Të mos qe një fjalë e parathënë nga yt Zot, në afat të caktuar, do të vendosej mes tyre. Ata që trashëguan Librin më pas janë në dyshim rreth tij, skeptikë.
15. Pra, fto dhe ji i vendosur siç je urdhëruar. Mos ndiq dëshirat e tyre, por thuaj: “Unë besoj në librin që zbriti Zoti dhe u urdhërova për drejtësi mes jush. Allahu është Zoti ynë dhe Zoti juaj. Për ne janë veprat tona dhe për ju, veprat tuaja. Nuk ka polemikë mes nesh. Zoti do të na mbledhë të gjithëve dhe fundi është tek Ai.”
16. Cilët kundërshtojnë te Zoti pasi Atij i është përgjigjur, argumenti i tyre s’ka vlerë pranë Zotit. Kanë mbi vete zemërim dhe dënim të rreptë.

17. Zoti është Ai që zbriti Librin me të vërtetën e drejtpeshimin. Ku ta dish, ndoshta Ora është afër?
18. Ata që nuk e besojnë duan të shpejtohet, por, cilët besojnë, shqetësohen për të dhe e dinë se është e vërteta. A s'janë në gabim të thellë ata që vënë në dyshim Orën?
19. Zoti është i butë me robtë; ushqen me dashjen e Tij. Ai është i Forti, i Plotfuqishmi.
20. Kujt dëshiron prodhimin e së ardhmes, ia shtojmë prodhimin; kujt dëshiron prodhimin e kësaj bote, i japim prej tij, por nuk ka pjesë në të ardhmen.
21. Mos kanë bashkëpjesëmarrës që ua ligjëruan ndonjë fe pa lejen e Zotit? Të mos qe fjala e vendimit, do të ishte kryer mes tyre. Dhunuesit kanë dënim të hidhët.
22. I sheh dhunuesit të shqetësuar si rrjedhojë e veprave të tyre dhe ajo do t'u ndodhë. Ata që besojnë e bëjnë të mira janë në lëndinat e parajsës, me ç'të dëshirojnë pranë Zotit të tyre. Kjo është mirësia e madhe.
23. Kështu i përgëzon Zoti robtë e Vet që besojnë e bëjnë të mira. Thuaj: "Nuk po ju kërkoj për të shpërblim, por dashuri mes njëri-tjetrit." Kujt fiton një të mirë, i shtojmë të mirë në të. Zoti është falës, mirënjohës.
24. Apo thonë: "Sajoi ndaj Zotit gënjeshtër?" Po të deshte Zoti, ta mbyllte zemrën. Me fjalët e Tij, Zoti asgjëson të pavërtetën dhe vërteton të vërtetën. Ai është dijeplotë për vetë kraharorët.
25. Është Ai që pranon pendimin nga robtë e Vet, fal të këqiat dhe jua njuh veprat.
26. U përgjigjet atyre që besojnë e bëjnë të mira dhe ua shton me Mirësinë e Vet. Mohuesit kanë dënim të rreptë.

27. Sikur Zoti t'ua zgjeronte të mirat robërve të Tij, do të rebelonin në tokë, por zbret me masë atë që do. Ai është në dijeni dhe largpamës për robtë e Vet.
28. Është Ai që zbret shiun kur ata s'kanë shpresë dhe shtrin Mëshirën e Tij. Ai është Kujdestari, i Lëvduari.
29. Ndër dëshmitë e Tij është krijimi i qiejve e i tokës dhe gjallesave që ka përhapur në to, që, në dashtë, ka fuqi t'i bashkojë.
30. Ç'e keqe ju bie, është e bërë me duart tuaja, por Ai fal shumë.
31. Ju nuk jeni çudibërës në tokë dhe nuk keni, veç Zotit, kujdestar e përkrahës.
32. Ndër dëshmitë e Tij janë anijet si male në det.
33. Po të dojë, qetëson erën e mbesin në ujë. Këtu ka dëshmi për çdo durimtar e mirënjohës.
34. Ose i shkatërron si rrjedhojë e veprës së tyre, por Ai fal shumë.
35. Ta dinë ata që kundërshtojnë dëshmitë Tona se nuk kanë shteg.
36. Ç'ju është dhënë, është mjet jetese në këtë botë; ç'është pranë Zotit, është më e mirë dhe e qëndrueshme për ata që besojnë dhe te Zoti i tyre mbështeten;
37. që u mënjanojnë mëkateve të mëdha e paudhësive dhe, kur zemërohen, falin;
38. që i përgjigjen Zotit, falen, këshillohen mes tyre dhe kontribuojnë nga ç'u kemi dhënë;
39. që, kur u bëhet dhunë, vetëmbrohen.
40. Ndëshkimi i së keqes është me të keqe si ajo; kush fal e pajton, shpërblimin e ka te Zoti. Ai nuk i do dhunuesit.

41. Nuk ka udhë kundër atyre që, pas dhunës, vetëmbrohen.
42. Ka udhë kundër atyre që dhunojnë njerëzit dhe ushtrojnë me pa të drejtë tirani në tokë. Ata kanë dënim të hidhët.
43. Të durosh e të falësh, kjo është ndër çështjet vendimtare.
44. Kë lë Zoti të gabojë, nuk ka kujdestar pas Tij. I vëren dhunuesit tek shohin dënimin, të thonë: “A ka udhë kthimi?”
45. Do t'i shohësh t'i përballen të mjeruar nga poshtërimi duke hedhur ndonjë vështirim të fshehtë. U thonë besimtarët: “Të humbur janë ata që humbën veten dhe familjet e tyre. A nuk janë dhunuesit në dënim të përhershëm?”
46. Nuk kanë veç Zotit kujdestarë që t'i ndihmojnë. Kë lë Zoti të gabojë, s'ka për të udhë.
47. Përgjigjijuni Zotit para se të vijë prej Zotit një ditë pa kthim, kur nuk ka për ju, atë ditë, strehim dhe nuk ka për ju refuzim.
48. Në shmangen, nuk të dërguam mbi ta rojë. Detyra jote është fjala. Kur e bëjmë njeriun të shijojë prej Nesh mëshirë, vetëkënaqet; kur i bie një e keqe që ia bënë duart, njeriu është vërtet mosmirënjohës.
49. Zotit i takon sundimi i qiejve dhe i tokës. Krijon me dashjen e Tij. I dhuron atij që do femra dhe i dhuron atij që do meshkuj.
50. Ose i përzien meshkuj e femra dhe lë, kë do, shterp. Ai është dijeplotë, i plotpushtetshëm.
51. Zoti nuk i flet njeriut ndryshe, por me frymëzim ose pas ndonjë perdeje ose dërgon të dërguar dhe

- kumton, me lejen e Tij, atë që do. Ai është i Lartë, i Urtë.
52. Kështu, frymëzuam drejt teje një shpirt me Urdhrin Tonë. Ti nuk e dije ç'janë libri dhe besimi, por Ne e bëmë atë dritë; drejtojmë me të kë duam ndër robtë Tanë dhe ti po udhëheq në udhë të drejtë,
53. udhës së Zotit të Cilit i përkasin ç'janë në qiej e në tokë. Te Zoti përfundojnë çështjet.

43. STOLIA (EZ-ZUHRUF)

Periudha e Mekës, 89 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Ha, mim.
2. Për Librin e Qartë!
3. E bëmë atë një këndim në arabisht që të mund të kuptoni.
4. Pranë Nesh, në Librin Mëmë, është i lartë, i urtë.
5. Ta largojmë prej jush Kujtesën si komb shpërdorues?
6. Dërguam sa e sa profetë tek të parët!
7. Nuk u erdhi profet që të mos e tallnin.
8. Zhdukëm më të fuqishëm se ata dhe kaloi shembulli i të parëve.
9. Në i pyet: "Kush krijoi qiejt e tokën?"- do të thonë: "I krijoi i Plotfuqishmi, Dijeploiti."
10. Që ju bëri tokën shtrat dhe bëri për ju shtigje në të që të mund të orientoheni.

11. Që zbret nga qielli ujë me masë. Përtërijmë me të një truall pa jetë. Ja, kështu do të dilni.
12. Që krijoi llojet, të gjitha dhe bëri për ju anije e kafshë ku barteni;
13. të hipni në shpinën e tyre dhe, kur të keni zënë vend, të përmendni të mirën e Zotit e të thoni: "Madhëruar qoftë Ai që na i nënshtroi këto se ne nuk do të kishim qenë të aftë!
14. Vërtet te Zoti ynë kthehem."
15. I bëjnë Atij, ndër robtë e Vet, pjesë. Njeriu është mohues i hapur.
16. Mos merr nga krijesat e Tij bija dhe zgjodhi për ju bij?
17. Kur ndonjëri prej tyre përgëzohet me ç'i bëjnë shembull Bamirësit-Rahman, nxihet në fytyrë e dëshpërohet:
18. "Kë rritet e brishtë e jo për luftë?"
19. I bëjnë engjëjt, robtë e Bamirësit-Rahman, femra. Mos ishin dëshmue në krijimin e tyre? U shkruhet dëshmia dhe do të merren në pyetje.
20. Thonë: "Po të deshte Bamirësi-Rahman, nuk i adhuronim." S'kanë dije për këtë, por gënjejnë.
21. Mos u dhamë ndonjë libër para tij që t'i mbahen?
22. Jo, por thonë: "I gjetëm etërit tanë në një udhë dhe, në gjurmët e tyre, ecim."
23. Kështu, nuk dërguam para teje lajmëtar në ndonjë vend dhe krerët e tij të mos thonin: "I gjetëm etërit tanë në një udhë dhe, ne, gjurmët e tyre ndjekim."
24. Thoshte: "Edhe në ju erdha me drejtim më të mirë nga ç'i gjetët etërit tuaj?" Thonin: "Ne nuk e besojmë misionin tuaj."
25. U hakmorëm dhe shih si qe fundi i përgënjeshtresve!

26. Kur Ibrahim i tha të atit dhe kombit të tij: “Unë jam i çliruar nga adhurimi juaj,
27. vetëm kë më krijoi e që më drejton”,
28. - e bëri atë një fjalë të lënë te pasardhësit që të mund të ndryshonin.
29. Edhe këtyre dhe etërve të tyre u dhashë jetë sa u erdhi e vërteta dhe një i dërguar i qartë.
30. Kur u erdhi e vërteta, thanë: “Kjo është magji dhe ne e mohojmë.”
31. Thanë: “Përse nuk i zbriti Kurani një njeriu të madh nga dy qytetet (Mekë e Taif)?”
32. Ata e ndajnë mëshirën e tët Zoti? Ne i ndajmë mjetet e jetesës në jetën e kësaj bote dhe ngrejme në pozitë disa mbi të tjerë për të marrë në shërbim njëri-tjetrin. Por, mëshira e tët Zoti është më e mirë nga ç'grumbullojnë.
33. Sikur njerëzit të mos ishin një bashkësi, mohuesve të Bamirësit-Rahman do t'ua bënim shtëpitë me çati argjendi, edhe shkallët ku ngjiten,
34. edhe dyert e shtëpive, edhe fronat ku mbështeten.
35. Edhe stoli prej ari. Të gjitha këto janë pajisje të jetës së kësaj bote; e ardhmja pranë tët Zoti është për të devotshmit.
36. Cilët janë të verbër në përmendjen e Bamirësit-Rahman, atyre ua bëjmë djallin shok.
37. U zë udhën dhe kujtojnë se janë drejt.
38. Kur vijnë te Ne, i thonë: “Ah sikur të mos piqeshim kurrë! Ç'shok i keq!”
39. Sot nuk ju vlen që dhunuat. Jeni në dënim bashkëpjesëtarë.
40. Ti bën shurdhin të dëgjojë apo drejton të verbrin dhe të humburin?

41. Edhe po të të largojmë ty, ndaj tyre hakmerremi.
42. Ose të bëjmë të shohësh çfarë u paralajmëruam. Ne jemi mbi ta të pushtetshëm.
43. Prandaj, mbahu te ç' t'u kumtua sepse ti je në rrugë të drejtë.
44. Ajo është kujtesë për ty dhe kombin tënd. Dhe do të merreni në pyetje.
45. Pyeti ata që u dërguam të dërguarit Tanë para teje: "Mos caktuam përveç Bamirësit-Rahman zota që të adhurohen?"
46. Dërguam Musanë me dëshmitë Tona te faraoni dhe paria e tij. Dhe tha: "Unë jam i dërguari i Zotit të botëve."
47. Kur u solli dëshmitë Tona, qeshën me to.
48. U treguam dëshmi, njëra më e madhe se tjetra dhe i ndëshkuam që të mund të ndryshonin.
49. Thanë: "O magjistar, lute për ne tët Zot sipas besës me ty! Do të kthehemi në udhë të drejtë."
50. Me t'ua hequr dënimin, thyen besën.
51. Faraoni i thirri kombit të vet dhe tha: "Kombi im! A s'janë nën sundimin tim Egjipti dhe këta ujëra që rrjedhin poshtë meje? Nuk vështroini?"
52. Apo nuk jam më i mirë nga ky i mjerë që mezi shprehet?
53. Përse s'iu dhanë atij byzylykë ari ose të vinin me të engjëjt shoqërues?"
54. Ia mori mendjen popullit dhe ai iu bind. Ishte popull mëkatar.
55. Kur Na zemëruan, morëm hak dhe i mbytëm të gjithë.
56. I bëmë përvojë e së kaluarës dhe shembull për të tjerët.

57. Kur u mor si shembull biri i Merjemit, kombi yt ngriti zërin.
58. Thanë: "Më mirë zotat tanë apo ai?" Ta sollën për polemikë, si njerëz kundërshtues.
59. Ai ishte vetëm një rob. Ne e bekuam dhe e bëmë shembull për bijtë e Izraelit.
60. Po të donim, bënim në vendin tuaj engjëjt mëkëmbës në tokë.
61. "Me të vërtetë, ai (Isai a.s.) është dije për Orën, mos dyshoni rreth saj, por ndiqmëni! Kjo është udhë e drejtë.
62. Të mos ju pengojë djalli. Ai është për ju armik i hapur."
63. Kur Isai u solli provat, tha: "Unë ju erdha me urtësinë dhe t'ju sqaroj ku ratë në kundërshti. Përmbajuni Zotit dhe bindmuni!
64. Allahu është im Zot dhe Zoti juaj. Adhuronit Atë! Kjo është rrugë e drejtë."
65. Por palët ranë kundërshti. Mjerë dhunuesit nga dënimi i një dite të hidhët!
66. Presin t'u vijë ora papritur e pakuptuar?
67. Atë ditë miqtë bëhen për njëri-tjetrin armiq. Por jo të devotshmit.
68. "Robtë e Mi, s'ka frikë për ju sot dhe nuk dëshpëroheni."
69. Ata që besuan në dëshmitë Tona dhe ishin muslimanë.
70. "Hyni në kopshte të lumtur, ju dhe bashkëshortet tuaja!"
71. U vijnë përqark me tabaka e kupa floriri dhe ka atje ç'të dëshirojë shpirti e të kënaqet syri. "Jeni në to të përhershëm.

72. Kjo është parajsa që trashëguat me veprën tuaj!
73. Keni aty fryte të shumta prej të cilave ushqeheni"
74. Fajtorët janë të përhershëm në dënimin e ferrit.
75. Nuk u lehtësohet dhe janë në të të dëshpëruar.
76. Nuk u bëmë padrejtësi, por ishin ata të padrejtët.
77. Thërrasin: "Rojë, le t'i japë fund me ne yt Zot!" Thotë:
"Aty do të mbeteni.
78. Ju sollëm të vërtetën, por të shumtët tuaj e urrejnë të
vërtetën."
79. Mos po vendosin ndonjë çështje? Ne vendosim.
80. Apo pandehin se Ne nuk i dëgjojmë sekretet dhe
bisedat e tyre? Sigurisht, lajmësit Tanë, pranë tyre,
mbajnë shënim.
81. Thuaj: "Po të kishte Bamirësi-Rahman bir, unë do të
isha i pari adhures."
82. Madhëruar qoftë Zoti i qiejve dhe i tokës, Zoti i
Pushtetit nga ç'i përshkruajnë!
83. Le të merren me biseda të kota e të luajnë derisa të
arrijnë ditën që u paralajmëruan.
84. Ai është Zot në qiell dhe Zot në tokë, i Urti, Dijeploiti.
85. Bekuar qoftë Ai që ka sundimin e qiejve dhe të tokës
e ç'janë mes tyre! Pranë Tij është dija e Orës dhe tek
Ai ktheheni.
86. Ç'lusin në vend të Tij, nuk zotërojnë ndërmjetësimin.
Vetëm ata që dëshmojnë me dije të vërtetën.
87. Në i pyet: "Kush i krijoi ata?" – do të thonë: "Zoti." Pra,
ku ikin?
88. Është fjala e tij (të dërguarit): "O Zot! Këta janë njerëz
që nuk besojnë."
89. Fali dhe thuaj: "Paqe!" Pa do ta mësojnë.

44. TYMI (ED-DUKHAN)

Periodha e Mekës, 59 ajete
Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Ha, mim.
2. Për Librin e Qartë!
3. E zbritëm atë një natë të bekuar. Ne paralajmërojmë.
4. Ndahet në të çdo çështje e urtë.
5. Dekret nga ana Jonë. Ne dërgojmë të dërguar.
6. Mëshirë nga yt Zot. Ai është dëgjues, dijeplotë.
7. Zoti i qiejve dhe i tokës e ç'ka mes tyre në jeni të bindur.
8. S'ka zot veç Tij; Ai ngjall e vdes, Zoti juaj dhe Zoti i etërve tuaj të hershëm.
9. Por ata luhaten andej-këtej në dyshim.
10. Prit ditën kur qielli të sjellë një tym të dukshëm.
11. Që i mbulon njerëzit. Ky është dënim i hidhur.
12. "O Zot, largona dënimin se kemi besuar!"
13. Si u kujtuan tek u erdhi hapur i dërguar?
14. I kthyen shpinën dhe thanë: "Një i mësuar, i çmendur!"
15. "Ne jua largojmë pak dënimin dhe ju riktheheni.
16. Ditën që ushtrojmë fuqinë e madhe, hakmerremi."
17. Vumë para tyre në provë kombin e faraonit kur i erdhi i dërguar fisnik:
18. "M'i lini robtë e Zotit! Jam tek ju i dërguar besnik.
19. Mos ngrini krye kundër Zotit! Unë ju erdha me argument të qartë.
20. Kërkoj mbrojtjen e tim Zoti dhe Zotit tuaj në më gjuani me gurë.
21. Mos më besofshi, më lini mënjane."
22. I thirri Zotit: "Këta janë një popull fajtor."

23. "Nisu natën me robtë e Mi! Jeni në ndjekje.
24. Lëre detin të qetë. Ata janë hordhi në mbytje."
25. Lanë pas kopshte e burime,
26. ara dhe troje të dashura,
27. një jetë të begatë ku ishin të lumtur.
28. Ia trashëguam kështu një populli tjetër.
29. Nuk qanë për ta qielli e toka dhe nuk u lanë në pritje.
30. I shpëtua bijtë e Izraelit nga dënimi që i poshtëronte.
31. Prej faraonit. Ai qe tiran, një shpërdorues.
32. I zgjodhëm ata, mbi popujt, me dije.
33. U dhamë dëshmitë e një përvoje të qartë.
34. Ja, këta po thonë:
35. "Një herë vdesim e nuk dalim në jetë.
36. Sillni etërit tanë në jeni të vërtetë!"
37. Mos janë më të mirë nga kombi Tubba (në Jemen) dhe ata më parë? I zhdukëm si fajtorë.
38. Nuk krijuam qiejt, tokën dhe gjithçka mes tyre për lojë.
39. I krijuam me të vërtetën, por të shumtët nuk dinë.
40. Dita e Vendimit, një kohë e caktuar për të gjithë.
41. Dita kur nuk i vlen miku mikut dhe nuk janë për ndihmë.
42. Vetëm në mëshirë të Zotit. Ai është i plotfuqishëm, mëshirëplotë.
43. Pema e ferrit,
44. ushqimi i mëkatarit,
45. si bakër i shkrirë që zien nëpër barqe,
46. si ujë i valë.
47. "Merreni dhe shtyjeni në mes të zjarrit!
48. Pastaj, derdhjani mbi kokë dënimin me ujë të valë.
49. Shijoje, pra, ti, o i plotfuqishmi, fisniku!
50. Ja, kjo që dyshonit!"

51. Të devotshmit janë në vend të qetë,
52. në kopshte e burime,
53. veshur me mëndafsh e kadife, njëri-tjetrit përkarshi.
54. Kështu, pra, i bashkojmë me hyritë.
55. Kërkojnë atje lloj-lloj fryti, në paqe e siguri.
56. Pas vdekjes së parë, nuk provojnë atje vdekje. I ruajti Ai prej dënimit të zjarrit.
57. Mirësi nga yt Zot. Kjo është e madhja fitore!
58. E bëmë atë të lehtë në gjuhën tënde që të mendohen.
59. Prit! Edhe ata po presin.

45. GJUNJËZIMI (EL XHATHIJE)

Periudha e Mekës, 37 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Ha, mim.
2. Shpallja e Librit është nga Zoti, i Plotfuqishmi, i Urti.
3. Në qiej e tokë ka dëshmi për besimtarët.
4. Edhe në krijimin tuaj dhe të gjallesave që Ai ka shpërndarë, ka dëshmi për njerëzit që binden.
5. Në ndërrimin e natës e të ditës, në ushqimin që Zoti zbret nga qielli dhe përtërin me të tokën e vdekur dhe në qarkullimin e erërave, ka dëshmi për njerëzit që kuptojnë.
6. Këto janë dëshmitë e Zotit. Po t'i recitojmë me të vërtetën. Pas Zotit dhe dëshmive të Tij, në ç'fjalë besojnë?
7. Mjerë shpifësit mëkatarë!

8. Që dëgjojnë t'u recitohen dëshmitë e Zotit dhe vazhdojnë me mendjemadhësi si të mos i kenë dëgjuar. Jepu lajmin e një dënimi të hidhur.
9. Edhe kur mësojnë diçka nga dëshmitë Tona, e marrin me tallje. Për ta ka një dënim poshtërues.
10. Pas tyre është skëterra. Nuk do t'u vlejë fitimi, as miqtë në vend të Zotit. Dhe kanë dënim të madh.
11. Ky është drejtim. Cilët mohojnë dëshmitë e Zotit, kanë si dënim një ndëshkim të hidhur.
12. Zoti është Ai që nënshtroi për ju detin, të lundrojnë në të anijet me urdhrin e Tij, të kërkonin mirësitë e Tij dhe që të mund të falënderoni.
13. Nënshtroi për ju ç'janë në qiej e në tokë, të gjitha prej Tij. Këtu ka dëshmi për njerëzit që mendojnë.
14. Thuaju besimtarëve, le t'i falin ata që nuk presin ditët e Zotit, kur Ai i shpërblen njerëzit sipas veprave.
15. Kush bën mirë, e ka për vete; kush bën keq, ia bën vetes. Pastaj, te Zoti juaj ktheheni.
16. U dhamë bijve të Izraelit librin, gjykimin e profetësinë; i pajisëm me të mira dhe i dalluam në botë.
17. U dhamë atyre prova të qarta rreth çështjes, por ranë në kundërshti, pasi u erdhi dija, nga keqdashja mes tyre. Yt Zot do të vendosë mes tyre, Ditën e Ringjalljes, se ku ranë në kundërshti.
18. Pastaj, të vumë ty në një platformë të çështjes, pra, ndiqe atë dhe mos ndiq pasionet e të paditurve.
19. Ata nuk do të të vlejë gjë ndaj Zotit. Dhunuesit janë miq të njëri-tjetrit. Zoti është miku i të devotshmëve.
20. Ky është ndriçim për njerëzit, drejtim e mëshirë për një popull që bindet.

21. Mos pandehin keqbërësit t'i vëmë njësoj, në jetën dhe vdekjen e tyre, me ata që besojnë e bëjnë të mira? Sa keq gjykojnë!
22. Zoti krijoi qiejt e tokën me të vërtetën dhe të shpërblehet çdo frymë me ç'ka fituar e të mos i bëhet e padrejtë.
23. E sheh kë merr për zot pasionin? Zoti e la të humbur përballë dijes, ia mbylli të dëgjuarit e zemrën dhe në sytë e tij ka bërë perde. Pas Zotit, kush do ta drejtojë? A nuk mendoheni?
24. Thonë: "Është jeta jonë e kësaj bote. Vdesim e jetojmë dhe na asgjëson koha." Nuk kanë për këtë dije, por pandehin.
25. Kur u recitohen dëshmitë Tona të qarta, argument për ta është vetëm të thonë: "Sillni etërit tanë në thoni të vërtetën!"
26. Thuaj: "Zoti ju jep jetë, ju vdes, pastaj ju mbledh Ditën e Ringjalljes ku s'ka dyshim." Por të shumtët e njerëzve nuk dinë.
27. Zotit i përket sundimi i qiejve dhe i tokës. Ditën që vjen ora, humbasin të remët.
28. I sheh popujt të gjunjëzuar. Çdo popull thirret te libri i tij: "Sot shpërbleheni sipas veprave tuaja.
29. Ja, Libri Ynë! Flet për ju me të vërtetën. Regjistruam çdo gjë që keni bërë."
30. Cilët besuan e bënë të mira, Zoti i pranon në Mëshirën e Vet. Kjo është fitorja e qartë.
31. Atyre që mohuan: "A nuk u lexuan te ju dëshmitë e Mia? U mburrët dhe ishit mëkatarë."
32. Kur thuhej: "Premtimi i Zotit është i vërtetë, pa dyshim edhe Ora", - thonit: "Nuk dimë ç'është ora. E quajmë hamendje dhe s'jemi të bindur."

33. U dalin të këqiat që kanë bërë dhe i zë ajo me të cilën u tallën.
34. Thuhet: “Sot Ne ju harrojmë juve siç harruat ju takimin e kësaj dite. Strehë juaj është zjarri dhe s'ka për ju ndihmëtarë.
35. Sepse i morët dëshmitë e Zotit me mospërfillje dhe ju mashtroi jeta e kësaj bote.” Sot nuk nxirren së andejmi, as që lejohen të bëjnë lutje.
36. Lavdet janë vetëm për Allahun, Zotin e qiejve, Zotin e tokës, Zotin e botëve!
37. Atij i takon madhështia në qiej e në tokë. Ai është i Plotfuqishmi, i Urti.

46. DUNAT (EL AHKAF)

Periudha e Mekës, 35 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Ha, mim.
2. Shpallja e Librit është nga Zoti, i Plotfuqishmi, i Urti.
3. I krijuam qiejt, tokën e ç'janë mes tyre me të vërtetën dhe afat të caktuar. Por mohuesit janë larg vërejtjeve.
4. Thuaj: “E kuptoni çfarë po lusni në vend të Zotit? Më thoni, ç'krijuan ata në tokë? Mos kanë pjesë në qiell? Më sillni një libër para këtij ose ndonjë gjurmë nga dija në thoni të vërtetën.”
5. Kush është më i gabuar se ai që lut në vend të Zotit ç'nuk i përgjigjen deri Ditën e Ringjalljes, të pavetëdijshëm për lutjen e tij?

6. Kur njerëzit të tubohen, do të jenë armiq, mohues të adhurimit të tyre.
7. Nëse u recitohen dëshmitë Tona të qarta, mohuesit thonë për të vërtetën që u erdhi: “Kjo është magji e hapur.”
8. Ose thonë: “E sajoi ai.” Thuaj: “Në e sajova unë, ju s’keni fuqi të më mbronin ndaj Zotit. Ai e di se me ç’merreni. Mjafton Ai, dëshmues mes meje e jush. Ai është Falësi, Mëshirëploti.”
9. Thuaj: “Unë nuk jam nismëtar i profetëve dhe nuk di ç’do të bëhet me mua e me ju, por ndjek çfarë më kumtohet. Unë jam vetëm një paralajmërues i qartë.”
10. Thuaj: “E kuptoni që, duke qenë nga ana e Zotit dhe ju e mohoni, një dëshmues prej bijve të Izraelit dëshmoi për shembullin e tij dhe besoi ndërsa ju u mburrët? Zoti nuk i drejton dhunuesit.”
11. Mohuesit u thonë besimtarëve: “Po të ishte e mirë, nuk do të na e kalonin në të.” Meqë nuk u udhëzuan me të, do të thonë: “Është trillim i vjetër.”
12. Para tij që Libri i Musait, drejtim e mëshirë. Edhe ky është një libër vërtetues, në gjuhën arabe, për të paralajmëruar dhunuesit dhe sihariq për mirëbërësit.
13. Ata që thonë: “Zoti ynë është Allahu” – dhe janë të vendosur, nuk frikësohen e dëshpërohen.
14. Ata janë banorët e parajsës, të përhershëm në të, shpërblim për veprat që bënë.
15. E porositëm njeriun të jetë i sjellshëm me prindërit. Nëna e bart me vështirësi dhe e lind me vështirësi. Bartja dhe gjidhënia janë tridhjetë muaj. Derisa, kur arrin fuqinë e plotë fizike dhe kap të dyzetat, thotë: “Im Zot, frymëzomë të të falënderoj për të mirën që na dhurove mua e prindërve të mi dhe të bëj vepra të

mira për kënaqësinë Tënde. Më jep mbarësi te pasardhësit e mi! Unë kthehem nga Ty i penduar dhe jam musliman.”

16. Këtij ia pranojmë më të mirat e veprave dhe ia kapërcejmë të këqiat, si banor i parajsës. Premtim i vërtetë që u premtua.
17. Por, kush u thotë prindërve: “Uff! Më premtoni se do të ringjalle kur para meje kanë kaluar breza”, – ata, duke i lypur ndihmë Zotit: “I mjeri ti, beso se premtimi i Zotit është i vërtetë”, – u thotë edhe: “Kjo është rrëfenjë e të parëve”,
18. - ai është nga ata që merituan fjalën te bashkësitë e kaluara më parë, të xhinëve e njerëzve, se janë me të vërtetë të humbur.
19. Secili ka një pozitë sipas veprave. Që Ai t’ua plotësojë veprat e të mos u bëhet e padrejtë.
20. Ditën kur mohuesit dalin përballë zjarrit: “Ju i harxhuat të mirat në jetën e asaj bote dhe përfituat me to. Sot shpërbleheni me dënim poshtërues sepse ishit pa të drejtë mendjemëdhenj në tokë dhe nuk u bindët.”
21. Kujto të vëllanë e Adit kur paralajmëroi kombin e vet në vendin e dunave ndërsa kishin kaluar paralajmërues para e pas tij: “Adhuroni Zotin! Unë i frikësohem për ju dënimit të një dite të madhe.”
22. Thanë: “Erdhe të na largosh nga zotat tanë? Sille dënimin në thua të vërtetën.”
23. Tha: “Dija është te Zoti. Unë po ju komunikoj porosinë me të cilën u dërgova, porse ju shoh juve njerëz të paditur.”
24. Kur panë një re të dendur t’u afrohej luginave, thanë: “Kjo re po na sjell shi!” Jo, është çfarë kërkuat me ngut, re dënimi të hidhur.

25. Shkatërron çdo gjë me urdhrin e Zotit. Dhe mbetën vetëm rrënojat. Kështu i shpërblejmë fajtorët.
26. I vendosëm ata ku s'ju kemi vendosur juve; u bëmë veshë, sy e zemër, por s'u bënë dobi veshët, sytë e zemra kur refuzuan dëshmitë e Zotit. Dhe i zuri ajo me të cilën u tallën.
27. Zhdukëm rreth jush vendbanime që ua bëmë të qarta dëshmitë e të ndryshonin.
28. Përse nuk u erdhën në ndihmë zotat që merrnin si mjet afrimi në vend të Zotit? Përkundrazi, humbën prej tyre dhe mbetën gënjeshtat e trillimet.
29. Kur disa xhinë i kthym nga ty të dëgjonin Kuran, me të arritur, thanë: "Kini vëmendjen!" Në fund, u kthyen te populli i tyre si paralajmërues.
30. Thanë: "Kombi ynë! Dëgjuam një libër të shpallur pas Musait, që vërteton shkrimet para tij, drejton te e vërteta dhe në rrugë të drejtë.
31. Kombi ynë, përgjigjuni thirrësit të Zotit dhe besojeni! Që Ai t'jua falë gabimet dhe t'ju ruajë nga një dënim i hidhët."
32. Cilët nuk i përgjigjen thirrësit të Zotit, nuk mund të shpëtojnë në tokë dhe nuk ka për ta, veç Zotit, kush t'i mbrojtë. Ata janë në humbje që duket.
33. Nuk vërejnë se Zoti që krijoi qiejt e tokën dhe s'u lodh në krijimin e tyre, ka fuqi të ngjallë të vdekurit? Po, Ai është mbi çdo gjë pushtetplotë.
34. Ditën kur mohuesit dalin përballë zjarrit: "Nuk është kjo e vërtetë?" Thonë: "Po, për Zotin!" Thotë: "Shijoni dënimin pasi mohuat."
35. Ti duro siç duruan me vendosmëri të dërguarit. Dhe mos kërko t'u nxitohet. Kur të shohin të realizuar paralajmërimin, do t'u duket se nuk qëndruan më se

një orë dite. Një komunikim. A nuk zhduken njerëzit e pabindur?

47. MUHAMMEDI (MUHAMMED)

Periudha e Medines, 38 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Atyre që mohojnë dhe pengojnë nga Rruga e Zotit Ai ua humb veprat.
2. Cilët besojnë e bëjnë të mira dhe besojnë shpalljen të Muhammedi si të vërtetën nga Zoti i tyre, Ai ua shlyen të këqiat dhe përmirëson gjendjen.
3. Sepse mohuesit ndjekin të kotën dhe besimtarët ndjekin të vërtetën nga Zoti i tyre. Zoti u sjell kështu shembuj njerëzve.
4. Kur t'i ndeshni mohuesit, mëshojuni në qafë derisa t'i keni shpartalluar e zënë robër që t'i lironi më pas, si favor ose me shpërblesë, kur lufta të ketë ulur barrët e saj. Ja, pra, po të deshte Zoti, hakmerrej me ta, por vë në provë disa me të tjerë. Atyre që vriten në Rrugën e Zotit Ai nuk ua humb veprat.
5. Por i drejton dhe ua përmirëson gjendjen.
6. Dhe i pranon në kopshtin që ua ka bërë të njohur.
7. Besimtarë! Nëse ndihmoni Zotin, ju ndihmon dhe jua forcon këmbët.
8. Mohuesit kanë disfatë dhe Ai ua humb veprat.
9. Sepse ata urrejnë fjalët e Zotit dhe Ai ua asgjëson bëmat.

10. Nuk udhëtojnë në tokë të shohin si përfunduan të parët? Zoti i rrënoi. Atë shembull kanë mohuesit.
11. Sepse Zoti është mbrojtësi i besimtarëve dhe nuk ka mbrojtës për mohuesit.
12. Zoti i pranon ata që besojnë e bëjnë të mira kopshteve ku rrjedhin lumenj. Mohuesit jetojnë e hanë si kafshët dhe zjarri është streha e tyre.
13. Sa e sa vendbanime më të fuqishme nga vendbanimi yt që të dëboi rrënuam dhe nuk patën përkrahës.
14. Cili mbështetet në dëshmi të qartë nga Zoti i tij, mos është si dikush që i duket e mirë vepra e vet e keqe dhe ndjek pasionet?
15. Shembulli i parajsës premtuar të devotshmëve: lumenj me ujë të pandotur, lumenj qumështi të paprishur, lumenj vere me shije për ata që e pijnë, lumenj mjalti të kulluar. Kanë në të gjithfarë frytësh dhe falje nga Zoti. Mos janë si dikush përgjithmonë në zjarr ku i jepet të pijë ujë të valë që ia shkatërron zorrët?
16. Ndër ta, ka që të dëgjojnë, aq sa, kur dalin prej teje, u thonë atyre me dije: “Ç’ta ai pak më parë?” Janë ata që Zoti ua ka vulosur zemrat dhe ndjekin pasionet.
17. Atyre që udhëzohen drejt Ai ua forcon drejtimin dhe u jep devocionin.
18. Mos presin t’u vijë papritur Ora? Shenjat kanë ardhur. Sa vlen kur të përmenden?
19. Dije se s’ka zot veç Zotit dhe kërko falje për mëkatin tënd, të besimtarëve e besimtareve. Zoti e di ku shkoni dhe ku do të qëndroni.
20. Besimtarët do të thonë: “Përse nuk iu zbrit një sure (kapitull) ?” Kur zbritet një sure vendimdhënëse dhe

- përmendet në të lufta, i sheh zemërsëmurët të të vështrojnë si t'u këtë rënë vdekja. Mjerim për ta!
21. Bindje dhe fjalë nderi! Kur merret një vendim, është më mirë të jenë besnikë ndaj Zotit.
 22. Po të kthenit, a nuk do të sillnit mosmarrëveshje e t'i prishnit marrëdhëniet?
 23. Janë ata që i ka mallkuar Zoti dhe i bëri shurdhë e të verbër.
 24. Nuk shqyrtojnë Kuranin apo i kanë zemrat mbyllur?
 25. Cilët kthehen mbrapsht, pasi u sqarua drejtimi, i mashtroi e nxiti djalli.
 26. Sepse u thanë atyre që urrejnë fjalët e Zotit: "Do t'ju bindemi juve në disa çështje." Zoti ua di të fshehtat.
 27. Dhe si, kur t'i vdesin engjëjt dhe t'i qëllojnë në fytyrë e shpinë?
 28. Sepse ata ndoqën zemërimin e Zotit dhe urrejnë kënaqësinë e Tij. Prandaj Ai ua dështon veprat.
 29. Mos pandehin zemërsëmurët se Zoti nuk u nxjerr në dukje të ligat?
 30. Po të deshim, t'i kishim treguar e t'i njihje në çehret, por do t'i njohësh nga fjalët. Zoti jua di veprat.
 31. Ne do t'ju provojmë derisa t'i njohim ndër ju luftëtarët e të vendosurit dhe t'i vëmë në provë lajmet.
 32. Cilët mohojnë dhe pengojnë nga Rrugat e Zotit dhe i kundërvihen Profetit pasi u është sqaruar drejtimi, nuk do ta dëmtojnë gjë Zotin ndërsa Ai do t'ua dështojë veprat.
 33. Besimtarë! Bindjuni Zotit, bindjuni të Dërguarit dhe mos i zhvlehtësoni veprat.
 34. Ata që mohojnë dhe pengojnë nga Rrugat e Zotit, pastaj vdesin mohues, nuk do t'i falë Zoti.

35. Mos u dobësoni e të lypni paqe tek jeni ju më lart. Zoti është me ju dhe nuk do t'jua zhvleftësojë veprat.
36. Jeta e kësaj bote është vetëm shfaqje e kalimkohe. Po të besoni e jeni të devotshëm, Ai jua jep shpërblimet dhe nuk ju kërkon pasuritë.
37. Në i kërkon e ju vë kusht, ngushtoheni dhe jua nxjerr në dukje të ligat.
38. Ja, jeni ju që ju bëhet thirrje të kontribuoni në Rugën e Zotit dhe disa prej jush ngushtohen. Kush ngushtohet, ia bën vetes. Zoti është i Pasuri dhe ju të varfrit. Nëse tërhiqeni, ju zëvendëson me njerëz të tjerë, ndryshe prej jush.

48. FITORJA (EL FET'H)

Periudha e Medines, 29 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Ne të dhamë një fitore të qartë. (Në Hudejbije, dhul-kade 6h., mars 628, ku u nënshkrua paqja dhjetëvjeçare me mekasit. Në dukje, në dëmin e muslimanëve, kjo marrëveshje i hapi rrugën përhapjes së Islamit. Pakti i Hudejbijes ishte arritje e shkëlqyer e strategjisë në të cilën i Madhi Zot e udhëhoqi të Dërguarin e Tij, Muhammedin a.s. gjatë Misionit Profetik.)
2. Që të t'i falë Zoti mangësitë e mëparshme e ato të mëpasshme, ta plotësojë Mirësinë e Tij ndaj teje dhe të të udhëheqë në udhë të drejtë.
3. Të të ndihmojë Zoti me një përkrahje të fuqishme.

4. Është Ai që zbriti qetësi në zemrat e besimtarëve për t'u shtuar besim në besimin e tyre. Ushtritë e qiejve dhe të tokës janë të Zotit. Zoti është dijeplotë, i urtë.
5. T'i fusë besimtarët e besimtarët në kopshte ku rrjedhin lumenj, të përhershëm në to dhe t'ua shlyejë të këqiat. Te Zoti, ky është sukses i madh.
6. Dhe t'i dënojë hipokritët e hipokritet, idhujtarët e idhujtarët që kanë mendim të keq për Zotin. E ardhmja e tyre është e keqe. Zoti u zemërua me ta, i mallkoi dhe u bëri gati skëterrën. Ç'fund i keq!
7. Ushtritë e qiejve dhe të tokës janë të Zotit. Zoti është i plotfuqishëm, i urtë.
8. Ne të dërguam si dëshmues, përgëzues e paralajmërues.
9. Të besoni Zotin dhe të Dërguarin e Tij, ta ndihmoni e respektoni atë dhe t'i thurni Atij lavde mëngjes e mbrëmje.
10. Ata që të dhanë besë ty, i dhanë besë Zotit. Dora e Zotit është mbi duart e tyre. Kush e thyen, e ka thyer për vete. Kujt përmbush besën me Zotin, Ai i jep shpërblim të madh.
11. Beduinët që mbetën pas do të thonë: "Na penguan malli e fëmijët. Lyp falje për ne!" Thonë me gojë e jo me zemër. Thuaj: "Kush e ka në dorë ndaj Zotit nëse Ai ju do dëmin a dobinë?" Zoti është në dijeni të punëve tuaja.
12. Menduat se Profeti dhe besimtarët s'do të kthehen më në familjet e tyre dhe kjo u zbukurua në zemrat tuaja. Menduat me mendim të keq, si njerëz në humbje.
13. Mohuesve, atyre që nuk besojnë te Zoti dhe i Dërguari i Tij, u bëmë gati zjarrin e përlaktë.

14. Zotit i takon sundimi i qiejve dhe i tokës; fal e dënon me dashjen e Tij. Zoti është falës, mëshirëplotë.
15. Po të dilni për pre, të prapambeturit do të thonë: “Na lini t’ju ndjekim.” Duan të ndryshojnë fjalën e Zotit. Thuaj: “Nuk do të na ndiqni. Kështu ka thënë Zoti më parë.” Do të thonë: “Na keni smirë.” Në të vërtetë ata pak kuptojnë.
16. Thuaju beduinëve që mbetën pas: “Do të ftoheni te një popull me fuqi të rreptë (bizantinët), ta luftoni a të nënshtrohet. Në bindeni, Zoti ju jep shpërblim të mirë. Në shmangeni, siç u shmangët më parë, ju dënon me dënim të hidhët.”
17. Nuk detyrohen i verbri, sakati dhe i sëmuri. Kë i bindet Zotit dhe të Dërguarit të Tij, Ai e pranon kopshteve ku rrjedhin lumenj; kë shmangët, e ndëshkon me dënim të hidhët.
18. Zoti ishte i kënaqur nga besimtarët kur të dhanë besën te pema dhe ua dinte zemrat. Zbriti mbi ta qetësi dhe ua shpërbleu me fitore të afërt.
19. Dhe me shumë pre që do të zinin. Zoti është i plotfuqishëm, i urtë.
20. Zoti ju premtoi pre të shumtë, e shpejtoi këtë për ju dhe ua mbajti njerëzve duart prej jush, që të jetë dëshmi për besimtarët dhe t’ju drejtojë në udhë të drejtë.
21. Edhe të tjera ku s’keni fuqi, por që Zoti i ka nën kontroll. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.
22. Edhe sikur mohuesit t’ju luftojnë, do të kthejnë shpinën dhe nuk do të gjejnë aleat e përkrahës.
23. Udhë e Zotit kaluar më parë. Nuk do të gjesh zëvendësim në Udhën e Zotit.

24. Është Ai që i mbajti duart e tyre prej jush dhe duart tuaja prej tyre në luginën e Mekës dhe më pas ju dha mbi ta fitore. Zoti është largpamës i veprave tuaja.
25. Janë ata që mohuan dhe ju penguan nga Faltorja e Shenjtë dhe nuk i lanë kurbanet të arrinin në vendin e sakrificës. Si të mos kishte burra besimtarë e gra besimtare të cilët ju nuk i dinit, do t'i shkelnit e t'ju binte prej tyre, me pa dije, një krim. Zoti fut në mëshirën e Vet atë që do. Sikur të dalloheshin, do t'i ndëshkonim mohuesit me një dënim të hidhët.
26. Ndërsa mohuesit morën në zemrat e tyre valë, valën e padijes, Zoti zbriti qetësinë e Tij mbi të Dërguarin e Vet dhe besimtarët dhe i bashkoi ata te Fjala e Devotshmërisë (La ilahe il-lall-llah, Muhammedun resulull-llah. S'ka zot veç Zotit, Muhammedi është i Dërguari i Zotit.), të meritueshëm për të dhe ithtarë të saj. Zoti është për çdo gjë dijeplotë.
27. Zoti ia vërteton ëndrrën të Dërguarit të Tij. Dashtë Zoti, do të hyni në Faltoren e Shenjtë të sigurt, kryerruar e të qethur, pa frikë. Ai di ç'ju nuk dini dhe, veç kësaj, bën fitore të afërt.
28. Është Ai që dërgoi të Dërguarin e Vet me drejtimin dhe fenë e vërtetë, të triumfojë mbi gjithë fetë. Mjafton Zoti dëshmitar. (Feja e Zotit është një.)
29. Muhammedi është i Dërguari i Zotit dhe ata me të janë të ashpër me mohuesit dhe të mëshirshëm mes tyre. I sheh të përkulur dhe të përlur me krye në tokë duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë e Zotit. Shenjë në fytyrat e tyre është gjurma e sexhdes. Ky është shembulli i tyre në Teurat. Shembulli i tyre në Ungjill, një farë që nxjerr filiz, i jep fuqi, rritet e zhvillohet në trungun e vet dhe i gëzon mbjellësit. Me ta, Ai tërbon

mohuesit. Zoti u premtoi atyre që besojnë e bëjnë të mira falje dhe shpërblim të madh.

49. MURET (EL HUXHURAT)

Periudha e Medines, 18 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Besimtarë, mos dilni para Zotit dhe të Dërguarit të Tij! Kini frikë Zotin! Zoti është dëgjues, dijeplotë.
2. Besimtarë, mos e ngrini zërin mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të lartë siç i flisni njëri-tjetrit, t'ju zhvleftësohen pa kuptuar veprat.
3. Atyre që ulin zërin para të Dërguarit të Zotit, Zoti ua ka provuar zemrat për devocion. Ata kanë falje dhe shpërblim të madh.
4. Cilët të thërrasin përtej mureve (dhomave), më së shumti nuk kuptojnë.
5. Sikur të duronin sa t'u dilje jashtë, do të ishte më mirë për ta. Zoti është falës, mëshirëplotë.
6. Besimtarë, në ju vjen një shpifës me lajm, shqyrtojeni para se të goditnit me padije njerëz e të pendoheshit.
7. Dijeni që tek ju është i Dërguari i Zotit. Sikur t'ju bindej në shumë çështje, do të binit në fatkeqësi, por Zoti jua bëri të dashur besimin dhe e stolisi atë në zemrat tuaja ndërsa jua bëri të urreyer mohimin, mosbindjen dhe kundërshtimin. Ja, këta janë të udhëzuarit drejt.
8. Si mirësi dhe bekim prej Zotit. Zoti është dijeplotë, i urtë.

9. Kur dy grupe besimtarësh luftojnë mes tyre, pajtojini dhe, nëse njëri bën agresion, luftoni agresorin derisa t'i nënshtrohet urdhrit të Zotit. Po të nënshtrohet, bëni paqe me drejtësi. Dhe jini të paanshëm sepse Zoti i do të paanshmit.
10. Besimtarët janë vëllezër, pra, bëni paqe mes vëllezërve tuaj dhe përmbajuni Zotit që të mëshiroheni.
11. Besimtarë, le të mos përbuzin disa njerëz të tjerët si më të mirë, as disa gra gratë e tjera si më të mira; mos përgojoni njëri-tjetrin dhe mos vini nofka. I keq është epiteti i të pabesit pas besimit! Cilët nuk pendohen, ata janë dhunuesit.
12. Besimtarë, largojuni hamendjeve të shumta se, pas hamendjes, është mëkati. Mos hetoni njëri-tjetrin dhe mos flisni prapa krahëve. A dëshiron ndonjëri të hajë mishin e vëllait të vdekur? Urrejeni atë! Dhe përmbajuni Zotit. Zoti e pranon pendimin, është mëshirëplotë.
13. O njerëz! Ne ju krijuam nga një mashkull e femër dhe ju bëmë popuj e fise që të njiheni njëri me tjetrin. Më i nderuar te Zoti është më i devotshmi ndër ju. Zoti është dijeplotë, i gjithëditur.
14. Beduinët thonë: "Besuam." Thuaj: "Nuk keni besuar, por thoni: "U nënshtroam", - përderisa besimi nuk ka hyrë në zemrat tuaja." Në u bindeni Zotit dhe të Dërguarit të Tij, Ai nuk jua mangëson veprat. Zoti është falës, mëshirëplotë.
15. Besimtarë janë ata që besojnë Zotin dhe të Dërguarin e Tij, nuk janë në mëdyshje, por përpiqen me pasuritë dhe veten e tyre në Rrugën e Zotit. Këta janë të vërtetët.

16. Thuaj: “Ia bëni të ditur Zotit besimin tuaj? Zoti di ç’është në qiej e në tokë. Zoti është për gjithçka dijeplotë.”
17. E quajnë se të kanë bërë nder ty duke pranuar Islamin. Thuaj: “Nuk më bëtë nder mua që pranuat Islamin. Zoti ju bëri nder që ju drejtoi për besim nëse jeni të singertë.”
18. Zoti di të fshehtat e qiejve dhe të tokës. Zoti është largpamës i veprave tuaja.

50. KAF (KAF)

Periudha e Mekës, 45 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Kaf. Për Kuranin e lëvduar!
2. Çuditën që u erdhi mes tyre paralajmërues dhe mohuesit thonë: “Është e pabesueshme!
3. Kur të vdesim e të bëhemi dhé? Një kthim i largët.”
4. Ne e dimë ç’u mangëson toka. Te Ne është një libër ruajtës.
5. Jo, ata përgënjeshtrojnë të vërtetën që u erdhi dhe janë të hutuar.
6. Nuk shohin nga qielli sipër tyre si e ngritëm dhe stolisëm pa të çara?
7. Edhe tokën që e shtrimë, hodhëm në të vargmale dhe rritëm gjithfarë llojesh të hareshme?
8. Dritë e kujtesë për çdo rob që kthehet i penduar.

9. Ulim nga qielli ujë të bekuar dhe rrisim me të kopshte e të korra,
10. palmat e larta me vilet ngarkuar,
11. ushqim për robtë. Ngjallim me të një tokë të vdekur. Kështu është ringjallja.
12. Përgënjeshtroan më parë kombi i Nuhit, banorët e Ressit dhe themudët,
13. adët, faraoni dhe vëllezërit e Lutit,
14. banorët e Ejkes dhe kombi i Tubbait. Të gjithë përgënjeshtroan të dërguarit dhe u realizua paralajmërimi Im.
15. Mos u lodhëm në të parin krijim? Jo, ata janë të paqartë rreth krijimit të ri.
16. Ne e krijuam njeriun dhe e dimë ç'i pëshpërit shpirti. Ne jemi më afër tij se damari i jetës.
17. Kur dy marrës, në të djathtë e të majtë, regjistrojnë,
18. nuk flet ndonjë fjalë pa qenë pranë tij një vëzhgues gati.
19. I vjen agonia e vdekjes bashkë me të vërtetën. Ja kujt i ike!
20. I fryhet bririt. Kjo është dita e paralajmëruar.
21. Vjen çdo frymë, me të, një përcjellës e një dëshmues.
22. Ishe i shkujdesur, ta hoqëm perden dhe vështrimi yt sot është i mprehtë.
23. Thotë shoqëruesi: "Kjo që kam unë është gati."
24. "Ju të dy, hidhni në skëterrë çdo mohues rebel,
25. pengues të së mirës, shkelës, dyshues,
26. që bëri me Zotin zot tjetër, hidheni në dënimin e ashpër!"
27. Thotë i afërmi i tij: "O Zot, nuk e rebelova unë, por ishte në humbje të thellë."

28. Thotë: “Mos u grindni para Meje! Ju paralajmërova më parë.
29. Nuk ndryshon fjala te Unë dhe s’jam me robtë i padrejtë.”
30. Atë ditë i themi skëterrës: “U mbushe plot?” “A ka më?” – do të thotë.
31. U sillet parajsa të devotshmëve, jo larg:
32. “Ja kjo që u premtuat, për çdo të kthyer, të ruajtur,
33. që iu frikësua Bamirësit në të padukshmen dhe erdhi me zemër të penduar.
34. Hyni në paqe! Kjo është Dita e Pasosur.”
35. Kanë në të ç’të dëshirojnë, pranë Nesh, akoma më shumë.
36. Zhdukëm sa e sa brezni para tyre! Ishin më të rreptë në fuqi dhe çanë në tokë, por a gjetën strehë?
37. Këtu ka mësim për çdo njeri me zemër a që dëgjon e dëshmon.
38. Ne krijuam qiejt e tokën dhe gjithçka mes tyre në gjashtë ditë e s’na preku lodhje.
39. Pra, duroji fjalët e tyre dhe thuri lavde Zotit tënd mëngjes e mbrëmje.
40. Madhëroje natën dhe pas riteve.
41. Dëgjo ditën kur një thirrës të thërrasë nga një vend i afërt.
42. Ditën që dëgjojnë krismën bashkë me të vërtetën. Ajo është dita kur do të dalin.
43. Ne japim jetë e vdesim dhe fundi është tek Ne.
44. Ditën kur u rrëshqet shpejt toka, për Ne është një i lehtë tubim.
45. Ne e dimë më së miri çfarë thonë; ti nuk je ndaj tyre tiran. Por këshillo me Kuran kë i frikësohet paralajmërimit Tim.

51. ERËRAT (EDH-DHARIJAT)

Periudha e Mekës, 60 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Për erërat që tej shpërndajnë
2. dhe retë që një ngarkesë mbajnë,
3. për anijet që rrëshqasin lehtë
4. dhe engjëjt që një urdhër ndajnë,
5. ç' u premtuat është e vërtetë
6. dhe gjykimi do të ndodhë!
7. Për qiellin udhëllakuar,
8. ju jeni në tjetër fjalë!
9. Largohej prej saj një i mashtruar.
10. U shofshin hamendësit
11. që enden të hutuar!
12. Pyesin: "Kur është Dita e Gjykimit?"
13. Ditën që vihen në provën e zjarrit.
14. "Shijoni provën tuaj, ja ku u nxituat!"
15. Të devotshmit, në kopshte e burime,
16. marrin ç'u jep Zoti. Ishin më parë mirëbërës,
17. një pjesë nate pushonin
18. dhe herët në agim falje kërkonin.
19. Te malli i tyre, lypësi e nevojtar të drejtë kishin.
20. Në tokë ka dëshmi për ata që binden.
21. Edhe në veten tuaj. A nuk vështroi?
22. Në qiell është ushqimi juaj e ç'u premtuat.
23. Për Zotin e qiejve dhe të tokës, është e vërtetë, siç edhe po flisni!
24. Të erdhi ngjarja e miqve të nderuar të Ibrahimit?

25. Kur hynë tek Ai dhe thanë: "Paqe!" - ai tha: "Paqe, o njerëz të panjohur!"
26. Shkoi te të tijët dhe solli një viç të pjekur.
27. Ua afroi e tha: "Nuk po hani?"
28. Ndjeu prej tyre frikë. Thanë: "Mos ki frikë!" Dhe e uruan me një djalë të mençur.
29. Doli e shoqja duke rënkuar, rrahu fytyrën dhe tha: "Një plakë e mbaruar?!"
30. Thanë: "Kështu ka thënë yt Zot. Ai është i urtë, dijeplotë."
31. Tha: "Ç'është qëllimi juaj, o të dërguar?"
32. Thanë: "U dërguam te një popull i fajësuar.
33. Të hedhim mbi ta gurë balte të pjekur,
34. me damkë nga yt Zot për ata që kanë shpërdoruar."
35. I nxorëm së andejmi besimtarët.
36. Nuk gjetëm më se një shtëpi ndër muslimanët.
37. Lamë atje dëshmi për këdo që i frikësohet dënimit të hidhët.
38. Edhe në Musanë, kur e dërguam te faraoni me mandat të hapur.
39. Por ai refuzoi me forcë dhe tha: "Një magjistar a i magjepsur!"
40. E morëm atë dhe trupat e tij, i hodhëm në det të fajësuar.
41. Edhe te adët, kur u dërguam erën e thatë,
42. që nuk la gjë pa prishur.
43. Edhe te themudët kur iu tha: "Kënaquni një kohë!"
44. Shkelën urdhrin e Zotit dhe i zuri krisma duke vështuar.
45. S'mund të ngriheshin dhe vetveten të ndihmonin.
46. Edhe kombin e Nuhit më parë. Ishin njerëz që nuk bindeshin.

47. Qiellin, Ne e ngritëm atë me fuqi dhe e zgjerojmë.
48. Edhe tokën, Ne e shtrimë dhe sa mirë e formuam!
49. Nga çdo gjë krijuam palë. Ndoshta e mendoni.
50. "Rendni te Zoti! Unë jam për ju, prej Tij, një paralajmërues i qartë.
51. Mos bëni me Zotin tjetër zot! Unë jam për ju, prej Tij, një paralajmërues i qartë."
52. Kështu, nuk u erdhi më parë i dërguar që të mos i thonin magjistat a i magjepsur.
53. E lanë porosi? Jo, ata janë njerëz të papërmbytur.
54. Largohu prej tyre dhe nuk je i qortuar.
55. Bëj kujtesë se nga kujtesa përfitojnë besimtarët.
56. Xhinët dhe njerëzit i krijova për të më adhuruar.
57. Nuk kërkoj pjesë prej tyre e të më ushqejnë.
58. Zoti është ushqyesi me fuqinë e duhur.
59. Dhunuesit, pjesën e shokëve të tyre pjesë kanë, pra, të mos më nxitojnë!
60. Mjerë mohuesit ditën që u paralajmëruan!

52. MALI (ET-TUR)

Periudha e Mekës, 49 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Për Malin (Sinai)
2. dhe librin e radhitur
3. në fletë të hapur;
4. për shtëpinë e populluar (Qaben),
5. çatinë e ngritur

6. dhe detin e gufuar,
7. dënimi i Zotit patjetër do të ndodhë!
8. Askush s'e pengon.
9. Kur të lëkundet qielli
10. e të lëvizin malet,
11. atë ditë, mjerë përgënjeshtuesit,
12. që luajnë në fjalë të kota!
13. Ditën kur shtyhen në zjarrin e ferrit:
14. "Ja zjarri që përgënjeshtonit!
15. Është magji apo nuk vështroni?
16. Digjuni, pra, e duruakeni apo s'e duruakeni, njësoj për ju, me veprën tuaj shpërbleheni."
17. Të devotshmit janë në kopshte e begati,
18. të gëzuar me ç'u ka dhënë Zoti. I ruajti Zoti nga dënimi i zjarrit:
19. "Hani e pini, ju bëftë mirë, për ato që bëtë!"
20. Mbështetur në frona radhë-radhë, i shoqërojmë me hyritë.
21. Bashkojmë me ta pasardhësit e tyre në besim, që besuan e i pasuan dhe nuk ua lëmë mangët veprat. Çdo njeri është peng i fitimit të tij.
22. I furnizojmë me fryte e mish, ç'të dëshirojnë.
23. Shkëmbejnë gotë (fig. bisedojnë), pa fjalë të kota e mëkate.
24. U sillen qark shërbyes si margaritarë të fshehtë.
25. Qëndrojnë karshi njëri-tjetrit, bisedojnë.
26. Thonë: "Ishim më parë në familjet tona jo të qetë.
27. Por Zoti na nderoi dhe na ruajti nga vuajtja e afshit të nxehtë.
28. Ne, që më parë, i luteshim Atij. Ai është bamirës, mëshirëplotë." (Dhënë në trajtën e shquar. Këtu, fjala "bamirës"

është përshtatur nga "berru"/el ber-ru, jo "rahman" siç merret zakonisht.)

29. Bëj kujtesë! Me mirësinë e tët Zoti, ti nuk je falltar e i marrë.
30. Ose thonë: "Është poet. Presim t'i vijë një ditë."
31. Thuaj: "Prisni. Edhe unë jam me ju në pritje."
32. Ua thotë mendja apo janë të papërmbajtur?
33. Ose thonë: " Ai e ka sajuar." Jo, ata nuk besojnë.
34. Le të sjellin një fjalë të tillë, në thonë të vërtetën.
35. Mos u krijuan nga hiçi apo janë ata krijuesit?
36. Dhe krijuan qiejt e tokën? Jo, ata nuk binden.
37. Mos janë pranë tyre thesaret e tët Zoti dhe i kontrollojnë?
38. Ose kanë shkallë ku mund të ngjiten e të dëgjojnë?
Le të vijnë dëgjuesit me një argument të qartë.
39. Mos janë për Të bijat dhe për ju bijtë?
40. Apo u kërkon shpërblim dhe borxhi u rëndon?
41. Mos zotërojnë të fshehtën dhe shkruajnë?
42. Apo duan të bëjnë kurth? Mohuesit janë në kurth të zënë.
43. Mos kanë veç Zotit tjetër zot? I madhëruar është Zoti nga ç'i shoqërojnë!
44. Edhe në shohin copa qielli duke rënë, do të thonë:
"Re të grumbulluara."
45. Lëri të arrijnë ditën kur shtangen.
46. Ditën që s'u vlen dredhia dhe nuk do të përkrahen.
47. Dhunuesit kanë një tjetër dënim, por të shumtët nuk e dinë.
48. Prit me durim vendimin e tët Zoti. Ti je në sytë Tanë.
Thuri, pra, lavde Zotit kur ngrihesh.
49. Madhëroje natën dhe kur shuhet yjet.

53. YLLI (EN-NEXHM)

Periudha e Mekës, 62 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Për yllin kur perëndon!
2. Nuk lajthiti shoku juaj e u gabua.
3. As po flet nga mendja.
4. Është kumtim që u kumtua.
5. Ia përcolli një fuqi e rreptë,
6. me intelekt (Xhebraili a.s.). Dhe u përqendrua
7. në horizontin e lartë,
8. pastaj zbriti e u afrua
9. sa dy harqe a më afër.
10. Kumtoi te robi i Tij një kumtim.
11. Çfarë pa, zemra s'e gënjeu.
12. Ia dyshoni atë që pa?
13. E pa tjetër herë,
14. te pema në mbarim (fig.: të botës reale);
15. pranë saj, parajsa-vendqëndrim.
16. E mbuloi pemën ç'e mbuloi! (Drita e Zotit)
17. Nuk lakoi shikimi, as tejshkoi.
18. Shenjat e mëdha të Zotit ai pa.
19. Keni parë Latin e Uzzanë?
20. Edhe tjetrin, Manatin, të tretin? (Tre idhujt, bijat e Zotit, sipas besimit pagan)
21. Për ju meshkujt dhe për Të femrat janë?
22. Kjo, pra, një ndarje jo e drejtë.
23. Emra që keni vënë ju dhe etërit tuaj. Zoti nuk zbriti për to ndonjë argument. Shkojnë me hamendje e ç'pëlqejnë vetë. Ndërsa u erdhi nga Zoti drejtimi.
24. Mos është e njeriut dëshira?
25. Të Zotit janë e fundit dhe e para.

26. Sa engjëj ka në qiej, nuk bën dobi ndërhyrja. Vetëm me lejen e Zotit, për atë që do dhe është i kënaqur.
27. Cilët s'besojnë në të ardhmen, i emërtojnë engjëjt femra.
28. Me padije. Dhe shkojnë me hamendje. Por hamendja s'vlen gjë te e vërteta.
29. Pra, largoj atyre që i kthejnë shpinën Kujtesës Sonë dhe duan vetëm jetën e kësaj bote.
30. Ky është kufiri i dijes së tyre. Yt Zot e di mirë cili largohet nga Rruga e Tij; Ai e di mirë kush është në rrugë të drejtë.
31. Zotit i takojnë ç'janë në qiej e në tokë për t'i shpërblyer ata që bëjnë keq me ç'bëjnë dhe t'i shpërblejë ata që bëjnë mirë me më të mirën.
32. Cilët u shmangen mëkateve të mëdha dhe paudhësive, vetëm nëse pa dashje, Zoti ka për ta falje të gjerë. Ai ju njeh mirë qëkurse ju formoi nga toka dhe ishit embrion në barqet e nënave, pra, mos u shfajësoni. Ai i di ata që janë të devotshëm.
33. Ke parë kë largohet,
34. që jep pak e tërhiqet?
35. Mos di të padukshmen dhe sheh?
36. A s'ka dijeni për fletët e Musait?
37. Dhe besën e Ibrahimit?
38. Se askush nuk mban barrën e tjetrit?
39. Dhe se njeriut i takon ajo për të cilën përpiket?
40. Se përpjekja e tij do të shihet?
41. Dhe me shpërblim të plotë të shpërblehet?
42. Se fundi është drejt Zotit?
43. Është Ai që bën të qeshë e të vajtojë,
44. Ai që vdes e jep jetë,
45. që mashkullin e femrën në palë i krijoi,

46. nga një pikëz kur hidhet.
47. Te Ai është krijimi i së ardhmes.
48. Ai pasuron e bën të kënaqur.
49. Zoti i Siriusit.
50. Ai zhduku adët, të parët.
51. Dhe nuk la prej Themudit.
52. Më parë, kombin e Nuhit. Ishin më tiranët e rebelët.
53. Dhe tokat që përmbysi.
54. I mbuloi ç'i mbuloi!
55. Te ç'të mira të tët Zoti dyshoni?
56. Ky është një paralajmërues ndër paralajmëruesit e parë.
57. E pritshmja u afrua.
58. Veç Zotit, s'ka kush e largon.
59. Çuditeni nga kjo fjalë?
60. Qeshni e s'vajtoni?
61. Dhe të paepur jeni?
62. Bini Zotit përmbys e adhuron!

54. HËNA (EL KAMER)

Periodha e Mekës, 55 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. U afrua ora dhe hëna u nda. (Sipas disa thënieve, hëna u nda më dysh, si mrekulli që mosbesimtarët i kërkuan Muhammedit a.s.. *Ora* është katastrofa dhe Dita e Ringjalljes. Ajetet 46-48 e shpjegojnë këtë.)
2. Në shohin ndonjë shenjë, bëjnë mënjane e thonë:
“Një vegim që kalon.”

3. Përgënjeshtrian dhe ndoqën pasionet, por çdo gjë do të vendoset.
4. U erdhën lajmet si parandalim,
5. një urtësi e thellë dhe nuk bënë dobi vërejtjet.
6. Pra, largohu prej tyre! Ditën që një thirrës thërret te diçka e padëshiruar,
7. syalur dalin nga varret, si karkalecë të derdhur.
8. Me nxitim te thirrësi, thonë mohuesit: “Kjo qenka ditë e vështirë!”
9. Përgënjeshtroi para tyre kombi i Nuhit.
Përgënjeshtrian robin Tonë e thanë: “Është i marrë!”
Dhe me forcë u ndalua.
10. I thirri Zotit: “Jam mundur, ndihmomë!”
11. Hapëm portat e qiellit me ujë që derdhej si lumë.
12. Shpërthyem në tokë burime dhe arriti uji masën e duhur.
13. E bartëm në një platformë me trungje e gozhda,
14. duke lundruar nën sytë Tonë, shpërblim për atë që u mohua.
15. E lamë shenjë, por kush merr mësim?
16. Si qenë dënimi dhe vërejtjet e Mia?
17. E bëmë Kuranin të lehtë për këshillim, por kush merr mësim?
18. Përgënjeshtroi Adi. Si qenë dënimi dhe vërejtjet e Mia?
19. U dërguam një erë të furishme në ditë ogurzezë, pa mbarim.
20. I rrëmbente njerëzit si kërcunj palماش shkukur me rrënjë.
21. Si qenë dënimi dhe vërejtjet e Mia?
22. E bëmë Kuranin të lehtë për këshillim, por kush merr mësim?

23. Përgënjeshtroi Themudi vërejtjet.
24. Thanë: "Të ndjekim një njeri të vetëm prej nesh? Do të qemë në humbje e çmenduri.
25. I paska ardhur mes nesh atij mesazhi? Jo, ai është gënjeshtar, i marrë."
26. "Do ta mësojnë nesër kush është gënjeshtar, i marrë.
27. U dërgojmë devenë si provë, vëzhgoji e bëj durim!
28. Njoftoji se uji është ndarë mes tyre, me radhë."
29. Thirrën shokun e tyre. Ai e mori dhe e gjymtoi.
30. Si qenë dënimi dhe vërejtjet e Mia?
31. U dërguam një krismë dhe mbetën si kallamat në vathë.
32. E bëmë Kuranin të lehtë për këshillim, por kush merr mësim?
33. Përgënjeshtroi kombi i Lutit vërejtjet.
34. I dërguam një stuhi. Përrjashtuar familjes së Lutit. E shpëtuan atë në agim.
35. Mirësi nga ana Jonë. Kështu shpërblejmë kë falënderon.
36. Ai i paralajmëroi me Fuqinë Tonë, por vunë vërejtjet në dyshim.
37. Ia lypën miqtë dhe Ne u shuam sytë. "Shijoni, pra, dënimin dhe vërejtjet e Mia!"
38. I zuri në mëngjes një dënim pambarim.
39. "Shijoni, pra, dënimin dhe vërejtjet e Mia!"
40. E bëmë Kuranin të lehtë për këshillim, por kush merr mësim?
41. U erdhën njerëzve të faraonit vërejtjet.
42. I përgënjeshtroan të gjitha dëshmitë Tona dhe i morëm me dënimin e një të Plotfuqishmi, Pushtetploti.
43. Këta, mohuesit tuaj, mos janë më të mirë prej tyre, apo keni ndonjë leje në shkrimet e shenjta?

44. Ose thonë: “Ne jemi një shumicë që ia arrin qëllimit.”
45. Shumica do të mundet dhe ata do të kthejnë shpinën.
(Kjo sure i përket periudhës së Mekës kur besimtarët ishin pak e të shtypur, shumë kohë para Betejës së Bedrit ku mekasit u mundën. Në atë kohë asnjëri s’e dinte si do të rridhnin ngjarjet.)
46. Ora është afati i tyre; ora është më e rëndë dhe e vështirë.
47. Mëkatarët janë në humbje e çmenduri.
48. Ditën kur tërhiqen zvarrë me fytyrë nga zjarri: “Vuajeni realitetin e ferit!”
49. Ne e krijuam çdo gjë me masë.
50. Urdhri Ynë është një herë, sa çel e mbyll sytë.
51. E rrënuam llojin tuaj, por kush merr mësim?
52. Çfarë bëjnë, është në fletë,
53. e vogël a e madhe, e shkruar në radhë.
54. Të devotshmit janë në kopshte e lumenj,
55. në pozitë të vërtetë, pranë një Sundimtari Pushtetplotë.

55. BAMIRËSI-RAHMAN (ER-RAHMAN)

Periudha e Mekës, 78 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Bamirësi-Rahman,
2. i mësoi Kuran;
3. njeriun e krijoi,
4. fjalën ia mësoi.
5. Dielli dhe Hëna me llogaritje janë.

6. Yjet dhe pemët përulur rënë kanë.
7. Ngriti qiellin dhe vuri peshojën.
8. Të mos cenoni në peshojë.
9. Peshoni drejt dhe mos mangësoni peshojën!
10. Tokën gjallesave ua shtroi,
11. me fryte, palmat me vilet mbështjellë,
12. grurin në kallinj dhe bimët plot aromë.
13. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi? (njerëz e xhinë)
14. Krijoi njeriun prej bote, si baltë e pjekur
15. dhe xhinët i krijoi prej zjarrit, flakës së kaltër.
16. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
17. Zoti i dy lindjeve, Zoti i dy perëndimeve.
18. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
19. La dy dete të takojnë,
20. mes tyre një cak që s'e kalojnë.
21. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
22. Dalin prej tyre perla e korale.
23. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
24. Të Tijat janë anijet që ngrihen në det si male.
25. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
26. Ç'është mbi të, zhduket.
27. Fytyra e tët Zoti, i Madhështisë e Nderimit, mbetet.
28. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
29. I luten Atij ç'janë në qiej e në tokë, çdo ditë është i zënë.
30. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
31. Merremi me ju, o të ngarkuar rëndë.
32. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
33. Ju turmë e xhinëve dhe e njerëzve, nga anët e qiejve dhe të tokës në mund të kaloni, kaloni! Vetëm me një fuqi mund të kaloni.
34. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?

35. Ju lëshohen flakë zjarri e shkëndija dhe s'mund të vetëmbroheni.
36. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
37. Kur të çahet qielli, si vaj i kuq të bëhet,
38. - Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?-
39. njeriu a xhini, atëherë, rreth mëkatit të vet s'do të pyetet.
40. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
41. Njihen fajtorët në çehre dhe zihen kokë e këmbë.
42. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
43. Ja ferri që mohonin fajtorët!
44. Sillen përqark tij dhe ujit të valë.
45. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
46. Cili i druhet pranisë së Zotit, ka dy kopshte.
47. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
48. Me degë.
49. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
50. Në to, që rrjedhin, dy kroje.
51. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
52. Çdo frut në to është dy lloje.
53. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
54. Mbështetur në shtroja mëndafshi, frytet e dy kopshteve pranë.
55. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
56. Në to, virgjëreshat: s'i ka prekur njeri a xhin më parë.
57. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
58. Si rubinë e korale.
59. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
60. Shpërblimi i së mirës është me të mirë.
61. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
62. Veç tyre, edhe dy kopshte.
63. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?

64. Me gjelbërim të thellë.
65. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
66. Në to, dy burime që gufojnë.
67. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
68. Ka në to fruta, hurma e shegë.
69. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
70. Në to, të ndershme e të bukura.
71. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
72. Hyri që rrinë nëpër tenda.
73. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
74. Njeri a xhin më parë s'i ka prekur.
75. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
76. Në jastëkë të gjelbër dhe halli të këndshme mbështetur.
77. Ç'të mirë të Zotit përgënjeshtroi?
78. Bekuar qoftë Emri i tët Zoti, i Madhështisë e Nderimit!

56. NDODHIA (EL VAKIA)

Periudha e Mekës, 96 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Kur të ndodhë ndodhia,
2. ndodhinë e saj kush s'e mohon,
3. dikë ul e dikë çon.
4. Kur të tronditet toka
5. e të thërrmohen malet,
6. si pluhur i derdhur,
7. jeni në tri palë:
8. Anëtarët e së djathtës, të djathtët ç'janë?

9. Anëtarët e së majtës, të majtët ç'janë?
10. Paraprijësit të parët janë.
11. Ata janë të afërmit (e Zotit),
12. në kopshtet e begata,
13. shumë nga të hershmit,
14. pak nga të vonshmit.
15. Në frona stolisur,
16. përkarshi mbështetur,
17. rreth e qark të rinj pa moshë (engjëj),
18. me kupa, ibrikë dhe gotë prej burimit,
19. pa marramendje e dehje;
20. me fryte që zgjedhin,
21. mish shpesësh që dëshirojnë,
22. me hyri syshkruara,
23. si perla të fshehura,
24. shpërblim për ato që bëjnë.
25. Fjalë të kota e mëkate atje s'dëgjojnë,
26. por të thuhet: "Paqe, paqe!"
27. Anëtarët e së djathtës, të djathtët ç'janë?
28. Mes shëlgjesh të varura,
29. bananesh të ngarkuara,
30. hijesh të shtrira,
31. ujërash që derdhen,
32. frutash të shumta,
33. pa stinë, jo të ndaluara,
34. në shtroja të larta.
35. Krijua ato,
36. i bëmë virgjëresha,
37. të dashura, moshatare,
38. për shokët e së djathtës;
39. ca nga të hershmit,
40. ca nga të vonshmit.

41. Anëtarët e së majtës, të majtët ç'janë?
42. Në afsh të nxehtë e ujë të valë
43. dhe hije tymi të zi,
44. pa prehje e qetësi.
45. Të kamur qenë më parë,
46. dhënë pas mëkatesh të mëdha
47. dhe thonin: "Kur të vdesim e të bëhemi dhé e kërcinj,
do të ngrihemi përsëri?"
48. Edhe etërit tanë të parë?"
49. Thuaj: "Po, të parët e të mbramit,
50. mblidhen në kohë të saktë.
51. Pastaj, ju, o të gabuar përgënjeshtres,
52. do të hani nga pema e ferrit,
53. të mbushni me të barqet
54. dhe të pini ujë të valë,
55. siç pinë devetë e etura."
56. Kjo është gostia e tyre Ditën e Gjykimit.
57. Ne ju krijuam, përse nuk pohoni?
58. E vini re çfarë hidhni?
59. Ju e krijuat apo Ne krijojmë?
60. Ne e përcaktojmë mes jush vdekjen, askush s'mund
të na parakalojë.
61. Që ta zëvendësojmë shembullin tuaj dhe t'ju nxjerrim
ku nuk e dini.
62. Ju dini krijimin e parë, përse nuk mendoni?
63. E vini re çfarë mbillni?
64. Ju e rrisni apo Ne rrisim?
65. Po të deshim, e bënim pluhur e hi dhe të thonit të
hutuar:
66. "Jemi të humbur!
67. Jo, na është mohuar."
68. E vini re ujin që pini?

69. Ju e zbritët nga retë apo Ne bëjmë të zbresë?
70. Po të deshim, e bënim të hidhur. Përse nuk falënderoni?
71. E vini re zjarrin që ndizni?
72. Ju e krijuat lëndën e tij apo Ne krijojmë?
73. E bëmë mesazh dhe mjet për ata që udhëtojnë.
74. Pra, thuri lavde Emrit të tët Zoti, të Madhit!
75. Nuk bëj be për yjet në të perënduar!
76. Sikur ta dinit, është betim i madh.
77. Me të vërtetë, ky është një Këndim i Nderuar,
78. në libër të ruajtur.
79. E prekin ata që janë të pastër.
80. Shpallje nga Zoti i gjithë ç'janë krijuar.
81. Kësaj fjale i lakoni?
82. Dhe ushqimin tuaj mohoni?
83. Kur fryma vjen më të dalë
84. dhe ju rrini e përgjoni,
85. Ne jemi më afër tij, por ju nuk vështroni.
86. Në jeni të pushtetshëm,
87. kthejeni atë, të vërtetën po qe se thoni!
88. Dhe ai, në qoftë ndër të afërmit,
89. ka prehje, kënaqësi dhe kopshtet e begata.
90. Në qoftë ndër anëtarët e së djathtës:
91. "Paqe për ty!" - nga anëtarët e së djathtës.
92. Në qoftë ndër përgënjeshtuesit, të gabuarit,
93. pritje me ujë të valë
94. dhe përcëllimë në zjarr.
95. Ja, kjo është e vërteta e sigurt.
96. Pra, thuri lavde Emrit të tët Zoti, të Madhit!

57. HEKURI (EL HADID)

Periudha e Medines, 29 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. I thurin lavde Zotit ç'janë në qiej e në tokë. Ai është i Plotfuqishmi, i Urti.
2. Atij i përket sundimi i qiejve dhe i tokës; jep jetë e vdes dhe është mbi gjithçka pushtetplotë.
3. Ai është fillimi e mbarimi, e dukshmja dhe e padukshmja, për gjithçka dijeplotë.
4. Është Ai që krijoi qiejt e tokën në gjashtë ditë, pastaj përqendroi pushtetin. Di ç'hyn në tokë e del prej saj, çfarë zbret nga qielli e ngjitet në të. Ai është me ju, kudo qofshi. Zoti ju sheh se ç'bëni.
5. Atij i përket sundimi i qiejve dhe i tokës; Zotit i kthehen çështjet.
6. Fut natën në ditë dhe fut ditën në natë. Ai është dijeplotë për vetë kraharorët.
7. Besoni Zotin dhe të Dërguarin e Tij dhe kontribuoni nga ku ju ka bërë trashëgimtarë. Cilët besojnë ndër ju dhe kontribuojnë, kanë shpërblim të madh.
8. Përse të mos besoni Zotin kur i Dërguari ju fton të besoni në Zotin tuaj që tashmë ka marrë besën tuaj në jeni besimtarë?
9. Është Ai që zbret mbi robin e Vet dëshmi të qarta për t'ju nxjerrë nga errësitat në dritë. Zoti është i dhembshur me ju, mëshirëplotë.
10. Përse të mos kontribuoni në Rrugën e Zotit kur Zotit i takon trashëgimia e qiejve dhe e tokës? Nuk barazohen mes jush ata që kontribuan para fitores dhe luftuan. Ata janë në pozitë më të lartë prej atyre që kontribuan më pas dhe luftuan. Zoti u premtoi të

- gjithëve parajsën. Zoti është në dijeni të veprave tuaja.
11. Kujt i huazon Zotit një hua fisnike, Ai ia dyfishon dhe ka për të shpërblim bujar.
 12. Ditën që sheh besimtarët e besimtare t'u shkojë drita para dhe nga e djathta: "Sihariq për ju janë sot kopshtet ku rrjedhin lumenj, të përhershëm në to. Ky është sukcesi i madh"
 13. Atë ditë, hipokritët dhe hipokritet u thonë besimtarëve: "Na prisni të marrim dritë nga drita juaj!" Thuhet: "Kthehuni pas e kërkon dritë!" Mes tyre ngrihet një mur i lartë me një derë: brenda, mëshira dhe jashtë, dënimi.
 14. U thërrasin: "A nuk ishim bashkë?" Thonë: "Po. Por ju mashtruat veten, pritët, dyshuat dhe mbetët me shpresa të kota gjersa erdhi urdhri i Zotit. Ju mashtroi për Zotin mashtuesi.
 15. Sot nuk merret prej jush shpërblesë, as nga mohuesit. Streha juaj është zjarri. Ai është mbrojtësi juaj. Ç'fund i keq!"
 16. A s'ka ardhur koha për besimtarët të nënshtrohen zemrat e tyre në të përmendurit e Zotit dhe të vërtetës që Ai ka shpallur? Të mos jenë si ata që u është dhënë libri më parë: zgjati për ta koha dhe iu ngurtësuan zemrat. Të shumtët e tyre janë të pabindur.
 17. Dijeni se Zoti i jep jetë tokës së vdekur. Jua sqaruar kështu dëshmitë që të mund të kuptoni.
 18. Bamirësve dhe bamirëseve që i japin Zotit një hua fisnike, Ai ua shumëfishon dhe u jep shpërblim bujar.
 19. Ata që besojnë Zotin dhe të dërguarit e Tij janë besnikët dhe dëshmitarët pranë Zotit. Kanë

shpërblimin dhe dritën e tyre. Cilët mohojnë dhe përgënjeshtrojnë dëshmitë Tona, janë banorët e skëterrës.

20. Dijeni se jeta e kësaj bote është lojë e shfaqje, stoli dhe krenari mes jush, garë në mall e fëmijë. Si një shi që i mrekullon mbjellësit gjelbërimi, pastaj zë e fishket, e sheh të zverdhur dhe bëhet byk. Në të ardhmen, një dënim i rreptë dhe falje e kënaqësi nga Zoti. Jeta e kësaj bote është iluzion.
21. Konkurroni për falje nga Zoti juaj dhe parajsë, e gjerë sa gjerësia e qiellit dhe e tokës; u gatit për ata që besojnë Zotin dhe të dërguarit e Tij. Kjo është mirësia e Zotit; ia jep atij që do. Zoti është i Mirësisë së Madhe.
22. Nuk ndodh fatkeqësi në tokë e në veten tuaj pa qenë në libër para se ta krijojmë atë. Kjo, për Zotin është e lehtë.
23. Që të mos ju vijë keq se ç'ju iku, as të vetëkënaqeni me çfarë Ai ju ka dhënë. Zoti nuk i do të vetëkënaqurit, mburracakët,
24. që janë dorështrënguar dhe porosisin njerëzit të jenë dorështrënguar. Nëse dikush kthen shpinën, Zoti është i Pasuri, i Lëvduari.
25. Dërguam të dërguarit Tanë me prova të qarta dhe zbritëm me ta Librin e peshojën që njerëzit të mbajnë drejtësi. Bëmë të zbulohej hekuri ku ka fuqi të madhe dhe përdorim për njerëzit. Ta dijë Zoti kush ndihmon Atë dhe të dërguarit e Tij në të padukshmen. Zoti është i fortë, i plotfuqishëm.
26. Dërguam Nuhin e Ibrahimin dhe caktuam te pasardhësit e tyre Profetësinë e Librin. Ndër ta ka të udhëhequr drejt, por shumë prej tyre janë të pabindur.

27. Pastaj, pasuam në gjurmët e tyre të dërguarit Tanë, pasuam me Isanë, birin e Merjemit dhe i dhamë Ungjillin; krijuam në zemrat e ndjekësve të tij dhembshuri e mëshirë. Murgërinë nuk ua caktuam Ne; e sajuan vetë për të kërkuar kënaqësinë e Zotit dhe nuk e ruajtën siç duhet ruajtur. Besimtarëve ndër ta ua dhamë shpërblimin, por shumë prej tyre janë të pabindur.
28. Besimtarë, përmbajuni Zotit dhe besoni të Dërguarin e Tij, t'ju japë dyfish, me Mëshirën e Vet, t'ju bëjë dritë të ecni nëpër të dhe t'ju falë. Zoti është falës, mëshirëplotë.
29. Ta dinë ithtarët e Librit se nuk kanë ndonjë fuqi të mirësia e Zotit. Mirësia është në Dorën e Zotit. Ia jep atij që do. Zoti është i Mirësisë së Madhe.

58. DEBATI (EL MUXHADILEH)

Periudha e Medines, 22 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Zoti e dëgjoi fjalën e asaj që bën debat me ty për të shoqin dhe ankohet te Zoti. Zoti dëgjon diskutimin tuaj. Zoti është dëgjues, largpamës.
2. Prej jush, cilët u kthejnë shpinën grave të tyre, që nuk janë nënat e tyre sepse nënat e tyre janë vetëm ato që i kanë lindur, po thonë fjalë të papëlqyeshme dhe jo të vërteta. Zoti është ndjesës, falës.

3. Ata që u deklarojnë “diharin” (duke thënë: “Shpina jote është si shpina e nënës sime.”) grave të tyre, pastaj tërhiqen nga kjo fjalë, duhet të lirojnë një skllav para se të bashkohen. Kështu porositeni. Zoti e di se ç'bëni.
4. Po të mos gjejnë, një agjërëm dy muaj me radhë para se të bashkohen. Në pamundësi, le të ushqejnë gjashtëdhjetë të varfër. Kjo, që të besoni Zotin dhe të Dërguarin e Tij. Këto janë kufijtë e Zotit. Për mohuesit, një dënim të hidhët.
5. Cilët dalin kundër Zotit dhe të Dërguarit të Tij do të poshtërohen siç u poshtëruan para tyre. Ne të shpallëm dëshmi të qarta. Për mohuesit, një dënim poshtërues.
6. Ditën që Zoti i ngre të gjithë, do t'i njoftojë se ç'kanë bërë. Zoti ua ka numëruar ndërsa ata i kanë harruar. Zoti është dëshmues për çdo gjë.
7. Nuk sheh që Zoti di ç'është në qiej e në tokë? S'ka bisedë mes treve pa qenë Ai i katërti, as mes të pestëve pa qenë Ai i gjashti. Dhe, as më pak se kaq e as më shumë, pa qenë Ai me ta kudo që të jenë. Pastaj, Ditën e Ringjalljes, i njofton se ç'kanë bërë. Zoti është për gjithçka dijeplotë.
8. Nuk ke parë nga ata që lanë pëshpëritjet dhe iu kthyen konspiracionit duke u konsultuar me mëkat, armiqësi e mosbindje ndaj Profetit? Kur vijnë tek ty, të përshëndesin jo siç të përshëndet Zoti (“Esselamu alejk!”), por thonë si çifutët: “Essamu alejk!” “Vdekje ty!”) dhe thonë në vetvete: “Përse Zoti s'na dënon me fjalët tona?” Mjafton skëterra ku do të digjen. Ç'fund i keq!
9. Besimtarë! Kur të konsultoheni, mos u konsultoni me mëkat, armiqësi dhe mosbindje ndaj Profetit, por

- konsultohuni me besimtari e devocion. Dhe kini frikë Zotin tek i Cili do të mblidheni.
10. Konspiracioni është nga djalli, për të shqetësuar besimtarët, por nuk mund t'i dëmtojë pa lejen e Zotit. Zotit t'i mbështeten besimtarët!
 11. Besimtarë! Kur ju thuhet të bëni vend në kuvend, bëni, t'ju bëjë vend Zoti dhe, kur ju thuhet të ngriheni, ngrihuni! Zoti do t'i lartësojë në gradë besimtarët mes jush dhe ata që u është dhënë dija. Zoti është në dijeni të veprave tuaja.
 12. Besimtarë, kur të konsultoheni më vete me Profetin, bëni më parë një bamirësi! Kjo është më e mirë për ju dhe më e pastër. Në qofë se nuk ia arrini, Zoti është falës, mëshirëplotë.
 13. A ju dhimbset të bëni para konsultimit një bamirësi? Në mos e keni bërë, Zoti ju fal, pra, kryeni të falurit, jepni detyrimin dhe bindjuni Zotit e të Dërguarit të Tij! Zoti jua di veprat.
 14. Nuk ke parë nga ata që zënë miq njerëz me të cilët Zoti është zemëruar? Ata s'janë me ju, as me ta dhe betohen me dijeni në gënjeshtëri.
 15. Zoti u ka përgatitur dënim të rreptë. Sa keq veprojnë!
 16. I marrin betimet si mburojë dhe pengojnë nga Rruga e Zotit. Ata kanë dënim poshtërues.
 17. Nuk do t'u vlejë ndaj Zotit malli e fëmijët. Ata janë banorët e përhershëm të zjarrit.
 18. Ditën që Zoti ngre të gjithë, i betohen Atij siç ju betuan juve. Pandehin se kanë bazë. A nuk janë ata gënjeshtarët?
 19. I mposhti djalli dhe bëri të harrojnë përmendjen e Zotit. Ata janë partia e djallit. A nuk është e humbur partia e djallit?

20. Cilët dalin kundër Zotit dhe të Dërguarit të Tij, ata janë më të ultit.
21. Zoti e ka shkruar që: "Unë dhe të dërguarit e Mi do të fitojmë." Zoti është i fortë, i plotfuqishëm.
22. Nuk do të gjesh njerëz që besojnë Zotin dhe Ditën e Fundit t'i duan ata që dalin kundër Zotit dhe të Dërguarit të Tij, qofshin etërit e tyre, bijtë e tyre, vëllezërit e tyre ose të afërmit e tyre. Në zemrat e tyre Ai shkroi besimin dhe i forcoi me shpirt prej Tij. Dhe i fut në kopshte ku rrjedhin lumenj, të përherëshëm në to. Zoti është i kënaqur prej tyre dhe ata janë të kënaqur prej Tij. Ata janë Partia e Zotit. A nuk është Partia e Zotit fitimtarja?

Titulli origjinal: "Debatuesja".

59. TUBIMI (EL HASHR)

Periudha e Medines, 24 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. I thurin lavde Zotit ç'janë në qiej e në tokë. Ai është i Plotfuqishmi, i Urti.
2. Është Ai që nxori nga shtëpitë e tyre mohuesit ithtarë të Librit në tubimin e parë (judenjtë Benu Nadir). Ju nuk besuat të dilnin ndërsa ata besuan se fortesat e tyre do t'i mbronin ndaj Zotit. U erdhi Zoti nga s'e pandehën dhe kalli në zemrat e tyre panik. I shkretuan shtëpitë me duart e tyre dhe me duart e besimtarëve. Pra, merrni shembull ju, o largpamës!

3. Sikur Zoti të mos ua kishte detyruar shpërnguljen, do t'i dënonte në këtë botë dhe, në të ardhmen, ata kanë dënimin e zjarrit.
4. Kjo, sepse iu kundërvunë Zotit dhe të Dërguarit të Tij. Kush i kundërvihet Zotit, Zoti ka për të ndëshkim të rreptë.
5. Ç'palma pretë apo i latë më këmbë, mbi rrënjët e tyre, ishte me lejen e Zotit dhe që t'i poshtëronte të pabindurit.
6. Për plaçkën e luftës që Zoti ia la në ngarkim të Dërguarit, nuk ngatë kuajtë e devetë, porse Zoti u jep autoritet të dërguarve të Tij mbi kë do. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.
7. Plaçka që Zoti ia la në ngarkim të Dërguarit të Tij, nga popullsia e vendbanimeve, është për Zotin dhe të Dërguarin e Tij (për shtetin islam), për të afërmit (në nevojë), jetimët, të varfrit, rrugëtarët, që të mos qarkullojë ndërmjet të pasurve mes jush. Ç'ju jep Profeti, merreni; ç'ju ndalon, hiqni dorë dhe kini frikë Zotin! Zoti ka ndëshkim të rreptë.
8. Edhe për emigrantët e varfër që u nxorën nga shtëpitë dhe pronat e tyre në kërkim të mirësisë e të kënaqësisë së Zotit dhe në ndihmë të Zotit e të Dërguarit të Tij. Ata janë të vërtetët.
9. Edhe atyre që përgatitën më parë vendbanimin e besimin, që i duan të shpërngulurit te ta dhe nuk gjejnë në zemrat e tyre zili nga ç'u është dhënë, por japin përparësi mbi veten edhe në janë nevojtarë. Cilët i ruhen lakmisë së nefsit, ata janë të suksesshmit.
10. Edhe atyre që erdhën më pas duke thënë: "Zoti ynë, falna neve e vëllezërit tanë që na paraprinë në besim

dhe mos na bëj në zemrat tona mëri për besimtarët!
Zoti ynë, Ti je i dhembshur, mëshirëplotë.”

11. A nuk ke parë te hipokritët duke u thënë të vëllezërve mohues ithtarë të Librit: “Po të dëboheni, do të dalim me ju dhe kurrë nuk do t’i bindemi dikujt për ju; nëse luftoheni, patjetër do t’ju ndihmojmë.” Zoti dëshmon se ata janë gënjeshtarë.
12. Në dëbohen, nuk do të dalin me ta dhe, nëse luftohen, nuk do t’u ndihmojnë. Edhe po t’i ndihmojnë, do të kthejnë shpinën e nuk përkrahen.
13. Në zemrat e tyre ju jeni më të frikshëm se Zoti. Kjo, sepse ata janë njerëz që nuk mendojnë.
14. Nuk do t’ju luftojnë në front, por vetëm në vende të mbrojtura ose pas mureve. Armiqësia mes tyre është e ashpër. I pandeh të bashkuar dhe zemrat e tyre janë të përçara. Kjo, sepse ata janë njerëz që nuk kuptojnë.
15. Sikurse ata pak më parë (Benu Kajnuka). Provuan pasojën e aktivitetit të tyre dhe kanë dënim të hidhët.
16. Si shembulli i djallit kur i thotë njeriut: “Moho!” Dhe, porsa ai mohon, thotë: “Unë jam i çliruar prej teje. Unë i frikësohem Allahut, Zotit të botëve.”
17. Fundi i të dyve është përgjithmonë në zjarr. Ja shpërblimi i dhunuesve.
18. Besimtarë, përmbajuni Zotit dhe le të shikojë secili çfarë ka përgatitur për të nesërmen. Kini frikë Zotin! Zoti është në dijeni të veprave tuaja.
19. Mos jini si ata që harruan Zotin dhe Ai i bëri të harrojnë veten. Ata janë të pabindurit.
20. Nuk barazohen banorët e zjarrit me banorët e parajsës: banorët e parajsës, ata janë fitimtarët.

21. Sikur ta zbrisnim këtë Kuran mbi një mal, do ta shihje të tronditur e bërë thërrime nga frika e Zotit. Këta shembuj i sjellim për njerëzit që të mund të mendohen.
22. Zoti, s'ka zot veç Tij, Njohësit të së padukshmes e të dukshmes, është Bamirësi, Mëshirëploti.
23. Zoti, s'ka zot veç Tij, është Mbreti, i Shenjti, Paqedhënësi, Besëtari, Mbikëqyrësi, i Plotfuqishmi, Sundimtari, Madhështori. Lavdi Zotit, i dëlirë nga ç'i shoqërojnë!
24. Zoti është Krijuesi, Zanafillësi, Trajtëformuesi. Ai ka atributet më fisnike. I thurin Atij lavde ç'janë në qiej e në tokë. Ai është i Plotfuqishmi, i Urti

60. PROVA (EL MUMTEHINE)

Periudha e Medines, 13 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Besimtarë! Në keni dalë për luftë (xhihad, përpjekje) në Rugën Time dhe në kërkim të Kënaqësisë Sime, mos bëni miq armiq të Mi dhe armiq të tuaj duke u shprehur dashuri ndërsa ata mohuan të vërtetën që ju erdhi, dëbuan Profetin dhe ju vetë sepse besoni Allahun, Zotin tuaj. Ju u mirëbesoni ndërsa Unë e di mirë se çfarë fshihni dhe ç'bëni të njohur. Kush vepron ashtu, ka gabuar rrugën e drejtë.
2. Po t'ju ndeshin, janë armiq të tuaj, zgjasin me të keq nga ju duart dhe gjuhët e tyre dhe do të dëshironin të mohonit.

3. Ditën e Ringjalljes nuk do t'ju bëjnë dobi farefisi dhe fëmijët. Ai bën mes jush ndarje. Zoti është largpamës i veprave tuaja.
4. Keni shembull të mirë te Ibrahim i dhe ata me të kur i thanë kombit të tyre: "Ne jemi çliruar prej jush e çfarë adhuronit në vend të Zotit, ju mohojmë dhe armiqësia e urrejtja mes nesh ka dalë hapur, përgjithmonë, derisa të besoni Zotin Një." Përgjithmonë fjalës së Ibrahimit të atit: "Do të kërkoj falje për ty, por unë nuk kam fuqi ndaj Zotit. Zoti ynë, tek Ty u mbështetëm, Ty të kthehemi të penduar dhe fundi është tek Ty.
5. Zoti ynë, mos na bëj provë për mohuesit, falna, Zoti ynë! Ti je i Plotfuqishmi, i Urti."
6. Keni te ata shembull të mirë për këdo që shpreson Zotin dhe Ditën e Fundit. Nëse dikush largohet, Zoti është i Pasuri, i Lëvduari.
7. Zoti mund të krijojë miqësi mes jush dhe armiqve tuaj. Zoti është pushtetplotë. Zoti është falës, mëshirëplotë.
8. Zoti nuk ju ndalon t'u bëni mirë e të jeni të drejtë me ata që nuk ju kanë luftuar në fe dhe nuk ju nxorën nga shtëpitë tuaja. Zoti i do të drejtët.
9. Zoti ju ndalon t'i bëni miq ata që ju luftuan në fe, ju nxorën nga shtëpitë tuaja dhe bashkëpunuan në dëbimin tuaj. Cilët i bëjnë miq, janë dhunues.
10. Besimtarë! Kur ju vijnë besimtare emigrante, vëriti në provë. Zoti e di besimin e tyre. Në i dini për besimtare, mos i ktheni te mohuesit. Ato nuk u lejohen atyre dhe ata nuk janë të lejuar për to. Jepuni atyre çfarë kanë shpenzuar dhe nuk është mëkat për ju të martoheni me to duke u dhënë vlerën e kurorës. Mos i mbani lidhjet martesore me idhujtaret, por kërkonit çfarë keni

- shpenzuar dhe ata le të kërkojnë çfarë kanë shpenzuar. Ky është gjykimi i Zotit. Ai gjykon mes jush. Zoti është dijeplotë, i urtë.
11. Në qoftë se ju ka kaluar diçka nga gratë tuaja te mohuesit dhe vjen radha juaj, jepuni atyre që u kanë ikur gratë çfarë kanë shpenzuar. Përmbajuni Zotit te i Cili besoni.
 12. O Profet! Kur të të vijnë besimtarët, të japin besën se nuk i bëjnë Zotit shok, se nuk vjedhin (si të varfra e pa burrë), nuk bëjnë imoralitet, nuk mbysin fëmijët e tyre, nuk mashtrojnë për pjellën e tyre, nuk do të mosbinden ty në të drejtën, pranoje zotimin e tyre dhe kërkoji Zotit falje për to. Zoti është falës, mëshirëplotë.
 13. Besimtarë, mos i bëni miq njerëzit me të cilët Zoti është zemëruar. Ata kanë humbur shpresën në të ardhmen, siç humbën mohuesit shpresën nga banorët e varreve.

Titulli origjinal: "Ajo që vihet në provë".

61. RRESHTI (ES-SAF)

Periudha e Medines, 14 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. I thurin lavde Zotit ç'janë në qiej e në tokë. Ai është i Plotfuqishmi, i Urti.
2. Besimtarë, përse thoni çfarë nuk bëni?
3. E rëndë dhe e urryer është te Zoti të thoni çfarë nuk bëni.

4. Zoti i do ata që luftojnë në Rugën e Tij, në rreshta, si një trup i vetëm.
5. Kur Musai i tha kombit të tij: “Kombi im, përse më mundoni ndërsa e dini se jam i Dërguari i Zotit të ju?” - ata u shmangën dhe Zoti ua shmangu zemrat. Zoti nuk i drejton njerëzit e pabindur.
6. Edhe kur Isai, biri i Merjemit, tha: “Bijtë e Izraelit, unë jam i Dërguari i Zotit të ju, vërtetues i Teuratit para meje dhe përgëzues i një të dërguari pas meje me emrin Ahmed” , – sapo u erdhi me prova të qarta, thanë: “Kjo është magji e hapur.”
7. Kush është më i padrejtë se ai që trillon gënjeshtër ndaj Zotit ndërsa ftohet në Islam? Zoti nuk i drejton njerëzit dhunues.
8. Duan të shuajnë me gojën e tyre Dritën e Zotit, por Zoti e plotëson Dritën e Tij edhe pse e urrejnë mohuesit.
9. Është Ai që dërgoi të Dërguarin e Vet me drejtimin dhe fenë e vërtetë për të ngadhënjyer mbi fetë edhe pse e urrejnë idhujtarët.
10. Besimtarë, t’ju tregoj një tregti që ju shpëton nga dënimi i hidhët?
11. Të besoni Zotin dhe të Dërguarin e Tij e të luftoni në Rugën e Zotit me pasuritë dhe veten tuaj. Kështu është më mirë për ju sikur ta dinit.
12. Jua fal mëkatet dhe ju fut kopshteve ku rrjedhin lumenj, në banesa të këndshme, kopshteve të Edenit. Ky është suksesi i madh.
13. Edhe tjetër të cilën e dëshironi: ndihmën e Zotit dhe një fitore të afërt. Dhe përgëzoji besimtarët!
14. Besimtarë, jini ndihmëtarët e Zotit! Siç u tha Isai, biri i Merjemit, dishepujve: “Kush janë ndihmëtarët e mi te

Zoti?” Dishepujt thanë: “Ne jemi ndihmëtarët e Zotit.” Nga bijtë e Izraelit disa besuan dhe disa mohuan. I mbështetëm besimtarët ndaj armiqve dhe ata ngadhënjyen.

62. E PREMTJA (EL XHUMUA)

Periudha e Medines, 11 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. I thurin lavde Zotit ç’janë në qiej e në tokë, Sundimtarit, të Shenjtit, të Plotfuqishmit, të Urtit.
2. Është Ai që dërgoi te populli i paditur një profet prej tyre që u reciton dëshmitë e Tij, i çliron dhe ua mëson Librin e Urtësinë ndërsa ishin më parë në gabim të hapur.
3. Edhe të tjerëve që akoma nuk u janë bashkuar. Ai është i Plotfuqishmi, i Urti.
4. Kjo është mirësia e Zotit; ia jep atij që do. Zoti është i Mirësisë së Madhe.
5. Shembulli i atyre që iu ngarkua Teurati dhe s’e mbajtën është si shembulli i gomarit që bart libra. I keq është shembulli i njerëzve që përgënjeshetrojnë dëshmitë e Zotit. Zoti nuk drejton popullin dhunues.
6. Thuaj: “O judenj! Meqë besoni se jeni miqtë e Zotit, veçan njerëzve, kërkon vdekjen në thoni të vërtetën.”
7. Kurrë s’do ta kërkonin me ç’kanë përgatitur duart e tyre. Zoti i njeh mirë dhunuesit.

8. Thuaj: “Vdekja që i ikni, ju arrin, pastaj i ktheheni Njohësit të së padukshmes e të dukshmes dhe ju njofton se ç’keni bërë.”
9. Besimtarë! Kur bëhet thirrje për lutjen e ditës së premte, nxitoni të përmendni Zotin dhe lini tregtinë. Kështu është më mirë për ju sikur ta dinit.
10. Kur të ketë mbaruar lutja, shpërndahuni në tokë dhe kërkoni mirësitë e Zotit. Përmendni Zotin shumë që të mund të keni sukses.
11. Kur shohin ndonjë tregti a dëfrim, derdhen andej e të lënë më këmbë. Thuaj: “Ç’është pranë Zotit, është më e mirë nga dëfrimi e tregtia. Zoti është Ushqyesi Më i Mirë.

63. HIPOKRITËT (EL MUNAFIKUN)

Periudha e Medines, 11 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Kur vijnë te ty, hipokritët thonë: “Dëshmojmë se je i Dërguari i Zotit.” Zoti e di që je i Dërguari i Tij. Zoti dëshmon se hipokritët janë gënjeshtarë.
2. I përdorin betimet si mburojë dhe pengojnë nga Rrugja e Zotit. Sa keq veprojnë!
3. Sepse ata besuan, pastaj mohuan, iu vulosën zemrat e nuk kuptojnë.
4. Kur i sheh, të habit paraqitja e tyre dhe, në flasin, ua dëgjon fjalën. Si të ishin trarë; u duket se çdo krismë

- rëndon mbi ta. Ata janë armiku, pra, kujdes prej tyre! I vraftë Zoti si ikin!
5. Kur u thuhet: “Ejani, të kërkojë për ju falje i Dërguari i Zotit”, – tundin kryet dhe i sheh të bëjnë mënjanë me mendjemadhësi.
 6. Njësoj për ta, kërkon apo s’kërkon falje, Zoti nuk i fal. Zoti nuk drejton njerëzit e pabindur.
 7. Të tillë që thonë: “Mos kontribuoni për ata që janë me të Dërguarin e Zotit derisa të shpërndahen.” Të Zotit janë thesaret e qiejve dhe të tokës, por hipokritët nuk kuptojnë.
 8. Thonë: “Në u kthefshim në Medine, të nderuarit do t’i dëbojnë njerëzit e ulët.” Nderi i takon Zotit, të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve, por hipokritët nuk dinë.
 9. Besimtarë, të mos ju largojnë nga përmendja e Zotit pasuria dhe fëmijët tuaj. Cilët veprojnë ashtu janë të humbur.
 10. Kontribuoni nga pjesa që ju kemi dhënë para se t’i vijë dikujt prej jush vdekja e të thotë: “Zoti im, përse nuk ma vonove në një afat të afërt, të bëja bamirësi dhe të isha me të mirët?”
 11. Zoti nuk ia vonon një fryme kur i vjen afati. Zoti është në dijeni të veprave tuaja.

64. ZHGËNJIMI (ET-TEGABUN)

Periudha e Medines, 18 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. I thurin lavde Zotit ç'janë në qiej e në tokë. Atij i përket sundimi dhe për Të janë lavdet. Ai është mbi gjithçka pushtetplotë.
2. Është Ai që ju krijoi ndërsa mes jush ka mohues e besimtarë. Zoti ju sheh se ç'bëni.
3. Krijoi qiejt e tokën me të vërtetën, ju trajtësoi në formën më të bukur dhe tek Ai është fundi.
4. Di ç'janë në qiej e në tokë, di edhe ç'fshihni e çfarë shfaqni. Zoti është dijeplotë për vetë kraharorët.
5. Nuk ju erdhi lajmi i atyre që mohuan më parë? Shijuan pasojën e veprës së tyre dhe kanë dënim të hidhët.
6. Sepse u erdhën të dërguarit me prova të qarta dhe thanë: "Të na drejtojë një njeri?" Mohuan e u larguan. Zoti s'ka nevojë. Zoti është i pasur, i lëvduar.
7. Mohuesit pandehin se nuk do të ringjallen. Thuaj: "Po, për tim Zot! Do të ringjallen e njoftoheni se ç'keni bërë. Kjo, për Zotin është e lehtë."
8. Pra, besoni Zotin, të Dërguarin e Tij dhe Dritën që zbritëm. Zoti është në dijeni të veprave tuaja.
9. Kur t'ju mbledhë Ditën e Tubimit, ajo është Dita e Zhgënjimit. Kë beson Zotin e bën të mira, ia shlyen të këqiat dhe e pranon kopshteve ku rrjedhin lumenj, i përhershëm në to, përgjithmonë. Kjo është fitorja e madhe.
10. Cilët mohojnë dhe përgënjeshtrojnë dëshmitë Tona janë banorët e zjarrit, të përhershëm në të. Ç'fund i keq!
11. Nuk ndodh fatkeqësi pa lejen e Zotit. Kujt beson Zotin, Ai ia mbarëson zemrën. Zoti është për çdo gjë dijeplotë.

12. Bindjuni Zotit dhe bindjuni të Dërguarit! Në largoheni, detyrë e të Dërguarit Tonë është fjala e qartë.
13. Zoti, s'ka zot veç Tij. Zotit t'i mbështeten besimtarët!
14. Besimtarë! Ndër gratë tuaja dhe fëmijët tuaj keni armiq, pra, kujdes! Por, nëse ndjeni, nuk vini re dhe falni, Zoti është falës, mëshirëplotë.
15. Pasuria dhe fëmijët tuaj janë provë. Zoti ka pranë Tij shpërblim të madh.
16. Përmabajuni Zotit me gjithë mundësitë tuaja, dëgjoni e binduni dhe kontribuoni në të mirën tuaj. Cilët i ruhen lakmisë së nefsit, ata janë të suksesshmit.
17. Në i huazoni Zotit një hua fisnike, Ai jua shumëfishon dhe ju fal. Zoti është mirënjohës, i butë.
18. Njohësi i së padukshmes e të dukshmes, i Plotfuqishmi, i Urti.

65. SHKURORËZIMI (ET-TALAK)

Periudha e Medines, 12 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. O Profet! Kur shkurorëzoni gratë, ndajini ato sipas periudhës së tyre dhe llogaritni periudhën. Kini frikë Allahun, Zotin tuaj! Mos i nxirrni nga shtëpitë e tyre dhe ato të mos dalin, vetëm po të kenë bërë ndonjë turp të qartë. Këto janë kufijtë e Zotit. Kush shkel kufijtë e Zotit, i ka bërë keq vetes. Ku ta dish, ndoshta Zoti bën më pas urdhër?

2. Kur të arrijnë afatin, mbajini me mirëkuptim ose ndajini me mirëkuptim dhe bëni të dëshmojnë dy vetë të drejtë mes jush. Bëni dëshminë për Zotin. Kështu këshillohet kushdo që beson Zotin dhe Ditën e Fundit. Kujt i përmbahet Zotit, Ai i bën zgjidhje.
3. Dhe e ushqen nga s'e mendon. Kujt i mbështetet Zotit, Ai i mjafton. Zoti ia arrin qëllimit. Zoti ka bërë masë në çdo gjë.
4. Afati i grave që i kanë lënë të përmuajshmet, nëse dyshoni, është tre muaj. Edhe për ato që s'kanë të përmuajshme. Gratë shtatzëna kanë afat derisa të lindin. Kujt i përmbahet Zotit, Ai ia lehtëson çështjen.
5. Ky është urdhri i Zotit që zbriti te ju. Kujt i përmbahet Zotit, Ai ia shlyen të këqiat dhe ia shton shpërblimin.
6. Strehojini ato atje ku ju banoni, me mundësitë tuaja dhe mos ua vështirësoni për t'i zënë ngushtë. Po të jenë shtatzëna, shpenzoni për to derisa të lindin. Në qoftë se japin gji për ju (për foshnjën tuaj), jepuni shpërblimin dhe këshillohuni me mirëkuptim. Në hasni vështirësi, të japë gji një tjetër.
7. Le të shpenzojë i kamuri nga kamja e tij dhe ai që e ka gjendjen të kufizuar, le të shpenzojë me ç'i ka dhënë Zoti. Zoti nuk ngarkon një frymë, por me aq sa i ka dhënë. Pas vështirësisë, Zoti bën lehtësi.
8. Sa e sa vendbanime shkelën urdhrin e Zotit dhe të dërguarve të Tij, i morëm në llogari të rreptë dhe i ndëshkuam me dënim të keq.
9. Shijuan pasojën e çështjes së tyre dhe fundi i çështjes së tyre qe humbje.
10. Zoti u përgatiti dënim të rreptë, pra, përmbajuni Zotit, ju o të mençur besimtarë! Zoti ju zbriti kujtesë,

11. një të dërguar që ju reciton dëshmitë e qarta të Zotit, për t'i nxjerrë ata që besojnë e bëjnë të mira nga errësirat në dritë. Kë beson Zotin dhe bën të mira, Ai e fut kopshteve ku rrjedhin lumenj, të përhershëm në to, përgjithmonë. Zoti i ka bërë pjesë të mirë.
12. Zoti është Ai që krijoi shtatë qiej, si ato, edhe toka. Zbret mes tyre urdhri, ta dini se Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë dhe se Zoti përfshin çdo gjë me dije.

66. NDALIMI (ET-TAHIRM)

Periudha e Medines, 12 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. O Profet! Përse ndalon diçka që Zoti ta lejoi duke kërkuar pëlqimin e grave tuaja? Zoti është falës, mëshirëplotë.
2. Zoti ju përcaktoi zgjidhjen e betimeve tuaja. Zoti është Mbrojtësi juaj; Ai është Dijeploti, i Urti.
3. Kur Profeti i besoi një lajm njëres prej grave të tij dhe ajo e bëri të njohur, Zoti ia zbuloi këtë, ndërsa ai pati treguar një pjesë e lënë një pjesë. Kur e njoftoi, ajo tha: “Kush të njoftoi?”- tha: “Më njoftoi Dijeploti, i Gjithëdituri.”
4. Sikur ju të dyja të pendoheshit te Zoti, sepse zemrat tuaja anuan, nëse bashkëpunoni kundër tij, Zoti është Mbrojtësi i tij, edhe Xhibrili, edhe besimtarët e drejtë, edhe engjëjt janë më pas në ndihmë.

5. Në qoftë se ai ju ndan, Zoti mund t'ia zëvendësojë me gra më të mira nga ju, muslimane, besimtare, të bindura, penduese, adhuruese, agjëruese, të martuara e beqare.
6. Besimtarë, ruani veten dhe familjen tuaj nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit e idhujt! Mbi të, engjëjt e ashpër, të rreptë, nuk kundërshtojnë Zotin në urdhrin e Tij, por bëjnë ç'urdhërohen.
7. Mohues, sot mos u shfajësoni! Shpërbleheni vetëm me ç'keni bërë.
8. Besimtarë, pendohuni te Zoti me pendim të singertë! Ndoshta Zoti jua shlyen të këqiat dhe ju pranon kopshteve ku rrjedhin lumenj, ditën kur Zoti nuk do t'i poshtërojë Profetin dhe besimtarët me të. U shkon drita në ballë e më të djathtë dhe thonë: "Zoti ynë, plotësona dritën tonë dhe falna! Ti je mbi gjithçka pushtetplotë."
9. O Profet, luftoji mohuesit e hipokritët dhe ji me ta i rreptë. Streha e tyre është skëterra, ç'fund i keq!
10. Zoti u sjell shembull mohuesve gruan e Nuhit dhe gruan e Lutit. Ato ishin nën dy robtë Tanë të mirë, i tradhtuan dhe nuk u vlejti gjë ndaj Zotit, por iu tha: "Hyni me të tjerët në zjarr!"
11. Zoti u sjell shembull besimtarëve gruan e faraonit kur tha: "Im Zot! Bëmë pranë Teje banesë në parajsë dhe shpëtomë prej faraonit dhe veprës së tij, shpëtomë nga njerëzit tiranë!"
12. Edhe Merjemin, bijën e Imranit, që ruajti nderin e saj. Ne i frymë nga Shpirti Ynë dhe ajo besoi në fjalët e Zotit dhe librat e Tij dhe ishte e bindur.

67. SUNDIMI (EL MULK)

Periodha e Mekës, 30 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Bekuar qoftë Ai në Dorën e të Cilit është sundimi! Ai është mbi gjithçka pushtetplotë.
2. Ai që krijoi vdekjen dhe jetën, për t'ju provuar kush është më i mirë në vepra, i Plotfuqishmi, Falësi.
3. Ai që krijoi shtatë qiej në shtresa. Nuk sheh mungesë në krijimin e Bamirësit-Rahman. Ktheje vështrimin! Mos sheh ndonjë të çarë?
4. Ktheje edhe njëherë vështrimin, të të kthehet vështrimi i mekur, i lodhur.
5. E stolisëm qiellin e botës me kandilë dhe i bëmë gjuajtës për djajtë. Bëmë për ta gati dënimin në zjarrin e përflaktë.
6. Edhe për ata që mohojnë Zotin, dënimin në skëterrë. Ç'fund i keq!
7. Kur të hidhen në të, ia dëgjojnë hungërimën tek gufon.
8. Nga tërbimi, gati shpërthen. Sa herë hidhet një turmë, roja pyet: "A s'ju erdhi paralajmërues?"
9. Thonë: "Po, na erdhi paralajmërues, përgënjeshtroam e thamë: "Zoti nuk ka zbritur gjë, porse ju jeni në gabim të rëndë."
10. Thonë: "Sikur të dëgjonim e të mendonim, nuk do të ishim te banorët e zjarrit të përflaktë."
11. I pranojnë mëkatet, pra, larg banorëve të zjarrit të përflaktë!
12. Cilët i frikësohen Zotit në të padukshmen, kanë falje dhe shpërblim të madh.

13. E fshihni fjalën apo e thoni hapur, Ai është dijeplotë për vetë kraharorët.
14. Nuk di Ai që krijoj, i Ndjeshmi, i Gjithëdituri?
15. Është Ai që bëri për ju tokën shtruar, ecni nëpër shpatet e saj dhe ushqeheni me ushqimin e Tij. Rikthimi është tek Ai.
16. Jeni të sigurt se Ai në qiell nuk e fundos bashkë me ju tokën kur, ja, ajo tronditet?
17. Jeni të sigurt se Ai në qiell nuk ju dërgon një ciklon, ta dini si është paralajmërimi Im?
18. Përgënjeshtroan më parë dhe si qe mospëlqimi Im?
19. Nuk shohin shpendët sipër duke u hapur e mbledhur në radhë? Ç'i mban ato veç Bamirësit-Rahman? Ai është largpamës për çdo gjë.
20. Çfarë ushtrie do t'ju ndihmonte veç Bamirësit-Rahman? Mohuesit janë në mashtrim.
21. Cili ju ushqen nëse Ai e mban ushqimin? Porse ata këmbëngulin me mosbindje e largim.
22. Kush është më drejt, dikush që shkon përmbys apo që ecën mbarë, në udhë të drejtë?
23. Thuaj: "Është Ai që ju solli në krijim dhe bëri për ju të dëgjuarit, të parët e zemrat. Ju pak falënderoni."
24. Thuaj: "Është Ai që ju përhapi në tokë dhe tek Ai do të mblidheni."
25. Thonë: "Kur realizohet kjo në thoni të vërtetën?"
26. Thuaj: "Dija është pranë Zotit. Unë jam vetëm një paralajmërues i qartë."
27. Kur ta shohin nga afër, mohuesve u prishen fytyrat dhe thuhet: "Ja çfarë kërkuat!"
28. Thuaj: "E kuptoni, nëse Zoti na asgjëson mua e ç'janë me mua ose na mëshiron, kush i mbron mohuesit nga një dënim i hidhur?"

29. Thuaj: “Është Bamirësi - Rahman. Ne Atë besojmë dhe te Ai mbështetemi. Ju do ta mësoni cili është në gabim të hapur.”
30. Thuaj: “E kuptoni, nëse ujët shteron, kush ju sjell ujë që buron?”

68. PENA (EL KALEM)

Periudha e Mekës, 52 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Nun ("n"). Për penën dhe shkrimin,
2. me mirësinë e tët Zoti, nuk je i marrë!
3. Për ty, një shpërblim të pashterë.
4. Ti je mbi moral të lartë.
5. Do ta shohësh e ta shohin,
6. kush është i marrë.
7. Yt Zot e di cili nga Rruga e Tij ka shkarë. Ai i di ata në udhë të mbarë.
8. Mos iu bind atyre që përgënjeshtrojnë.
9. Duan të lakosh e të lakojnë.
10. Mos iu bind një premtuesi të pavlerë,
11. përfolësi me shpifje poshtë e përpetë,
12. penguesi të së mirës, shkelësi, mëkatari,
13. të pamëshirshmi, më tej, të pafismi,
14. sepse ka mall e fëmijë.
15. Kur i lexohen dëshmitë Tona, thotë: “Rrëfenja nga të parë.”
16. I bëjmë një damkë në fytyrë.

17. I vumë në provë siç provuam të zotët e kopshtit tek u zotuan të vilnin patjetër në agim.
18. Dhe nuk bënë përjashtim (nuk thanë: "Në dashtë Zoti!").
19. Kur po flinin, i shkoi përqark nga yt Zot një furtunë.
20. Dhe u bë si i shirë.
21. I thirrën njëri-tjetrit me t'u gdhirë:
22. "Dilni herët te të vjelat në keni për të vjelë!"
23. Dolën pa bërë zë:
24. "I varfër, sot, të mos hyjë!"
25. Dhe shkuan të vendosur në një qëllim.
26. Kur e panë, thanë: "Paskemi gabuar udhë!"
27. "Jo, na është mohuar!"
28. Më i maturi i tyre tha: "Nuk ju thashë Zotin të kishit lëvduar?"
29. Thanë: "Lëvduar qoftë Zoti ynë! Ishim të padrejtë."
30. Iu kthyen njëri-tjetrit me qortim.
31. Thanë: "Të mjerët ne, e kishim tepruar!"
32. Ndoshta Zoti ynë na e këmben me diçka më të mirë. Zotit tonë i jemi përgjëruar."
33. Kështu është dënimi. Porse dënimi i së ardhmes është më i madh sikur ta dinin.
34. Të devotshmit kanë pranë Zotit të tyre kopshtet e begata.
35. T'i bëjmë muslimanët si mëkatarët?
36. Ç'është me ju që kështu gjykoni?
37. Mos keni ndonjë libër ku mësoni?
38. Dhe gjeni në të çfarë dëshironi?
39. Apo keni zotimet Tona deri Ditën e Ringjalljes siç gjykoni?
40. Pyeti, kush ndër ta i siguron?
41. Mos kanë idhujt që shoqërojnë? Le t'i sjellin shoqëruesit e tyre të vërtetën në thonë.

42. Ditën që dalin nga varret dhe u bëhet thirrje t'i falen Zotit, nuk do të munden.
43. Të mjera janë vështirimet e tyre, i mbulon poshtërimi. U ftuan t'i përulëshin sa ishin gjallë.
44. M'i lini Mua cilët përgënjeshtrojnë këtë fjalë. T'i shpiem hap pas hapi ku nuk e dinë.
45. U jap kohë, por plani Im është i sigurt.
46. Mos po u kërkon shpërblim dhe borxhi u rëndon?
47. Apo është me ta e fshehta dhe mbajnë shënim?
48. Duro për vendimin e tët Zoti dhe mos ji si ai i peshkut kur thirri në dëshpërim.
49. Të mos ia arrinte mirësia e Zotit, do të hidhej me faj në djerrinë.
50. Zoti e zgjodhi dhe e bëri udhëheqës në rrugën e drejtë.
51. Kur dëgjuan Kuranin, mohuesit, me vështirimet e tyre, gati do të bënin të kishe shkarë. Dhe thonë se është i marrë.
52. Për botët është kujtesë.

69. E PASHMANGSHMJA (EL HAKKAH)

Periudha e Mekës, 52 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. E pashmangshmja.
2. E pashmangshmja ç'është?
3. Ku ta dish ti e pashmangshmja ç'është?
4. Përgënjeshtroan Themudi dhe Adi katastrofën.

5. Themudi u shkatërrua nga një shpërthim i papërmbajtshëm.
6. Dhe Adi u shkatërrua nga një uragan i furishëm.
7. Ua lëshoi Ai për shtatë netë e tetë ditë me radhë. I shihje njerëzit shembur në tokë, si trungje palme të kalbur.
8. Mos sheh prej tyre ndonjë të mbetur?
9. Edhe faraoni, pararendësit dhe vendbanimet që u përmbysën, erdhën me faje.
10. Nuk iu bindën të Dërguarit të Zotit dhe Ai i mori me ndëshkim në rritje.
11. Kur vërshoi uji, ju bartëm në anije.
12. Si mesazh për ju dhe ta mbajë atë një vesh që mban kujtesë.
13. Kur t'i fryhet bririt vetëm një herë
14. dhe të shkulen toka e malet, të rrafshohen menjëherë,
15. ndodh ndodhia atëherë.
16. Çahet qielli. I brishtë është atëherë.
17. Në skaje, engjëjt; mbi ta, tetë, bartin fronin e tët Zoti atë ditë. (fig. siç bartin fronin mbretëror.)
18. Atëherë, dilni në shesh; nuk fshihet prej jush ndonjë e fshehtë.
19. Kujt i jepet libri në dorën e djathtë, thotë: "Lexojeni librin tim, ja tek është!
20. Unë besova ta shoh llogarinë."
21. Pra, ai, në jetë të këndshme është,
22. në kopsht të lartë,
23. me vile frutash pranë.
24. "Hani e pini, ju bëftë mirë, me ç'bëtë gati ditët që kaluar kanë!"
25. Kujt i jepet libri në dorën e majtë, thotë: "Ah, sikur libri të mos më qe dhënë

26. dhe të mos e dija llogarinë!
27. Sikur të qe fundi im!
28. Nuk më vlejti malli
29. dhe më ra autoriteti.”
30. “Merreni e lidheni,
31. pastaj, në zjarr hidheni!
32. Pastaj, në vargonj shtatëdhjetë kut të gjatë futeni.”
(zjarri dhe vargonjtë e lakmive tokësore)
33. Nuk besonte Zotin, të Madhin.
34. Dhe nuk nxiste për të ushqyer të varfrin.
35. Sot, këtu, nuk ka mik.
36. As ushqim, por rrjedhë nga plagët.
37. Ushqehen me të mëkatarët.
38. Nuk betohem në çfarë shihni
39. e nuk shihni,
40. se kjo është fjala e një të Dërguari të Nderuar
(Xhebrailit që ia përcolli Muhammedit a.s.),
41. nuk është fjalë poeti. Ju pak besoni.
42. As fjalë falltari. Ju pak mendoheni.
43. Shpallje nga Zoti i botëve.
44. Sikur për Ne ai fjalë të trillonte,
45. e zinin në të djathën,
46. ia merrnim jetën.
47. Askush nga ju nuk mund ta shpëtonte.
48. Kjo është këshillë për të devotshmit.
49. Ne i dimë ndër ju përgënjeshtresit.
50. Është mjerim për mohuesit.
51. E vërteta e sigurt.
52. Thuri lavde Emrit të Zotit tënd, të Madhit!

70.LARTËSITË (EL MEARIXH)

Periodha e Mekës, 44 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Pyeti një pyetës për ndodhinë e dënimit
2. të mohuesve. Askush nuk e prapson.
3. Nga Allahu, Zoti i Lartësive.
4. Ngjiten drejt Tij engjëjt dhe Shpirti në një ditë sa pesëdhjetë mijë vjet.
5. Pra, duro me një durim të vendosur.
6. Ata e shohin larg,
7. Ne e shohim afër.
8. Ditën kur qielli të bëhet si bakër i derdhur
9. dhe malet të jenë si lesh i hedhur,
10. kur miku për mikun s'ka për të pyetur,
11. por shohin njëri-tjetrin. Do të deshte mëkatari dënimin e asaj dite ta pagonte me të bijtë,
12. me gruan e vëllanë,
13. farefisën që i dha strehë,
14. që ta shpëtonin, me krejt ç'janë në tokë.
15. Por, jo. Ferri i përflakur,
16. i ethshëm të djegë,
17. thërret kë ikën e largohet,
18. që grumbullon e vë mënjanë.
19. Njeriu u krijua jo i qetë.
20. Kur e zë e keqja, ankohet;
21. kur e zë e mira, tërhiqet.
22. Përveç atyre që falen,
23. të rregullt kur falen,
24. që në mallin e tyre është një e drejtë e njohur
25. për lypësin e nevojtarin;
26. që pohojnë Ditën e Gjykimit

27. dhe shqetësohen nga dënimi i Zotit,
28. sepse dënimin e Zotit nuk mund t'i shpëtohet;
29. që ruajnë nderin,
30. - nuk fajësohen për bashkëshortet dhe robinjat e tyre;
(Shih 4:25),
31. bëjnë shkelje nëse lakmojnë më tej; -
32. që mbajnë amanetet dhe besën e dhënë
33. dhe në dëshminë e tyre qëndrojnë,
34. që ritet e adhurimit respektojnë.
35. Këta, në kopshte, janë të nderuar.
36. Përse mohuesit, të dalldisur, nga ty nxitojnë?
37. Djathtas e majtas, në turmë?
38. Mos lakmon secili prej tyre në kopshtin e begatë të
hyjë?
39. Por, jo! Nga se i krijuam, ata e dinë.
40. Nuk betohem në Zotin e lindjeve dhe të perëndimeve
që Ne jemi të pushtetshëm
41. t'i zëvendësojmë me më të mirë. Askush nuk mund të
na parakalojë.
42. Le të zhyten në fjalë të kota e lojë derisa të takojnë
ditën që u paralajmëruan.
43. Ditën kur dalin nga varret me nxitim, si të shtyheshin
drejt një qëllimi,
44. të përulura janë vështrimet e tyre dhe i mbulon
poshtërimi. Ja, kjo është dita e paralajmëruar!

71. NUHI (NUH)

Periudha e Mekës, 28 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Dërguam Nuhin te kombi i tij: “Paralajmëro kombin tënd para se t’i vijë një dënim i hidhur.”
2. Tha: “Kombi im! Unë jam për ju një paralajmërues i qartë.
3. Adhuroni Zotin, përmbajuni Atij dhe bindmuni!
4. T’jua falë mëkatet dhe t’ju lërë deri në një afat të caktuar. Kur vjen afati i Zotit, sikur ta dinit, nuk ka të vonuar.”
5. Tha: “Im Zot, i thirra kombit tim natën e ditën.
6. Por thirrja ime ia shtoi ikjen.
7. Sa herë u bëja thirrje që t’i falje, zinin veshët e mbulonin kryet, këmbëngulnin dhe, me mendjemadhësi, mburreshin.
8. Pastaj u thirra hapur.
9. I njoftova publikisht e fshehur.
10. Dhe thashë: “Kërkoni falje Zotit. Vërtet, Ai është Falës i Madh.
11. Ju sjell qiellin me rrëke
12. dhe ju shton me mall e fëmijë. Bën për ju kopshte e lumenj.
13. Në madhështinë e Zotit përse nuk shpresoni?
14. Ai ju krijoi në faza.
15. Nuk shihni si krijoi Zoti shtatë qiej në shtresa?
16. Bëri Hënën me dritë dhe Diellin një llambë.
17. Zoti ju rriti nga toka në rritje.
18. Pastaj ju kthen në të dhe ju nxjerr në dalje.
19. Zoti bëri për ju tokën në shtrirje.
20. Që të mund të përshkoni në të udhë e shtigje.”
21. Tha Nuhi: “Im Zot, më kundërshtuan dhe ndoqën kë malli e fëmijët e çuan në humbje.
22. Plane të mëdha sajuan.

23. Dhe thanë: "Zotat tuaj mos i lini! Mos lini Veddan e Suvaan, Jeguthin, Jeukën dhe Nesren." (emra perëndish të kohës së Nuhit, trashëguar ndër shekuj te fiset arabe)
24. Ata gabuan shumë, pra, shtoju dhunuesve humbje!"
25. Për fajet e tyre u mbytën dhe në zjarr u futën. Veç Zotit, ndihmëtarë nuk gjetën.
26. Tha Nuhi: "Im Zot! Mos lër banor mbi tokë mohues!
27. Në i lë, robtë e Tu do t'i gabojnë dhe s'do të lindin, veçse keqbërës e mohues.
28. Im Zot! Falëm mua, prindërit e mi dhe cilët hynë në shtëpinë time si besues, besimtarë e besimtare. Dhe jepu dhunuesve humbje!"

72. XHINËT (EL XHINN)

Periudha e Mekës, 28 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Thuaj: "M'u kumtua se disa xhinë dëgjuan e thanë: "Dëgjuam një këndim të mrekullueshëm,
2. që udhëheq tek arsyja; e besuam dhe nuk do t'i shoqërojmë Zotit tonë dikë.
3. E lartë është madhështia e Zotit tonë! Ai nuk bën bashkëshorte e djalë.
4. Një i pamendi jonë thotë ndaj Zotit fjalë të rëndë.
5. Mendojmë se njerëzit e xhinët nuk duhet të thonë ndaj Zotit të paqenë.
6. Ndër njerëzit, ka individë që kërkojnë mbrojtjen e individëve xhinë. Këta të keqen ua shtojnë.

7. Ata besojnë, siç keni besuar ju, se Zoti nuk ringjall dikë.
8. Ne prekëm qiellin dhe e gjetëm plot me roja të rrepta e predha flake.
9. Qëndruam atje të dëgjonim, por, tashmë, kë përgjon, e pret një flakërimë gati.
10. Nuk dimë a është në të keqen e atyre në tokë apo Zoti dëshiron t'i drejtojë.
11. Ndër ne ka të mirë dhe jo të tillë. Ne jemi në grupime të ndryshme.
12. Ne besojmë se nuk mund t'i shpëtojmë Zotit në tokë dhe nuk i shpëtojmë në ikje.
13. Kur dëgjuam udhëzimin, e besuam. Kush beson Zotin, nuk i frikësohet ndonjë humbjeje e të keqeje.
14. Ndër ne ka muslimanë e të shmangur. Cilët u bënë muslimanë, zunë udhën e drejtë.
15. Të shmangurit janë lënda djegëse e ferrit.”
16. Po t'i përmbaheshin udhës, do t'i begatonim.
17. Për t'i vënë në provë. Dhe, kujt shmanget nga përmendja e Zotit, Ai i hap udhën e një dënimi të vështirë.
18. Faltoret janë për Zotin, pra, mos lusni me Zotin dikë tjetër.
19. Kur robi i Zotit u ngrit t'i falej, gati sa s'i hipën sipër.
20. Thuaj: “I falem tim Zoti dhe nuk shoqëroj me Të tjetër.”
21. Thuaj: “Unë nuk zotëroj për ju dëm e dobi.”
22. Thuaj: “Mua s'do të më mbronte kush nga Zoti, as të gjeja, veç Tij, strehë.
23. Një komunikim nga Zoti dhe mesazhet e Tij.” Kush nuk i bindet Zotit dhe të Dërguarit të Tij, ka zjarrin e ferrit ku është i përhershëm , përgjithmonë.

24. Kur ta shohin të realizuar paralajmërimin, do ta kuptojnë se cili është më i dobët në përkrahës dhe më pak në numër.
25. Thuaj: “Nuk di në është afër paralajmërimi apo im Zot i bën kohë.”
26. Njohësi i së fshehtës, nuk ia zbulon kujt të fshehtën e Tij.
27. Përveç të dërguarve që Ai miraton dhe i përcjell para e pas me vëzhgues.
28. Ta dijë se i komunikuan mesazhet e Zotit. Ai përfshin e kontrollon gjithçka me saktësi.

73. I MBËSHTJELLI (EL MUZZEMMIL)

Periodha e Mekës, 20 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. O i mbështjellë!
2. Ngrehu natën përveçse pak,
3. gjysmën ose më pak
4. a më shumë dhe recito me ritëm Kuran.
5. Ne do të të përcjellim fjalë me peshë.
6. Qëndrimi natën e ka gjurmën të rëndë dhe fjalën me gjurmë.
7. Ditën ke endje të gjatë.
8. Përmende Emrin e tët Zoti dhe kushtoj Atij me kushtim.
9. Zoti i Lindjes dhe i Perëndimit. S'ka zot veç Tij. Atë merre në besim.

10. Duro fjalët e tyre dhe largoju i denjë.
11. Lërmi Mua përgënjeshtresit e kamur dhe shtyjua një kohë.
12. Te Ne ka pranga e flakë,
13. ushqim që ngel në fyt dhe dënim të hidhur,
14. ditën kur shkunden toka e malet dhe bëhen malet përgje me rërë.
15. Dërguam te ju një të dërguar, dëshmues ndaj jush, siç dërguam te faraoni të dërguar.
16. Faraoni kundërshtoi të dërguarin dhe Ne e morëm me të rreptë.
17. Në mohoni, si do t'i ruheshit një dite që i bën fëmijët të thinjtë?
18. Çahet qielli dhe Fjala e Tij është e bërë.
19. Kjo është këshillë; kush të dojë, te Zoti i tij të marrë udhë.
20. Yt Zot e di se qëndron gati dy të tretën e natës, gjysmën a të tretën e saj. Edhe një grup nga ata me ty. Zoti mat natën e ditën. Ai e di se ju nuk mund ta llogaritni dhe ju fal. Lexoni Kuran ç'të jetë lehtë. Ai e di se ka ndër ju të sëmurë, të tjerë që udhëtojnë në tokë duke kërkuar mirësitë e Zotit dhe të tjerë që luftojnë në Rrugën e Zotit. Pra, lexoni prej tij ç'të jetë lehtë. Kryeni të falurit, jepni detyrimin dhe huajini Zotit një hua fisnike. Ç'të mirë i përgatisni vetes, e gjeni pranë Zotit, më të mirë dhe me shpërblim më të madh. Kërkoni falje Zotit sepse Zoti është Falës, Mëshirëplotë.

74. I MBULUARI (EL MUDETHHIR)

Periodha e Mekës, 56 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. O i mbuluar!
2. Ngrehu e lajmëro,
3. Zotin tënd madhëro,
4. petkat tua i pastro,
5. të papastrës (idhujtarisë) iu largo;
6. në bën një të mirë, të përfitosh mos kërko,
7. për tët Zot duro! (Pas vargjeve 1-5 të kreut 96, me këto ajete fillon shpallja publike e Kuranit.
8. Kur t'i fryhet borisë,
9. është ditë e vështirë,
10. për mohuesit jo e lehtë.
11. Lërma Mua kë të vetëm e krijova,
12. që i bëra mall dhe ia shtova,
13. me djem pranë,
14. udhën ia sheshova.
15. Pastaj lakmon t'ia shtoj.
16. Jo! Armik i dëshmive Tona,
17. rëndë do ta ndëshkoj.
18. Mendoj dhe mori një vendim.
19. U vraftë, ç'vendim!
20. Përsëri, u vraftë, ç'vendim!
21. Pastaj hodhi një vështirim.
22. U vrenjt e u bë zi.
23. Pastaj u kthye me krenari.
24. Dhe tha: "E vjetër magji,
25. fjalë e njeriut."
26. Do t'ia vë zjarrit.
27. A e di ti ç'është ky zjarr?

28. Nuk kursen e lë gjë.
29. Lëkurëpërzhitës.
30. Nëntëmbëdhjetë janë mbi të.
31. Roja të zjarrit i bëmë engjëjt, numrin e tyre, tundim për mohuesit. Le të binden ata të Librit dhe t'u shtohet besimtarëve besimi. Të mos dyshojnë ata të Librit e besimtarët dhe të thonë zemërsëmurët e mohuesit: "Ç'ka dashur Zoti me këtë shembull?" Kështu, Zoti lë të gabojë atë që do dhe drejton atë që do. Veç Tij, askush s'e di ushtrinë e tët Zoti. Kjo, për njeriun është kujtesë.
32. Jo, për Hënë!
33. Për natën kur ikën
34. dhe agimin kur ndriçon!
35. Është ndër më të mëdhatë,
36. për njeriun, lajmëresë.
37. Për këdo që dëshiron të shkojë përpara a prapa të mbesë.
38. Secili është peng i fitimit të tij.
39. Por jo të djathtët.
40. Në kopshte pyesin
41. nga mëkatarët:
42. "Ç'ju solli në zjarrin e ferrit?"
43. Thonë: "Nuk faleshim,
44. nuk ushqenim të varfrit,
45. merreshim me fjalë të kota,
46. përgënjeshtrojmë Ditën e Gjykimit,
47. derisa na erdhi vdekja."
48. Nuk u bën dobi e ndërhyrësve ndërhyrja.
49. Përse largohen nga Kujtesa?
50. Si gomerë të trembur
51. që ikin prej luanit?

52. Jo! Secili ndër ta dëshiron t'i jepen fletë të hapura.
53. Dhe nuk i frikësohen së ardhmes.
54. Por kjo është kujtesë.
55. Kush të dojë e kujton.
56. E kujtojnë në dashtë Zoti. Zoti i devocionit dhe i faljes.

75. RINGJALLJA (EL KIJAMEH)

Periudha e Mekës, 40 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Nuk bëj be në Ditën e Ringjalljes!
2. Nuk bëj be në shpirtin vetëqortues! (Kurani përmend tri gjendje të nefsit (ndërgjegjes): prirë nga e keqja (12:53), qortues ndaj vetvetes dhe shpirt i qetë (89:27)
3. Pandeh njeriu se nuk do t'ia mbledhim eshtrat?
4. Po! Ne kemi fuqi t'ia përvijojmë mollëzat.
5. Njeriu dëshiron të mos i besojë së ardhmes.
6. Pyet: "Kur është Dita e Ringjalljes?"
7. Kur të verbohët shikimi
8. e të merret hëna,
9. të bashkohen dielli dhe hëna,
10. thotë atëherë njeriu: "Ku është vendshpëtimi?"
11. Jo, nuk ka vendstrehim.
12. Tek yt Zot është atëherë vendqëndrimi.
13. Ç'bëri gati e ç'la pas, njeriu atë ditë njoftohet.
14. Jo, pasqyrë e vetvetes është njeriu,
15. edhe po të shfajësohet.
16. Ti, mos u ngut në këndimin e tij.
17. Te Ne është hartimi dhe këndimi i tij.
18. Kur e recitojmë, ndiqe këndimin e tij!

19. Pastaj, te Ne është sqarimi i tij.
20. Por ju doni të përkohshmen
21. dhe lini pas të ardhmen.
22. Atë ditë, fytyra të shndritura,
23. te Zoti i tyre duke shikuar.
24. Atë ditë, fytyra të trishtuara,
25. ç'fatkeqësi i pret, duke menduar.
26. Jo! Kur fryma vjen më të dalë
27. dhe thuhet: "Kush e shëron?"
28. - beson se është ndarë,
29. këmbëpuqur,
30. tek yt Zot atë ditë shkon.
31. Nuk besoi e adhuroi,
32. por mohoi e u largua,
33. shkoi në familje dhe u lëvdua.
34. Mjerim për ty, mjerim!
35. Përsëri, mjerim për ty, mjerim!
36. Beson njeriu të lihet pa qëllim?
37. A nuk ishte pikë lëngu e lëshuar,
38. pastaj gjak i ngjizur dhe Ai e krijoi e formoi,
39. bëri prej tij palën, mashkullin e femrën?
40. Nuk është Ai i aftë të ngjallë të vdekurin?

76. NJERIU (EL INSAN)

Periudha e Medines, 31 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. A erdhi për njeriun kohë e të mos përmendej?

2. E krijuam njeriun prej një pike lëngu të përbërë që ta vëmë në provë. E bëmë të dëgjojë e të shikojë.
3. E drejtuam në udhë, qoftë mirënjohës a mosmirënjohës.
4. Mohuesve u bëmë gati vargonj, pranga e zjarr.
5. Të vërtetshmit do të pijnë prej një gote, në esencë, kamfur.
6. Burim ku robtë e Zotit pijnë dhe e bëjnë të gufojë.
7. Përmbushin zotimet dhe i frikohen një dite e keqja e së cilës është e gjerë.
8. Ushqejnë me vetëdashje të varfrin, jetimin e robin:
9. “Ju ushqejmë për hir të Zotit. Nuk duam prej jush shpërblim e falënderim.
10. I trembemi nga Zoti ynë një dite të zymtë e plot trishtim.”
11. I ruajti Zoti nga e keqja e asaj dite dhe u dha dritë e gëzim.
12. I shpërbleu për durimin e tyre me parajsë e shkëlqim.
13. Mbështetur në frona, nuk shohin atje vapë e të ftohtë.
14. Mbi ta, pranë, hije dhe vile rënë.
15. Përreth, enë të argjendta dhe kupa kristali.
16. Me kristale argjendi. I mbushin me masë.
17. U jepet të pijnë një gotë me esencë xhenxhefil,
18. nga një burim i quajtur Selsebil.
19. U shërbejnë të rinj të përjetshëm. Kur i sheh, të duken si margaritarë të derdhur.
20. Tek vështron, sheh begati e sundim të madh.
21. Veshur me petka atllasi të gjelbër e mëndafsh dhe të stolisur me byzylykë argjendi, Zoti u jep të pijnë pije të pastër:
22. “Shpërblim për ju. Përpjekja juaj është e mirënjohur.”
23. Ne ta zbritëm Kuranin me faza.

24. Prandaj, bëj durim për vendimin e tët Zoti dhe mos iu bind atyre që janë mëkatarë a të pabesë.
25. Përmende Emrin e tët Zoti mëngjes e mbrëmje.
26. Falju një pjesë nate dhe madhëroje natën gjatë.
27. Ata duan të përkohshmen dhe hedhin pas një ditë të rëndë.
28. Ne i krijuam dhe i kemi shtuar. Po të deshëm, i kishim zëvendësuar.
29. Kjo është kujtesë, pra, kush të dojë, te Zoti i tij të marrë udhë.
30. Jo me dashjen tuaj, por në dashtë Zoti. Zoti është dijeplotë, i urtë.
31. Pranon cilin do në Mëshirën e Vet. Dhunuesve u bëri gati dënim të hidhur.

77. LAJMËSET (EL MURSELAT)

Periudha e Mekës, 50 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Për lajmëset valë-valë,
2. stuhi e furtunë,
3. ato që shpërndajnë
4. e bëjnë dallim,
5. që një mesazh përcjellin,
6. justifikim a paralajmërim,
7. ç'ju është premtuar, do të ndodhë!
8. Kur të shuhet yjet,
9. të çahet qielli

10. e të derdhen malet;
11. kur të caktohen profetët,
12. për ç'ditë u caktuan?
13. Për Ditën e Vendimit.
14. E di ti ç'është Dita e Vendimit?
15. Atë ditë, mjerë përgënjeshtuesit!
16. A nuk zhdukëm të parët
17. dhe i pasuam me të tjerët?
18. Kështu veprojmë me mëkatarët.
19. Atë ditë, mjerë përgënjeshtuesit!
20. A s'ju krijuam nga një lëng i lënë?
21. E vumë në vend të sigurt,
22. me afat të njohur.
23. Ne e paracaktuam. Sa mirë paracaktojmë!
24. Atë ditë, mjerë ata që përgënjeshtrojnë!
25. Nuk e bëmë tokën të mbajë
26. të gjallë e të vdekur?
27. Ngritëm në të vargmale të larta dhe ju dhamë të pini ujë të ëmbël.
28. Atë ditë, mjerë përgënjeshtuesit!
29. Shkoni ku përgënjeshtruat,
30. shkoni te hija me tri shtjella!
31. Pa hije, që s'mbron nga flaka,
32. por hedh si kala shkëndija,
33. si të qenë deve leshverdha.
34. Atë ditë, mjerë përgënjeshtuesit!
35. Kjo është dita kur s'do të flasin
36. dhe nuk u jepet leje të shfajësohen.
37. Atë ditë, mjerë përgënjeshtuesit!
38. Kjo është Dita e Vendimit. Ju mblodhëm juve e të parët.
39. Në keni dredhë, më dredhoni!

40. Atë ditë, mjerë përgënjeshtuesit!”
41. Të devotshmit janë në hije e burime,
42. me fryte që pëlqejnë:
43. “Hani e pini, ju bëftë mirë, me ç’keni bërë!
44. Mirëbërësit kështu i shpërblejmë.”
45. Atë ditë, mjerë përgënjeshtuesit!
46. “Hani e gëzoni për një kohë se jeni fajtorë.”
47. Atë ditë, mjerë përgënjeshtuesit!
48. Kur u thuhet: “Faluni,” - nuk falen.
49. Atë ditë, mjerë ata që përgënjeshtrojnë!
50. Në ç’fjalë tjetër pas kësaj besojnë?

78. LAJMI (EN-NEBE')

Periodha e Mekës, 40 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Përse pyesin?
2. Për lajmin e madh
3. ku janë në kundërshti.
4. Por, do ta dinë.
5. Pra, do ta dinë.
6. Tokën-shtrat a nuk e bëmë?
7. Dhe malet-direkë?
8. Ju krijuam në palë.
9. Gjumin-pushim jua bëmë,
10. natën-mbulesë
11. dhe ditën-jetesë.
12. Ngritëm mbi ju shtresa-shtatë,

13. bëmë një pishtar të zjarrtë.
14. Ulëm nga shimbartëset ujë-rrjedhë,
15. nxjerrim me të drithra e bimë
16. dhe kopshte të begatë.
17. Dita e Ndarjes është në kohë e saktë.
18. Kur t'i fryhet bririt, vini grupe-grupe,
19. hapet qielli porta-porta,
20. enden malet: një vegim,
21. vërtet, ferri është në përgjim,
22. për të paudhët vendkthim,
23. ku me shekuj do të qëndrojnë,
24. freski e pije atje nuk shijojnë,
25. por ujë të valë dhe plagët ç'kullojnë,
26. shpërblim që e meritojnë.
27. Ata nuk e prisnin llogarinë
28. dhe dëshmitë Tona i përgënjeshtuan.
29. Çdo gjë në libër Ne e shënuam.
30. "Shijojeni! Vetëm vuajtje do t'ju shtojmë."
31. Për të devotshmit, shpëtim,
32. bahçe e vreshta,
33. vasha moshatare
34. dhe kupa të mbushura (fig. kënaqësitë e parajsës).
35. Nuk dëgjojnë atje fjalë të kota e gënjeshtra.
36. Një dhuratë bujare si shpërblim nga yt Zot,
37. Bamirësi-Rahman, Zoti i qiejve e i tokës dhe, mes tyre, gjithçkaje. Para Tij, askujt s'i jepet fjala.
38. Ditën kur Shpirti dhe engjëjt qëndrojnë në radhë, flet vetëm ai që lejon Bamirësi-Rahman e të vërtetën thotë.
39. Kjo është Dita e së Vërtetës. Kush dëshiron, te Zoti i tij kthim të marrë.

40. Ne ju paralajmërojmë me një dënim të afërt, ditën kur njeriu ç'i bënë duart sheh dhe mohuesi thotë: "Ah, sikur të isha dhé!"

79. ENGJËJT E VDEKJES (EN-NAZIAT)

Periudha e Mekës, 46 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Për ata (engjëjt) që shpirtrat marrin me dhunë,
2. a me lehtësi ato i çlirojnë,
3. që valë-valë notojnë
4. dhe në kohë paraprijnë,
5. urdhrin në vend e çojnë!
6. Ditën kur ushtima të ushtojë
7. dhe një tjetër atë ta pasojë,
8. zemrat atë ditë janë të tronditura
9. dhe shikimet të përulura.
10. "Kthehemi, - thonë, - në jetë të re,
11. eshtra të bëra dhé?"
12. Thanë: "Një kthim, humbje për ne."
13. Vetëm një thirrje
14. dhe më këmbë janë mbi dhé.
15. Të erdhi ngjarja e Musait,
16. kur i thirri Zoti në luginën e shenjtë Tuva?
17. "Shko te faraoni! Ai e teproi.
18. Thuaji: "A do të çlirohesh,
19. të të drejtoj tek yt Zot e t'i frikësohesh?"
20. Më të madhen shenjë i tregoi,
21. por ai mohoi e kundërshtoi,

22. ktheu shpinën e nxitoi,
23. tuboi e thirri:
24. “Unë jam zoti juaj, më i larti!” – tha.
25. Për të ardhmen e të tashmen shembull e bëri Zoti.
26. Kush frikësohet, këtu mësim ka.
27. Ju jeni më të vështirë në krijim apo qielli që Ai ngriti?
28. Ia lartësoi kupën dhe e ekuilibroi,
29. ia errësoi natën dhe i nxori ditën,
30. më tej, tokën e shtroi.
31. Prej saj nxori ujë e kullosë
32. dhe malet i ankoroi,
33. për ju dhe kafshët tuaja, jetesë.
34. Kur më e madhja katastrofë të vijë,
35. ditën që njeriu përse u përpoq të kujtojë
36. dhe t’i shfaqet skëterra atij që ta shikojë,
37. kush e teproi
38. dhe këtë botë lakmoi,
39. për të skëterra është strehë.
40. Pranisë së Zotit kush iu frikësua dhe nga lakmitë
- veten e ndaloi,
41. për të parajsa është strehë.
42. Të pyesin rreth Orës, kur është ndodhia e saj?
43. Mos je ti në brendësi të saj?
44. Tek yt Zot është caku i saj.
45. Ti je një paralajmërues për këdo që i frikësohet asaj.
46. Ditën që e shohin, sikur nuk qëndruan, veç një
- mbrëmje a mëngjesin e saj.

80. MOSPËRFILLJA (ABESE)

Periodha e Mekës, 42 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. U vrenjt e u largua,
2. kur i verbri iu afrua.
3. Ku ta dish, ndoshta ai çlirohet,
4. merr mësim e këshillohet?
5. Atij që vetëmjaftohet,
6. ti i je kushtuar.
7. Ç'ke ti që s'çlirohet?
8. Kujt të erdhi i nxituar,
9. tek ishte i frikësuar (te Zoti),
10. ti i je larguar.
11. Porse kjo është këshillë;
12. kush të dojë, me të këshillohet.
13. Është në fletë të nderuara,
14. të lartësuara, të dëlira,
15. në duart e shkruesve
16. fisnikë, të përkushtuar.
17. Njeriu, sa mosmirënjohës, qoftë mallkuar!
18. Nga se atë e ka krijuar?
19. Nga një pikëz e ka krijuar e zhvilluar.
20. Pastaj rrugën ia ka lehtësuar (i dha arsye e aftësi).
21. Pastaj e vdes, e shtie në dhé,
22. kur të dojë, mbi dhé e ngre.
23. Por ai nuk bën ç'e ka urdhëruar.
24. Njeriu, te ushqimi i tij, le të shikojë!
25. Derdhëm ujë me bollëk
26. dhe tokën e bëmë me brazda,
27. rritëm në të drithëra,
28. rrush e tërfil,

29. ullinj e palma,
30. kopshte të dendura,
31. fryte e kullota,
32. jetesë për ju dhe kafshët tuaja.
33. Kur të vijë ushtima,
34. ditën që njeriu ikën prej të vëllait,
35. nënës e babait,
36. nga gruaja e fëmija,
37. atëherë, secilit i mjafton e tija.
38. Atë ditë, fytyra të shndritura,
39. të qeshura, të gëzuara.
40. Atë ditë, fytyra të pluhurosura,
41. prej territ të mbuluara.
42. Janë mohuesit, keqbërësit.

Titulli origjinal: "U vrenjt"

81. ERRËSIMI (ET-TEKVIR)

Periudha e Mekës, 29 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Kur të errësohet dielli,
2. të shkapërderdhen yjet,
3. të zhvendosen malet,
4. të braktisen devetë
5. e të grumbullohen bishat;
6. kur të vlojnë detet,
7. të bashkohen shpirtrat;
8. kur të pyetet foshnja e mbytur,

9. për ç'faj u mbyt;
10. kur të shpërndahen fletët,
11. të zbulohet qielli,
12. të këndellet skëterra
13. dhe të afrohet parajsa,
14. e di një frymë se ç'solli.
15. Nuk bëj be në planetët,
16. që enden e fshihen,
17. as në natën kur errësira mbulon
18. dhe mëngjesin kur gjallëron,
19. se ajo është fjala e një lajmësi të nderuar,
20. me fuqi pranë Zotit të Fronit,
21. të bindur, atje të besuar!
22. Shoku juaj nuk është i marrë.
23. E pa atë në horizontin e qartë.
24. Te e fshehta, jo i ngurtë.
25. Dhe kjo s'është fjalë djalli të mallkuar.
26. Ku po shkoni?
27. Është për botët kujtesë.
28. Për cilindo prej jush që dëshiron të ndjekë udhën e drejtë.
29. Jo me dashjen tuaj, por në dashtë Allahu, Zoti i Gjithësisë.

82. HAPJA (EL INFITAR)

Periudha e Mekës, 19 ajete
Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Kur të hapet (çahet) qielli,
2. të shpërndahen yjet,
3. të derdhen detet,
4. të zbulohen varret,
5. e di një frymë se ç'bëri dhe çfarë pas i mbeti.
6. O njeri! Ç'të mashtroi për Zotin tënd bujar,
7. që të krijoi, formoi e plotësoi,
8. të bëri në pamjen që deshí?
9. Ndërsa ju mohoni fenë.
10. Mbi ju janë ruajtësit,
11. shkruet të nderuar;
12. çfarë bëni, ata e dinë.
13. Të mirët janë në parajsë,
14. të këqijtë në skëterrë,
15. ku hyjnë Ditën e Gjykimit.
16. Prej saj nuk do të mungojnë.
17. Ku ta dish ti ç'është Dita e Gjykimit?
18. Përsëri, ku ta dish ti ç'është Dita e Gjykimit?
19. Dita kur njeriu s'i bën dobi njeriut dhe çështja i takon Zotit.

83. MANGËSUESIT (EL MUTAFFIFIN)

Periodha e Mekës, 36 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Mjerë mangësuesit!
2. Që, kur u masin njerëzve, për vete e plotësojnë.
3. Kur masin e peshojnë për ta, mangësojnë.

4. Se do të ngrihen, a nuk mendojnë?
5. Një ditë të rëndë,
6. ditën kur njerëzit para Zotit të botëve qëndrojnë?
7. Jo! Regjistri i të këqijve është në libër të mbyllur.
8. Ku ta dish ti ç'është libri i mbyllur?
9. Një libër i gdhendur.
10. Atë ditë, mjerë përgënjeshtuesit,
11. që përgënjeshtrojnë Ditën e Gjykimit!
12. E përgënjeshtruan atë shkelës, mëkatarë.
13. Kur u lexohen dëshmitë Tona, thonë: "Mite nga të parë."
14. Jo! Njollë në zemrat e tyre ajo që fituan.
15. Nga Zoti i tyre, atë ditë, janë të veçuar.
16. Pastaj, në skëterrë do të digjen.
17. U thuhet: "Ja çfarë keni përgënjeshtruar!"
18. Jo! Regjistri i të mirëve është në libër të lartë.
19. Ku ta dish ti ç'është libri i lartë?
20. Një libër i gdhendur.
21. Të afërmit e dëshmojnë.
22. Të mirët janë në parajsë.
23. Mbi frona të lartë vështrojnë.
24. Në fytyrat e tyre njih dritën e lumturisë.
25. U jepet të pijnë nektar i vulosur.
26. Zënë me misk. Lakmuesit në të le të lakmojnë!
27. Përbërja e tij, esencë parajse,
28. burim ku të afërmit pijnë.
29. Mëkatarët qeshnin me besimtarët.
30. Kur kalonin, njëri-tjetrit i bënin shenjë.
31. Ktheheshin në familje të kënaqur.
32. Tek i shihnin, thonin: "Ja, këta janë të humbur!"
33. S'u dërguan mbi ta për t'i vëzhguar.
34. Sot, besimtarët qeshin me mohuesit.

35. Mbi frona të lartë vështrojnë.
36. A nuk shpërblehen mohuesit me ç'kanë punuar?

84. ÇARJA (EL INSHIKAK)

Periodha e Mekës, 25 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Kur të çahet qielli,
2. dëgjon Zotin e vet dhe bindet.
3. Kur të hapet toka,
4. të hedhë ç'ka në të e të zbrazet,
5. dëgjon Zotin e vet dhe bindet.
6. Ti, o njeri, je në përpjekje tek yt Zot dhe do ta takosh.
7. Kujt i jepet libri nga e djathta,
8. e ka llogarinë të lehtë
9. dhe kthehet në familje i gëzuar.
10. Kujt i jepet libri nga pas,
11. thërret i zhgënjyer
12. dhe digjet në zjarrin e përflakur.
13. Ishte në familje i gëzuar.
14. Besoi se s'kishte për t'u kthyer.
15. Vërtet, Zoti i tij e ka largvështuar.
16. Nuk bëj be në muzgun e mbrëmjes,
17. natën e çfarë ajo mbulon
18. dhe në hënën kur mbushet,
19. se ju do të kaloni nga faza në fazë.
20. Ç'është me ta që nuk besojnë?
21. Kur u lexohet Kurani, nuk përulen?

22. Por mohuesit përgënjeshtrojnë.
23. Zoti e di mirë në zemër ç'mbajnë.
24. Jepu, pra, lajmin e një dënimi të hidhur.
25. Jo ata që besojnë e bëjnë të mira. Shpërblimi i tyre është i pasosur.

85. YJËSITË (EL BURUXH)

Periudha e Mekës, 22 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë

1. Për qiellin e yjësuar
2. dhe Ditën e Premtuar;
3. për dëshmues e të dëshmuar,
4. u shofshin autorët e hendekut,
5. me trupat në zjarr djegur,
6. kur përballë rrinin,
7. spektatorë të veprës së tyre me besimtarët!
8. I ndëshkuan vetëm e vetëm pse Zotin, të
Plotfuqishmin, Lavdiplotin besonin,
9. që sundon qiejt e tokën. Gjithçka, Zoti e dëshmon.
10. Ata që persekutuan besimtarët e besimtarët dhe nuk
u penduan kanë vuajtjen e skëterrës, dënimin në
zjarrin e këndellur.
11. Cilët besojnë e bëjnë të mira, kanë kopshte ku
rrjedhin lumenj. Kjo është fitorja e madhe.
12. Goditja e tët Zoti është e rreptë.
13. Ai zë fill e përsërit.
14. Ai është Falësi, i Dhembshuri,

15. Zoti i Fronit, Lavdiploti.
16. Vepron me Dashjen e Tij.
17. Të erdhi ngjarja e hordhive
18. të Faraonit e Themudit?
19. Porse mohuesit vazhdojnë duke përgënjeshtuar.
20. Zoti nga pas i ka rrethuar.
21. Ky është një këndim i lëvduar,
22. në pllakë të ruajtur.

86. VIZITORI I NATËS (ET-TARIK)

Periudha e Mekës, 17 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Për qiellin dhe Vizitorin e Natës!
2. Ku ta dish ti ç'është Vizitori i Natës?
3. Është Ylli Shndritës.
4. Çdo frymë ka një rojë.
5. Nga se u krijua, njeriu le të shikojë!
6. U krijua nga një lëng që gufon,
7. prej palcës dhe brinjve dalë.
8. Ai është i fuqishëm ta rikthejë,
9. ditën kur sekretet vihen në provë.
10. S'ka fuqi e kush ta ndihmojë.
11. Për qiellin që shiun kthen
12. dhe tokën ku jeta shpërthen,
13. kjo është fjalë që dallon,
14. nuk është lojë!
15. Ata bëjnë një plan.

16. Dhe Unë bëj plan.
17. Mohuesve shtyjua sa t'u shkojë!

87. I LARTI (EL A'LA)

Periodha e Mekës, 19 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë!

1. Thuri lavde Emrit të tët Zoti, Më të Lartit!
2. Që krijon e harmonizon,
3. që përcakton e drejton,
4. që nxjerr barin e ri
5. dhe e bën atë të tharë, byk të zi.
6. Ne do të të bëjmë të recitosh e të mos harrosh.
7. Me dashjen e Zotit. Ai di të haptën e të fshehtë.
8. Të lehtësojmë në të lehtë.
9. Këshillo kur këshilla bën dobi.
10. Këshillohet ai që ruhet.
11. I pashpresi mënjanohet,
12. që zjarrit të madh i përballet,
13. ku nuk vdes e jeton.
14. Kush çlirohet, ai shpëton;
15. që përmend Emrin e Zotit dhe falet.
16. Por ju parapëlqeni këtë botë.
17. E ardhmja është më e mirë dhe e gjatë.
18. Kjo është në fletët e para,
19. fletët e Ibrahimit dhe Musait.

88. PËRMBYSJA (EL GASHIJEH)

Periudha e Mekës, 26 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Të erdhi ngjarja e përmbysjes?
2. Atëherë, fytyra të trishtuara,
3. lëvizje të mekura,
4. në flakë e zjarr të përzhitura,
5. me pije burimi të valë,
6. jo ushqim, por shkurre e ferra,
7. që nuk ushqejnë e shuajnë urinë.
8. Atëherë, fytyra të lumtura,
9. për mundin e tyre, të kënaqura,
10. në kopshte të larta,
11. ku s'dëgjojnë fjalë të kota (por "Paqe, paqe!" 56:26);
12. atje, një burim i pashterë,
13. frona ngritur,
14. kupa servirur, (nga burimi i dashurisë për Zotin)
15. jastëkë radhitur,
16. halli shtruar.
17. Nuk shohin te deveja si është krijuar?
18. Dhe te qielli si është lartësuar?
19. Dhe te malet si janë ngulur?
20. Dhe te toka si është shtruar?
21. Këshillo se ti je një këshillues,
22. nuk je mbi ta vëzhgues.
23. Jo kë largohet e mohon.
24. Zoti me dënim të madh e dënon.
25. Te Ne është kthimi i tyre.
26. Pastaj, mbi Ne, llogaria e tyre.

89. MËNGJESI (EL FEXHR)

Periudha e Mekës, 30 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Për mëngjesin
2. e të dhjetë netët,
3. për dyshen e njëshin
4. dhe natën kur kalon!
5. A ka këtu betim për dikë që kupton?
6. Nuk ke parë si veptoi yt Zot me Adin,
7. të kolonave të larta, Iramin?
8. Ndër vende si ata nuk u krijuan.
9. Që çau shkëmbin në luginë, Themudin?
10. Dhe Faraonin, tiranin?
11. Që nëpër vende rebeluan
12. dhe të keqen në to shtuan?
13. Yt Zot i fshikulloi me dënim.
14. Vërtet, Zoti yt është në përgjim.
15. Kur Zoti e vë në provë, e nderon dhe i jep të mira, njeriu thotë: "Im Zot më ka nderuar."
16. Kur e vë në provë dhe ia kufizon të mirat, thotë: "Im Zot më ka poshtëruar."
17. Por ju nuk nderoni jetimin,
18. nuk nxitni për të ushqyer të varfrin,
19. përvetësoni pa dallim trashëgimin,
20. lakmoni shumë pasurimin.
21. Jo! Kur të rrafshohet toka
22. e të vijë yt Zot me engjëjt radhë-radhë,

23. sillet, atëherë, skëterra dhe përmendet, atë ditë,
njeriu. Por, ç'i vlen përmendja?
24. Thotë: "Ah, sikur për jetën time të isha përgatitur!"
25. Atë ditë, s'ka dënim me dënimin e Tij,
26. s'ka pranga me prangat e Tij.
27. O shpirt i qetë,
28. kthehu te yt Zot, i kënaqur, i pranuar!
29. Hyr te robtë e Mi,
30. hyr në Kopshtin Tim!

90. QYTETI (EL BELED)

Periudha e Mekës, 20 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Nuk bëj be në këtë qytet (Mekën)!
2. Ti je i lirë në këtë qytet.
3. Për atin dhe birin e vet (Ademin e breznitë)!
4. E krijuam njeriun në vështirësi, vërtet.
5. Pandeh se nuk ka kush mbi të pushtet?
6. "Prisha shumë mall", - do të thotë.
7. Pandeh se askush nuk e sheh?
8. Nuk i bëmë atij dy sy,
9. një gjuhë e dy buzë?
10. Dhe i treguam dy rrugë.
11. Por nuk iu vu së vështirës.
12. A e di ti ç'është e vështira?
13. Lirimi i një robi,
14. ushqimi në ditë zije,

15. i një të afërmi jetim
16. ose të varfri në mjerim.
17. Dhe të jetë nga ata që besojnë e këshillojnë durim,
këshillojnë mëshirë.
18. Këta janë anëtarët e së djathtës.
19. Cilët mohojnë dëshmitë Tona, ata janë anëtarët e së
majtës.
20. Mbi ta, një zjarr pa dalje.

91. DIELLI (ESH-SHEMS)

Periudha e Mekës, 15 ajete

Me Emrin e Zotit, Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Për Diellin dhe dritën e tij;
2. për Hënën kur vjen pas tij;
3. për ditën kur jep shkëlqimin e tij;
4. për natën kur i vë perde atij;
5. për qiellin që ngriti
6. dhe tokën që shtroi;
7. për shpirtin (këtu: nefis, vete) që formoi
8. dhe e frymëzoi nga vesi e virtyti,
9. shpëtoi kush e dëliri atë,
10. dështoi kush e prishi atë!
11. Me tirani Themudi mohoi,
12. kur më i ligu e përfaqësoi.
13. "Kujdes devenë e Zotit! - i Dërguari i Zotit u pati
thënë. - Ujë le të pijë!"

14. Përgënjeshtuan dhe e gjymtuan. Me mëkatet e tyre,
Zoti i dënoi e rrafshoi.
15. Atij nuk i vjen pasojë.

92. NATA (EL LEJL)

Periudha e Mekës, 21 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Për natën kur mbulon
2. dhe ditën kur ndriçon,
3. mashkullin e femrën ç'i krijon,
4. përpjekja juaj vërtet ndryshon!
5. Kujt jep e vetëpërmbahet,
6. Më të Bukurën që beson,
7. te e lehta ia lehtësojmë.
8. Kujt nuk jep e vetëmjaftohet,
9. Më të Bukurën që mohon,
10. te e rënda ia lehtësojmë.
11. Kur të vdesë, malli nuk i shkon.
12. Ne drejtojmë;
13. e ardhmja, e tashmja Neve na takon.
14. Kujdes zjarrit që digjet,
15. ku i ligu futet,
16. i cili përgënjeshton e largohet.
17. Shpëton ai që ruhet,
18. që jep mallin e çlirohet,
19. jo për dikë që ka në dorë një të mirë e të shpërblehet,
20. por për hir të Zotit, të Lartit.
21. Dhe do të kënaqet.

93. DITA (ED-DUHA)

Periudha e Mekës, 11 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Për ditën kur rrezaton
2. dhe natën kur heshtja mbulon,
3. nuk të la yt Zot, as të urren!
4. E ardhmja është më e mirë për ty nga ajo që shkon.
5. Do të të japë yt Zot e të mbetesh i kënaqur.
6. A nuk të gjeti jetim e të strehoi,
7. të gjeti të humbur e të drejtoi,
8. të gjeti të varfër e të pasuroi?
9. Pra jetimin mos e mundo
10. dhe lypësin mos e largo.
11. Mirësinë e tët Zoti bëje të njohur!

94. ZGJERIMI (EL INSHIRAH)

Periudha e Mekës, 8 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. A nuk ta zgjeruam zemrën
2. e ta hoqëm barrën
3. që ta ndrydhte shpinën?

4. Ta ngritëm lart famën.
5. Vërtet, me vështirësinë ka lehtësi,
6. me vështirësinë ka lehtësi.
7. Kur të lirohesh, ngrehu e fillo.
8. Tek yt Zot shpresoj!

95. FIKU (ET-TIN)

Periudha e Mekës, 8 ajete
Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Për fikun e ullirin!
2. Për Malin Sinin!
3. Për këtë qytet të sigurt!
4. E krijuam njeriun në formën më të bukur,
5. pastaj e kthejmë në gjendjen më të ulët.
6. Përveç atyre që besojnë e bëjnë të mira. Ata kanë shpërblim të pashterë.
7. Ç'të bën, më pas, të mohosh fenë?
8. A nuk është Zoti Gjykatësi Më i Urtë?

96. EMBRIONI (EL ALAK)

Periudha e Mekës, 19 ajete
Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Lexo! Me Emrin e tët Zoti që krijoi,
2. njeriun n'embrion e krijoi.

3. Lexo! Yt Zot, Më Bujari,
4. Ai që shkrimin ia mësoi,
5. njeriut të paditurën ia mësoi.
6. Por njeriu rebelon
7. kur mendon se vetëmjafton,
8. te yt Zot në kthim shkron.
9. E sheh kë ndalon
10. robin kur falet?
11. E sheh në është në udhë të drejtë
12. a porosit devocion?
13. E sheh, nëse mohon e largohet,
14. nuk e di që Zoti vështrohet?
15. Jo, jo! Do ta zëmë te balli nëse nuk ndalon,
16. ballë gënjeshtar e mëkatar.
17. Dhe, le të thërrasë këshillin e tij!
18. Ne thërrasim engjëjt zebanij (rojat e ferrit).
19. Jo, jo, mos iu bind atij, por falju Zotit dhe afrohu!

97. DEKRETI (EL KADR)

Periudha e Mekës, 5 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Ne e zbritëm atë Natën e Kadrit.
2. A e di ti ç'është Nata e Kadrit?
3. Nata e Kadrit është më e çmuar nga një mijë muaj.
4. Zbresin në të engjëjt e Shpirti, me lejen e Zotit, për çdo vendim.
5. Paqe, deri në agim.

98. DËSHMIA (EL BEJJINEH)

Periodha e Medines, 8 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Mohuesit ithtarë të Librit dhe idhujtarët nuk qenë ndarë derisa u erdhi dëshmia,
2. një i dërguar nga Zoti që reciton fletë të pastra,
3. me shkrime të vërteta.
4. Ithtarët e Librit u përçanë kur u erdhi dëshmia.
5. Dhe u urdhëruan vetëm e vetëm të adhuronin Zotin, me besim thjesht për Të dhe të vendosur, të kryenin të falurit e të jepnin zekatin (detyrim bamirësie) .Kjo është feja e vërtetë.
6. Mohuesit ithtarë të Librit dhe idhujtarët janë përgjithmonë në zjarrin e ferrit. Ata janë më të këqijtë e krijesave.
7. Cilët besojnë e bëjnë të mira, janë më të mirët e krijesave.
8. Shpërblim pranë Zotit të tyre kanë kopshtet e Edenit ku rrjedhin lumenj, të përhershëm në to, përgjithmonë. Zoti është i kënaqur prej tyre dhe ata, të kënaqur prej Tij. Kjo, për këdo që i frikësohet Zotit.

99. TËRMETI (EZ-ZELZELE)

Periudha e Mekës, 8 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Kur të dridhet toka me dridhjen e saj,
2. të nxjerrë toka barrën e saj,
3. të thotë njeriu: “Ç’i ndodhi asaj?”-
4. rrëfen atë ditë ndodhitë e saj,
5. sepse yt Zot ia frymëzoi asaj.
6. Atë ditë, dalin njerëzit për bëmat e tyre në grupe të ndarë:
7. kush bën një të mirë, ka për ta parë;
8. kush bën një të keqe, ka për ta parë.

100. MËSYMËSIT (EL ADIJAT)

Periudha e Mekës, 11 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Për mësymësit që turfullojnë,
2. rrahin tokën, zjarr lëshojnë,
3. në mëngjes kur sulmojnë
4. dhe me gjurmët pluhur ngrejnë,
5. si një trup përmes çajnë!
6. Njeriu është mosmirënjohës te Zoti i tij;
7. për këtë, dëshmues është ai;
8. te pasuria, i rreptë në lakmi.
9. A nuk e di se kur të përmbysen varret
10. e të dalin ç’mbajnë zemrat,
11. atë ditë, Zoti i tyre është për ta në dijeni?

101. KATASTROFA (EL KARIAH)

Periudha e Mekës, 11 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Katastrofa.
2. Katastrofa ç'është?
3. A e di ti katastrofa ç'është?
4. Ditën që njerëzit si flutura derdhur të jenë
5. dhe malet si lesh i shprishur të jenë,
6. kujt peshojat (e të mirave) i peshojnë,
7. në jetë të këndshme është;
8. kujt peshojat nuk i peshojnë,
9. vendi e tij një gropë është.
10. A e di ti ajo ç'është?
11. Zjarr i nxehtë është.

102. SHTIMI (ET-TEKATHUR)

Periudha e Mekës, 8 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Ju shqetëson shtimi,
2. derisa varret të arrini.
3. Por do ta dini.

4. Pra, do ta dini.
5. Me dijen e së vërtetës po ta dinit,
6. se zjarrin do të shihni,
7. me syrin e së vërtetës do ta shihnit.
8. Atëherë për lumturinë do të pyeteni.

103. KOHA (EL ASR)

Periudha e Mekës, 3 ajete
Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Për kohën,
2. vërtet njeriu është në humbje!
3. Përveç atyre që besojnë e bëjnë të mira, që këshillohen me të vërtetën, këshillohen me durimin.

104. PËRGOJUESI (EL HUMEZEH)

Periudha e Mekës, 9 ajete
Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Mjerë kush përgojon e përçmon,
2. që mbledh mall dhe e numëron,
3. pandeh se malli e përjetëson!
4. Por do të flaket në një hon.
5. Ç'është honi, ç'ta mëson?
6. Zjarr i Zotit ndezur,
7. në zemra shfaqur,

8. rreth e qark mbyllur,
9. me gjuhët zgjatur.

105. ELEFANTI (EL FIL)

Periudha e Mekës, 5 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Nuk ke parë njerëzve të elefantit yt Zot ç'u punoi?
2. A nuk bëri që plani i tyre më kot të shkojë?
3. Mbi ta, tufë-tufë zogj dërgoi,
4. duke i gjuajtur me gurë balte të pjekur
5. dhe i bëri si kashtë e shkelur.

106. KUREJSHËT (KUREJSH)

Periudha e Mekës, 4 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Për të drejtën që kurejshët gëzojnë,
2. të drejtën e tyre dimrit e verës kur udhëtojnë,
3. Zotin e kësaj shtëpie le të adhurojnë,
4. që i ushqen në uri dhe në frikë i siguron.

107. E MIRA (EL MAUN)

Periudha e Mekës, 7 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. E sheh kë mohon fenë?
2. Është Ai që përzë jetimin
3. dhe nuk nxit për të ushqyer të varfrin.
4. Mjerë ata që falen,
5. të pavëmendshëm kur falen,
6. ata që shtiren
7. dhe pengojnë të mirën!

108. BURIMI I PARAJSËS (EL KEUTHER)

Periudha e Mekës, 3 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Ne të dhamë parajsën-pjesë.
2. Falju tët Zoti e bëji fli!
3. Përfolësi yt, ai është i pashpresë.

109. MOHUESIT (EL QAFIRUN)

Periudha e Mekës, 6 ajete
Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Thuaj: "O mohues!
2. Unë nuk adhuroj ç'adهوري ju.
3. Dhe ju nuk adhuron ç'adهوري unë.
4. Unë nuk do të adhuroj ç'adهوري ju.
5. Dhe ju nuk adhuron ç'adهوري unë.
6. Ju keni fenë tuaj dhe unë, fenë time.

110. NDIHMA (EN-NASR)

Periudha e Medines, 3 ajete
Me Emrin e Zotit, Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Kur vjen ndihma e Zotit dhe fitorja
2. dhe i sheh njerëzit të hyjnë në Fenë e Zotit grupe-grupe,
3. thuri lavde të Zotit dhe kërkoi falje. Vërtet, Falja e Tij është e Madhe (Ai është Falës i Madh).

111. KONOPI (EL MESED)

Periudha e Mekës, 5 ajete
Me Emrin e Zotit, Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Iu thafshin duart Atit të Flakës (Abu Leheb), qoftë mallkuar!
2. nuk i bënë dobi malli e ç'ka fituar,

3. përballë zjarrit të flakëruar.
4. Dhe e shoqja nxitëse-gojëlëshuar,
5. në qafë një konop përdredhur.

112. PËRKUSHTIMI (EL IKHLAS)

Periudha e Mekës, 4 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Thuaj: “Zoti është Një,
2. Zoti është i Amshuar.
3. Nuk ka lind, as është i lindur
4. dhe nuk ka të krahasuar.”

113. AGIMI (EL FELEK)

Periudha e Mekës, 5 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Thuaj: “Mbrohëm me Zotin e agimit,
2. prej së keqes së krijimit (që Ai ka krijuar),
3. prej së keqes së natës terr e zi,
4. prej së keqes së magjistricave që bëjnë magji,
5. prej së keqes së ziliqarit kur ka zili.”

114. NJERËZIT (EN-NAS)

Periudha e Mekës, 6 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

1. Thuaj: “Mbrohëm me Zotin e njerëzve,
2. Sundimtarin e njerëzve,
3. Perëndinë e njerëzve,
4. nga e keqja e pëshpëritjeve të djajve,
5. që pëshpërisin në zemrat e njerëzve
6. dhe janë prej xhinëve e njerëzve.

=====

KRONIKA E NGJARJEVE

610 - 632 e.r.

610. Fillimi i shpalljes së Kuranit.

613. Ftesa e hapur në Islam.

615. Shpërngulja e një grupi besimtarësh në Abisini.

617-619. Izolimi i Benu Hashimëve (njerëzve të gjinisë së Muhammedit a.s.)

620. Viti i dëshpërimit. Udhëtimi i Profetit në Taif.

621-622. Besëlidhja e Akabesë. Emigrimi në Jathrib (Medine). Kalendari Islamik.

624, 13 mars (17 Ramadan 2h.) Beteja e Bedrit. Judenjtë e klanit Benu Kajnuka.

625, mars (15 Shevval 3h.) Beteja e Uhudit. Judenjtë e klanit Benu Nadir. Ekspedita e dytë në Bedër.

627, shkurt-mars (Shevval-Dhulkadeh, 5h.) Beteja e Hendekut. Judenjtë e klanit Benu Kurejdha.

628, mars (Dhulkadeh, 6h.) Pakti i Hudejbijes.

628, maj-qershor (Muharrem-Sefer, 7h.) Ekspedita e Khajberit.

629, mars (Dhulkadeh, 7h.) Umreja e prapambetur.

629, shtator (Xhumadel ula, 8h.) Beteja në Mu'teh (Siri) kundër bizantinëve.

630, janar (20 Ramadan 8h.) Fitorja e Mekës. Pastrimi i Qabes nga idhujt. Mekasit japin besën për Islam.

630, janar (6 Shevval 8h.) Beteja e Hunejnit.

630, tetor (Rexhep, 9h.) Fushata në Tebuk përballë bizantinëve.

631. (9-10 hixhri) Viti i Delegatëve. Mosangazhimi me idhujtarët.

632, mars (Dhulhixhxheh, 10h.) Pelegrinazhi i Lamtumirës.

“Sot jua përsosa fenë, plotësova Mirësinë Time ndaj jush, pëlqeva për ju Islamin fe.” (Kurani 5:3)

P Ë R M B L E D H J E
E N G J A R J E V E K R Y E S O R E G J A T Ë
S H P A L L J E S S Ë K U R A N I T
(610-632 e.r.)

610 e.r. Fillimi i revelatës

Ramadan ishte muaji spiritual edhe para Islamit.

Muhammedi, atëherë te dyzetat, tërhiqej nga Meka në Malin Hira ku, shpesh, kalonte natën, meditonte dhe i lutej Zotit. Netëve të fundit, iu shfaq, si në vegim, një dritë që
“...u përqendrua në horizontin e lartë, pastaj zbriti e u afrua sa dy harqe a më afër.” (53:6-9) I thirri: “Lexo!”

Muhammedi iu përgjigj i frikësuar: “Nuk di të lexoj.”
Thirri përsëri: “Lexo!” Muhammedi iu përgjigj: “Nuk di të lexoj.” Të tretën herë rrodhën vargjet e para të Kuranit:
“Ikre bismi rabbikel-ledhi khalek. / Khalekal insane min alek. / Ikre ve rabbukel ekrem. / El-ledhi al-leme bil kalem. / Al-lemel insane ma lem ja’lem.” “Lexo! Me Emrin e Zotit tënd që krijoi, / njeriun n’embrion e krijoi. / Lexo! Yt Zot, Më Bujari, / Ai që shkrimin ia mësoi, / njeriut të paditurën ia mësoi.” (96: 1-5) Muhammedi u kthye në shtëpi i tronditur. I tha së shoqes, Hadixhesë: “Mbulomë, mbulomë!” Pas një ndërprerjeje të gjatë, engjëlli do të shfaqej përsëri duke i thënë: ***“O i mbuluar! Ngrehu e lajmëro, Zotin tënd madhëro...”*** (74: 1-3)

Biri i Abdullahit dhe Amines, Muhammedi vinte nga klani Benu Hashim i kurejshëve, gjenerata e të cilëve shkonte deri te Ismaili dhe Ibrahim (Abraham). I ati pati vdekur dy muaj para se të lindte ndërsa e ëma e la në moshën gjashtë vjeçare. Djalin do ta merrte pranë gjyshi i tij, Abdul Muttalibi, i përmendur si kujdestar i Qabes qysh kur Ebreha, sundimtar i krishterë i Jemenit, erdhi me ushtri dhe elefantë për të shkatërruar tempullin e shenjtë të arabëve. Dy vjet më pas e la edhe i gjyshi dhe Muhammedi do të jetonte në shtëpinë e të ungjit, Ebu Talibit.

Nga vetë pozita gjeografike, mekasit ishin detyruar të bënin udhëtime të gjata në drejtim të Sirisë dhe Jemenit për të shkëmbyer prodhimet e tyre në natyrë me pëlthurë, mëndafsh, erëza dhe artikuj artizanalë. Karvaneve do t’u bashkohej shpesh edhe Muhammedi, si shoqërues ose duke tregtuar për të tjerët. Por ai nuk ka pasë vënë kurrë në jetën e vet ndonjë kapital, qoftë edhe si profet apo kryetar shteti

kur i takonte një e pesta e trofesë së luftës të cilën e shpërndante për nevojat e bashkësisë dhe bamirësi. Vetë Muhammedi, familja e tij, shokët e tij më të afërt dhe ndjekësit e shembullit të tij kaluan jetë të thjeshtë, kushtuar Zotit dhe çështjes islame. **Për ndershmërinë dhe besnikërinë e tij, djaloshin e ri, Muhammedin, e quanin në Mekë: “El Emin”, Besniku.**

Kur Muhammedi ishte rreth njëzet e pesë vjeç, një grua e ve, e pasur dhe e mirënjohur në Mekë, Hadixheja, ia besoi karvanin e saj për në Siri. Duke e parë nga afër, ajo propozoi për martesë dhe Muhammedi pranoi. Atë kohë, Hadixheja ishte dyzetë vjeç. Kështu, Muhammedi u largua nga i ungji dhe u vendos në familjen e re ku i lindën dy djem e katër vajza. Djemtë i vdiqën që të vegjël. Me rastin e martesës, Hadixheja i pati dhuruar Muhammedit një skllav me emrin Zejd ibn Haritha të cilit ai i dha lirinë dhe më vonë e birësoi.

Në kohën e Muhammedit, ndër mekasit kishte njerëz që urrenin idhujtarinë e zakonet barbare dhe kërkonin t'i ktheheshin traditës së Profetit Ibrahim. Përkrahësit e tyre quheshin “ahnaf” ose hanifë, të drejtë e të vendosur (në besimin te një Zot). Muhammedi, sikurse i gjyshi, Abdul Muttalibi, nuk adhuronte idhujt, por Zotin Një, në fenë e Ibrahimit.

Të nesërmen e ngjarjes së Hirasë, Hadixheja shkoi me Muhammedin te kushëriri i saj, Varaka bin Neufal, që ishte bërë i krishterë dhe njihte Biblën. Varaka që i moshuar dhe e patën lënë sytë. Kur dëgjoi ngjarjen, tha se, po të kishte jetë, do ta shihte Muhammedin të përzënë prej popullit të

vet siç ndodhte me profetët. Hadixheja e njihte mirë të shoqin për vërtetësinë e fjalëve të tij dhe e besoi. Ajo ishte e para besimtare e mesazhit profetik dhe, për vitet e vështira që do të pasonin, që për Muhammedin një mbështetje e madhe. Në të njëjtën kohë, besuan Zejdi dhe Aliu, kushëriri i Muhammedit, biri i Ebu Talibit, por ai ishte mjaft i ri në moshë. Nga njerëzit jashtë familjes, i pari që besoi ishte Ebu Bekri, një tregtar i pasur, njeri i mësuar, bamirës i njohur, shok i ngushtë dhe, më vonë, i vjehrrë e bashkudhëtari më i afërt në Misionin Profetik të Muhammedit Alejhisselam (Paqja qoftë me të).

613. Ftesa

Në fillim, Muhammedi ua bënte të njohur mesazhet që i vinin disa njerëzve në mënyrë vetjake. Ata ishin burra e gra me moshë të re, të lirë e skllëvër. Kur i erdhi urdhër të lajmëronte, ftoi popullin në Malin Safa, një kodrinë afër Qabes ku mekasit mblidheshin. Profeti u bëri thirrje të adhuronin Zotin dhe t'i linin idhujt, të besonin në Ditën e Gjykimit dhe barazinë e njerëzve para Zotit, të ishin të drejtë e të përmbushnin detyrimet, të trajtonin mirë skllëvërit, të varfërit dhe jetimët. Kurejshët nuk ia vunë veshin. Pastaj ftoi fisin e tij, Benu Hashim. I ungji, Ebu Leheb, e kërcënoi me qëndrim të ashpër nëse do të vazhdonte të dilte kundër traditave të të parëve. Kurejshët filluan ta quanin poet, magjistar e të zënë nga xhinët. Kur numri i besimtarëve po shtohej, nisën vuajtjet e mundimet. Skllëvërit i rrihnin në rrugë për t'u dhënë mësim të tjerëve. Gratë dhe njerëzit e pambrojtur i keqtrajtonin. Profetit i zinin rrugën, s'e linin të falej dhe e tallnin.

615. Shpërngulja në Abisini

Për t'u shpëtuar mundimeve, disa nga besimtarët u shpërngulën fshehtas në Abisini ku ishte një sundimtar i krishterë. Mekasit dërguan njerëz për dorëzimin e të ikurve. Mbreti i Abisinisë, Negus, i dëgjoi të dyja palët. Nga muslimanët foli Xhaferi, i biri i Ebu Talibit. Mbreti e gjykoi të drejtë besimin e tyre dhe u dha mbrojtje. Pas shpërnguljes së parë, një grup tjetër prej rreth tetëdhjetë vetësh shkoi në Abisini.

617-619. Izolimi

Aty nga viti 616, muslimanët morën kurajë me besimin e Hamzait dhe të Omerit. Hamzai ishte ungji i Muhammedit, trim e krenar. Omer bin Khatab, i cili do të bëhej khalif (zëvendësi) i dytë pas vdekjes së Profetit, ishte një burrë i shquar nga klani Adi. Me ta, besimtarët dolën hapur në Qabe. Kurejshët vendosën të mbanin qëndrim të përbashkët ndaj fesë së re. Dërguan një përfaqësi te Ebu Talibi që ta bindte të nipin, në fund të fundit, të mos i përmendte idhujt e tyre dhe ata ta besonin ose të hiqte dorë nga mbrojtja e tij. Zoti thotë në Kuran: “***Po të të mos forconim, do të anoje diçka nga ata.***” (17:74) Meqë nuk arritën të bënin kompromis, vendosën ta bojkotonin klanin e hashimëve. Në muret e Qabes varën të shkruara kushtet e bojkotit sipas të cilit kurejshët ndërprisnin çdo marrëdhënie me Benu Hashimët. Këta nuk kishin më fuqinë dhe ndikimin e kohës së Abdul Muttalibit prandaj u detyruan të mblidheshin në një luginë jashtë qytetit ku Ebu Talibi kishte një pronë të tijën. Bojkoti vazhdoi në kushte shumë të vështira rreth tre vjet.

620. Viti i dëshpërimit. Udhëtimi në Taif

Pak kohë pas heqjes së bojkotit, vdiq Ebu Talibi dhe parësia i kaloi Ebu Lehebit. Vdekja më pas edhe e së shoqes, Hadixhesë, ishte humbje e pazëvendësueshme për Muhammedin. Ky vit do të kujtohej në jetën e tij si “viti i dëshpërimit” (Amul’huzni). I mbetur pa mbrojtje, Muhammedi shkoi bashkë me Zejdin në Taif për të biseduar me krerët dhe popullin, por atje njerëzit e përzunë me gurë. U kthye në Mekë ku e mori nën mbrojtje klani Benu Neufal.

621-622. Besëlidhja e Akabesë. Emigrimi në Jathrib (Medine). Kalendari Islamik

Jathrib është një oaz i madh rreth 320 km. në veri të Mekës. Popullsia atje merrej me frutikulturë, bujqësi e blegtori. Arabët përbënin dy fise të mëdha, Avs dhe Khazrexh, në armiqësi me njëri-tjetrin. Pas kësaj armiqësie qëndronin judenjtë e klaneve Benu Nadir, Benu Kajnuka dhe Benu Kurejdha, në aleancë me njërin ose tjetrin grup. Judenjtë kishin në dorë tregtinë dhe paranë. Konflikti që në interesin e tyre. Gjatë pelegrinazhit, Profeti pati takuar në Akabe, diku afër Mekës, gjashtë burra khazrexhë, ndër të cilët pesë pranuan Islamin. Vitin e ardhshëm, një grup tjetër u takua me Profetin. Kjo njihet si Besëlidhja e Parë e Akabesë. Të lodhur nga mosmarrëveshjet e vazhdueshme, jathribasit mirëprisnin një faktor pajtues. Profeti dërgoi me ta Mus’ab bin Umejr që t’ua shpjegonte fenë e re. Pas një viti, shtatëdhjetë e pesë burra dhe dy gra do t’i jepnin besën Profetit në Akabe. Kjo ishte Besëlidhja e Dytë e Akabesë.

Kur mekasit panë se besimtarët po shpërnguleshin në Jathrib, vendosën ta vrisnin Muhammedin a.s. nëpërmjet një grupi të rinjsh prej secilit klan, kështu që përgjegjësia

nuk do t'i mbetej kujt. Kur të rinjtë rrethuan shtëpinë e tij, Profeti a.s. me Ebu Bekrin dolën natën nga Meka pa u vënë re. Kjo ngjarje hyri në historinë islame si Hixhreti (Emigrimi) dhe hapi Erën Islame, me institucionalizimin e fesë dhe përhapjen e shpejtë të saj. Me këtë ngjarje fillon edhe kalendari islamik sipas vitit hënor tradicional. Datë e parë është 1 Muharrem i vitit 1h. (hixhri) që përkon me datën 16 korrik 622. Emigrimi filloi më 26 Sefer 1h. (9 shtator 622), ditën e enjte. Pasi qëndruan tri ditë në Malin Theur, ditën e hënë, më 1Rebiul Evvel (13 shtator),

Muhammedi a.s. dhe Ebu Bekri u nisën me një shoqërues drejt veriut duke i lakuar udhës së karvaneve. Më 8 Rebiul Evvel (20 shtator) arritën në Kuba, afër qytetit dhe, ditën e premte, më 12 Rebiul Evvel 1h. (24 shtator 622), banorët e Jathribit, që më pas do të quhej Medinet-ul Nebi (Qyteti i Profetit) ose thjesht Medine, pritën ardhjen e Profetit të Shenjtë. Avs dhe Khazrexh, të bashkuar, e njohën Profetin si autoritet shpirtëror dhe politik. Një marrëveshje u arrit me fiset hebrenj për mbrojtjen e përbashkët të qytetit dhe për të mos bërë aleanca me armiqtë e secilës palë. Muslimanët, hebrenjtë dhe pakicat e tjera do të kryenin lirisht ritet e tyre. Armiqësitë dhe gjakmarrjet e kohës së mëparshme, që u quajt koha e barbarisë (padijes), anuloheshin dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve do të bëhej në prani të Profetit. Pikat e marrëveshjeve formuan kushtetutën e parë islame, të quajtur Sahifetul Medinah (Karta e Medines).

**624, 13 mars (17 Ramadan 2h.) Beteja e Bedrit.
Judenjtë e klanit Benu Kajnuka**

Jeta në Medine shtronte para bashkësisë islame probleme të reja. Të ardhurit, muhaxhirët, ishin njerëz pa shtëpi e katandi. Vendasit, ensarët (ndihmëtarët), i mbanin ata nëpër shtëpitë e tyre mbi bazën e vëllazërimit që ndonjëherë merrte drejtim të gabuar në të drejtën e trashëgimisë. Mes klaneve kishte njerëz të cilëve u qe cenuar pozita fisnore. Ata, si individë apo në formacione, do të dilnin para shoqërisë së re me dy fytyra. Përtej qytetit ishin beduinët, banorët e shkretëtirës. Siç thotë Kurani, ata “mbanin vesh” të dëgjonin se ç’po ndodh. Judenjtë nuk kishin më fuqi t’i ndryshonin ngjarjet në Medine. Edhe pse në dukje një komunitet, ata ishin të ndarë sipas interesave. Nga ana e tij, Profeti a.s. do të ruante me çdo kusht unitetin e muslimanëve. Ky qe çelësi i suksesit të strategjisë së tij. Në qendër të kuadrit të përgjithshëm qëndronin individë dhe familja. Mbi ç’bazë do të ndërtoheshin të drejtat dhe marrëdhëniet e tyre përderisa feja e re mohonte rendin e vjetër? Gjatë periudhës së Medines vërejmë se si ndryshon toni i Kuranit, nga ajetet me vargje të shkurtra e të fuqishme ku tërhiqet vëmendja, dënohet e keqja dhe bëhet thirrje te Zoti dhe e mira, në fjalitë e gjata ku bëhet analizë dhe jepen udhëzime e vendime. Sepse Kurani nuk ishte një përmbledhje lutjesh e përsiatjesh, por platformë dhe program për besimtarët.

Konflikti i armatosur qe zgjidhje e pashmangshme. Për kurejshët, Medina ishte tashmë jo vetëm strehë e të ikurve, por një fuqi rivale dhe pengesë në rrugën e karvaneve. Për emigrantët, ata ishin armiq të betuar që i nxorën nga shtëpitë e tyre dhe u mbajtën peng gratë, fëmijët dhe pasurinë. Medinasit, emigrantë e ndihmëtarë, ishin gati të sakrifikonin edhe pse një fuqi e dobët, pa aleatë. Mirëpo

urdhri i luftës nuk kishte ardhur. Gjatë gjithë atyre viteve vuajtjesh e mundimesh, Kurani këshillonte durim: ***“Të durosh e të falësh, kjo është ndër çështjet vendimtare.”*** (42:43) Kur erdhi urdhri i luftës, u përcaktua shprehimisht me ajetin: ***“Luftojini në Rrugën e Zotit ata që ju luftojnë, por mos e teproni. Zoti nuk i do ata që e teprojnë.”*** (2:190) “...ata që e teprojnë,” me një fjalë, janë agresorët. Prandaj kjo pjesë e ajetit është përkthyer: ***“Zoti nuk i do agresorët.”***

Aty nga marsi 624, ramazan i vitit të dytë të emigrimit (hixhri), një forcë prej treqind e trembëdhjetë vetësh, emigrantë e ndihmëtarë, doli nga Medina në drejtim të burimeve të Bedrit, rreth 130 km. në jugperëndim, për t’i prerë udhën karvanit mekas që po kthehej nga Siria. Ndërkohë, mekasit, nëntëqint e pesëdhjetë apo një mijë luftëtarë, me në krye Ebu Xhehlin (Amër bin Hisham), po lëviznin me shpejtësi drejt veriut. Më gjashtëmbëdhjetë të muajit ramazan, Profeti a.s. i mbajti trupat afër një pusi në bregun perëndimor të Bedrit. Atë natë, pararoja e tij zuri rob dy vetë që po mbushnin ujë dhe i mori në fillim për të karvanit. Më tej doli se, jo larg anës tjetër të bregut, kishte qëndruar një forcë e madhe mekase. Medinasit u ndodhën papritur mes dy grupeve: karvanit në ultësirë, me pak njerëz të armatosur dhe ushtrisë në krahun e majtë. Traditë luftarake e arabëve ishin aksionet e shpejta dhe jo ndeshjet frontale. Kur Profeti i pyeti luftëtarët nëse donin të ktheheshin në Medine, sepse, sipas marrëveshjes, medinasit kishin për detyrë të mbronin qytetin, ata, si edhe emigrantët mekas, ishin gati të vriteshin në fushëbetejë. Nga ana e tij, Ebu Sufjani, drejtuesi i karvanit, arriti t’i largohej rrezikut dhe i çoi fjalë Ebu Xhehilit të merrte rrugën e Mekës. Ebu

Sufjani, vëlla qumështi me Muhammedin, ishte njëri nga njerëzit më të shquar në Mekë. Inteligjent, orator, poet e tregtar, Ebu Sufjani do të bëhej kundërshtari kryesor i misionit profetik të Muhammedit a.s. gjatë periudhës së Medines. Por, pas pushtimit të Mekës, ai pranoi Islamin dhe mori pjesë në beteja të ndryshme përkrah Profetit. Ndërsa Ebu Xhehli nuk ishte nga ata njerëz që kthenin mbrapsht. Megjithë kundërshtimet mes klaneve, të nesërmen në të gdhirë i vendosi mekasit në formacion luftimi.

Kurani e përshkruan ngjarjen kështu: ***“Kur ju ishit në bregun e afërm, ata në bregun e largët dhe karvani, poshtë jush, edhe po të kishit lënë pikëpjekje, do të mungonit. Mirëpo, që Zoti të ekzekutonte një vendim, ata që do të vdisnin, të vdisnin pas një prove të qartë; ata që do të jetonin, të jetonin pas një prove të qartë. Zoti është dëgjues, dijeplotë.”*** (8:42) Nga mekasit dolën tre luftëtarë për duel. Profeti nxori tre vetë nga klani i tij. Në ndeshjen e parë, mekasit mbetën të vrarë. Pastaj filloi beteja ku muslimanët arritën fitore të plotë. Ebu Xhehli dhe shumë mekas mbetën të vrarë. Të tjerët lanë robër dhe u tërhoqën në ikje. Nga besimtarët u vranë katërmbydhjetë vetë. Pas betejës, u kthyen me robërit në Medine.

Dy judenj Benu Kajnuka patën shkuar, njëri në Mekë me elegji për të rënë të Bedrit dhe tjetri pranë fiseve beduine duke nxitur urrejtjen ndaj muslimanëve. Kur u kthyen në Medine, Profeti urdhëroi vrasjen e tyre. Një ngjarje që ndodhi më vonë, gjatë konfliktit mes muslimanëve dhe judenjve për mbrojtjen e nderit të një gruaje muslimane, e acaroi situatën. Judenjtë u mbyllën në fortifikatat e tyre

dhe, pas një rrethimi që zgjati pesëmbëdhjetë ditë, u larguan nga vendi.

625, mars (15 Shevval 3 h.) Beteja e Uhudit. Judenjtë e klanit Benu Nadir. Ekspedita e dytë në Bedër

Beteja e Uhudit që mësime për emigrantët mekas dhe ndihmëtarët medinas se në luftë duhet rregull e disiplinë. Kurani thotë: ***“Zoti i do ata që luftojnë në Rrugën e Tij, në rreshta, si një trup i vetëm.”*** (61:4) Një vit pas humbjes së parë, tre mijë luftëtarë mekas ngritën kampin e tyre pranë malit të Uhudit, në anën veriperëndimore të Medines. Një mijë luftëtarë medinas ishin gati të ndesheshin me ta. Abdullah bin Ubej, njëri nga krerët medinas, dha mendimin që të mbrohej qyteti dhe Profeti a.s. e mbështeti atë. Por, pjesa më e madhe e luftëtarëve ishte për t'i dhënë armikut betejë të hapur, si në Bedër. Atëherë, Abdullah bin Ubej me treqind luftëtarë u tërhoq në Medine. Profeti i vuri besimtarët në formacion luftimi rrëzë Uhudit dhe la pas një shtegu të hapur pesëdhjetë harkëtarë për të ruajtur me çdo kusht shtegun. Në fillim, beteja që për besimtarët. Radhët e para të mekasve u thyen. Shumë nga harkëtarët lanë pozicionet dhe u hodhën pas presë. Khalid bin Velid, me njëqint kalorës, vrau harkëtarët e mbetur dhe sulmoi nga pas. Muslimanët filluan tërheqjen në panik duke lënë Profetin me një grup luftëtarësh. Në përpjekje për t'i bashkuar forcat, Profeti u plagos dhe ra pa ndjenja. Ushtria u mblodh rreth tij. Mekasit menduan se ia arritën qëllimit dhe lanë fushën e betejës. Mes dy palëve u shkëmbyen thirrje për t'u takuar përsëri. Nga ana e muslimanëve mbetën në betejë shtatëdhjetë e dy luftëtarë, besimtarë dhe aleatë. Me ta ishte edhe Hamzai, Luani i Zotit, siç e quajti Muhammedi a.s. Pas lutjeve për të rënë dhe varrimin e

tyre, Profeti a.s. u kthye në Medine, por nuk e hoqi parzmoren. Atë natë, mblodhi ushtrinë dhe doli nga qyteti. Jo larg kampit të mekasve, muslimanët qëndruan në një vend të ngritur ku Profeti porositi të ndiznin sa më shumë zjarre. Një kalimtar u tha mekasve se e tërë Medina kishte dalë në ndjekje të tyre. Mekasit u larguan.

Duke i bërë jehonë ngjarjes së Uhudit, Kurani, mes të tjerash, thotë: ***“Muhammedi është vetëm një i dërguar. Kaluan para tij të dërguar. Po të vdiste a të vritej, ju do të dezertonit? Kush dezerton, nuk i bën dëm Zotit. Zoti i shpërblen mirënjohësit.”*** (3:144)

Judenjtë Benu Nadir banonin gjysëm dite rrugë në jug të Medines. Aty nga gushti, Profeti a.s. shkoj te ata bashkë me Ebu Bekrin, Omerin dhe Aliun për t’u kërkuar të kontribuonin, sipas marrëveshjes, në shlyerjen e gjakut familjeve të dy beduinave të vrarë pa dashje. Judenjtë, kur bëhej thirrje për kontribut, thonin: “Allahu është i varfër dhe ne të pasur.” (Shih 3:181) Me këto fjalë, donin të bënin për vete pjesën e lëkundur të medinasve dhe, në të njëjtën kohë, merrnin me tallje Emrin e Zotit, kur e dinin që muslimanët besojnë një Zot dhe se respektonin në besim ithtarët e Librit, hebrenjtë e të krishterët. Edhe kur kishin ndonjë detyrim për t’u larë arabëve, thonin: “S’mbajmë përgjegjësi për të paditurit.” (Shih 3:75) Lanë Muhammedin a.s. me shokët e tij të prisnin jashtë dhe vetë u tërhoqën për të biseduar. Nuk bisedonin, por bënin plan të vrisnin Profetin. Kjo gjë, atij iu zbulua dhe u kthye në Medine pa marrë përgjigje. Prej andej u çoi fjalë të linin trojet për shkak të pabesisë së tyre. Ata përsëri nuk u përgjigjën. Si edhe kajnukët, besonin në forcën e tyre dhe te

aleatët. Pas tri javësh rrethimi, benu nadirët u larguan drejt Khajberit me gjashtëqint deve të ngarkuara.

Nga muaji dhjetor, Rexhep i vitit 4h., Profeti a.s., me një mijë e pesëqind luftëtarë, u nis në drejtim të Bedrit për t'iu përgjigjur thirrjes së kurejshëve. Nga ana e tyre, kurejshët po marshonin drejt Bedrit me dymijë luftëtarë. Kur arritën në vend, Ebu Sufjani, që nuk priste të ndeshej me një forcë të madhe, në mungesë të rezervave, vendosi të tërhiqej. Muslimanët qëndruan atje një javë.

627, shkurt-mars (Shevval-Dhulkadeh, 5h.) Beteja e Hendekut. Judenjtë e klanit Benu Kurejdha

Judenjtë Benu Nadir me ata të Khajberit dërguan njerëz në Mekë dhe pranë fisit Ghatafan duke premtuar ndihmë në rast se do të sulmonin Medinen. Aty nga fundi i vitit të pestë hixhri, fillimi i vitit 627, rreth dhjetë mijë trupa të koalicionit, me në krye Ebu Sufjanin, rrethuan Medinen. Në Kuran, ky koalicion përmendet me fjalën Ahzab (grupimet; këtu: klanet. Shih kreun 33). Sipas planit të Selman Farisiut, një rob persian, këshilltar i Profetit a.s., medinasit hapën në gjashtë ditë një hendek të madh përgjatë pjesës veriore, të pambrojtur të qytetit. Kanali ishte pesë kilometër e gjysëm i gjatë, rreth pesë metër i gjerë dhe më se tre metër i thellë. Dheu i gërmuar formonte një ledh të lartë nga brenda. Profeti i Shenjë punonte bashkë me të tjerët. Kur filloi lufta, flamurin ia dha Aliut. Ai doli së pari në fushë të hapur dhe fitoi duelin me kurejshët. Rrethimi zgjati pa sukses një muaj. Medinasit ia arritën të përçanin koalicionin dhe të provokonin me aleatët e tyre një marrëveshje të dështuar mes kurejshëve dhe klanit Benu Kurejdha në jug të qytetit. Studiuesit orientalistë e quajnë

Betejën e Hendekut si betejë të mençurisë. Rrethuesit ndodheshin në gjendje shumë të vështirë. Të plagosurit i mbanin në faltore. Gratë e fëmijët i mblodhën së bashku në thellësi, diku pranë kurejdhëve. Kur u mor vesh qëndrimi i dyshimtë i tyre, një forcë prej më se dyqint vetësh rrinte në ruajtje të popullatës. Më në fund, një stuhi e fortë dhe rrebesh shiu, ua shkatërroi kampin rrethuesve. Të demoralizuar, e ngritën rrethimin.

Me t'u larguar klanet, Profeti iu kthye benu kurejdhëve, të mbyllur në kullat e tyre. Pas njëzetë e pesë ditësh rrethimi, kurejdhët u dorëzuan. Ata zgjodhën si gjykatës Sa'd ibn Muadh, kryetarin e klanit Avs, aleat i dikurshëm me judenjtë Benu Kurejdha. Sa'd gjykoi për tradhti, sipas ligjit hebre, me vrasjen e burrave dhe robërimin e grave e të fëmijëve. Për këtë, në Kuran thuhet: ***“I zbriti nga fortifikatat e tyre ithtarët e Librit që i mbështetën ata dhe u futi panik në zemër. Një pjesë e vratë dhe një pjesë e robëruat. / Dhe jua trashëgoi juve tokën e tyre, shtëpitë e tyre, mallin e tyre, një vend që nuk e patët shkelë. Zoti është mbi gjithçka pushtetplotë.”*** (33:26-27)

628, mars (Dhulkadeh, 6 h.) Pakti i Hudejbijes

Pas gjashtë vjetësh emigrimi, muslimanët ishin në gjendje të kërkonin një marrëveshje me kurejshët për vizitën dhe pelegrinazhin në Faltoren e Shenjtë, si e drejtë e çdo individi apo bashkësie në Arabi. Lufta në muajt e shenjtë që tradicionalisht e ndaluar (haram). Në muajin Dhul kade të vitit të gjashtë të hixhretit, Profeti i Shenjtë, me një mijë e katërqint besimtarë të veshur me ihram, petkun e bardhë të pelegrinazhit dhe me shtatëdhjetë bagëti për kurban, doli me ceremoni nga Medina për të kryer umren (vizitën) ose,

siç quhet ndryshe, haxhin e vogël. Pelegrinët kishin me vete vetëm nga një shpatë, si armë dhe mjet që mbante çdo njeri në rrugë e sipër. Profeti ftoi në umre fiset beduine rreth Medines, por ata nuk i erdhën. Kurani, me këtë rast, i kritikon sepse ata shkonin vetëm pas presë. (Shih kreun 48)

Kur mekasit e morën vesh, nisën një forcë nën komandën e Khalid bin Velidit dhe Ikrimë ibn Ebu Xhehlit për t'i penguar muslimanët të hynin në kufijtë e zonës së shenjtë. Medinasit ndryshuan rrugë dhe qëndruan në Hudejbije, në krahun lindor të Mekës. Profeti dërgoi për bisedime Othman bin Affanin, shokun dhe dhëndrin e tij, njeri i mirënjohur në Mekë dhe kushëri me Ebu Sufjanin. Ndërkohë mekasit nisën tre vëzhgues njëri pas tjetrit për të parë nëse muslimanët ishin të përgatitur për umre. Një njësit i armatosur mekas ra në duart e muslimanëve dhe ata e lanë të lirë të kthehej në Mekë. Nga ana e tyre, kurejshët mbajtën Othmanin peng dhe në Hudejbije erdhi fjala se e kanë vvarë. Atëherë, Muhammedi a.s. mbloodhi bashkudhasit e tij dhe u mori besë të luftonin për vdekje. Në betim e sipër, Othmani u kthye bashkë me përfaqësuesin e kurejshve, Suhejl ibn Amr, i njohur në Mekë si khatib (orator).

Zoti e përshëndeti besën që dhanë besimtarët në Hudejbije me fjalët kuranore: ***“Ata që të dhanë besë ty, i dhanë besë Zotit. Dora e Zotit është mbi duart e tyre...”*** (48:10)

Muhammedi a.s. që i vendosur të arrinte një marrëveshje. Shkruar ishte Aliu. Së pari, Suhejli kërkoi të ndryshohej hyrja e protokollit, nga shprehja kuranore: “Bismil-Lahir-Rahmanir-Rahim,” në: “Bismike All-llahumme” (Me

Emrin Tënd, o Zot), sipas shprehjes tradicionale arabe dhe, nga: “Muhammedi, i Dërguari i Zotit,” në: “Muhammedi, biri i Abdullahit.” Pastaj u përmblodhën pikat e marrëveshjes, sipas të cilës, një pakt dhjetëvjeçar paqeje arrihej mes dy palëve dhe aleatëve të tyre; muslimanët të ktheheshin pa kryer umren dhe ta bënë atë vitin e ardhshëm pasi kurejshitët të kishin liruar qytetin për tri ditë; muslimanët detyroheshin të kthenin mbrapsht ata që do të iknin nga Meka në Medine, ndërsa mekasit nuk detyroheshin të kthenin të ikurit nga Medina; secila palë kishte të drejtë të bënte aleatë.

Omeri dhe shumë nga besimtarët nuk arritën të kuptonin perspektivën e kësaj marrëveshjeje. Muhammedi a.s., me vizionin e tij profetik, shihte në të hapjen në vend të izolimit, njohjen në vend të mohimit dhe një fitore të afërt të Islamit. Pakti i Hudejbijes është po aq aktual në ditët tona, një mësim për muslimanët dhe udhëheqësit e tyre. Duke siguruar paqen afatgjatë me kundërshtarin kryesor dhe aleatët e tij në jug, Muhammedi i jepej mundësia t’i dilte përpara një rreziku të pranishëm nga veriu. Në të njëjtën kohë, Medina njihej si fuqi e pavarur me të cilën mund të krijoheshin lidhje e të bëheshin marrëveshje.

Kreu Fitorja vërtetoi arritjen në Hudejbije: ***“Ne të dhamë një fitore të qartë. / Që të t’i falë Zoti mangësitë e mëparshme e ato të mëpasshme, ta plotësojë Mirësinë e Tij ndaj teje dhe të të udhëheqë në udhë të drejtë; / të të ndihmojë Zoti me një përkrahje të fuqishme. / Është Ai që zbriti qetësi në zemrat e besimtarëve për t’u shtuar besim në besimin e tyre. Ushtritë e qiejve dhe të tokës janë të Zotit. Zoti është dijeplotë, i urtë.”*** (48:1-4)

628, maj-qershor (Muharrem-Sefer, 7 h.) Ekspedita e Khajberit

Më së shumti, pjesëmarrësit e Hudejbijes dhe disa forca që iu bashkuan atyre me njëqind a dyqind kalorës, pas kthimit në Medine, iu drejtuan Khajberit, rreth 150 km. në veriperëndim. Lëvizja që e shpejtë, në vetëm tri ditë rrugë dhe i zuri banorët e Khajberit në befasi, para se të përquendronin forcat e tyre disa herë më të mëdha apo të kërkonin përforcime nga ghatafanët në jug dhe fiset e tjera beduine. Judenjtë e Khajberit me ata të klanit Benu Nadir patën marrë nismën kryesore në organizimin e klaneve gjatë rrethimit të Medines. Edhe më pas, ata përbënin rrezikun më të afërt për muslimanët. Por, siç thotë Kurani: ***“i pandeh të bashkuar dhe zemrat e tyre janë të përçara.”*** (59:14)

Fortesat e Khajberit, të ngritura nëpër vende shkëmbore anembanë oazit, njiheshin si të papushtueshme. Kur filloi rrethimi në front të gjerë, harkëtarët nga brenda u shkaktuan shumë dëme muslimanëve. Pesë ditë me radhë, rrethuesit nuk arritën asnjë sukses. Ditën e gjashtë, natën, Omeri zuri rob një jude i cili u tregua i gatshëm të bashkëpunonte duke thënë të merreshin më parë fortesat më të dobëta dhe u tregoi fortesën e quajtur Naim ku që fshehur një sasi e madhe armësh dhe mjetesh luftarake. Të dhënat ishin të sakta. Pasi vunë në dorë gjithë ato mjete, fortesat zunë të binin njëra pas tjetrës. Fortesa e fundit që ajo Al Kamus, e rrethuar për gati një muaj. Pasi dështuan disa sulme, Profeti a.s. nxori në vijën e parë Aliun i cili kishte qenë pak më parë i sëmurë. Pasi ia fërkoj sytë me dorën e tij dhe e bekoi, Aliu vrau në duel dy vëllezër,

Harithin dhe Marhabin, luftëtarë të përmendur ndër fiset arabe. Pastaj iu sul portës së fortesës dhe muslimanët pas tij morën zemër.

Dy fortesa që u dorëzuan me dashje, nuk u prekën. Kërkesën e khajberasve për të qëndruar në trojet e tyre duke dhënë gjysmën e prodhimit, Profeti e pranoi me kusht që të ndërprisnin aktivitetin armiqësor. Po ato ditë, e veja e një judeu solli para Profetit një qingj të pjekur si dhuratë për paqen. Profeti a.s. e pranoi dhe u shtrua me shokët e tij. Mori një copë mish shpatulle dhe e futi në gojë. Dikush tjetër, një khazrexhit me emrin Bishr, ndër të parët e Besëlidhjes së Akabesë, përtypi copën e mishit dhe e çoi poshtë. Profeti e nxori menjëherë kafshatën dhe u thirri shokëve: “Mbani duart!” Bishr vdiq pas pak. Kur e thirrën gruan dhe e pyetën pse e bëri atë, tha se i kishin vrarë babanë, ungjin dhe burrin dhe se Muhammedit, po të qe profet, kjo gjë do t’i rrëfehej. Profeti a.s. e la atë të lirë, por, katër vjet më vonë, në prag të vdekjes, do të thoshte se helmi e kishte bërë efektin e vet.

629, mars (Dhulkadeh, 7 h.) Umreja e prapambetur

Sipas marrëveshjes, Profeti i Shenjtë me dymijë besimtarë, plot një vit më vonë, u nis për në Mekë të kryente pelegrinazhin e umres së vitit të kaluar. Mekasit liruan qytetin dhe zunë vend në një kodër prej nga dukeshin ritet e pelegrinëve muslimanë. Duke i shkuar përqark Qabes, përhapeshin anembanë thirrjet: “Lebbejk All-llahumme, lebbejk!” (Ja ku jam, o Zot, ja ku jam!). Pjesëmarrja, uniteti dhe devotshmëria e tyre lanë mbresë të thellë te idhujtarët. Vëllezërit e tyre, besimtarë në Zotin dhe Profetin e Tij, po ktheheshin triumfues, jo si njerëz të ikur, pa plëng e shtëpi.

Më vonë, ata që ikën në Medine, për t'i shpëtuar kthimit të detyrueshëm te kurejshitët, u vendosën diku pranë Detit të Kuq dhe prej andej sulmonin karvanet mekase. Kështu që mekasit i dërguan një letër Profetit a.s. t'i pranonte të konvertuarit rishtas. Në këtë kohë muslimanëve iu bashkuan dy kalorës e luftëtarë të shquar nga Meka, Khalid bin Velid dhe Amër bin As, ata që do të thyenin ushtritë e Bizantit e të Persisë.

629, shtator (Xhumadel ula, 8 h.) Beteja në Mu'teh

Pas paqes së arritur në Hudejbije, Profeti a.s. nisi emisarët e tij te sundimtarët e kohës me ftesën për Islam. Njërin prej tyre e vrau në rrugë kreu i gassanidëve, Shurahbil. Po kështu kishte ndodhur edhe me emisarët e dërguar pranë disa fiseve nomade. Për të ndëshkuar vrasësin, Profeti nisi në drejtim të veriut një ushtri prej tremijë vetësh. Në krye të saj vuri Zejd bin Harithën, ish skllavin dhe birin e vet të adoptuar; pas tij caktoi kushëririn, Xhafer bin Ebu Talibin dhe, të tretin, Abdullah bin Revahën. Me këtë, Profeti a.s. parandjente një betejë të përgjakshme me gassanidët. Sidoqoftë, ai porositi ushtrinë të bënte së pari thirrje në Islam, të mos vriste gra, pleq e fëmijë dhe të mos dëmtonte të mbjellat e bagëtisë.

Zejdi e mbajti ushtrinë në Me'an, brenda territorit sirian, ku u mor vesh se pas gassanidëve ishin legjionet bizantine të Teodorit me njëqind mijë trupa. Zejdi vendosi të priste udhëzime nga Medina. Abdullah bin Revaha u ngrit e tha: "O njerëz! Për Zotin, ajo që i frikësoheni se mund t'ju ndodhë është pikërisht motivi për të cilin erdhët këtu, të rënë dëshmor. Ne, muslimanët, nuk luftojmë me numër,

fuqi fizike a pajisje materiale. Fuqia jonë e vetme është në këtë fe që Zoti Shumëbujar na i ka dhënë. Çohuni për betejë dhe marshoni përpara! Njëra nga dy bekimet më të mëdha do t'ju vijë, fitorja ose të rënët dëshmor!” (Shih 9:52) Zejdi u dha betejë bizantinëve pranë kampit të tyre në fshatin Masharif, në juglindje të Detit të Vdekur. Përballë frontit të gjerë të armikut, u tërhoq drejt luginës në Mu'teh ku u zhvilluan luftime të rrepta. Me flamurin e Profetit në dorë, Zejdi u fut thellë në radhët e armikut derisa e mbuluan shigjetat. Pas tij, flamurin e mori Xhaferi, cili luftoi kaluar dhe, kur kali ra nën të, çau me shpatë në dorë; kur ia prenë njërin krah, e mbajti flamurin me dorën tjetër; kur ia prenë krahun tjetër, e shtrëngoi flamurin me dy këmbët, derisa dha shpirt. Më tej, flamurin e mori Abdullah bin Revaha. Mendja e Abdullahit ishte më e guximshme se vullneti i tij. Ai u mbajt aty ku qe dhe, me thirrje në vargje, u jepte kurajë vetes e shokëve. Kur Abdullahi ra, flamurin e mori në dorë Thabit bin Arkam i cili thirri që dikush tjetër ta merrte komandën. Khalid bin Velidi po luftonte për herë të parë në radhët e muslimanëve. Me të marrë flamurin, Khalidi ndërroi taktikën e luftimit, nga ndeshja frontale, në goditje të shpejta dhe tërheqje. Kur ra nata, Khalidi ndryshoi formacionin e ushtrisë. Në mëngjes, detashmentet me flamuj të rinj në front dhe pluhuri i madh që ngrinte kavaleria e fshehur pas kodrave, bënë që ushtria bizantine të tërhiqej duke menduar se kishin ardhur përforcime. Khalidi gjithashtu u tërhoq dhe i ktheu trupat në Medine. Atje populli i priti me grushta dheu, por Profeti i Shenjtë mbajti një fjalim ku vlerësoi heroizmin e ushtrisë dhe aftësitë luftarake të Khalid bin Velidit të cilit i dha titullin: “Shpata e Islamit.”

Kurani thotë: “Zoti ka blerë nga besimtarët veten e tyre dhe pasuritë e tyre me parajsë. Luftojnë në Rrugën e Zotit, vrasin e vriten. Premtim i vërtetë i Tij në Teurat, Ungjill e Kuran. Kush e përmbush besën veç Zotit? Përgëzohuni me shitblerjen që keni bërë! Ky është sukseesi i madh” (9:111)

630, janar (20 Ramadan 8 h.) Fitorja e Mekës

Një ngjarje që pati ndodhur mes klaneve Benu Bekr dhe Khuza, ku kurejshët, në kundërshtim me Paktin e Hudejbijes, ndihmuan njëren palë ndaj palës tjetër, aleate e muslimanëve, e detyroi Ebu Sufjanin të merrte i vetëm rrugën e Medines për të biseduar me Muhammedin, duke u nisur nga lidhjet familjare, aq më tepër që tashmë Muhammedi kishte për grua të bijën, Umm Habibën. Umm Habiba me të shoqin ishin ndër muslimanët e parë që u shpërngulën në Abisini. Atje i shoqi ndërroi fenë në të krishterë. Me vdekjen e tij, Muhammedi i çoi fjalë të kthehej në Medine dhe të martohej me të. Në Medine, Ebu Sufjani shkoi së pari te e bija. Ajo, si edhe gratë e tjera të Profetit a.s., jetonte në një kthinë pranë xhamisë, me një shtrat ku uleshin e flinin. Ebu Sufjani ishte pasanik i madh ndërsa Muhammedi a.s. bënte po atë jetë të thjeshtë, si dikur, me gjithë ato trofe lufte. E bija ia largoi shtratin dhe i tha se ai që idhujtar, jo i pastër. Profeti nuk këshillonte këtë sepse Kurani i Shenjtë këshillon respektin e prindërve, qofshin mohues. Ebu Sufjani u largua i mërzhitur. Takoi Muhamedin a.s. dhe i foli për ngatërresën mes dy klaneve. Para tij, një i dërguar i khuzejve ia pati treguar ngjarjen. Tani u vërtetua se ata kishin të drejtë. Ebu Sufjani u takua edhe me njerëz të tjerë të njohur, pa marrë ndonjë premtim. Pastaj u kthye në Mekë.

Profeti i Shenjtë përgatiti forcat për një ekspeditë, qëllimi i së cilës nuk dihej. Një letër, me anë të së cilës një emigrant, pjesëmarrës i betejës së Bedrit, lajmëronte njerëzit e vet në Mekë për një luftë të mundshme, që kapur në rrugë. Profeti deshte t'i zinte mekasit në befasi e të mos bëhej gjakderdhje. Përkrah mekasve qenë aleatët e tyre. Natën e njëzetë të ramazanit, 8 hixhri, rreth dhjetë mijë besimtarë të armatosur zunë kodrat e Mekës në pritje të ditës së re.

Kur pa zjarret e ndezura, Ebu Sufjani nxitoi te Abbasi, ungji i Muhammedit dhe që të dy dolën të gjenin Profetin e Shenjtë. Abbasi formalisht nuk qe bërë musliman, por edhe s'e pati braktisur të nipin. Kur e panë Muhammedin a.s., Profetin e Shenjtë, Abbasi i tha: "Ebu Sufjani kërkon prej teje një nder." Muhammedi iu përgjigj: "Le të qëndrojnë në shtëpi." Pas tyre, dërgoi në qytet lajmëtarë që njerëzit të strehoheshin në shtëpinë e Ebu Sufjanit ose të mbylleshin në shtëpitë e tyre apo të mbledheshin të paarmatosur pranë Qabes për të qenë të siguar. Repartet hynë në Mekë nga drejtime të ndryshme. Atje, Bilali, skllavi i dikurshëm, i munduar me torturat më të egra për besimin e tij te Zoti, hypi në muret e Qabes dhe ftoi besimtarët të faleshin. Kur mbaruan, Profeti i Shenjtë hyri në Qabe dhe e pastroi atë nga idhujt e vizatimet. Tek i prekte me tehun e shpatës, recitonte fjalët e Kuranit: "***Erdhi e vërteta dhe u zhduk e pavërteta. E pavërteta është në zhdukje.***" (17:81)

Ndërkohë e tërë Meka qe mbledhur pranë Qabes. Pas vitesh armiqësie e gjakderdhjeje, mekasit e pyetën Muhammedin se çdo të bëhej me ta. Ai iu përgjigj me fjalët e Jusufit të vëllezërve: "***Sot s'ka qortim për ju. Zoti ju faltë! Ai është***

Mëshiruesi i mëshiruesve.” (12:92) Pastaj u ul në Safa, pranë Qabes dhe aty mekasit i dhanë besën për Islam.

630, janar (6 Shevval 8 h.) Beteja e Hunejnit

Kur dëgjuan rënien e Mekës në duart e muslimanëve, fiset e mëdha Havazin e Thekif u mobilizuan për luftë. Kryetari i havazinëve, Malik bin Auf, lajmëroi njerëzit e tij të dilnin të gjithë, me kafshë e bagëti, për t'i bërë sa më shumë përshtypje armikut. Profeti la Mekën me dymbëdhjetë mijë vetë, ndër të cilët dymijë ishin mekas dhe u takua me forcat e bashkuara kundër tij në luginën e Hunejnit, rreth gjashtëmbëdhjetë kilometër në juglindje. Muslimanët ranë papritur përmes breshërisë së shigjetave të kundërshtarit dhe sulmin e kavalerisë së tyre. Radhët e para u tundën dhe u prapsën. Përkrah Muhammedit a.s. qëndronin Abbasi me Ebu Suffjanin. Me thirrjen e tyre, forcat u përqendruan dhe vazhduan sulmin deri në fitoren e plotë. Një pjesë e kundërshtarit u tërhoq në Taif ku mbeti e rrethuar dy muaj. Me këshillën e Khalid bin Velidit, Profeti la Taifin dhe u kthye në Mekë ku bëri umren dhe, bashkë me ushtrinë, mori rrugën e Medines.

Duke i bërë jehonë betejës së Hunejnit, Kurani, mes tjerash, thotë: ***“Zoti ju ndihmoi në shumë fushëbeteja edhe Ditën e Hunejnit kur ju mahniti epërsia juaj e nuk ju vlejti gjë, u ngushtua para jush toka me gjithë gjerësinë e saj dhe u kthyet në ikje...”*** (9:25)

630, tetor (Rexhep, 9 h.) Fushata në Tebuk

Tebuku ndodhet mes rrugës nga Medina për në Damask, një qendër brenda territorit arab të Hixhazit. Pra, fushata në Tebuk ishte strategji mbrojtëse. Në Historinë Islame,

Fushata e Tebukut njihet me emrin Gazvetu'l Usrah, Fushata e Vështirësisë. Profeti i Shenjtë mobilizoi një fushatë të tillë, me pjesëmarrje të gjerë, në kushte të një të nxehti të madh e thatësire dhe mungesave në pajisje e transport, pas lajmeve për lëvizjen e ushtrisë bizantine. Profeti doli nga Medina me tridhjetë mijë trupa, ndër të cilat, dhjetë mijë kalorës dhe njëzetë mijë këmbësorë. Njerëzit e lëkundur, hipokritët e Medines dhe disa beduinë u përpoqën të sabotonin fushatën, duke thënë: “Mos dilni në të nxehtë.” Zoti thotë: “Thuaj: “Zjarri i skëterrës është më i nxehtë....” (Shih 9:81) Për këtë fushatë, Ebu Bekri, Othmani, Abdurahman bin Auf dhe shokë të tjerë dhanë, kush më shumë e kush më pak, gjithë pasurinë e tyre, me deve, ar dhe argjend.

Nga Tebuku, Profeti dërgoi emisarë në fiset arabe. Disa pranuan Islamin, të tjerë njohën protektoratin e Medines ndaj një tributi vjetor. Pasi qëndroi atje rreth njëzetë ditë, Profeti u kthye me ushtrinë në Medine, ndërsa Khalid bin Velidi me katërqind kalorës ndërmori një ekspeditë në Deumat el Xhandal prej nga solli rob kryetarin e fisit, Ukajdir bin Malik me të vëllanë. Në Medine ata pranuan protektoratin islam.

631. (9-10 hixhri) Viti i Delegatëve. Mosangazhimi me idhujtarët

Me rënien e Mekës, autoriteti i Profetit a.s. u rrit mjaft në fiset dhe krahinat e Arabisë. Si edhe më parë, një pjesë njerëzish të mësuar me Kuranin dhe parimet e Fesë Islame dërgohej në kohë paqeje e lufte për të mësuar të tjerët. Fjala e Kuranit përhapej anëmbanë, nga veriu, deri në Siri dhe nga jugu e lindja, në Jemen, Hadramaut dhe Oman. Viti

631 (9-10 hixhri) njihet si viti i delegatëve që vinin në Medine për të pranuar Islamin. Thekifët e Taifit në fillim vunë kushte për të mbajtur idhullin e tyre Lat dhe të mos faleshin. Kur e panë se Profeti nuk bënte lëshime të tilla, pranuan Islamin. Të krishterët e krahinës së Nexhranit, në jug, mbajtën besimin e tyre nën protektoratin e Medines. Aliu u dërgua në Jemen, popullata e të cilit nisi një përfaqësi në Medine për t'u takuar me Profetin e Shenjtë.

Në pelegrinazhin (haxhin) e vitit të nëntë hixhri, Profeti i Shenjtë dërgoi në Mekë Ebu Bekrin me treqind pelegrinë (haxhinj). Përfshirë këtë haxh, edhe pse Qabja që pastruar prej idhujve, ritet kryeshin në të njëjtën kohë nga muslimanët dhe ata pak idhujtarë të mbetur. Ishte kjo arsyeja që Profeti a.s. nuk deshte të merrte pjesë vetë. Ndërkohë kishte ardhur revelata e sures Pendimi ose Mosangazhimi (me idhujtarët). Profeti i Shenjtë dërgoi Aliun që ta bënte këtë sure të njohur mes besimtarëve e jobesimtarëve për mosangazhim të mëtejshëm me idhujtarët dhe heqjen e së drejtës së tyre për të kryer pelegrinazhin në Mekë.

632, mars (Dhul hixhxeh, 10 h.) Pelegrinazhi i Lamtumirës

“Sot jua përsosa fenë, plotësova Mirësinë Time ndaj jush, përleqeva për ju Islamin fe.” (Kurani 5:3)

Viti i 10të hixhri shënonte përvjetorin e parë të Islamit në Arabi. Për të kryer pelegrinazhin (haxhin) e atij viti, me pjesëmarrjen e vetë Profetit të Shenjtë, besimtarët nga të katër anët e Arabisë u mbledhën në Medine. Në fund të muajit Dhul-kadeh, Profeti i Shenjtë, në krye të njëqind

mijë pelegrinëve, doli nga Medina me himnet që dëgjoheshin anembanë: “Zoti është i Madh, Zoti është i Madh. S’ka zot veç Zotit. Zoti është i Madh, Zoti është i Madh. Falënderimi i takon vetëm Zotit.” Në Dhul Halifa, Profeti i Shenjtë dhe haxhinjtë, burra e gra, veshën ihramin, petkun e bardhë të pelegrinit dhe vazhduan rrugën me thirrjet: “Lebbejk All-llahumme, lebbejk!” (Ja ku jam, o Zot, ja ku jam!) Në Mekë arritën ditën e katërt të muajit Dhul-hixhxe. Atje filluan ritet përreth Qabes. Ditën e tetë, vargu i pelegrinëve mori drejtimin e Minasë ku qëndroi një natë.

Në Mina, Profetit të Shenjtë i erdhi frymëzimi nga Zoti me ajetet: ***“Kur vjen ndihma e Zotit dhe fitorja / dhe i sheh njerëzit të hyjnë në Fenë e Zotit grupe-grupe, / thuri lavde tët Zoti dhe kërkoji falje. Vërtet, Falja e Tij është e Madhe.”*** (Fjalë për fjalë: “Vërtet, Ai është Falës i Madh.”) (Kreu Ndihma, 110:1-3) Ky ishte kreu i fundit i shpallur nga Kurani.

Të nesërmen, në Arafat, më 9 Dhul hixhxe 10 h. (5 mars 632), në prani të njëqind e njëzetë e katër mijë besimtarëve, Profeti i Shenjtë mbajti një fjalim që njihet si Predikimi i Lamtumirës (Hutbet’ul Veda). Në këtë fjalim ai shpalli të shenja jetën dhe pasurinë e çdo muslimani, moscenimin e të drejtave të secilit, shfuqizoi hakmarrjen dhe traditat barbare të kohës para islamike, theksoi ndalimin kategorik të fajdes, përmendi të drejtat reciproke mes burrit e gruas dhe trajtimin e grave me mirësjellje e dashuri, mospërçarjen dhe vëllazërimin e muslimanëve, barazinë mes njerëzve, arabit e joarabit, të bardhit e të ziut duke theksuar epërsinë në bamirësi dhe vepra të mira, zbatimin e

detyrave fetare dhe dhënien llogari para Zotit. Zoti i Madh dëshmoi mesazhin e tij.

* * *

Me këtë përmbledhje nuk është bërë qëllim të pasqyrohet jeta e Muhammedit a.s, në aspektin individual e familjar të tij, në rininë e hershme, burrërinë, martesat, vdekjen dhe trashëgiminë e tij. Në Kuran, për shembull, bëhet fjalë për përgojimin e Aishes, gruas së Muhammedit a.s. Kjo mund të trajtohej nga këndi i luftës që i bënin Profetit hipokritët e Medines. Në vështrimin njerëzor, Muhammedi a.s. jetoi si çdo njeri tjetër mes njerëzve. Porse jeta e tij është për ne, muslimanët, shembull sepse Kurani i Shenjtë thotë: “***Te i Dërguari i Zotit keni një model të mirë për këdo që shpreson Zotin dhe Ditën e Fundit dhe që përmend Zotin shumë.***” (33:21) Prandaj, për të kuptuar më mirë e më thellë Kuranin, duhet të merren njohuri për jetën dhe trashëgiminë profetike të **Muhammedit a.s., paqja dhe bekimet e Zotit qofshin me të!**

Kudret Salih Hoxha
Nju Jork, janar 2010

PËRGATITI
Kudret S. Hoxha

© 2014 - 2016kshoxha